Bedri Islami

LËVIZJA

(LINDJE E PËRGJAKUR)

- Bashkëbisedim me Ibrahim Kelmendin -

Bedi Islami: **Lëvizja (Lindje e përgjakur)**
- Bashkëbisedim me Ibrahim Kelmendi -

Faqosja: Ibrahim Kelmendi
Kopertina: Ngadhnjim Memeti

© Të drejtat autoriale: Bedri Islami dhe Ibrahim Kelmendi

Shtypshkronja: Tringa Design (Tetovë, MK)

CIP - Katalogimi në botim
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare
"Shën Kliment Ohridski", Shkup

929 Kelmendi, I.(047.53)

ISLAMI, Bedri
Lëvizja : (lindje e përgjakur) : bashkëbisedim me Ibrahim Kelmendin / Bedri Islami. - Tetovë : Tringa design, 2012. - 496 стр. ; 21 см

ISBN 978-608-211-046-2

a) Kelmendi, Ibrahim (1916-1979) - Intervista
COBISS.MK-ID 90457098

Përmbajtja

Në vend të hyrjes..... 5

I. Lindje e përgjakur 11

Çfarë ndodhi tridhjetë vite më parë..... 25

Pararendje e ditës së 17 janarit..... 41

Dita e 17 janarit..... 55

Pas 17 janarit..... 79

II. Dy Xhaferët 85

Ftohje apo armiqësi..... 95

Enigmat dhe njerëzit e mirë..... 101

Ringritja dhe sherret..... 117

III. Burimet që do të mbushin detin e së ardhmës 130

Çfarë ndodhte ndërkohë në Kosovë?..... 150

Çfarë ndodhte ndërkohë në Perëndim?..... 153

Rikthimi në fillimet e saj..... 161

IV. Vitet 1989-1992 – kthesa dhe zhvillime të mëdha 166

Viti 1989: Çfarë ndodh në Kosovë?..... 180

Ramadan Avdiu rikujton..... 182

Shkaqet e vrasjes së Afrimit..... 183

Pluralizmi dhe Lëvizja..... 186

V. Një kohë e re me mendim të ri 211

Rikthimi në Kosovë..... 227

VI. Lëvizja formon Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës 230

Fillesë e re..... 239

Nga procesverbali..... 263

VII. Në nderim të "Zërit të Kosovës"..... 259

Rrëfimi i Shaban Sinanit 279

VIII. Përgatitja e luftës dhe fillimet e saj 290

Historia e një greve urie dhe vazhdimi i mëtejshëm 309
IX. Dy mendime të ndryshme ……..…..…..…….. 315
Diskutim i I. Kelmendit në mbledhjen e KP, 23 maj 1998 …… 315
Diskutimi I. Kelmendit në mbledhjen e KP, 12 dhjetor 1998 ……..…… 323
X. Njerëzit e mirë të luftës ……..…….…… 334
Parathënia e përfaqësimit politik të UÇK-së ……..…….. 345
Takimi i Brukselit, një ngjarje e panjohur ……. 350
XI. Sprovat konkrete në fillim të Kryengritjes ….....…… 364
Një pyetje e herëshme:
Si ishte qëndrimi ndaj Adem Jasharit dhe zonës së Drenicës? …..……370
Tiranë, mars 1998 ……..……..…….. 382
Kufiri shqiptaro/shqiptar, pranverë 1998 ……..……..….. 388
Përsëri në Tiranë, ardhja e ushtarakëve ……..…… 395
Pranverë 1998, Kosovë ……..……..……. 401
Historia e një Kënge ……..……..…….. 403
Perëndim, pranverë / verë 1998 …..……..….. 405
XII. Mbledhja e Gjashtë e Përgjithshme, maj 1998 .....… 415
Qershor 1998, rizgjedhja e Kryesisë së Fondit "Vendlindje thërret" ….... 427
XIII. Edhe një herë në Tiranë, korrik 1998 ……..... 435
Një qëndrim i kundërt me njëri tjetrin ……..... 448
XIV. Rambujeja / Një nisje e re ……..……..…… 455
Pas Rambujeja dhe fillimi i fundit të luftës ……..……..……. 473
XV. Mbledhja e fundit e Përgjithshme r LPK-së / Prizren, qytet i lirë, qershor 1999 482

Në vend të hyrjes

Në janarin e vitit 1994 më ndodhi një ngjarje e rëndësishme, e cila, tashmë duhet thënë, ndryshoi thuajse krejt pjesën e mbetur të jetës sime. Një telefonatë e ardhur nga larg, në një orë të vonë dimri, të cilën as e kisha menduar, do të ishte edhe zanafilla e kësaj bisede, por edhe e shumë ngjarjeve të tjera të jetës sime. Ibrahim Kelmendi, të cilin deri asaj kohe e njihja më shumë si një ndër njerëzit e lëvizjes klandestine sesa si dhëndër në një fis ku ishte nuse prej dekadash tezja ime, tepër shkurt, siç është në stilin e tij të të folurit, më tha se ishin nisur drejt meje tre shokë të tij, të cilët donin të bisedonin me mua. Siç e thashë, ishte një orë e vonë dimri. Bora kishte mbuluar rrafshinat në të gjitha anët dhe nëpër strehët e shtëpive vareshin heje të gjata akulli. Emrat e tre njerëzve që ai më tha se po udhëtonin drejt meje, ishin të njohur për mua, por vetëm njërin prej tyre e kisha takuar më parë. Quhej Emrush Xhemajli. Ajo që më kishte bërë përshtypje fillimisht, në momentin e parë kur kisha biseduar me të, një mbrëmje vonë, në një rrethinë të Shtutgartit, ishte çanta e tij që e mbante në krah si komisarët e kohës së luftës në Shqipëri, e më pas të folurit e ngadalshëm dhe ajo mirësi e pazakontë që shpërndante rreth vetes. Dy të tjerët do të

ishin Fazli Veliu (më pas do të mësoja se ai kishte edhe një emër tjetër, Daja i madh) dhe Ali Ahmeti, që për shumë kohë do e njihja si Abaz Gjuka, dhe kështu më pëlqen ta quaj edhe tani.

Ata erdhën kur tashmë kishte rënë nata. Çuditërisht ishte një natë e bardhë, e pazakontë për atë stinë të vitit. Edhe unë duhej të isha i njohur për ta, të paktën emri im duhej t'u thoshte diçka, për vetë faktin se kisha disa muaj që shkruaja rregullisht në „Zërin e Kosovës". Në mos qofsha i gabuar, së bashku me ta ishte edhe Shukri Buja, i cili në atë kohë njihej edhe me emrin e dytë, „Gazetari". Kërkuan ndjesë për ardhjen në atë orë të vonë. Nuk e dija tamam shkakun e ardhjes së tyre. Fillimisht mendova se kishte qenë një ndalesë e zakonshme, ndoshta për të bërë një pushim të shkurtër nga një rrugëtim i gjatë. Nuk i pyeta se nga vinin e ku do të shkonin. E dija se të gjithë banonin në Zvicër. Banesa ime ishte diku një orë e gjysmë larg nga kufiri dhe nuk ishte mirë të udhëtonin nëpër një natë mes janari.

Ata kishin ardhur me mendimin të më ftonin të bëhesha pjesë aktive e organizatës Lëvizja Popullore e Kosovës dhe njëkohësisht edhe një ndër hallkat e strukturave drejtuese. Tashmë e dija programin e organizatës së tyre, dija shumë më tepër se një vit më parë, kur gjithçka që kishte të bënte me Kosovën, nuk kishte qenë kurrë e plotë. Në rrethin tim miqësor ishin disa nga emrat e njohur të Lëvizjes, si Hasan Ukhaxhaj, Ibrahim Kelmendi, Fehmi

Lladrovci, Begzat Gashi, Sabri Kiçmari, Ramiz Lladrovci, Selim Krasniqi, Xhemail Fetahu. Më pas do të njihja të tjerë, mes të cilëve nuk do të mund të harroj kurrë Iliaz Kodrën. Ishte një plejadë e shkëlqyer dhe ftesën e tyre për të punuar së bashku, doemos që do ta mbështetja.

Kështu filloi rrugëtimi im drejt Lëvizjes që, siç e thashë, ndryshoi krejt pjesën e mëtejshme të jetës sime, por edhe që u bë një ndër shkaqet e këtij libri, i cili, më shumë se gjithçka tjetër, është vazhdim i asaj që është thënë në vite.

Kosova më kishte tërhequr prej kohësh. Ishte një nga ëndrrat e mia. Ajo qëndronte përherë e rrethuar nga bardhësia dhe kishte një brerore të jashtëzakonshme, të cilën nuk mund të bëja gjë tjetër, veçse ta adhuroja. Siç ndodh zakonisht, atë nisa ta kuptoj fillimisht përmes njerëzve të fisit të nënës sime, të njohur me një emër famëmadh, Gjylbegaj. Në shtëpinë e madhe të Gjylbegajve, ku jetonim prej vitesh, Kosova kishte gjithmonë hisen e saj. Aty ende jetonte një ndër miqtë e njohur të Isë Boletinit, i cili, për një rastësi të padëshiruar nga dhembja, kishte qenë në varrimin e tij, ku edhe kishte folur. Aty ende mund të gjeje objekte që kishin lidhje me ardhjen e Bajram Currit apo të muhaxhirëve, ashtu si mund të gjeje edhe pjesë nga shumë gjëra të tjera, kjo ndoshta për shkak se ai që e ngriti këtë shtëpi, Muharrem beg Gjylbegu, kishte qenë për shumë vite kryetar i bashkisë së Shkodrës në vitet e njohura si Rrethimi i Shkodrës nga serbomalazezët. Po të shtosh këtu edhe faktin që do e mësoja më vonë nga një

mik tjetër i familjes sonë, por kësaj radhe mik i tim ati, patrioti i njohur Qamil Çela, që emri im kishte qenë dhuratë nga Bedri Pejani, gjithçka e bënte më të lehtë për mua të kisha një ëndërr për Kosovën.

Zgjedhja ime, disa vite më pas, si kryetar i Lëvizjes Popullore të Kosovës, ndoshta ishte një rastësi, por ajo që më lidhte me të, nuk do të ishte kurrë rastësi. Në një rrugë ose në një tjetër, unë do të mbërrija aty. Ngjarja e mesit të janarit 1994 e bëri më të lehtë këtë rrugëtim, por edhe një ndër shkaqet e ndërtimit të këtij rrëfimi, i cili është në fakt një dialog në dy zëra, njëri nga të cilët është i Kelmendit dhe, në një mënyrë ose në një tjetër, ata që dëshmohen, janë edhe pjesë të jetës së tij, ashtu si janë edhe fragmente të jetës sime, por që medoemos kanë lidhje me Lëvizjen Popullore të Kosovës.

Cila ishte zanafilla e gjithë kësaj, pasi një ngjarje nuk do të ishte e mjaftueshme, kur, për më tepër, shumë gjëra i kam thënë në librat e tjerë, botuar më parë, në vite të ndryshme të pas luftës në Kosovë.

Duhej edhe një tjetër.

Dhe kjo, së cilës mund t‘i them një ngjarje e dytë, ishte më themelore. Pak javë më parë, siç është në natyrën e tij, Ibrahim Kelmendi më dërgoi një e-mail ku më propozonte të bënim një bisedë së bashku, përmes së cilës të risillnim në kujtesën e njerëzve rrugën që kishte bërë Lëvizja Popullore e Kosovës në tridhjetë vitet e saj.

Për mua ajo ka pasur kurdoherë një zanafillë, një ditë ngritjeje ose, më saktë, një datë themelimi. Kishte qenë gjithnjë 17 Janari i vitit 1982 dita e provës së madhe dhe, njëkohësisht, dita e fillesës së madhe që, si në baladat e lashta, përpara se të ngrihej, donte pjesën e saj të flijimit. I kam pasur gjithnjë në sy ata tre djem, njëri më i ri se tjetri, me të përbashkëtat dhe të veçantat e tyre, të cilët, pasi bënë bashkimin e parë të madh, në një moment çlodhjeje u kujtuan se duhet të bënin diçka edhe për njerëzit e tyre të afërt, një telefonatë, e cila nuk do të mund të ishte kurrsesi vetëm e tillë. Duke shkuar drejt njerëzores, pra në atë çastin e papërsëritshëm kur legjenda ngjizet, por edhe kthehet në jetësore, ata i vranë.

Jam i bindur se, edhe nëse nuk do t'i vritnin asaj nate, kjo do të ndodhte një natë tjetër. Për shërbimin e fshehtë jugosllav, sa më herët të ndodhte vrasja e tyre, aq më e frytshme do të ishte për ta. Në të vërtetë ajo i vonoi paksa ngjarjet, por pastaj i rriti me një hov të jashtëzakonshëm. Emrat e tre djemve tani janë ndër më të merituarit në altarin e historisë së kombit.

Jusuf Gërvalla. Kadri Zeka. Bardhosh Gërvalla.

Do të jenë në një ditë bashkimi, ngritja, themelimi, vrasja dhe kushtrimi. Nuk mund të ëndërronin asaj kohe të bartnin më tepër. Më pas, si ndodh zakonisht me përmasat epike, atyre do t'u shtohej edhe përjetësia.

Pra, kur mora e-mail-in e Ibrahim Kelmendit dhe men-

dimin e tij për të bërë një bisedë për ngjarjet, mendova se është ndoshta koha për të bërë diçka më shumë se një bisedë të zakonshme. Ndoshta ishte koha për të "shtrydhur" kujtesën e një njeriu, i cili kishte qenë pjesë e 17 Janarit, ishte ndarë nga Kadriu, Jusufi dhe Bardhi vetëm disa orë para ngjarjes dhe ishte ende pjesë e një historie. Ndoshta më i hershmi i saj, por ndoshta edhe më i besuari. Nëse do të doja të shkoja në zanafillën e Lëvizjes, më duhej patjetër të shkoja përmes këtij njeriu.

Dhe kështu u bënë bashkë dy ngjarje, njëra që zë fill në mesin e janarit 1994 dhe tjetra, si për rastësi, në mesin e tetorit 2011, për ta bërë këtë bisedë me Ibrahim Kelmendin.

Besoj se do të jetë e frytshme.

I. Lindje e përgjakur

(B.I.:) - Kush është Ibrahim Kelmendi? Kjo është një pyetje, e cila, si rrallëherë, është bërë për një njeri të vetëm. Siç e kam thënë më herët, Ibrahim Kelmendin, ashtu siç është, mund ta duash ose jo, ta pranosh si mik ose ta largosh, të jesh pjesë e tij ose të jesh krejt i huaj, por në asnjë moment nuk mund të jesh indiferent ndaj tij. Kjo nuk u përket shumë njerëzve. Për më tepër, ajo vjen e bëhet veçori e disa njerëzve, të cilët, edhe pse nuk kanë asnjë lloj misteri në vete, përsëri, për shumëkënd, bëhen të mistershëm. Kelmendi është njëri prej tyre.

Për herë të parë për të kam dëgjuar në majin e vitit 1992 kur do të udhëtoja në Gjermani. Më kishin dhënë numrin e telefonit të shtëpisë së tij, banesë e cila ishte diku në qendër të shtetit gjerman, por, sa herë telefonoja, ai nuk ndodhej në shtëpi. Njeriu që më shoqëronte, një shqiptar i Kosovës, i lidhur me lëvizjen ilegale, siç e mësova më pas, ndihej i habitur që unë, një njeri nga Shqipëria, kisha numrin e telefonit të Bacës Ibrahim, si e thërriste ai. Sidoqoftë, asaj kohe nuk u takuam. Do të takoheshim më vonë, në janarin e vitit 1993, në varrezat e qytetit të Shtutgartit, ku preheshin trupat e Jusuf Gërvallës, Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, tre emra atëherë dhe tani shumë të afirmuar. Edhe asaj dite të ftohtë kishim një takim të shkurtër, që ishte edhe më i ftohtë se ajo ditë dhe nuk e mendoja kurrë se, pas disa kohe, mund të bëheshim miq e, për më tepër, të ishim në të njëjtën organizatë.

Megjithatë, për shumë kohë, pa dashjen time, enigma mbeti: Kush është Ibrahim Kelmendi? Nga vjen ai? Cili ishte sh-

kaku që doli jashtë Kosovës, tepër herët, pikërisht asaj kohe kur dukej se gjithçka po zgjidhej paqësisht dhe se lëvizja e rezistencës po shuhej? Ende nuk kishin ndodhur demonstratat e vitit 1981, pra ende nuk kishte ndodhur shpërthimi i pranverës, kur ai qe një nga të mërguarit e paktë politikë në ato vite.

Megjithëse kemi qëndruar shumë me njëri-tjetrin, asnjëherë nuk e kam pyetur atë se çfarë ndodhi me të, cili ishte shkaku i arratisjes, përse pikërisht në Gjermani e jo në Zvicër ku ishte një qendër e lëvizjes ilegale, si hyri ai në këtë rrjedhë e cila asaj kohe dukej se kishte një të ardhme të largët, pse ndodhte që disa e donin çmendurisht dhe disa nuk i besonin, si u bë ai pjesë e një lëvizjeje që 16 vite më pas do ta ndërronte krejt rrjedhën e historisë së Kosovës dhe të të gjithë kombit njëkohësisht, pse… kam shumë pse dhe tani që "më erdhi dita", është koha më e përshtatshme për t'ia drejtuar këto pyetje atij drejtpërdrejt:

*Kush është Ibrahim Kelmendi? **Ç**farë ndodhi me fillesën e jetës suaj politike, por edhe si student? Cili ishte shkaku i largimit tuaj nga Kosova? U larguat normalisht, fshehtas, krejt vetëm apo me përkrahjen e dikujt tjetër? A kishit lidhje të mëhershme me lëvizjen ilegale në Kosovë, apo ishit krejt fillikat? A nuk mund të qëndronit aty, si shumë të tjerë, dhe të ishit ndoshta më i vyer? Pse zgjodhët pikërisht shtetin gjerman për të qëndruar? A kishit lidhje të mëhershme me lëvizjen ilegale që vepronte jashtë Kosovës dhe jashtë Jugosllavisë?*

Shumë pyetje njëherësh, por të gjitha kërkojnë një përgjigje.

(I.K.:) **-** Fillimisht dëshiroj të shfaq përcaktimin tim për këtë bashkëbisedim. Më ka impresionuar shumë vizioni i Robert Kenedit, të cilit kam ndërmend t'i përmbahem. Po citoj:

“Pjesa më e madhe e njerëzve më shumë parapëlqejnë të ndihen të qetë, se sa ta njohin të vërtetën. Epo mirë, unë jam ai që do ta prish qetësinë tuaj, duke jua thënë të vërtetën.”

Mbase duhet sqaruar se bëhet fjalë për të vërtetën e jetuar dhe të përjetuar, për interpretimet dhe komentimet sipas perceptimit dhe këndvështrimit tim, në kohë dhe hapësirë kontekstuale.

Nuk më takon mua t’i përgjigjem pyetjes “Kush është Ibrahim Kelmendi?”, sepse, rëndom, njeriu nuk mund të lirohet nga subjektivizmi, meqë ai është i prirur të ofrojë të dhëna afirmative për veten dhe të heshtë për ato kompromituese. Megjithatë, për mirësjellje, po ofroj ca të dhëna telegrafike, kryesisht të karakterit fizik, nëse mund të thuhet kështu, ndërsa, sa i përket karakterit përmbajtjesor, le të përgjigjen të tjerët, siç edhe ka ndodhur, po ndodh dhe do të ndodhë, kush me xhelozi, inat, deri edhe me armiqësi, kush me objektivizëm e dashamirësi, por pothuajse secili i ndikuar nga subjektivizmi, këndvështrimi dhe interesi i tij, duke u bërë kështu palë. Uroj që, kur të krijohet distanca e bollshme kohore, të bëhen vlerësime kritike, edhe pse thuhet se “historinë e shkruajnë fitimtarët”.

Nëna Noke (emri i vajzërisë i nënës sime, i ndryshuar pas martese në Nurije), siç më ka thënë, më ka lindur ditën e mërkurë, më 23 qershor 1954, në fshatin Llabjan, rreth 8 km afër Pejës, buzë rrugës Pejë-Prishtinë. Familja jonë e atëhershme në Dukagjin njihej me emrin **Vuthjanët**, për shkak të origjinës, meqë paraardhësit nga babai vinin nga fshati Vuthaj, buzë Gucisë, tani në Mal të Zi, fshat i ndarë me kufirin Shqipëri-Mali i Zi. Nëna është nga familja Iberdemaj, fshati Shtupeq i Vogël, krahina malore e Rugovës së Pejës, që jeton edhe në fshatin Nabergjan të Pejës prej disa dekadash, si shumë familje

të Rugovës që blinin toka në rrafsh, për të kombinuar rrojtjen e tyre, në bjeshkë dhe në rrafsh.

Në dhjetor të vitit 1956, ende pa mbushur një vit e gjysmë, pësova një djegie të rëndë. Duke qenë vetëm, në odën e madhe, ndërsa nëna dhe gratë e tjera të shtëpisë merreshin me bagëtinë dhe punë të tjera fshati, ndoshta nga kureshtja për zjarrin, rashë në oxhakun e madh të familjes sonë të madhe. Kur më kanë gjetur duke u pjekur në zjarr, siç më kanë rrëfyer, askush nuk e ka ditur me saktësi sa kohë kam qëndruar në zjarrin e oxhakut, prandaj më ra hise të lëngoj gjatë...

Në vitin 1960 nisa shkollën fillore në Zahaq. Klasën e 5-të e vijova në shkollën 8-vjeçare të Gllaviqicës me sukses mesatar. Në vitin 1968 u regjistrova në shkollën normale 5-vjeçare, "Ali Kelmendi" në Pejë, ku kualifikoheshin mësuesit.

Në klasën e 3-të ngela, pra duhej të përsërisja klasën.

Në verën e vitit 1970 shkova për punë në Gjermani. Arsyet kryesore që më detyruan të shkoj në Gjermani qenë: së pari, varfëria e tejskajshme e familjes sonë, tashmë të vogël, sepse familja e madhe me rreth 60 anëtarë u nda në shumë familje të vogla në vitin 1966 / 69 dhe; së dyti, dëshpërimi për shkak të ngeljes në klasë. Ndenja në Gjemani deri në verën e vitit 1971. Kthehem dhe regjistrohem në gjimnazin e Rahovecit në vitin e 3-të. Me të mbaruar klasën me sukses të shkëlqyeshëm, në fund të vitit më mundësohet dhënia e provimeve të klasës së katërt dhe diplomës se maturës, duke përfunduar 2 klasë brenda një viti shkollor. Kështu arrita t'i zë shokët e brezit tim të shkollës normale dhe, në tetor 1973 u regjistrova në Universitetin e Kosovës, në Prishtinë, në Fakultetin e Shkencave Natyrore, degën e fizikës. Gjatë vitit të parë banoja në konviktin shtetëror nr. 1, dhoma numër 5, ilegalisht, siç shpreheshim

atëherë, te vëllai im, Zeneli. Gjatë gjithë vitit e ndamë bashkë krevatin e ngushtë. Edhe dhoma e konviktit ishte tepër e vogël. Po në atë dhomë banonte edhe Tahir Rreci, i cili, si im vëlla strehonte Fetah Kajtazin, ilegalisht, dhe Sefa (Sefer Shabani) nga Presheva.

Në vitin e 2-të banova në barakën e studentëve nr 2 në lagjen e konvikteve të studentëve, kurse vitin e 3-të më takoi strehimi sërish në konviktin nr. 1.

Gjatë studimeve më dukej tepër tërheqëse të ndiqja shumë ligjërata në fakultetet e sociologjisë, të historisë, të ekonomisë, ngaqë dëshiroja të dëgjoja profesorët duke ligjëruar. Kisha krijuar bindjen se kështu, në vend që të lexoja literaturë të këtyre lëmenjve, më shpejt do të informohesha drejtpërdrejt nga profesorët. Kjo bënte që, ndërkohë, për studime të fizikës të mos kisha kohë të bollshme.

Pasi përfundova ligjëratat e vitit të 3-të në fizikë, në vitin 1976 u arratisa në Gjermani.

(B.I.:) - Si u arratisët kështu papritmas? U zgjuat një mëngjes të bukur, diku në Pejë apo në Prishtinë dhe thatë me vete: do të arratisem…?

(I.K.:) - Në vitin 1968, kur isha në vitin e parë të shkollës normale në Pejë, për Ditë të Flamurit (siç i thoshim Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 Nëntor 1912) u angazhova në demonstratën e fuqishme që u bë në Pejë. Demonstrata e kishte nismën organizative në shkollën tonë. Në mesin e organizatorëve ishte edhe im vëlla, Zeneli, i cili ndiqte mësimet në klasën e 5-të të së njëjtës shkollë, por shquheshin sidomos Demë Molliqi, Skënder Kuqi, Skëndër Tafa dhe pak veta të tjerë. Meqë jam të kjo demonstratë, edhe një detaj eksesiv: Kur grupimi i parë prej rreth 15 nxenësve kishte dal në

oborr të shkollës për të filluar demonstratën, klasa ime ishte në fushë sportive, sepse rastisi të kishim orën e edukatës fizike. Mësues e kishim Misha Zvicër. Sapo i pash u vesha, të tjerët gjithashtu. Mësuesi nuk na ndaloi dot. U thash ca shokëve të hymë në të gjitha klasët dhe të japim alarmin e rrëmë: "Po digjet shkolla, të gjithë përjashta." Dolën edhe me panik. Dhe kështu për pak minuta u mbush oborri. Ishte ditë pazari në Pejë. Sapo arritëm në qendër të qytetit, me disa shokë të klasës shkuam në tregun e gjelbër dhe thirrem fshatarët, duke i bindur se po protestohet kundër tatimit. Kështu u rrit pjesëmarrja në mijëra veta. Më vonë pata ca biseda qortuese nga drejtori i shkollës për angazhimin tim në demonstratë.

Në mbrëmje të po asaj dite organizuam manifestim kushtuar Ditës së Flamurit në shtëpinë e kulturës në fshat. Policia erdhi dhe na e prishi manifestimin.

Kjo ishte fillesa e konkretizimit të angazhimit kombëtar, sepse frymëzimin përkatës e kisha nga ndejat në odën e madhe, tradicionale, e njohur në anët tona si Oda në Kullën e Vuthjanëve.

Duke qenë në gjimnaz, në Rahovec, u bëra anëtar i klubit letrar "Gjon Nikollë Kazazi". Për shkak se në një aktivitet letrar lexova një vjershë timen, në mëngjesin e ditës së nesërme policia e atij qyteti më arrestoi. Nga mesdita informohet drejtori i gjimnazit, Hasan Sharku. Ai ishte njeri me autoritet politik në atë komunë. Drejtori erdhi në polici, më mori me vete dhe më dërgoi në shkollë. Pësova vetëm ca flakaresha goxha të rrepta nga policët.

Ky ishte pagëzimi i parë, që do të më tregonte se kjo rrugë mund të kishte edhe flakaresha.

Përcaktimin për t'u regjistruar në lëndën e fizikës nuk e pata vetëm nga kureshtja për këtë shkencë, por edhe nga një orientim i atëhershëm, pothuajse naiv, se UDB-ja (policia e fshehtë jugosllave) survejonte më shumë studentët e historisë dhe të gjuhës e të letërsisë shqipe. Kështu po mashtroja veten se mund t'ia hidhja.

Kjo ishte përpjekja e parë për të kamufluar angazhimin që parashihja në të ardhmen.

Deri atëherë nuk isha i organizuar në ndonjë organizatë klandestine. Edhe po të doje, nuk gjeje dot mundësi kontaktuese. Duhej pritur derisa të të gjenin ato. Atëherë, i vetmi organizim aktiv për të cilin pëshpëritej, ishte Grupi Revolucionar i Kosovës, nëse nuk e gaboj emërtimin e saktë të tij. (Po rezervohem të jap shpjegime për organizimet e fshehta çlirimtare, të atëhershme, sepse lidhur me to tashmë është krijuar një konfuzion.

Në fakultet dhe në konvikte kishim grupet tona, të paorganizuara formalisht, por që përpiqeshim të bënim ndonjë aktivitet. Në këtë grupimin tonë dallohej Isuf Bruçaj, Fetah Kajtazi, Kamer Raci, Zeqir Qollaku e ndonjë tjetër.

Në fund të muajit nëntor të vitit 1975, ne studentët e vitit të 3-të të fizikës, spontanisht, organizuam një protestë, kërkesë e së cilës ishte të na i siguronin të gjithë ligjëruesit në gjuhë shqipe. Në mungesë të kuadrit shqiptar të Kosovës ndodhte të ligjëronin profesorë nga Beogradi e gjetiu. Ne mbështeteshim në Marrëveshjen ndërmjet Universitetit tonë dhe Universitetit të Tiranës, prej ku mund të silleshin ligjërues shqiptarë, siç na e pat ligjëruar kursin e fizikës së përgjithshme prof. Petrit Skëndo nga Tirana, të cilin e respektonim si një idhull. Arsye akoma më konkrete qe një profesorë serb, i cili në provim me

shkrim kolegët studentë serbë i kishte mbivlerësuar, kurse neve na kishte nënvlerësuar. Kjo padrejtësi u bë shkak konkret që shpallem protestën.

Gjatë përplasjeve me strukturat komuniste dhe me pushtetin, unë dhe Abaz Mustafa, nga Sukobina e Ulqinit, u fajësuam si organizatorë të protestës. Asaj proteste të njëanshmërisht iu dha karakter politik, nacionalist e armiqësor, siç ishte gjuha e atëhershme zyrtare komuniste. Gjatë hetimeve u fajësova unë si organizatori kryesor.

Ky ishte ballafaqimi i parë serioz me pushtetin komunist dhe e pashë se mund të ishte një rrugëtim i vështirë.

Praktikë e atëhershme ishte që strukturat komuniste, lidhja e rinisë socialiste dhe lidhja komuniste në fakultet merrnin qëndrim politik, pastaj i kalohej rasti policisë hetimore. Paralelisht angazhohej UDB-ja si hetuese dhe si koordinatore e vendimeve politike të strukturave komuniste. Duke parandier rrezikshmërinë, meqë këto struktura po merreshin intensivisht, sajova një vërtetim me vulë të lidhjes së studentëve në fakultet sikur do të organizohej një ekskursion shkencor në Poloni për studentët e vitit të 3-të të fizikës. Me atë vërtetim nxora lejen për udhëtim jashtë shtetit në sektorin ushtarak të mbrojtjes popullore në Pejë. Me lejen e sektorit ushtarak, që ishte kusht i kohës për të marrë pasaportë ata që ende nuk e kishin bërë shërbimin ushtarak, nxora pasaportën në SPB-në (policinë) e Pejës.

Meqë aktivi i lidhjes komuniste të Fakultetit të Shkencave Natyrore, të cilin e kryesonte Dr. Muhamet Bicaj, ku merrnin pjesë edhe udhëheqës drejtues të komitetit të LRS të Prishtinës, mori vendim të më ndalohet e drejta e vazhdimit të studimeve. Debati në atë mbledhje qe i nxehtë, profesorët u ndanë në dy taborre. Dr. Rexhep Gashi dhe kryetari i Lidhjes se Rinisë

socialiste Mahmut Alidemajn kërkonin dënim të ashpër, kurse Profesor Dervish Rozhaja dhe disa profesorë tjerë ishin për dënim me vëbrejtje të but. Po atë natë, nga që parandjeva burgosjen, ia mbatha me trenin e natës, nga Fushë-Kosova në Mynih (München) të Gjermanisë. Pra, jemi në fillimet e qershorit të vitit 1976.

Mora arratinë pa ndihmën e askujt. Për këtë arratisje njoftova vetëm Zenelin, vëllanë tim më të madh.

Kisha synim Gjermaninë, jo vetëm sepse kisha mësuar pak gjermanisht gjatë qëndrimit të mëhershëm për punë (kisha punuar, madje si i mitur, në firmën ndërtimore "Hans Maus" në Erlangen ku i kisha dajat.). Pra, zgjodha Gjermaninë sepse shpresoja të më ndihmonin vëllai dhe dajat.

Më pyete përse nuk zgjodha Zvicrën, meqë atje kishte "qendër ilegale". Unë nuk u arratisa jashtë me përcaktim që të angazhohesha në veprimtari patriotike e çlirimtare. U arratisa vetëm për t'i ikur arrestimit të mundshëm. Nuk kisha ndonjë informatë se ku kishte organizime "ilegale", pos që dija qysh nga vera e vitit 1974 se diçka të tillë kishte në Bruksel. Më kishte rastisur ta njihja kryetarin e partisë Legaliteti, tashmë të ndjerin Hasan Hoxha, një ish-i arratisur nga Shqipëria në Mal të Zi dhe prej andej, pas ca vitesh, i emigruar në Belgjikë. Por, edhe kur shkova atje, me rastisi të informohem vetëm për organizime "të djathta", të cilat përcaktim të vetëm kishin çlirimin e Shqipërisë nga diktatura komuniste, por që nuk merreshin fare me çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera të pushtuara shqiptare. Që të mos zgjatëm, më vonë u informova se në Zvicër nuk kishte pas ndonjë lloj organizimi të shqiptarëve.

Në tetor të vitit 1976, kur vajta në Universitetin e Bohumit (Bochum) për të pyetur se cilat ishin mundësitë për regjistrim,

më rastisi të njihem me albanologun Dr. Lazër Dodiqin, kroat nga Janjeva e Kosovës. Ai ishte lektor i gjuhës shqipe në Ruhr-Universität në Bochum dhe i vetmi albanolog me këtë gradë shkencore në Gjermaninë Perëndimore. Dr. Dodiqi kishte mbaruar gjimnazin e jezuitëve në Shkodër dhe në vitin 1948 ishte arratisur në Itali. Me peripeci të mëdha kishte studiuar dhe kishte marrë doktoratën në Romë (tek Profesor Ernest Koliçi). Ai më përkrahu që të regjistrohem në universitet, me vendosi në konvikt dhe disa muaj pagoi qiranë për mua. Në lektoratin e albanologjisë në atë universitet gjeta literaturë të bollshme në gjuhën shqipe, kurse nga Dr. Dodiqi dëgjova shumëçka që nuk kisha pasur mundësinë të dëgjoja më herët. Ai u përkujdes për mua si të më kishte djalë.

Për të studiuar regjistrova gjermanistikë e filozofi, pasi ndoqa një semestër kursin e gjuhës gjermane, meqë dhënia e provimit në këtë gjuhë ishte parakusht për regjistrim. Me të mbaruar semestrin dimëror të gjuhës, dhashë provimin dhe, në semestrin veror 1977 fillova studimet. Nuk vazhdova fizikën, meqë nuk më pranohej asnjë provim i dhënë në Universitetin e Prishtinës dhe tashmë nuk më tërhiqte ai drejtim.

Pesë vitet e para qëndrova në Gjermani me pasaportë jugosllave, për të cilën thashë tashmë se si e pata nxjerrë në policinë e Pejës. Në vitin 1980 i skadoi vlefshmëria. I shoqëruar me një prift të Qendrës Studentore Evangeliste (ESG), si masë sigurie e si dëshmitar, shkova për vazhdimin e pasaportës në konsullatën jugosllave në Dortmund. Vetë konsulli e priti me marifet priftin gjerman dhe, për t'i krijuar atij përshtypje të mirë, ma vazhdoi pasaportën edhe për dy vjet. Në fund të vitit 1982 i mbaroi afati edhe asaj kështu që, në fillim të vitit 1983 u detyrova të kërkoj strehim politik.

(B.I.:) - Arratia juaj në Gjermani dhe kalimi i statusit tuaj si refugjat politik ishte një ngjarje jo e zakontë. Të mos harrojmë se jemi në një kohë kur ish-shteti jugosllav përkëdhelej nga Perëndimi, si një urë ndërlidhjeje me bllokun e Varshavës dhe drejt "botës së tretë", përkëdhelje që përfundoi fatalisht në dëm të ballkanasve, si askund tjetër, me pesë luftëra të përgjakshme dhe një tjetër të porsafilluar në Slloveni. Si e përjetuat këtë fillesë dhe çfarë ndodhi me familjen tuaj?

(I.K.:) - Pas qëndrimit tim 2-mujor te dajat në Erlangen, u vendosa të vëllai, Mustafa, në Mylheim / Ruhr. Në tetor u regjistrova në universitet, në Bohum. Përjetimet varen nga ndjesitë dhe perceptimet. Mundësi të shumta përzgjedhjeje nuk kisha. Sa për fillim, në aspektin fizik, nëse mund të thuhet kështu, nuk e kisha edhe aq vështirë, meqë atje kisha vëllanë, dajat, Dr. Dodiqin dhe shumë miq të tjerë, që me përkrahnin herë pas here.

Në aspektin e ndjesive, ambientimin fillestar nuk e kisha të lehtë, sepse e dija se nuk do të mund të kthehesha shpejt në Kosovë.

Në Kosovë kisha lënë Nënën, 7 vëllezër e 3 motra, kushërinj, shokë e farefis. Qysh në gjysmën e dytë të vitit 1977 UDB-ja filloi të keqtrajtojë Nënën, vëllezërit e motrat e mia.

(B.I.:) - Në Perëndim kishte mjaft shqiptarë të Kosovës dhe nga trevat e tyre në Maqedoni e në Mal të Zi. Shumica hallemëdhenj, të larguar nga fukarallëku, disa, jo të paktë, besnikë ndaj regjimit të Beogradit, i cili i kishte nën vëzhgimin e tij të gjitha lëvizjet që mund të quheshin subversive për të dhe ndryshuese për ne. Pra, një mjedis ku njerëzit mendonin më shumë për ngushticën e oborrit të tyre sesa për shtetin e ardhshëm të Kosovës. Ishte përgjumje, humbëtirë, kalimi nga një gjendje në një tjetër, apo një pritje e heshtur e asaj që do të

vinte? Ju, ku e gjetët veten?

(I.K.:) **-** Në Gjermani në atë kohë kishte rreth 70 mijë shqiptarë, emigrantë ekonomikë nga Jugosllavia. Pushteti jugosllav i quante ata *punëtorë të përkohshëm në botën e jashtme*, por, fatkeqësisht, kanë ngelur të përjetshëm. Pjesa më e madhe e tyre ishin analfabetë dhe gjysmanalfabetë. Si të papunë e të varfër që kishin qenë, ata ishin emigruar me bindje se do t'i siguronin bukën familjes, do të kursenin për t'u kthyer shpejt në vendlindje, ku do të vazhdonin një rrojtje më të mirë. Ky detyrim i tyre bënte që ata të bënin jetë skllevërish, në punë tepër të rënda. Pjesa më e madhe e tyre në ato vite jetonin në emigracion vetëm, pa gra e fëmijë. Rrallë ndonjë ishte i vetëdijshëm për veprimtari patriotike e çlirimtare. Pothuajse të gjithë nuk ishin fare të ndërgjegjshëm se edhe atyre u takonte të bënin diçka për të ndryshuar atë gjendje.

Jo vetëm vuajtjet rinore, gjendja në Kosovë, vuajtjet e emigrantëve, por edhe leximi dhe informimi më ndërgjegjësuan që të angazhohesha në veprimtari çlirimtare. Ky angazhim u konkretizua në tetor të vitit 1977, kur edhe formuam grupin, të cilin e emërtuam: Fronti i Kuq Popullor.

(B.I.:) - Sigurisht, Perëndimi për ju do të ishte një zgjidhje e përkohshme, kështu e kishit menduar, megjithëse zgjati gati dy dekada e gjysmë. Nuk e besoj se kishit shkuar për të vegjetuar. Jeta e mëpastajme e vërtetoi këtë. Mirëpo, në vitin 1993, kur ne jemi njohur e, më pas, kur kemi bashkëpunuar, gjërat ishin shtruar për zgjidhje, problemet ishin kaluar. Fillesa do të kishte qenë e vështirë, ju ishit në fillesën e ngjarjeve. Si e përjetuat këtë fillesë, pra si i vendosët lidhjet me njerëzit që kishin të njëjtin mendim si ju, për rezistencë aktive, demonstrim të vullnetit për të bërë ndryshimin e statusit të Kosovës, edhe për-

mes lëvizjeve, të cilat aso kohe quheshin revolucionare? Pra, ku i gjetët njerëzit, si u lidhët me ta, kush ishin të parët që u bashkuan me ju?

(I.K.:) - Vetë rrethanat pararendëse ma kanalizuan jetën e pastajme, nëse mund të shprehem kështu. Po të më interesonte jeta private, kushtet atëherë ishin të volitshme për të gjallëruar mirë, pse jo, edhe për t'u pasuruar. Tregu kishte nevojë për punëtorë dhe vetëm ndërmjetësimet për t'u gjetur firmave gjermane punëtorë, të sillnin fitime. Gjuhën e zotërova shpejt, fal edhe qëndrimin tim të mëhershëm në Gjermani dhe mund të fitoja mirë edhe nga përkthimet.

Menjëherë krijova njohje të shumta, sepse bashkatdhetarët m'i bënin jehonë pozicionit si student i parë shqiptar në ato anë. Afirmimin e përshpejtonte ndihma për bashkatdhetarët me përkthime, plotësim formularësh, shkrim kërkesash, letrash etj., shërbime këto për të cilat nuk merrja asnjëherë honorar.

Vërtet, atëherë emigrantët tanë ekonomikë kishin mendësi prej njerëzish të nënshtruar, nuk dua të them prej skllevërish, po për faktin se vetëm punonin dhe kursenin, pa një vetëdije sociale për padrejtësitë që u bëheshin, mbase mund të karakterizohen për të tillë.

U krijuan rrethanat që në mars të vitit 1978, në Dyzeldorf, të formohej Klubi Shqiptar. Nismën për këtë e kishte ndërmarrë konsullata jugosllave në Dyzeldorf, gjegjësisht nëpunësi i saj, Zenel Syka, që ishte nga Gjakova.

Disa muaj më herët isha njoftuar me disa bashkatdhetarë patriotë në këtë qytet kur shkova për të shpërndarë trakte në konviktet e punëtorëve të fabrikës së tubave *Manesman* në Dyzeldorf. Sapo hyra në konvikt, në kthesën ku ishte një si i thënçin kuzhinë, ku përgatitnin ushqimin dhjetëra punëtorë, kon-

taktova të parin, Zenel Iljazin, malësor i rrethit të Tetovës. Sa i zgjata traktin ai u befasua dhe menjëherë më tërhoqi për krahu që të shkonim në dhomë. Ma tërhoqi vërejtjen duke më thënë se ishte punë me rrezik, meqë në konvikte konsullata kishte angazhuar informatorë. Ai më njohu fillimisht me kushërirën e tij, Samedinin, pastaj me Nebi e Hisri Rekën, Nazmi, Sylë, Mursel Nuhajn, Haxhi Begën dhe kështu u gjet filli i kontakteve. Ata më treguan për nismën e formimit të klubit, për përplasjen e përgjakshme qysh në krijimin e tij, etj. U angazhova që t'i bashkërendonim punët rreth themelimit dhe aktivizimit të klubit.

Përplasja e parë kryesore qe për emërtimin, meqë konsullata urdhëronte që klubi të quhej *klub jugosllav*, kurse ne këmbëngulnim që ai të quhej *klub shqiptar*. Shumë shpejt u angazhua sekretari i parë i ambasadës jugosllave në Bon, Zotëri Shefqet Hashani, nga i cili, ca bashkëvendës të tij kërkuan ndihmë. Ai na dha të drejtë dhe kjo bëri që emigrantëve t'u rritej guximi. Me shumë peripeci e sakrifica klubi "Emin Duraku" në Dyzeldorf rriti numrin e anëtarëve deri në 600 veta dhe u bë kështu vatra kryesore e veprimtarisë patriotike e çlirimtare në Gjermani dhe në gjithë Evropën Perëndimore, derisa Kosova u çlirua.

Në vazhdën e kësaj përvoje dhe me këto njohje të shpejta, në shumë qytete të Gjermanisë, Belgjikës, Zvicrës, më vonë edhe të Skandinavisë, krijuam bërthamat e para të emigrantëve patriotë.

Çfarë ndodhi tridhjetë vite më parë?

(B.I.:) - Në jetën e çdo kombi ka ngjarje të cilat vjetrohen tmerrësisht shpejt. Në një moment të caktuar, ato mund të jenë dukur tepër të rëndësishme, por janë harruar. Ashtu siç ka edhe ngjarje të tjera, të cilat, fillimisht kanë qenë të padukshme ose të ditura për një grup shumë të paktë, por që, me kalimin e viteve, kanë marrë madhësi të jashtëzakonshme, do të thosha epike. Tridhjetë vjet më parë, më 17 Janar, u themelua Lëvizja Popullore e Kosovës. Një ngjarje e padukshme ajo për kohën, por që i qëndroi kohës dhe u bë pjesë e saj. Ju, duam apo nuk duam, jeni anëtari më i vjetër i kësaj organizate, sepse keni qenë pjesë në krijimin e saj, pra jeni një nga themeluesit e saj. Do të doja të ktheheshit pas në kohë. Të ndërtoni tri ditët e parathemelimit, pra të ktheheni në datat 14, 15 dhe 16 janar 1982. Çfarë ndodhi në ato tri ditë?

(I.K.:) - Kohë e gjatë për të rikujtuar detajet. Megjithatë janë ca rrjedha që të mbeten në kujtesë, deri sa vjen koha dhe ligjet biologjike e fiziologjike pamundësojnë trurin për t'i riprodhuar.

Të enjten e 14 janarit të vitit 1982 Kadri Zeka erdhi për vizitë në Gjermani, më konkretisht në rrethinë të Dyzeldorfit. Erdhi aty, sepse në këtë krahinë të zhvilluar industriale kishte shumë emigrantë shqiptarë. Por, nuk duhet të ketë qenë ky fakt shtysa kryesore që ai të vinte. Më shumë rol në ardhjen e tij duhet të ketë luajtur gjallërimi i veprimtarisë patriotike dhe çlirimtare, që ishte më e avancuar se në krahina të tjera gjermane dhe në shtete të tjera të Evropës Perëndimore. Ai erdhi edhe sepse donte të më takonte dhe, së bashku, të takonim patriotët e angazhuar të asaj ane.

Nuk e pyeta se nga erdhi dhe si erdhi, sepse ai praktikonte konspiracion të thellë, i cili ndonjëherë më bezdiste. Natën ndërmjet të enjtes e të premtes e kaluam në Mylhajm/Rur (Mülheim a.d. Ruhr), në familjen e vëllait tim, Mustafës, kurse ditën e premte e kaluam në Dyzeldorf. Edhe emigrantët e angazhuar të Mylheimit dhe të shumë qyteteve përreth Dyzeldorfit, si qendër të angazhimeve patriotike kishin Klubin "Emin Duraku", në Dyzeldorf. Ky klub tashmë ishte afirmuar si vatër kryesore e angazhimeve patriotike të shqiptare në Evropën Perëndimore.

Në Dyzeldorf zumë vend në banesën e Sylë dhe Vezire Nuhajt, nga Malësia e Jezercit të Ferizajt. Aty dhe në vizita të tjera takonim bashkatdhetarë veprimtarë. Kadriu kishte planifikuar ta kalonte atë fundjavë në Dyzeldorf. Aty kaluam natën ndërmjet të premtes e të shtunës së 16 janarit. Të shtunën para dite, ndoshta rreth orës 11.00, Mustafa na njoftoi se Jusufi kishte telefonuar dhe na kishte ftuar për të shkuar në mbrëmje në Bernhausen, qytezë afër *Shtutgartit* (Stuttgart), te bashkatdhetari Murat Kryeziu.

Me thënë të drejtën ftesa e Jusufit me gëzoi, sepse vinte pas një ftohjeje në marrëdhëniet në mes Jusufit dhe Kadriut, por nuk ishte krejtësisht befasuese, sepse para dy javësh, në dasmën e Kadriut dhe Saime Isufit, ishim sqaruar për rrethanat që kishin imponuar atë ftohje. Vetëkuptohet, nuk e diskutuam fare nëse duhej të shkonim ose jo. Sylën e lutëm të gjente një zgjidhje për të na dërguar me makinë, meqë ai nuk kishte të vetën dhe kishim rreth 450 km., largësi për të udhëtuar.

Në mbrëmje arritëm në Bernhausen. Atje gjetëm Jusufin, Bardhin, Fahredin Tafallarin dhe, ndoshta, më shumë se 20 vetë të tjerë. Ata ishin mbledhur për të parë premierën e fil-

mave shqiptarë që Jusufit i kishin ardhur në videokaseta nga Tirana. Krijova përshtypje se Jusufi e kishte organizuar këtë aktivitet dhe na kishte ftuar që bashkatdhetarët e rrethinës së Shtutgartit të na shihnin bashkë.

Në banesën e Muratit qëndruam deri pas mesnate. Prej aty u shpërndamë. Jusufi dhe Bardhi na morën mua, Kadriun dhe Sylën në shtëpi të tyre.

Të dielën, pas mesdite, diku rreth orës 15.00, unë dhe Syla u nisëm për në Dyzeldorf, sepse një javë më parë kishim paralajmëruar se të dielën, më 17 janar, në ora 20.00, në sallën e klubit "Emin Duraku" do të shfaqnim dramën televizive "Gërsheta lufte" (me motive nga jeta e heroinës Shote Galica).

Arritëm në kohë në Dyzeldorf, ku gjetëm përplot sallën me bashkatdhetarë dhe shfaqëm dramën në fjalë, për të vazhduar me diskutime deri afër mesnate. Prej lokalit shkova për të fjetur te Hysri Reka (nga Nerodima e Ferizajt), meqë banesën e kishte afër klubit dhe jetonte vetëm, prandaj ndihesha më komod.

Kjo ishte kryesisht lëvizja jonë fizike e atyre ditëve për të cilat pyetet.

(B.I.:) - Do të rikthehemi përsëri në ngjarjet e këtyre ditëve, jo vetëm sepse janë gjeneza e krijimit, por edhe sepse, në vite të ndryshme dhe nga njerëz të ndryshëm ka pasur komente të cilat jo gjithherë janë përputhur me njëra-tjetrën. Por më parë duhet të kthehem rishtas në atë që më preokupon, e cila, në fakt, duhet të jetë edhe fillesa e një rrjedhe që ka bartur me vete enigma, të sakta e të pasakta. Për të ardhur deri këtu, po ashtu, ka një fillesë tjetër:

Një organizatë nuk krijohet nga hiçi, nga asgjëja dhe në vakuum. Pra nuk krijohet nga vakuumi i ideve, i subjek-

teve dhe as nga dëshirat e një grupi njerëzish, sado të përkushtuar të jenë ata. Duhen idetë, duhen rrethanat, duhen njerëzit, duhet përkushtimi i tyre.

Le t'i saktësojmë që në fillim të bisedës idetë që kishit, rrethanat në të cilat po ngriheshin ngjarjet, njerëzit që e morën përsipër dhe çfarë përfaqësonin ata. Dhe, si për të përmbyllur pyetjen time, përse u hodh ideja dhe u realizua krijimi i një organizate të tillë, thellësisht ilegale, jashtë Kosovës?

(I.K.:) **-** Veprimtaria e paorganizuar patriotike e disa emigrantëve ekonomikë kishte zënë fill qysh në nismë të viteve '70. Veprimtaria e emigracionit politik ishte e mëhershme, që kur kanë zënë të emigrojnë shqiptarët, por më e sforcuar bëhet kur arratisen kundërshtarët politikë, që ndiqeshin nga regjimet e Jugosllavisë, Shqipërisë dhe Greqisë, pas Luftës së Dytë Botërore. Por, veprimtaria e këtij emigracioni politik ishte e orientuar kryesisht në luftën ideologjike kundër diktaturës komuniste në Shqipëri dhe jo për çlirimin e trojeve të pushtuara.

Emigrantët e interesuar ekonomikë kishin gjetur materiale propagandistike të Shqipërisë përmes komunistëve gjermanë, të cilët, në qendrat e qyteteve gjermane, dilnin të shtunave për të përhapur idetë e tyre. Ata shpërndanin e shisnin edhe libra e revista në gjuhën shqipe, që silleshin nga Tirana. Kështu disa nga emigrantët tanë kishin zënë të bartnin fshehurazi libra e revista në vendlindje. Kështu kishte vepruar, ta zëmë, edhe im vëlla, Mustafa.

Kur u arratisa dhe u vendosa fillimisht tek ai gjeta literaturë të bollshme nga Tirana. Më pas, me këta emigrantë të frymëzuar me patriotizëm aktiv, zumë të njiheshim dhe të bënim aktivitete më të angazhuara, duke u përqendruar fillimisht në Dyzeldorf, rreth 90 km., larg nga Bohumi. Ky angazhim u for-

cua edhe me themelimin e Frontit të Kuq Popullor (FKP) në tetor të vitit 1977. Kjo ishte njëra anë, ajo që do të vinte nga unë dhe nga njerëzit që mendoja se i përfaqësoja. Më shumë se disa anëtarë të organizatës çlirimtare FKP, unë mendoja se sillja frymën e mendimin e bashkatdhetarëve të organizuar në klubet shqiptare, sidomos të asaj pjese që ishte e gatshme të merrte përsipër angazhime më të mëdha.

Në dhjetor të vitit 1979 u arratis Jusuf Gërvalla. Meqë me Bardhin (emri i plotë Bardhosh), vëllanë e tij, njihesha qysh nga viti 1977, përmes bashkëveprimtarit Hysen Gega dhe dhëndrit tim, Ramush Kastrati, Bardhi më telefonoi pothuajse sapo Jusufi arriti në Ludvigsburg, gjegjësisht sapo Bardhi e solli atë nga Sllovenia në qytetin ku jetonte e punonte.

Ardhja e Jusufit na ngriti shumë moralin, sepse deri atëherë nuk kishim intelektual të njohur që, veç të tjerave, pos urtësisë dhe rrëzëllimit që përmbante, dinte të bënte edhe gazetë. Pra ishte njeriu i duhur. Me kontributin e Jusufit veprimtaria jonë sa vinte e rritej, sepse aty e tutje u liruam nga angazhimi për të përgatitur e shtypur gazetën. Kjo bëri që ne të kishim më shumë kohë e energji për të kontaktuar bashkatdhetarët, ndaj dhe zgjeruam rrethin edhe në Zvicër, Belgjikë, Francë, Austri, Danimarkë, Suedi etj.

Qysh në takimin e parë me Jusufin shkëmbyem informatat, meqë nuk i druheshim njëri-tjetrit, sepse në mes kishim Bardhin dhe Hysen Gegën. Fakti se u përkisnim organizatave të ndryshme, - Jusufi, Lëvizjes Nacional-Çlirimtare të Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ), unë FKP-së, - nuk na pengoi fare për të bashkërenduar veprimtarinë patriotike e çlirimtare.

Vëllimi i veprimtarisë sonë ishte mbi kapacitetet njerëzore

e financiare që kishim atëherë, por kjo ndodhte sepse vullnetin dhe përkushtimin i kishim mbi mundësitë tona. Në këtë vazhdë, edhe fama e organizimeve tona u bë më e madhe sesa e meritonte, ngaqë nën pushtete pushtuese e diktatoriale kjo famë fryhej, qoftë për shkak se populli propagandonte fuqishëm angazhimet çlirimtare, qoftë edhe për shkak të alarmimit të sundimtarëve pushtues e diktatorë kundër organizimeve të fshehta (klandestine) politike e çlirimtare. Kjo ishte ana e dytë, ajo që mund të thosha se vinte nga Jusufi dhe organizimi i tij politik që ai dhe vetëm ai, mund të them bindshëm, me dinjitet si askush tjetër, mund ta bënte. Koha tregoi se shumë nga ata që hiqeshin se ishin „drejtuesit“ e Jusufit, në të vërtetë nuk ishin asgjë tjetër, veçse tkurrje e mendimit politik e intelektual, për të mos folur për ngrehina të tjera.

Gjatë vitit 1980 nisi aktivitetet e saja të dukshme edhe Organizata e Marksistë-Leninistëve të Kosovës (OMLK), kryesisht në Zvicër. Njeriu më i njohur i tyre në Perëndim do të bëhej shumë shpejt Kadri Zeka, një figurë e vyer, jo vetëm për kohën kur jetoi, i cili përmblidhte në një militantin e zjarrtë dhe njeriun e vendosur. Mendoj se OMLK-ja nuk do të kishte mundur të gjente një njeri më të denjë për ta përfaqësuar atë. Kjo është e vërteta. Dhe kjo përbën atë që mund ta quaj **pala e tretë.**

Renditja e palëve nuk ka të bëjë me rëndësinë e tyre. Unë mund të them bindshëm se në këtë përfaqësim e ndieja veten gjithnjë në rolin e një njeriu që ishte i gatshëm kurdoherë për të qenë pranë tyre, duke hequr dorë nga çfarëdo angazhimi tjetër. Asnjëherë nuk jam merakosur se ku duhet të jem, në cilin pozicion, jam apo nuk jam në udhëheqje? Më shumë jam prirë nga ideja se ku mund të shërbej.

Shpërthimi i demonstratave të studentëve më 11 mars 1981

na befasoi për të mirë. Bazuar në informatat që kishim, asnjëri nga ne nuk kishte parashikime konkrete, aq më pak dorë në organizimin e shpërthimit të tyre, pos paralajmërimeve propagandistike që bënim në stilin "popullit po i humb durimi dhe shpejt pritet shpërthimi i revoltave të hapura dhe kryengritëse".

Ai shpërthim i demonstratave na gjeti të papërgatitur, brenda dhe jashtë vendi. Nuk kishim organizime të fuqishme dhe të shtrira. Ishim në fillimet e një praktike të re. Disa ditë pas demonstratave u bëmë bashkë veprimtarët e tri organizimeve dhe vendosëm të bashkërendonim veprimtaritë, fillimisht me organizimin e demonstratave në kryeqendrat e Evropës Perëndimore. Kjo bashkëveprimtari na ndërgjegjësoi edhe më shumë për të bërë edhe bashkimin organizativ të të tria organizatave tona.

Bisedimet për bashkim i filluam sapo përfunduam serinë e demonstratave para pushimeve verore. Këtë angazhim na e nxitën dhe lehtësuan *Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës,* për të cilat nga Kadriu na u tha se i kishte hartuar OMLK-ja në Kosovë, por, për shkak të arrestimeve të mëdha, duhej të vazhdonin bisedimet për bashkim në emigracion.

Atëherë dhe tani mund të dëshmoj se ne nuk kishim ndonjë dallim të madh ideor dhe politik, pos ndonjë nuance në aspektin se do të bashkoheshim në një organizatë të përbashkët me ose pa pararojë komuniste, si dhe nëse kërkesa për Republikë duhet të përfshinte vetëm Krahinën e Kosovës apo të gjitha territoret e banuara në shumicë me shqiptarë në Jugosllavi.

Kërkesa Kosova-Republikë ishte një kthesë e madhe, e imponuar nga përcaktimi në Kosovë vetëm për Republikën e Kosovës, meqë deri atëherë kishim përcaktimin për çlirim të plotë kombëtar dhe bashkimin me Republikën e Shqipërisë.

Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës i miratuam vërtet shumë shpejt, qysh në bisedimet e para, me ndonjë ndryshim pothuajse kozmetik. Në bisedimet e atëhershme qenë përfshirë një rreth më i gjerë bashkëveprimtarësh, por, me kërkesën e Jusufit, i cili dëshironte t'i bënte nder veteranit Sabri Novosella, siç e vlerësonte ai, u pajtuam që bashkimi të shpallej nga Sabriu në Turqi, ku ishte i strehuar qysh në fillim të vitit 1980. Atje ai kishte shkuar me ndihmë të strukturave shtetërore të Tiranës, por ende nuk ishim të informuar si kishte arritur deri në Tiranë.

Në 12 tetor të vitit 1981 Kadriu dhe Bardhoshi shkuan për këtë qëllim në Turqi, por atje bashkimi dështoi. Arsyetimet përse nuk u formalizua bashkimi në atë takim (ku ishte i pranishëm edhe diplomati shqiptar Bujar Hoxha), janë dhënë dhe janë nga më të ndryshmet, por, sipas investigimeve të mia (që ende vazhdojnë), Sabriu duhet të ketë qenë kundër atij bashkimi, sepse duhet t'i jetë frikësuar të vërtetave të hidhura që do të zbuloheshin më pas. Sigurisht, pastaj do të zbulohej se ai nuk kishte dhe nuk po udhëhiqte organizatë të mirëfilltë, së cilës i dihet koha, vendi i themelimit, njerëzit që e kanë themeluar, mënyra e funksionimit organizativ e të tjera, si dhe shpërdorimet financiare. Do të zbulohej, siç isha informuar, se kryetar i asaj organizate nuk ishte Metush Krasniqi, siç kishte dezinformuar më herët Sabriu. A nuk të detyron të dyshosh fakti se Jusufi dhe Sabriu arratisen në mbarim të vitit 1979, Jusufi vendoset në Gjermani, Sabriu në Shqipëri dhe prej andej ai kalon në Turqi dhe që atëherë e deri në prill të vitit 1981 nuk kanë asnjë kontakt ndërmjet tyre. Me Jusufin nuk merr kontakt as edhe ndonjë drejtues tjetër i asaj organizate, qoftë nga Kosova ose nga emigracioni. Sa herë i qe dërguar porosia dhe lutja Sabriut në Turqi, i ishte përcjellë numri i telefonit

dhe adresa që të kontaktonte Jusufin dhe ai nuk bëhej i gjallë. Si e ka udhëheq Sabriu organizatën e tij gjatë kësaj kohe, prej gati një viti e gjysmë, kur as me Jusufin nuk ka kontaktuar? Vetëm në prill 1981, kur ai është informuar se veprimtaria e angazhuar patriotike po merrte përmasa të shtrira në shtetet e Evropës Perëndimore, edhe si meritë e angazhimit të Jusufit, vetëm atëherë duhet të ketë vendosur të angazhohet për ta kontaktuar e "udhëhequr" Jusufin (!).

Që nga mesi i tetorit të vitit 1981 e deri në ditët e parat të janarit të vitit 1982, megjithëse në heshtje, ishte një periudhë për shkrirjen e akujve mes Jusufit dhe Kadriut, shkrirje e cila, megjithëse ngrirja nuk kishte qenë aq e thellë, kërkonte kohën e saj dhe po ndodhte natyrshëm. Është thënë disa herë se animi im ishte më shumë nga Kadri Zeka dhe organizata që ai përfaqësonte dhe, herë pas here, edhe është sulmuar ky anim, si e quajnë, megjithëse e vërteta ishte ndryshe. Unë nuk kisha ndër mend asnjë lloj animi. Fakti është se "shkrirja" mes nesh dhe OMLK-së, por edhe mes nesh dhe LNÇKVSHJ-së, ishte bërë qysh kur kishim filluar bashkëveprimtarinë në terren, nga prilli e këtej dhe bashkëveprimtarinë po e vazhdonim tani më intensivisht me OMLK-në. Ne mund të vendosnim vetë, pa dashur të kishim edhe një mendje tjetër, diku tjetër, gjegjësisht një "udhëheqës" në Turqi. Pengesë e shkrirjes dhe e bashkimit nuk mund të ishte kurrë, assesi, Jusufi apo Bardhi, sepse, si i kam njohur dhe besoj se i kam njohur mirë, ata nuk e kishin ndarjen në natyrën e tyre. Pengesa vinte nga larg, jashtë tyre dhe do të mjaftonte një rast i vetëm, siç ishte dasma e Kadri Zekës dhe e Saime Isufit, që të mos kishte ndarje të mëtejshme dhe të fillonte procesi i bashkimit konkret.

Kjo është e vërteta dhe nuk ka një të vërtetë tjetër, duan

apo nuk duan të tjerët. Unë kam qenë aty, pjesë e ngjarjeve e herë pas here edhe faktor i tyre. Por, kjo nuk do të thotë se gjithçka u zgjidh. Kishte mbetur edhe diçka pa u bërë. E kjo do të bëhej shumë shpejt.

Pas shumë peripecive, më 16 janar, me ftesë të Jusufit, bëhemi sërish bashkë dhe, më 17 Janar 1982 vendosëm të bashkohemi në **Lëvizjen për Republikën e Kosovës,** për të lënë të hapur çështjen e pararojës komuniste për më vonë, në bazë të zhvillimeve në terren.

Atentatet e kobshme të natës së 17 Janarit na e përgjakën dhe na e plagosën rëndë këtë **bashkim**, por nuk na e vranë. Ndaj vendimi për formimin e Lëvizjes ishte një Lindje e Përgjakur.

(B.I.:) - I saktësuam disa nga idetë, të paktën fillestare. Tashmë dihen disa nga rrethanat dhe ngjarjet, koha që ishte. Mirëpo, për të shkuar te dita dhe nata e 17 Janarit, që është faktikisht data e saktë e krijimit të LRK-së, kishin ndodhur disa ngjarje, prej të cilave një palë ishin shumë të rëndësishme, do të thosha vendimtare. Demonstratat e vitit 1981, të cilat i përmendët, që u zhvilluan në të gjitha vendet kryesore evropiane, ishin shpallja e parë e divorcit dhe e ndarjes politike dhe shtetërore e Jugosllavisë së atëhershme. Shqiptarët në Perëndim, për herë të parë e shpallën këtë. Si u organizuan ato, nga kush, sepse asaj kohe, siç dihet, Lëvizja nuk ishte krijuar, bashkimi nuk ishte bërë, kishte disa organizata politike? Si u organizuan ato, nga cilët, kush merrte vendimin se ku dhe kur do të bëhej një demonstratë?

(I.K.:) **-** Demonstratat e fuqishme në Kosovë në Pranverën e Vitit 1981 ishin shpallja e parë e divorcit me Jugosllavinë, nëse më lejoni të përdor simbolikën tuaj, kurse demonstratat në Perëndim ishin vetëm afirmim dhe fuqizimi

i tyre politik dhe çlirimtar.

Organizimin e demonstratave në Perëndim e bënim bashkërisht, të tria organizatat tona të atëhershme, OMLK-ja, LNÇKVSHJ-ja dhe FKP-ja. Për këtë bashkorganizim u morëm vesh shpejt e lehtë, sepse, do të thosha, edhe nga këndvështrimi i sotëm, dominoheshim nga patriotizmi idealist dhe nuk gjenin aspak shprehje karrierizmi, bajraktarizmi ose epërsia e ndonjërës organizatë.

Planifikimin e demonstratave e bëmë qysh në fillim, në takimin e parë që kisha me Kadriun në Bil (Biel/Bienne) të Zvicrës, meqë isha dërguar dhe i ngarkuar edhe nga Jusufi. Për fjalimet në gjuhën shqipe në demonstrata ramë dakord t'i merrte përsipër Kadriu, traktet në gjuhën shqipe duhej t'i përgatiste Jusufi, traktet në gjuhën gjermane unë dhe Bardhoshi, kurse në gjuhët e tjera duhej të gjenim përkthyes. Demonstratat duhej të thirreshin në emër të secilës organizatë, sipas radhës, kurse për organizimin teknik dhe mbarëvajtjen secili nga ne do të duhej të caktonte bashkëveprimtarë sa më të zhdërvjellët. Megjithatë, ne të FKP-së hoqëm dorë që ndonjëra nga ato demonstrata të kishte për "patron" organizatën tonë, sepse nuk donim t'i ekspozonim demonstratat si tepër ekstremiste, siç tingëllonte emri i organizatës. Në vend të saj, titullar zyrtar të demonstratës në Dyzeldorf bëmë Klubin Shqiptar "Emin Duraku". E vërtetë e pakontestueshme është se vrojtuesi i jashtëm nuk kishte si të hetonte se demonstratat po organizoheshin nga tri organizata, ngaqë të tria e kishin bashkuar veprimtarinë në atë nivel, sa dukej se po i organizonte një organizatë e vetme.

Organizimet e djathta nuk u bashkuan në demonstrata, meqë në platformat e tyre ato kishin kryesisht çlirimin e Shqipërisë nga diktatura komuniste, për të mos thënë të vërtetën

e hidhur se pothuajse të gjitha i kontrollonte dhe i komandonte UDB-ja jugosllave dhe shërbime të tjera. Ato u munduan dhe na kërcënuan që të mos demonstronim në Bruksel, në qershor 1981, por ne nuk iu frikësuam kërcënimeve të tyre dhe demonstrata rezultoi e fuqishme dhe pa asnjë incident.

(B.I.:) - Përmendët disa herë shtetin shqiptar. E përmendët në kontekste të ndryshme, mirëpo ende nuk kemi shkuar te themelorja.

Tani nuk është sekret për asnjë se strukturat klandestine të lëvizjeve atdhetare të asaj kohe, por edhe më parë e më pas kërkonin mbështetjen e shtetit shqiptar, madje besonin, nganjëherë deri në verbëri, te kjo mbështetje. Pa dashur të futemi tani në këtë temë, që më pas do të ketë vendin e saj në bisedën tonë, pyetja ime është e thjeshtë: Në organizimin e demonstratave, kudo në Perëndim, cili ishte roli i shtetit shqiptar? A kishit ju në atë kohë një strukturë lidhëse me shtetin shqiptar, që, në fund të fundit, pavarësisht se si rrodhën më pas ngjarjet, do të ishte e natyrshme?

(I.K.:) - Sigurisht që prisnim përkrahje nga shteti amë, gjegjësisht pushteti i tij. Por, për këtë tematikë, jam shprehur më gjerësisht në romanin "Atentatet", ndërsa këtu, besoj, mjafton nëse përgjigjem shkurtimisht.

Ndonjë përkrahje konkrete materiale ose financiare nuk kemi pasur asnjëherë nga shteti shqiptar, as unë individualisht, as Fronti i Kuq Popullor. Këshilla, sugjerime, kritika kemi pasur ndoshta me tepri e pa takt, si të natyrës: "Mos shkruani në gazetat tuaja për partinë dhe për shokun Enver Hoxha, por përqendrohuni vetëm në barazi nacionale brenda Jugosllavisë", etj. Disa herë kam takuar Simon Qiricin, Sazan Beun, Lirim Shytin (të angazhuar në ambasadën shqiptare në Vjenë) e të

tjerë në Paris, Berlinin Lindor, Nju-Jork. Nuk di të kemi pasur as ndonjë ndihmë konkrete organizative. Shpesh më kanë ndodhur keqkuptime e përplasje goxha vulgare, si rasti në ambasadën shqiptare në Vjenë, në prill të vitit 1981, kur me këmbënguljen e Jusufit shkova për të pyetur nëse duhej të demonstronim në Perëndim, ose rasti tjetër në ambasadën shqiptare pranë OKB-së, në Nju-Jork, në qershor të vitit 1982, kur ambasadori Abdi Baleta u urdhërua nga një "sigurims" që të më nxirrte jashtë, por unë nuk dola me arsyetimin se nuk isha në shtëpinë e tyre private.

Ndërkohë po dëgjoj e po lexoj spekulime nga më të ndryshmet, lidhur me (mos)ndihmesën e shtetit shqiptar.

Po shfrytëzoj kësaj radhe këtë bashkëbisedim për të rrëfyer për një reagim, ndoshta tejet domethënës, pas botimit të romanit, që ka të bëjë pikërisht me ndihmën e shtetit shqiptar. Personaliteti NN në Tiranë, tejet kompetent, reagoi se në romanin tim nuk kisha thënë të vërtetën lidhur me ndihmën e shtetit shqiptar dhe se ajo ishte ndryshe nga sa unë kisha shkruar. Unë këmbëngula se kisha thënë të vërtetën, duke u kufizuar në relacionin ndaj meje dhe FKP-së, pastaj ai më pyeti: "Di gjë nëse Jusuf Gërvalla i ka kërkuar ndihmë financiare Enver Hoxhës përmes një letre?" Pohova t'i kishte kërkuar, madje ia rrëfeva edhe debatin që kisha pasur me atë rast me Jusufin, kur më informoi se i kishte shkruar letër Enver Hoxhës dhe i kishte kërkuar 10 mijë dollarë ndihmë për të blerë një makinë radhitëse të tekstit për botimin e gazetës. Unë e pata qortuar goxha rëndë kur më tha se letrën e kishte dërguar me postë, duke i thënë se kështu po i jepnim argumente policisë gjermane për të na kategorizuar si strukturë spiunazhi të Enver Hoxhës. Më vonë Jusufi më thotë se i kishte ardhur ndihma nga Tirana. E pyeta,

sa i kishin ardhur dhe përmes kujt? Ai më tha, aq sa i kishte kërkuar, 10 mijë dollarë, përmes Sabri Novosellës.

- Enveri nuk meriton të respektohet nëse nuk do të kishte dërguar të paktën edhe 10 dollarë më shumë, me porosi që të qerasësh nga një kafe shokët, por, ama, ia paskan ngopur babëzinë "rrobaqepësit", - i thashë. Ai reagoi me hidhërim, me kërkesën që të mos e përflas e të mos e paragjykoj më „udhëheqësin" e tij të devotshëm, Sabri Novosellën.

Sapo mbarova rrëfimin, personaliteti kompetent u zotua se vetëm në atë rast i ishin dorëzuar 500 mijë dollarë Sabri Novosellës, pastaj edhe në tri raste të tjera nga 500 mijë, sa kishte qenë ai në atë pozicion ndërlidhës. Ajo informatë më turbulloi jashtëzakonisht, ngaqë njeriu që po më fliste ishte një personalitet që e respektoja së tepërmi me besim në sinqeritetin dhe patriotizmin e tij.

E luta t'i publikonte të dhënat, meqë më siguroi se pranimin e atyre ndihmave financiare e ka firmosur Sabriu. Më tha se nuk e bënin dot, ngaqë qeveria kineze do të mendonte se kishin shpërdoruar fondin e fshehtë prej 500 milionë dollarësh, që ua kishte besuar për të financuar lëvizjet komuniste e revolucionare në botë dhe do të na i kërkonte tani si borxhe, ngaqë fuqia blerëse e dollarit të atëhershëm ka qenë të paktën 10 herë më e madhe sesa e dollarit të tanishëm. Nuk më mbeti tjetër, pos të ngushëlloja veten dhe atë, duke i thënë se shteti shqiptar tani kishte mundësinë për të ngritur padi kundër Sabri Novosellës dhe t'ia konfiskonte pasurinë, meqë nuk ka asnjë dëshmi se ndihmat që paska dhënë atëherë shteti shqiptar, ai i ka investuar në veprimtarinë e atëhershme patriotike, me përjashtim të atyre 10 mijë dollarëve që ia kishte dhënë Jusufit, meqë duhej të ishte informuar nga Bujar Hoxha, se aq kishte kërkuar.

Sigurisht që pyeta edhe një personalitet tjetër, tepër kompetent, i cili pohoi të njëjtën gjë, madje duke shtuar se ka edhe shuma të tjera që i janë dhënë Sabriut, por edhe ndonjë tjetri.

Meqë këtë pabesi e hajni e ka bërë "udhëheqësi" Sabri Novosella, alias "rrobaqepësi", mos i pastë hije dhe mos ua paftë hairin, meqë gjithë jetën nuk e kam përmbajtur hidhërimin ndaj mosndihmesës nga Shteti shqiptar. Disa herë jam grindur me Jusufin duke u përpjekur ta bind se çfarë keqbërësi e shpërdoruesi ishte Sabri Novosella. Në rastin e kundërt, nëse kjo rezulton e trilluar, nuk mjafton të kërkoj publikisht falje, por vullnetarisht pranoj dënimin, sipas ligjeve përkatëse.

(B.I.:) - Jusuf Gërvalla, pa dyshim njëri ndër ideologët dhe liderët më të rëndësishëm të të gjitha dekadave në lëvizjen ilegale në Kosovë, i është drejtuar Enver Hoxhës, drejtpërdrejt, me një letër që, më pas, shumë më vonë, do të bëhej e njohur. Ju ishit ndër miqtë më të afërt të tij, ndoshta, në atë kohë, më i afërti. Kishit dijeni për atë letër dhe, ajo që më intereson më shumë, erdhi ndonjëherë një përgjigje nga Tirana?

Më treguat si ndodhi ngjarja me ndihmën e kërkuar financiare dhe mendoj se shteti shqiptar mirë ka bërë, por më shumë sesa kjo, pra ndihmë prej disa mijëra dollarësh, më intrigon fakti nëse ka pasur një letërkëmbim mes tij, Enver Hoxhës dhe Jusufit, apo mes tij e të tjerëve e, në fund, mes shtetit shqiptar dhe lëvizjes konspirative në Perëndim?

(I.K.:) **-** Për një letër të Jusufit dërguar Enver Hoxhës sapo ju fola, për të tjera Jusufi nuk më ka informuar, ndoshta për shkak se e pata qortuar për letrën në fjalë. "Letrat" dhe "raportet" që i ka publikuar Fahredin Tafallari dhe ndonjë tjetër, përmbahem t'i komentoj derisa origjinalet t'i dorëzohen Arkivit të Kosovës

dhe të vlerësohen nga ekspertët, nëse janë të vërteta apo të falsifikuara, sepse veprimtaria subversive e disa komplotistëve të atëhershëm, po vazhdon të jetë aktive.

Sa i përket pyetjes vijuese, nuk do të thosha se Jusuf Gërvalla ishte ideolog dhe as lider i përmasave të madhërueshme. Ai ishte një krijues e kritik letrar goxha brilant dhe, po të vazhdonte të jetonte, do të na kishte dhënë vepra të mira letrare, po vetëkuptohet, nëse nuk do të merrej me veprimtari politike, do të thosha. Ishte këngëtar me zë tejet melodik, instrumentist, kompozitor, gazetar e publicist brilant, madje i talentuar edhe në artet grafike, por ideolog e udhëheqës nuk ishte, sepse literaturën përkatëse e ka urryer dhe as ndonjë përvojë të atij lëmi nuk kishte. Në vitin 1980 pati nisur të lexonte veprat e Leninit dhe me vrull i përdorte citatet nga ato. Them se për lider nuk mund të vlerësohet, derisa pranonte ta udhëhiqte, më saktësisht ta manipulonte një rrobaqepës gjysmanalfabet, siç ishte Sabri Novosella, për të mos thënë dhe ndonjë sharlatan edhe më i ulët se rrobaqepësi. Tjetër është madhërimi dhe mitizimi që i kemi bërë, ndër të cilët jemi dhe ne të dy, ne për interes të hovëzimit të lëvizjes çlirimtare, disa të tjerë për ta shpërdorur për interesa egoiste e të ulëta vetjake.

Thënë shkoqur, asnjë bashkëveprimtar nuk e kam pasur më për zemër se Jusufin, ama mitizimet dhe madhështitë deri në banalizime, që po u bëhen Jusufit dhe shumë të tjerëve, vërtet po ma zbehin admirimin për veprimtarë kombëtar heronj.

Pararendje e ditës së 17 Janarit

(B.I.:) - E kemi tani një tablo edhe më të saktë të ideve që janë hedhur asaj kohe, ngjarjet që janë zhvilluar, njerëzit që i kanë marrë përsipër, dukjen ose mosdukjen e shtetit shqiptar, lëvizjet që kanë ndodhur, vështirësitë, disa të kalueshme që asaj kohe dhe të tjera që kanë ndjekur zhvillimin e organizatës. Të gjitha këto të duket sikur janë të mjaftueshme për të ardhur në ditën e 17 Janarit 1982, por unë mendoj se mungon edhe një detaj: ***marrëdhëniet njerëzore****. Dikujt mund t'i duket e pazakontë një gjë e tillë, sidomos kur bëhet fjalë për ngjarje të tilla të mëdha, si ideja e Republikës së Kosovës dhe bashkimi me shtetin shqiptar. Mirëpo, duam apo nuk duam, ata kanë rëndësinë e tyre, sidomos kur është fjala për ne, shqiptarët dhe mendësinë tonë.*

Si ishin marrëdhëniet tuaja njerëzore, të përditshme, të zakonshme, ato që në pamjen e parë nuk bëjnë pjesë në jetën e një ilegali, por që janë vetë thelbi i punës së tyre?

(I.K.:) - Përgjithësisht, marrëdhëniet tona kanë qenë njerëzore, shoqërore, marrëdhënie të një bashkëveprimtarie të ngushtë, të bazuara në besimin dhe në respektin reciprok. Meqë ishin njerëzore, ndonjëherë ndodhnin keqkuptime e përplasje, edhe mes meje dhe Jusufit, por i tejkalonim, pasi sqaroheshim. Nganjëherë keqkuptimet sqaroheshin menjëherë e nganjëherë zgjatnin, por jo aq sa të bëheshin të dëmshme. Shumë gjëra po i bënim për herë të parë. Mendonim se koha do na mësonte. Askush nuk e dinte se rrjedha e jetës mund të këputej kaq shpejt, megjithëse ishim të vetëdijshëm se edhe mund të ndodhte. Pastaj, kishte dhe ka nga ata xhelo-

zë, smirëzinj, shpifarakë, do të thosha argatë të djallit e të birit, që vetëm shpifnin e nxinin, madje vazhdojnë edhe tani, sikur bashkëveprimtaria jonë ka qenë e dominuar me zënka e grindje. Ata duan të risjellin këtë në mend, pasi shpeshherë nuk ishin as dytësorë dhe mendojnë se, duke sjellë këtë, bëhen të pranishëm, të dukshëm dhe të pranueshëm.

Qysh kur është arratisur Jusufi e kam mirëpritur dhe jam angazhuar ta prezantoj e ta afirmoj në rrethet e emigrantëve të angazhuar patriotë, e kam marrë në mbrojtje kur e kanë akuzuar të tjerët dhe jo vetëm kaq, e kam prezantuar dinjitetshëm, pse jo edhe madhërishëm, edhe pse ai kur u arratis ende nuk kishte bërë emër që do të imponohej e do të respektohej. Pra, për emigrantët ishte pothuajse anonim. Jusufi e gjeti terrenin e përgatitur, nëse mund të shprehem kështu. Nuk është ballafaquar si unë me vështirësitë fillestare të mosnjohjes me njerëz, me të cilët ndërkohë kam krijuar besim e miqësi. Vetë vëllimi fizik i bashkëveprimtarisë sonë, vetëm për pak më shumë se dy vjet kohë, dëshmon se bashkëveprimtaria jonë ka qenë goxha e gjerë, e bazuar në besimin e ndërsjellë. Hidhërimet e keqkuptimet afatshkurta kanë qenë kryesisht rezultat i shpifjeve, i veprimtarisë subversive dhe i luftës speciale, që bënin njerëzit e komanduar nga UDB-ja, të cilët nuk e kishin të vështirë t'i afroheshin dhe ta dezinformonin Jusufin, meqë i mungonte përvoja organizative në njërën anë, poaq sa i idealizonte shqiptarët, në anën tjetër.

Me Bardhoshin nuk kam pas ndonjëherë ndonjë keqkuptim, ngaqë ai kishte përvojë më të madhe në marrëdhëniet me njerëzit dhe dinte të çmonte përafrimin tim ndaj tij, edhe kur të tjerët e paragjykonin atë si punëtor social të dërguar nga shteti jugosllav, nga i cili merrte një pjesë të rrogës, për të kështilluar

emigrantët “jugosllavë”.

Bashkëpunimi me Kadriun ka pasur intensitet shumë herë më të vogël sesa me Jusufin dhe Bardhin, sepse edhe koha e bashkëveprimtarisë ka qenë e shkurtër, por ka qenë tejet e frytshme, pasi ishte një njeri i cili, me gjithë përparësinë që u jepte parimeve, të linte hapësirë, të kuptonte, dinte te të përvetësonte, përpiqej të krijonte atë mjedis që duhej. Gjithsesi, kemi qenë shokë të ngushtë, kemi pasur besim, mirëkuptim e respekt kulmor reciprok.

Ndoshta nuk e teproj nëse sjell shembuj që i dëshmojnë marrëdhëniet tona të ngushta dhe të mira. Rëndom, gjatë veprimtarisë klandestine çlirimtare veprimtarët janë tepër të kujdesshëm, madje shpesh të kujdesshëm dhe konspirativë më shumë sesa duhet, meqë vazhdimisht janë të rrezikuar nga pushtuesi dhe pushteti diktatorial. U arratis Jusufi dhe unë nuk hezitova fare për t’i besuar, për ta afruar dhe për ta angazhuar në punë serioze, ashtu siç nuk kam menduar dy herë për të marrë nga ai detyra apo angazhime të ndryshme. Kjo ndodhi sepse në mes fillimisht ishte besimi që kishim ndërtuar me Bardhoshin. Qysh në takimin e parë unë i rrëfej për gjendjen dhe zhvillimet e deriatëhershme në emigracion. Shumë shpejt i besojmë edhe redaktimin e organit “Bashkimi”, duke e njoftuar njëkohësisht me bashkëveprimtarë, pavarësisht faktit se ai ishte i një organizate tjetër. Njeh ndokush një praktikë të tillë, të kishte ndodhur përpara ose pastaj, në mes të subjekteve klandestine çlirimtare? Kësaj duhet t’i shtoj edhe faktin se bëhej fjalë për individë goxha sektarë e fanatikë, sa u përket bindjeve ideologjike. Kush, edhe sot e kësaj dite, do t’ia besonte ose do t’i jepte tjetrit redaktimin e një organi a gazete, vetëm se e di se tjetri është më i përgatitur dhe më kompetent? Besimit tonë Jusufi iu

përgjigj me gatishmërinë për ta redaktuar, lekturuar e faqosur organin e një organizate tjetër, pa qenë xheloz dhe egoman, se gazeta dhe organizata tjetër do të afirmoheshin shumë, falë edhe atij angazhimi të tij. Kush tjetër do ta prezantonte dhe do ta afirmonte veprimtarinë e një organizate tjetër klandestine te anëtarët dhe simpatizantët e organizatës së tij? Kjo ndodhte sepse ekzistonte besimi dhe bindja reciproke, sepse së shpejti këto dy organizime do të bashkoheshin, se nuk do të garohej për t'ia grabitur organizata organizatës anëtarët dhe simpatizantët, në kuadër të garës për të pasur primatin. Kjo ka bërë që, së bashku, si kurrë më parë, të ngremë në këmbë bashkatdhetarët në një vazhdimësi demonstratash, në të cilat, siç tregova, nuk kishte asnjë primat dhe asnjë hatërmbetje. Kjo nuk kishte ndodhur më parë e nuk do të ndodhte as më pas. Ti, për shembull, si drejtues i Lëvizjes, nga fundi i luftës në Kosovë e ftove disa herë Gagicën që të bashkohej dhe të dilnim së bashku në mbështetje të UÇK-së, por veç përgjigjes "të ruajtë zoti" nuk more asgjë tjetër. Tjetër frymë ka qenë gjatë bashkëveprimtarisë sonë. Ishim njerëzorë, të shtëpisë, si të thuash. Fakti që në shtëpinë e Jusufit dhe të Bardhit kishte një dhomë të veçantë, të cilën banuesit e saj e quanin "dhoma e Ibrahimit", flet më shumë se ato periudha të shkurtra kur heshtja binte mes nesh e që nuk zgjaste shumë. E njëjta u përsërit edhe në mes të Kadriut dhe Jusufit. Edhe Kadriu ia besoi Jusufit redaktimin, lekturën dhe faqosjen e organit "Liria" të OMLK-së, kurse Jusufi, si në rastin me "Bashkimin", nuk hezitoi, u angazhua, madje sakrifikoi edhe vazhdimin e nxjerrjes së revistës së tij "Lajmëtari i lirisë", meqë gjykonte se kështu do të bashkonim më ngushtë bashkëveprimtarinë dhe, rrjedhimisht, do të bashkonim më shpejt organizatat në një të vetme.

Për të mos u zgjatur me këso informimesh e vlerësimesh, a nuk janë këto bashkëpunime e bashkëveprime **më domethënëse** dhe më me **vlerë** sesa ca keqkuptime, hidhërime, ndërprerje afatshkurta të bashkëpunimit? Sigurisht: Po! Prandaj shpejt u mirëkuptuam dhe vendosëm për t'u bashkuar qysh në gusht të vitit 1981, por, fatkeqësisht, këtë përcaktim tonin e pengoi në tetor të po atij viti Sabri Novosella. U sqaruam goxha shpejt për të vendosur përfundimisht më 17 Janar 1982 **bashkimin** e organizatave tona në Lëvizjen për Republikën e Kosovës, të cilin e paguam me jetën e tre heronjve, **bashkim** që përmes atentateve na u plagos rënd, por mbijetoi, doli fitues.

Këtë vlerë përmbajtjesore mundohen ta zbehin dhe ta plagosin shpifjet dhe falsifikimet e organizuara të disa individëve, qysh nga 17 Janari 1982 e deri sot. Mbase edhe do të vazhdojnë, por jam i bindur se vlerat do të fitojnë, për çka edhe uroj.

Metoda e krahasimit është mënyrë domethënëse për të përcaktuar përmbajtjen e vlerave. Ta zëmë, tani një farë Xhafer Durmishi, dikur veprimtar dhe "trashëgimtar" i Jusuf Gërvallës, dhe ndonjë tjetër, harxhojnë kohë e mund, bëjnë sajime e falsifikime, për të paraqitur shtrembër rrjedhat e asaj kohe, sidomos marrëdhëniet e mia me Jusufin, etj. Po ky Xhafer, më 17 shkurt 1982, bashkë me Sabri Novosellën, takohet me kryetarin e Partisë Komuniste të Kosovës, ish-oficerin e UDB-së, Zotëri Abdulla Prapashticën, firmosin bashkimin e organizatës, gjegjësisht "partisë" së tyre dhe pas një muaji fillojnë grindjen mes tyre, kontestojnë marrëveshjen e nënshkruar për "bashkim" dhe armiqësohen për të mos bashkëvepruar kurrë më. Po ky Xhafer, i komanduar nga Sabri Novosella, së bashku përçahen edhe me "përfaqësuesin" e OMLK-së, Zotëri Xhafer Shatrin, me të cilin kishin firmosur

edhe një "bashkim" tjetër, më 15 maj 1982. Përçahen në fillim të vitit 1984, ndahen e armiqësohen, për të mos u takuar e për të mos bashkëvepruar kurrë më.

Krahasimi i bashkëveprimtarisë së të tillëve, që firmosin edhe "bashkime", me bashkëveprimtarinë tonë deri më 17 Janar 1982, pa nënshkruar asnjëherë asnjë marrëveshje, mbase nuk do koment.

*(B.I.:) - Ende nuk kemi ardhur te 17 janari. Dëshiroj të mos shkojmë shpejt e shpejt në një datë themeluese, e cila ka mbetur tashmë në histori. Për të shkuar deri atje na duhet edhe pak rrugëtim, qoftë historik, qoftë njerëzor. Njëri ndër figurat emblematike të datës 17 janar është Kadri Zeka. Një emër i njohur prej dekadash, por, jo rrallë, i lidhur më shumë me ngjarjet e 17 janarit, sesa me atë që i parapriu kësaj dite. Pyetja ime është e thjeshtë: Kush ishte Kadri Zeka? **Ç**farë përfaqësonte ai vetë, si njeri dhe si figurë politike? A ishte dasma e tij, pak kohë para ngjarjeve për të cilat do të flasim edhe më tej, parathënia e bashkimit? Si u njohët me të? Ku? Kush ju njohu? Në cilin vend u takuat për herë të parë?*

(I.K.:) **-** Kadri Zeka ishte një idealist 24-karatësh, nëse mund të shprehem kështu, por me bindje komuniste. Besoj, po të detyrohej të përcaktohej nëse do të sakrifikohej për çështje të çlirimit kombëtar apo për ideologji komuniste, sigurisht, ai do të përcaktohej për çështje kombëtare. Këtë e bazoj edhe në shpjegimet teorike që i dëgjoja nga ai, se popujt e pushtuar, së pari duhet të çlirohen, pastaj të angazhohen për drejtësi sociale. Ai, si shumë të tjerë, ishin përcaktuar për ideologjinë komuniste për shkak të inercisë së kohës, hapësirës dhe rrethanave, me bindje se ishte mjeti më efikas për të realizuar çlirimin kombëtar. Por, jam i bindur se para

ideologjisë ai vinte çështjen kombëtare.

Veprimtarinë e tij, para njohjes mes nesh, nuk e kam hulumtuar, kurse që nga njohja e këtej mund të jem subjektiv, meqë e kam admiruar shumë. Për Kadriun mund të thuhet lirshëm se kishte predispozita të avancuara për t'u bërë ideolog dhe lider, kishte frymën dhe aspiratën e liderizmit, së bashku me guximin për të qenë i tillë. Atentati kriminal ia preu në mes këto mundësi. Në të kundërtën e Jusufit, ai kishte dhunti e përvojë shumë më të madhe organizative, kishte dhunti të shquar për të njohur e për të kategorizuar karakteret e njerëzve, kishte oratori brilante. Jeta në organizim të thellë klandestin, teknika e sforcuar e konspiracionit, parimet e komunistit të devotshëm, linin mundësi që ta keqkuptoja ndonjëherë si tepër shabllon dhe tepër të rreptë. Përndryshe, në jetë normale, ai shfaqej tejet njerëzor e me pah. Kishte dhunti për publicistikë dhe mjeshtëri propagandimi, por rrethanat dhe koha nuk i dhanë mundësi të shfaqte gjithë thesarin e tij, ngaqë, për të qenë revolucionar i devotshëm dhe i suksesshëm, ishte përgatitur paraprakisht gjatë, me përkushtim.

Dasma, në të vërtetë, qe mundësi fatlume për të përshpejtuar mirëkuptimin me Jusufin, më konkretisht, për ta kthyer në gjendjen e para tetorit 1981, të cilën e kishte goditur rëndë "rrobaqepësi" dhe disa shpifarakë të tjerë. Dhe nuk ishte "enverizmi" i Kadriut shkak që Sabri Novosella të pengonte bashkimin e organizatave, (meqë Jusufi ishte "enverist" tepër më fanatik sesa Kadriu), por ishin qëllime të tjera hileqare, të cilave sikur ka zënë t'u vijë era, sepse, po ky Sabri, që nuk pranonte "marksizmin" e Kadri Zekës, një muaj pas vrasjeve bëri krushqi me një "parti komuniste", që drejtohej nga një ish-oficer i UDB-së dhe firmosi bashkimin që ua kishte mohuar të tjerëve.

Në dasmë patëm një si shamatë mes nesh, ama ishte produktive, meqë shumë shpifje u sqaruan. Ajo e bëri Jusufin të ndërgjegjësohej, të ishte më i qartë për të na ftuar në aktivitetin e 16 janarit, meqë tashmë ishte sqaruar se cilët ishin ata që po pengonin bashkimin. Kritere ideopolitike Jusufi nuk kishte paraqitur ndonjëherë, meqë edhe nuk i njihte në atë nivel sa për të këmbëngulur në të tijën. Të vetmin kriter tepër fanatik kishte idhujtarinë për Enver Hoxhën, por më shumë si udhëheqës i kombit, sesa si ideolog komunist. Kurse Kadriu dinte të këmbëngulte për parimet ideopolitike, sipas modelit leninist. Që të dy dëshironin të organizoheshim sipas modelit shqiptar gjatë Luftës se Dytë Botërore, organizatë/lëvizje/front të masave, që do të udhëhiqej nga pararoja komuniste.

(B.I.:) - Ju, Ibrahim, atëherë drejtonit organizatën Fronti i Kuq Popullor. Duken dy ndikime të kohës në emërtimin e organizatës dhe të dyja janë ndikime politike, qoftë nga shteti amë, ku dikur kishte qenë Fronti Nacionalçlirimtar, por edhe nga lëvizjet e ndryshme të asaj kohe në Perëndim. Mund të jetë rastësi, nuk e përjashtoj. Botonit edhe gazetën "Bashkimi", shpeshherë edhe me Jusuf Gërvallën. Gazeta "Bashkimi" shkonte edhe në Kosovë, fshehtas.

Si ju lindi ideja e krijimit të organizatës, si e gjenit njëritjetrin, ju që kishit vendosur të krijonit një lëvizje ilegale, sigurisht të dënueshme nga shteti prej të cilit kishit ardhur? Fakti është se do të kishte dënime të rënda, burgime të gjata. Pra ishte diçka me rrezik. Njerëzit do të hiqnin dorë nga shumë gjëra, qoftë edhe nga diçka e thjeshtë: udhëtimi në vendlindje.

Konkretisht, si i gjetët ju njerëzit me të cilët donit të krijonit një sistem në dobi të idesë së shtetit të lirë të Kosovës?

(I.K.:) - Me thënë të drejtën, për mënyrën e themelimit

të Frontit të Kuq Popullor flas fare pa dëshirë. Krijimi i tij nuk ishte një lindje e rregullt, por një lindje fatkeqe, nëse mund të shprehem kështu.

Se duhej ta avanconim angazhimin patriotik drejt angazhimit të organizuar, për këtë isha bindur nga literatura që kisha lexuar dhe nga bisedimet me aktivistë gjermanë ose të lëvizjeve çlirimtare të shteteve të tjera, që ishin për studime në Gjermani, si të strehuar politikë. Në ato vite ishte e organizuar deri në ekstremizëm lëvizja studentore gjermane, anëtar i kryesisë të së cilës isha në universitetin ku studioja. Por, konkretizimi i Frontit të Kuq ishte fatkeq dhe këtë e kam thënë që në krye të herës e jo vetëm sot.

Tani, më konkretisht. Në tetor të vitit 1977 më rastisi të njihem me Besim Rexhën nga Gjakova, një gjysmanalfabet, goxha skizofren. Ai e kishte shoqëruar një mikun tim kroat, Vinko Knezeviç, arkitekt me profesion, i arratisur nga Kroacia në vitin 1971, i cili vinte në Universitetin e Bohumit për të mësuar gjuhën shqipe tek albanologu Lazar Dodiq. Në atë ligjëratë Besimi nuk la të zhvillohej leksioni normal, meqë donte ta bindte Dr. Dodiçin se Enver Hoxha ishte klasik i marksizëmleninizmit dhe se sistemi komunist në Shqipëri ishte i realizuar sipas klasikëve përkatës. Pas ligjëratës Vinkoja më mori me vete në Vupertal, që të kisha rastin të njihja më konkretisht proletarin e tij idealist, Besim Rexhën. Atë e kishte mahnitur aq shumë ky farë Besimi, i cili ishte shpërdorues i madh i sloganeve komuniste. I recitonte si besimtari lutjet myslimane në arabisht, pa ditur fare gjuhën arabe. Kështu Besimi e kishte detyruar arkitektin Vinko të qethej e të vishej si komunist. Me thënë të drejtën, në takimin e parë edhe mua më mahniti. Pastaj Besimi më bindi se duhej të shkonim në fundjavë në një

aktivitet të Partisë Komuniste Gjermane në Dortmund, ku do të takonim një komunist tjetër të devotshëm, me pseudonim "Xhaviti", me emër e biemër konkret Xhevat Ramabaja. Dhe ashtu ndodhi. U takuam. Që të dy ma mbushën mendjen, për të mos thënë ma rritën, se do të formonim një organizatë revolucionare tejet të suksesshme.

Pas dy javësh lamë takimin në konviktin ku unë banoja. Kërkova dy javë afat për të përgatitur një projekt-program dhe projektstatut. Ndërkohë iu luta një profesori gjerman (J.L.) të më ndihmonte në përpilim të tyre, meqë ai shquhej si njohës i teorisë se revolucioneve dhe luftërave guerile.

Në takim thirra edhe Idriz Bajrën, patriot i përkushtuar, emigrant ekonomik nga Istogu. Në atë tubim debatuam rreth emrit dhe doli fitimtar propozimi i Xhevat Ramabajes: Fronti i Kuq. E filluam me vrull veprimtarinë. Në disa takime të para, të përjavshme, sikur garonim, kush dinte më shumë slogane komuniste, kush e njihte më mirë teorinë e revolucionit, etj.

Ndërkohë, që të dy, Besimi dhe Xhevati, fituan besimin të më tregonin ku jetonin, përndryshe shtireshin si tepër konspirativë. Më merrnin mysafir për të më mbajtur ligjërata teorike për maksizëm-leninizmin. Për Besimin menjëherë u binda se ishte"komunist" skizofren. Qysh në derën e hyrjes në shtëpi, në zile kishte vendos emrin '"Taras" (pseudonim i Enver Hoxhës gjatë lufte). Në banesën e tij kishte improvizuar një "zyrë", me mobilie tepër të mëdha e të shtrenjta. Në derën e dhomës kishte shkruar me germa të madha "BYRO", kurse muret i kishte mbuluar me foto të klasikëve dhe me slogane komuniste. Ulej në një tavolinë të madhe pune dhe pozonte si të ishte përgatitur që të bëhej udhëheqësi i partisë. Ai po bashkëjetonte me një grua polake, edhe pse në Gjakovë thoshte se kishte grua dhe

fëmijë. Polakja e shkretë zuri të ankohej se si ia kishte thyer kryqin, si e terrorizonte për të mësuar slogane komuniste, etj.

Zotëri Xhevat Ramabaja po bashkëjetonte me një gjermane. Por ai më nxiti dyshimin, meqë nuk tregonte ku e çfarë punonte, nga i kishte të ardhurat për ato angazhime, meqë ishte avancuar edhe në udhëheqjen e Partisë Komuniste Gjermane, ku kuotizacioni ishte i lartë. Sakaq u pendova për themelimin e Frontit me këta dy tipa. Në anën tjetër, shumë bashkatdhetarë kishin shprehur dëshirën për t'u anëtarësuar. Meqë po i druhesha rrezikimit të tyre me plotësimin e formularëve për anëtarësim, siç këmbëngulnin dy komunistët "parimorë", u përcaktova për veprimtari pa anëtarësime. Kështu zuri fill konflikti me dy "parimorët" dhe m'u krijuan vështirësitë se si duhej t'i mashtroja me forma të reja të organizimit "popullor", për të minimizuar rrezikimin konkret dhe ngadalë-ngadalë të anashkaloheshin që të dy, pa e hetuar ata.

Shkurt e shqip krijova dyshimin se Xhevati ishte i dërguar i UDB-së dhe, në bashkëpunim me sigurimin gjerman, e kishin infiltruar si spiun te Partia Komuniste Gjermane, kurse Besimi ishte një skizofren "komunist". Mu për këtë, vazhdimisht kam ndier vështirësi, sa herë kam informuar për themelimin e Frontit të Kuq, të cilit, më vonë, "vjedhurazi", i shtova edhe karakterizimin "Popullor".

Herë pas here filluam të shtypnim trakte edhe në gjermanisht, por edhe broshura udhëzuese për mënyrat e angazhimit revolucionar në gjuhën shqipe. Më i shpërndari qe pamfleti me titull: "Rron or rron dhe nuk vdes kurrë shqiptari", botuar me rastin e 100-vjetorit të themelimit të Lidhjes së Prizrenit, në qershor të vitit 1978.

Emri i Frontit u afirmua shumë shpejt dhe rrethi i ithtarëve

të tij u rrit, jo vetëm në Gjermani, por edhe në Zvicër e Belgjikë. Morëm guximin të fillojmë edhe me "organ", të cilin e emërtuam "Bashkimi". Ishte rasti i parë që emigrantët tanë kishin në duar një gazetë modeste, prandaj dhe ishin tejet entuziastë. Për cilësinë nuk isha i kënaqur, por nuk dinim më mirë. Edhe si të tillë, shumë ekzemplarë të "Bashkimit" i fusnim fshehurazi dhe i shpërndanim në Kosovë dhe në Maqedoni.

Ardhjen e Jusufit e mirëpritëm si ndihmë të madhe, të bindur se do të angazhohej për të rritur cilësinë e "Bashkimit", siç edhe ndodhi.

Për futjen e "Bashkimit" në Kosovë entuziazmi i nxiti bashkatdhetarët të bëheshin novatorë në gjetjen e metodave për të mos u zbuluar. Ta zëmë, Hysen Gega grumbullonte televizorë të vjetruar, që i hidhnin gjermanët, u thyente ekranin, ua ngjyroste xhamin që të dukeshin si origjinalë dhe fuste brenda gazeta, aq sa e kishte paraprakisht peshën televizori. Kështu i bartte gazetat brenda. Hysri Reka, nga më intelektualët në rrethin e Dyzeldorfit, teknik dhëmbësh, nxiti idenë për të angazhuar emigrantë grekë e turq, meqë ata, si transit nëpër Jugosllavi, nuk kontrolloheshin rigorozisht. Kështu, ta zëmë, gjeta një profesor gjerman, që kishte të shoqen greke dhe shkonin për pushim në Greqi. Nëse nuk gabohem, ai mori 3 mijë gazeta dhe i dërgoj deri në Nerodime të Ferizajt, te Familja Rekaj. Malush Ademaj nga Katuni i Ri i Pejës, një natë vere në shëtitore (Korzo) shpërndau 300 ekzemplarë. U dha 50 DM romëve që lustronin këpucë për t'ua shpërndarë qytetarëve dhe vetë u largua për t'i vështruar në distancë, nëse do t'i shpërndanin. Sakaq shëtitorja në Pejë u zbraz, ngaqë çdo qytetar që merrte gazetën, ikte në shtëpi.

Aksion tepër i sukseshëm ishte edhe futja e mijerëa etiketa-

ve vetëngjitëse, në emër të Frontit, të cilat në Kosovëi i bartën dhe i shpërndanë Hysen Gega dhe Maksut Saramati, të ndihmuar nga veprimtarë klandestinë në Kosovë.

Thënë shkurt, kishim vullnet e gatishmëri për sakrifica, por nuk kishim dije e financa.

(B.I.:) - Nuk ju kuptova, cila ishte forma e organizimit dhe e veprimtarisë së Frontit pas themelimit, më konkretisht, pasi vendosët të anashkalonit Besimin e Xhevatin?

(I.K.:) - Në muajt e parë pas themelimit të Frontit, ne të katër themeluesit takoheshim pothuajse çdo javë. Këto takime i kalonim duke bërë vetëlavdërime dhe garë, cili njihte më mirë teorinë e komunizmit dhe të revolucionit proletar. Në të vërtetë nuk e njihte asnjë nga ne, meqë nuk kishim studiuar literaturë përkatëse, pos ca doracakëve dhe disa vëllimeve të veprave të Enver Hoxhës. Herë pas herë unë përgatitja ndonjë gjë me shkrim dhe ua lexoja, sepse më caktonin për detyrë t'u lexoja gjatë javës dhe t'i ndihmoja, si klasë punëtore që paraqiteshin, që të aftësoheshin edhe më shumë teorikisht.

Çdo herë i riktheheshim tematikës se përse nuk po anëtarësonim të tjerë, meqë edhe formularët përkatës i kishim përgatitur. Secili pyeste tjetrin, përse nuk kishte përvetësuar asnjë komunist për anëtarësim dhe për kuotizacion, siç e quanim pagesën mujore të anëtarësisë. Që të tre justifikoheshim se ishim të zënë me punë, se nuk po hasnim në proletarë të devotshëm, kurse Besimi dhe Xhevati prisnin që unë të anëtarësoja, meqë kisha më shumë kohë të lirë dhe njihja më shumë bashkatdhetarë. Kurse unë po i druhesha anëtarësimit se dyshoja mos Xhevati i përcillte formularët e anëtarësimit te shërbimet jugosllave dhe gjermane. Pastaj, ku do ta ruanim dokumentacionin? Nuk kisha siguri se do të na shpëtonte pa na u zbuluar e konfiskuar.

Për të mos e zgjatur me arsyetime, vendosa t'i anashkaloj Besimin e Xhevatin dhe të angazhohem me bashkatdhetarët në Dyzeldorf dhe rrethina, ku në mars të vitit 1978 kishim themeluar Klubin "Emin Duraku". Atje krijuam një rreth të ngushtë, me dhjetëra veta, të përcaktuar që të zhvillojmë veprimtari të organizuar në kuadër të Frontit, por pa plotësuar formularë. Edhe në Bruksel, në Nyrnberg, Shtutgart, në Cyrih etj., po krijonim këso rrethesh, meqë numri i bashkëveprimtarëve po shtohej shpejt. Entuziazmi po përzinte frikën. Ne të Frontit takoheshim çdo fundjavë, tashmë pa praninë e Xhevatit dhe të Besimit, dhe jo në lokalet e klubit, sepse atje mund të dekonspiroheshim, por në banesa, të cilat ndonjëherë i quanim baza. Në këto takime planifikonim si duhet ta menaxhonim klubin, çfarë shkrimesh të gazetave duhej të përzgjidhnim për t'ua lexuar punëtorëve në klub. Kur përzgjidhnim ndonjë shkrim nga shtypi i Tiranës, e paraqitnim si shkrim të gazetës prishtinase "Rilindja", sepse ajo gazetë na dërgohej falas nga Prishtina në adresë të klubit.

Bazat e para për takime i kishim në banesat e veprimtarëve të Frontit - Samedin Iljazi, Hisri Selimi, Imerja Qamili nga Tetova, Nebi e Hisri Reka, Nazmi, Mursel e Sylë Nuha, Haxhi Bega, Qamil Rexhepi, të gjithë këta nga rrethina e Ferizajt, Safet Azizi nga Davidovci i Shtimes dhe të disa bashkatdhetarë të tjerë. Në Bruksel nuk kishim nevojë të ishim konspirativë, sepse ishin angazhuar kryesisht bashkatdhetarë që kishin shtetësi turke ose që ishin refugjatë të arratisur pas Luftës së Dytë Botërore. Atje, si kryeplak, kishim caktuar Hysen Xhelilin (Kalishtë e Gostivarit). Në Nyrnberg takimet i mbanim në banesën e Qemajl Bajramit nga Reka e Epërme (Dibër); në Mynhen te Maksut Saramati (Zhur i Prizrenit); në Vupertal te Sylejman Haxhijaj (Llabjan i Pejës), Malush Ademaj (Katun i

Ri, Pejë); në rrethina të Shtutgartit te Hysen Gega (Sallagrazhdë, Suharekë), Nami Ramadani (Tetovë), Fahredin Tafallari (Zhur); në Berlin te Bajram e Rifat Mulaj (Istog); në Këln te Jahir Preka (Gllogovc); në Lëverkuzen te Latif Prevetica (Podujevë) e Shukri Xhelili (Tetovë); në Bon me rrethina te Isa Elshani (Krajkovë, Gllogovc), Imer Duka (Deçan); në Hamburg te Jahir Prekaj, Muhamet Elshani (Pejë), Jahir Baftiari e Lazim Lazami (Tetovë); në Cyrih te Rexhep Halimi (Firajë e Shterpcës), në Rrethina te Bernit te Hasan Kadria (Preshevë); në Gjenevë te Shyqri Ukshini (Gjilan), etj.

Pra, gjatë vitit 1979 numri i bashkëveprimtarëve u rrit shumë, gjithashtu edhe rrjeti u zgjerua, sepse secili angazhonte bashkatdhetarë në rrethin e tij dhe të njohur të hershëm që i kishin në qytete të ndryshme. Por, për numër të saktë nuk dinim, meqë, siç shpjegova, nuk mbanim evidencë konkrete të anëtarësimit, as në rrethe, as në qendër.

Dita e 17 Janarit

(B.I.:) - Tani le të vijmë te dita e 17 janarit. Më thatë se keni udhëtuar së bashku me Kadri Zekën dhe një mikun tuaj drejt banesës së Jusuf Gërvallës. Edhe më parë është ditur një gjë e tillë, pasi ka pasur disa intervista. Kjo të çon te njëra nga ditët më të diskutuara. Më ka tërhequr gjithnjë ideja se për çfarë keni diskutuar asaj dite? Cili ishte qëllimi i vajtjes suaj? Nëse për ju, dita e 17 janarit është njëkohësisht edhe dita e themelimit të Lëvizjes, kjo do të thotë se asaj dite është vendosur për shumëçka. Pra, meqë ishit bashkë, përse keni biseduar?

(I.K.:) **-** Sa për saktësim, ju thashë se na kishte ftuar Jusufi dhe si pikë takimi kishim banesën e Murat Kryeziut, në Bern-

hausen, qytezë afër aeroportit të Shtutgartit. Aty kemi qëndruar deri pas mesnate. Prej aty Jusufi na ka marrë në shtëpinë e tij.

Nata ka qenë e mbingarkuar nga mjegulla, ngrica dhe reshje bore, kështu që na është dashur të udhëtojmë ndoshta mbi dy orë, edhe pse nuk duhet të kemi qenë larg rreth 60 km.

Në shtëpi të Jusufit e Bardhoshit, vetëkuptohet, në shtëpi të zënë me qira prej tyre, sepse shtëpi të veten nuk kishin, duhet të kemi arritur rreth orës 03.00.

Pjesën me të madhe të qëndrimit në banesën e Muratit, që kishte dhomën e ndenjjes tejet të madhe, e kaluam duke parë drama televizive e filma, ndoshta 2 ose tre. Shkak për t'i dhënë fund asaj ndeje, pothuajse brutalisht, me sa mbaj mend, ishte biseda, në dukje inatçore, dhe ca pyetje tejet tekanjoze e provokuese të Nuhi Sulejmanit, drejtuar Kadriut. Ai ishte llafazan i madh dhe i jepte të drejtë vetes të fliste i pari, duke shpërdoruar epërsinë e moshës. Jusufi e ndërpreu atë dhe propozoi, për të mos thënë urdhëroi, të shpërndahemi.

Kur dolëm jashtë nata ishte tepër e ftohtë, me mjegull të dendur, ngrica dhe flluska borë. Me atë rast Jusufi na caktoi që Kadriu, unë dhe Syla të shkonim në Untergrupenbah (Untergruppenbach) ku jetonte familja Gërvalla. Rrugëtimin e bëmë me dy makina.

Derën e shtëpisë e hapi Jusufi, meqë Bardhi po merrej me parkim të makinave. Ai e hapi prajshëm, për të mos zgjuar njëri. Edhe ne hymë me qetësi kulmore.

Sapo hymë, në dhomën e ndenjjes pashë të ulur një njeri, i cili ishte i mbështetur në kauç dhe po flinte. M'u duk paksa e pazakontë. Sapo e pa edhe Jusufi bëri me shenjë të ngjiteshim lart, por ai u zgjua prandaj u detyruam të rrinim poshtë, në dhomën e ndenjjes.

Nga prezantimi që i bëri Jusufi rezultoi se ishte një njeri nga Bllaca e Suharekës. Ndërsa unë krijova dyshim ndaj atij njeriu, meqë as Jusufi nuk e njihte prej një kohe të gjatë. Mund ta kishte takuar vetëm një herë, kur e kishte shoqëruar Bardhin për ta vizituar atë në kamp të refugjatëve. Ai thoshte se ishte arratisur para pak kohe dhe rrëfente ca aventura të përjetuara, të cilat nuk ma mbushnin mendjen se i kishte të vërteta.

Për raste të tilla, kur shfaqej ndonjë problem me refugjatët, mbikëqyrësit e kampeve të asaj rrethine i telefononin Bardhit, meqë ai ishte i angazhuar si punëtor social në Ludvigsburg, enkas për t'u përkujdes për emigrantët që vinin nga Jugosllavia, fillimisht për emigrantët ekonomikë, tashmë edhe për ndonjë rast të rrallë të të arratisurve azilkërkues. Për këtë shërbim Bardhi paguhej nga organizata joqeveritare *Arbeiterwohlfahrt*. Mysafiri i paftuar, si i zënë në faj, rrëfeu "hallin" e tij, pse gjendej aty. Tha se ishte frikësuar të kalonte natën në kampin e refugjatëve, sepse kishte hetuar ta përcillnin e ta provokonin gjatë netëve të fundit, se kishte ardhur për të kërkuar t'i jepej revole për vetëmbrojtje. Këto ankesa ai ia kishte shfaqur edhe më herët Bardhit. Pasi mbaroi, Jusufi i propozoi të shkonte lart për të fjetur, njëherësh i propozoi edhe Sylës, me shpjegimin se kishte ngarë makinën gjatë dhe ishte lodhur. Bardhi u mor me sistemimin e tyre.

Sapo i rehatoi mysafirët, Bardhi, edhe pse shërbeu pije të bollshme, pyeti nëse kishim nevojë për ndonjë gjë tjetër, kërkoi falje dhe shkoi për të fjetur.

Ndoshta rrethanat e momentit imponuan bisedën për rastin e atij njeriu. Gjatë rrjedhës se bisedës, Kadriu kritikoi Jusufin dhe kritika të tilla i kishte bërë edhe më herët, se shtëpia e tij nuk duhej të kthehej në strehimore të rasteve të tilla, pasi, siç

thoshte ai, Jusufi po e tepronte me bujarinë tradicionale dhe shtëpinë e tyre po e frekuentonin shumë njerëz, të cilët, pos rritjes se probabilitetit të rrezikimit, pengojnë edhe në punë. Bisedat pasuese edhe mund të vetëkuptohen, se kujdesi dhe vigjilenca duhet të jenë në maksimum, sepse vrasjet e cilido veprimtar dëmtojnë veprimtarinë, etj. Mua ky virtyt apo ves i veprimtarëve të OMLK-së, - varësisht nga këndvështrimi, - më kishin nervozuar edhe më parë, prandaj edhe me këtë rast kritikat dhe këshillat e Kadriut zunë të më bezdisnin. Nuk durova edhe unë pa thënë ca fjalë rreth kujdesit, vigjilencës, konspiracionit, se nuk kishim nevojë t'i shndërronim në obsesion vigjilencën dhe kujdesin, duke arsyetuar se UDB-ja i kishte mundësitë të vriste cilin të donte, kur të donte e kudo që të donte, qoftë edhe përmes vrasësve mercenarë. UDB-ja nuk e gjykon të nevojshme të na vrasë deri sa të jemi të ndarë. Do të na rritet vlera nëse do të bashkohemi dhe vetëm atëherë UDB-së mund t'i mbushet mendja të ndërmarrë vrasjet.

Thënë, ndoshta naivisht, unë ndihesha më i çliruar për të nxitur biseda, sepse kohëve të fundit, sidomos në dasmën e Kadriut e Saimës, ushtroja rolin nga pozita e neutralit, ndërmjetësuesit, në mes të Jusufit dhe Kadriut. Kjo edhe për faktin se kishim deklaruar se Fronti i Kuq Popullor e kishte ngrirë aktivitetin e tij dhe po pret bashkimin. Ne ishim dakord të shkriheshim e të bashkoheshim, por jo të bëheshim thjesht pjesë e një organizmi tjetër politik, ende pa u bërë bashkimi.

Pastaj i dhashë të drejtë vetes të informoja Jusufin për bisedat që kishim pasur dy ditët e fundit me bashkatdhetarë në Duzeldorf e rrethina, - se ju ka folur kryesisht shoku Zeqë - (meqë emrin e vërtetë, Kadri, nuk ia dija), se çdo bashkatdhetar po pret të ndodhë bashkimi konkret, madje po kushtëzojnë angaz-

himin e tyre me bashkim, përndryshe do të pasivizohen, se u kishim premtuar që bashkimi do të ndodhte shumë shpejt, etj.

Jusufi sikur e mirëpriti këtë rast për të dhënë sqarime se pikërisht për këtë çështje na kishte ftuar, "madje ju kam dërguar me postë letra rekomande para dy ditësh dhe, me mendimin se mund të mos i keni marrë letrat, edhe ju kam telefonuar". Në vazhdim, ai foli gjerësisht, duke i quajtur keqkuptimet si të kapërcyera qysh me bisedat që kishim në dasmë, prandaj e kishte menduar që të rrinim bashkë në sy të veprimtarëve të kësaj ane, duke e përmbyllur bisedën se kishte vendosur t'i thoshte **PO** bashkimit, një çast e më parë. Në këtë frymë foli edhe Kadriu, duke i thënë **PO** bashkimit.

Sapo përfundoi Kadriu, Jusufi u ngrit në këmbë dhe i zgjati dorën Kadriut: **"Atëherë për hair na qoftë bashkimi,"** duke u përqafur mes tyre tepër shoqërisht. Pastaj më përqafuan edhe mua për **bashkimin** e sapomiratuar.

Sapo u ulëm, Jusufi tha se për modalitetet do të bisedojmë pasi të kemi bërë një sy gjumë, me shpjegimin se ishim të lodhur nga udhëtimi dhe se tashmë po agonte mëngjesi, pastaj foli se tashmë nuk e kemi të vështirë të konkretizojmë dokumentet përkatëse, meqë qysh në gusht veç ishim marrë vesh. Me atë rast Jusufi shfaqi një lutje konkrete që, në vend të emërtimit Front, të përdorim emërtimin **Lëvizje**, me arsyetim se emërtimi lëvizje është më shqip, më gjithëpërfshirës dhe se të jep më shumë emocione. Këtë propozim të tij e miratuam pa kurrfarë hezitimi e diskutimi. Natyrshëm u dakortuam që organizatën ta emërtonim: **Lëvizja për Republikën e Kosovës.**

Meqë kishte kaluar ora 5 e mëngjesit, Jusufi propozoi të pushonim, me arsyetimin se, pasi të kemi pushuar ca, do t'i saktësojmë e t'i protokollojmë anët formale të bashkimit të

sapomiratuar. Ramë dakord dhe u sistemuam për të fjetur.

U zgjuam rreth orës 11.00 dhe u ulëm rreth tavolinës që ishte përgatitur mrekullisht e bujarisht për të ngrënë. Pasi mbaruam, shkuam të tre lart. Ramë dakord që Jusufi e Kadriu të merreshin me anët konkrete të bashkimit, kurse unë zbrita poshtë, meqë që të tre ishim të mendimit se nuk kishte kuptim t'i linim mysafirët të pashoqëruar derisa Bardhi ende nuk ishte zgjuar.

Herë pas here i vizitoja Jusufin e Kadriun lart. Ata po merreshin intensivisht me ripunimin e "Tezave të Frontit", duke i përshtatur për programin e **Lëvizjes për Republikën e Kosovës**. Edhe me këtë rast ishim të një mendjeje të hiqej nga programi pjesa që kishte të bënte me pararojën komuniste, derisa të krijoheshin rrethana e kushte të reja që do të favorizonin krijimin e partisë komuniste, si pararojë e Lëvizjes, kurse për fillim do të mjaftonte përcaktimi në program e statut se në Lëvizje mund të anëtarësohen e të angazhohen të gjithë shqiptarët, pavarësisht bindjeve të tyre ideologjike, besimeve fetare, përkatësive gjinore e krahinore, etj., mjafton të ishin për statusin - Republikë për Kosovën.

Jusufi e Kadriu ishin nën presionin e kohës, sepse Kadriu duhej të udhëtonte për në Sant Gallen të Zvicrës dhe në mëngjes duhej të ishte në punë.

Rreth orës 15.00 ishim të gjithë poshtë. Pimë kafet e lamtumirës, meqë Jusufi tha se unë duhej të udhëtoja patjetër me Sylën, për të arritur në kohë në Klubin "Emin Duraku" në Dyzeldorf, ngaqë atje do të na prisnin bashkatdhetarët e paralajmëruar për të parë dramën televizive "Gërsheta lufte". Ai arsyetoi se unë do t'i nënshkruaja dokumentet më pas, kurse unë me të qeshur u thashë se ato që do t'i nënshkruanin ata, unë vetëm do të vija gishtin, prandaj nuk kishin pse merakoseshin

për nënshkrimin tim aty për aty. U nisëm për udhë me Sylën diku rreth orës 15.30.

Për habinë time, mysafiri i paftuar po vazhdonte të qëndronte aty, pa e kuptuar se ishte i tepërt. Vazhdonte të qëndronte me arsyetimin se ishte i frikësuar. Për këtë njeri pastaj informova SOKO-n (Sonder Komission, si e quanin gjermanët komisionin e veçantë, të formuar nga policia kriminalistike dhe hetimore rajonale e republikane e të tjerë pjesëmarrës). Më informuan se ndaj tij nuk po zhvilloheshin hetime, meqë ai nga shtëpia e Gërvallajve ishte larguar rreth orës 19.00. E kishte çuar me makinë Bardhi dhe gjatë kohës së tragjedisë kishte qenë në kamp. Këto shpjegime të tyre i pata kundërshtuar ngaqë ai nuk më dukej fatkeq i rastësishëm, se nuk kishte konstrukt e paraqitje fizike për të qenë i tillë, se kishte shkuar për t'u informuar nëse Jusufi dhe Bardhoshi mbanin armë, nëse dinin t'i përdornin, etj. Por, kaq mund të thosha para SOKO-s, kur kisha dyshimin se edhe shteti gjerman ishte bashkëpjesëmarrës (qoftë edhe i heshtur) në krim, në kuadër të marrëveshjeve dhe marrëdhënieve përkatëse ndërshtetërore me Jugosllavinë. Qeveria gjermane po i kërkonte Beogradit një pjesëtar të RAF-it (Fraksionit të Ushtrisë se Kuqe), për të cilin supozohej se ishte strehuar në Jugosllavi. Së këndejmi më rezultonte punë pazaresh.

Më pas mësova se Kadriu nuk kishte udhëtuar në mbrëmje, meqë nuk kishin mundur t'i kompletonin të gjitha punët përkatëse. Për mosnisjen e Kadriut ishte e arsyeshme t'i telefonohej Saimes, por Gërvallajt nuk kishin telefon në shtëpi ndaj duhej të telefononin nga kabina publike, atje ku shkonte shpesh Jusufi dhe të tjerë pjesëtarë të familjes. Për në kabinë, siç u tha, qenë nisur rreth orës 22.15, kur edhe ranë në pritë të atentatorëve.

Atentati i kobshëm na e plagosi edhe bashkimin e miratuar. Dokumente për të dëshmuar atë që kishim vendosur nuk kisha, sepse ato i kishte konfiskuar policia gjatë bastisjeve. Shpresoj se ato e kanë kohën për të dalë në dritë, me shpresën se policia gjermane ia ka kthyer familjes Gërvalla gjithë arkivin dhe dokumentet më të freskëta, që duhet të kenë qenë mbi tavolinën e punës. Shpresoj po ashtu, që familja Gërvalla do t'ia dorëzojë komplet Arkivit Shtetëror të Kosovës të gjithë atë që mund të quhet tashmë **Arkivi i Jusufit**. Meqë nuk kisha dokumente, por edhe për shkak se pas vrasjeve u krijua një situatë e acaruar, unë nuk këmbëngula të imponoj bashkimin që kishim arritur, pos që kisha informuar vetëm pak veta. U përcaktova të bëj çfarë mund të bëhej. Më kryesorja ishte t'u iknim vrasjeve zinxhir, të inskenuara nga UDB-ja **pikërisht** për të penguar bashkimin. Ajo do të provokonte vrasje të njëpasnjëshme, në mënyrë që kështu të vriste gjithë lëvizjen patriotike në emigracion, të cilën e kishim aktivizuar.

(B.I.:) - Në njërën nga përgjigjet tuaja thatë se ju erdhi mirë për ftesën e dërguar nga Jusufi, edhe për shkak se disa kohë më parë kishte pasur një lloj ftohjeje mes jush. Cili ishte shkaku i asaj gjendjeje?

(I.K.:) **-** Gjatë gjithë asaj bashkëveprimtarie kemi pasur ftohje jo vetëm një herë e ndonjëherë. Madje kemi pasur edhe hidhërime serioze. Besoj se kjo vetëkuptohet se gjatë bashkëpunimit në organizime dinamike, që janë në proces të ndërtimit të identitetit të tyre politik, ndodhin përplasje e zënka. Vetëm në sekte të ngritura mbi dogma, nuk ndodhin, sepse ata që anëtarësohen e angazhohen në sekt, janë të përgatitur paraprakisht se duhet të zbatojnë vetëm udhëzime e urdhra. Keqkuptime, përplasje dhe hidhërime me Jusufin kemi pasur

disa herë, por sërish sqaroheshim e mirëkuptoheshim, sepse përparësi kishim veprimtarinë e përbashkët çlirimtare. Ato ndodhnin pikërisht se e kishim me pasion përkushtimin për bashkëveprimtari çlirimtare. Po të ishte për të bërë retushe unë fare lehtë do të mund ta pohoja të kundërtën

Në rastin konkret, fjalën e kisha për ftohjen në mes të Jusufit e Kadriut pas takimit që kishin pasur në tetor të vitit 1981 në Turqi, Kadri Zeka e Bardhosh Gërvalla me Sabri Novosellën. Ne e kishim miratuar bashkimin në gusht të vitit 1981, duke u bazuar në *Tezat e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës*, madje vetë Jusufi e kishte rishkruar variantin e miratuar, meqë kopja e tyre na erdhi nga Kosova e shtypur në një makinë të stërvjetër dhe me cilësi të dobët fotokopjimi. Jusufi ishte pedant deri në skajshmëri për t'i bërë gjërat të duken sa më të bukura. Do të thotë që gjuha dhe drejtshkrimi të ishin të përkryera, faqosja e dizajni, gjithashtu. Pra, vetë Jusufi i pati rishtypur, redaktuar, faqosur, duke u bazuar në ndryshimet kozmetike që u bënë gjatë bisedimeve për bashkim. Ato *Teza* i kishim shpërndarë anekënd Evropës Perëndimore, në një broshurë të formatit A5, por, për shkak të respektit të tij deri në idhull ndaj "udhëheqësit" Sabri Novosella, për mendim timin të atëhershëm dhe të tanishëm, tejet naiv, bashkimin duhej ta formalizonte "rrobaqepësi" (Sabriu).

Kjo pritje e Jusufit dhe jona rezultoi zhgënjyese. Sabriu kundërshtoi bashkimin. Për shkak të konsideratës ndaj "udhëheqësit", Jusufi, në vend që të fajësonte pikërisht udhëheqësin e tij (unë do të thosha komandantin shpërdorues të tij), u shtrëngua të fajësojë Kadriun. E Jusufi kishte një të metë njerëzore: sakaq bëhej idhnak, meqë ishte idealist dhe ende nuk ishte i përgatitur teorikisht dhe praktikisht për veprimtari të organizuar politike

dhe çlirimtare në atë shkallë që duhej e që do të ndodhte më pas.

Në të vërtetë, marrëdhëniet u ftohën dhe u acaruan vetëm ndërmjet Jusufit dhe Kadriut. Unë e kisha mirë me të dy, paçka se, pas tetorit, anoja më shumë ndaj angazhimeve dhe përcaktimeve të Kadriut. Jusufi nuk e kishte të vështirë ta hetonte këtë, por unë ruaja marrëdhënie të mira me të, me premtimin se nuk do të ndodhte kurrë ndonjë bashkim që do ta anashkalonte atë. Fakt është se figura si Jusufi dhe Bardhi qëndronin shumë më lart se organizata ku bënin pjesë. Dashje pa dashje, kjo krijonte dyzim të personalitetit, mes asaj që ata vetë mendonin e dëshironin dhe që, në këtë rast, ishte më e drejtë, dhe asaj që u vinte nga "qendra", e cila në të vërtetë nuk ishte kurrfarë qendre e aq më pak një qendër e denjë për të udhëhequr njerëz të vyer si Jusufi e Bardhi. E vërteta është se figura e Jusufit, do të thosha poliedrike dhe frymëzuese, do të ishte zanafilla e krijimit të simotrave të saj në Kosovë dhe, pikërisht ky njeri, do të ishte frymëzimi, të themi i krijimit të Komitetit të njohur të Deçanit dhe në asnjë rast jo "qendra", që nuk dihej as se ku ishte, por që shfaqej vetëm kur ishte fjala për të hedhur në erë natën, atë që ndërtohej ditën, pra atë që ndërtohej me mirësi e mirëkuptim, për ta shembur me fjalë dhe mjegull. "Qendra" s'ishte veçse pushteti fiktiv si në "Kështjellën" e Kafkës, me pasoja rrënuese për aktivitetin tonë. Pikërisht kjo paqartësi dhe diferencë mes Jusufit dhe "qendrës" do të shtrihej shkurtimisht mes tij dhe Kadri Zekës, për një periudhë prej disa javësh.

Tani, meqë jemi në distancë kohore prej 30 vjetësh, për organizatën ku ai militonte, s'kam si të mos e them se kisha krijuar dilema e dyshime goxha të skajshme. Qysh gjatë vitit 1980, meqë kisha angazhuar ta pyesnin, Metush Krasniqi më kishte informuar se nuk ishte ai kryetar i asaj lëvizjeje, prandaj

kisha dyshime se atë organizatë fantazmë e kishte sajuar dhe e "udhëhiqte" vetëm Sabri Novosella. Madje mendja e dyshimi më kishin ikur drejt pandehmës se Sabriun e kishte urdhëruar UDB-ja për atë manovrim, duke shpërdoruar edhe emrat e Metush Krasniqit dhe Adem Demaçit, si themelues, për të imponuar autoritetin dhe komplotet e tij. Edhe para se të më informonte Metush Krasniqi, unë kisha krijuar neveri ndaj Sabriut në bazë të informimit që kisha nga njerëzit në Turqi për bëmat e tij atje, që kur kishte kërkuar strehim politik. Pastaj, moskontaktimi i tij me Jusufin për gati një vit e gjysmë, kur Jusufi po priste udhëzime prej tij, ishte pothuajse argument i mjaftueshëm për të krijuar dyshimet e para. Në anën tjetër, për shkak të respektit dhe simpatisë që kisha për Jusufin, isha përcaktuar që ta çliroj Jusufin, me të gjitha mënyrat, nga tutela e Sabriut. Gjatë kësaj përpjekjeje shumë herë jemi keqkuptuar dhe hidhëruar.

Vetëm atëherë, pas kundërshtimit të bashkimit, Sabriu e urdhëroi Jusufin të intensifikonte anëtarësimin e bashkatdhetarëve në organizatën e tij. Në ato rrethana Jusufit po i qaseshin disa ish-bashkëveprimtarë, të cilët ne i kishim seleksionuar që me herët si të papërshtatshëm, si destruktivë, si të degjeneruar, madje edhe si të dyshimtë për kodoshë (siç u thonë shqiptarët në Maqedoni informatorëve e bashkëpunëtorëve të UDB-së). Ndër ta ishin Nuhi Sulejmani, Xhevat Ramabaja, Besim Rexha, Hafiz Gagica e ndonjë tjetër, për të mos sjellë më shumë emra të parëndësishëm. Në kuadër të këtij angazhimi Jusufi filloi të nxjerrë "Zërin e Kosovës", si organi i LNÇKVSHJ-së.

Në anën tjetër, edhe Kadriu këmbëngulte të bënim fakt të kryer themelimin e *Frontit Populllor për Republikën e Kosovës*, sipas *Tezave*, me arsyetim të logjikshëm se nuk ia vlente të

prisnim derisa t'i mbushej mendja Sabri Novosellës, skizofrenit e anadollakut në paraqitje, kurse unë e lusja të prisnim edhe ca. Pra, sinqerisht, më dhimbseshin Jusufi e Bardhoshi të mbeteshin nën tutelën e Sabriut.

Po vinte një kohë kur figura e Jusufit, nga e nevojshme, po bëhej e domosdoshme. Ne nuk donim në asnjë mënyrë që ngutja jonë të sillte dyzimin e një lëvizjeje atdhetare, e cila mund të priste edhe disa javë për të realizuar bashkimin, por nuk mund të duronte kurrsesi një ndarje ose një thellim të ri, që mund të ishte fatal për kohën dhe mundimshëm i ndreqshëm në vitet e ardhshme. Ishim të gatshëm më parë të duronim pasojat e pak javëve "hidhërim", sesa vuajtjet e disa viteve ndarje.

Kjo ftohje e tyre demoralizoi veprimtarët e lëvizjes patriotike, sepse, sado që përpiqeshim ta mbanim të mbyllur, kasnecët që shtireshin se i përkisnin "Lëvizjes së Jusufit" (siç po e quan me hile tani Xhafer Durmishi), Frontit ose OMLK-së, përhapnin dezinformata e demoralizim.

Fatmirësisht, më 2/3 janar 1982, u bë dasma e Kadriut dhe e Saimes dhe aty patëm fat të sqaroheshim dhe të mirëkuptoheshim. Prandaj na rezultoi takimi i 16 e 17 Janarit, që solli bashkimin. Fatkeqësisht, e pësuam me atentate politike nga UDB-ja ndaj autorëve kryesorë të bashkimit në **Lëvizjen për Republikën e Kosovës** - të Jusufit, Kadriut dhe Bardhoshit, që do të thotë se Lëvizja pati lindje të përgjakshme, gjegjësisht flijimet e mëdha në themelet e saj.

(B.I.:) - Për të bërë një organizatë duhet më shumë sesa dëshira e mirë e tre përfaqësuesve, sado të fuqishëm të jenë ata. Më duket sikur, duke u ngutur, i kaluam disa gjëra që, edhe nëse rithuhen, janë të dobishme. A është diskutuar para vendimit për një organizatë të përbashkët, për platformën e saj,

synimet, përcaktimet, anën organizative, statutin etj.?

(I.K.:) - Më duket se u përgjigja më herët, por nuk prish punë nëse e përsëris. Për organizatë të përbashkët është diskutuar me përkushtim gjatë verës së vitit 1981 dhe ishte miratuar platforma, por ja që bashkimi përkohësisht u bllokua nga Sabri Novosella në tetor të po atij viti. Më vjen keq, sidomos për Jusufin dhe për Kadriun, por edhe për vetën time, se ia lejuam vetes të tallet me ne ai farë "rrobaqepësi" anadollak. Sikur të mos e kishte pranuar Jusufi atë manipulim, zhvillimet mund t'i kishim më fatlume.

Ndoshta është vendi të them se unë nuk u druhem disa mitizuesve të shpifur të Jusufit, të them atë që ndiej, sepse e di se ka nga ata që po e mitizojnë dhe e madhërojnë për të fshehur keqbërjet e tyre...

(B.I.:) - Si do të veprohej më tej pas themelimit të organizatës? Si do të veprohej në Perëndim, në Kosovë dhe në marrëdhëniet me shtetin shqiptar? A ishte në dijeni ky i fundit se do të bëhej një bashkim i tillë dhe, nëse po, cili kishte qenë qëndrimi i tij?

(I.K.:) - Mund të them se tashmë kishim përvojë si do të organizoheshim e si do të vepronim në Perëndim, në Kosovë dhe në relacion me shtetin shqiptar. Edhe si tri organizata bashkëveprimtarinë e bënim sikur t'i përkitnim vetëm një organizate. Sigurisht, pas bashkimit, veprimtaria e organizuar do të ishte më e koordinuar dhe më e shtrirë. Mbase Sabri Novosella duhet ta ketë penguar bashkimin kryesisht për hir të përfitimit të tij financiar nga shteti shqiptar, i cili duhet t'i ketë dhënë para të shumta për veprimtari patriotike të organizatës së tij, por që, pos 10 mijë dollarëve, për të cilat di unë, ai nuk ka dhënë të tjera. E, po të ndodhte bashkimi, 'rrobaqepësi' nuk do të mund

t'i përvetësonte aq lehtësisht e paturpësisht ndihmat që i jepte shteti shqiptar dhe do të zbuloheshin ato që ia kishte dhënë.

Meqë Tirana i ka dhënë gjithë ato ndihma, atëherë rezulton se ajo paskësh qenë fare e painformuar, gjegjësisht mjeshtërisht e manipuluar. Bej thirrje që këto gjera të sqarohen derisa ka ende të gjallë atje që do të dëshmojnë.

Shteti shqiptar nuk ka qenë i informuar për takimin e 16/17 janarit 1982. Edhe po të donim ta informonim, nuk kishim asnjë mundësi, sepse, megjithëse ishim të përgatitur për këtë ngjarje, nuk e dinim me saktësi se kur do të ndodhte. Ishte thirrja e Jusufit ajo që i përshpejtoi ngjarjet. Pra, jam krejt i bindur se shteti shqiptar nuk ka qenë i informuar. Dhe, po të pyetesha unë, mirë që nuk ka qenë. Përse të informohej dhe të ngatërrohej shteti shqiptar, kur atë e përfaqësonin tipa si Bujar Hoxha dhe ndonjë "sigurims" që të nxitnin dyshime, madje shpesh edhe neveri.

Nga rrjedha e përshkruar rezulton se Jusufi duhet të na ketë ftuar vetëm për të thelluar mirëkuptimin që ndodhi në dasmën e Kadriut. Bashkimi doli natyrshëm, sepse marrëdhëniet dhe zhvillimet ishin mbarsur në atë nivel sa nuk kishte kush më ta pengonte bashkimin, pos me ndërhyrje kriminale fizike, siç edhe veproi UDB-ja.

Unë edhe përpara kam shprehur dyshimin se UDB-ja është informuar për qëndrimin në Bernhausen, në banesën e Murat Kryeziut. Dhe dyshimin e kisha drejtuar te Nuhi Sulejmani, duke u mbështetur në njohjet e mëhershme dhe në provokimin e tij që na bëri atë natë, për çka Jusufi urdhëroi të shpërndahemi. Pra, kam dyshuar se po ai Nuhi duhet të ketë paralajmëruar eprorët e tij se ne ishim bashkë, prandaj mund të ndodhte bashkimi, që nuk mund të pengohej më me shpifje, dezinformata e bllokime.

Në godinën karabina (parafabrikat), pranë vendit të ekzekutimit, prapa shtëpisë ku banonin Gërvallajt, policia ka mbledhur, me sa mbaj mend, 47 bishta cigaresh të konsumuara vetëm nga njëri prej vrasësve, në afat prej rreth 9 orë pritjeje. Analizat e atyre bishtave ruhen, mjafton të gjendet pirësi i tyre dhe ka për t'u gjetur, sepse tani po 'digjitalizohen' të gjithë qytetarët e Evropës. Emrin e personit të dyshuar nga unë, që duhet të ketë thithur ato cigare, ua kam dhënë hetuesve gjermanë në vitin 2007, meqë më patën ftuar të shkoj në Shtutgart, pasi e kishin zbërthyer romanin "Atentatet". Më herët kam informuar edhe organet kompetente të Kosovës. Druaj se shtetit gjerman nuk po i intereson të zbardhë vrasjen deri në fund, kurse organet e Kosovës, siç më është thënë, nuk janë kompetente, pos nëse organet gjermane do të kërkonin ndihmë.

Unë, gjithsesi, jam i interesuar të zbulohen ekzekutorët e UDB-së. Nuk jam tradicionalist romantik si Jusufi, për të thënë "nëse dorasit janë shqiptarë, mos u zbulofshin kurrë", as naiv, si ndonjë "bashkëpunëtor" i Jusufit që thonë se duke ua ngarkuar vrasjen dorasëve shqiptarë, shfajësohet UDB-ja.

(B.I.:) - Në 17 janar ndodhi vrasja e Jusufit, Bardhoshit, Kadriut. Ka pasur ndonjë sinjalizim të mëhershëm se mund të ndodhte diçka e tillë, sepse, nëse ju nuk do të kishit udhëtuar, sigurisht që edhe ju mund të ishit njëri nga të vrarët? Pra, nëse Kadriu ruhej vazhdimisht, nëse Jusufi kishte kërkuar ndërrim banese e më shumë siguri dhe nëse ndaj jush ishte synuar për të vepruar, kishte pasur sinjalizime të tilla dhe, nëse po, cili ishte qëndrimi juaj?

(I.K.:) - Që të sqarohemi para se të përgjigjem konkretisht, dua ta bëj të njohur se secili shqiptar e secila shqiptare në ish- Jugosllavi, kur ka pranuar të angazhohet në lëvizjen

klandestine çlirimtare, është pajtuar me fatin e tij: Angazhimi bart në vete edhe vrasjen, si dënimin më të rëndë, pos torturave më barbare. Megjithatë, idealistët e kanë ndarë mendjen dhe janë angazhuar. Frikacakët dhe dykëmbësorët rrojnë sa për të dëmtuar bukën që hanë.

Në rastin konkret është folur për shenja dhe sinjalizime, por ato duhet të jenë bërë në kuadër të përpjekjes për të na frikësuar që të heqim dorë nga veprimtaria çlirimtare. Mendoj kështu, sepse edhe UDB-së më shumë i ka ardhur për shtat frikësimi dhe pasivizimi i njerëzve, sesa vrasja e tyre. Vendimin për vrasje UDB-ja duhet ta ketë marrë atëherë kur ka konstatuar se njerëzit që kishte infiltruar pranë nesh, nuk ia dilnin dot ta sabotonin më tej bashkimin.

Sa për atë që thoni se po të kisha qëndruar unë aty mund të isha vrarë, janë supozime hipotetike që nuk na bëjnë mirë për të spekuluar. Ta zëmë se unë do të kisha qëndruar aty, mund të mos i kisha lënë të dilnin në atë kohë për të telefonuar, meqë, si "skandaloz" e i "padisiplinuar" që isha, do t'i kisha thënë Kadriut se burri nuk ka pse t'i frikësohet gruas e të dalë në rrethana aq të papërshtatshme kohore për t'i telefonuar vetëm që të arsyetohet për mosshkuarje, etj. Ama, meqë UDB-ja duhet ta ketë marrë vendimin, vrasja do të ndodhte, sepse ajo ka qenë e zonja t'i ekzekutonte vendimet e saja. Pra, do ta kishte ekzekutuar vendimin në vend e kohë tjetër.

Pra, siç thashë, supozime e hamendësime të këtilla hipotetike mund të bëjmë sa të duam, por nuk na hyjnë fare në punë.

Kur jemi këtu, po përgjigjem me sinqeritetin që tingëllon naiv, se shpesh i kam xhelozuar bashkëveprimtarët e vrarë, meqë më kanë terrorizuar aq shumë "bashkëpunëtorët" dhe "trashëgimtarët" e Jusufit, sa më shkonte mendja t'i vrisja ose

të vetëvritesha. Por, përcaktimi për t'i mundur të tillët, eprorët e tyre dhe pushtuesit, me patën bindur se hakmarrja më efektive është të realizoj veprën dhe idealet e tyre - Çlirimin e Kosovës! Mbase është momenti të them se për këtë përcaktim me ka ndihmuar tepër shumë drama e Bertolt Brecht-it, "Jeta e Galile Galileut", të cilën pothuajse të tërën e kisha mësuar përmendësh dhe e kisha përkthyer në shqip në vitin 1978, të njëjtën ia kisha dërguar Shtëpisë botues "Naim Frashri" ose "8 Nëntori" në Tiranë, për ta botuar. Në të shtjelloheshin jeta e Xhordano Bruno-s dhe e Galileut, por i pari, për të vërtetën e tij shkencore, se toka sillet rreth diellit, si dënim digjet në turrë të druve nga kleri katolik, kurse Galileu për të imponuar të njëjtën të vërtetë gjen metoda dhe shpëton pa u ndëshkuar. Në rastin konkret, gjykoja se më mirë ishte të hakmerresha duke realizuar me takt e përkushtim efektiv përcaktimet e shokëve të vrarë, se sa të hakmerresha fizikisht, ta zëmë duke vrarë Riza Salihun, të cilin e dyshoja për doras dhe vitet e pastajmë t'i kaloja në burg. Po të pëcaktohesha për hakmarrje, do i jepja "argument" UDB-së për luftën e saj speciale, se shqiptarët po vriten në mes tyre, për qërim hesapesh...

(B.I.:) - A i ka analizuar ndonjëherë organizata, sigurisht më pas, ngjarjet e 17 janarit, sepse ishte një ngjarje e rëndë, e dhembshme dhe me pasoja në lëvizjen ilegale? Cili ka qenë qëndrimi i saj për këtë ngjarje? Ka pasur ndonjë konkluzion të caktuar? Ka pasur ndonjë përcaktim se nga ku kanë rrjedhur informacionet, si ka rënë në gjurmët e tyre UDB-ja serbe e jugosllave?

(I.K.:) - Në dy-tre vitet e para janë bërë vetëm "analiza" folklorike. Unë tashmë pothuajse kisha dyshimin se krerët që bënë "bashkimin" më 17 shkurt e më 15 maj 1982, gjoja si të auto-

rizuar nga organizatat e tyre për t'i përfaqësuar, komandoheshin nga UDB-ja dhe ishin urdhëruar për të kapur udhëheqjen e Lëvizjes, që pastaj ta shpërdoronin për qëllime të tyre. Tashmë njihet si sekret publik se i kam emërtuar për komplotistë: Sabri Novosellën, Abdullah Prapashticën, Xhafër Shatrin e ndonjë "argat" të tyre. Meqë ishte kështu, unë përmbahesha t'u them atyre, se ne e kishim bërë bashkimin me 17 Janar 1982. Ç'është e vërteta, vetëm Xhafer Shatrin, duke mos ditur se ishte Xhafër Shatri, e pata informuar pas 15 majit, në kuadër të kritikave, se nuk e kishte përfaqësuar denjësisht OMLK-në dhe nuk është dashur ta "shkrinte" OMLK-në në sajesën e Sabri Novosellës e Abdullah Prapashticës. Në ato rrethana, unë isha i gëzuar që po më lejonin të jem pranë tyre. Dhe unë dhunoja veten që të merrja pjesë në strukturat që formonim, nëse për hiç tjetër, për të qenë i informuar për veprimtarinë e tyre, i bindur se shpejt do të ndërgjegjësoheshin individë të rinj, për t'i diskreditуar e skualifikuar ata.

Kur ia arritëm t'i demaskonim dhe izolonim komplotistët deri tek i fundit, në vitin 1985, atëherë nuk e quaja të nevojshme të merreshim me analizat e vrasjeve, meqë tashmë Lëvizja kishte marrë konturat që i kishim vendosur më 17 Janar 1982. Fundja, edhe po të merreshim, nuk do t'i ndriçonim vrasjet dhe nuk do t'i zbulonim vrasësit. Atëherë, por edhe tani, e quaja me pasoja po të merreshim me analiza në struktura udhëheqëse, sepse vazhdimisht kam qenë i mendimit se UDB-ja duhet të ketë individë të infiltruar e penetruar në Organizatën tonë. Kurse veprimtarët kryesorë, të devotshëm, i kam informuar dhe kemi biseduar.

Analiza e gjatë që kam bërë me veten time e me disa nga miqtë e mi më të afërt, jo vetëm gjatë ditëve të para pas

vrasjeve të 17 janarit, por edhe më vonë, më shtynë pashmangshëm të shkruaja romanin "Atentatet", që u bë në një kohë kur gjërat kishin filluar të ktheheshin përfundimisht për së mbari. Kur përfundoi detyra ime themelore: Çlirimi i Kosovës, që ishte edhe amaneti i shokëve të mi, erdhi koha të shfletoja të kaluarën, të qartësoja gjërat që i kisha mbajtur brenda dhe t'i thosha ato publikisht. Çdo gjë ka kohën e vet e çdo njeri bart mundimin e tij.

Sa jemi këtu të kujtoj faktin fatlumë se fillimin e diskreditimit e ndërmorën vetë "krerët", kundër njëri -tjetrit, për t'i imponuar Lëvizjes vetëm luftën e brendshme, që edhe kjo të katandisej si emigracioni më i vjetër politik.

Prej 30 vjetëve kam kërkuar përgjigje se kush vërtet i ka autorizuar këta komplotistë për të përfaqësuar organizatat përkatëse? Kush, si, kur dhe ku janë mbajtur mbledhje për t'i autorizuar të tillët? Më ka rezultuar se ata e kanë autorizuar veten e tyre. Këtu përpiqem t'u shmangem dyshimet e mia të skajshme se janë komanduar nga eprorët e tyre.

(B.I.:) - Jusufi nuk vdiq menjëherë. Ai vdiq nga plagët, më pas, në spital, ku ndodhej edhe një mjek serb, kirurg, i cili më vonë u zhduk nga rrethinat e Shtutgartit, ku edhe ndodhi ngjarja. Kjo është shkruar edhe në novelën e Kadaresë, ,,Balada e J.G." Si është e vërteta e kësaj ngjarjeje?

(I.K.:) - E kam lexuar "baladën" në fjalë. Uroj të mos jenë krijuar kështu baladat e tjera.

Kur e kam dëgjuar rrëfimin e zonjës Suzana Gërvalla lidhur me inkriminimin që ajo i bënte atij mjeku serb, kam biseduar gjerësisht me udhëheqësin e SOKO-së, të cilit i jam mirënjohës për shumë konsulta dhe për besimin që ka pasur ndaj meje. Ai më ka bindur se mjeku i dyshuar nga Suzana nuk është vrasësi

i dytë i Jusufit. Ai argumente se ia kanë studiuar në arkiv planifikimin e orarit të punës. Ishte i bindur se nuk kishte ndodhur asnjë montim i orarit për të qenë ai atë natë aty. Kam mirëkuptim për zonjën Gërvalla që ka bërë atë akuzë, sepse ajo ishte e shokuar dhe e traumatizuar, por nuk kam mirëkuptim për Kadarenë që e ka ndërtuar "baladën" duke u bazuar në rrëfimet e saj, në mos qoftë çështje e sendërgjisë krijuese letrare.

(B.I.:) *- Kjo është vrasja e parë politike, sidomos në këto përmasa, e militantëve ilegalë të shqiptarëve të Kosovës, në Perëndim. Përse u zgjodh ky moment nga UDB-ja dhe përse u përcaktuan kush duhej të vritej? Ky fakt bëhet edhe më i rëndë për dy arsye: së pari, sepse ishin të paktën dy nga drejtuesit e njohur, sidomos Kadri Zeka, si drejtues i OMLK-së, dhe Jusufi, si njëri nga drejtuesit e lëvizjes ilegale dhe, së dyti, sepse ishte pikërisht momenti kur po bëhej bashkimi i organizatave ilegale në një strukturë të vetme. Unë shpeshherë i kam përfytyruar ata pas dhënies së dorës së fundit të programit politik dhe tezave për bashkim, të lodhur e të lumtur, si njerëz që e kanë ndier mbi vete përgjegjësinë që po merrnin e, njëkohësisht, me ndjenjën se tashmë, ndërsa ishte kaluar e djeshmja, po niste një fillesë e re. Pastaj, ndoshta për të qindtën herë, kam pyetur veten: Përse? Si ndodhi vrasja pikërisht asaj nate, kur ende lajmi që pritej, nuk ishte bërë i njohur? Përse duhej të ndodhte përgjakja pikërisht në atë moment? Mos vallë kjo ka të bëjë me atë ndjekje fatale që i është bërë përherë kombit tonë, kur ndodhitë e mëdha jo rrallë janë ndjekur nga kobe të mëdha?*

(I.K.:) **-** Më bëhet se edhe kësaj pyetjeje iu përgjigja më sipër. E them edhe një herë pa u lodhur, pavarësisht se përgjigjet asnjëherë nuk mund të jepen qind për qind të njëjta.

Se përse u zgjodh ky moment, ne vetëm mund të supozojmë

në bazë të rrethanave dhe rrjedhave, sikundër nuk mund të thuhet me saktësi as se përse u përcaktuan se kush duhej të vritej.

Ju keni të drejtë. Është e vërtetë se ishin dy udhëheqës të lëvizjes çlirimtare të emigracionit të ri. Ishin udhëheqës të organizatave përkatëse në Evropën Perëndimore dhe ishte momenti i bashkimit të tri organizatave të atëhershme. E kam përsëritur shpeshherë se UDB-ja ishte shërbim i atij niveli, sa mund të vriste kë të donte, kur dhe ku të donte, por nuk ishte shërbim që vriste vetëm sa për të vrarë. Edhe UDB-ja vrasjen duhet ta ketë pasur si mjet të fundit, kur nuk ka mundur t'i përballojë me mjete e mënyra të tjera kundërshtarët politikë.

UDB-ja duhet të jetë informuar se tashmë Jusufi dhe Kadriu ishin sqaruar se kush e kishte zvarritur bashkimin dhe prandaj do të bëhej bashkimi. E, meqë natën e parafundit njerëzit e UDB-së nuk mundën t'i përçanin më, atëherë ajo duhet të ketë komanduar vrasësit për të kryer aktin e vrasjes, në momentin kur mund t'i pozicionone njerëzit e saj në krye të lëvizjes çlirimtare, për të vrarë kështu gjithë atë lëvizje. Ky duhet të ketë qenë koncepti UDBesk, sipas mendjes sime.

Ndonjë arsye që vrasjen ta ketë bërë ndonjë shqiptar i organizatave të tjera, për shkak të garës apo të armiqësisë, nuk ka pasur. Jusufi e Kadriu nuk ishin të armiqësuar me asnjë organizim të emigracionit shqiptar, ndërsa unë po, sidomos me krerët e Besëlidhjes Shqiptare dhe të Legalitetit, por jo në ato përmasa sa të qëroheshin hesapet vetëm me vrasje.

Parë në aspektin e ngushtë, vetëm Riza Salihu duhet të ketë pasur arsyet e tij për t'u hakmarrë, sepse në vitin 1980 ia zbuluam dhe penguam urdhrin që kishte dhënë për të vrarë Jusufin. Më pas e zhbëmë "grupin komunist" që kishte formuar dhe e komandonte. As këtë nuk e besoj, meqë unë kisha

mjaftueshëm prova për të besuar se ai ishte vetëm një argat i UDB-së dhe nuk kishte kompetenca të merrte vendime e të bënte ekzekutime me kokën e vet. Gjithsesi, e kam akuzuar për ekzekutor, të komanduar nga UDB-ja dhe vazhdoj ta akuzoj, përderisa ai nuk e provon të kundërtën. Të paktën duke ofruar alibi të pakontestueshme.

Pjesëtarët e organizimeve ekstremiste serbe në emigracion, do të thosha, nuk merren në konsideratë, sepse ata nuk duhet të kenë pasur fare informata e qasje në organizimet tona, pos nëse janë vënë në shërbim të UDB-së.

Ndonjëherë është spekuluar se këto atentate i ka bërë sigurimi shqiptar, por as kjo nuk duket e logjikshme. Po të kishin qenë armiq të shtetit shqiptar ose të pushtetit të atëhershëm, atëherë edhe mund të kishte hapësirë për akuza të tilla, ama Jusufi, Kadriu e Bardhoshi ishin ithtarët më të flaktë të pushtetit të atëhershëm.

(B.I.:) - Kush kishte dijeni për lëvizjet e fundit të Jusufit dhe, njëkohësisht, a kishte të tjerë që ishin në dijeni rreth projektit të bashkimit në një strukturë të vetme politike ilegale atdhetare?

(I.K.:) - Për lëvizjet e fundit të Jusufit, më konkretisht për udhëtimin e Jusufit bashkë me ne, nga Bernhauzeni në Untergrupenbah, kanë pasur dijeni rreth 17-20 veta, sepse janë ndarë duke u përshëndetur. Kurse për sqarimin dhe pajtimin në dasmë mes Jusufit dhe Kadriut gjithashtu kanë ditur shumë bashkëveprimtarë e "bashkëveprimtarë" dhe ka qenë e vetëkuptueshme se, pas atij sqarimi dhe pajtimi, nga dita në ditë pritej të ndodhte bashkimi.

(B.I.:) - Ju, bashkëveprimtarët e vjetër, por edhe unë, e pranojmë se dita e 17 Janarit 1982 është edhe dita e bashkimit në organizatë të re, megjithëse unë jam bërë anëtar i saj 11 vjet

më pas. Edhe nga arkivi i organizatës kam vërejtur se ajo është dita fillestare. Mirëpo, zyrtarisht, nëse mund të quhet zyrtare, është quajtur 17 shkurti. Pse është ky dallim mes dy datave dhe çfarë ndodhi mes njërës datë dhe tjetrës?

(I.K.:) **-** Për mua është i mirëqenë fakti se 17 Janari i vitit 1982 është datë e bashkimit dhe i gëzohem fatit që kam mundur t'i dal zot gjatë gjithë kohës. Edhe më i gëzuar ndihem se kemi dalë ngadhënjimtarë. Pse të mos e them, i gëzohem fatit që jam gjallë për të dëshmuar dhe për të dhënë informata dhe vlerësime për rrjedhën e lëvizjes çlirimtare në emigracion dhe për **Lëvizjen për Republikën e Kosovës**, e cila në vitin 1990 përshtati emrin në **Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK).**

Më 17 shkurt 1982 janë "bashkuar" Sabri Novosella dhe Abdullah Prapashtica, për t'u "ndarë" në muajt vijues. Jam munduar të mësojë se kush i autorizoi këta persona që të përfaqësojnë dhe kë kanë përfaqësuar? Kanë ende individë të gjallë që dëshmojnë me prova apo ende është gjithçka në mjegull? Pastaj, përse pikërisht këta "përfaqësues", të cilët, pas vrasjeve, ngutshëm bënë bashkimin, filluan të kontestojnë të parët njëri-tjetrin, sa të na detyronin të merreshim me grindjet e tyre të stisura, të mbanim tubime sqaruese dhe vendimmarrëse.

Sigurisht, as unë dhe as Jusufi nuk ishim përfaqësues juridikë të organizatave tona, sepse Fronti i Kuq Popullor e kishte ngrirë veprimtarinë e organizuar në prill të vitit 1981 për të pritur bashkimin, kurse as LNÇKVSHJ-ja nuk e kishte autorizuar Jusufin, por të paktën ne flisnim në emër të bashkëveprimtarëve tanë në Perëndim dhe ata donin të bashkoheshin në një organizatë unike.

Koha është që në Kosovë të sqarohen rrjedhat. Ta zëmë, të mos spekulohet me të vdekur, se gjoja Metush Krasniqi ka qenë

kryetar i "Lëvizjes" së Sabri Novosellës! Të saktësohen njerëzit, themelimi, mënyra e funksionimit, sepse nga intervistat e deritanishme është krijuar huti. Njësoj do të duhej të bëhen sqarime edhe për "Partinë" e Abdullah Prapashticës, i cili duket se ka manipuluar ca të afërt e familjarë për të dëshmuar se kishte parti. Nuk është turp, ndoshta, të thuhet e vërteta edhe për mënyrën naive të themelimit të këtyre "subjekteve", siç kam informuar unë disa herë për mënyrën naive e fatkeqe të themelimit të Frontit të Kuq Populllor.

Edhe zyrtarët e atëhershëm në Shqipëri do të duhej të jepnin sqarime të sakta, si hynë ata në Shqipëri dhe nëse i kanë ndihmuar Sabri Novosellën dhe Abdullah Prapashticën gjatë "arratisjes" së tyre në Turqi. Nëse po, si dhe përse i kanë ndihmuar, pasi ndonjëherë thuhet se këta janë "arratisur", fillimisht në Shqipëri dhe prej andej janë ndihmuar të shkojnë në Turqi. Rëndom pushteti i atëhershëm nuk është shquar për këso angazhimesh, me sa di unë.

Kontribut sqarues mund të jepte edhe ndonjë bashkatdhetar në Turqi, nëse Sabri Novosella vërtet e kishte formuar atje "komitetin Hasan Prishtina" në vitet 1980-81, si formë e organizimit të lëvizjes së tij dhe çfarë veprimtarie ka pasur ai farë komiteti, i cili, për bindjen time, ishte sajesë virtuale, meqë, me gjithë këmbënguljen time, nuk më ka rënë të lexoj se ka rrëfyer ndokush konkretisht, pos Sabri Novosellës, për ekzistencën dhe veprimtarinë e tij. Me sa dihet deri tani ai ishte një komitet që kishte vetëm një njeri dhe me "gërshërën" e këtij njeriu priteshin shumë fije të vyera e "qepeshin" shumë lidhje të dëmshme. Sidoqoftë, deri tani, dyshoj se komiteti ishte vetëm "rrobaqepësi", emri me të cilin njihej herë pas here Sabri Novosella.

Edhe udhëheqësit e OMLK-së do të duhej të sqaronin publikisht, nëse e kishin autorizuar Zotëri Xhafer Shatrin të përfaqësonte organizatën e tyre, gjë që në biseda të rastit ma kanë thënë se, edhe po të donin, nuk i kishin mundësitë, meqë tashmë të gjithë ishin në burgje.

Pas 17 Janarit

(B.I.:) *- Dihet se varrimi i tre dëshmorëve është shtyrë disa herë për të ardhur në ceremoninë e tyre edhe prindërit nga Kosova apo edhe për ndonjë shkak tjetër. Unë kam parë në një fotografi babanë e Kadriut, por më duket, nëse nuk jam i gabuar, se ka qenë edhe nëna e Jusufit dhe e Bardhoshit, nëna Ajshe. Si u bë organizimi i varrimit të tyre, kush e mori përsipër, si u ndanë përcaktimet për organizimin, kush do të mbante fjalën e rastit dhe hollësitë e tjera të kësaj pasngjarjeje?*

(I.K.:) - Varrimi i Jusufit, Kadriut dhe Bardhoshit është shtyrë vetëm për një arsye kryesore: avokati (Wolf) ishte angazhuar dhe na premtonte se po nxirrte lejen në konsullatën jugosllave në Shtutgart për t'i bartur trupat e tyre në Kosovë. Por, kur erdhi refuzimi përfundimtar nga ajo konsullatë, caktuam ditën e varrimit.

Në ceremoninë mortore dhe në varrim kanë qenë nëna e *Jusufit* dhe e Bardhoshit dhe babai i Kadriut. Ceremonia në dukje ka qenë e rregullt, me shumë njerëz që vinin për ngushëllime, kurse përbrenda ziente, sepse ne që e menaxhonim, ishim të armiqësuar. Megjithatë ia dolëm të ndajmë e t'i koordinojmë punët kryesore.

Fjalën mortore te varrezat u ngarkova unë ta shkruaj, kurse

për ta lexuar caktuam Agron Selën nga Dibra, bashkëveprimtari ynë më i ri. U zgjodh ai sepse Xhafer Durmishi kishte zë të gërvishtur, fare të ulët, kurse mua nuk me donin. Agronin e vlerësuam si më neutral. Më erdhi keq që e caktuam atë, sepse kisha një parandjenjë se nuk do ta lexonte dot deri në fund, meqë ishte tepër i ri në moshë (rreth 18-vjeçar). Për këtë arsye i qëndrova pranë. Kur i plasi vaji me dënesë, ia mora letrën nga dora dhe e mbarova së lexuari unë.

Edhe ca veprime të mëpasshme i koordinuam dhe i bashkorganizuam, por pa vullnet e përkushtim. Sidomos Nuhi Sulejmanin dhe "trashëgimtarin", Xhafer Durmishin, nuk m'i donte fare organizmi, por më duhej të sillesha me takt që të mos plaste ndonjë grindje e egërsuar. Po sjell dy incidente, që shpjegojnë, sa vështirë ka qenë të përballoheshin komplotet e tyre. Njërin e sajoj Nuhi Sulejmani, se gjoja unë kisha tentuar të vidhja ndihmat financiare në shtëpi të Gërvallëve, ato që Klubi Emin Duraku ia kishte dorëzuar Zonjës Suzana Gërvalla, dhe me atë rast u mundua të manipuloi e nxit Naim Haradinajn (nga Glloxhani) dhe Agron Selën, si tepër të ri që ishin, për të me sulmuar fizikisht. Por rasti u sqarua dhe Nuhi faqeziu u diskreditua. Rasti tjetër qe kur në të njëjtin takim planifikues të aktiviteteve, Xhafer Durmishi provoi të ngarkonte Saime Isufin për bashkëveprim me vrasësit, sikur ajo u paskësh treguar orarin e telefonimit vrasësve. Bile pat përdor fjalor tepët denigrues kundër saj. E, duke qenë në atë shtëpi, gjegjësisht në atë takim, ku merrnin pjesë 7-8 veta, që të dyve ua bëra të qartë: "Kur të me mbaroj durimi, do ua bëjë gjëmën...!" Fatmirësisht e kuptuan kërcënimin tim dhe nuk më provokuan më aq konkretisht e aq marrëzisht.

Simpatizantët e OMLK-së ishin kryesisht në Zvicër dhe ata

ndiheshin të përfaqësuar nga Saime Isufi dhe Hasan Mala gjatë koordinimeve të veprimtarisë se përbashkët. Me ata mirëkuptohesha, por me Zotëri Durmishin dhe bashkëpunëtorët e tij të ngushtë, shpesh na rastiste të grindeshim, megjithatëë gjenim kompromis, që ndonjëherë me zor e kapërdija. Kështu vazhdoi deri pas 15 majit 1982, kur "përfaqësuesi" i OMLK-së, komplotisti Xhafer Shatri, bëri "bashkimin" me "krijesën" e Sabri Novosellës dhe Abdullah Prapashticës, të sajuar më 17 shkurt 1982, në Turqi. Pas këtij "bashkimi", të dytë, zuri të normalizohej organizimi mjeran. Për këtë fillim organizativ meritat u takojnë dy Xhaferëve (Shatrit dhe Durmishit). Por ishte një shurdhëri politike që ndillte sherre të tjera, që do të vinin ende pa u shuar sherret e vjetra.

(B.I.:) - E kemi të pamundur të mos hapim edhe një herë, për fat të keq, edhe një çështje, që edhe pa dashjen tonë, është hapur herë pas here e do të mund të hapet edhe pas kësaj interviste. Roli juaj, konkretisht, në bashkimin e grupeve, në krijimin e një strukture dhe në organizimin e varrimit të tre dëshmorëve. E them këtë, sepse, qysh kur kam ardhur në Gjermani, jam njohur, si shumë të tjerë, me plot thënie, akuza, rrëfime, sajesa, përshkrime ndodhish, të cilat, herë pas here, kundërshtojnë njëra- tjetrën. Ju keni mbajtur një fjalë në varrimin e tyre. Pra ishit ndër njerëzit kryesorë. Në kohën kur ju po flisnit, kishin kaluar disa ditë nga vrasja, flitet se zërin e kishit të fortë. Një nga pjesëtarët në varrim, ish-gardian burgu në Jugosllavi, më pas i punësuar në Gjermani, duke ju dëgjuar, u thotë të pranishmëve: "hiç nuk po iu dridhka zani, ky duket edhe i paska vra". Këtë të dhënë nuk e kam nga ju, por nga Xh.L., dhe jo tani, por shumë kohë më parë. Që atëherë, pra që prej asaj dite e ndoshta edhe më parë, herë pas here

jeni fajësuar edhe ju për këtë ngjarje. Më pas ju botuat romanin „Atentatet“ dhe në një intervistë keni thënë se e njihni vrasësin e Jusufit. Romani është roman, në të mund të bëhen aludime, të shpjegohen ngjarjet sipas përjetimit vetjak ose përfytyrimit. Unë vetë e kam të qartë, mirëpo të tjerët, edhe pse janë qartësuar ngjarjet, duan të dinë më shumë. Dhe atë duan ta dinë nga ju.

(I.K.:) - Atmosferën në familjen e Gërvallajve gjatë ceremonisë mortore e kam përshkruar në roman dhe nuk jam i interesuar ta përshkruaj edhe një herë. E kam komanduar veten ta përballoj atë rrjedhë deri në fund, për respekt ndaj Jusufit e Bardhit, për hatër të fëmijëve të Jusufit, për hatër të Nënës Ajshe, si dhe për inat të "trashëgimtarëve" dhe vrasësve. Ikja më dukej dezertim. Isha i bindur se ikja ime do t'u krijonte më shumë hapësirë veprimi keqbërjeje "trashëgimtarëve" dhe komplotistëve, të cilët do ta turpëronin fare familjen Gërvalla, nëse do t' i lija pa krahë e mbrojtje njerëzit e çmuar në atë familje. Edhe kur "trashëgimtarët" më thoshin se prania ime aty nuk ishte e dëshiruar, unë nuk ua varja. Edhe kur më thoshin në prani të Zonjës Gërvalla se prania ime nuk ishte e dëshiruar dhe ajo thoshte se i duhej t'u përmbahej vendimeve të "shokëve", përsëri nuk dezertoja, sepse nuk dëshiroja ta lija familjen e bashkëveprimtarëve të ngushtë ta nëpërkëmbnin "trashëgimtarët" e komanduar nga Sabri Novosella. Dhe ata e dëshmuan shumë shpejt se cili kishte qenë respekti për të vrarët duke braktisur idetë e tyre me arnime të shëmtuara politike mbi një krijesë denjësisht të merituar për shqiptarët.

E çfarë nuk shpifnin ata aty dhe njerëzit e UDB-së në Kosovë. Ta zëmë, më patën informuar se një dajë i falshëm (djali i axhës së nënës sime) nuk ishte vonuar ta vizitonte Nënën time

në shtëpinë tonë në Llabjan të Pejës dhe, në vend të ngushëllimit, i kishte thënë: "Si na e ka marrë fytyrën nipi, i ka vra shokët për t'i marrë nusen Kadriut dhe tani nuk po i gjen as policia gjermane...". Kishte nga ata bashkatdhetarë që kthehshin nga pushimi dimëror dhe habiteshin kur më takonin në ceremoninë mortore, sepse në Kosovë ishte përhapur fjala për vrasjen që "kisha bërë" dhe policia gjermane nuk po më gjente e të tjera shpifje të ngjashme, diskredituese. Por, që t'i përballoja të gjitha, fillimisht më duhej bindja ime e plotë se jo vetëm isha i panjollë në këtë ngjarje, por edhe kisha qenë pjesë e rëndësishme e një ngjarjeje tjetër dhe prandaj më duhej t'i dilja zot deri në fund të jetës sime. Bindja ishte kryesorja. Largimi konsideroja se do të ishte njollë dhe dobësi, por edhe lënie e lirë e rrugës së krimit tjetër: përdhosjes së vlerave që kishin bartur tre shokët e vrarë, vlera që ata i kishin bartur denjësisht deri në momentin e fundit. Kishte edhe arsye tjera të cilat më mundësonin të qëndroja mes tyre, edhe leximi i literaturës për veprimtari subversive të shërbimeve të fshehta, si dhe vendosmëria për t'i dal zot veprës së bashkëveprimtarëve. Madje, shumë konkretisht më pati ndihmuar leximi i romanit romatik "Prijësja e komitëve", e autorit Sylejman Krasniqi, i cili përmbante fragmente të metodave të ngjashme të policisë serbe për të diskredituar Shotën dhe Azem Galicën edhe përmes hoxhallarëve dhe pleqve me nam në Drenicë.

Edhe më shumë se vetja më janë dhimbsur kunata ime, Sabrija dhe Vezirja, bashkëveprimtarja jonë, bashkëshortja e Sylë Nuhajt, që qëndruan aty gjatë gjithë kohës për t'ua lehtësuar dhembjet nënës Ajshe, Suzanës, Tushës dhe Saimes dhe për t'u shërbyer njerëzve me gatime e pije. Prania e tyre aty m'i lehtësonte dhembjet dhe ma rriste forcën morale.

E vërtetë, me zërin e sforcuar e kam deklamuar fjalën në varrimin e shokëve, sepse doja të dilja fitimtar kundër UDB-së vrastare dhe "trashëgimtarëve" të komanduar nga Sabri Novosella. Dhe ai gardiani dhe të tjerë si ai, të paktën tani, le të skuqen, nëse janë ndërgjegjësuar njerëzisht e shqiptarisht.

II. Dy Xhaferët

(B.I.:) - Nuk e di pse m'u kujtua një këngë e hershme e popullit, më duket e Jugut të Shqipërisë, e cila mes të tjerave, ka edhe vargun e njohur: "Dy xhaferë në një derë, e mjera unë, e mjera...", pikërisht në momentin kur këtë kapitull, nëse e quaj kështu, mendova ta emërtoj "Dy Xhaferët".

Është një periudhë e shkurtër në jetën e Lëvizjes, kur rastësisht ose jo rastësisht, në drejtimin e saj do të jenë dy Xhaferë, Shatri dhe Durmishi, të cilët, më pas, do të ishin nga të parët, të larguar, për disa, e të përzënë, për disa të tjerë, nga Lëvizja, ku ata kishin qenë pjesë e ngritjes statike. Nuk do të jetë rasti i parë në një lëvizje klandestine kur drejtues të saj, të lodhur ose jo, largohen prej tyre dhe zënë strehë diku tjetër, por do të jetë rasti i vetëm ndoshta, kur në një periudhë kaq të shkurtër, tre nga ata që quheshin kryesorët, jo vetëm që do të largoheshin, për disa, e do të përziheshin, për disa të tjerë, por edhe do të hasmëroheshin deri në skaj, fillimisht me njëri- tjetrin, e pastaj me vetë strukturën që pretendonin se e kishin krijuar.

Kur pata fatin të zgjidhem në drejtimin e organizatës kam menduar shpeshherë edhe për këtë fakt, aq më tepër më dhembte kur mendoja se njerëz të aftë, si Shatri, ishin tashmë në drejtimin e kundërt të shokëve të tyre. Më pëlqente fakti se një njeri i larguar, për disa, dhe i përzënë, për disa të tjerë, ishte bërë Ministër i Informimit në një qeveri si ajo që quhej „Bukoshi", dhe që ishte figura e dytë e saj, sepse mendoja, nganjëherë në mënyrë cinike, se edhe një i larguar nga radhët e Lëvizjes, për disa, dhe i përzënë, nga disa të tjerë, ishte i aftë të bëhej

ministër. Ndërsa kur dëgjoja se diku në Suedi, një njeri me mbiemrin Novosella kërcëllinte dhëmbët kundër Lëvizjes, nuk bëhesha merak, sepse mendoja se ata ishin dhëmbë të hequr diku e dikur më parë e se tani nuk mund të kafshonin e të përgjaknin. Por, kohë më vonë, u binda se ata u larguan ose u përzunë nga Lëvizja pa dhembje, sepse ata thjesht kishin qenë pjesë fiktive e themelimit të saj, kishte qenë pjesa e parë, e dukshme, ndërsa e vërteta ishte diku tjetër dhe ajo pjesë tjetër do të ishte pikërisht ajo që do e vazhdonte deri në fund atë që kishte nisur më 17 Janar 1982 dhe që ishte përgjakur mizorisht po asaj nate.

Ende sot nuk kam mundur t'i jap shpjegim tjetër. Njeriu largohet vetëm nga ajo që nuk ia do zemra, kur nuk e ka me të vërtetë ose është i lodhur e nuk bën më tutje. Këta nuk ishin të lodhur, sepse gjërat porsa kishin filluar.

Por, sidoqoftë, le të vazhdoj bisedën time me Ibrahim Kelmendin. Ai, pas shumë viteve, më ka "rënë në dorë" dhe dua ta shfrytëzoj këtë rast deri në fund. Kam pritur gjatë për t'i bërë këto pyetje dhe nuk mendoj se duhet të ndal në fillesën e rrugës. Kemi ende plot gjëra për të folur. Ai është i gatshëm. Le të vazhdojmë…

(B.I.:) *- Që nga dita e 17 Janarit, ku u bashkuan tri organizatat ilegale e deri në 17 shkurt 1982, që improvizohet si datë e themelimit të Lëvizjes Popullore të Kosovës, është një muaj. Në këto ditë është dashur të bëhen shumë gjëra, disa tejet të dhembshme, siç ishte varrimi i tre shokëve të vrarë, por edhe përgatitja për të ecur më tej. Në mes pengut të varrimit dhe asaj që duhej përgatitur, ku e gjen veten Ibrahim Kelmendi?*

(I.K.:) **-** "Trashëgimtarët" e Jusufit nuk donin të pranonin se e kishim bërë bashkimin në **Lëvizje për Republikën e Koso-**

vës më 17 Janar 1982, kurse anëtarët e OMLK-së, që po ndiheshin të shokuar nga vrasjet e kobshme, nuk shquheshin për ndonjë iniciativë. Ata kishin besim tek unë se nuk do të lejoja të merreshin vendime që do të dëmtonin OMLK-në. Që të këmbëngulja për të imponuar organizatën e re që kishim formuar më 17 Janar, nuk e bëja dot, sepse dy nga bashkëthemeluesit tashmë ishin shndërruar në martirë të kombit, gjithashtu, nuk kisha si të ofroja ndonjë provë faktike, pasi policia i kishte bastisur dhe marrë të gjitha materialet e shkruara që kishte gjetur në shtëpinë e Jusufit e të Bardhit. Pra, ishte një situatë vërtet e rëndë. "Trashëgimtarët" e Jusufit provonin të më përzinin edhe nga varrimi i shokëve bashkëveprimtarë që të livadhisnin pastaj siç do t'u tekej, zi e më zi, do të thosha. Më konkretisht, të zbatonin komandimet e "udhëheqësit" Sabri Novosella, meqë edhe shtëpia e Vëllezërve Gërvalla kishte mbetur pa Zot. Unë rezistova dhe them se ceremonia mortore dhe varrimi u kryen në nivelin më të dinjiteteshëm të mundshëm.

Se po përgatitej "bashkimi" në mes të Sabri Novosellës dhe Abdullah Prapashticës dhe se do të ndodhte më 17 shkurt, nuk më kishte folur njeri. Asnjëherë nuk u sqarua si u njohën pikërisht ata mes vete, kishin ndonjë diskutim paraprak, kush e caktoi takimin dhe vendin ku do të ndodhte "bashkimi"? Nga ato që kam lexuar nga pjesëmarrësit e atij takimi më rezulton se për të realizuar atë farë "bashkimi" duket sikur i ka komanduar apo t'i ketë koordinuar një i tretë, deri tani i paidentifikuar!

Dhe, më 17 shkurt, ndodhi ai "bashkim", por nuk u dha ndonjë njoftim publik deri më 15 maj, kur do të ndodhte "bashkimi" i radhës, tashmë në mes të "bashkimit" të Sabri Novosellës e Abdullah Prapashticës, në njërën anë, dhe "përfaqësuesit" të OMLK-së, Xhafer Shatrit, në anën tjetër. Se mos i

treti ashtu kishte urdhëruar, për të pritur "arratisjen" e "përfaqësuksesit" Xhafer Shatri. Fatkeqësisht po i përdor si shpesh thonjëzat lidhur me këto dy "bashkime", meqë, edhe pas kaq shumë vitesh, ende nuk janë ofruar sqarime bindëse se kush dhe cilin ka autorizuar për përfaqësim.

Edhe më goditëse qenë zënkat e menjëhershme pas disa muajsh, ndërmjet "përfaqësuesve" që kishin firmosur "bashkimet", duke denoncuar njëri-tjetrin për vendimet që kishin firmosur. Secili kontestonte tjetrin, se nuk kishin vendosur kështu apo ashtu, por kështu e ashtu. Unë, si i paimplikuar në ato "bashkime", i akuzoja që të tre se kanë bërë bashkime hileqare e komplotiste, për t'u grindur artificialisht mes tyre, në mënyrë që Lëvizja aty e tutje të merrej vetëm me ato grindje.

Ata që thonë se Lëvizja është themeluar më 17 shkurt 1982, nuk merrnin parasysh se vetë firmëtarët e marrëveshjes për atë "themelim" kanë kontestuar njëri-tjetrin dhe kështu, rrjedhimisht, kanë zhvlerësuar marrëveshjen e tyre. Po "bashkimi" tjetër, më 15 maj, si duhet të trajtohet? Që Xhafer Shatrin nuk e kishte autorizuar OMLK-ja, ishte më se e qartë, atëherë dhe sot. Nuk është e qartë si u caktua përfaqësuesi i "Lëvizjes" së themeluar më 17 shkurt? Kishte ajo ndërkohë udhëheqje të saj, meqë kishin kaluar dy muaj që kur ishte themeluar, apo vetëm po prisnin derisa të ndodhte "arratisja" e Xhafer Shatrit? Sikur po i vinte tamam era skenar, i bërë nga eprorët e atyre "përfaqësuesve", për të komplotuar kundër Lëvizjes së 17 Janarit, një herë me "bashkimet" e komplotistëve, pastaj me përçarjet e improvizuara mes tyre, që ne të merreshim pastaj vetëm me ato grindje, derisa të demoralizoheshim ose të vriteshim me njëri-tjetrin, për të mos pasur më Lëvizje. Këto dyshime kisha atëherë dhe, fatkeqësisht, dyshoj edhe tani, kur edhe pas pothuajse 30 vjetëve nuk janë ofruar shpjegime dhe

prova përkatëse në kanë ekzistuar vërtet organizata e Sabriut dhe partia e Avdullahut!? Kanë vendosur kryesitë e tyre për t'i autorizuar Sabriun dhe Avdullahun për bisedime!? U kanë dhënë udhëzime kryesitë përkatëse përfaqësuesve se mbi bazë të çfarë platforme duhet të themelohej organizata e re pasi ta kenë bërë bashkimin!? U kishin dhënë projekte si do të bëhej bashkimi dhe kush do të udhëhiqte organizatën e re apo ua kanë dhënë të pakufizuar të drejtën e përfaqësimit që të vendosin aty për aty, si t'u tekej?!

Unë vazhdoj të këmbëngul në përjetimet dhe në angazhimin tim, se Lëvizja u themelua më 17 Janar 1982, se në themelet e atij themelimi u bënë theror tre heronj, se atë themelim do ta dëshmojnë dokumentet e përpiluara nga Jusufi dhe Kadriu (meqë ata nuk kishin ndenjur kot bashkë ditën e 17 Janarit, për të vazhduar të rrinin edhe ditën në vijim), se Lëvizja e themeluar më 17 Janar 1982 i mbijetoi komplotet dhe doli fitimtare. Në fund, e quaj veten fatlum se isha pjesë e kësaj historie, në mos për tjetër, së paku për të qenë dëshmitar i asaj që ka ndodhur në të vërtetë dhe që është themeli i bashkimit në Lëvizje. Sepse vetëm një bashkim i tillë, i saktë, i menduar mirë, i bërë pas sprovash, mendimesh, herë-herë edhe keqkuptimesh, por me gjithçka që dilte nga zemra dhe vizionet, mund të përballonte kohën. Për mua, por edhe për shumë shoqe e shokë të mi, nëse marsi i vitit 1981 është dita fatlume kur populli fillon e i del zot Kosovës, 17 Janari është, po ashtu, dita fatlume kur formësohet zëri i kryengritjes dhe, pashmangshëm, është vazhdimi i ngjarjeve të marsit të vitit 1981. Bashkimi i 17 Janarit nuk erdhi pas kompromiseve, pazareve, rrahjeve të gjoksit apo sharjeve dhe as nuk prodhoi pazare, rrahje gjoksi apo sherre. Ai ishte i qëndrueshëm, sfidoi kohën, manipulimet, komplotet dhe fakt është se u rikthye në zanafillën e tij e ky është rikthimi i madh.

(B.I.:) - Në materialet e konsultuara, disa të sakta dhe disa që kundërshtojnë njëra-tjetrën, vërehet se është një periudhë e habitshme, në të cilën, pasi kalohen disa ngjarje e vendime, bëhen gati të afishohen njerëz të tjerë, disa të njohur e disa të panjohur, mes të cilëve, herë del në pah e herë mbetet në hije, roli i „rrobaqepësit", Sabri Novosella. Atij i jeni drejtuar disa herë edhe ju në këtë rrëfim, por, ndërsa disa e mohojnë krejtësisht, disa, në këtë fillim të vitit 1982, e kanë si mit, i drejtohen atij, nuk bëjnë gjë, pa pasur miratimin e tij. Kush është ky njeri, i cili shumë shpejt do të largohet nga Lëvizja dhe do të anatemohet edhe nga ata që e kishin ngritur?

(I.K.:) - Për të qenë i sinqertë, tashmë jam i sigurt se pseudonimi "rrobaqepësi" i takonte Sabri Novosellës dhe se Jusuf Gërvalla e dinte dhe e çmonte atë për udhëheqës të tij dhe të LNÇKVSHJ-së. Për të tjerat tani jam ende më i paqartë dhe më i dyzuar sesa para 30 vjetëve, se cili vërtet është Sabri Novosella dhe a ekzistonte apo jo organizata e tij.

Po të ketë qenë Sabri Novosella patriot i vërtetë, atëherë më duhet t'i kërkoj falje dhe t'i përulëm, sepse vërtet e kam kundërshtuar dhe e kam luftuar me përkushtim. Ta zëmë, qysh në fillim jam munduar ta bind Jusufin se po gabonte që po e respektonte dhe çmonte për udhëheqës. Ai, jo vetëm nuk më dëgjonte, por edhe hidhërohej me mua. Ruaj bindjen se vetëm gjatë dasmës se Kadriut e të Saimes, pas sqarimeve e mirëkuptimeve që kishim, Jusufi duhet të ketë filluar të lirohet prej shpërdorimeve e tutelës së Sabriut.

Unë vazhdoj të mendoj se Sabriu ka sajuar organizatë fiktive për qëllime antishqiptare, ka mashtruar dhe ka manipuluar personalitete, ka shpërdoruar emra personalitetesh, ka përvetësuar mjete të shumta që shteti shqiptar ia ka dhënë për të finan-

cuar veprimtarinë e organizatës së tij, është angazhuar me të gjitha mundësitë e tij që ta zhdukë Lëvizjen e 17 Janarit 1982, është marrë vazhdimisht vetëm me përçarje të emigracionit, na ka komplotuar keq dhe rëndë sa herë i ka ardhur ndoresh, etj.

Në vazhdën e nxirosjes që po i bëj atij njeriu, - uroj të dal i gabuar, - po sjell edhe informatën nga aktualiteti. Pas botimit të romanit "Atentatet", Demë Ademaj, një ish-kryepolic në Prishtinë, iu lut njërit të farefisit të tij, bashkëveprimtarit tim shumëvjeçar, Malush Ademajt, që t'i organizonte një takim me mua për të diskutuar për romanin. Malushi, bashkë me një bashkëveprimtar tjetër, Bilal Kryeziun (e Kievës), më marrin dhe shkojmë në takim. Aty ish-kryepolici na rrëfeu për mënyrën e bastisjes së shtëpisë dhe të "arratisjes" së Sabri Novosellës në fund të vitit 1979. Atij i kishte dhënë urdhër shefi i UDB-së së Prishtinës, Ibush Kllokoqi, që të përgatiste ekipin policor për të bastisur shtëpinë e Sabri Novosellës dhe për ta burgosur atë. Kryepolici kishte caktuar edhe 11 policë dhe së bashku mbajtën nën vëzhgim terrenin dhe shtëpinë e Sabriut gjatë asaj nate. Bastisja dhe arrestimi i Sabriut duhej të ndodhte rreth orës 04.00. Ekipi po priste ardhjen e Ibush Kllokoqit, sepse ai kishte urdhëruar se duhej të ishte i pranishëm. Sapo arritën Ibushi, bashkë me udbashin... Krasniqi (emrin ia paskam harruar), i thonë kryepolicit se ata të dy do të hynin vetë të parët në shtëpinë e Sabriut dhe se policia duhet të hynte për të bërë bastisjen kur t'i sinjalizonin ata. Kryepolici reagoi ndaj kësaj mënyre të pazakontë duke pyetur Ibushin nëse ishte ndonjë skenar taktik. Tjetri e urdhëroi të heshtte që të mos e dëgjonin policët e tjerë dhe të zbatonte urdhrin.

Pas rreth 7-8 minutave, pasi dy kryeudbashët kishin hyrë brenda, u dëgjua ndezja dhe nisja e makinës së Ibushit nga

ana tjetër e shtëpisë. Në atë moment kolegu i tij, Krasniqi, sinjalizon policinë për të bërë bastisjen. Policët hynë brenda qetë-qetë. Nënën Naile e gjetën në gjumë të thellë dhe nuk e trazuan. Pastaj shkuan në dhomën e gjumit të Sabriut dhe të bashkëshortes së tij. Ajo po qëndronte e mbështetur dhe e mbuluar me jorgan në anën e saj të krevatit çift. E pyetën ku ishte Sabriu dhe ajo u përgjigj se nuk kishte qenë aty atë natë. Kryepolici i kishte thënë se gjatë survejimit e kishin parë duke hyrë në shtëpi dhe se pjesa e krevatit ku kishte fjetur Sabriu ishte ende e ngrohtë...

Kryeudbashi Krasniqi urdhëroi kryepolicin të ndërpriste marrjen në pyetje dhe të shkruante në protokoll se bastisja kishte ndodhur, por Sabri Novosellën nuk e kishin gjetur në shtëpi. Ibush Kllokoqi dhe Sabriu tashmë ishin larguar në drejtim të panjohur. E ai drejtim i panjohur paskësh qenë Shqipëria, prandaj lind dyshimi, mos ndoshta Zotëri Novosella ishte spiun i dyfishtë - edhe i Sigurimit shqiptar.

Kryepolici Demë Ademaj tha se ishte i gatshëm me të gjithë kolegët e tij që kishin qenë në atë aksion, të dëshmonin publikisht për atë që kishte ndodhur.

Them se nuk ka nevojë të kursej edhe një të dhënë të paverifikuar se, pas vrasjes se Ibush Kllokoqit, Sabri Novosella paskësh bërë një banket simbolik, i gëzuar se krimineli Ibush Kllokoqi kishte marrë dënimin e merituar. Sapo dëgjova për këtë, nuk u përmbajta pa komentuar: Ata që janë frikësuar se Ibush Kllokoqi dhe kryeudbashë të tjerë mund t'i dekonspirojnë "patriotët çlirimtarë" si bashkëpunëtorë të tyre, duhet të kenë urdhëruar njerëz të mjerë për t'i vrarë kryeudbashët, që të mbeten "patriotët çlirimtarë" të pazbuluar, si kodoshë që ishin.

Sinqerisht do të gëzohesha shumë sikur ndokush me

prova do të më përgënjeshtronte dhe, në rast të tillë, nuk do të më mjaftonte vetëm të kërkoja falje publikisht, por do të pranoja edhe të vuaja dënimin e merituar për shpifje e diskreditim ndaj Sabri Novosellës.

(B.I.:) - Në aktin e themelimit, nëse mund ta quaj kështu, mungon prania juaj. Dimë se Fronti që ju drejtonit, e kishte ngrirë aktivitetin. Mirëpo, pas marrëveshjes së 17 Janarit, këtë "ngrirje" duhet të kishin pasur edhe organizatat e tjera. Marrëveshja nuk u bë e njohur për shkaqe që dihen, por nuk mendoj dhe nuk dua të besoj se, qoftë Kadriu, qoftë Jusufi, kishin ardhur në këtë konkluzion, në të përbashkëtën e mëtejshme, me mendimin e tyre vetjak. Duhet të ketë pasur vendime që i kanë autorizuar ata të marrin një vendim të tillë. Cili ishte shkaku që në "bashkimet" e mëpasshme ju nuk jeni aty?

(I.K.:) - Nga përgjigjet e mëhershme mbase vetëkuptohet përse nuk më kanë integruar në ato "bashkime". Jam i bindur se Sabri Novosella dhe Xhafer Shatri e kanë ditur se më 17 Janar 1982 Kadri Zeka, Jusuf Gërvalla dhe unë kishim vendosur të bashkoheshim. Sabriun duhet ta ketë informuar "trashëgimtari" i Jusufit, Xhafer Durmishi, kurse Xhafer Shatrin duhet ta ketë informuar Hasan Mala. Por, këta "përfaqësues" nuk donin të zbatonin atë vendim, ngaqë ishin komanduar të komplotonin përmes "themelimit" të një organizatë të re, sipas shijeve të tyre, gjegjësisht sipas skenarit dhe urdhrave të eprorëve të tyre. Mirë që nuk më kanë thirrur as formalisht, sepse unë do isha përpjekur të bllokoja komplotet e tyre dhe kështu do të ndodhte ndonjë eksces i rëndë ose, ndoshta, për të tejkaluar më lehtë ballafaqimin me ta dhe situatën, do të bëhesha konformist dhe pjesë e komplotimeve!

E kam thënë, qysh kur kemi vendosur bashkorganizimin

e demonstratave në prill të vitit 1981, ne të Frontit e kishim ngrirë veprimtarinë e organizuar për t'i hapur rrugë e për të përshpejtuar bashkimin. Prandaj thirrjet që bëheshin për demonstrata, herë lëshoheshin në emër të OMLK-së dhe herë në emër të LNÇKVSHJ-së, por asnjëherë në emër të Frontit të Kuq Populllor dhe, sa për të mos mbetur fare të paprezantuar, demonstratën e majit 1981, në Dyseldorf, e bëmë në emër të Klubit shqiptar "Emin Duraku". Ndoshta nuk keqkuptohem nëse informoj se në atë kohë, në shtetet e Evropës Perëndimore pothuajse vetëm FKP-ja kishte veprimtarë e simpatizantë, ngaqë OMLK-ja ende nuk kishte zhvilluar veprimtari publike, mund të kishte 2-3 anëtarë e ndonjë kandidat për t'u bërë anëtarë, kurse Jusufi vetëm pas tetorit 1981 kishte vendosur për të ushtruar veprimtari të të organizuar, sigurisht sipas udhëzimeve të "udhëheqësit" Sabri Novosellës dhe gjatë asaj kohe të shkurt nuk duhet të ketë anëtarësuar më tepër se 15 veta në organizatën e tyre.

Nëse në prill të vitit 1981 e kishim "ngrirë" veprimtarinë, si do ta "shkrinim" pasi kishim bërë bashkimin më 17 Janar 1982? A nuk do të ishte kjo një pabesi ndaj shokëve dëshmorë!?

Në anën tjetër, komplotistët që kishin improvizuar "bashkimet" e 17 shkurtit dhe 15 majit 1982, vazhdonin të thirreshin në organizatat e tyre edhe pas "bashkimeve". Veç Avdullah Prapashtica pat deklaruar se dilte nga "bashkimi" i 17 shkurtit dhe se do të vazhdonte veprimtarinë më vete. Kurse Xhafer Shatri duhet të ketë dhënë urdhra në Kosovë që të formohej "Partia e Luftës" dhe ndonjë parti a organizatë tjetër, në vend që t'i ndihmonte organizimet e atëhershme klandestine në Kosovë që të integroheshin në Lëvizjen e sapothemeluar.

Ftohje apo armiqësi?

(B.I.:) - Është një periudhë që disa nga krerët e përkohshëm të Lëvizjes ishin ftohur me ju apo ju ishit ftohur me ta?

(I.K.:) - Jo ftohja, por armiqësimi, ishte i dyanshëm. Unë i di arsyet e mia, përse isha armiqësuar kundër komplotistëve, kurse për armiqësinë e tyre kundër meje nuk them dot arsye, vetëm se mund t'i marr me mend. Mirëpres që ata të japin shpjegime konkrete, duke uruar që të jenë objektivë, sepse mendimin tim e kam publikuar edhe me shkrim: Për sa kohë ata janë angazhuar brenda normave ligjore të kohës, unë i quaj edhe UDBashët pjesë të hallkave të atij sistemi, siç ishin udhëheqësit e tyre politikë e ekzekutivë, ta zëmë Ibrahim Rugova, sekretar i partisë që sundonte, Fadil Hoxha, Mahmut Bakalli, Azem Vllasi e deri te gazetarët e "Rilindjes", meqë edhe ajo ishte organ i subjektit politik që sundonte. Pra, nuk jam për përndjekje e dënim vetëm të udbashëve, për sa kohë nuk janë inkriminuar me veprimtari kundërligjore, nëse udhëheqësit e tyre ideologjikë, politikë e sistemorë lavdërohen dhe nderohen. Të parët, UDBashët dhe argatët e tyre, kanë zbatuar ligjet që kanë miratuar të dytët, udhëheqësit e Lidhjes Komuniste, siç kanë zbatuar të njëjtat ligje, të miratuara nga e njëjta parti moniste në pushtet edhe nëpunësit, mësuesit, profesorët, etj. Nga kjo rezulton se edhe oficeri i UDB-së, Avdullah Prapashtica nuk duhet të dënohet para se të dënohen eprorët profesionistë dhe udhëheqësit partiakë të tij, meqë, për atë punë dhe për veprimtari subversive kundër armiqve të shtetit dhe të pushtetit, është shkolluar, është punësuar, është paguar. Ama, tani lavdia për veprimtari patriotike e çlirimtare në atë kohë nuk ka

përse t'i takojë dhe është njerëzore që vetë ai të përmbahet nga këmbëngulja për ta kërkuar. Mbase një lloj lavdie edhe do ta meritonte, po të tregonte të vërtetën. Pra: a e urdhëruan të themelonte "parti komuniste", apo ishte vendim autentik dhe, nëse ishte vendim autentik, përse pikërisht parti komuniste, kur duhet t'i ketë ditur kriteret se parti nuk mund të themelosh me disa individë; pastaj, të dëshmojë si paskësh qenë partia e tij organizuesja e demonstratave të vitit 1981 në Prishtinë, meqë në vitin 1982 zotohej për atë dhe, së fundi, si e gjeti bash Sabri Novosellën që të bashkohen në një organizatë të re; a ka pasur ndërmjetësues, etj.?

Njësoj vlen edhe për kodoshët.

Për veten time jam përcaktuar kështu, sepse populli ynë nuk e ka madhësinë, takatin, luksin dhe interesin të dënojë rreth 80 mijë veta sa kanë qenë të angazhuar në strukturat e shërbimeve të atëhershme në Kosovë dhe as rreth 220 mijë anëtarë e udhëheqës të Lidhjes Komuniste, të cilët përmes Lidhjes së tyre Komuniste kanë ushtruar pushtet monist, që do të thotë kanë miratuar edhe ligjet e atij sistemi, sipas të cilave kanë shërbyer rreth 80 mijë udbashë. Prandaj, pas çlirimit, vetvetiu duhet të ketë ndodhur përcaktimi popullor për paqe kolektive, prandaj pas çlirimit u jepet e drejta edhe udbashëve dhe sekretarëve e udhëheqësve të ish-Lidhjes Komuniste, siç ishte rasti i Ibrahim Rugovës, që të garojnë e të votohen për president e për parlamentarë të Parlamentit të shtetit të Kosovës. Përjashtim nga pajtimi kolektiv duhet të bëjnë vetëm udbashët, policët e hetuesit, prokurorët dhe gjyqtarët e inkriminuar, që në mënyrë të kundërligjshme kanë torturuar dhe kanë dënuar kundërshtarët e tyre politikë dhe, në këtë rast, ata duhet të hetohen e të dënohen sipas ligjeve të atëhershme, nëse do t'i denoncojnë

individualisht viktimat e tyre.

(B.I.:) - Unë e quajta periudha e dy Xhaferëve, sepse në këtë kohë dalin në pah, herë më shumë e herë më pak, Xhafer Shatri dhe Xhafer Durmishi. Të dy Xhaferët nuk kanë qenë dashamirës ndaj teje. Ky i fundit, edhe në një botim të fundit merret më shumë me librin tuaj "Atentatet" dhe me ju, sesa me të vërtetat e një periudhe. Cilët ishin Xhafer Shatri dhe Xhafer Durmishi?

(I.K.:) - Periudha e dy Xhaferëve nuk zgjati shumë ose zgjati tepër shumë, varësisht nga perceptimi dhe këndvështrimi. Teorinë e tij të relativitetit Albert Ajnshtaini ua shpjegon simbolikisht studentëve duke u thënë: më të gjatë janë dy sekonda për njeriun e ulur mbi koftorr (stufë) të skuqur, sesa dy orë ulur me një dashnore. Pra, Xhaferët u grinden dhe u armiqësuan mes tyre dhe Xhafer Durmishi iku ose u përzu nga Lëvizja në vitin 1984, kurse Xhafer Shatri rezistoi deri në vitin 1985.

Asnjëri nga Xhaferët nuk ishte dashamirës ndaj meje, siç nuk isha as unë ndaj tyre. Dhe nuk kishim si të ishim, kur unë kisha dyshime se ata ishin të komanduar të vinin në krye të Lëvizjes pas vrasjes së Jusufit, Kadriut e Bardhoshit dhe që, pos vrasjes fizike, të vrisnin edhe gjithë lëvizjen patriotike e çlirimtare të emigracionit tonë.

Se kush ishin me të vërtet Xhaferët, tani le të flasin të tjerët. Vlerësimet e mia për ta i kam shfaqur dhe po i shpreh edhe tani.

Pamfletin e Xhafer Durmishit, versionin elektronik, të titulluar "Lëvizja e Jusuf Gërvallës", e kam lexuar. E falënderoj për mundin që ka marrë. Atë lëvizje të Sabri Novosellës nuk e legalizon dhe arsyeton edhe nëse Xhafer Durmishi tani e quan "Lëvizja e Jusuf Gërvallës".

Vërtet më vjen keq për Jusuf Gërvallën, si ia ka shpërdoruar emrin ky farë Xhafer Durmishi. Uroj që Xhafer Durmishi të mos jetë vet ai sajues i ca lloj "raportimeve" e "letrave" që Jusuf Gërvalla gjoja ia paskësh dërguar Sabri Novosellës.

(B.I.:) - Xhafer Shatri, më pas një figurë e njohur në atë që quhet „qeveria Bukoshi" e, pas luftës, njëri ndër kritikuesit më të ashpër të saj, do të jetë drejtuesi i parë i Lëvizjes, në mos qofsha i gabuar. Në historikun e saj, historik i cili nuk duhej të ishte i ndërtuar mbi marrëdhëniet që u krijuan pas luftës në Kosovë dhe ndasitë ose pëlqimet e atypëratyshme, nuk ka një përcaktim të qartë të kësaj periudhe. Si erdhi Shatri në drejtimin e Lëvizjes? Cila është, gjithnjë sipas mendimit tuaj, e vërteta e ardhjes së tij në Perëndim?

(I.K.:) - Xhafer Shatri nuk ka qenë asnjëherë drejtues i Lëvizjes së mirëfilltë, por i "lëvizjes" që e kishte sajuar bashkë me Sabri Novosellën dhe Abdullah Prapashticën.

Për arratisjen e tij nga burgu i Prishtinës, ku i kishte mbetur edhe pak kohë për të vuajtur dënimin kapital prej shumë vitesh, qenë bërë spekulime e spekulime. Unë nuk e di të vërtetën, si arriti ai të arratisej. Komplotet e shumta që na bëri, më detyruan të anoj nga dyshimi se atë e kishin komanduar të vinte të na komplotonte, por, paraprakisht, inskenuan arratisjen e tij, që ta kishte si mjet për të manipuluar Hasan Malen (i cili nuk ishte kompetent për t'i dhënë atij autorizim që të përfaqësonte OMLK-në, pavarësisht emocioneve se dikur ky Xhafer kishte qenë bashkëveprimtar me heroin Rexhep Mala), të cilin e shpërdoroi për t'i marrë "autorizimin" që të përfaqësojë OMLK-në dhe pastaj për të sajuar "bashkimin", më saktësisht bashkëngjitjen e 15 majit.

(B.I.:) - Megjithëse nuk ishit i pranishëm në aktin e

dytë të bashkimit, shumë shpejt u gjendët në drejtimin e saj, si anëtar i kryesisë. Në rolin që keni pasur, besoj dhe jam deri diku i bindur, duke e njohur karakterin tuaj, duhet të keni pasur njohuri për ngjarjet, strukturat, vetitë ose veset e atyre që e përbënin Lëvizjen.

(I.K.:) - Në udhëheqësin e "lëvizjes" së Xhaferëve mua më kooptoi Xhafer Shatri. Arsyet e vërteta përse me kooptoi i di më së miri ai. Unë kam menduar se ai me kooptoi për shkak se ata (Xhaferët) nuk i njihnin mërgimtarët e angazhuar, prandaj, po të mos isha edhe unë në atë "udhëheqje", ata nuk do t'u shkonin atyre prapa. Kurse unë iu gëzova atij kooptimi me mendimin se, nëse nuk do të mund t'i mund Xhaferët, të paktën do të jem dëshmitar i komploteve të tyre.

Meqë parashikoja se mund të më ndodhte zënkë e rëndë fizike me ta, në fund të maji të vitit 1982 "ika" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe atje qëndrova deri në dhjetor të atij viti. Qëndrimi dhe angazhimi atje me ndihmuan të përforcoj pozicionin tim në atë "udhëheqje" dhe kështu asaj "lëvizjeje" t'i bëja më vonë gjëmën, për të jetësuar Lëvizjen e themeluar më 17 Janar 1982.

Për komplotet e Xhaferëve besoj kam folur mjaft dhe nuk kam përse të shtoj edhe të tjera fragmente nga komplotet e tyre.

(B.I.:) - Në periudhën pas vitit 1982 e deri në vitin 1985 a keni menduar ndonjëherë se në radhët e organizuara të Lëvizjes ka pasur depërtim edhe të njerëzve të shërbimit të fshehtë serb apo jugosllav? A e keni trajtuar një temë të tillë, qoftë edhe një herë, në mbledhjet e kryesisë ose në takimet e veçanta?

Në fund të fundit, kush e përbënte asaj kohe kryesinë e organizatës?

(I.K.:) - Besoj keni dëgjuar dhe lexuar se Abdullah Prapashtica ka qenë oficer madhor i UDB-së në Prishtinë, pra as argat dhe as spiun i kamufluar. Duke qenë i tillë, ai trilloi "Partinë Komuniste të Kosovës", duke e emërtuar veten si kryetar të saj. Unë dyshoj se ai ka sajuar edhe "arratisjen" e tij në Shqipëri dhe prej andej ka emigruar në Turqi e, më vonë, në Gjermani. Të tjerë të përndjekur mezi ia dilnin të arratiseshin vetëm deri te shteti i parë, kurse këta "të arratisur" gati si turistët e kamur ndërronin vendqëndrimet. Dhe, duhet të jetë "arratisur" tamam kur janë komanduar të themelojnë "lëvizjen" e tyre, ai dhe Sabri Novosella. Do ta quaja me vlerë sikur ai të kishte tradhtuar UDB-në për interesa kombëtare, por komplotet e tij të mëpasshme nuk ma përmbushën këtë shpresë.

Ndërkaq për Sabri Novosellën dhe Xhafer Shatrin, thënë shkurt e shqip, kam dyshuar atëherë dhe dyshoj edhe tani se kanë qenë argatë (shërbëtorë) të UDB-së, po vetëkuptohet, duke u bazuar në veprimet e tyre. Uroj që dyshimet e mia të mos dalin të vërteta dhe të mbetet që veprimtaria e tyre të diskualifikohet vetëm si veprimtari e keqbërësve autentikë, edhe pse shpesh e kam thënë se ndonjëherë dëmet më të mëdha i kanë shkaktuar dogmatikët, sektarët, delirantët, egocentrikët, ahmakët, sesa edhe vetë udbashët, meqë të parët e kishin hyxhymin përtej mundësive, kurse të dytët vetëm për aq sa komandoheshin e paguheshin dhe nuk rrezikonin veten e tyre për t'i shkuar deri në fund.

Në atë "udhëheqje" nuk kemi bërë analiza se kush mund të ishte i infiltruar nga UDB-ja. Xhafer Shatri pati bërë përpjekje për të bindur anëtarët e tjerë se gjoja unë spiunoja "Qendrën Ekzekutive" te Sigurimi Shqiptar.

Fillimisht udhëheqjen, të cilën e emërtuam "Qendër Ekze-

kutive", nëse ia kam qëlluar, e përbënim: dy Xhaferët, Sabri Novosella (edhe pse ishte ende në Turqi), Hasan Mala, Fahredin Tafallari, Saime Isufi dhe unë. Nuk më kujtohet nëse kam harruar edhe ndonjërin. Dy Xhaferët, pos votave të tyre individuale, përfaqësonin edhe nga katër vota të udhëheqësve të organizatave përkatëse në Kosovë (edhe pse ato tashmë nuk duhej të ekzistonin, meqë kishte ndodhur "bashkimi" i tyre).

(B.I.:) - Si u bë shtrirja e saj fillimisht në Zvicër dhe në Gjermani e më pas edhe në shtetet e tjera perëndimore?

(I.K.:) - Nismat e angazhimit të emigracionit të angazhuar patriotik i kishim qysh nga fundi i vitit 1977 në Gjermani, Zvicër, Belgjikë, Austri, Francë, Amerikë etj. Ato erdhën vetëm duke u shtrirë dhe duke u rritur.

Enigmat dhe njerëzit e mirë

(B.I.:) - A ndikoi në qëndrimin e njerëzve vrasja e tre shokëve më 17 janar? Do të thotë: a kishte më shumë nga ata që u trembën, për shkak të drojës së natyrshme të atyre që nuk e kanë synimin për të shkuar deri në fund, apo nga ata që u afruan edhe më shumë nga dëshira për të vazhduar punën e ndoshta edhe për hakmarrje?

(I.K.:) - Pak veta ishin që u trembën, më shumë veta u trimëruan nga pikëllimi, hidhërimi dhe nga ndjenja për hakmarrje. Është e pabesueshme se si një vrasje e tillë, krejtësisht mizore, nuk i largoi, por i forcoi patriotët. Ajo pati një jehonë krejt ndryshe nga sa kishte planifikuar UDB-ja. Për kuadrot e saj dhe për vetë psikologjinë tonë, kjo është e kuptueshme, por edhe më e kuptueshme bëhet kjo në një organizatë klandestine.

(B.I.:) - Jeni larguar nga kryesia e organizatës në të njëjtën ditë me Xhafer Shatrin, megjithëse motivi ka qenë i ndryshëm për të dy. Shatri largohet ose, më saktë, detyrohet të largohet për krijimin e grupimeve, etj., ju për krijimin e problemeve. Cila është e vërteta?

(I.K.:) - Nuk i mbaj mend detajet, me gjasë nga gëzimi që po përzihej Xhafer Shatri. Për përjashtimin tim nga Kryesia e Lëvizjes nuk u merakosa fare, meqë isha i lumtur se nuk janë më pjesë e saj Sabri Novosella, Abdullah Prapashtica, Xhafer Shatri dhe Xhafer Durmishi. Rrjedhimisht Lëvizja po kthehej në identitetin e saj të planifikuar të 17 Janarit 1982 dhe këtë e vlerësoja për fitore të madhe.

(B.I.:) - Kemi lënë pa folur për një personazh të atyre viteve, i cili sa i mbuluar ishte fillimisht me mister, aq i zhveshur ishte më pas nga misteri: Riza Salihu. Rreth viteve 1978-1980 ai botoi një fletushkë, e cila shkoi edhe në Kosovë. Emri i tij është i njohur për shumë gjëra: i kudondodhur-konspirativ, budalla deri në marrëzi - dekonspirues - agresiv i skajshëm, lidhet me gjithçka, por nuk është i lidhur me të vërtetën... Në fund të fundit, ashtu siç e keni njohur, kush është ai?

(I.K.:) - Rizah Salihu? Fillimisht do të thosha se edhe ky është një shqiptar fatkeq, si shumë të tjerë, të cilët pushtimi, varfëria, egoizmi dhe ambicia për të jetuar më lehtë i ka tjetërsuar në shërbëtorë e doras të pushtuesit dhe pushtetit. Ende pa e njohur personalisht dhe pa pasur konfrontime me të, me rastisi të dëgjoj nga studentët kroatë për këtë njeri. Rëndom, me disa studentë kroatë shkonim në të njëjtën kohë për drekë në mensën e studentëve për të bërë biseda të ndryshme. Ata tashmë ishin emigrantë politikë, jetonin në mërgim, si kundërshtarë të Jugosllavisë. Duhet të ketë qenë ndoshta viti 1977, kur një nga

këta kroatë, Damir Petriqi, më pyeti nëse e njihja njëfarë Riza Salihun. Unë iu përgjigja jo, sepse vërtet nuk e njihja. Pastaj ai më rrëfeu incidentin që kishte ndodhur në oborrin e një kishe në Shtutgart, para se të fillonte mesha për kroatët katolikë. Një veprimtar kroat, duke mos e njohur Rizën, i cili paskësh qëndruar aty, i kishte ofruar revistën "Nova Hrvatska", të cilën e botonin kroatët në mërgim. Ky e paskësh refuzuar duke e hedhur në tokë dhe duke e shkelur me këmbë dhe paskësh nxjerrë nga xhepi gazetën beogradase "Novosti" duke i thënë kroatit se ajo ishte gazetë e vërtetë. Kroati kishte nxjerrë thikën dhe në ndjekje e sipër e kishte zënë Rizën dhe e kishte goditur në shpinë. Riza kishte përfunduar në spital. Në spital atë e vizitoi disa herë konsulli jugosllav në Shtutgart dhe e lavdëroi për patriotizmin jugosllav. Për këtë rast kishte shkruar shtypi i Beogradit dhe Damiri m'i tregoi disa nga artikujt që kishte ruajtur. Meqë nga ato shkrime mora vesh se Riza ishte nga Mushitishti e Suharekës, u interesova të pyes bashkëvendës të tij. Edhe nga ata dëgjova se, kur funksionarët komunistë në Kosovë i kishin tubuar emigrantët për t'u folur, siç vepronin rëndom dimrit kur ata ishin për pushime në vendlindje, e kishin lavdëruar rastin e Rizës, si shembull se çfarë qëndrimi duhet të mbajnë patriotët jugosllavë në botën e jashtme.

Po në vitin 1978 Riza Salihu duket të ketë themeluar në Shtutgart grupin komunist "Zëri i Kosovës". Unë pata dyshuar se e kishte themeluar atë pas formimit të Frontit të Kuq Popullor, që të garonte kundër nesh. Më vonë sikur më rezultoi se ishte komanduar për ta formuar që të provokonte hutim çorientues dhe të identifikonte patriotët e interesuar për veprimtari çlirimtare, jashtë dhe në Kosovë. Ky dyshim m'u ngulit edhe nga një informim i Maksut Saramatit, anëtar kryesie në këtë grup. Ai tha se, kur ia kishin burgosur bashkëshorten në Priz-

ren, në vitin 1979, gjatë hetimeve, policia ishte përpjekur t'ia dëshmonte anëtarësimin përmes formularit të anëtarësimit, të cilin e ruante Rizai në arkivin e tij. Por, meqë ajo viktimë nuk e kishte firmosur vetë atë formular, por i shoqi, dhe as që e dinte që ai e kishte anëtarësuar, pa e pyetur fare atë, shpëtoi me dënim vetëm disaditor. Ama, Maksuti po i kërkonte llogari udhëheqësit të tij, Rizait, pse ia kishte përcjellë policisë në Prizren atë formular.

Në verën e vitit 1978, kur shkova për punë te dhëndri im, Ramush Kastrati, i cili punonte në Plohingen (Plochingen), afër Shtutgartit, u njoha me Hysen Gegën. Shumë shpejt u bëmë shokë. Ndërkohë ai me njoftoi se në Shtutgart kishin formuar grupin në fjalë me Riza Salihun dhe të tjerë. Mua m'u kujtuan informatat që kisha për Rizën, por Hysenit nuk ia thashë. Mendoja se do të më keqkuptonte. Hyseni organizoi një takim mes nesh dhe qysh në takimin e parë bëra fjalë me Rizën, sepse sjelljet e tij më lanë përshtypjen e një udbashi diletant.

Në dhjetor 1979 kur u arratis Jusuf Gërvalla, deri atëherë, sidomos për emigrantët, ai ishte fare i panjohur. Hysen Gega, unë dhe bashkëveprimtarë të tjerë u angazhuam ta prezantonim Jusufin me madhështi, sepse ishte intelektuali i parë që njihnim, me kualifikime të larta, që po angazhohej në veprimtari çlirimtare, klandestine.

Ndërsa ne po e bënim këtë, Riza kishte filluar të dezinformonte se gjoja Jusufin e kishte dërguar UDB-ja si spiun të sprovuar për të penguar veprimtarinë revolucionare të grupit të tij.

Që të mos zgjatem, ndërkohë, në fillim të vitit 1980, Riza i komunikon Hysen Gegës "në emër" të "Grupit Komunist" vendimin për ta vrarë Jusufin, me arsyetimin se ishte udbash i

rrezikshëm. Për fat, Hyseni kishte një identitet dhe personalitet tejet të formuar dhe të arsyeshëm, prandaj i dha vetes kohë për t'u informuar dhe për t'u bindur nëse Jusufi ishte ose nuk ishte vërtet udbash. Në kuadër të përpjekjeve për t'u informuar Hyseni me pyet edhe mua për Jusufin. Me atë rast më tregoi edhe për urdhrin që i kishte dhënë Riza. Për këtë e informuam edhe Jusufin dhe Bardhin. Disa muaj inskenuam sjellje që Riza nuk i dinte, sepse donim të bindeshim se cili ishte vërtet ai njeri. Kur gjykuam se inskenimi ishte i mjaftueshëm, organizuam një ballafaqim në të cilin merrnim pjesë Jusufi, Bardhoshi, Hysen Gega, Maksut Saramati dhe unë. Këtë ballafaqim e bëmë në konviktin e imigrantëve që punonin në firmën ITT në Eslingen (Esslingen), ku punonte Hyseni. Ballafaqimi qe dramatik. Të gjithë u bindëm se Riza i shërbente UDB-së. Në përmbyllje të ballafaqimit, me lutjen këmbëngulëse të Jusufit, Riza shpëtoi pa u ndëshkuar siç kishim planifikuar, kurse vetë Riza, si mirënjohje, u zotua se nuk do të merrej më me përhapje të dezinformatave diskredituese kundër Jusufit. Më pas u mor vendimi për të shpërndarë "Grupin Komunist". Riza nuk iu përmbajt zotimit dhe sërish zuri të shpifte publikisht se Jusufin e kishte dërguar UDB-ja.

Sa herë zihej ngushtë, Riza improvizonte rolin e skizofrenit. Këtë rol luajti edhe para trupit gjykues, në vitin 92, kur po i bëhej gjyq në Shtutgart, si i akuzuar për vrasje të Jusufit, Kadriut e Bardhoshit.

(B.I.:) - Jusufi, sipas kujtimeve, është takuar një herë me Riza Salihun. Kjo ndodhi në verën e vitit 1980. Ishte një bisedë pa fryt, që u kthye në dëshpërim për Jusufin dhe në revoltë e hakmarrje për Riza Saliun. Pas këtij takimi, Riza takohet me Hysen Gegën, një figurë e njohur politike, njëkohësisht miku juaj. Keni qenë në dijeni, si më thatë, për "detyrën" që Riza

Salihu i kishte dhënë Hysen Gegës për vrasjen e Jusufit. Si u zhvilluan ngjarjet më tej? Duket si një kthesë në rrëfimin tonë dhe në bisedën tonë, por, duam apo nuk duam, na bie shpeshherë të kthehemi pas për të qartësuar atë që do të vijë.

(I.K.:) - Mendoj se kësaj pyetjeje iu përgjigja, sado që telegrafikisht.

Ndoshta është vendi të informoj se hetimet kundër Rizës gjermanët i riaktivizuan në vitin 1992, pasi shteti gjerman nuk kishte më interesa për të përkrahur Jugosllavinë, e cila kishte filluar të shpërbëhej. Unë mora pjesë në atë proces gjyqësor si dëshmitar kundër Riza Salihut. Gjykata e liroi Rizën nga akuza për vrasje në mungesë të provave, pasi vuajti ndoshta një vit e gjysmë burg. Kryehetuesi dhe unë biseduam se ai ishte njëri nga dorasët, por gjykata nuk kishte të drejtë t'i shfrytëzonte si dëshmitarë nipat e Riza Salihut, meqë kur ka ndodhur vrasja, ata ishin të mitur. Ata e kishin informuar kryehetuesin se në momentin që ishte bërë vrasja, Riza nuk kishte qenë të motra e tij, që ai po e përdorte si alibi.

Të interesuarit mund të informohen për atë gjykim nga materialet e arkivuara në gjykatën e Shtutgartit.

Interesant është fakti se Hysen Gërvalla, pasi u botua romani "Atentatet", e ka takuar Riza Salihun dhe, kur i kishte kërkuar të prononcohej për akuzat që i bëheshin atij përmes romanit, ai i ishte përgjigjur se vazhdonte të besonte se Jusufi ka qenë udbash. Meqë këtë po na e thoshte vetë Hysen Gërvalla, vëllai im Qerimi, i pranishëm në atë ndejë rasti, ku kishte edhe të tjerë, e pyeti atë se cili ishte reagimi i tij ndaj akuzës që Riza i kishte bërë Jusufit? Hyseni u përgjigj se nuk kishte bërë ndonjë reagim, pos që e kishte pranuar si mendim të tij të lirë.

(B.I.:) - Në një intervistë, pas botimit të librit "Atenta-

tet", keni deklaruar se e njihni vrasësin e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës. Kush është ai dhe pse e afishuat kaq vonë dyshimin tuaj, kur, për më tepër, për shumë kohë, ju jeni anatemuar për këtë ngjarje? Anatemimi vazhdoi edhe pas kësaj interviste, përmes një emri të njohur nga ju dhe ai është Xhafer...

(I.K.:) - Unë vazhdoj të dyshoj se njëri nga dorasët është Riza Salihu, kurse urdhërdhënës ishte, gjithsesi, Beogradi. Beogradi duhet ta ketë përzgjedhur Rizën për vrasës, për shkak se ai e njihte terrenin dhe, edhe nëse do të kapej a do të zbulohej, Beogradi do të shfajësohej me shpjegimin se janë vrarë kundërshtarët politikë shqiptarë ndërmjet tyre.

Si provë konkrete për të përforcuar dyshimin tim kam vlerësuar kryesisht foton 'fantom' që e kishin prodhuar specialistë gjermanë në bazë të rrëfimeve të fqinjit gjerman të Jusufit dhe Bardhoshit, i cili vrasjen e kishte vështruar nga ballkoni i shtëpisë së tij, kati i dytë, në një largësi prej rreth 20 metrash, sado që ka qenë duke rënë borë. Pastaj prova më kokëfortë për mua ishte informimi nga kryehetuesi, i cili ishte i bindur se alibia e sajuar nga Riza nuk qëndronte.

Sa për shpifjet, anatemimet e shumta ndaj meje, tepër idioteske, barbare dhe armiqësore, ato kanë ndodhur, por mua nuk më kanë lënduar shumë. Njihja veten time, siç dija se ato ishin pjesë e luftës speciale të shërbimeve të Beogradit e të Kosovës kundër veprimtarisë sime çlirimtare. Ndoshta nuk e teproj ta them hapur dhe shkoqur, se më se shumti me ka shkaktuar mërzi, hidhërim, dhembje kur më anatemonin vëllezërit e Jusufit dhe Bardhoshit dhe ndonjë tjetër i krahut tonë çlirimtar, të cilët mundohesha t'i arsyetoja e t'i toleroja si viktima të luftës speciale të UDB-së.

Po të mos kisha lexuar për luftën speciale të UDB-së, sigurisht, do të isha çmendur, do të kisha vrarë veten ose ndonjë shpifës anatemues dhe pjesën më aktive të jetës do ta kaloja në burgje.

Sa për atë farë Xhaferi, nuk di për cilin e ke fjalën, por nuk gaboj nëse them se ose ishte udbash dhe, si i tillë, pjesë e luftës speciale ose argat mjeran, i mashtruar dhe i manipuluar, një nga dhjetëra të tjerë, për të cilët më vjen keq pse ishin aq të mjerë dhe naivë.

(B.I.:) - Fjalën e kisha për Xhafer Durmishin, por u mërzita duke ia përmendur emrin tash e parë. Thashë ta lë një herë pa mbiemër, por pastaj m'u kujtua një thënie e lashtë: "të humbtë emri" dhe këtë nuk e dua për askënd, ndaj edhe e bëj sqarimin. Mund të dalin rrugës edhe Xhaferë të tjerë, rruga është e madhe e cilido ka të drejtën të hedhë gurë, sidomos kur nuk ka ide të hedhë. Por le të mos vazhdojmë më tej me Xhaferët. Ata shkuan e vanë, mjerisht, për një periudhë, ishin në krye e, lumturisht, ajo periudhë nuk zgjati shumë. Nuk do të prononcohesha kaq gjatë dhe kaq haptas, sidomos ndaj njerëzve me të cilët nuk kam pasur kontakte e nuk kam punuar, nëse në arkivin e organizatës nuk do të ishin mjaft materiale, të cilat mbështetin pohimet e tua dhe nëse këto pohime nuk do të ishin të njëjta, për ngjarje të caktuara, edhe me pohime që janë bërë nga drejtues të tjerë të Lëvizjes. Pra, le ta lëmë këtë periudhë dhe, nëse ndonjëherë do t'u kthehemi gjërave të veçanta të saj, do të jetë një rikthim i përkohshëm, por edhe i detyruar.

Janë disa momente të kësaj periudhe të cilat, megjithëse janë sqaruar herë pas here, si duket ato nuk kanë qenë të mjaftueshme, janë ringritur, herë-herë si një mundësi informacioni, por më shpesh si reagim ndaj librit tuaj "Atenta-

tet". Për mua bashkimi i grupeve nuk vjen në një ditë ose vetëm nga një dëshirë. Gjithçka ka një parathënie. Por ka edhe ngjarje të cilat, duke dalë në mesin e udhës, duhen qartësuar. Duken gjëra të shkuara, mirëpo, në një mënyrë ose në një tjetër, mbi to ngrihet një e ardhme.

Gazeta „Bashkimi" ishte e njohur, por ajo u bë edhe më e njohur sidomos në numrat e fundit të saj, edhe për shkak të Zotërimit në faqet e saj të mendimit dhe të artit krijues të Jusufit. Si ishte historia e këtij bashkëpunimi? Duhet sqaruar edhe një detaj, i cili është vënë në dukje nga të tjerët: ankesa e Jusufit se ju dhe Hysen Gega nuk i jeni përgjigjur atij për shpenzimet e botimit. Më pas ndodhi arrestimi në Kosovë i Hysen Gegës, i cili u nis me Sadik Blakajn, figurë të cilën ju e keni cilësuar si bashkëpunëtor i shërbimit të fshehtë serb. Si ndodhi në të vërtetë? Pse u lejua Hyseni të nisej për në Kosovë me një njeri të tillë?

(I.K.:) - Sigurisht, niveli i "Bashkimit" u rrit edhe me kontributin që dha Jusufi, por meritë kishin edhe bashkëveprimtarët që e shpërndanin, që e futnin fshehurazi në Kosovë dhe që e propagandonin.

Qysh nga dhjetori i vitit 1979 deri më 17 Janar 1982 Jusufi nuk ka pasur bashkëveprimtari më të ngushtë dhe më intensive me asnjeri sesa me mua. Ndonjëherë jemi zënë, jemi hidhëruar, zemëruar, përplasur, siç mund të ndodh në mes të bashkëpunëtorëve, ngaqë vepronim në rrethana të rënda, ku nuk na linin të qetë dezinformuesit, spiunët, keqbërësit, por edhe për shkak të konfrontimit të ideve e të koncepteve organizative e ideopolitike. Besoj kaq mjafton kësaj radhe, të tjerët le të hulumtojnë, le të gërmojnë, le të shpifin, le të dezinformojnë, le të falsifikojnë "letra" e "ra-

porte", sikur i paskësh shkruar Jusufi. Për mua rëndësi ka që e quaj veten të nderuar të kemi qenë bashkëveprimtarë dhe se bashkëveprimtaria jonë ka dalë ngadhënjyese.

Sa për dezinformatën se unë dhe Hysen Gega i paskëshim premtuar Jusufit për ta financuar shtypjen e "Bashkimit", por nuk e kemi realizuar premtimin, nuk qëndron, meqë atë nuk e ka shtypur Jusufi, por e kam shtypur unë në shtypshkronjën e Lidhjes se Studentëve të Universitetit ku studioja. Ai është marrë me shkrimin e disa artikujve, me redaktimin e kryeartikujve ideopolitik që i shkruaja unë, lekturën dhe faqosjen.

Hysen Gega ishte person tepër sovran, prandaj nuk kam mundur ta ndaloj të mos shkonte bashkë me UDBashin Sadik Blakaj, edhe pse pata bërë përpjekje. Ai e ka shpjeguar disa herë atë ndodhi dhe mund ta pyesni sërish atë. Mjafton të them se Sadiku ia arriti ta mashtrojë Hysenin dhe gabimin ai e pagoi shtrenjtë. Por, edhe për ne, arrestimi i Hysenit ishte një ngjarje e rëndë, pasi ai ishte dhe mbetet një njeri i devotshëm, besnik, pa fjalë të mëdha, por me punë të realizuara, tepër me vlerë.

(B.I.:) - Për të mbyllur këtë cikël, në qendër të të cilit, jo rastësisht, janë tre heronjtë e njohur të Kosovës, pa dashur të bëj dallim mes tyre, por duke u ndalur në cilësitë e tyre të asaj kohe, më intereson mendimi juaj, se cili prej tyre, me gjithë të përbashkëtat, kishte stofin e një udhëheqësi të ardhshëm dhe autoritetin e duhur në luftën që do të niste 15 vjet pas rënies së tyre?

(I.K.:) - Kësaj pyetjeje nuk i përgjigjem me dëshirë dhe shpresoj të më mirëkuptoni pse do të përmbahem.

Ndoshta mjaftoheni nëse ju jap një vlerësim subjektiv për kohën. Kadriu kishte përgatitje më të avancuar politike e or-

ganizative dhe ishte më orator, ndërsa Jusufi kishte përgatitje më të avancuar letrare, publicistike, muzikore, sesa Kadriu. Si do të zhvilloheshin e do të aftësoheshin ato personalitete gjatë viteve pasuese këtë nuk mund ta di, pos të them se bazat i kishin tejet solide dhe mund të bëheshin udhëheqës të shquar. Në asnjë rrethanë, megjithatë, nuk mund të ndodhte kurrë të bëheshin dështakë. Ndoshta edhe do të mundeshin nga armiku, por ishin ndër njerëzit që kurrë nuk mund të humbisnin nderin e tyre. Për ta është i denjë perifrazimi: "i humbëm të gjitha, edhe jetën, por nuk e humbëm nderin".

(B.I.:) - *Në lindjen dhe ringritjen e Lëvizjes Populllore, në marrëveshjet e në mosmarrëveshjet, në bisedimet e ndërprerjet, në dakordimet dhe në hatërmbetjet, në ngritjen e versioneve dhe në deklasimin e njerëzve, në gjithë atë që po ndodhte, nganjëherë në sfond, nganjëherë më dukshëm, janë punonjësit e shërbimit diplomatik të shtetit shqiptar, sidomos në Vjenë dhe në Stamboll. Janë përcaktuar emra, misione, detaje, janë thënë gjëra dhe janë përgënjeshtruar. Ndonjëri prej tyre nuk ka qenë dashamirës ndaj teje, për të mos thënë se kishte raste kur moskuptimet ishin të dukshme. Përse, cili konkretisht dhe cili ishte roli i diplomacisë shqiptare, sidomos në lëvizjen ilegale të asaj kohe?*

(I.K.:) - Gjithë veprimtarinë e përfaqësive diplomatike shqiptare në Evropë dhe në Amerikë nuk e njoh, prandaj nuk jam kompetent për ta vlerësuar. Studiuesit e interesuar mund ta gjejnë atë në arkiva, në Tiranë.

Kontaktin e parë duhet ta kem pasur ndoshta në fund të vitit 1977, meqë nuk kam mundur të ruaj shënime për data të sakta. Në konvikt me patën vizituar Simon Qirici dhe Sazan Beu. Për të parin jam i sigurt, për të dytin nuk jam i sigurt, nëse ishte

Sazani apo Lirim Shyti, apo ishin edhe këta të dy. Ata ishin të angazhuar në ambasadën shqiptare në Vjenë. Sapo u takuam, më bënë qortime pse në gazetën "Bashkimi" kishim lavdëruar sistemin komunist në Shqipëri dhe udhëheqësin Enver Hoxha dhe më kështilluan të kufizoheshim vetëm në kërkesa për barazi nacionale brenda Federatës së Jugosllavisë, etj. Ato qortime dhe këshilla kanë pasur ndikim serioz tek unë gjatë reflektimeve të pastajme, edhe pse aty për aty nuk i mirëprita.

Më ka rastisur të takoj ambasadorë dhe diplomatë të shumtë, por nuk kemi pasur komunikim të shtruar. Besoj dy raste kanë qenë skandaloze, ku na kanë ndodhur grindje të rënda: njëra në prill të vitit 1981 në ambasadën shqiptare në Vjenë dhe tjetra në maj të vitit 1982, në misionin shqiptar pranë OKB-së, në Nju-Jork.

E pranoj, për ta nuk duhet të kem qenë fort i përshtatshëm, qoftë për nga paraqitja fizike, qoftë ideopolitike. Kurse çfarë kanë raportuar ata për mua në Tiranë, nuk jam interesuar të informohem. Disa nga ata i kam takuar gjatë vitit 1991-92 në Tiranë dhe kemi rikujtuar me kënaqësi të kaluarën, duke shfaqur respekt e miqësi të ndërsjellë. Disa të tjerë ose nuk rronin, ose nuk dëshironin të më takonin. Me pati mbetur merak, pse nuk po e takoja Simon Qiricin, për të cilin më thoshin se kishte emigruar në Amerikë. Ndonjëri me thoshte se e kishte marrë CIA në Amerikë për ta strehuar. Cila qe e vërteta nuk e mora vesh dhe nuk u angazhova me përkushtim për ta sqaruar.

Përgjithësisht unë ruaj respektin për shumicën prej tyre.

(B.I.:) - Më ka intriguar gjithnjë udhëtimi juaj ilegal në Kosovë, në vitin 1979, takimi juaj me Hysen Gegën dhe me Nezir Gashin, pastaj prania juaj në një ngjarje në familjen e vëllezërve Xhemajli në Komogllavë të Ferizajt... Si ndodhi e gjithë

kjo? Përse shkuat në Kosovë?

(I.K.:) - Në verën e vitit 1979 se si më shkrepi për të shkuar në Kosovë, gati rastësisht.

Gjatë pushimit veror po punoja me Safet Azizin e Davidovcit të Shtimës në një kantier ndërtimi në rrethina të Vupertalit. Rëndom, gjatë pushimeve semestrale verore dhe dimërore punoja që të kisha të holla për studime dhe për veprimtari çlirimtare. Ai më tha se do të shkonte me makinë në Kosovë. Unë e pyeta nëse mund të më merrte me vete. Ai pranoi, edhe pse e dinte se ishte me rrezik. Gati sa nuk ia thashë aty për aty miratimin përfundimtar. Kisha muaj që po mendoja për t'u kthyer në Kosovë. Në këto mendime ndikoi shumë një letër që më kishte dërguar vajza e djalit të axhës, Imerit, të cilën unë e kisha tepër për zemër, edhe pse ishte shumë vite më e re sesa unë. Në shtëpi e thërrisnim Liri, kurse, zyrtarisht, ishte e regjistruar me emrin Sofi. E kisha lënë të sëmurë nga leucemia. Para një muaji më kishte dërguar një letër 'terrorizuese', në përmbyllje të së cilës ishte fjalia: "Nuk po ia dal dot të vdes, pa të përqafuar!" Gjykoja se duhej të sakrifikoja për t'ia bërë qejfin. Pastaj, me veprimtari të organizuar patriotike nuk isha i kënaqur dhe, për shkak të dëshpërimit, mendoja të kthehesha në Kosovë. Gjykoja se veprimtaria nuk ishte aq e vëllimshme për të më dënuar shumë rëndë, nëse do të më kapnin në Kosovë. Njëkohësisht doja të kontaktoja veprimtarë të organizuar, siç qe rasti i takimit tim me Nezir Gashin dhe të tjerë në Komogllavë të Ferizajit dhe Mushitishtë të Suharekës, që nuk e quaj të nevojshme tani t'i përmend me emër e biemër.

Për të mos e zgjatur, si një njeri që i pëlqen të rrezikojë, siç isha, vendosa të udhëtoja për në Kosovë. Pata siguruar një pasaportë goxha të përshtatshme, të falsifikuar mirë.

Arritëm në Kosovë pa ndonjë qeder. Së pari vizitova Lirinë në Klinikën universitare në Prishtinë dhe u binda se sakrifica që bëra për ta takuar atë ishte tepër njerëzore. Pak kohë më pas ajo vdiq dhe unë u pikëllova vërtet shumë.

Në Kosovë takova bashkëveprimtarin Malush Ademajn, i cili ishte për pushime në vendlindje në Katund të Ri, buzë Pejës, kurse në Gjermani punonte në Vupertall (Wuppertal). Shkuam së bashku për të vizituar vëllezërit Xhemaili në Komogllavë të Ferizajt, meqë ai ishte takuar me ta më herët.

Kur ishim në Komogllavë rastisi të vdiste babai i vëllezërve Xhemajli, Muharremi. Në varrimin e tij më lutën që të flisja unë. Fola dhe u dekonspirova. Që nga ai çast policia m'u vu pas për të më kapur, por ia arrita të arratisem.

(B.I.:) - Më ka mahnitur gjithnjë ideja e këmbënguljes së stërpërsëritur për t'u rikthyer tek emri juaj, sa herë që keni bërë një ide publike. Pas botimit të romanit "Atentatet" ju u ndodhët edhe një herë në dy kahe: në përgëzimin e shumë prej atyre që i kishin përjetuar ngjarjet bashkë me ju, si Saime Isufi apo Mustafë Xhemajli, por edhe në ciklimin e radhës së sulmit ndaj jush, nëse mund ta quaj kështu. Mes të tjerave, në një material, i cili po përhapet tashti, nuk e di nëse është i saktë, bëhet fjalë për lidhjen fisnore me Ramë Nikçin ose Ibërdemaj, i cili, siç e cilëson Xhafer Durmishi, me siguri "analisti" më i zellshëm i romanit tuaj, ishte agjent i UDB-së.

(I.K.:) - Pas botimit të romanit "Atentatet" ka pasur vërtet reagime të llojllojshme dhe, me thënë të drejtën, më kanë gëzuar. Ato ishin një dëshmi se nuk e kisha shkruar vetëm sa për ta shkruar. Pas dy muajve romani u shit dhe shpesh ndihem keq kur të interesuarit e tjerë e kërkojnë dhe unë nuk kam asnjë kopje. Shtëpia botuese "Toena" e Tiranës ka premtuar ta ribotojë.

Tani ka shkruar një reagim të gjatë Xhafer Durmishi, ish-bashkëveprimtar, njëkohësisht ish-kundërshtari imi. Sa për shembullin që sollët ju për sqarim, unë nuk do t'i isha hidhëruar fare Xhaferit, sikur të kishin qenë shpifje të tij autentike, ngaqë ndaj tyre kam krijuar imunitet. Tani më shqetëson fakti se ato shpifje i vishen Jusufit, të cituar në bazë të një "raporti" që gjoja ai i paskësh dërguar Sabri Novosellës. Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësimin se atë "raport" nuk e ka shkruar fare Jusufi, meqë nuk është në fahun, në germën dhe në frymën e tij. Po ta kishte shkruar vërtet ai, nuk do të ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant.

Kohë më parë, në Maqedoni, më ka rastisur të ballafaqohem me materiale të falsifikuara, që ca kriminelë i shpërndanin për "dosje". Ishin sajuar për të diskredituar Ali Ahmetin, Fazli Veliun, Musa Xhaferin, bashkëveprimtarët tanë shumëvjeçarë. Edhe ky "raport" më ngjan me ato falsifikime. Mjafton të them se Jusufi e ka ditur shumë mirë kush ishte Ramë (Idriz) Iberdemaj, prandaj nuk ka pasur nevojë të hamendësohej nëse ishte Ramë Iberdemaj apo Ramë Nikçi. Ai ka qenë i informuar për Ramë Iberdemajn, meqë është shkolluar në Pejë dhe e ka ditur se Rama ishte djali i axhës së nënës sime.

Në vitin 1980, në Mynih, unë dhe Jusufi patëm një zënkë serioze. Unë kisha shkuar aty me katër bashkëveprimtarë për të marrë pjesë në tubimin e klubit "Rilindja" që të pengonim zgjedhjen e Ganisë, djalit të Ramë Iberdemajt, si kryetar të atij klubi famëkeq. Asnjëri nga ne nuk e dinte nëse do ta takonim në klub Bali Rexhbogajn nga Bllagaja e Pejës. Pas tubimit ai këmbënguli të na merrte mysafirë. Sapo arritëm para pallatit ku banonte Baliu, takuam Jusufin dhe Bardhoshin. Ata ishin aty për vizitë te Misin Mavraj i Staraderanit të Istogut. Paprit-

mas Jusufi dyshoi mos po e survejoja. Në këtë aspekt ai ishte tejet i papërvojë dhe ndonjëherë bëhej si fëmijë. I shpjegova pse ishim në Mynih dhe përse ndodheshim pikërisht aty dhe se survejimi nuk bëhej në atë mënyrë. Pra, e mori vesh se kishim vajtur të pengonim zgjedhjen si kryetar klubi të djalit të Ramë Iberdemajt. Edhe më herët, edhe aty, edhe më vonë, kemi biseduar bashkë për dyshimet ndaj Ramë Iberdemajt, se kishte qenë argat i UDB-së dhe Jusufi, si gazetar, i shkolluar në Pejë, dinte për ato dyshime. Tashmë dinte edhe për lidhjet tona farefisnore. Dihet, dajën nuk e zgjedh dot. Jusufit nuk do t'i kishte shpëtuar kjo lajthitje, edhe po të kishte qenë i pabesë dhe intrigant dhe të kishte përpiluar të tillë "raport" kaq diskreditues, së pari për veten e tij. Pra, kjo lajthitje është prodhuar nga falsifikuesi, i cili ngjan të jetë vetë Xhafër Durmishi, meqë e citon rreth 100 herë atë "raport" në "librin" e tij, me titull hileqar e intrigues: "Lëvizja e Jusuf Gërvallës".

Në të njëjtin "raport" është edhe një lajthitje tjetër për Sadik Blakajn, që e ka prodhuar falsifikuesi i painformuar. Jusufi ka qenë i informuar saktësisht për të, e ka njohur edhe personalisht dhe nuk do t'i kishte raportuar "udhëheqësit" Sabri Novosella kaq dezinformueshëm. Për pjesët e tjera të "raportit" e "letrave" të Jusufit, gjithsesi të falsifikuara, ndoshta do të reagoj më shtruar në një rast tjetër.

Po ta kishte publikuar këtë "libër" Xhafer Durmishi para se ta kisha shkruar romanin "Atentatet", sigurisht, unë do ta kisha mënjanuar Ramë Iberdemajn si personazh të romanit, për inat të Xhaferit. Prandaj, edhe për inat të Xhaferit, me këtë rast dua t'u kërkoj falje fëmijëve të respektuar të dajës Ramë, pse e kam diskreditуar atë në roman si të dyshimtë për bashkëpunëtor të UDB-së. Vetëm për Haki (Ramë) Iberdemajn, të cilin një spiun

i UDB-së e vrau në Bruksel, sigurisht që kisha dhënë një tren me xhafera që të mos e vrisnin, sepse e kishte dëshmuar veten në demonstratat e vitit 1981 në Prishtinë dhe gjatë angazhimit të tij patriotik në Bruksel si trim e patriot i devotshëm!

Ringritja dhe sherret

(B.I.:) - Pas vitit 1982, sidomos pas majit të këtij viti, u ngritën strukturat e para, deri diku të organizuara të Lëvizjes. Ju thatë se vrasja e tre shokëve, megjithëse kishte qenë një dhembje e madhe, nuk i kishte ndaluar njerëzit për të qenë pranë strukturave të organizatës. Ka një diferencë mes disa prej drejtuesve, si i përcaktoni ju, dhe njerëzve të thjeshtë, të cilët i marrin punët seriozisht. Disa prej tyre do të vazhdojnë deri në fund, disa do të ndalen rrugës, por kjo është një gjë e mëvonshme. Pyetjet e mia janë: Si u ngritën këto struktura? Ku ishin problemet? Si u ndërtuan marrëdhëniet mes njerëzve që drejtonin organizatën dhe shkëputjet e para? Si ndodhi largimi i "rrobaqepësit", pasi, nëse nuk gabohem, ai është i larguari i parë nga strukturat drejtuese?

(I.K.:) - Pas "bashkimit" të 15 majit 1982 në mes "përfaqësuesve", tashmë të *Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi* ose të *Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi*, të themeluar në Turqi, më 17 shkurt 1982, në mes të "përfaqësuesve" Sabri Novosella dhe Abdullah Prapashtica, ende pa u tharë ngjyra e nënshkrimeve të tyre, filluan të zihen për emrin. Pastaj u shtua edhe "përfaqësuesi" Xhafer Shatri. Me këta komplotistë nuk ia dolëm të krijonim strukturat e përbashkëta udhëheqëse të organizatës së dalë nga këto "bashkime". I pari që u përzu ose u vetëlargua nga "bashkimi" i 17

shkurtit ishte Avdullah Prapashtica dhe vartësit e tij. Në fund të majit 1982 unë "ika" për në Amerikë dhe atje ndenja deri në dhjetor 1982. Them ika, sepse ishte gjendje e tensionuar mes meje dhe komplotistëve. Krerët që kishin bërë "bashkimet" nuk kishin njohje dhe ndikim në radhët e bashkëveprimtarëve të angazhuar deri atëherë. Pastaj komplotistët nuk kishin mirëkuptim as mes tyre. Ata ishin të përqendruar të na imponoin që të merreshim vetëm me grindje të brendshme dhe këtë mundësisht ta shtrinim sa më gjerësisht e sa më thellë.

Shkova në Amerikë edhe sepse isha ftuar nga disa patriotë të Malësisë së Madhe (pranë Tuzit) dhe sepse emigracioni reaksionar, siç e quanim atëherë, po pengonte gjallërimin e lëvizjes patriotike për Kosovën-Republikë, me diskreditime banale se të rinjtë që kishin bërë demonstratat e Pranverës së vitit 1981 në Prishtinë, ishin "kuqaloshë të Enver Hoxhës".

Sapo arrita atje u përballa me vështirësitë e para, të iniciuara nga komplotistët. Në pritjen e parë që më bënë malësorët në banesën e Nue Camajt, të pranishmit me informuan me krenari se kishin filluar aksion të gjerë për të grumbulluar ndihma për Musa Hotin. Unë atëherë Musa Hotin e vlerësoja si kriminel dhe udbash të kalibrit të lartë. Kohë më parë, në Bruksel, në një bar nate, rreth orës tre të mëngjesit, ai kishte vrarë një bashkëpunëtor të tij. I vrari ishte nëpunës në ambasadën jugosllave në Bruksel. Ai dhe Musa shisnin bashkërisht pasaporta jugosllave dhe bashkëvepronin në veprimtari të tjera kriminale. Me gjasë se i kanë bërë hile njëri-tjetrit gjatë ndarjes së fitimeve, Musa e kishte vrarë bashkëpunëtorin e tij. I vrari vinte nga Bosnja dhe Hercegovina. Menjëherë naivët, mjeranët dhe argatët e UDB-së nxituan ta komentojnë e ta vlerësojnë atë krim, secili në mënyrën e tyre. Kurse Sabri Novosella e kishte shpër-

blyer Musa Hotin me letrën që i kishte dërguar në burg, duke e kooptuar atë në udhëheqje të "Lëvizjes së Jusuf Gërvallës". Përafërsisht edhe Xhafer Shatri bënte thirrje publike që shqiptarët t'u dërgonin telegrame organeve belge për ta liruar nga burgu "Avni Rustemin" e kohës, - siç e madhëronte ai Musën.

Kur i pyeta se kush i kishte motivuar dhe i kishte bindur që të mblidhnin ndihma për Musa Hotin, ata më treguan kopje shkresurinash, të cilat ua kishte dërguar Musa nga burgu, ku shihej vendimi i Sabri Novosellës, i shkruar me kaligrafi prej gjysmanalfabeti. Për të mos e zgjatur, në fund i kështillova malësorët t'ua kthenin donatorëve ndihmat që kishin dhënë. Madje u bëra aq i pacipë e vulgar, sa u thashë "më hallall i keni t'i shkërdheni vetë të hollat tuaja me prostituta, sesa t'ia dërgoni Isës, vëllait të Musa *Hotit*, që t'i shkërdhente dhe të luante ai bixhoz me ndihmat e tyre". Sigurisht që aksioni u ndërpre.

Një argat kriminel i UDB-së, me nder me thënë, Haki Terpeza, kishte përhapur lajmin në emigracionin e Nju-Jorkut me rrethinë, herë duke shpifur se me kishte dërguar UDB-ja dhe herë se më kishte dërguar Sigurimi shqiptar, varësisht nga njerëzit me të cilët kishte folur. Kërkova ballafaqim me të, pak a shumë në stil kaubojsh të filmave western. U mundua të argumentonte se informatat që unë do të shkoja në Amerikë dhe që isha udbash i kishte nga një udhëheqës i "Lëvizjes së Jusuf Gërvallës". Shkurt e shqip, unë nxora koburën kur shau Shqipërinë dhe ia vura në ballë, duke u thënë disa të rinjve të pranishëm në atë lokal ta tërhiqnin zvarrë nëpër lokal atë pleh, që t'ia shkërdhenim "trimërinë", meqë mburrej me faktin se i kishte shërbyer UDB-së si diversant në Shqipëri.

Xhafër Shatri me pati "urdhëruar" të shkoja në "kongresin" e *Vatrës* që duhej të mbahej në korrik të vitit 1982, për

ta përshëndetur në emër të "Lëvizjes" së Xhafer Shatrit. Ma kishte dërguar edhe tekstin e fjalës përshëndetëse. Shkova. Qysh në fillim të "kongresit" disa krerë, që ishin edhe krerë të Legalitetit, garonin mes tyre për t'u bërë udhëheqës të *Vatrës*, duke u vetëlavdëruar, fare pa u skuqur e pa u zverdhur se kush kishte lidhjet më të mira me Beogradin. U tmerrova. Kur më lajmëruan që të dal në foltore për të përshëndetur, nxora letrën që më kishte dërguar Xhafer Shatri, me njoftimin se isha porositur që ta lexoja, por unë, në vend që ta lexoja atë letër, fola shkurt e shqip se po me vinte keq për personalitetet e shquara, për Nolin e Konicën, se në dorë të kujt paska rënë *Vatra* dhe si qenka katandisur. Pasi i mallkova dhe i shava nga foltorja, zbrita në drejtim të daljes. Shokët që më shoqëronin u ngritën, por u ngritën edhe shumë vatranë të vjetër dhe të devotshëm që më përqafuan. Dolëm jashtë dhe kështu u prish "kongresi".

Me patriotin e Malësisë së Madhe, Kolë Gojçin, shkuam për vizitë nga Detroidi në Ilinojs (Çikago), me ftesë të Mentor Lleshit me shokë. Arritëm atje rreth orës 15.00. Në banesën e Mentorit u mblodhën shumë veta, ndër të cilët edhe i lavdishmi Agim Gashi (nga Prishtina). Ndenjën gjithë pasditen dhe gjatë natës, deri në orët e mëngjesit. Të nesërmen pasdite organizuam një tubim. U mblodhën shumë veta, kryesisht nga anët e Zajazit të Rekës së Epërme. Ftuan edhe "hoxhë" Isuf Azemin, kryetarin e Lidhjes Kosovare, por ai nuk erdhi, me arsyetimin se mua më kishte dërguar UDB-ja. Kur i lypën fakte, tha se ishte i informuar nga një udhëheqës i "Lëvizjes së Jusuf Gërvallës" dhe se më kishte parë mbrëmjen e natës së kaluar duke hyrë në konsullatën jugosllave në Çikago për të marrë direktiva.

Shkoi Agim Gashi me dy veta te "hoxha" dhe e kushtëzoi

që të betohej me dorë mbi Kuran se me kishte parë duke hyrë në konsullatë. "Hoxha" u betua. Agimi e shau aty për aty, duke i thënë se kështu paskësh gënjyer vazhdimisht. U kthye me shoqëruesit në tubim dhe e diskreditua "hoxhën" edhe aty.

Për Ditë të Flamurit organizuam një manifestim të madh, i pari i atij niveli. Emigracioni "reaksionar" kërcënoi se nuk do të lejonte "kuqaloshët e Enverit" të mbajnë manifestim. Gjatë manifestimit "reaksionarët" shkatërruan makinat e manifestuesve në vendparkim. Me këtë manifestim emigracioni patriotik, që ishte i interesuar për të përkrahur kërkesën Kosova-Republikë, nisi aktivitetet të cilat deri atëherë i kishte penguar emigracioni "reaksionar" (i kontrolluar dhe i komanduar nga UDB-ja).

Solla vetëm ca shembuj për t'ju treguar se si po e menaxhonin "Lëvizjen..." dy Xhaferët.

Nga mesi i dhjetorit u ktheva në Gjermani. Bashkëveprimtarët me njoftuan se Lëvizja nuk kishte pasur ndonjë aktivitet të organizuar që do t'ia vlente për t'u përmendur.

Në janar të vitit 1983, pas homazheve te varrezat e Jusufit, Kadriut e Bardhit, zgjodhëm udhëheqjen e Lëvizjes, të quajtur **qendra ekzekutive** (nëse e kam mbajtur në mend emërtimin e vërtetë dhe kohën!). Xhafer Shatri kooptoi edhe tetë anëtarë fiktivë nga Kosova, ketër të OMLK-së dhe katër të Lëvizjes së Sabri Novosellës, në emër të të cilëve do të flisnin e do të votonin përkatësisht dy Xhaferët. Qendra ekzekutive e (zh)drejtonte Lëvizjen me përplasje e kacafytje dominuese, derisa në fillim të vitit 1984, vetëlargohen nga Lëvizja Sabri Novosella dhe Xhafer Durmishi. Prapa u shkuan vetëm 4-5 ithtarë të tyre. Ata formuan një "Lëvizje..." të re në Suedi dhe nisën botimin e "Zërit të Kosovës". Për arsye të paqarta për mua, atyre iu bash-

këngjit edhe Milaim Zeka. Fatmirësisht, pas rreth katër muajve e shuan veprimtarinë e tyre.

Bashkëveprimtarët e bazës, siç e quanim atëherë anëtarësinë e gjerë, ndërkohë po kërkonin të mbahej kuvend (kongres) i përgjithshëm, në të cilin do të miratohej programi, statuti (që ende nuk i kishim) dhe të zgjidhej udhëheqja e Lëvizjes. Këtë kërkesë e fuqizuan veprimtarët që zunë të arratiseshin nga Kosova, fillimisht Muhamet Kelmendi (në vitin 1982), pastaj Behxhet Mehmeti (mars 1984), Emrush Xhemajli, Ali Ahmeti, Mustafë Xhemail, Behxhet Luzha, Muhamer Shabani (prill-maj 1984) e disa bashkëveprimtarë të tjerë. Me angazhimin e tyre ia dolëm të konsolidonim Lëvizjen, duke realizuar identitetin themeltar të 17 Janarit 1982, pasi komplotistët u përzunë ose u vetëlarguan.

(B.I.:) - Gjatë e pas vitit 1982, sapo e përmendët, do të ketë një veçanti që nuk kishte qenë më parë. Në Perëndim dolën disa prej atyre që më pas do të bëhen të njohur për të gjithë, si Ali Ahmeti, Emrush Xhemajli, Muhamet Kelmendi, vetë Xhafer Shatri e Xhafer Durmishi e të tjerë, do të ketë një dukuri të patjetërsueshme: tani nuk po vijnë thjesht emigrantë ekonomikë për punë, por njerëz që kishin qenë të angazhuar më parë se të vinin në Perëndim. Çfarë solli në organizatë një gjë e tillë?

(I.K.:) - Ardhja e tyre solli frymë të re në Lëvizje, atë që e kishim gjatë vitit 1981 dhe shumë shpejt asaj ia kthyem identitetin, pikërisht në zanafillë, si Lëvizja për Republikën e Kosovës, të themeluar më 17 Janar 1982. Ardhja e tyre i nxori jashtë, si "tepricë teknologjike", dy Xhaferët dhe Sabri Novosllën, kurse më herët e kishim përzënë Abdullah Prapashticën. Fal vetëdijesimit të tyre, Xhafer Shatri, edhe pse pati bërë përpjekje të sforcuar, nuk arriti sukses t'i de-

zinformojë, t'i manipulojë e t'i përvetësojë këta veprimtarë të guxitshëm e të sprovuar, të cilët u detyruan të arratisen pas goditjeve të rënda nga ana e UDB-së dhe policisë në Kosovë gjatë muajve janar-mars 1984.

Unë kam pasur gjithnjë mendimin se ardhja e tyre kishte qenë një domosdoshmëri, edhe për faktin se ata ishin më realë, kishin lidhje të qëndrueshme me Organizatën në Kosovë, ishin njerëz me autoritet, por që nuk e shfaqnin atë, do të thosha, sado që i kishte detyruar diçka e rëndë të largoheshin. Ata kthyen për së mbari gjërat që ishin vendosur së prapthi. Ndoshta është me interes të them se, me gjithë natyrën time herë-herë tepër rebele dhe të padisiplinuar, dhe megjithëse me këta shokë jemi bashkë gati prej 30 vjetësh, nuk kemi pasur përplasje të atilla që mund të thyheshim. Probleme ka pasur, ne po rriteshim dhe po rritej edhe Lëvizja. Pse, sepse ikën grindavecët, prishësit, përçarësit, dekonspiruesit dhe, më saktë, ikën komplotistët. Kjo është e vërteta.

(B.I.:) - Është koha kur në Perëndim del gazeta "Zëri i Kosovës", botim i organizatës. Te njerëzit është i njohur fakti që kishte dy gazeta dhe, me sa më kujtohet, edhe dy Lëvizje, njëra me adresë dhe tjetra pa adresë, njëra e dukshme, tjetra e padukshme. Si ndodhi e gjithë kjo? Kush ishte në drejtimin e gazetës në fillimet e saj? Si funksiononte redaksia, botimi dhe shpërndarja e saj?

(I.K.:) - Pasi u formua dhe u shua "Lëvizja..." që formuan Sabri Novosella dhe Xhafer Durmishi me ca individë të "Lëvizjes së Jusuf Gërvallës", siç e emërtoi kohëve të fundit Xhafer Durmishi, na lindi edhe një "Lëvizje..." e re me ca individë përreth njeriut pa të keq, Hasan Malës dhe gjysmanalfabetit Fahredin Tafallari. Ky fraksion u shkëput në vitin 1986, me

udhëzimet që u kishin dhënë në Tiranë: Oficeri i Sigurimit Ajet Haxhiu dhe shkrimtari Sylejman Krasniqi gjatë vizitës atje të Fahredin Tafallarit me disa bashkëveprimtarë. Për habinë tonë, atje i kishin këshilluar se në demonstrata në Perëndim duhej të dilnin me flamur të Jugosllavisë dhe fotografi të Titos, për të dëshmuar se po kërkonin vetmëm Republikë për Kosovën në kuadër të RSFJ-së. Ashtu edhe vepruan këta mjeranë në demonstratën që organizuan në Shtutgart, por së cilës iu bashkëngjiten shumë pak veta. Edhe këta provuan të botonin gazetën "Zëri i Kosovës" dhe meqë si adresë kontaktuese përdorën adresën e zviceranit Beat Schafer në Biel/Bienne, që e kishte përdorur edhe organi i OMLK-së "Liria", zunë ta quanin veten e tyre "Lëvizja me adresë". Pra, ajo adresë u mundësoi ta quanin "Lëvizjen..." e tyre "të vërtetë". Kjo "Lëvizje" dhe "Zëri..." i tyre u shuan shpejt, meqë nuk kishin potencial intelektual dhe njerëzor.

Lëvizja "pa adresë", në të cilën aderonte shumica e bashkëveprimtarëve në Perëndim, rritej, forcohej dhe konsolidohej me hove, sidomos kur nga kjo largoheshin keqbërësit, plëngprishësit, të lodhurit. Ndërkohë udhëheqja e Lëvizjes, në vitin 1984, zgjodhi për redaktor dhe kryeredaktor të "Zërit të Kosovës" Mustafë Xhemajlin, i cili formoi redaksi dhe i dha gazetës pamje e përmbajtje tejet profesionale.

Gazetën e ndihmoi shumë edhe Shaban Sinani, i cili, pothuajse për secilin numër shkruante artikuj tematikë, e ndihmuan edhe shumë intelektualë të tjerë, të cilët gjatë atyre viteve të rënda nuk vënin emrin e tyre.

(B.I.:) - Më duket se kjo është koha kur nga organizata largohet Xhaferi i parë, Durmishi, i njohur me nofkën Skënderi, siç e keni skicuar edhe ju në librin tuaj „Atentatet". Si thatë më

sipër, ai ka bërë një fejton të gjatë, në formë libri, i cili nuk e di nëse është botuar. Kjo nuk është e rëndësishme. Jemi në fillimet e vitit 1983 e diçka më tej dhe, jo vetëm te ju, por edhe te të tjerë, figura e tij fillon e krijon një dyzim. Përse u largua ai? Si ndodhi ngjarja? A kishte edhe të larguar të tjerë pas largimit të tij, që mund të ishin pjesë e një grupimi lidhur rreth figurës së tij apo ishte një ikje fillikat dhe e pandier në organizatë?

(I.K.:) **-** Pak a shumë fola më herët për "dorëheqjen" e Xhafer Durmishit dhe ikjen e tij nga Lëvizja. Por ju po këmbëngulni. Si duket kërkoni edhe më tej themelin e gjërave që kanë ndodhur. Më duket se ai u largua për të pushuar, meqë u bind se nuk kishte më gjë për të thënë aty ku nuk e dëgjonte njeri. Provoi me "Lëvizjen" që themeluan ai, Sabri Novosella dhe ca argatë të tyre, por shpejt dështuan. Por, ky farë Xhaferi u rehatua personalisht në Suedi dhe nuk u mor më me veprimtari të dukshme. Bashkë me të pushuan veprimtarinë e organizuar edhe Sabri Novosella dhe 4-5 të tjerë. Ndërsa Xhaferi heshti pothuajse për fare (me gjasë bënte një kurim psikik), Sabri Novosella përpiqej të bënte çorbë emigracionin në Suedi, derisa e bëri veten personazh tepër të diskredituar e pa respekt. U bë si një gogol.

Viteve të fundit, siç po duket, Xhaferi dhe Sabriu kanë akumuluar energji për libra të rinj. Uroj të mos kenë sukses dhe ndikim, për sa kohë e kanë me hile.

(B.I.:) - Largimi i Xhaferit të dytë, me sa di, ndodhi më vonë. Sipas një bisede me Ali Ahmetin, botuar edhe në librin tim "I vërteti", shkaku kryesor ishte manipulimi me struktura që nuk ekzistonin, fshehja pas tyre, mbajtja e lidhjeve të hershme grupale dhe, kur erdhi dita që e gjitha të shtrohej haptas, gjithçka që ishte thënë, kishte qenë e ngritur mbi një flluskë. Ndodhi

largimi i tij, dhe unë do t'ju bëj të njëjtën pyetje: Ishte kjo një ikje pa zhurmën e zakonshme të largimit të një njeriu që kishte qenë deri asaj kohe lider, apo ishte një ikje e pazhurmshme, pa rëndesa në anëtarët e tjerë të organizatës? Pra, a iku fillikat, apo krijoi një tërmet politik me ikjen e tij?

(I.K.:) **-** Për ikjen e Xhafer Shatrit kam kontribuar shumë, por më pati kushtuar kohë, energji, nervozizëm. Vlerësoj se kam bërë mirë. Në të vërtetë isha zotuar të hakmerresha kundër krerëve që injoruan Lëvizjen e themeluar më 17 Janar 1982 nga Jusufi, Kadriu dhe unë dhe që e kishin luftuar atë **bashkim** me "bashkimet" e shpifura të 17 shkurtit e 15 majit 1982. Jam krenar që kam dalë fitues, fal bashkëveprimtarëve që më përkrahën dhe që u pozicionuan shqiptarisht.

Edhe ky Xhafer (Shatri) u (vetë)largua, sepse nuk kishte më hapësirë ndikimi e veprimi dhe atij nuk iu bashkëngjit pothuajse asnjë bashkëveprimtar.

(B.I.:) - Fundi i vitit 1985 e gjeti Lëvizjen të kthyer në janarin e vitit 1982. Them nga idetë, njerëzit që i përkasin asaj, strukturat, megjithëse nuk janë më dy nga themeluesit e saj kryesorë, Jusufi dhe Kadriu. Rikthimi në këtë ide, mendoj unë, ndoshta jam i gabuar, solli edhe ringritjen e Lëvizjes. Duam apo nuk duam ne, ajo u bë forca kryesore e lëvizjes ilegale të rezistencës në Kosovë dhe jashtë saj. Çfarë u bë ndryshe në vitin 1985 që nuk ishte bërë deri asaj kohe dhe përse mendoni se ndodhi rikthimi në janarin e vitit 1982?

(I.K.:) **-** Mbajtja e Kuvendit të Parë të Përgjithshëm, i cili miratoi programin, statutin dhe zgjodhi këshillin e përgjithshëm, i dha formën e një organizate të mirëfilltë. Meqë kjo ndodhi në Perëndim, nëse ju përdorni shprehjen "ilegale" si sinonim i shprehjes "e fshehtë" ose "klandestine", atëherë dua të sqaroj

se veprimtaria e Lëvizjes në Perëndim tashmë nuk ishte krejtësisht e fshehtë ("ilegale"). Gjatë hartimit të projekt-programit, si material orientues i përdorëm *Tezat e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës*, të hartuara nga OMLK-ja në Kosovë, që i kishim miratuar në gusht 1981 dhe më 17 Janar 1982. Në këtë kuvend u legalizua pluralizmi politik, u praktikua votimi i fshehtë, etj. Shkurt dhe shqip, Kuvendi i Parë vuri bazat për organizatë serioze, prandaj dhe Lëvizja e dëshmoi veten.

(B.I.:) - Në këto vite, për të cilat edhe po flasim, pra për periudhën që shtrihet mes vitit 1982 dhe 1985, ndodhi një fenomen, i cili, në vetvete, do të thotë shumë. Në këtë periudhë, një e nga një, dikush pa zhurmë e dikush me hidhërim, largohen nga organizata të gjithë ata që për një kohë mbaheshin ose qëndronin si drejtuesit kryesorë të saj, si: Prapashtica, Novosella, Durmishi, Shatri e ndonjë tjetër. Disa vite më vonë do të ketë edhe një largim tjetër. Do të ndodhë kjo, por nuk është përsëritje e së njëjtës situatë. Të larguarit, që ishin ose quheshin shefa, me ndonjë përjashtim, në vitet që erdhën, u bënë edhe nga më agresivët kundër Lëvizjes, për të mos thënë nga më denigruesit. Jo të gjithë, por kjo ndodhi. Ndërsa të tjerët, që ishin aty, të thjeshtë e të urtë deri në dhembje, jo vetëm qëndruan, por u shkuan punëve deri në fund. Si ndodhi ky fenomen, pra largimi i „shefave" dhe qëndresa e të tjerëve?

(I.K.:) - Largimin e "shefave" duhet ta kem sqaruar. Por, meqë po më pyesni, them se largimin e tyre e mundësuan ata që ishin të sinqertë, të sakrificës. Ata që para interesave individuale kishin interesat kombëtare.

Për bindjen time "shefat" e kishin me hile dhe energjitë për të bërë hile shterojnë shpejt. Vetë mënyra e ndërhyr-

jes dhe e imponimit të tyre bazohej në hile të mëdha, ishte një komplot i madh (komplotet janë si ujërat e zeza, shpërthejnë kur nuk e pret njeri). Për arsyet pse vepruan ashtu, besoj janë dhënë goxha shumë sqarime, por nuk janë bërë vlerësimet përfundimtare. Për këtë ndoshta është e domosdoshme distanca kohore. Unë kam dhënë informata, kam bërë vlerësime, me shpresë se do t'i ndihmoj analistët dhe studiuesit të bëjnë vlerësimet e tyre objektive.

Uroj të ndodhin zhvillime të mbara, që vlerësimet të rezultojnë objektive.

(B.I.:) - Në vend të pyetjes:

Në një kohë të shkurtër, lëvizja klandestine do të përballej me shumë gjëra njëherësh. Ndryshe nga sa thotë Ibrahim Kelmendi, ajo nuk ishte edhe aq legale. Nëse brenda vetes ajo ishte krejtësisht legale, e njohur dhe e hapur, jashtë saj, ishte e detyrueshme të ishte disi e panjohur, klandestine, e fshehtë. Vetë fakti që Mbledhja e parë e Përgjithshme u bë në tri vende, duke filluar nga Cyrihu e më pas në dy vende të tjera, dëshmon se fama e konspiracionit ishte e pranishme dhe ishte mirë që ndodhte kështu. Kur kjo ngjante në Perëndim, kuptohet sesa klandestine do të ishte Lëvizja brenda në Kosovë. Thellësisht konspirative, deri në rrënjën e saj. Kjo do të ketë të mirën e saj, sepse kishte të mbajtur brenda vetes të fshehtën e ekzistencës, por jepte mundësi të ringriheshin grupime e kjo sillte detyrimin të ribënte bashkimin dhe shkrirjen e grupeve.E rëndësishme do të jetë që Lëvizja në Kosovë,megjithë përndjekjen e jashtëzakonshme nga pushtimi swerb, nuk hoqi dorë asnjëherë nga qëllimi kryesor i saj, por edhe nga bindja e saj thellësisht nacionale dhe progresive, ashtu si mund të jenë kombëtare e progresive idetë që barti ajo denjësisht,deri në flijim.

Bashkëbiseduesi im është njëri ndër ata që në jetën e tij politike nuk ka qenë konspirativ e herë-herë ka qenë krejt i zbuluar. Megjithëse në drejtimin e organizatës që nga fillimi ai kurrë nuk pati një emër të dytë, pra kurrfarë pseudonimi, nuk dëshiron të jetë i fshehtë për askënd dhe, siç duket, në një mënyrë ose në një tjetër, kjo e bënte të njohur atë, por edhe lehtë të shigjetueshëm. Hashim Thaçi më pat thënë një herë se, sikur secilin prej nesh, në vite të shumta, ta kishin sulmuar e ta kishin anatemuar kaq fort e kaq shpesh, me siguri që do të ishte lëkundur e ndoshta do të ishte tërhequr. I pata dhënë të drejtë. Mirëpo koha është për të vazhduar më tej. Kjo nuk është një histori që mund të mbyllet këtu.

III. Burimet që do të mbushin detin e së ardhmës

Viti 1981 la pas vetes idenë se për lirinë e Kosovës duhej luftuar. Ai përvijoi edhe idenë tjetër se liria nuk mund të mbështetej te supet e lodhura dhe të ronitura të funksionarëve titistë, por duhej të krijohej doemos një plejadë e re, e cila doli në dritë pas përgjakjeve të pranverës së vitit 1981. Natyrshëm, krejt normalisht, historia thërriti një brez të ri klandestin që, edhe pse nën një rëndesë të jashtëzakonshme, pati një fillesë të shkëlqyer. Emblema e këtij brezi u bënë disa nga emrat më të spikatur, Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Fadil Vata, Fehmi Lladrovci, Shaban Shala, Ahmet Haxhia, Xhevë Krasniqi (Lladrovci), Ali Ahmeti, Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi, Xhavit Haziri, Hilmi Reçica, të cilët në fillimet e viteve '80 ishin në Kosovë, në klandestinitet ose në burgjet serbe.

Pas fillesës së shkëlqyer, ky brez u bë një ecje e shkëlqyer, që në vërshimin e saj mori me vete disa nga ngjarjet më të vrullshme, që u bënë pjesë e jetës kolektive të Kosovës. Kjo pati edhe një veçori që kishte munguar më parë: përfshirjen në lëvizjen ilegale të shqiptarëve nga të gjitha trevat. Nëse deri atëherë kishte një lloj shkëputjeje, jo vetëm e trevave që ishin copëzuar në republika të ndryshme jugosllave, por edhe brenda vetë Kosovës, tani, në përmasat e reja të fituara, pati zgjerim të jashtëzakonshëm. Për herë të parë lëvizja klandestine ka frymëmarrjen e saj jo vetëm në viset që u njohën si Krahina e Kosovës, por edhe në viset shqiptare në Tetovë, Kumanovë, Strugë, Dibër, Preshevë, Ulqin, Tivar, për të shkuar edhe përtej

zonave shqipfolëse. Për herë të parë në historinë e saj, përmes figurës emblematike të Fehmi Lladrovcit, lëvizja klandestine u shtri edhe te studentët shqiptarë që studionin në Kroaci dhe, si për ta bërë edhe më të qartë se gjërat tash e tutje do të ishin ndryshe, ai nuk u mjaftua me studentë të zakonshëm, por ngriti celulat klandestine edhe mes ushtarakëve shqiptarë, që, gjithashtu, po ndodhte për herë të parë.

Ka një ndryshim të madh mes zhvillimeve të lëvizjes klandestine të kësaj kohe në Kosovë dhe asaj në Perëndim. Jashtë Kosovës ajo dukej e bashkuar, madje, sikur të mos kishte mjaftuar bashkimi i 17 janarit, do të bëheshin më pas edhe dy të tjerë, por në të vërtetë ishte thuajse e asfiksuar. Shkaku kryesor i asfiksimit ishte pikërisht mohimi i asaj që u ngrit më 17 janar dhe falsiteti i asaj që u gatua një muaj më pas, si një çorbë e pagëlltitshme.

Brenda në Kosovë ishte ndryshe. Ajo dukej e copëzuar, por ishte shumë më pranë bashkimit, sesa aty ku dukej se ky bashkim ishte bërë.

Kjo është periudha kur, përmes idesë së lëvizjes klandestine, mori formë ideja e bashkimit të të gjithë shqiptarëve në Jugosllavi brenda një shteti të vetëm, si formë e parë, mjaft e gjetur, për të shkuar më pas drejt bashkimit kombëtar. Njëkohësisht, kjo ishte periudha kur mendimi politik i lëvizjes klandestine pësoi një shndërrim të rëndësishëm: u fut ideja e luftës.

Pas përgjakjes së ngjarjeve të vitit 1981 dhe arrestimeve të shumta, në Kosovë dhe në vise filloi ringritja, siç kishte ndodhur edhe herë të tjera. Filluan të veprojnë grupe të ndryshme ilegale, të cilat, deri në mesin e vitit 1982, ose ishin struktura, ose ishin në hapat e tyre të strukturimit. Shpeshherë ata kishin dalë nga e njëjta bërthamë ilegale, por, pas goditjeve që kishin

ndodhur në vitin 1981 dhe më pas, kishte pasur shpërndarje, krijime rrjetesh të tjera, grupe ilegalësh ishin grumbulluar me njëri-tjetrin, duke pritur vazhdimin në njësi më të bashkuara. Mbi të gjitha kishte ardhur koha e një strukture të vetme.

Ndërsa në Perëndim, në pamjen e parë dukej sikur ishte bërë ndërtimi i një qendre të vetme e, më pas, u ngrit edhe formalisht një qendër e tillë, në Kosovë po bëhej i domosdoshëm krijimi i një strukture të përbashkët organizative, politike e drejtuese.

Janë shumë shkaqe që e kërkonin këtë domosdoshmëri. Megjithëse si datë të formimit të saj, Lëvizja Popullore e Kosovës pati janarin e vitit 1982, më saktë 17 janarin, formim i cili u përskuq me gjakun e Jusufit, Kadriut dhe Bardhoshit, ngjarjet që e pasuan këtë datë, marramenthi shpejt, sollën ndasi të tjera dhe Lëvizja ishte ende e copëzuar edhe si pasojë e arrestimeve që kishin ndodhur, por e frymës së grupit dhe e komandimit nga jashtë-brenda.

Fundi i vitit 1983 ishte i rëndë. Pati rishtas goditje të njëpasnjëshme në radhët e organizuara të Lëvizjes Atdhetare Klandestine. Në pak kohë ndodhën reprezalje në të gjithë Kosovën, të cilat kulmuan me vrasjen e Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, në 11 janarin e vitit 1984. Sidoqoftë, qëndresa dhe lufta që bënë për disa orë radhazi kishte njëkohësisht edhe ndjenjën e forcës për të vazhduar më tej. Natyrisht, kjo nuk ishte e re në Lëvizjen Atdhetare, por përsëri ishte e rëndë. Veç të tjerave, shumë lidhje organizative dhe strukturore i kishin ditur vetëm ata, pasi kishin qenë drejtuesit kryesorë dhe mungesa e tyre kishte lënë edhe boshllëkun e madh të mosnjohjes.

Është e kuptueshme, për vetë rrethanat e asaj kohe që, pas arrestimeve dhe vrasjeve të reja, të kishte një periudhë të

shkurtër kur tregohej një kujdes më i ndjeshëm se më parë. Pati më shumë maturi në lëvizjet e para. Në qershorin e vitit 1984, kur u zhvilluan gjyqet politike të radhës, përmes tyre, për strukturat e padëmtuara, u bë e qartë se deri ku ishin dëmtuar dhe se çfarë kishte mundur të dekonspirohej.

"Diku nga fundi i vitit 1982, pasi u godit lëvizja studentore, doli si domosdoshmëri se duhej ripërtërirë lëvizja klandestine, prandaj krijuam Këshillin Organizativ. Në atë këshill, të themeluar në Drenicë, kanë qenë të zgjedhur Shaban Shala, si sekretar politik, Fehmi Lladrovci, si sekretar organizativ dhe unë, si përfaqësues në kontaktet me grupet e tjera", - kujton Ali Ahmeti.

Fakt është se, që nga fillesa e janarit të vitit 1983, kur Këshilli Organizativ mori formën e tij të strukturuar e deri në fillimin e një viti më pas, kishim 237 anëtarë dhe këta jo simpatizantë, por anëtarë aktivë. Kjo ishte një rritje tejet e ndjeshme në një kohë tepër të shkurtër.

Për një kohë të shkurtër, në botën e Lëvizjes klandestine Adhetare u shfaqën disa organizime të të njëjtit trung, ku spikatnin: Këshilli Organizativ, i përfaqësuar nga Fehmi Lladrovci, Ali Ahmeti dhe Shaban Shala; "Komiteti i trojeve", që ishte në lidhje me Këshillin Organizativ, ku ishin Pasho Maksuti, Fatmir Ibrahimi dhe Bajram Limani; "Komitetet Lokale", përfaqësuar nga Xhavit Haziri, Bashkim Mazreku dhe Nuhi Ahmeti, si dhe "Komiteti Organizativ", përfaqësuar nga Xhabir Morina dhe Hajdin Abazi.

Kjo është periudha kur në Kosovë formatohet një brez i ri liderësh të luftës së ardhshme, njëri më idealist se tjetri, mes të cilëve spikatnin Xhavit Haziri, Bilall Sherifi, Metush Krasniqi, Fehmi Lladrovci, Ali Ahmeti, Emrush Xhemajli, Mustafë Xhe-

majli, Ilmi Reçica, Shaban Shala, Xhavit Haliti, Nuhi Ahmeti, Abdulla Dërguti, Idriz Hyseni, Hajdin Abazi etj. Ishin aq të shumtë, sa pak kohë më pas, vetëm në njërin nga gjyqet politike u dënuan 27 vetë në një ditë.

Marsi i vitit 1981 ishte i përgjakshëm, por që këtu nisën të marrin udhë zgjidhjet e ardhshme. Ishte e vështirë, sidomos për një kohë të vështirë, por jo e pamundur. Nëse goditja kishte qenë e rëndë dhe mizore, ringritja do të ishte e denjë dhe madhështore. Nga "Lindja e përgjakshme" e 17 Janarit 1982 filloi një periudhë e re, por tejet e vështirë. Herë-herë dukej se do të ishte e pamundur dhe, rëndesa filloi të ndihej aty ku ishte menduar se do të ishte më e lehtë: në Perëndim, ku ndodhej qendra e saj e përkohshme.

Pasi bëmë një rikthim në kohën e ringritjes, tani është momenti të rikthehem te bashkëbisedimi me Ibrahim Kelmendin. Siç ju kam thënë, është ende herët që ai të mendojë se pyetjet e mia përfunduan. Duke qenë bashkudhëtar i kohës në të cilën eci Lëvizja, sidomos jashtë Kosovës, ai ka detyrimin të rrëfejë edhe më tej. Mund të ndodhë të mos jemi në një mendje. Zakonisht ai ka qenë përherë një natyrë që nuk i ka pasur "punët" mirë me drejtuesit dhe, megjithëse kemi kaq vite miqësi, jam i bindur se mund të vijë momenti kur, krejt haptas, të ketë diçka edhe për mua, sidomos për periudhën kur drejtoja organizatën.

Por, le të mos ngutem! Jo rrallëherë kam qenë i gabuar me këtë njeri. Është koha për të vazhduar me pyetjet e mia dhe të kthehem edhe një herë pas në kohë.

***(B.I.:)** - Më 15 janar 1983, në banesën e Hafiz Gagicës u ngrit qendra ekzekutive e Lëvizjes. Sigurisht, shtëpia u zgjodh rastësisht. Kjo qendër ekzekutive, me sa dihet deri më tani, ishte e para strukturë drejtuese e saj. Sipas disa informacioneve,*

ajo u shua më 3 mars 1984, ndërsa, për disa të tjerë, ajo vazhdoi edhe më tej, deri në qershorin e vitit 1985. Anëtarë të saj ishin: Xhafer Shatri, Xhafer Durmishi, Faredin Tafallari, Hasan Malja dhe ju, zoti Ibrahim. Pse u ngrit dhe pse u shua më pas kjo Qendër? Kush e nisi dhe kush e solli shuarjen e saj? Ishte e efektshme ajo, apo jo?

(I.K.:) - Ashtu duhet të ketë ndodhur, nëse e thoni ju, se unë datat nuk i mbaj mend me saktësi dhe nuk kam mbajtur as shënime për zhvillimet konkrete. Jo për mungesë shprehie, por për shkaqe sigurie. Atëherë ruhesha edhe nga organet gjermane, sepse kisha bindjen se po bashkëpunonin ngushtësisht me organet jugosllave, prandaj rrezikonim veprimtarinë dhe njerëzit. Kjo ishte arsyeja pse edhe në Perëndim detyroheshim të ishim të kujdesshëm dhe konspirativ deri në maksimumin e mundshëm.

Data e krijimit të qendrës ekzekutive ndoshta është pikërisht 15 janari 1983, por e shuarjes së saj nuk besoj të ketë qenë 3 marsi 1984. Informatën për shuarjen ju mund ta keni marrë nga "libri" i "trashëgimtarit" të atdhetarit të madh Jusuf Gërvalla, pra të Zotëri Xhafer Durmishit, sepse, meqë më 3 mars 1984 ai paskësh dhënë "dorëheqjen" nga qendra ekzekutive, atëherë menduaka se edhe ajo është shuar! Ai farë "trashëgimtari" mendon se Lëvizja është krijuar kur komplotistët Novosella, Prapashtica, Shatri dhe ai vetë kanë firmosur "bashkimin" dhe është shuar kur ata janë larguar, që unë do të thosha kur janë përzënë, ngaqë ne të tjerët arritëm t'ua ngushtonim fushëveprimtarinë dhe t'i izolonim.

(B.I.:) *- Sidoqoftë, siç ndodh rëndom, është një njeri, i cili hedh fillimisht një ide të caktuar.*

(I.K.:) - Nuk më kujtohet se cili individ e dha idenë për

krijimin e asaj qendre ekzekutive. Mundësia për të spekuluar se meritat për formimin e saj më takojnë mua, është dhënë. Në fund të majit 1982 "ika" në Amerikë, qëndrova atje deri në mes të dhjetorit. Gjatë kësaj kohe dy Xhaferët e kishin udhëhequr Lëvizjen bashibozukçe, kurse Abdullah Prapashticën e kishim përzënë. Vendosëm të formojmë një qendër ekzekutive për t'i dhënë fund asaj mënyre udhëheqjeje, më saktësisht atij komandimi e shpërdorimi. Siç e thashë, paçka se Zotëri Durmishi gjykon se me "dorëheqjen" e tij qendra qenkësh shuar, ajo nuk u shua.

Efekti i saj ishte se tashmë po fillonim të mësoheshim me udhëheqje kolegjiale, prandaj nuk mund të jepeshin më urdhra individualë, por të respektoheshin vendimet që i merrnim në QE.

Fatkeqësisht, Zotëri Xhafer Shatri e ka shpërdoruar atë QE. Ai qe vetimponuar si drejtues i QE-së. Nga ai pozicion, me kokën e vet, jepte udhëzime e urdhra në Kosovë "në emër" të QE-së. Tekat dhe komplotet e tij mundohej të na i imponte "në emër të shokëve" nga Kosova. Këtë shpërdorim e konstatova shumë shpejt. Mendoj se ky shpërdorim duhet të ketë shkaktuar anarshi e pasoja te radhët e organizuara në Kosovë gjatë hapësirës kohore maj 1982 deri në mars 1984. Them që të tilla shpërdorime do të duhej t'i ndriçonin veprimtarët e atëhershëm në Kosovë. Ta zëmë, ekziston mundësia që Zotëri Shatri të ketë dhënë udhëzim, ndoshta edhe urdhër, "në emër" të QE-së, që në Kosovë të themelohej edhe "Partia e Luftës", etj. Ka pasur shumë spekulime me idenë e krijimit të Partisë së Luftës, e cila herë paraqitej si gjetje e Kadri Osmanit dhe, kur binin ngushtë, mendohej se ishte e Rexhep Malës. Është e vërtetë se njerëzit në Kosovë ishin të gatshëm të luftonin, caku i pritjes po i afrohej fundit. Mirëpo mes QE-së dhe strukturave

në Kosovë ishte krijuar një mjegull dhe përmes kësaj mjegulle ishte e lehtë të krijohej ndasi, hutim, pështjellim në radhët e organizimit klandestin çlirimtar. Zotëri Shatri e kishte bërë mënyrë të punës që, kur binte ngushtë, fshihej pas thënies së kështu kanë porositur nga poshtë, lidhjet që kishte nuk i dorëzonte, direktivat që shkonin në Kosovë nuk dihej se nga kush ishin dhe pse ishin. Këtë veprimtari të tij e hetova meqë ai po i imponontе QE-së vendimmarrje "në emër" të udhëheqjes nga brenda, që vetëkuptohej në emër të udhëheqjes së Lëvizjes në Kosovë, e cila, realisht dhe faktikisht, nuk ekzistonte.

(B.I,:) *- A është krejt i një mendjeje me ju për këtë edhe Ali Ahmeti. Disa kohë më parë, në një bisedë të gjatë me të, pikërisht për periudhën që flasim, ai më tha se "jashtë Kosovës kishte probleme organizative. Kishte probleme të brendshme, kishin lindur përplasjet, fillimisht mes Xhafer Shatrit dhe Prapashticës, pastaj në mes të Xhafer Shatrit dhe Sabri Novosellës. U nda një fraksion nga Lëvizja, duke u përqendruar në Suedi. Në meset e emigracionit përflitej sikur njëra Lëvizje qenkësh me adresë dhe tjetra pa adresë. Si rrjedhojë e përplasjeve na u dëmtuan shumë gjëra, sepse ne kishim menduar në mënyrë idealiste. Xhafer Shatri fshihej pas "strukturave" në Kosovë. Ne i kërkonim të ishin gjërat e qarta e nuk mund të shkohej më në këtë mënyrë".*

Mirëpo pyetja ime për ju vazhdon edhe më tej:

Si e shpjegoni që nga pesë anëtarët e kësaj qendre ekzekutive - vetëm ju mbetët deri në fund me Lëvizjen, ndërsa të tjerët u larguan në kohë të ndryshme, u vetëpërjashtuan, u përjashtuan, shkuan në parti politike legale ose ndenjën mënjanë? Ishit më i mirë se ata dhe më i vendosur, apo kishin ata të drejtë dhe ju ishit i gabuar?

(I.K.:) - Këtë pyetje do ta vlerësoja tepër të drejtpërdrejtë dhe ndoshta nuk më takon mua të përgjigjem. Megjithatë po jap një shpjegim, i cili edhe mund të keqkuptohet si subjektiv.

Nuk kam nevojë ta mbaj për vete bindjen time të atëhershme. Kam qenë i qartë asaj kohe, jam i qartë edhe tani: UDB-ja na i vrau shokët, Jusufin, Kadriun dhe Bardhoshin, në momentin kulmor të bashkëveprimtarisë sonë, kur u bind se nuk do të mundte ta shmangte dot më bashkimin dhe themelimin e organizatës, përmes komplotistëve. Pra, vrasjet UDB-ja mund t'i bënte kur, ku dhe si të donte. Por, zgjodhi pikërisht atë moment, e informuar se bashkimi mund të ndodhte pikërisht më 17 Janar 1982. Sigurisht, ajo do ta ketë bërë më parë planin. Do të ketë analizuar se çfarë pasojash do të shkaktonte pastaj, cilat do të ishin përparësitë dhe ndoshta edhe rrjedhimet që, së bashku me themeluesit, të vriste edhe veprimtarinë e organizuar çlirimtare. Për të ka qenë e rëndësishme të vriten tre ose më shumë figura të njohura, me autoritet, por më e rëndësishme ka qenë që, përmes këtyre vrasjeve, të vritet edhe ideja e organizimit, e përpjekjeve dhe e qëndrimit. Mu për këtë, si një zgjidhje të mundshme dhe të efektshme, ajo duhet të ketë urdhëruar tre komplotistët: Sabriun, Abdullahun dhe Xhaferin, të improvizonin "bashkimet" e tyre dhe kështu të imponoheshin si udhëheqës. Për këtë, sigurisht, nuk kisha prova. Në pamundësi për të siguruar prova, kisha zhvilluar afinitetin dhe shprehinë për të vlerësuar individët në bazë të sjelljes se tyre të përditshme, sigurisht edhe në bazë të paraqitjes së tyre. Një nga provat ishte përplasja e parë mes "përfaqësuesve" të krahut të Sabri Novosellës me krahun e "përfaqësuesve" të Abdullah Prapashticës, ndoshta pas një muaji nga 17 shkurti 1982, kur kishin firmosur "bashkimin" e tyre në Turqi. Dhe për çfarë u zunë ata vetëm pas një muaji? Njëra palë (Novosella)

thoshte se është vendosur e firmosur, lëvizja të quhet *Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi*, kurse pala tjetër (Prapashtica) lëvizja të quhej *Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi*. Kjo përplasje na u imponua dhe duhej të përcaktoheshim. Vetëm në qershor ose korrik të vitit 1983 u detyruam të mbanim një tubim (në Bil/Biel të Zvicrës), në të cilin morën pjesë rreth 60-70 veprimtarë të përzgjedhur nga e gjithë Evropa Perëndimore, pa praninë e krahut të Abdullahut, ku "deklasuam" krahun e tij dhe bëmë sikur i përzumë nga Lëvizja, edhe pse, faktikisht, krahu i Avdullahut ishte vetëlarguar menjëherë pas "bashkimit" dhe po mundohej të riaktivizonte partinë e tij komuniste, tashmë duke themeluar edhe sindikata të punëtorëve, organizatë të grave dhe të rinisë etj., si "leva" të partisë së tij. Të gjitha këto me nga 2-3 individë të njëjtë, me kryesues njerëzit e tij familjarë.

Përplasjet nuk pushuan me kaq. Ato kulmuan në janar të vitit 1984 me ardhjen e Sabri Novosellës nga Turqia në Gjenevë. Sapo erdhi nga Turqia, Sabriu u vendos fillimisht mysafir te Xhafer Shatri në Gjenevë. Duke qenë aty, u zunë për faqe të zezë, aq sa Sabriu e kishte akuzuar Xhaferin në sy edhe të bashkëshortes duke e quajtur udbash. I gjendur para një situate të rëndë, Xhaferi më telefonoi e m'u lut të shkoja në Gjenevë e t'ia hiqja Sabriun nga shtëpia, meqë ai nuk po i dilte. Kur, i habitur, e pyeta Sabriun përse nuk dilte nga banesa e Xhaferit kur ai e kishte urdhëruar t'ia lironte atë, ai m'u përgjigj se kishte frikë që, sapo ta nxirrte përjashta, ai do ta vriste. Për të mos e zgjatur me këtë tragjikomedi, rezultat i kësaj përplasjeje të re ishte përzënia në mars të vitit 1984 e Sabri Novosellës dhe Xhafer Durmishit nga QE-ja (sepse edhe Sabri Novosella quhej anëtar i saj, por anëtar me "korrespondencë" ose virtual, siç ishin edhe tetë veta nga Koso-

va...). Krahu i Sabriut dhe Xhafer Durmishit u vendosën në Suedi dhe menjëherë themeluan Lëvizjen e "vërtetë". Filluan të botonin "Zërin e Kosovës", gjithashtu, "të vërtetin", por kjo veprimtari zgjati vetëm disa muaj.

Largimet e krahut të Avdullah Prapashticës dhe Sabri Novosellës i kam përjetuar si çlirim prej tyre, përkatësisht si fitore ndaj tyre. Tani më kishte mbetur Xhafer Shatri. As atëherë dhe as sot nuk kam pasur asgjë personale me të. Ndryshe nga meskiniteti i Novosellës apo nga kodoshllëku politik i Durmishit, ky ishte më i aftë, më i vetëpërmbajtur, paraqitej me stofin e një lideri, kishte lidhje në Kosovë, për një kohë gëzonte autoritet në organizatë, njerëzit kishin filluar ta dëgjonin, por, jashtë Kosovës, në Perëndim, rrethi i tij ishte i ngushtë, lidhjet nuk i vendoste dot. Gjithnjë kisha përshtypjen se, pas gjithë pamjes së tij, fshihej diçka që nuk mund ta përtypja. Isha i bindur se edhe ndaj tij do të dilnim fitues. Për këtë qëllim unë mbaja lidhje të gjalla dhe të ngushta me veprimtarët në bazë, siç shpreheshim atëherë. Vetëm Klubi "Emin Duraku" në Dyzeldorf kishte mbi 600 anëtarë. Dy Xhaferët ishin përpjekur të përvetësonin individë të këtij Klubi, përmes të cilëve ta shpartallonin, por nuk ia dolën. Xhafer Durmishi shkoi aq larg, sa të urdhëronte që në lokalet e atij klubi të vihej fotografia e Josip Broz Titos. Kurse Xhaferi tjetër ishte përpjekur të bindte dy bashkëveprimtarë të mi të më vrisnin, por, falë besimit që kishin ndaj meje, ata nuk pranuan të zbatonin urdhrin e tij.

Dy Xhaferët i patën imponuar Klubit "Emin Duraku" edhe një diversion të tmerrshëm, që pati për pasojë plagosje të rënda fizike ndaj veprimtarëve Sylë Nuha e Haxhi Bega, në një manifestim në Dyzeldorf, më 4 prill 1984, ku merrnin pjesë mbi 800 veta, burra, gra, rini dhe fëmijë. Por bashkëveprimtarët e

klubit i lexuan mirë, në kohën e duhur dhe i përballuan komplotet e tyre. Kurse në Zvicër, për shkak të nxitjeve të ngjashme, na qe vrarë një bashkëveprimtar.

Edhe në kryeqendra të tjera veprimtarët e devotshëm të Lëvizjes kishin formuar klube, sipas modelit të Klubit "Emin Duraku". Me formimin dhe konsolidimin e tyre merreshin edhe shumë veprimtarë të Klubit "Emin Duraku". Kjo formë e legalizimit të veprimtarisë së organizuar patriotike dhe çlirimtare po e rriste dhe po e konsolidonte Lëvizjen. Kjo po më jepte forcë e siguri se edhe Xhafer Shatri do të mundej, prandaj do të qëndroja në Lëvizje deri në Kuvendin e fundit në Prizrenin e sapoçliruar, në qershor të vitit 1999.

U mbetet të tjerëve të vlerësojnë, nëse Sabri Novosella, Abdullah Prapashtica, Xhafer Shatri dhe Xhafer Durmishi dhe pak veta të manipuluar prej tyre u mundën, me ose pa të drejtë, sepse ndonjëherë i padrejti, nëse ka forcën, e mund të drejtin. Unë jam i bindur se u mundën me të drejtë nga Lëvizja që kishim themeluar Jusufi, Kadriu dhe unë, më 17 Janar 1982. Ata që do të merren me analiza e vlerësime, duhet të kenë parasysh edhe veprimtarinë e mëpasshme, të derisotme, të atyre komplotistëve, që unë atëherë i dyshoja si të komanduar nga UDB-ja.

(B.I.:) - Sipas një burimi, në vitin 1985, në banesën e Hasan Malajt, në Zvicër, struktura drejtuese e Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, në mbledhjen e saj, ku ishin të pranishëm Xhafer Shatri, Sabri Novosella, Xhafer Durmishi, Saime Isufi, Hasan Mala dhe ju, Ibrahim Kelmendi, vendosi të bëhet ndërrimi i emrit në Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës. Dy pyetje:

A është i saktë ky informacion? Pra, a kishte të drejtë dega

të ndërronte emrin e organizatës, kur qendra drejtuese duhej të ishte në Kosovë?

(I.K.:) - Për momentin, kjo mbledhje nuk po më kujtohet, prandaj dëshiroj të rezervohem, por, në vitin 1985, Sabriu dhe Xhafer Durmishi nuk duhet të kenë qenë më anëtarë.

Sa për raportet në Organizatë dhe Degë, edhe atëherë, edhe më vonë, do të kemi relacione të ndërlikuara. Tashmë po dihet se Lëvizja si organizatë ishte formuar në emigracion (më 17 Janar 1982 në Gjermani). Deri në vitin 1985 ka pasur përpjekje për të organizuar Lëvizjen, si një forcë e bashkuar, edhe në Kosovë, po kanë rezultuar të pasuksesshme. Duhet të kenë rezultuar të pasuksesshme, kryesisht për shkak të komploteve të Xhafer Shatrit, sepse, "në emër" të Lëvizjes (jashtë vendi), ai duhet të ketë urdhëruar që të formohet në Kosovë "parti lufte" dhe organizime të tjera, për të cilat do të duhej të informonin aktorët dëshmitarë. Është e vërtetë se, pas vitit 1981, sidomos në fillimet e vitit 1983, në Kosovë do të ketë disa organizime klandestine, të gjitha të lidhura me Lëvizjen, por ato nuk ishin të bashkuara e të organizuara në Lëvizje. Përpjekjet e para, siç duket, ishin të parakohshme. Ndoshta bashkimin e tyre e kanë vështirësuar përndjekjet fashiste që kishte ndërmarrë Beogradi ndaj tyre, prandaj ato duhet ta kenë pasur të vështirë të merreshin vesh mes tyre.

Edhe në vitet e mëvonshme janë bërë përpjekje për të organizuar Lëvizjen në Kosovë, por në konsolidim e sipër të saj, ajo është goditur deri në mosfunksionim nga UDB-ja dhe sërish janë bërë përpjekje për riorganizim. Për këto arsye ishte e sanksionuar në Statut që, kur Lëvizja në Kosovë të goditej rëndë nga UDB-ja, që do të thotë: kur udhëheqja e saj ta kishte të pamundur të udhëhiqte organizatën,

atëherë Lëvizja, dega jashtë vendit, kishte kompetenca për të udhëhequr strukturat e pagoditura të Lëvizjes në Kosovë, derisa të merrte veten nga goditja dhe të zgjidhej e të funksiononte udhëheqja e saj në Kosovë.

Besoj se, kur i është ndërruar emri në Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës, në udhëheqje tashmë duhet të kenë qenë anëtarë edhe Muhamet Kelmendi, Mustafë e Emrush Xhemajli, Ali Ahmeti etj., por kurrsesi Sabri Novosella dhe Xhafer Durmishi.

(B.I.:) *- Le të kthehem te një ngjarje më e hershme. Ngjarje të tilla është e natyrshme të na dalin dhe të sqarohen gjatë bashkëbisedimit tonë. Aq më shumë kur janë të ngritura nga njerëz me të cilët ke bashkëpunuar, por, në të njëjtën kohë, duam apo nuk duam, nuk kanë të bëjnë vetëm me ju, por edhe me vijën e ndjekur nga organizata. Faredin Tafallari tregon për një rast, për të cilin thotë se ka qenë i pranishëm edhe Jusuf Gërvalla. Sipas këtij tregimi, Tafallari kujton se ju keni marrë 50 mijë marka gjermane nga një organizatë kroate për të blerë armë, por në të vërtetë, sipas tij, keni rregulluar një lokal kafeneje në Pejë. Duke marrë shkas nga ky rrëfim, i cili nuk e di nëse është i saktë apo jo, do të më interesonte të di disa të vërteta. Në radhë të parë sa i saktë është ky rast dhe, më tej, si ishin marrëdhëniet e Lëvizjes me organizatat e tjera që vepronin në Perëndim, qofshin ato shqiptare, me njerëz nga Kosova apo me njerëz nga Republika e Shqipërisë? Si ishin marrëdhëniet, nëse ishin vendosur, me organizata të tjera ballkanase që vepronin kundër shtetit jugosllav të kohës? Pra, është një pyetje me disa drejtime, nga rasti juaj e deri te vija që ndiqte Lëvizja me organizatat e tjera.*

(I.K.:) - Mirë që ju ka rënë ndër mend të më pyesni për këtë

shpifje të përhapur përmes Fahredin Tafallarit, e "përtypur" dhe e "stërpërtypur" edhe prej disa "trashëgimtarëve" të Jusufit. Fahredini i shkretë, një gjysmanalfabet, tashmë në delir se ka qenë faktor i kohës, paguan njerëz për të shkruar libra në emër të tij, në bazë të rrëfimeve dhe të "dokumenteve" të tij. Ai është një rast fatkeq, vërtet për të ardhur keq. Pavarësisht shpifjeve që ka përhapur, jam përmbajtur, kam ruajtur respektin ndaj tij, sipas motos që i është veshur të ketë thënë Jezusi: "Fali Zot, se nuk dinë çfarë bëjnë!" Ai ka qenë një veprimtar i përkushtuar, sa ka mundur dhe siç ka ditur. Nuk ka kursyer financa dhe angazhim fizik, ndonjëherë edhe mbi mundësitë e tij. Në banesën e tij kemi pasur bazën kryesore në atë anë të Gjermanisë Jugore. Në banesën e tij jam ndier i lirë, si në banesën e tim vëllai, Mustafës, si edhe në banesat e familjeve të shumë bashkëveprimtarëve. Kur ka "shkruar" libra, nuk ka hezituar të përflasë edhe lirinë e sjelljes sime gjatë qëndrimit të shpeshtë në banesën e tij dhe të Zadës, bashkëshortes së tij, e cila më ka pritur e më ka trajtuar si vëllanë e saj. Për këtë pritje i jam përherë mirënjohës dhe e falënderoj nga thellësitë e shpirtit. Por, kjo dalldi e mëpasshme, kur nuk ishim më bashkëveprimtarë të së njëjtës organizatë, aspak shqiptare e aspak mes miqsh, le t'i mbetet në ndërgjegje atij, meqë ka kompromet uar më vonë bujarinë e tij të atëhershme edhe përmes librave të tij, duke i numëruar një miku të dikurshëm kafshatat e bukës që i ka shtruar. Megjithatë, ndaj librave të tij nuk kam reaguar asnjëherë, siç e thashë, kryesisht për shkak të respektit që kisha dhe kam ndaj tij edhe tani, meqë e di se nuk e ka kapacitetin për të qenë i ndërgjegjshëm se ndaj ish-bashkëveprimtarit edhe mund të luftosh, kur shndërrohet në kundërshtar, por jo me shpifje të ulëta, siç ka vepruar ai.

Lidhur me 50 mijë marka gjermane, të përfolura si ndihmë nga një organizatë kroate, të dhëna për të blerë armatim, edhe Jusfi, edhe Fahredini, edhe ndonjë tjetër, fillimisht janë dezinformuar nga Besim Rexha, pastaj nga ca shpifarakë tjerë. Për ato para është shpifur se i paskësha shpërdoruar për të ndërtuar një restorant në Pejë. Kjo shpifje konkrete më ka shtyrë të dyshoj në sinqeritetin e dikurshëm të Fahredinit, gjatë kohës kur ishim bashkëveprimtarë.

Rasti i 50 mijë markave është si vijon: Duhet të ketë qenë viti 1979. Njëfarë Hysen Muhaxheri nga Ferizaj ishte dërguar nga *Elekroekonomia* e Kosovës për specializim në makineri të rëndë në Gjermani. Ai kishte filluar të mblidhte ndihma nga daja i tij Nebih Reka (që atëherë e kishim kryetar klubi në Dyzeldorf) dhe vëllazëria e tij (Basriu në Bruksel, Hysriu në Dyzeldorf), që vinin nga Nerodimja e Ferizajt. Hysen Muhaxheri nuk kishte marrë ndihma dhe huazime vetëm nga dajat e tij, por edhe nga bashkëvendës të tjerë. Por Hyseni po kërkonte edhe më shumë para, me arsyetimin se i duheshin t'i deponente si garanci në një laborator, ku duhej të eksperimentonte për të mbrojtur doktoraturën. Dhe, nëse nuk do t'i ndodhnin avari gjatë eksperimentimeve, thoshte ai, paratë e deponuara për garanci do t'ua kthente huadhënësve. Në pamundësi që dajat dhe bashkëvendësit t'i huazonin edhe pjesën tjetër të parave që ai kërkonte, Nebiu dhe Hisri Reka, meqë e dinin se kisha miqësi të ngushtë me shumë kroatë, m'u lutën t'i gjeja Hysenit 50 mijë marka hua. Kur më takoi edhe vetë Hysen Muhaxheri, më bindi. Vajtëm bashkë në Esen te vëllai i bashkëveprimtarit Vinko Knezeviq, mikut që do të na i jepte paratë (fatkeqësisht, ia paskam harruar emrin). Ia paraqita lutjen dhe arsyetimin dhe ai m'u përgjigj: "Do t'ia jap dhe, nëse garancia nuk kthehet, le të çmohen 50 mijë markat e mia si ndihmë për përgatitjen e

kuadrit profesional për Kosovën, kurse nëse kthehet, le të m'i kthejë të hollat!" Na i dha të hollat pa hezitim, madje me dashamirësi. Mënyra e largimit të Hysen Muhaxherit, kur i kishte të hollat në xhepin e tij, me shtynë të dyshoja se nuk ishte i sinqertë. As dajat dhe askush tjetër nuk ia dinte adresën. Dajat dinin vetëm se ai po specializohej në Universitetin e Duisburgut. Shkova që ditën e nesërme në atë universitet. U informova se ishte angazhuar si asistent aty. Gjeta kolegët e Hysenit. Për të mos e zgjatur, u informova se u kishte marrë 300 mijë marka edhe dy kolegëve gjermanë, me arsyetim se do të blinte fabrikën e tubave në Ferizaj. Brenda dy ditësh, bashkë me kolegët gjermanë zbuluam se Hyseni luante bixhoz në Holandë dhe atje i kishte humbur të gjitha të hollat. Atë bixhozçi mashtrues nuk e takova më. Mikut kroat ia rrëfeva gjithë ngjarjen dhe ai më ngushëlloi, duke më thënë se nuk kisha nevojë të ndihesha borxhli ndaj tij, meqë Hyseni kishte qenë usta për të na mashtruar të gjithëve. Për këtë ndodhi janë dëshmitarë shumë vetë dhe unë kam menduar gjithnjë se, duke qenë e qartë, është edhe një ngjarje e mbyllur. Por, derisa miku kroat pati mirëkuptim për atë fatkeqësi, disa zuzarë e shpërdoruan me përdredhime. Atë fatkeqësi fillimisht e shpërdoroi Besim Rexha (meqë qe informuar përmes mikut Vinko Knezoviq), pastaj Xhevat Ramabaja dhe ndonjë tjetër, që vazhduan të shpifnin sikur një organizatë kroate m'i kishte dhënë ato të holla për të blerë armë. Pastaj shpifja u zbukurua, sikur ato unë i kisha shpërdoruar, kush thoshte për restorant që paskëshin hapur vëllezërit e mi në Pejë, kush se ia paskësha dhënë dajës tim, Rexhep Iberdemajt, për të ndërtuar restorant "Kalanë" në Zahaq të Pejës (pa ditur se ai e kishte mbaruar atë restorant para se të më ndodhte fatkeqësia në fjalë).

Këta shpifës dhe ata që dëshironin t'u besonin, nuk do-

nin t'ia dinin rregullës se vetëm ai që të jep paratë (qoftë edhe si donacion), ka të drejtë të kërkojë llogari, por jo kujt t'i teket dhe si t'i teket.

Kurse sa u përket marrëdhënieve të Lëvizjes me organizata të tjera, kjo është paksa e koklavitur. Meqë ne ushtronim veprimtari klandestine, nuk kishim si të kishim marrëdhënie të ndërsjella, sepse, kur organizatat duan të kenë marrëdhënie, ato duhet të informohen reciprokisht për shumë gjera. Konkretisht, me organizatat politike të emigracionit shqiptar nuk kishim ndonjë marrëdhënie. Ne mbanim distancë, meqë nuk njihnim ndonjë organizim për të cilin të mos dyshonim se kontrollohej e komandohej nga UDB-ja. Rëndom, ndokush kishte lidhje individuale, por ama ndonjë veprimtari të përbashkët nuk e zhvillonim. Me organizata kroate mbanim lidhje dhe bashkëpunonim, por vetëm sa për mirësjellje ose sa për t'ia shtuar njëri-tjetrit pjesëmarrësit në demonstrata, pa përdorur simbole identifikuese nacionale. Kurse unë vet isha miqësuar me personalitetet më të shquara të emigracionit kroat dhe bashkëpunonim në veprime konkrete. Ta zëmë, ata kishin besim të strehonin tek unë persona që Jugosllavia i akuzonte për terroristë (meqë ndodhnin atentate ndaj ambasadorëve jugosllavë) dhe kërkonte ekstradimin e tyre. I strehoja ata derisa drejtësia gjermane refuzonte ekstradimin.

As me parti gjermane dhe të shteteve të tjera nuk kishim marrëdhënie në nivel organizatash, sepse Lëvizja ishte klandestine, por mbanim lidhje individuale, sa për t'i informuar ata për gjendjen në Kosovë dhe për t'i bindur për kërkesat e drejta të popullit tonë.

(B.I.:) *- Me sa jam i informuar dhe më duket se jam i mirinformuar, ndër porositë e ndryshme që ju kanë ardhur nga shteti*

shqiptar, mes të tjerave, kanë qenë edhe dy porosi të rëndësishme: E para, të hiqnit dorë, si lëvizje, nga mbrojtja e parimeve ideologjike që mbronte shteti shqiptar, dhe të përkushtoheshit më shumë në çështjet kombëtare e atdhetare. Një shenjë për këtë është edhe fakti se, megjithëse Jusuf Gërvalla kërkoi nga shteti shqiptar materialet e Kongresit të 8-të të PPSH-së, në të vërtetë i erdhën vetëm disa filma me tematikë të çështjeve kombëtare. E dyta, të bashkëvepronit me Ballin Kombëtar të Kosovës, duke e ndarë atë nga Balli Kombëtar që ka vepruar në Shqipëri. Si janë përmbushur orientime të tilla?

(I.K.:) - Këshilla nga përfaqësuesit diplomatikë të Tiranës për t'u kufizuar vetëm në kërkesa për barazi nacionale në kuadër të RSFJ-së dhe, për të mos u marrë fare me propagandë ideologjike, na jepeshin sa herë takoheshim, por nuk na jepeshin urdhra, meqë me Tiranën nuk kishim ndonjë marrëveshje konkrete. Përfaqësuesit diplomatikë të shtetit shqiptar në Perëndim, sidomos të ngarkuarit me çështjet e Kosovës, përpiqeshin të ishin të matur. Dukej sikur nuk donin të ishin diktues të mendimit të tyre, por kishte edhe raste kur ndonjëri prej tyre nuk përmbahej dhe e kalonte cakun. Përgjithësisht, ne i respektonim, sepse tek ata shihnim shtetin shqiptar. Kishte raste që ndienim adhurim, por kishte edhe raste të tjera kur zhgënjeheshim dhe ziheshim, sidomos unë. Prej tyre ne merrnim materiale propagandistike, sidomos filma me temë atdhetare, albume, libra, revista, gazeta, por të gjitha këto nuk ishin në atë sasi që mund të flitet apo që mund të mendohet se ishin të shumta. Nuk na shkonte në mend të prisnim prej tyre ndihmë financiare, ndërsa ndienim siguri se nuk do të na braktisnin, nëse do të ishte e nevojshme. Shumë gjëra që kanë ndodhur atëherë, nuk mund të shihen me syrin e sotëm dhe me ngjarjet që pasuan. Ne vinim nga një shtet

shtypës, ishim betuar të luftonim kundër tij dhe mendonim, siç do të kishte menduar kushdo, se shteti shqiptar e kishte për detyrë të na përkrahte, prandaj dhe prisnim përkrahje prej tij. Por, punët tonë i zgjidhnim vetë. Nganjëherë ndërhyrjet e tyre kanë qenë edhe së prapthi.

Vetëm pas botimit të romanit "Atentatet", nga personalitete kompetente në Tiranë jam informuar se shteti shqiptar, në kohë të ndryshme, kishte dhënë ndihma financiare përmes Sabri Novosellës, por ato nuk janë shfrytëzuar për veprimtarinë tonë (përjashto vetëm 10 mijë dollarë, që i janë dorëzuar Jusuf Gërvallës nga Sabriu, të cilat nuk mund të mos dorëzoheshin, pasi kishin ardhur si përgjigje e kërkesës së tij). Mendoj se fakti që, edhe kjo shumë, e kërkuar nga Jusuf Gërvalla drejtpërsëdrejti tek Enver Hoxha dhe e ardhur përmes Sabri Novosellës, tregon se ishte një kanal që ishte hapur më parë dhe se nuk mund të jetë përdorur vetëm një herë.

Që ta konkretizoj këtë tematikë: qysh nga fundi i vitit 1977, për herë të parë më patën vizituar dy personalitete që ishin të angazhuara në ambasadën e Shqipërisë në Vjenë. Njëri, më kryesori, ishte Simon Qirici, ndërsa tjetri Sazan Beu (ambasadori i parë i Shqipërisë në Uashington, pasi u lidhën marrëdhëniet diplomatike në vitin 1991). Edhe atëherë me patën kritikuar rreptë për përmbajtjen ideologjike të gazetës "Bashkimi", konkretisht për propagandën për PPSH-në dhe Enver Hoxhën, duke më këshilluar të kufizoheshim vetëm rreth barazisë nacionale në kuadër të Jugosllavisë. Këtë kërkesë e patën përsëritur, sa herë që u binte në dorë numri vijues i "Bashkimit" dhe sa herë i takoja.

Sa për bashkëpunim me Ballin Kombëtar, siç thoni ju, nuk kam dëgjuar ndonjëherë të na këshillojnë, sepse organizime

të veçuara të ballistëve nga Kosova nuk kishte. Di se Lidhja Kosovare prezantohej si pjesë e Ballit Kombëtar, e cila "udhëhiqej" nga njëfarë "hoxhë" Isuf Azemi, që vinte nga rrethi i Tetovës dhe jetonte në afërsi të Çikagos. As me atë organizatë nuk kemi bashkëpunuar, sepse ata na diskreditonin e na luftonin si "kuqalashë të Enverit".

Çfarë ndodhte ndërkohë në Kosovë?

(B.I.:; Shënim i intervistuesit:)

Fillimi i janarit të vitit 1985, si zakonisht, ishte krejt i akullt në të gjithë Kosovën. Pas reshjeve të mëdha të dëborës, ishin zënë të gjitha shtigjet dhe lëvizja e njerëzve bëhej me vështirësi të mëdha. Frynin erërat nga veriu, në të gjitha drejtimet dhe gjithçka ishte akulluar. Pikërisht në këtë kohë, në Kosovë kemi një lëvizje tjetër, tejet të mbarë dhe premtuese. Kishin nisur të shkrinin hejet e akullit të mosbesimit mes strukturave klandestine dhe po vendoseshin lidhjet e para. Nga jashtë, me një vendim të posaçëm të QE-së, në Kosovë u fut një ilegal, i cili kishte veçse disa muaj që ishte larguar prej aty, Ali Ahmeti. Ai kishte marrë detyrën të ndihmonte në krijimin e një strukture të përbashkët organizative, politike e luftarake në Kosovë. Ndërkohë, jashtë saj, pothuajse ishin "ndrequr" punët me punëprishësit. Tashmë kishte ardhur koha që qendra e Lëvizjes të zhvendosej aty ku e kishte vendin, në Kosovë, kur, për më tepër, tashmë aty ishin përvijuar drejtues nga më të rëndësishmit dhe më të devotshmit.

Ishin ditë të vështira, megjithëse po synohej të bëhej bashkim-shkrirja. Ende akujt nuk ishin shkrirë si duhet. Duheshin takime të njëpasnjëshme, biseda të gjata, në grupe apo veç

e veç. Nuk bëhej fjalë për t'u bashkuar dhjetë vetë, por një shumësi e madhe njerëzish, të cilët qëndronin pas tyre. Kishte kontradikta. Kur mendohej se çdo gjë ishte zgjidhur, duhej filluar edhe një herë nga e para. Takimet nuk mund të bëheshin haptas. Mjaft prej tyre ishin në ilegalitet, të tjerë kishin bartur në kohë të ndryshme mospajtime, kishin lidhje të ndryshme, herë-herë edhe jashtë Kosovës. Duheshin pritur orientime. Të tjerë kishin shokët e tyre në burgjet serbe. Duhej një kohë tjetër, më e gjatë, derisa të vinte mendimi i tyre dhe, përsëri, sapo zgjidhej një çështje, vinte menjëherë kontradikta tjetër. Siç kujton Ali Ahmeti, "dilemat kanë qenë të mëdha, sidomos mes Këshillit Organizativ dhe Komitetit Organizativ".

Takimi vendimtar u zhvillua në prill të vitit 1985, në një banesë konspirative në Prishtinë, ku ishte vendosur Ali Ahmeti. Në atë mbledhje u bë bashkim-shkrirja e grupeve dhe e organizatave ilegale atdhetare.

U deshën më shumë se tre muaj bisedime, takime, debate, shikime dhe rishikime programesh dhe platformash, bisedime të përsëritura dhe, së fundi, pas një kohe shumë të gjatë përpjekjesh, në Kosovë u krijua për herë të parë një organizatë unike atdhetare ilegale.

Të gjitha grupet / organizatat u bashkuan-shkrinë në MLK, me pëlqimin dhe marrëveshjen e plotë dhe të njëzëshme të përfaqësuesve të tyre.

Sipas projektstatutit, organi më i lartë i MLK-së ishte Komiteti Organizativ, kurse sekretariati i KO-së ishte organ udhëheqës-drejtues politik dhe organizativ dhe përbëhej prej 5 vetëve:

Xhabir Morina - sekretar politik, Bashkim Mazreku - sekretar organizativ, Fehmi Lladrovci - sekretar për çështje usht-

arake, Xhavit Haziri - sekretar për propagandë, informim dhe shtyp, Bajram Limani - sekretar për sigurimin e bazave.

Ali Ahmeti u caktua në drejtimin dhe për krijimin e lidhjeve me strukturat që vepronin në Perëndim, së bashku me Emrush Xhemajlin.

Disa gjëra u përcaktuan që në takimin vendimtar të prillit 1985, si: struktura organizative, projekt-programi, projektstatuti, si dhe caktimi i disa shokëve në sektorë të rëndësishëm.

Hajdin Abazi dhe Ymer Grainca u caktuan si anëtarë të Këshillit, që në rast të burgosjeve dhe arrestimeve, të bënin detyrën e sekretariatit, së bashku me Ali Ahmetin dhe Emrush Xhemajlin; në sektorin e lidhjembajtjeve u caktua Ilmi Reçica, Nuhi Ahmeti dhe Fatmir Ibrahimi, në sektorin e shtypit dhe të tipografisë Abdulla Dërguti etj.

Tejet e rëndësishme dhe për herë të parë, si një organ ekzekutiv, u zgjodh Byroja Organizative, ku ishin edhe Xhavit Haliti, Ilmi Reçica, Nuhi Ahmeti, Fatmir Ibrahimi, ndërsa pjesët e tjera u plotësuan gradualisht.

Bashkim-shkrirja u bë. Tani, çfarë do të ndodhte më tej? Do të kishte heshtje, ndarje të sërishme, krijimi i një paradoksi të çuditshëm, ku më themeltare ishte se brenda në Kosovë bashkoheshin, ndërsa jashtë Kosovës vinin erërat e ndarjes, sikur po ndanin zonat e influencës? Asgjë nuk dihej. Përvoja ishte e hidhur. Spekulimet në emër të shokëve nga brenda, të drejtimit nga brenda, ishin bërë një gjë e zakonshme, për disa kohë, jashtë Kosovës. Më i thekuri ishte Xhafer Shatri, i cili krijoi një precedent të rrezikshëm. Për fat, u tejkalua, megjithatë precedentë të tjerë ishin të pranishëm.

Ajo që bëri bashkim-shkrirja për gjashtë muaj, deri me 4 nëntor 1985, kur ndodhën edhe arrestimet e jashtëzakonshme,

nuk kishte ngjarë asnjëherë në Lëvizjen Ilegale Atdhetare.

Ishte një periudhë shumë e frytshme, e cila i dha një impuls të jashtëzakonshëm Lëvizjes. Përmasat e saj u bënë të ndjeshme në të gjitha viset shqiptare, me një ritëm që nuk ishte parë deri asaj kohe. Thuajse në të gjitha qendrat dhe qytetet kryesore, u ngritën strukturat që i takonin këtij organizimi politik dhe, për një kohë, heshti ndarja dhe krijimi i strukturave të dyta, brenda të njëjtit organizëm. Xhavit Haziri dhe Nuhi Ahmeti shkuan në Zvicër, u takuan me përfaqësuesit e Lëvizjes në Perëndim dhe bënë të ditur bashkimin e të gjitha grupeve në një strukturë të vetme. Edhe një herë po ndodhte zhvendosja e qendrës së veprimit nga jashtë brenda Kosovës dhe kjo ishte në të mirë të saj.

Kjo ndodhi deri më 4 nëntor. Në këtë datë erdhi goditja e jashtëzakonshme, burgosjet masive. Edhe një herë kemi një zhvendosje të qendrës drejt Perëndimit dhe ngjarjet fillojnë e barten edhe atje.

Çfarë ndodhte ndërkohë në Perëndim?

Ne e kemi një dëshmues, siç e kam thënë, ndoshta më të vjetrin.

Le të kthehem rishtas te biseda me të:

***(B.I.:)** - Më 8 nëntor 1986, në Cyrih të Zvicrës, LPRK-ja mbajti mbledhjen e saj konsultative në të cilën u formua grupi për organizimin e Mbledhjes së Parë të Përgjithshme. U vendos të mbahej në Perëndim, meqë nuk mund të mbahej në Kosovë. Mbledhja e Parë e Përgjithshme u mbajt në korrik '87, me një fillesë në Cyrih, pastaj në St.Gallen. Veç kushteve të*

vështira në Kosovë, a kishte edhe arsye të tjera pse mbledhja e parë e përgjithshme e organizatës duhej bërë jashtë saj? A keni qenë pjesë e kësaj mbledhjeje? Çfarë u përcaktua në të? Nga Kosova ishte pjesëmarrës një figurë e njohur, Ahmet Haxhia. A jeni takuar me të në këtë mbledhje ose më pas? Cili ishte roli i figurave të njohura të Lëvizjes, të cilët, edhe pse nuk ishin në udhëheqjen e lartë, kishin autoritet të ndjeshëm? Së dyti, në Mbledhjen e Parë të Përgjithshme, që kishte rolin dhe autoritetin e një kongresi apo kuvendi, u zgjodh kryesia e saj, me Fazli Veliun, kryetar; Emrush Xhemajlin, sekretar dhe anëtarë Gafur Elshanin, Avni Deharin, Xhavit Halitin, Rexhep Halimin, por edhe Ernest Jurstver. Kush ishte ky i fundit? A kishte lidhje Lëvizja me partitë marksiste-leniniste (m-l) që ishin asaj kohe në Evropë, sidomos me partinë PKGJ/ML gjermane apo të kësaj natyre në Zvicër e diku tjetër?

(I.K.:) - Unë nuk isha i ngarkuar për lidhje me Kosovën dhe nuk di të them gjë konkrete. Për lidhjet me Kosovën kryesia kishte ngarkuar grupin përkatës dhe mendoj se në atë grup bënin pjesë Emrush Xhemaili, Ali Ahmeti dhe Gafurr Elshani. Nga ata kishim informata se kushtet në Kosovë nuk lejonin të mbahej atje Mbledhja e Përgjithshme (që në Perëndim i thonë kongres).

Unë isha i deleguar në atë Kuvend dhe u zgjodha anëtar i Këshillit të Përgjithshëm.

Me patriotin veteran, Ahmet Haxhia, më ka rënë të rri në pushimet gjatë Mbledhjes dhe në mbrëmje, por nuk isha i ngarkuar të bisedoja me të për gjendjen organizative në Kosovë. Prandaj bënim biseda të lira, në prani të shumë vetave.

Ernest Jurtsever ishte një bashkëveprimtar, me origjinë nga Mitrovica, i shpërngulur në Turqi në vitet ‘50, pasi kish-

te mbaruar gjimnazin në Mitrovicë. Në Turqi mbaroi Fakultetin Teknik. Prej Turqie arratiset dhe vendoset në Bruksel. Në Bruksel kishim organizim të rregullt dhe të shtrirë, me shumë anëtarë të devotshëm. Fillimisht kryesisht me shqiptarë që kishin shtetësi turke. Ata ishin organizuar qysh në vitin 1978, fillimisht në Front. Ndër emrat e spikatur po përmend luftëtarët legjendë të Luftës së Dytë Botërore, Gjelë e Hysen Kalishti (Xhelili), nga Kalishta e Tetovës. Më të rinj se dy të parët ishin Muharrem Berisha (Vatansever) me vëllezërit e tij, vëllezërit dhe kushërinjtë Hysen, Smajl, Sefer (Xhemë) e Avdulla Haxhijaj (nga Uça e Istogut), Sadik Tolaj, Fatime Xhelili, Afërdita Tolaj, Sheribane Berisha, Fëllanza Jurtsever, Sabit Abazi dhe shumë të tjerë. Prandaj Mbledhja e Përgjithshme e votoi Ernestin për anëtar Kryesie, meqë ishte i deleguar nga Lëvizja në Belgjikë dhe bashkë edhe me dy delegatë të tjerë merrnin pjesë në Mbledhje.

Sa i përket bashkëpunimit, gjegjësisht marrëdhënieve me partitë dhe organizatat komuniste në Perëndim, nuk kemi pasur asnjë bashkëpunim dhe marrëdhënie në nivel përkatës të subjekteve të barabarta, as legale dhe as klandestine. Disa bashkëveprimtarë bashkëpunonin me ato subjekte, madje ishin edhe anëtarë të tyre, por vetëm mbi baza individuale. Ato parti e organizata nuk e pranonin platformën tonë, mundoheshin të na imponoin revolucionin proletar në Jugosllavi dhe ishin kundër angazhimit tonë për barazi nacionale. Sa i përket bashkëpunimit të individëve, do veçoja disa. Fillimisht Xhevat Ramabajën dhe Besim Rexhën me PKGJ / m-l, pastaj bashkëpunimin e Bardhosh Gërvallës me Joachim Röhm (udhëheqës i lartë në PKGJ/m-l, dikur redaktor në shtëpinë botuese "8 Nëntori" në Tiranë, më pas përkthyesi i veprave të Ismail Ka-

daresë). Argati i UDB-së Enver Hadri (tashmë, fatkeqësisht, hero i Kosovës), me autorizim të Xhafer Shatrit, nxjerr leje për demonstratën që e kishte thirrur Lëvizja në mars të vitit 1984 në emër të Partisë Komuniste Belge (pro BRSS-së) dhe për atë komplot kompromet ues që na kishte bërë Enver Hadri patëm grindje dhe eksese të rënda natën e fundit para asaj demonstrate në Bruksel. Gjykimi im ishte se qe një komplot për të na lidhur përmes asaj partie me shërbimet e Bashkimit Sovjetik.

Që të mos zgjatëm, nuk dua të them se nuk kemi bashkëpunuar për shkak të bindjeve tona demokratike, por sepse ato organizime nuk na kanë joshur.

(B.I.:) - Ju jeni caktuar një herë nga Lëvizja me detyrën e lidhjeve me organizatat e tjera, çfarë lidhjesh u vendosën?

(I.K.:) - Unë sapo fola për këtë çështje. Shkurtimisht mund të shtoj: Duke qenë organizatë klandestine, ne e kishim të vështirë të lidhnim marrëdhënie reciproke në nivel organizatash, por mbanim lidhje informuese me personalitete partiake dhe qeveritare. Për këtë qëllim në secilin shtet caktuam veprimtarë që do merreshin me këtë veprimtari.

Me organizatat "e djathta" shqiptare nuk kishim marrëdhënie dhe bashkëpunim, sepse, siç kam thënë, pothuajse të gjitha ishin nën kontrollin e nën komandën e UDB-së dhe të shërbimeve të tjera projugosllave (në Perëndim).

(B.I.:) - Me 31 tetor 1987, pas disa kohë heshtjeje, Lëvizja organizoi një demonstratë para ambasadës jugosllave në Bernë. Cili ishte qëllimi i kësaj demonstrate? Si u organizua ajo dhe si merrej leja për zhvillimin e saj?

(I.K.:) - Me organizim teknik dhe politik të asaj demonstrate është marrë Kryesia e Lëvizjes. Mua, si çdo herë, m'u dha detyra të hartoja traktin në gjuhën gjerma-

ne që do të shpërndahej gjatë demonstratës, të përgatisja njoftimin për shtyp, të informoja gazetarët gjermanishtfolës, të flisja në gjuhën gjermane, etj.

Nuk besoj të kemi heshtur gjatë, siç thatë, meqë çdo janar, vit për vit, organizonim vizitën në varrezat e Shtutgartit, ku preheshin Jusufi, Kadriu e Bardhoshi; çdo mars e prill bënim demonstrata në kryeqytetet evropiane për të shënuar përvjetorët e demonstratave të Kosovës; në dhjetor mbanim tubime informuese me bashkatdhetarë në Ditën për të Drejtat e Njeriut, etj. Por, sa shpesh ose sa rrallë kemi organizuar protesta, kjo është çështje perceptimi.

(B.I.:) *- Duhet të kthehem edhe një herë në një çështje që më intereson: në marrëdhëniet e Lëvizjes me shtetin shqiptar, sidomos me strukturat e tij në Perëndim. Është e natyrshme që në këto struktura do të kishte njerëz, të cilët duhet ta kishin për detyrë, ndoshta joparësore, lidhjen me strukturat e një lëvizjeje klandestine. Fakti që më 17 shkurt 1982, në të ashtuquajturin bashkim mes strukturave që përfaqësonte Sabri Novosella dhe atyre që përfaqësonte Abdulla Prapashtica, ishte edhe një funksionar i lartë i shtetit, Bujar Hoxha. Për më tepër, i biri i një figure të njohur në Kosovë dhe në Shqipëri, Hoxhë Kadri Prishtinës, fakt që dëshmon se shteti shqiptar nuk ka qëndruar asnjanës ose i heshtur. Nga një letër e Jusuf Gërvallës, dërguar në tetor 1981 strukturave të tij (Sabri Novosellës) jashtë Kosovës, mes të tjerave tregon për një takim tuajin (ju dhe Jusufi) në ambasadën shqiptare në Vjenë. Tregon se në bisedimet e zhvilluara ju keni pasur vërejtje rreth Kushtetutës së Shqipërisë, për më tepër, gjë e palejueshme për kohën, keni pasur vërejtje rreth botimit luksoz të veprave të Enver Hoxhës, duke dhënë mendimin se do të ishte më mirë që këto vlera të*

përdoreshin për botimin e veprave të shkencëtarëve, të albanologëve, të letërsisë shqipe. Po ashtu, Jusuf Gërvalla shkruan se ju keni shprehur dyshime në drejtësinë e një artikulli të "Zërit të popullit", ku shprehej gatishmëria e Shqipërisë për të luftuar krah Jugosllavisë, nëse ajo sulmohet nga Bashkimi Sovjetik. Pas saj, gjithnjë sipas letrës, jepet porosia nga përfaqësuesit e shtetit shqiptar që të ketë distancim nga ju, megjithëse, gjithnjë sipas letrës, ju keni thënë se në atë ambasadë e ndieni veten si në shtëpinë tuaj dhe mund të flisni lirisht.

Si është e vërteta e këtij takimi dhe e takimeve të tjera? Përse u ftohën me ju segmente të shtetit shqiptar, por edhe me të tjerë?

(I.K.:) - Mbase e keni fjalën për një "letër" që Jusuf Gërvalla i paskësh dërguar Sabri Novosellës në tetor të vitit 1981, publikuar si "dokument" nga Fahredin Tafallari dhe Xhafer Durmishi. Unë besoj se kjo letër do të rezultojë si falsifikim flagrant, për qëllime goxha hileqare. Nuk besoj të ketë dezinformuar Jusufi, qoftë edhe "udhëheqësin" e tij, Sabri Novosella. Bashkë me Jusufin nuk kam qenë asnjëherë në Vjenë. Pra, vetëkuptohet, as në ambasadën shqiptare. Ai nuk kishte dokument udhëtimi dhe ilegalisht nuk rrezikonte për të dalë jashtë Gjermanisë. Vetëm në fund të vitit 1981 organet gjermane ia njohën të drejtën e azilit, prandaj i dhanë pasaportë refugjati (travel dokument / Reiseausweis). Për herë të parë jashtë Gjermanisë Perëndimore Jusufi udhëtoi për në Zvicër, në dasmën e Kadri Zekës dhe Saime Isufit, më 2 janar 1982.

Me diplomatët shqiptarë që vinin nga Vjena, unë e Jusufi duhet të jemi takuar, nëse nuk gaboj, në tetor të vitit 1980. Jusufi ishte bërë merak të shkonte për vizitë në Shqipëri, prandaj më luti t'i organizoja një takim me ta. U takuam te një pompë

benzine, diku afër Heilbronit. Në takim duhet të kenë ardhur Simon Qirici, Sazan Beu dhe ndoshta edhe Lirim Shyti. E pata paralajmëruar Jusufin që para takimit se nuk do të mund të duroja pa debatuar me diplomatët shqiptarë, duke e sqaruar se ata mund të hidhëroheshin dhe të ndërprisnin takimin. Po kështu e luta që, në momentin që ata mund të hidhëroheshin, duhej të ndërhynte ai duke më urdhëruar ta mbyllja gojën, për të vazhduar pastaj bisedën për çfarë kishte për t'u thënë. Mbaj mend që trajtova dy-tri gjëra, nëse mund të shprehem kështu, pasi ata nuk ishin aty për debate. E para, u thashë me inat se Shqipëria e Ahmet Zogut ishte angazhuar më konkretisht për çlirimin e Kosovës, pavarësisht se kishte vrarë disa patriotë të shquar shqiptarë të Kosovës, si Hasan Prishtinën, Qorr Ilazin, etj. Ata kundërshtuan me argumentimet e tyre, që ishin brenda vijës ideopolitike të kohës. Pastaj u thashë se folklori shqiptar do ta pësonte keq, nëse në Republikën e Shqipërisë do të ndodhte ndonjë puç kundër Enver Hoxhës dhe Partisë së Punës, sepse poetët, kompozitorët, solistët, instrumentistët me të shquar kishin krijuar këngët më të mira për Partinë dhe Enverin. E treta, u thashë se Shqipëria nuk kishte përse të zhvillonte zgjedhje dhe as të kishte polici, kur vetëm 2-3 veta votonin kundër Frontit Demokratik. Dhe vërtet ata u hidhëruan dhe e ndërprenë takimin. Në atë moment Jusufi më urdhëroi ta mbyllja gojën. Ai mori fjalën, duke më kritikuar mua dhe duke u kërkuar falje atyre. Pastaj ua shfaqi dëshirën e tij për të vizituar ose për t'u vendosur në Shqipëri. Ata i premtuan, siç më kishin premtuar mashtrueshëm edhe mua disa herë, se do t'i jepnin vizë. Edhe me atë rast unë nuk u përmbajta pa iu drejtuar Jusufit, në prani të tyre, se po i premtonin sa për ta mashtruar dhe për të fituar kohë. Madje shtova se nuk na lejonin të vizitonim Shqipërinë, meqë e dinë se do të dëshpërohemi. "Nëse, është hëngër pitja,

tepsia ka mbetë", – thotë populli. Diplomatët në fjalë, pos Lirim Shytit, janë gjallë, siç janë edhe shënimet e tyre në arkivat përkatës për atë takim. Nuk besoj t'i ketë shkruar Jusufi me dorën e tij ato gjëra që përmendet ju, por duhet t'ia kenë veshur falsifikuesit. Pra, unë nuk besoj që diplomatët shqiptarë t'i kenë dhënë udhëzime Jusufit që të më izolonte mua, sepse ata e dinin se Jusufi ende nuk kishte njohje me bashkatdhetarë dhe ato pak njohje i kishte përmes meje dhe bashkëveprimtarëve të mi qysh kur jemi njohur, që do të thotë: po të ishte udhëzuar dhe po të provonte të më izolonte, do t'i shkaktonte vetes së tij vetizolimin.

Meqë jam i bindur se kemi të bëjmë me falsifikime që i vishen Jusufit, po përmbahem që t'i komentoj fjali për fjali ato formulime.

(B.I.:) *- Një pyetje e drejtpërdrejtë, e cila kërkon, po ashtu, një përgjigje të drejtpërdrejtë: A keni qenë në ndonjë moment të aktivitetit tuaj bashkëpunëtor i sigurimit të shtetit shqiptar? Nëse jo, si ka ndodhur kjo, nuk ju janë afruar apo ju nuk keni dashur të jeni?*

(I.K.:) - Nuk kam qenë asnjëherë as spiun, as bashkëpunëtor në çfarëdo kategorie, sepse nuk më kanë bërë ndonjëherë ofertë, përndryshe do të kisha pranuar me dëshirë, me bindjen se do t'i shërbeja shtetit tim, atdheut tim.

(B.I.:) *- Në Lëvizjen ilegale është edhe një emër i njohur, i cili gjithë punën e tij e zhvilloi në Kosovë, por, për fat të keq, vdekja i erdhi në Perëndim, ku kishte dalë për t'u shëruar. E kam fjalën për Fadil Vatën. Në kohë të ndryshme dhe nga njerëz të ndryshëm, unë kam dëgjuar mjaft për të, sidomos nga vëllezërit Lladrovci, Fehmiu e Ramizi dhe nga Ali Ahmeti. Jeni njohur me të apo lidhjet kanë qenë vetëm me një grup shokësh*

të cilët vinin nga OMLK-ja?

(I.K.:) - E kam njohur personalisht, e kam takuar në banesën e Gafurr Elshanit në Aarau të Zvicrës, kur erdhi për mjekim dhe e kam vizituar dy herë në klinikën e Bazelit. Kam pasur konsideratë të lartë për të, por nuk kam biseduar për çështjet në Kosovë dhe as për çështje të tjera, sepse të tjerë bashkëveprimtarë ishin të ngarkuar me përgjegjësi përkatëse dhe tashmë ai ishte shumë i sëmurë.

Rikthimi në fillimet e saj

***(B.I.:)** - Pas vitit 1985, me largimin e Xhaferëve, por edhe të Hasan Malajt, Lëvizja sikur kthehet në fillimet e saj, në 17 Janarin e vitit 1982, pasi tani, realisht, do të gjendemi në një situatë të re. Jo rastësisht, pas këtyre largimeve nuk do të ketë largime të tjera, me përjashtime të rralla, por nuk do të ketë grupime që ruanin ende lidhjet e hershme. Ky është mendimi im, aq sa e njoh unë historikun e Lëvizjes. Ju keni qenë aty, si të thuash njëri nga më të brendshmit. Sa është e vërtetë kjo? A kishte më pas, që nga viti 1985 dhe deri në vitin 1998, për të cilin do të flasim më vonë, grupime, devijime dhe largime?*

(I.K.:) - Fatmirësisht edhe Xhafer Shatri u vetëlargua, pasi e shkarkuam nga detyra si kryeredaktor i "Zërit të Kosovës" dhe qe përjashtuar edhe nga kryesia. Ai nuk pranonte post të rëndësisë se 2-të, të 3-të, prandaj u vetëlargua dhe unë u gëzova. Ai më kishte shkaktuar hidhërime e plagë të shumta, sado që herë pas here simulonte sikur po më merrte në mbrojtje nga "udhëheqësi" dhe "trashëgimtarët" e Jusuf Gërvallës. Por edhe ato simulime të tij më kanë ndihmuar të fitoj kohë dhe të përgatis terrenin për t'i mundur komplotistët, po vetëkuptohet,

duke kthyer Lëvizjen në origjinë – në ditëlindjen e saj, më 17 Janar 1982. Për këtë fitore merita, gjithsesi, u takon edhe bashkëveprimtarëve që erdhën nga Kosova, si Muhamet Kelmendi, Mustafë dhe Emrush Xhemaili, Ali Ahmeti, Bexhet Mehmeti, Muhamer Shabani dhe të tjerë, sepse ata ishin kuadro të sprovuar në Kosovë dhe devotshëm e shqiptarisht të përcaktuar.

Fatkeqësisht, bashkëveprimtarët shumëvjeçarë, tejet të respektuar nga ana ime, Hasan Mala dhe Fahredin Tafallari, me disa miq të tyre u shkëputën nga Lëvizja, duke themeluar LPRK-në (të vërtetë, me adresë), sipas tyre. Shkëputja e tyre duhet të ketë ndodhur pas "këshillimeve" që u janë bërë në Tiranë nga Ajet Haxhia, Sylejman Krasniqi dhe ndonjë tjetër. Por nuk patën potencial e energji për ta vazhduar gjatë. Atëherë më ka ardhur keq për atë shpërdorim që u ishte bërë, dhe, sigurisht, më vjen keq edhe tani, meqë jam i mendimit se shumë shpejt duhet të jenë penduar. Mbase do të kenë kurajë ndonjëherë për të dhënë sqarime të sakta se çfarë dhe kush i ka "këshilluar" në Tiranë!

Në vitet pasuese jemi rehatuar nga "dorëheqjet", vetëlargimet, përjashtimet.

(B.I.:) *- Fakti është se pas vitit 1985, ndoshta edhe për shkaqe të rikonstruktimit, hovi i lëvizjes nuk është i dukshëm, por është i brendshëm. Pra, nuk ka më raste të demonstratave të përsëritura çdo javë në vende e qytete të ndryshme, por, nga ana tjetër, ka rritje të numrit të anëtarëve, megjithëse ishte një periudhë e vështirë. Sidoqoftë, thelbi është në Kosovë, aty ka ndryshime të ndjeshme. Megjithëse është një periudhë, po ashtu, tejet e rëndë, sidomos pas vrasjes së Rexhep Malajt dhe Nuhi Berishës, më 11 janar 1984 (përsëri në janar), lëvizjet që bëhen atje janë të rëndësishme. Fillon një periudhë e re, e cila*

në historikun e Lëvizjes njihet me bashkim-shkrirjen për të cilat shkrova më lart. Kjo tregon se forcat janë rritur politikisht, por ende ka grupime, përderisa flitet për bashkim e shkrirje. A do të ketë rishtas, pas burgosjeve, tentim për rigrupime të veçanta? A është njohur dega me këto zhvillime? Si kanë ndikuar ato në vetë degën e saj në Perëndim, e cila, deri asaj kohe, sipas një përcaktimi të veçantë, kishte marrë përsipër edhe rolin drejtues?

(I.K.:) - Po e përsëris, për zhvillimet në Kosovë nuk jam kompetent për t'u përgjigjur, sepse nuk kam qenë i ngarkuar asnjëherë të merrem me to. Për vrasjet e Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës kam dyshuar të kishte ndikim të tërthortë edhe Xhafer Shatri, meqë atyre, dyshoja, t'u ketë dërguar udhëzime e urdhra "në emër" të Qendrës Ekzekutive të Lëvizjes dhe kështu të ketë imponuar huti, përplasje, anarki, në mes të veprimtarëve tanë në Kosovë, meqë duhet të ketë udhëzuar e komanduar secilin grupim ndryshe e ndryshe. Një zhvillim katrahurë, i komanduar nga Xhafer Shatri, duhet të ketë shkaktuar ekspozimin dhe dekonspirimin e Rexhepit dhe të Nuhiut, që shkaktoi vrasjen e tyre.

Njësoj dyshoja se Xhafer Shatri kishte nisur Zija Shemsiun me bashkëveprimtarin NN, për të futur material e armë në Kosovë, por nisja e tyre e kishte dekonspiruar dhe dëshmori Zija Shemsiu e pëson me vdekje në burgun e Beogradit...

Besoj, është koha që veprimtarët e atëhershëm në Kosovë të ofrojnë të dhëna dhe të japin sqarime se cilat zhvillime e rrethana kanë ndikuar që Rexhep Mala e Nuhi Berisha të dekonspiroheshin, t'u zihej prita dhe të vriteshin nga njësia speciale policore, e komanduar nga Tahir Zemaj (i cili për këtë vrasje, të vlerësuar si aksion joprofesional, shkarko-

het nga posti i komandantit të policisë speciale, siç e kam dëgjuar nga Jusuf Karakushi në Hamburg, ndoshta në vitin 1996, në prani të 7-8 vetave).

(B.I.:) *- Në gjysmën e dytë të tetorit të vitit 1989, në Ollten dhe në Baden të Zvicrës, u mbajt Mbledhja e Dytë e Përgjithshme e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës. Pas pak, në Kosovë do të nisë lëvizja gjithëpopullore kundër ndryshimeve kushtetuese. Njerëz nga Lëvizja në Perëndim do të shkojnë në Kosovë për të bërë organizimin dhe për të ndihmuar, njëri prej tyre do të jetë Ali Ahmeti, por edhe Hajdin Abazi. Cili ishte roli i Lëvizjes në gjithë këtë periudhë? Si u mbështet Lëvizja Popullore në Kosovë nga Lëvizja jashtë vendit?*

Dhe, për kureshtjen time, a ishit pjesë e Mbledhjes së Dytë të Përgjithshme dhe, nëse është koha për t'u thënë, çfarë u vendos në këtë mbledhje, e cila, në historikun e lëvizjes kalon lehtësisht dhe nuk e ka ende peshën e duhur?

(I.K.:) - Si edhe në pyetjet tjera, po e përsëris se nuk jam kompetent për zhvillimet në Kosovë, për të dhënë shpjegime shteruese, meqë lidhjet me Kosovën i mbanin bashkëveprimtarët e ngarkuar nga Këshilli i Përgjithshëm dhe nga Kryesia. Me këtë rast mjafton të them se Lëvizja jashtë vendi ishte Degë e Lëvizjes në Kosovë dhe vazhdimisht ka qenë në shërbim të saj logjistik e kadrovik, por, kur pësonte Lëvizja në Kosovë goditje të rënda dhe udhëheqja e saj humbiste lidhjet ose funksionalitetin, atëherë, me Statut, ishte përcaktuar që udhëheqja e Lëvizjes në Kosovë t'i bartej Degës jashtë vendit, derisa gjendja në Lëvizje, brenda në Kosovë të merrte veten.

Në të gjitha kuvendet e përgjithshme, të mbajtura nga Lëvizja, Dega j.v., kam qenë pjesëmarrës dhe jam zgjedhur anëtar në Këshill të Përgjithshëm, por vendimet e secilit kuvend nuk

i mbaj mend, sepse tashmë organizata kishte marrë përmasa, prandaj edhe ishin ndarë përgjegjësitë dhe kompetencat. Kurse në Kuvendin e parafundit (maj 1998) jam zgjedhur anëtar i Kryesisë, derisa Lëvizja përmbylli organizimin e saj, në Kuvendin e fundit (mbajtur në Prizren, në qershor 1999).

IV. Vitet 1989-1992
– kthesa dhe zhvillime të mëdha

(B.I.:) - Në vitin 1989 në Kosovë ndodhën ndryshime dramatike. Ndodhën njëra pas tjetrës disa ngjarje, të cilat kanë mbetur në memorien e njerëzve edhe pas kaq viteve. Disa prej tyre janë të lidhura ngushtë me Lëvizjen, disa të tjera janë jashtë dëshirës dhe forcës së saj. Në disa raste ajo do të ndihet më e fuqishme se kurrë më parë, por përsëri nuk do të arrihet qëllimi i duhur.

Ndodhi heqja e autonomisë së Kosovës nga regjimi i Milosheviqit, çka nuk ishte në dorën e askujt nga Lëvizja ilegale, por që përkrahej nga faktori politik pushtetar në Kosovë; ndodhën demonstratat e mëdha të tetorit e nëntorit 1989, të organizuara nga Lëvizja, ku spikati roli i Afrim Zhitisë; pastaj ngujimi i minatorëve të Trepçës; pastaj vrasja e shumë të rinjve demonstrues; në fillim të nëntorit, pas disa orë luftimesh, vriten Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, - pra një periudhë ku ndodhën kaq shumë ngjarje, saqë është e vështirë t'i përmendësh të gjitha.

Unë desha të di:

*- **Ç**farë bënte në këtë kohë Lëvizja jashtë vendit?*

- A kishte ajo pjesën e saj në këto manifestime dhe organizime?

- Cili nga shokët e Lëvizjes u dërgua në Kosovë për të ndihmuar në organizimin e demonstratave?

- Si u është përgjigjur në këtë kohë Lëvizja demonstratave brenda vendit, cilat ishin veprimtaritë e saj, u organizuan pro-

testa, demonstrata...?

- U morën kontakte me përfaqësues të Botës Perëndimore për të dëshmuar të vërtetën se çfarë po ndodh në Kosovë?

Për ngjarjet e vitit 1981 Beogradi fajësoi kryesisht shtetin shqiptar për passkenën e saj në organizimin e tyre, ndërsa në vitin 1989 heshti. Si ishin marrëdhëniet e kësaj kohe me shtetin amë? A kishte ndikim ai në gjithë këtë mes, apo nuk kishit më asnjë lidhje?

(I.K.:) - Që në fillim dëshiroj të sqaroj, siç e thashë disa herë deri tash: për zhvillimet dhe ngjarjet në Kosovë nuk jam kompetent, meqë nuk ishte në sektorin tim të merresha me zhvillimet në Kosovë. Për ato janë më kompetentë anëtarët e Kryesisë se Lëvizjes, Dega jashtë vendit, Sektori i posaçëm për lidhjet. Atë e kishte ngarkuar Këshilli i Përgjithshëm, që të angazhohej me zhvillimet në Kosovë. Megjithatë, po shpreh ndonjë mendim e vlerësim.

(B.I. / Ndërhyrje:) *- Tash disa herë që ju pyes për ngjarjet e zhvilluara në Kosovë dhe duket sikur ka qenë një gabim nga ana ime, sepse gjithnjë kam marrë të njëjtën përgjigje nga ju: Për zhvillimet në Kosovë nuk jam kompetent, sepse nuk kam qenë në dijeni të ngjarjeve dhe se njerëzit e caktuar për të krijuar e për të mbajtur lidhje të tilla kanë qenë anëtarë të kryesisë së Lëvizjes, sidomos të sektorit të lidhjembajtjes. Por, duhet ta them se ka pasur gjithnjë një qëllim ky ngacmim. Më është dashur të theksoj idenë se Lëvizja, edhe ndaj një njeriu të besuar si ju dhe si anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm, disa gjëra i ka lënë në një rreth të ngushtë, prej pak vetash, dhe kjo ka bërë që edhe më pas, në ngjarjet e rënda që kanë ndodhur atje, Lëvizja nga jashtë të mos ketë ndikimin e vet, pra mos të jetë palë ose kundërpalë. E kam përsëritur këtë pyetje dhe*

nuk do ta përsëris më, por kam dashur të nënvizoj se, në asnjë rast nuk ka pasur ndërhyrje apo rrjedhime në angazhimet në Kosovë nga strukturat në Perëndim, edhe për gjëra që nuk ishin tabu e aq më tepër kur ato kanë qenë rreptësisht tabu. Do të jem dëshmues kur të ketë akuza pikërisht për këtë, për ndërhyrje nga jashtë-brenda, krijime grupazhesh pas vitit 1990. Më duhet të them se, më shumë se gjithçka tjetër, ato kanë qenë dyshime e hipoteza të momentit për të kaluar një sfidë ose për të pasur një rrugë të çelur. Sidoqoftë, në jetën e një organizate klandestine kjo duket e kuptueshme dhe e tillë është, sepse është pikërisht e fshehta e lëvizjes klandestine që të imponon përplasje, probleme, hipoteza, të cilat, kur zgjidhen, lehtësojnë punët e së ardhmes.

Tani le të kthehemi në vazhdimin e përgjigjes suaj.

(I.K. / Vazhdim i përgjigjes:) - Në fund të viteve të ’80-a Lidhja Komuniste e Jugosllavisë u ballafaqua me luftimet e brendshme politike të njësive të saj, lidhjeve komuniste republikane dhe krahinore. Këto luftime i kishte shkaktuar dhe nxitur sidomos kriza e rëndë ekonomike. Edhe ish-Blloku i Varshavës nuk ishte më në gjendje ta përkrahte si përpara Jugosllavinë, kurse blloku i NATO-s nuk ishte më i interesuar të shpenzonte për Jugosllavinë, siç kishte shpenzuar, qysh kur Lidhja e Komuniste e Jugosllavisë ishte armiqësuar me partitë komuniste të Bllokut të Varshavës, rrjedhimisht qysh në vitin 1948, kur Jugosllavia doli nga ai Bllok. Tashmë vetëm pushteti amerikan, i udhëhequr nga klani projugosllav Eglberger, Backer, Skofworf, etj., donte ta shpëtonte Jugosllavinë nga shpërbërja shtetërore, ndërsa shtetet anëtare të NATO-s, sidomos Gjermania dhe Anglia, nuk ishin më të interesuara ta përmbanin Jugosllavinë me çdo çmim e kusht.

Sa i përket Kosovës, në ato vite dramatike, që do t'i quaja fatlume për interesat e shqiptarëve, ndodhnin dy zhvillime paralele: në njërën anë rinia studentore dhe klasa punëtore e Kosovës po zgjeronte e thellonte rebelimin e hapur, në anën tjetër, satrapët sundimtarë komunistë të Kosovës po ruanin dëgjueshmërinë ndaj sundimtarëve komunistë serbë të Republikës së Serbisë, udhëheqja e së cilës tashmë kishte përvetësuar platformën nacionaliste serbomadhe të Akademisë Serbe të Shkencave. Por, edhe brenda udhëheqjes komuniste të Kosovës po shkërmoqej uniteti i saj.

Ndoshta duhet të kthehem në vite të mëhershme për të sjellë një ngjarjeje e cila trimëroi shtresën e intelektualëve dhe të qytetarëve shqiptarë të Kosovës. Kjo ndodhi, tejet domethënëse, ishte paraqitja tepër e guximshme e personaliteteve krijuese letrare në Kongresin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë në Novi Sad. Në atë paraqitje u shquan disa personalitete, që ishin pjesëtarë të delegacionit të Lidhjes se Shkrimtarëve të Kosovës, si i pari institucion legal i Kosovës që zuri të rebelohej kundër sundimit serb. Kundër këtij rebelimi të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës u pozicionua udhëheqja e Lidhjes Komuniste të Kosovës (shkurtimisht LKK). Si ndëshkim për "fajin" që kishte bërë dhe për ta disiplinuar Lidhjen, në vitin 1988 u vendos për të ndryshuar shumëçka, madje duke filluar që nga kreu. Ishte pikërisht kjo arsyeja themelore që, pak kohë më vonë, tinëzisht e njëkohësisht brutalisht, Komiteti Krahinor i LKK imponoi Ibrahim Rugovën për kryetar të saj. Aty e tutje, plot 11 vite, Lidhja e Shkrimtarëve u rikthye në një subjekt të dëgjueshëm ndaj udhëheqjes së LKK-së, rrjedhimisht LDK-së. Ajo nuk qe më në gjendje të zhvillonte aktivitete opozitare, as edhe letrare, si përpara. Nuk mbajti ndonjë mbledhje për

të rizgjedhur udhëheqje të re gjatë gjithë atyre viteve, derisa Kosova u çlirua nga pushtimi serb. Vazhdimisht më ka habitur dhe vazhdon të më habisë heshtja e anëtarëve të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës për të trajtuar objektivisht defaktorizimin e Lidhjes, qëkur në krye të saj, nga famëkeqi Rrahman Morina u imponua Ibrahim Rugova për kryetar të saj.

Siç e thashë, paraqitja e guximshme e disa personaliteteve krijuese në Kongresin e mbajtur në Novi Sad hovshëm i ndërgjegjësoi dhe i trimëroi intelektualët dhe qytetarët e Kosovës. Në hovëzimin e tyre ndikuan dukshëm edhe rebelimi i lidhjeve komuniste, fillimisht i Sllovenisë dhe Kroacisë, rebelim i cili u shtri edhe në lidhjet e tjera komuniste. Sllovenia, sidomos, qe shndërruar në vatër të ndërgjegjësimit e të trimërimit të shqiptarëve. Uroj që analistët dhe studiuesit shqiptarë të merren me trajtimin e rolit të Sllovenisë për zhvillimet në Kosovë në atë kohë.

Nismën e rebelimit të guximshëm, të hapur, e bënë studentët dhe minatorët e gjigantit ekonomik të Kosovës "Trepça", ku kishin ndikim veprimtarët e angazhuar të Lëvizjes. Në lëvizjen e atëhershme të studentëve primatin organizativ e kishin anëtarët e Lëvizjes, të cilët qenë angazhuar me taktikë e konspiracion të përkryer. Për konkretizime të rolit të tyre nuk po ndalem, sepse nuk mund të shpjegohen përmes bashkëbisedimit tonë.

Tashmë, siç e dimë, Kosova shpërtheu në protesta të gjëra, në emër të solidarizimit me minatorët. Pothuajse e gjithë popullsia aktive shqiptare mori pjesë në ato protesta dhe në atë rebelim fenomenal popullor. Ai rebelim i zhbëri të gjitha organizimet komuniste të deriatëhershme, me në krye LKK-në, si Lidhjen Socialiste të Popullit Punues, Lidhjen e Ri-

nisë Socialiste, etj. Kësaj zhbërjeje i rezistoi vetëm Lidhja (komuniste) e Shkrimtarëve të Kosovës, e cila realisht kishte humbur funksionalitetin e saj, por ja që kryetari i saj, Ibrahim Rugova, me dy-tre argatë të tij, thirreshin në emër të saj, më saktësisht, ia kishin mbytur zërin asaj.

Sigurisht, Lëvizja në emigracion, më konkretisht Dega e saj jashtë vendit, - veç faktit që kishte dërguar ilegalisht disa nga përfaqësuesit e saj të spikatur, - midis tyre edhe Ali Ahmetin e Hajdin Abazin, - u bë shumë aktive. Ajo organizoi shumë manifestime solidarizuese, protesta, demonstrata e tubime në shumë kryeqendra të Evropës Perëndimore. Ndërkaq, Lëvizja, Nëndega në Gjermani, organizoi edhe një grevë urie para ambasadës jugosllave në Bon, atëherë kryeqytet i Gjermanisë Perëndimore. Ishte hera e parë kur një institucion gjerman, Kryqi i Kuq, na përkrahu hapur, duke na ofruar logjistikën përkatëse për grevë urie, si: tenda, shtretër, batanije, ngrohje me gaz, etj. Gjatë grevës, nga uria dhe emocionet na u sëmur rëndë Hedije (Selim) Demiri dhe kjo i shqetësoi qeveritarët gjermanë. Prandaj kjo grevë në Bon, e cila po sensibilizonte ndërgjegjen gjermane me grevën e minatorëve të "Trepçës", ndikoi dukshëm në kthesën e përcaktimit të deriatëhershëm projugosllav të disa personaliteteve dhe qeveritarëve gjermanë në drejtim të përkrahjes së Kosovës.

Për ata që nuk i kanë njohur rrethanat e atëhershme politike në Evropën Perëndimore, dëshiroj të them se Jugosllavia, sidomos sistemi i saj, i quajtur "socializmi vetëqeverisës", gëzonte respekt e përkrahje të madhe nga elita intelektuale dhe politike e atyre shteteve. Krahu i majtë i partive bazohej në konceptin ideopolitik, kurse partitë e djathta bazoheshin në interesin e tyre për zgjerim të tregjeve, rrjedhimisht në interesat

shtetërore, ngaqë Jugosllavja, jo vetëm që ishte treg i madh, por ishte edhe bashkideatore dhe lidere e "Bllokut të shteteve të painkuadruara". Në shërbim të këtyre interesave shtetërore silleshin edhe organet policore dhe të shërbimeve sekrete, të cilat na e vështirësonin veprimtarinë.

Ndonjëherë disa pseudoanalistë fajësonin përcaktimin tonë majtist, si shkak të mospërkrahjes nga Perëndimi. Kjo nuk qëndronte. Së pari, sepse në thelbin dhe në programin e saj Lëvizja nuk kishte asgjë të përbashkët me konceptet marksiste, aq më pak komuniste. Përkundrazi, me kërkesat dhe synimet e saj për pavarësi dhe bashkim të kombit, ajo shkonte drejt një organizate thellësisht kombëtare. Në fakt, që kur u themelua dhe që në bashkim-shkrirjen e vitit 1982, Lëvizja u përcaktua qartësisht se do të luftonte për kombëtaren dhe jo për ideologjiken, duke përfunduar deri në mohimin e plotë të koncepteve ideologjike. Së dyti, vetë përbërja e Lëvizjes, në të gjitha qelizat e saj, ishte heterogjene. Në të kishte dallime konceptuale ideologjike. Pas vitit 1993, por edhe më herët, ajo u përcaktua qartësisht për luftë dhe u përgatit për një gjë të tillë. Një organizatë e tillë, do të thosha tepër e sprovuar, anëtarët e së cilës, së bashku, mund të kishin bërë disa qindra vite burg ose që po vriteshin nëpër demonstrata e përpjekje, nuk mund t'i hynte rrugës së luftës, veçse për qëllimet më të larta. Unë jam i bindur se shërbimet e posaçme të vendeve ku jetonim në Perëndim e dinin fare mirë një gjë të tillë. Dhe kjo u dëshmua kur erdhi koha, e dëshmuan me mbështetjen që i dhanë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por, në kohën për të cilën po flasim, politika e ditës dëshmonte për tjetër gjë dhe kishte një tjetër qëllim.

Këtë politikë të Perëndimit, pra, nuk e pengonte fare sistemi socialist-komunist dhe monist i Jugosllavisë, sepse përparësi

kishin interesat e tyre shtetërore. Për këtë përcaktim të tyre pro Jugosllavisë mund të dëshmojë edhe përndjekja që i bëhej emigracionit politik kroat nga organet operative të atyre shteteve, pavarësisht faktit se emigracioni i organizuar politik kroat ishte pothuajse krejtësisht djathtist. Ndërkaq, të përjashtuara nga survejimet dhe përndjekjet ishin organizatat çetnike serbe dhe pothuajse të gjitha organizimet e djathta politike shqiptare, sepse ato i kontrollonte UDB-ja jugosllave. Ndodhte ashtu, sepse shërbimet inteligjente jugosllave bashkëpunonin ngushtësisht me simotrat e tyre të shteteve në Perëndim. Në kuadër të atij bashkëpunimi, ato koordinonin midis tyre se cila organizatë duhej vëzhguar, kontrolluar e përndjekur dhe cila duhej të tolerohej, madje edhe të përkrahej e të ndihmohej për interesa të tyre manovruese, në kuadër të luftërave speciale.

Edhe më intensive ishte përkrahja ushtarake e Perëndimit ndaj ushtrisë jugosllave. Vetëm gjatë viteve ’60 - ‘70, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kishin dhënë asaj më shumë se 100 miliardë dollarë ndihma. Merret me mend se ç’vlerë ishte ajo kur kihet parasysh fuqia blerëse e dollarit të atëhershëm. Po kaq intensive ishte edhe ndihma që u jepej shërbimeve inteligjente të Jugosllavisë, etj.

Mbase u ndala gjatë për këtë tematikë, por gjykova se duhej bërë, meqë ndokush, gabimisht, mendon se ne e kishim të lehtë të zhvillonim veprimtarinë tonë patriotike e çlirimtare në Perëndim, larg pushtetit monist jugosllav. Ka edhe nga ata që mendojnë se përkrahja e Perëndimit na është vonuar për shkak të përcaktimeve tona ideologjike majtiste.

Tani po përqendrohem te pyetjet:

Sigurisht, Lëvizja, Dega jashtë vendit, ishte angazhuar të përkrahte Lëvizjen në Kosovë, qoftë me veprimtarë të spro-

vuar, qoftë me mjete propagandistike, por edhe me mjete financiare. Po rezervohem të përgjigjem konkretisht për angazhime dhe përkrahje përkatëse, meqë ato i ka koordinuar Kryesia dhe unë nuk isha anëtar i saj. Di që në atë kohë patëm marrë vendim, madje në Këshill të Përgjithshëm, për të dërguar kuadro të sprovuara, të cilët do të ndihmonin me këshilla e organizim udhëheqjen e Lëvizjes në Kosovë, siç qenë Ali Ahmeti, Hajdin Abazi dhe ndonjë tjetër. Edhe pse ai vendim ishte marrë në një forum aq të zgjeruar, nuk ndodhi ndonjë dekonspirim dhe kjo duhet vlerësuar si dëshmi që në Këshillin e Përgjithshëm nuk kemi pasur spiunë të infiltruar nga shërbimet jugosllave.

Meqë isha caktuar nga Kryesia për të koordinuar informimin dhe kontaktet me partitë dhe organizatat politike dhe joqeveritare, me qeveritarë në Perëndim, besoj, brenda kapaciteteve tona njerëzore, e kemi bërë këtë punë. Po sjell një shembull për ilustrim. Në koordinim me të lavdishmen, norvegjezen Berit Baker dhe Nufri Lekën, - veprimtarë të Lëvizjes, - mundësuam vizitën e parë politike të Ibrahim Rugovës në Perëndim, konkretisht në Oslo. Me atë rast atë e pritën disa ministra norvegjezë. Ndoshta është rasti për të treguar se Berit Baker ishte edhe këshilltare e kryeministrit norvegjez për çështjet ballkanike. Fatkeqësisht, atë e mbyti në mënyrën më mizore Malë Lajçi, një vrasës i komanduar nga Beogradi. E, meqë jemi të kjo vrasje, po sjell edhe një hidhërim tonin konkret: Adem Demaçi e pat lutur "presidentit" Rugova, në emër të subjekteve që ishim bashkuar për t'i bërë nderimet e fundit Beritit në Oslo, në mënyrë sa më dinjitoze, që të shpallte për te ditë zie në Kosovë, por as nuk e shpalli dhe as nuk erdhi të merrte pjesë në varrim. Bisedën telefonike Demaçi i pat bërë nga Selia e Komitetit të Helsinkut në Oslo. Ne pjesëmarrësit e atyshëm secili shprehem hidhërimin në mënyrën e tij kundër

mospërfilljes nga ana e I. Rugovës. Mjaftonte ta thoshte si llaf, meqë ashtu ashtu Kosova nuk kishte si ta organizonte ditën e zisë. Kurse unë u prononcova: "Nuk e prish ai qejfin e tij në Itali, sepse është mysafir i Shën Exhidios proserbe. Pastaj ai nuk denjon të dënojë krimin makabër që ka bërë kushëriri i tij, Malë Lajçi..." Kurse lutjes se Demaçit Presidenti Berisha iu përgjigj me një tubim komomerativ në Presidencë.

Po me angazhimin tonë, i mundësuam Ibrahim Rugovës vizitën e parë në Bon. Dhe, Ibrahim Rugova nuk ka qenë fare mirënjohës për shërbim që i bënim, pavarësisht se mikpritësit e informonin që ishim ne promotorët e atyre vizitave. Mbase ai ishte mosmirënjohës, meqë e dinte se ne nuk po i shërbenim personalisht atij, por presidentit të Kosovës dhe këtë të fundit si duket Rugova nuk e dëshironte.

Për kontaktet dhe komunikimet e tjera të natyrës "operative" mbase është herët të informojmë. Për to nuk kemi informuar asnjëherë, për t'u reklamuar para popullit ose për ta gënjyer popullin, "kështu i thashë e kështu më tha...", siç vepronin deri në banalitet "turistët politikë" nga Kosova. Shumë "turistë politikë", siç i quaja atëherë, për shkak se vinin si individualistë, të papërgatitur, destruktivë, pa koncepte për zgjidhjet që duhej të ofronin, vetëm se provokonin neverinë ndaj tyre nga nikoçirët. Po të duan të jenë të sinqertë tani mund të informojnë për organizimet, ndihmat dhe shërbimet që u kemi bërë gjatë vizitave të tyre në Perëndim.

Meqë nuk i takon sferës "operative", po sjell një shembull se si reagoi kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve të Gjermanisë, shkrimtari Max von der Grün, kur i kërkova të priste "delegacionin" e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Gjermani më tha se nuk kishte dëshirë të takonte delegacione të lidhjeve të

shkrimtarëve nga ish-shtetet socialiste, sepse ata e mërzitnin duke i mbajtur leksione për demokracinë dhe duke ia lavdëruar sistemet e tyre demokratike.

Kurse destruktivitetin e "turistëve politikë" e ilustron skandali në takimet me Kryetarin e Unionit të Partive Popullore të Evropës (partive të djathta) në Bruksel. Kryetari i Partisë Demokristiane të Kosovës, Zotëri Lazër Krasniqi, kërkoi shërbimin tonë që ta çonim në atë takim, në Bruksel, meqë ai kishte rakorduar takimin me kryetarin në fjalë. Kur u paraqitëm në paradhomën e kabinetit të tij, sekretarja u habit. Ajo na informoi se kryetari e kishte realizuar takimin me një lider të Kosovës rreth gjysmë ore më parë. Zotëri Krasniqi, i zënë ngushtë, nxori kopjen e faksit për të dëshmuar konfirmimin për atë takim. Nxori edhe pasaportën jugosllave për të dëshmuar identitetin e tij. Sekretarja hyri te kryetari me dëshmitë në duar dhe, pas pak, na ftoi të hynim edhe ne. U skandalizuam kur ai na sqaroi se një shqiptar i ishte lutur qysh në mëngjes, që takimi i rakorduar të ndodhte më herët, meqë lideri duhej të udhëtonte për në Paris. Dhe ai lider ishte hiç më pak se Ibrahim Rugova, i cili i "vodhi" takimin e akorduar Lazër Krasniqit. Kryetari i Unionit kishte menduar se kishte takuar kryetarin e Partisë Demokristiane, meqë për të ishte caktuar takimi para shumë ditësh. Rezultonte se ai nuk e dinte se kishte takuar Ibrahim Rugovën...

Ja se si kishte ndodhur: Një kasnec i Rugovës në Bruksel i informuar për takimin e rakorduar mes kryetarit të Unionit Evropian dhe kryetarit të Partisë Demokristiane Shqiptare të Kosovës, e kishte lutur kabinetin e kryetarit që ta përshpejtonin atë takim, me arsyetime të shpifura, pa sqaruar se ishte fjala për një lider tjetër. Pas atij skandali, në mbrëmjen e po asaj

dite, Lazër Krasniqi u përplas me Ibrahim Rugovën në prag të një tubimi informues me bashkatdhetarë në Bruksel. Pra, Ibrahim Rugova nuk kishte udhëtuar për në Paris, siç e kishte mashtruar kasneci i tij kryetarin e Unionit të Partive Popullore Evropiane. Pas atij tubimi me bashkatdhetarët, ku Ibrahim Rugova i zhgënjeu të pranishmit, qe shtruar darkë në restorantin e një greku në Bruksel. Pos Ibrahim Rugovës dhe Lazër Krasniqit, në darkë ishin edhe Bujar Bukoshi me ca sejmenë të tij dhe dhjetëra aktivistë të LDK-së në Bruksel, shumë syrësh me dosje policore si të inkriminuar. Isha edhe unë në atë darkë. Edhe atje u ringjallën përplasjet për skandalin që kishte ndodhur gjatë ditës. Në përmbyllje nuk dihej kush duhej ta paguante darkën. Për të shmangur atë gjendje Ibrahim Rugova ofroi ec-kartën bankare dhe e pagoi. Ai veprim dhe fjetja e tij në hotel "Hajat" (2.200 DM qiraja e suitës për një natë) më patën shtuar dyshimin se kush ia kishte dhënë atë ec-kartë Ibrahim Rugovës dhe me paratë e kujt po bënte qejf ai në Bruksel, kur selinë qendrore të LDK-së në Prishtinë e kishte në një barakë të Shoqatës së Shkrimtarëve.

Meqë fola për sjelljet e "presidentit" Rugova po sjell edhe një si eksces tjetër. Në fund të vitit 1996 ose fillim të vitit 1997 Ibrahim Rgova ishte sërish në Bruksel. Sërish ishte vendosur në hotelin **Hajat**. Vendosa ta takoja për të biseduar për akuzat shpifëse dhe denigruese që ia bënte UÇK-së. Përmes disa telefonatave kërkova ndihmën e Zotëri Avni Spahiut, këshilltarit dhe përkthyesit të tij. Udhëtova nga Gjermania me NN. Gjatë rruge po bisedoja me NN, nëse Rugova nuk do të pranonte kompromisin të mos shpifte e denigronte më kundër UÇK-së, atëherë do ta vrisja. NN po më thoshte se nëse mendon se meriton të vritet, do ta vriste ai, sepse duke shkuar unë në burg, do të dobësoheshin Lëvizja dhe UÇK-ja. Por unë këmbëngulja ta

bëja vetë, me arsyetimin se gjatë procesit hetimor e gjyqësore, vrasjen e tij do ta arsyetoja më bindshëm. Shkuam në hotel **Hajat** për të pritur takimin, meqë Avniu me kishte premtuar. Prita aty deri rreth orës dy pas mesnate. Përfundimisht Avniu na informoi se Rugova nuk po ngrihej dot nga restoranti, sepse ishte bërë tapë nga alkooli. Meqë edhe në hotel **Hajat** zunë të dyshonin për pritjen tonë, bisedova me bashkatdhetarin NN që shërbente në atë hotel dhe në emër të të cilit ishte rezervuar vendi për suitën, për të pasur zbritje në çmim prej 2.200 DM (meqë qiraja për suitë për një natë ishte shumë më e lartë se kaq). Ky më premtoi se letrën që do ta shkruaja do t'ia vendoste në tavolinë të punës "presidentit" Rugova. Shkrova me nervozizëm dhe hidhërim një letër kërcënuese. Midis të tjerash e kërcënova se po vazhdoi të shpifte për UÇK-në, po vazhdoi ta denigronte atë, vërtet do të vritej. I propozova ta përdorte cilësimin "forcë radikale", nëse do ta pyeste ndokush për aksionet guerile të UÇK-së, por kurrsesi strukturë e formuar nga shërbimet e Beogradit. Të nesërmen bashkatdhetari që shërbente në hotel më tregoi se pronari i hotelit e kishte qortuar atë, pse e kishte futur letrën në suitë, meqë "presidenti" Rugova ishte ankuar te personeli i hotelit. Edhe Avniu më informoi për shqetësimin e Rugovës për kërcënim timin. Fatmirësisht Rugova, aty e tutje, korrigjoi shpifjet e tij kundër UÇK-së.

Që ta përmbyll përgjigjen, dëshiroj të informoj se kontaktet e Perëndimit me personalitete partiake, qeveritare etj., dhe informimi i tyre nga ana jonë kanë qenë tejet intensive.

Sa i përket qëndrimit të Beogradit ndaj Tiranës, fajësues në vitin 1981 dhe heshtës në vitin 1989, nuk kam të dhëna konkrete, prandaj po përmbahem të jap shpjegime. Megjithatë, mungesa e të dhënave konkrete nuk më ndalon dhe nuk mund

të më ndalojë njeri të bëj aludime se tashmë Beogradi kishte parapërgatitur terrenin për të pasur nën kontroll dhe nën komandë edhe Tiranën, siç e kishte Prishtinën. Ngjarjet që rrodhën më pas, e kanë rritur gjithnjë këtë dyshim timin.

Unë tashmë nuk di se çfarë marrëdhëniesh konkrete duhet të ketë pasur në këtë periudhë Lëvizja me Tiranën zyrtare, sepse Kryesia kishte ngarkuar individët që mbanin kontakte me shtetin shqiptar. Ndonjë lloj ndikimi ose ndihme konkrete të Tiranës nuk besoj të ketë pasur, pos nëse ka ndodhur, si në rastin e vitit 1980-81, kur Tirana duhet të kishte dhënë ndihma të shumta financiare përmes Sabri Novosellës, ndërkohë që ky satrap i kishte përvetësuar që t'i legalizonte në Shqipëri gjatë tranzicionit dhe në Kosovë pas çlirimit, si investime private, duke dhënë shembullin fillestar kriminal për masakrën urbanistike në Prishtinë. Vazhdoj të dyshoj që qeveria e Tiranës të na ketë dhënë ndihma financiare përmes ndonjë individi dhe ai t'i ketë përvetësuar ato, gjatë këtyre viteve për të cilat po flasim. Atëbotë Shteti shqiptar ishte përballur me krizë të rëndë ekonomike, për të mos thënë të vërtetën e hidhur, ishte përballur edhe me krizën për bukën e gojës për popullsinë.

Sa për ndonjë përkrahje politike, gjithashtu, s'besoj të ketë pasur, sepse qeveria e Tiranës po përballej me luftën për mbijetesë të vetes se saj.

Viti 1989: Çfarë ndodh në Kosovë?

(B.I.: / Shënim:)

Viti 1989, pa asnjë dyshim, ka qenë një ndër vitet e sprovës së madhe të Lëvizjes dhe pararendës i ngjarjeve që do të vinin një dekadë më pas.

Nëse ngjarjet e vitit 1989 e kanë fillesën në pranverën e vitit 1981, edhe ngjarjet e vitit 1998 e kanë burimin e tyre në tetorin dhe nëntorin e vitit 1989. Kjo është një e vërtetë që mund të argumentohet.

Ndryshe nga herë të tjera, Lëvizja nuk u gjend e papërgatitur. Në të vërtetë, ajo ishte shkaku kryesor i ngjarjeve që ndodhën, që nga greva e minatorëve të "Trepçës", marshimet e mëdha nëpër rrugët e Kosovës, demonstratat e deri te përleshjet e atyre ditëve.

Përse e mbështes tezën se ngjarjet e fundit të vitit 1989 e kanë gjetur Lëvizjen të përgatitur dhe udhëheqëse të tyre?

Ka disa ngjarje, fakte e dëshmi që e vërtetojnë këtë. Në janarin e vitit 1989, sipas vendimit të Komitetit Drejtues, në Kosovë, ilegalisht, u futën Ali Ahmeti dhe Hajdin Abazi. Për të ruajtur fshehtësinë u përhap e dhëna se Ali Ahmeti ishte dërguar me shërbim në Amerikë, ndërsa Hajdin Abazi në Australi. Në Kosovë, ndërkohë, ishte ngritur një plejadë e re liderësh, disa nga të cilët sapo kishin dalë nga burgjet serbe e të tjerë ishin ende në fshehtësinë e tyre. Spikatën Fadil Vata, Afrim Zhitia, Adem Jashari, Sabri Kiçmari, Bardhyl Mahmuti, Halil Selimi, Shaban Muja, Ramiz Lladrovci, Ramadan Avdiu, Hasan Ramadani, Ali Ajeti, Fahri Fazliu, Bedri Blakçori dhe të tjerë.

Cili ishte misioni i njerëzve të dërguar?

Në një bisedë me Ali Ahmetin, pikërisht për vitin 1989, ai tha:

"Qëndruam në Kosovë nga janari deri në qershor 1989. U morëm me organizimin e grevave të minatorëve, të studentëve dhe të popullit. Shtabin organizativ dhe teknikën për përgatitjen e trakteve e kishim në Obiliq, në shtëpinë e familjes së Sahit Krasniqit. Bazën tjetër e kishim në Llap, te Shaban Ajeti dhe te Nazmi Llapashtica i Dyzit. Kurse shtabin qendror, siç i thoshim, e kishim në Divlakë, në shtëpinë e vëllait të Nezir Zogajt. Në këtë shtëpi mbajtëm Konferencën e Parë të Lëvizjes Popullore. Merrnim pjesë rreth 40 veta, me sa mbaj mend. Suksesi për të mos u goditur nga armiku kësaj radhe ishin bazat konspirative në fshatra, në dallim nga herët e tjera, që i kishim kryesisht në Prishtinë".

Fundi i tetorit dhe fillimi i nëntorit, edhe në këtë periudhë sprove të madhe, ishin një kulm i ri. Lëvizja organizoi demonstrata e protesta në të gjitha qendrat e banuara. Pati përleshje e zemërime që mund të shkonin drejt kryengritjes. Vrullshëm po ngrihej vala e protestës. Ishte momenti kur gjithçka po ndryshonte rrjedhën e saj. Mendoj se kjo ishte koha kur Lëvizja, edhe një herë, nuk shkruante, por bënte histori. Njëri nga ata që e bëri këtë histori ishte Afrim Zhitia. Nuk jam i gabuar kur them se fjalimi i tij para njerëzve, krejt haptas dhe shumë burrërisht, ishte një moment i madhërishëm për zhvillimin e Lëvizjes në këtë kohë.

Dhe, si për ta përmbyllur gjithçka në traditën e saj, ajo u gjakos rishtas. Mes të tjerëve, u vranë Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu. Të rrethuar nga njësitë speciale serbe të kohës, ata luftuan për katër orë. E veçanta ishte se ata vërtet ishin të madhërishëm, por jo të madhërishëm në vetmi.

Si ndodhi rënia e tyre? Mendoj se duhet bërë një gërmim në arkivin e organizatës për të nxjerrë dëshminë e njërit nga njerëzit më të afërm të tij, Ramadan Avdiut. Mendoj se duhet bërë kjo, edhe për faktin se ai ishte udhëheqësi kryesor, politik e ushtarak, i Lëvizjes dhe se vrasja e Afrimit, nëse i referohem një thënieje të Hashim Thaçit, e vonoi për disa vite luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ramadan Avdiu rikujton:

"Në shtator të vitit 1989, në aksion gjatë shpërndarjes së traktеve në Gllogoc, u kapën dy shokë Bekim Krasniqi dhe Agron Shala, kurse në Prishtinë u arrestuan Afërdita Veliu dhe Fexhrije Bilalli. Si pasojë erdhi arrestimi i Shaban Mujës. Si rrjedhojë e gjendjes së krijuar u desh të kalojë në ilegalitet Afrimi dhe Fadil Vata. Fillimisht ata erdhën tek unë, se kam qenë në një celulë me Afrimin dhe Fadilin dhe më shpjeguan gjendjen e krijuar. Ata më sugjeruan se duhet të kooptohesha patjetër në komitetin drejtues të OMLK-së, për shkak se edhe Bardhyli (Mahmuti) ishte i rrezikuar dhe ishte e domosdoshme të tërhiqeshim duke kaluar në ilegalitet, përndryshe do të mbetej një strukturë e paqëndrueshme dhe që rrezikonte edhe ekzistencën e organizatës. Për një javë rresht ata qëndruan në shtëpinë time dhe hartuam planin e veprimit të mëtejshëm. U morën masat parandaluese për të gjithë

organizatën për ndërprerjen e arrestimeve, u siguruan bazat për qëndrim të mëtejshëm të Afrimit, u morën masat që Fadili të nxirrej jashtë vendit për shkak të gjendjes së tij të rëndë shëndetësore dhe u thirr mbledhja e komitetit drejtues. Kjo mbledhje u mbajt më 22 tetor në Prishtinë, në banesën e Binak Berishës. Në këtë mbledhje u bë kooptimi im në komitetin drejtues dhe planifikuam që me 30 tetor të organizonim demonstrata. Më 27 tetor shpërndamë traktet. Demonstratat që organizuam në shumë qytete të Kosovës ishin të fuqishme. Më 2 nëntor u vranë Afrimi dhe Fahriu.

Shkaqet e vrasjes së Afrimit

Në mbrëmjen e 1 nëntorit 1989, pasi janë ndarë prej demonstratës, Fahriu dhe një shok tjetër, Behlul Labënishti, kur kanë shkuar të vizitojnë dikë në spitalin që është afër hekurudhës, janë sulmuar prej policisë. Fahriu bëri rezistencë. Behluli u kap dhe u arrestua. Fahriu, meqë iu shmang arrestimit, atë natë shkoi në bazën ku ka ndenjur Afrimi. Ai e ka ditur atë bazë. Afrimi kishte shkuar aty tri ditë më herët. Tha se do të shkonte të rrinte me dy shokë ilegalë: Hasan Ramadanin dhe Bedri Blakqorin.

Të nesërmen, në orën gjashtë pasdite, unë kisha caktuar një takim me Afrimin për t'i dërguar disa materiale për nxjerrjen e buletineve "Zëri i Kosovës" dhe "Rruga e Lirisë". Diku nga ora 2 e pasdites ka ardhur tek unë, Ilazi (Zhitija) dhe më tha se e kishte parë Afrimin me një djalë tjetër, që shkonte rrugës kah Velania. Afrimi nuk duhej të dilte prej bazës ku ka qenë, mendova. Më vonë, pasi përcolla Ilazin, erdhi tek unë një shok tjetër, i cili më tregoi se janë rrethuar në Kodër të Diellit, në banesën e „Shpëtimit" (Fahri Fazlisë). Fillimisht kam dalë dhe kam shkuar

në bazën ku kanë qenë. Atje kam takuar Hasan Ramadanin dhe Bedri Blakqorin që ishin të strehuar në atë bazë dhe i pyeta përse kishte dalë Ismaili (emri konspirativ i Afrimit). "Mbrëmë, - më thanë ata,- pasi ka ardhur ai djali (sepse nuk e njihnin për shkak të konspiracionit), ata kanë biseduar bukur gjatë. Në mesditë ai ka dashur të dalë, por Afrimi i tha se do ta shoqëronte dhe shkuan bashkë. Vetëm një gjysmë ore pasi janë vendosur në banesën e Fahriut në Kodër të Diellit, ata u ndodhën të rrethuar.

Asnjëherë nuk e kam pasur të qartë arsyen përse ata kanë dalë dhe kanë shkuar në shtëpinë e Fahriut."

(Arkivi i LPK-së,10 maj 1998. Kaseta 6/a)

(B.I.:) - *E kishim të domosdoshme të ktheheshim pas në kohë, në mos tjetër, edhe si shenjë nderimi për një nga periudhat më të spikatura të Lëvizjes. Por, le të kthehemi në rrjedhën e bisedës sonë, e cila, siç të kam paralajmëruar, do të jetë e gjatë.*

Në vitin 1989 ishin bërë 4 vjet nga vdekja e Enver Hoxhës, i cili për shumë kohë e për shumë njerëz në Kosovë e jashtë saj kishte qenë idhull. Edhe për njerëz të Lëvizjes kështu kishte qenë, besoj që nga fillimi, më shumë duke menduar pas tij shtetin amë dhe bashkimin me të. Në një intervistë me shtypin gjerman, pyetjes se a do të bashkohej Kosova me shtetin shqiptar nëse do të ishte mbretëri, republikë demokratike apo ashtu siç ishte, Jusuf Gërvalla i është përgjigjur shkurt: "Me çdo kusht, në secilin variant".

Si është pritur nga pjesëtarët e Lëvizjes vdekja e Enver Hoxhës? Të mos harrojmë se Lëvizjen, deri vonë, jo pak njerëz e kanë cilësuar si lëvizje enveriste, nostalgjike dhe ka pasur

mjaft që e kanë dashur Enverin.

Ndikoi vdekja e tij në marrëdhëniet e Lëvizjes me shtetin shqiptar?

(I.K.:) - Jo për të gjithë anëtarët e Lëvizjes Enver Hoxha ka qenë idhull. Lëvizja kishte program politik pluralist dhe Statuti i saj mundësonte anëtarësimin në Lëvizje të çdo shqiptari / shqiptareje që përkrahte kërkesën për status të Republikës për Kosovën, pavarësisht bindjeve të tyre ideopolitike. Në Lëvizje kam njohur edhe joenveristë e madje edhe antienveristë, nëse mund t'i cilësoj kështu.

Kur jemi te kjo tematikë shpesh ndodhin spekulime e ngatërrime të gjërave. Shumica e shqiptarëve të Kosovës që e ndienin veten për "enveristë", në të vërtetë nuk ishin të brumosur me doktrinën e tij komuniste, por ishin vetëm patriotë shqiptarë me përcaktim radikal antijugosllav. Pra ishin "enveristë" sepse e çmonin Enver Hoxhën si udhëheqës të shtetit amë. Ndoshta vetëm disa nga udhëheqësit e OMLK-së kishin bindje të thekur komuniste dhe Enver Hoxhën e çmonin si klasik të komunizmit. Por, jo të tjerët, kurrsesi jo. Për ilustrim po marrë shembullin e Jusuf Gërvallës. Nuk besoj të kem njohur bashkëveprimtar më "enverist" fanatik sesa Jusuf Gërvallën. Ai vërtet e çmonte Enver Hoxhën për idhull, ama, vetë ai, në parim, ishte antikomunist, sepse doktrinën komuniste e identifikonte dhe e diskualifikonte si doktrinë sllavomadhe. Kishte të tjerë që ndiheshin "enveristë" vetëm pse Enverin e kritikonte Beogradi dhe lakenjtë e tij shqiptarë në Kosovë. Kurse tani disa e ndiejnë veten për "enverist" kryesisht për inat të "antikomunistëve", "demokratëve" dhe "kozmopolitëve".

Shumë "enveristë" të Lëvizjes u pikëlluan kur vdiq Enver Hoxha dhe organizuan tubime, madje në secilin përvjetor or-

ganizuan tubime përkujtimore. Pas vitit 1998, - kjo përkoi me zgjedhjen tuaj si drejtues i Lëvizjes, - nuk u zhvilluan më, edhe pse ndoshta njerëzit nuk patën më kohë të "përmalloheshin" për të.

Mua personalisht vdekja e Enver Hoxhës me pat zënë në Suedi, në Klubin shqiptar "Liria" në Malme. Xhemajl Duraku me bashkëveprimtarë organizuan vizitë në Ambasadën shqiptare në Stokholm. Me morën me vete dhe kryem formalitetin tonë, duke u regjistruar në librin e zisë.

Vdekja e Enver Hoxhës nuk besoj të ketë ndikuar në raportet e Lëvizjes me shtetit shqiptar, meqë as më parë nuk kishim raporte intensive, por kryesisht të natyrës folklorike, do të thosha.

Pluralizmi dhe Lëvizja

(B.I.:) - *Në vitin 1990, pas demonstratave, si për të dashur të shfryjnë vrullin, në Kosovë, me lejen e Beogradit, filloi regjistrimi i partive politike. E para u regjistrua LDK-ja, programi i së cilës, nëse i besohet Mehmet Krajës, njërit nga bashkëthemeluesit, u bë jashtë tyre, nga një funksionar i lartë i kohës, pra nga një njeri që de fakto e de jure ishte në shërbim të qeverisë represive të Beogradit.*

Në këtë kohë, në komunikatat e para të saj, Lëvizja përkrahu krijimin e partive, pastaj, befas, ishte ajo që u gjend në tehun e fjalëve dhe të sulmeve.

Si u përjetua në diasporë krijimi i partive politike në Kosovë?

(I.K.:) - Fillimisht, edhe ne të Lëvizjes e mirëpritëm for-

mimin e LDK-së, edhe në emigracion, meqë ngjau sikur kur ndodhin përmbytjet e mëdha e marrin para vetes gjithçka. Pak kohë më parë Lëvizja jonë kishte pësuar goditje të rënda. Asaj i ishte vrarë udhëheqësi Afrim Zhitia dhe veprimtarë të tjerë. Tani po shpresonim se veprimtarët tanë do të kamufloheshin përmes LDK-së që të zhvillonin veprimtari patriotike e çlirimtare, pa u përndjekur, burgosur e vrarë, si deri atëherë. Sigurisht, në mirëpritjen tonë duhet të ketë ndikuar edhe shpresa se gjithë ajo revoltë popullore që kishte ndodhur tani do të materializohej politikisht. Kësaj i duhej shtuar edhe gëzimi se po shpërbëheshin strukturat e deriatëhershme komuniste, por shumë shpejt u zhgënjyem. Dhe u zhgënjyem sapo morëm vesh se çfarë programi politik kishte, cilët ishin ideatorët e parë themelues, etj. Informimit tuaj do t'i shtoja se programin i saj, jo vetëm nuk e kishin hartuar bashkëthemeluesit e saj, por ai u kishte ardhur në gjuhën serbe dhe Jusuf Buxhovi vetëm e kishte përkthyer (siç sqaron bashkëthemluesi nr 2, Zotëri Mehmet Kraja).

Më duket se, para LDK-së, në Beograd duhet të jetë "legalizuar" njëfarë UJDI, subjekt panjugosllav, të cilin në Kosovë e prezantonin Shkëlzen Maliqi, Veton Surroi e ca si ata, bijë të ish-funksionarëve komunistë. Ndoshta juristët do të këndellen ndonjëherë për të shpjeguar se sa ishte legal (ligjor) regjistrimi i subjekteve politike të Kosovës në Beograd. E kam me të dëgjuar se, bazuar në ligjet e atëhershme, ato do të duhej të regjistroheshin në Prishtinë, si edhe subjektet politike të republikave të tjera, në kryeqytetet e tyre.

Fola për çështje të regjistrimit, sepse ai është spekuluar edhe përtej absurditetit, duke i quajtur subjektet politike të Kosovës, të regjistruara në Beograd, parti "legale" (ligjore), kurse

Lëvizja, e cila nuk mund të regjistrohej edhe po të donte, quhej "ilegale" (joligjore) vetëm pse nuk ishte regjistruar në Beograd. Ndonjë i painformuar dhe jokompetent shprehjen ilegale e përdorte dhe e përdor shpesh në vend të shprehjes i/e fshehtë ose klandestine. Kështu bëhej fushatë kundër Lëvizjes, duke e inkriminuar atë si "ilegale" dhe vazhdohet të inkriminohet, sot e kësaj dite, ndonjëherë pa vetëdije, por ndonjëherë edhe qëllimshëm. Kësaj i duhet shtuar edhe fakti se partitë "legale" asnjëherë, as pas Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në vitin 1990, nuk abroguan regjistrimin e tyre në Beograd që të regjistroheshin, përkatësisht të legalizoheshin, në Republikën (virtuale) të Kosovës.

Hidhërimin kryesor kundër LDK-së disa më të informuar te Lëvizja e patën kur mësuan që programi i saj, që në pjesën hyrëse, fillonte me një falsifikim skandaloz, se populli i Kosovës kishte shprehur vullnetin e lirë për të jetuar në Jugosllavi dhe se vazhdonte të kishte atë përcaktim. Dhe kjo po ndodhte në kohën kur parlamentarët e Kosovës në Kuvendin Federativ të RSFJ-së po i kundërviheshin delegacionit të Republikës së Serbisë, që kishin kërkuar që Kuvendi Federativ të shfuqizonte juridikisht vendimet e Konferencës së Bujanit.

Ndërsa mua, dyshimin ndaj LDK-së ma kishte rritur nismëtari i parë për themelimin e saj, gazetari, shkrimtari dhe historiani Jusuf Buxhovi. Atë besoja se e njihja mirë. Dhe e njihja qysh nga koha kur po themelonim Klubin në Dyzeldorf, në mars të vitit 1978. Ai atëherë ishte korrespondent i gazetës "Rilindja", i akredituar në Bon. Nuk e paragjykoja, sado që dija se, nëse nuk do të ishte i verifikuar si kuadër besnik, pushtetarët komunistë nuk do ta kishin lejuar që të ushtronte profesionin e korrespondentit të "Rilindjes" në Gjermani. Në tetor të vitit 1979, gjatë panairit të librit në Frankfurt, me Jusufin

u takuam te stenda e "Rilindjes". Ishte edhe sekretari i parë i ambasadës jugosllave në Bon, Zotëri Shefqet Hashani. Për ata që nuk e dinë, rëndom sekretarët e parë në ambasada caktohen nga shërbimet inteligjente shtetërore. Kjo kishte ndodhur edhe me Shefqetin. Para se të caktohej në këtë detyrë, kishte qenë drejtor i drejtorisë së 5-të të UDB-së krahinore në Prishtinë. Nga stenda e "Rilindjes" në atë panair Shefqeti propozoi të vizitonim edhe stendën e Tiranës. Jusufi bëri sikur po hezitonte nga frika se do të zbulohej si patriot. Shefqeti e qetësoi situatën, duke i thënë se nuk ishte e nevojshme të simulonte. Në tallje e sipër ai lëshoi një informatë këshilluese, "të keni kujdes ju armiqtë e shtetit, - siç na quante ai me intonacion sarkastik, - të mos flisni në prani të Jusufit, sepse ai është i detyruar t'm'i bjerë informatat...". Përndryshe, Shefqeti pat merita të mëdha në themelimin dhe masivizimin e Klubit tonë në Dyzeldorf, sepse bëri që emigrantët tanë, të cilët frikësoheshin nga kërcënimet e konsullatës jugosllave të këtij qyteti, të trimërohen nga përkrahja që ai na dha. Në maj të vitit 1981, Shefqetin e arrestuan në aeroportin e Beogradit, kur po kthehej për vizitë në vendlindje, në Gremë të Ferizajt. E dënuan me 8 vjet burg dhe e vuajti gjithë dënimin.

Pos këtyre njohurive autentike për Zotëri Buxhovin, kisha edhe informatën, se Hysen Gegën e Sallagrazhdës së Suharekës e kishte marrë në pyetje po ai Jusuf, si njohës i veprimtarisë sonë armiqësore në Gjermani. Duke pasur informata dhe njohje personale, gjykoja se nisma e Jusuf Buxhovit nuk duhej të ishte autentike, pra nga vetë vullneti i tij, por zbatim urdhri, sepse kisha bindjen se kuadro të tilla vetëm zbatojnë urdhra. Dyshimin ma rriste informimi se nismëtari i parë kishte bindur njeriun e dytë, Mehmet Krajën, (dikur përfaqësues i Kosovës në redaksinë e organit ushtarak "Fronti"). Mbase kisha të drej-

të të dyshoja se edhe Mehmeti, po të mos kishte qenë kuadër i verifikuar, vështirë se do ta pranonin për anëtar të asaj redaksie. Sigurisht, nuk besoja se Mehmet Kraja ishte në të njëjtat ujëra si Buxhovi, por kisha drojën se kishte mbetur peng i mirëbesimit ose i dëshirës për të ndryshuar diçka. Skenari parashihte që këta të dy të kooptonin Ibrahim Rugovën për kryetar të LDK-së. Një njeri që kishte vënë në gjumë Lidhjen e Shkrimtarëve, dikur të revoltuar, do të mund të ishte më i përshtatshmi për të vënë në gjumë gjithë valën e protestave dhe revoltave të popullsisë aktive shqiptare të Kosovës. Të tjerë bashkëthemelues duhet të kenë qenë kryesisht dekor dhe statistë "ilustrues".

Kurse për Ibrahim Rugovën e kisha thelluar dyshimin se ishte kasnec, argat i Beogradit, që kur gazetarja "gjermane" Renate Flotau e kishte intervistuar në ditën kur po shënohej 600-vjetori i Betejës së Kosovës. Kjo gazetare ishte e angazhuar në revistën gjermane "Der Spiegel", e njohur si proserbe, meqë nacionalizmin serbomadh e ngatërronte me antiimperializmin amerikan, për çka kjo revistë është e njohur. Kjo farë Renate Flotau ishte bijë e një çetniku serb, i strehuar pas Luftës së Dytë Botërore në Gjermani, por, për t'u kamufluar si gjermane, e kishte ndryshuar emrin. Për të më kishte folur redaktori i revistës gjermane "Der Spiegel" për Ballkan, Roland Hifwiler, miku im që nga koha e studimeve. Nga ai dhe të tjerë pata formuar dyshimin se Renate Flotau ishte një punonjëse e dyfishtë e shërbimeve serbe dhe gjermane, por, gjithsesi, ajo ishte një serbomadhe e thekur. Gjetja e saj për të intervistuar pikërisht Ibrahim Rugovën, kur ai ende nuk kishte as emrin dhe as aureolën e një lideri, kur nuk ishte shquar për asnjë akt rebelimi e, për më tepër, as për një akt kundërshtimi, ma kishte rritur dyshimin që kisha ndaj tij, qysh kur Rrahman Morina

e kishte imponuar atë si kryetar të Lidhjes së Shkrimtarëve. Madje edhe më herët, qysh kur ia dija prejardhjen familjare dhe karrierën e tij të mëparshme.

Këto të dhëna dhe dyshimet më kishin krijuar dilemën se mos ky riorganizim "legalist" në Kosovë, pas zhbërjes së të gjitha strukturave të deriatëhershme komuniste, po ndodhte për ta kontrolluar, për ta disiplinuar dhe për ta paqësuar rezistencën e deriatëhershme aktive gjithëpopullore, siç kishte ndodhur me Lidhjen e Shkrimtarëve. Megjithatë, në fillim të vitit 1991 u angazhova të përgatis me dizajn të kultivuar dhe t'i shumëzoj materialet e LDK-së. Gjatë demonstratës se Lëvizjes në Bon angazhuam aktivistë për t'i shpërndarë ato materiale që të motivonim ata që frikësoheshin të anëtarësoheshin në Lëvizje, duke i ndihmuar që të formonin e të organizoheshin në LDK-në, tashmë masive. Ne na interesonte që emigrantët të vrisnin frikën për t'u angazhuar për pavarësimin e Kosovës, qoftë edhe përmes LDK-së.

Por, fatkeqësia ndodhi kur LDK-ja në Gjermani do të caktonte për kryetar të saj Zotëri Hafiz Gagicën, ish- bash-këveprimtarin tonë, të cilin e kishim përzënë prej kohësh nga radhët e Lëvizjes, meqë ishte një lake i Sabri Novosellës dhe i Xhafer Durmishit. Ka mbetur e pashpjeguar, përse Prof. Ali Aliu, i cili po kryesonte një "grup pune" të LDK-së nga Prishtina, caktoi pikërisht Hafiz Gagicën për kryetar të LDK-së në Gjermani? Që kur kishte ndodhur përzënia e tij nga Lëvizja, Gagica nuk ishte ndier askund. Kishte mbetur veçse një hije e askundshme dhe, sa herë që do të mund ta shkundje atë politikisht, mund t'i binin vetëm grimcat që i kishin mbetur nga Lëvizja. Bashkë me të e, shpeshherë, edhe për të, shkuan edhe disa nga shokët që ishin larguar ose përzënë prej nesh, të

cilët, një ditë të bukur, e ndien veten sikur ishin *kuadrizuar*, pra ishin bërë "të vlefshëm", dhe, duhet thënë, qoftë edhe për hir së të vërtetës, se ishin pikërisht ata që ishin më të egër dhe më destruktivë ndaj Lëvizjes. Siç ndodh rëndom, pas pak, disa nga ata u larguan edhe nga Lidhja Demokratike. Jo për shkak të ideve, sepse nuk kishin, as për shkak të parimeve, sepse i kishin humbur dhe filluan t'i këlthasin njëri-tjetrit aq kohë sa bënë jetë në këtë mjegullinë. Kjo ndodhi sepse, bashkë me ta, u futën edhe njerëz të devotshëm, të ndershëm, që menduan se tashti është koha për ta bërë Kosovën shtet sovran përmes bisedave dhe 3-përqindëshit të tyre. Kam pasur dhe kam ende respekt për njerëz të tillë, megjithëse shpeshherë kam ndier dhembje për botën e tyre që, me siguri, sa më shumë shkonte koha, aq më shumë ndrydhej.

Lidhja e filloi fushatën e saj kundër Lëvizjes. Kjo tashmë dihet, megjithëse ne e kishim pritur si një ogur të mirë krijimin e saj. Kjo nuk ndodhi vetëm në Perëndim, por edhe brenda, në Kosovë dhe, nuk ndodhi vetëm si objekt idesh apo përpjekjesh, por, mjerisht, jo rrallë ata bënin të njëjtën punë përgjuese e përçuese që kishin bërë para tyre "buxhovët" e shpërndarë anekënd Perëndimit.

Pos Gagicës edhe të tjera figura të njohura të Lëvizjes u bënë drejtues të Lidhjes Demokratike. Midis tyre edhe njëri nga drejtuesit kryesorë, Gani Syla, që u bë njëkohësisht edhe kryetar i LDK-së në Zvicër, edhe kryetar i 3-përqindëshit.

(B.I.: / Shënime:) *- Në kohë të ndryshme unë kam bërë shkrime rreth ideve, politikës dhe mendësisë thellësisht komuniste të Lidhjes Demokratike të Kosovës, sidomos në dy gjëra themelore: në mosnjohjen e mendimit ndryshe, pasi kush nuk mendonte njëlloj si ata do të ishte patjetër i shitur, argat serb,*

enverist etj., dhe, së dyti, në përcaktimin e saj ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kjo do të ishte më kryesorja. Sigurisht, herë pas here, jam ndalur edhe në abuzimet që kanë ndodhur me fondin e 3-përqindëshit, me abuzimet e gjakut të dëshmorëve të Drenicës apo me kacafytjen për aksionin për "Pavarësinë e Kosovës", ku shefi i LDK-së në Perëndim nuk e njihte liderin e qeverisë, po në Perëndim.

Mirëpo asnjëherë, e theksoj, asnjëherë nuk kam shkuar në përcaktimet e mia kaq thellë dhe kaq larg sa do të shkonte, pas luftës, ish-ministri i Informimit në qeverinë e Bukoshit dhe de fakto njeriu më i rëndësishëm pas tij dhe bashkëthemelues i FARK-ut.

Në një prononcim të tij në gazetën "Epoka e re", Zotëri Xhafer Shatri, duke replikuar me një shkrim timin, shkruante tekstualisht:

"Fondin e Republikës së Kosovës, ku kanë mituar me mijëra patriotë dhe ku, në emër të luftës për liri, ishin grumbulluar qindra milionë marka gjermane, kopukët arritën ta privatizojnë. Ndërkohë që në kufi vriteshin si qengjat njomakët që kishin ardhur për armë, paratë e këtij fondi ruheshin për "ditë të zeza", ruheshin për Kosovën e pasluftës për të mbijetuar politikisht kryekopukët "institucionalë", duke blerë me paratë e fondit vota e parti të ndryshme, duke zhvilluar hapur me paratë e popullit veprimtari kundër tij".

E theksoj, ky shënim nuk është nga unë, por nga njeriu i dytë në qeverinë ***Bukoshi****. Megjithëse kanë kaluar dhjetë vjet nga ky pohim, ende askush nuk e ka mohuar atë dhe kjo do të thotë se e kanë pranuar në heshtje. Po ashtu, megjithëse e kam pyetur publikisht Zotëri Shatrin se cilët ishin "kopukët e kryekopukët institucionalë" dhe cilët ishin ata që me paratë e*

fondit të qeverisë zhvillonin hapur veprimtari kundër popullit, ende nuk kam marrë asnjë përgjigje.

Kam qenë gjithnjë i bindur se ata nuk ishin në lëvizjen klandestine, jo vetëm se kjo lëvizje nuk kishte "institucione", por edhe sepse kryekopukët institucionalë ishin shokët e, deri para pak çasteve, edhe miqtë e afërt të Shatrit.

Por le të kthehemi në bisedën tonë. Shënimi ishte vetëm për ata që e thirrën popullin të shkonte pas tyre dhe, më pas, me paratë e këtij populli bënë veprimtari kundër tij.

Pra, kishit krijuar ndonjë dyshim, apo jo?

(I.K.:) - Gjithë këto copëza mozaiku, të cilat së bashku nuk mund të ishin të rastësishme, sepse ishin shumë për të qenë të tilla në të njëjtën kohë, po ma thellonin dyshimin se organizimi "pluralist" në Kosovë zhvillohej sipas një skenari të Beogradit, të mirëmenduar e të planifikuar, i cili përmes liderucëve të partive "pluraliste" po zbatohej me përsosmëri në Kosovë. E, meqë kështu dyshoja, shpesh rikujtoja një mendim të Jusuf Gërvallës:

"Shpesh UDB-ja ka formuar organizata klandestine shqiptare, në dukje patriotike e çlirimtare, si masë preventive për të penguar organizimet e mirëfillta, autentike. Qëllimi i saj ishte zbulimi shqiptarëve që donin të angazhoheshin të organizuar në lëvizje çlirimtare dhe burgosja e eliminimi i tyre fizik. Edhe ato sajesa kanë dhënë rezultat pozitiv, sepse e kanë mbajtur të gjallë frymën se shqiptarët duhet të angazhohen e të organizohen për t'u çliruar..."

(Përifrazim i lirë, bazuar në mbamendje.)

Megjithatë, LDK-së nuk i patëm shpallur luftë të hapur, ar-

miqësi jo se jo, por taktizonim ndaj saj, meqë gjykonim se ashtu do të rrisnim dhe do të konsolidonim më shpejt rezistencën aktive në Kosovë. Njëherit mendonim, se kështu po sajonim në sy të botës shfrytëzimin e të gjitha mjeteve paqësore për t'u çliruar nga Serbia dhe kur ato nuk do të jepnin rezultatin e synuar, të kishim të drejtën legjitime për kryengritje të armatosur çlirimtare. E, meqë jam të ky mendim, një avokat gjerman, për të cilin unë dyshoja se ishte ekspert i angazhuar në shërbimin inteligjent gjerman BND (Bundes Nachrichten Dienst) me pat pyetur: "Si ia dolët të kombinonit me përsosmëri të përkryer angazhimin e kombinuar, paqësor me atë të armatosur, dhe askush nuk e mori vesh cilët ishin ideatorët dhe përse funksionojë perfekt?" Unë iu përgjigja: "Kot dyshoni, nuk kishim as ideatorë aq të sofistikuar dhe as sens për të rakorduar të dy variantet, përndryshe do ta kishin zbuluar shërbimet Tuaja. Organizimin pacifist e kishim të planifikuar e të komanduar nga Beogradi, për ta nënshtruar paqësisht popullin tonë, përndryshe nuk do ta kishte toleruar pushteti nacionalist i Millosheviqit, kurse luftën e armatosur çlirimtare e organizuam vet dhe vërtet u duk sikur e kemi planifikuar e rakorduar me mjeshtri të përkryer..."

(B.I.:) *- Disa nga shokët tuaj të dikurshëm, siç e cilësova edhe më lart, jo vetëm që ngarendën në partitë politike legale, por u bënë edhe drejtues të saj. Hafiz Gagica u bë drejtuesi kryesor i LDK-së në Gjermani, por edhe në gjithë Perëndimin; Shaban Bobaj, një njeri që e respektoj shumë, pavarësisht se kemi shumë vjet që nuk jemi parë, u bë kryetar i degës së saj në Baden Wyrtemberg; Faridin Tafallari, shef i 3-përqindëshit në këtë Land dhe shumë të tjerë që ose shkuan në LDK ose heshtën. Mendoj se kjo ka qenë pika më e rëndë për Lëvizjen,*

jo sepse i ikën disa anëtarë, sado të vyer të kishin qenë, por se tashmë filloi të bulëzojë e pastaj të sundojë mendimi se ishte krejt e mundshme që Pavarësia e Kosovës të fitohej pa luftë.

Si i përjetuat këto ngjarje? Pse ndodhën disa largime? Si u krijuan marrëdhëniet me partitë e reja politike?

(I.K.:) - Tre individët që përmendët, ishin pjesë e Lëvizjes qysh prej vitit 1982. Gagica i pat shkuar mbrapa Sabri Novosellës në vitin 1984 dhe pas ca muajve u shuajt. Bobaj duhet të jetë zhgënjyer nga "trashëagimtari" i Jusufit, Xhafer Durmishi, dhe prandaj duhet të jetë pasivizuar gjatë viteve 1984-1990. Tafallari që vetëshkëputur nga Lëvizja me pak veta në vitin 1987. Sigurisht, nuk u kanë shkuar pas shumë veta të Lëvizjes, ndoshta vetëm 7-8 veta në Gjermani. Pra kanë qenë lëvizje të vetmuara të tyre, të cilat, në atë kohë, janë pritur pa asnjë lloj zemërimi e mërzie. Në të vërtetë kishim një farë keqardhjeje kur shihnim si po shndërroheshin kaq shpejt disa nga të vetëlarguarit apo të heshturit në militantë pa ide, pa fryte, pa mendim. Por, sidoqoftë, kur takoheshim me ta, ne kishim të njëjtin qëndrim si më parë, nuk i bënim hasha, nuk i trazonim as kur na trazonin. U lëshonim rrugë, sepse e dinim se ishte në një rrugëtim të përkohshëm. Në të vërtetë, në këtë periudhë, Lëvizja mund t'u jetë dukur njerëzve si një lëvizje që po akullohej. Kishte edhe nga ata, më të shumtën jashtë Lëvizjes, që mendonin se kishte kaluar koha e protestave, e marshimeve, e gjakosjeve. Mirëpo unë mendoja dhe e kam këtë bindje edhe tani, se ajo kohë ka qenë periudha e ndërrimeve intensive në vetë konceptin e Lëvizjes, i cili u bë më i qartë, më i thellë dhe më i detajuar. Të sjell një shembull: pikërisht në këtë kohë, që dikush mund ta quante si kohë e mjegullimit të Lëvizjes, filloi të merrte formë ideja e aksioneve luftarake, e përgatitjes ushtarake dhe të mbizotëronte mendimi se nga fjalët duhej

kaluar në aksione. Nuk është për t'u habitur se këtë e kërkoi së pari pikërisht Këshilli popullor i Lëvizjes në Drenicë, ku ishte Adem Jashari. Pra, nuk ishte periudhë e fjetur, por e fillesës së përgatitjes. Si shkuan ngjarjet më pas dhe kush kishte të drejtë, këtë e dëshmoi koha.

Në ato zhvillime e kthesa të mëdha të tillët vetëm zvogëloheshin, që të "rriteshin" sërish vetëm kur ndodhi "nisma" e Jusuf Buxhovit, në dhjetor të vitit 1989.

(B.I.:) *- LDK-ja është krijuar më 23 dhjetor 1989, pra vetëm disa javë pas vrasjes së Afrim Zhitisë, Fahri Fazliut dhe shumë të tjerëve dhe menjëherë pas përfundimit të grevës së urisë së minatorëve të Trepçës. Sido që të thonë, kjo ishte një gjetje e mjaftueshme për të krijuar iluzione të humbura. Do të ketë disa takime mes përfaqësuesve të Lëvizjes brenda dhe atyre të LDK-së. Disa do të jenë të ashpra, por i ashpër do të jetë sidomos shtypi legal. Në një takim të tillë, zotit Fehmi Agani i thanë t'i lidhë qentë e shtypit, në mos, nëse duan të hapen të gjitha, Lëvizja ka shumë më tepër për të thënë dhe për të bërë publike veprimtarinë e atyre që përfaqësonin legalizmin politik. Agani u përgjigj se kjo nuk ishte në dorën e tij, se shtypi ishte i varur nga zoti Rugova dhe, më pas, pati një heshtje.*

Nga vitet që shkuan, si e përcaktoni tani këtë vijë, do të thosha zbutëse dhe disi pritëse të Lëvizjes në çastet e para të legalizimit dhe në bisedat e para?

A është ndier kjo frymë edhe në Perëndim?

(I.K.:) - Meqë nuk kam informata konkrete se si kanë ndodhur zhvillimet në Kosovë, mund të jap vetëm përgjigje të hamendësuar. Fushata e LDK-së dhe e shtypit të kontrolluar prej saj kundër Lëvizjes "ilegale" dyshoj të ketë qenë e orkestruar nga Beogradi, siç ishte edhe "alternativa kosovare", gjeg-

jësisht organizimi "legal" pluri-partiak. Në Perëndim bëmë goxha përpjekje për të bashkëpunuar me LDK-në, por, fatkeqësisht, rezultuan të dështuara. Tashmë, nga një front kundër Beogradit, që kishim deri atëherë, na u imponua edhe një front i ri, brendashqiptar. Dhe ky ishte një argument më shumë se LDK-ja ishte një sajesë e Beogradit dhe më vinte keq për gjithë ata veprimtarë që u angazhuan në gjirin e saj, duke u lodhur e tjetërsuar, gjë që bëri që Kosova të ishte hapësira më e paqësuar në ish-Jugosllavi.

(B.I.:) *- Fundi i vitit 1990 ishte edhe fundi i komunizmit në Shqipëri dhe u vendos edhe aty pluralizmi. Ka ngjasime në gjithë këtë periudhë me atë që kishte ndodhur një vit më parë në Kosovë.*

Si u përjetua kjo nga Lëvizja?

(I.K.:) - Fundi i komunizmit në Shqipëri ishte i pashmangshëm, sepse udhëheqja e Partisë së Punës e kishte sjellë shtetin para kolapsit të mjerë. Mua më rastisi të hyj në Shqipëri për herë të parë, më 29 dhjetor 1990. Nga fundi i janarit 1991, gazeta berlineze TAZ, gjegjësisht kryeredaktori i saj Erich Ratfelder, më angazhoi si korrespondent. Deri në korrik të viti 1992 qëndrova në Shqipëri dhe them se isha dëshmitar i një fatkeqësie të rëndë dhe i një tranzicioni kaotik, tejet sfilitës, por deri diku i kontrolluar nga kuadrot udhëheqëse të PPSH-së, Ramiz Alia, Fatos Nano e Sali Berisha, e të tjerë.

Besoj, si unë, edhe shumë veprimtarëve të Lëvizjes, ballafaqimi me gjendjen reale në Shqipëri, duhet ta kenë përjetuar me zhgënjime e trauma. Sa për informim konkret, sapo u ballafaqova me portin e Durrësit, nga zhgënjimi sfilitës pësova një si shok në formë të fikëti dhe gati sa nuk përfundova në "botën tjetër".

Rëndimi i gjendjes dhe vështirësia e procesit të demokratizi-

mit ma futën frikën në palcë se shteti dhe shoqëria shqiptare po zhbëheshin. Ndikim të madh kishin edhe shërbimet e fshehta serbe. Mbaj mend që një parlamentar serb, në Parlamentin e Beogradit, t'i ketë drejtuar një pyetje ministrit të brendshëm të Serbisë (në mos qoftë pikërisht ai tani "investitor" i madh në Tiranë) për 40 milionë dollarë të ndara nga buxheti i Serbisë për veprimtari subversive në Shqipëri, si ishin shpenzuar ato dhe a kishin dhënë rezultate? Ministri iu përgjigj se 40 milionë dollarët të ndara legalisht dhe shumë të tjera ilegalisht do të jepnin rezultatet e planifikuara.

(B.I.:) *- Me fillimin e vitit 1991, në Shqipëri pati edhe ngjarje të tjera, disa nga të cilat ishin tronditëse, por edhe të domosdoshme, si: heqja e përmendores së Enver Hoxhës, heqja e mitit të rremë të Shqipërisë etj., etj., por, mbi të gjitha, vendi u hap. Shqiptarët e Kosovës vërshuan, disa për mall, disa për tregti, disa për të qarë e disa për t'i shtuar hallet.*

Lëvizja ishte mbështetur deri asaj kohe, të paktën ashtu dihej, në shtetin shqiptar, në figurën e Enverit. Këto ranë në pak kohë. Çfarë ndodhi me Lëvizjen, si u përshtat ajo në këtë kohë të re?

(I.K.:) - Ngjarjet tragjike e tronditëse pasonin njëra-tjetrën. Them, mirë që asnjë shteti nuk i interesoi ta pushtonte Shqipërinë, sepse do ta pushtonte pa shkrepur njeri një plumb rezistues. Për ilustrim po sjell një anekdotë, që e kisha dëgjuar atëherë: *I thotë një korçar një vlonjati: "T'i shpallim luftë Amerikës, që ta provokojmë për të na pushtuar dhe të na mbajë me bukë?" Tjetri ia kthen: "Po sikur ta pushtojmë ne Amerikën, si do t'i ushqejmë gjithë ata amerikanë me bukë?"* Meqë ju jeni rritur në Shkodër, po ju sjell edhe një anekdotë shkodrane, po të kësaj fryme: *E pyesin Shtjefën Palushin, një*

humorist shkodran, se çfarë do të bënte ai sikur të hapeshin kufijtë. "Do të hipja në një lis", - u përgjigj ai. "E përse?" "Që të mos më shkel turma gjatë vrapimit të saj për të ikur sa më shpejt nga ky vend. Kur të iknin të gjithë do të zbrisja nga lisi dhe do t'u shkoja prapa".

Sa për informim, shqiptarët e Kosovës nuk e vërshuan Shqipërinë. Me pasaportë jugosllave mund të udhëtoje në çdo shtet, por nuk mund të hyje në Shqipëri, pa të dhënë policia serbe vizë dalëse nga Jugosllavia për në Shqipëri. Për këtë shkak, kontakti i parë ndërmjet shqiptarëve ishte i dhembshëm, ishte provokues dhe trishtues, ngaqë shqiptarët e Kosovës, që kishin marrë vizë për në Shqipëri, ishin udhëzuar të silleshin sa më keq dhe sa më vulgar në Shqipëri. Shembulli më flagrant ishte Hajdin Sejdia, njeriu që nxiti iluzione fantastike për shpëtimin e Shqipërisë nga kolapsi ekonomik, por që rezultoi si *blofi* dhe zhgënjimi më i turpshëm dhe më i urryer. "Gropa" e tij pas Pallatit të Kulturës u bë pikë referimi e batutave në Tiranë.

Lëvizja, edhe përpara, nuk ishte mbështetur në Shqipërinë reale, por në Shqipërinë ideale, të dëshiruar e të ëndërruar. Gjendja e re në Shqipëri nuk i shkaktoi ndonjë mangësi konkrete Lëvizjes, meqë nga ajo nuk na kishte ardhur ndonjë ndihmë materiale e financiare. Idealistët e Lëvizjes vazhdonin ta adhuronin dhe ta idealizonin Shqipërinë e dëshiruar, atë të ëndërrimeve romantike, kurse disa u këndellën për të gjetur zgjidhje adekuate, se si të mbanin gjallë frymëzimin e deriatëhershëm patriotik. Habitem se si ia dolëm të rezistojmë në atë tragjedi, që të mos dorëzoheshim.

(B.I.:) *- Berisha dhe partia e tij u shfaqën si apostujt e bashkimit kombëtar që do të bëhej shumë shpejt. Sipas programit të tyre të parë politik, bashkimi kombëtar, përmes*

rrugës paqësore, ishte çështje javësh ose, shumë- shumë, çështje muajsh. Si Lëvizje ose edhe vetë ju personalisht, a kishit takime me shtetin shqiptar, me opozitën e asaj kohe që pas pak do të bëhej shumicë qeverisëse, apo Lëvizja u la mënjanë si nostalgjike, enveriste, siç quhej etj.?

(I.K.:) - Unë vazhdoj të jem i stresuar dhe i dyzuar sa u përket zhvillimeve të përjetuara në atë kohë. Isha brenda ngjarjeve, prandaj përpiqesha të ndodhte tranzicioni në demokraci, me dhimbje e pasoja sa më të vogla. I njihja nga afër të gjithë liderët e kohës. Skenari i patriotizmit folklorik i PD-së ishte vulgar. Nuk kishte përmbajtje patriotike, por thjesht virtual e mashtrues. Mua ai skenar nuk më ngjallte ndonjë shpresë, kurse Lëvizja, si organizatë, ishte zënë e papërgatitur.

Lëvizjen në ato vite më bëhet sikur e përfaqësonte Xhavit Haliti në Tiranë, por ai kohën më të madhe e kalonte në selinë "Iliria Hollding" të Hajdin Sejdisë, i cili në Tiranë kishte shkuar edhe me lobimin e Xhavit Halitit te qeveria shqiptare. Mundej që në atë kohë, e cila në të vërtetë ishte kohë e turbullt, Xhavitit i duhej një pikë mbështetje, më shumë për të fshehur aktivitetin e tij klandestin dhe e kishte menduar këtë përmes Hajdin Sejdisë. Ata të dy e kishin shndërruar atë seli në një farë mishmashi, ku nuk merrej vesh se çfarë ndodhte dhe askush nuk e dinte se çfarë po gatuhej, pos që i kishte dal zëri edhe si harem. Fatmirësisht Drejtësia zvicërane ia arriti ta dërgonte Hajdin Sejdinë, atë argat të UDB-së pas grilave, ku vuajti shumë vite burg për mashtrime e shpërdorime edhe atje, duke e zhbërë atë vatër UBBeske të komploteve, në mes të Tiranës...

Unë shumë shpejt krijova bindjen se disa udhëheqës kryesorë të PD-së dhe të PS-së komandoheshin nga shërbimet serbe dhe greke, prandaj asnjëra udhëheqje e partive

kryesore nuk po brengosej për Kosovën. Por, edhe shqiptarët e Kosovës dhe të emigracionit po bënin sehir, nuk po i ndihmonin konkretisht qytetarët e Shqipërisë për të përballuar krizën. Ishte sprova më e ligë e solidaritetit ndërmjet shqiptarëve në atë gjendje tepër fatkeqe.

Udhëheqja e PD-së, pasi erdhi në pushtet, mbajti ndaj Lëvizjes sonë qëndrime pothuajse identike me udhëheqjen e LDK-së. Kjo ma rriste dyshimin se të dy udhëheqjet po kontrolloheshin e po komandoheshin nga e njëjta qendër – Beogradi, në bashkëveprim edhe me Athinën nacionaliste, e cila duhej të kishte kaparis Fatos Nanon...

(B.I.:) *- Cili është mendimi juaj vetjak, qoftë edhe jashtë organizatës, për dy figurat politike të kësaj kohe: Berishën dhe Rugovën? Ku ngjasojnë dhe ku ndahen ata? Cilat ishin të përbashkëtat e tyre në lidhje me Lëvizjen dhe çfarë ishte e ndryshme?*

(I.K.:) - Fillimisht dëshiroj të kem thënë se personalitetet, Berisha dhe Rugova, nuk ishin autentike, që do të thotë nuk vepronin siç u thoshte truri i tyre. Ata ishin të komanduar, prandaj ngjasonin si dy ushtarë të së njëjtës ushtri. Shpeshherë publikisht i kam karakterizuar si vëllezër siamezë.

Sa u përket ngjasimeve dhe dallimeve në mes të Berishës dhe Rugovës, në pamje Rugova shfaqej i butë, i mëndafshtë, kurse Berisha vulgar, brutal. Secili nga ata e urrente dhe e luftonte më brutalisht se tjetri Lëvizjen dhe rezistencën aktive në Kosovë. Në këtë plan ngjasonin si dy pika uji.

Do të flas edhe më konkretisht, meqë e di se do të këmbëngulni në zbërthimin e tyre, meqë ishin dhe, fatkeqësisht vazhdojnë të jenë, dy figurat dominuese që e zvarritën tranzicionin në Shqipëri duke e sakatosur popullin atje dhe duke e shpënë

rezistencën aktive në Kosovë deri buzë zhdukjes.

Rahmetliun Ibrahim Rugova, kujtoj, e përshkrova dhe e zbërtheva mjaftueshëm, nëse nuk e kam tepruar. Sigurisht, gjatë bisedimit do t'i rikthehemi, sepse ka qenë person me ndikimin më të madh gjatë shumë viteve në Kosovë dhe në emigracion.

Për Sali Berishën, në fillim fare, kisha mendime e dyshime të dyzuara. Në krye të herës u angazhova ta përkrahja, meqë me influencoi dukshëm me patriotizmin e tij folklorik. Por, shumë shpejt u përmbajta. Për këtë përmbajtje rol të madh pat luajtur Sadik Bekteshi, komandant partizan në zonën e Shkodrës dhe të Malësisë së Gjakovës (siç quhej atëherë Tropoja e tanishme), organizues teknik i Konferencës së Bujanit. Ai vinte nga familja e famshme Ahmetaj, që e kishte statusin e familjes së bajraktarit në Vuthaj të Plavës, nga e kisha origjinën e largët edhe unë. Pas Luftës së Dytë Botërore Sadik Bekteshi emërohet komisar i Ushtrisë shqiptare dhe atasheu i parë ushtarak në Moskë. Në vitet '70 Sigurimi shqiptar e burgos me akuzën për tentativë të puçit ushtarak kundër sigurimit të shtetit, i cili kontrollonte edhe Ushtrinë shqiptare. Për hir të origjinës nga Kosova, siç thuhej atëherë, vetë Enver Hoxha e shpëtoi nga dënimi me vdekje. Sadik Bekteshi kishte qenë shok fëmijërie me Rexhep Ramën (Balidemajn), kishin qenë shokë edhe gjatë studimeve ushtarake në Itali në kohën e Mbretërisë Shqiptare dhe shokë të ngushtë edhe gjatë luftës partizane. Familja e Rexhep Ramës, si edhe ajo e Sadik Bekteshit, ishte shpërngulur nga Vuthaj, gjegjësisht Martinaj të Plavës dhe ishte vendosur në rrethinë të Shkodrës. Ndërsa Sadiku ishte emëruar atashe ushtarak në Moskë, Rexhep Rama, pas lufte, u dërgua për specializim në Beograd. Gjatë specializimit në Beograd ndodhi që Rexhepi u fejua me një oficere të OZNA-s (shërbim sigurimi

ushtarak jugosllav), me emrin Milica (mbiemrin ia kam harruar) dhe martohet me të. Sadik Bekteshi u hidhërua kur mësoi se shoku i tij ishte martuar me Milicën, oficeren e OZNA-s. Kur u kthye nga Moska në Tiranë, në cilësi të komisarit të Ushtrisë shqiptare që ishte, provoi ta bindte ushtarakun Rexhep Rama që të ndahej me Milicën, por pa sukses. Kjo e egërsoi Sadikun, prandaj e përzuri Rexhepin nga Ushtria shqiptare.

Deri këtu, do të thosha, gjithçka individuale dhe personale, po të mos ishte në mes një oficere e OZNA-s dhe po të mos bëhej fjalë për Sadikun dhe Rexhepin që njihnin mirë veprimtarinë taktike dhe afatgjatë të nacionalizmit serb, që jo rrallëherë kanë angazhuar dhe kanë sakrifikuar vajzat e tyre për interesa nacionaliste.

Rexhepi dhe Milica lindin vajzën dhe e pagëzojnë me emrin Sllobodanka në kishën ortodokse në Vrakë, dhe, po me atë emër e regjistrojnë në zyrën e gjendjes civile. Kjo po ndodhte në kohën kur udhëheqja e Partisë Komuniste të Shqipërisë ishte në kulmin e flirtit me udhëheqjen e Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Më saktësisht, në kohën kur shteti shqiptar vetëm sa nuk ishte shndërruar edhe juridikisht në republikë të Jugosllavisë. Edhe lindja, edhe emri i vajzës së tyre, do të thosha, janë tepër personale. Por, ama, në pyetje është vajza e Rexhepit, e lindur në Shqipëri dhe, edhe pse nënën e kishte nga Beogradit, mund të kishin gjetur një emër më neutral, jo aq të preferuar nga nacionalizmi serbomadh.

Në vitin 1948 ndodhi prishja në mes të Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Për të shmangur vështirësitë e mundshme që do të shkaktoheshin nga emrat, çifti bashkëshortor Milica dhe Rexhep Rama bënë kërkesë në gjykatën e Shkodrës për të ndryshuar emrat, nga Milica në Vera, dhe nga Sllobodanka në Liri.

Deri këtu, do të thosha histori personale, fatkeqe ose fatmirë, varësisht nga perceptimi dhe këndvështrimi. Por, detyrimi që kanë ndier për të ndryshuar emrat, sigurisht, duhet të jetë përjetuar si fatkeqësi.

Ajo grua, Milica, e transformuar në Vera, do të vazhdojë të ushtrojë veprimtari agjenturore, për llogari të OZNA-s, siç e përflisnin njerëz të informuar në Tiranë, ndër ta edhe Sadik Bekteshi dhe Hava, Bashkëshortja e Sadikut, me origjinë po nga Martinajt dhe kushërirë e largët e Rexhepit, meqë të dy kishin prejardhjen nga barku i madh Balidemaj. Nuk duhej të ishte e painformuar as Hava, meqë për disa vite kishte qenë Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë. Po të njëjtën Milicë, e transformuar në Vera, me gjithë pamjen e saj të butë dhe natyrën qetësuese, siç pohojnë njerëz të ndryshëm, jo vetëm të asaj kohe, por edhe më pas, e kishte angazhuar edhe Sigurimi shqiptar dhe prandaj ishte shquar për disa denoncime politike dhe dëshmitare në gjykatë në Tiranë.

Dyshimi i disa të mirinformuarve në Tiranë ishte se Milica e kishte zgjedhur Sali Berishën për dhëndër, që do të thotë bashkëshort të vajzës së saj, Lirisë. Përzgjedhja nuk duhet të ketë qenë e vështirë, sepse studentët që vinin për të studiuar në Tiranë nga rrethet e largëta, detyroheshin të ktheheshin në vendlindje, për të kontribuar atje në profesionin e tyre. Përjashtim bënin rastet kur studentët ose studentet gjenin partnerë për martesë në Tiranë. Saliut këtë shans duhet t'ia ketë ofruar Milica, duke e fejuar me vajzën e saj, Lirinë.

Edhe unë, i prirur për të dyshuar se OZNA kishte bërë krushqinë, zura të dyshoj se, që atëherë, Beogradi duhet ta ketë rekrutuar Sali Berishën për ta pasur të gatshëm e për ta stërvitur si spiun të fjetur, për kohët që do t'i duhej.

Dyshimi, do të thosha, është i ligjshëm, aq më tepët ku ka për bazë këtë rrjedhë që paraqita. Por ku të gjenden faktet? Në pamundësi të sigurimit të provave konkrete, faktike, unë kam stërvitur dhuntinë për të analizuar angazhimet, mundësisht të përditshme, të individëve të caktuar. Prandaj përcaktohem t'i investigoj, gjegjësisht vëzhgoj, për të formuluar një vlerësim sa më konkret. Në kuadër të këtij angazhimi, ta zëmë, kur ndonjë politikan vepron tejet antishqiptarisht, nuk hamendësohem shumë për ta kategorizuar si argat të shërbimeve inteligjente antishqiptare e kështu me radhë.

Angazhimi i ambasadorit Rajerson (i cili, për çudi, gjatë shërbimit të tij në Beograd kishte mësuar gjuhën shqipe), një proserb i angazhuar, i thekur dhe zellshmërisht, edhe jashtë normave e mirësjelljes diplomatike, për të sjellë Sali Berishën, fillimisht në krye të Partisë Demokratike e, më pas, edhe në krye të pushtetit shqiptar, e quaja argument tepër kokëfortë për të thelluar dyshimin se këto angazhime po i koordinonte Beogradi nacionalist.

Udhëzimet e Sali Berishës me kasnecë të tij, gjegjësisht me spiunë të UDB-së dhe OZNA-s, që i kishte bashkëpunëtorët më të ngushtë të tij, për të shkatërruar gjithçka në Shqipëri: shkollat, madje edhe plantacionet e frutave me arsyetimin se i kishte ndërtuar e mbjellë "diktatura e proletariatit" e Enver Hoxhës; teoria e Çekut të Bardhë apo teoria ZERO etj., ishin argumente të tjera që ma thellonin dyshimin se ato urdhra vinin po nga Beogradi nacionalist, që ta lodhnin Shqipërinë për ta zhveshur deri në palcë.

Në vitin 1992 vendosa të organizoj një miting informues e protestues për Kosovën në Tiranë. Sakaq i binda të gjitha udhëheqjet e organizimeve rinore të partive përkatëse dhe të

shkollave në Tiranë. U formua një këshill i përbashkët "Rinia e Shqipërisë përkrah Kosovën". Më befasoi përse "demokratët" e thekur, patriotë tepër folklorikë, u munduan ta sabotojnë mitingun, ashtu si edhe bashkëveprimtari Xhavit Haliti, që po mendonte se po i rrezikoja primatin në Tiranë. Sabotimet e tyre vetëm sa na dëmtuan paksa, por mitingu në përkrahje të Kosovës u mbajt. I pari dhe më i madhi deri atëherë. Madje "demokratët", të cilët sapo kishin ardhur në pushtet, të komanduar nga Sali Berisha, patën provuar ta ndalonin mitingun të mbahej në sheshin *Gjergj Kastrioti* dhe të na impononinsheshin "Studenti".

Që të mos e zgjas po sjell edhe një argument konkret të natyrës ndoshta subjektive. Beogradi përpilon një listë të zezë, me 17 emra, si njerëz të rrezikshëm. Atë ia përcjell sigurimit shqiptar përmes "postierit" Prof. Ali Aliut, i emëruar si ambasador (vetëm virtual) i Kosovës në Shqipëri nga "presidenti" Ibrahim Rugova. Ndër emrat që kam mundur të mësoj dhe që kam mbajtur mend, ishin: ushtaraku Xhafer Jashari (nga Mitrovica), Fatos Aliu (me origjinë nga Presheva, me banim në Prishtinë) dhe unë. Në qershor të vitit 1992, duke qenë në shëtitoren kryesore të Tiranës, më shpëtuan nga një arrestim i mundshëm nga ana e Sigurimit, disa udhëheqës të forumit rinor të PD-së, të cilët i kisha miq dhe qëlluam duke shëtitur bashkë, siç ishte kryetari Arben Lika. Kur, personalisht, i kërkova presidentit Berisha të ndërhynte për të më ndihmuar ai me premtoi se do të më merrte në mbrojtje, por meqë mbrojti praktikën e "listës së zezë", ngaqë qenkësh dorëzuar nga ambasadori i Kosovës, u fjalosëm ca në kabinetin presidencial dhe pastaj unë vetë u arratisa nga Shqipëria.

Ngjarjet tragjike të marsit të vitit 1997 me bëhej se is-

hin "prodhim" origjinal i Presidentit Berisha dhe argatëve të shërbimeve antishqiptare, serbe e greke. Ato pata rast t'i përcjellë si shoqërues i redaktorit gjerman Roland Hofvieler. Dhjetë ditët e kaluar në Jugun e Shqipërisë i paraqita në librin »Shqipëria jashtë "Veriut" dhe "Jugut'«.

Besoj këto përjetime, dyshime e vlerësime të asaj kohe janë të bollshme për të ditur se si e kam vlerësuar Sali Berishën atëherë.

E thashë shkaras në fillim, po e përsëris edhe tani: Përafërsisht kam dyshuar edhe për Fatos Nanon, por të rekrutuar nga Asfalia greke, e cila bashkëpunonte ngushtësisht me shërbimet serbe, atëherë e sot kundër shqiptarëve dhe Shqipërisë së mjerë.

Më vjen keq që në takimin e organizuar mes Kryesisë së Organizatës sonë dhe Fatos Nanos, atëherë kryeministër i Shqipërisë, në korrik të vitit 1998, nuk munda të marr pjesë. Do të dëshiroja t'ia thosha ballas atë që kam menduar dhe do të doja që, si për njërin, ashtu edhe për tjetrin, të isha i gabuar. Mirëpo koha dhe zhvillimet, siç po duket, po më japin të drejtë. Trishtohem kur shokë të organizatës, në poste të ndryshme sot, falënderojnë Berishën apo Nanon për ndihmën e tyre për Luftën tonë çlirimtare. Më duhet të them se ishte një ndihmë minore nga Nanoja dhe nuk ka ekzistuar fare nga Berisha. Po i jap vetes të drejtë të konstatoj se jam njëri nga njohësit më të saktë të zhvillimeve përkatëse dhe të këtyre vëllezërve siamezë.

(B.I.:) *- Në zgjedhjet e para pluraliste, të dyja partitë kryesore politike në Shqipëri, megjithëse ishte viti 1991 dhe ishte një kohë mjaft e vështirë, ndoshta më e vështira e 40 vjetëve të fundit, ata e vendosën në programin e tyre politik bashkimin kombëtar. Mos të harrojmë se demonstratat e para të lëvizjes studentore në Tiranë kishin si profetë Ismail Kadarenë dhe*

Rexhep Qosjen. Portretet e tyre ishin kudo.

Ishte mendimi se do të shkonim drejt Evropës sipas këtij mendimi intelektual. Partia Demokratike, por edhe ajo Socialiste, edhe në zgjedhjet e vitit 1992, të parakohshme dhe të detyrueshme, e vendosën rishtas bashkimin kombëtar. Në vitin 1996 këtë nuk e vendosi asnjëra prej tyre. Në një bisedë me zotin Shaqir Vukaj, në atë kohë nënkryetar i Parlamentit shqiptar dhe drejtues i lartë i PS-së, Fehmi Lladrovci e pyeti drejtpërdrejt përse asnjëra prej partive politike nuk e ka në program bashkimin kombëtar, ashtu siç e kishin. Përgjigjja ishte e pritur, por edhe befasuese: nuk e vëmë sepse humbim votat. Çfarë ndodhi, sipas mendimit tuaj, në këtë hark kohor prej pak vitesh, që nga çështja e bashkimit si punë muajsh të kalohej në një faktor për humbje votash. Në fund të fundit, pse ra rejtingu politik i shqiptarëve të Kosovës në Tiranë?

(I.K.:) - E thashë edhe më lart, përcaktimet programore të dy partive kryesore politike ishin një mashtrim virtual, ndoshta për të përfituar financiarisht nga emigracioni! Nuk e besoj të kenë taktizuar për të marrë sa më shumë vota nga qytetarët. Ata e dinin se qytetarët nuk kishin si t'i lexonin programet e tyre politike, sepse nuk kishin as letër për t'i shumëfishuar ato. Në mitingje as e përmendnin bashkimin kombëtar, sepse e dinin se do të humbnin vota. Vetëm patriotizmi dhe bashkimi kombëtar nuk ishte trend i kohës. Këtë e paskësh thënë shumë shkoqur Shaqir Vukaj!

Përralla me fotografitë e Kadaresë dhe Qoses ishte paksa e stisur. Edhe po t'i donin studentët, nuk kishin ku t'i merrnin fotografitë e tyre. Nga dy-tre pankarta me fotot e tyre në ndonjë miting, nuk duhet sajuar se ishin me dhjetëra e qindra.

Se përse ndryshoi pozicionimi programatik aq shpejt,

mbase mund të shpjegohet me taktikën, se herën e parë qe shpresuar se "kosovarët" do vërshonin me ndihma financiare, por kur ato nuk ndodhën pothuajse fare, atëherë nuk vazhduan më joshjet mashtruese.

Urrejtja e shqiptarëve ndaj "kosovarëve" ishte skenar i suksesshëm i shërbimeve serbe. E si të mos e urreje modelin e "kosovarit" Hajdin Sejdia!?

(B.I.: / Reagim ndaj përgjigjes së fundit:)

Mendoj se për disa gjëra, në këtë kohë, nuk keni të drejtë. Nëse do të ktheheshim pas në motet që shkuan, do të thosha se edhe unë, si gazetar, kam qenë vëzhgues aktiv. Në vitin 1991 nuk kishte shqiptar, i cili mendonte sado pak si shqiptar, që nuk kishte një bindje të jashtëzakonshme për shqiptarët nga Kosova. Kjo është një e vërtetë që unë e kam përjetuar thellësisht dhe më ngrohte gjithnjë ideja e bashkimit, megjithëse nuk isha i qartë për rrugët që duheshin ndjekur. Përgjigjja juaj e fundit më shtyri të rikthej kujtesën pas dhe të sjell ndër mend ditët e mitingjeve, sidomos të PD-së, ku shpeshherë, sidomos në Veriun e vendit, tema e Kosovës ishte thelbësore. Ka një dallim mes qëndrimit të partive dhe qëndrimit të njerëzve të thjeshtë. Sigurisht, unë ju pyeta për partitë dhe ju, po ashtu, m'u përgjigjët për partitë dhe këtu keni të drejtë. Por, kur mendoj si ndizeshin njerëzit nga emri i Kosovës, ende tani ndiej një mall dhe përvëlohem nga idetë që ishin në ditët e para.

Por le ta lëmë mënjanë përgjigjen time dhe të vazhdojmë më tej. Le të futemi në një kapitull të ri.

V. Një kohë e re me mendim të ri

Jemi ende në fillimet e viteve '90. Në Kosovë, por edhe jashtë saj, po ndodhnin zhvillime të pazakonta politike, por që në të vërtetë nuk sillnin ndryshime në jetën reale të Kosovës. Ajo vazhdonte të mbetej nën pushtetin serb. Shkollat dhe universiteti filluan të zhvendoseshin në shtëpi private, represioni ishte i vazhdueshëm, megjithëse kishte ndërruar disi formën e tij. Ishte e dukshme ideja se Pavarësia e Kosovës gjendej diku afër, si të thuash pas një kodre dhe mjaftonte të zgjatje dorën për ta këputur atë fryt të dëshiruar.

Ky ishte iluzioni i parë i madh i krijuar nga politika. Në të vërtetë, nën të, si ujërat e nëndheshme, lëviznin ide të tjera, të cilat, edhe pse në pamjen e parë dukeshin të vjetruara, ishin të reja dhe do të ndërronin gjithë zhvillimet e mëtejshme. Të gjitha këto lidhen me Lëvizjen, e cila, edhe pse dukej sikur kishte një hapësirë të ngushtuar, bënte të gjitha përpjekjet për ringritje. Kishte ende besim se edhe forcat e tjera politike dhe "institucionet e saj" do të bënin diçka të vyer.

Në Kosovë, përfaqësuesit e Lëvizjes, brenda konfigurimit të tyre, megjithëse kishin filluar të ndienin se shumë shpejt do të bëhej një akullim i ri, ende nuk e kishin humbur besimin se mund të gjendej gjuha e përbashkët dhe, me këtë ide, përpiqeshin të hapnin dyert e mbyllura të marrëveshjeve. Nuk ishte Lëvizja ajo që vendosi murin e ndarjes mes organizatave politike, megjithëse mund ta kishte bërë këtë, qoftë edhe për faktin se, përtej murit që po ngrihej marramendshëm shpejt, ishin rreshtuar të gjithë ata që deri dje i kishin përndjekur, i kishin

dënuar e, herë pas here, edhe i kishin gjakosur. Në turmën që po rreshtohej tepër shpejt për të mos qenë e bindur, në radhët e para dukeshin e stërdukeshin, si në një ëndërr të keqe, portretet e gjykatësve, prokurorëve, hetuesve, diferencuesve, njerëzit e shërbimit sekret serb, të inkriminuarit, të cilët, mes asaj turme të madhe, ende në dalldinë e politikës, mund të shpërfytyroheshin tepër shpejt, por nuk do të ndryshonin kurrë. Një herë, shumë vite më parë, kam dëgjuar nga Demaçi të thotë se "në këtë botë vetëm të marrët dhe të vdekurit nuk ndryshojnë" dhe i kam besuar, por, më pas, do të kisha dashur të shtoja se, në këtë botë, as udbashët nuk ndryshojnë, pasi, duke e pasur shpirtin e shitur dhe zemrën e tjetërsuar, ata nuk kanë se çfarë ndryshojnë më.

Nuk mendoj se djemtë e Lëvizjes ishin naivë kur menduan të ngrinin urat e bashkëpunimit me strukturat partiake që po shndërroheshin me kaq shpejtësi. Mund të them se ata ishin idealistë me tepri, por ishin njëkohësisht edhe aq të zgjuar sa të mos mbështeteshin vetëm në pritjen se kur mund të hapej një portë, sido kudo, për të pasur një frymëmarrje më të qetë. Edhe në kohën e akullimit Lëvizja bëri hapin tjetër, çeli vetë një derë tjetër, e cila, duke qenë e kundërta e "paqësimit", herët a vonë, do të shpinte patjetër në përballjen me pushtuesin. Nëse këtë nuk do ta kishte bërë Lëvizja Popullore e Kosovës, pra nëse nuk do të ishte përgatitur që në fillimet e viteve '90 për të pritur marsin e vitit 1998, kasaphana në Kosovë do të kishte qenë shumë më e tmerrshme se në Bosnjë. Lufta do të vinte një ditë edhe në Kosovë, kjo ishte e pashmangshme. Ishin dy rrugë: ose përjetësisht nën pushtimin serb, ose kryengritje. E para nuk ishte e perceptueshme, e dyta ishte e pandryshueshme. Sikur vetëm këtë të kishte bërë Lëvizja, përgatitjen e popullit për atë që do të vinte, do të ishte e mjaftueshme për të mbetur në kujtesën e

kombit. Por ajo bëri më shumë se kaq. Ajo e përgatiti popullin për këtë ditë dhe, në fakt, mori rolin udhëheqës të luftës.

Por jemi ende në vitin 1992. Dhe ky vit, si një fillesë prove, kishte dy anë. Njëra anë ishte ideja se mund të bashkëpunohej, tjetra ishte ideja se do të luftohej. Por, në fillim ishte bashkëpunimi.

U krijua qeveria e njohur si "Qeveria Bukoshi". Me 5 dhjetor 1992 u bë takimi i parë, le të themi zyrtar, mes përfaqësuesve të Lëvizjes dhe qeverisë. Nga Lëvizja ishin: Fazli Veliu, Ali Ahmeti, Emrush Xhemajli dhe Gafur Elshani. Nga qeveria: Bujar Bukoshi dhe Ramush Tahiri.

Nga kjo nisje unë kam disa pyetje:

***(B.I.:)** - Si u vendosën lidhjet mes qeverisë dhe Lëvizjes?*

(I.K.:) - Konkretisht nuk jam i informuar se si i ka vendosur lidhjet Kryesia e Lëvizjes, por besoj se nuk duhet të ketë qenë ndonjë procedurë e koklavitur. Them nuk duhet të ketë qenë edhe aq e vështirë të bëhej një takim i atij niveli. Sapo u formua një, i thënçin qeveri, në emigracion zotëronte një eufori, sikur të ishte qeveri e vërtetë, kurse ajo vetëm emrin e kishte të tillë, pa asnjë atribut të vërtetë qeverie. Interesante është heshtja që po ndodh, edhe tani, pas kaq viteve, në shpjegimin se si vërtet u formua ajo qeveri. Ta zëmë, kush e propozoi dhe për çfarë meritash e propozuan Bujar Bukoshin për kryeministër? Kush dhe si e miratuan? Deri kur po ndodhnin kthesat e mëdha, ai nuk ishte ndonjë personalitet i afirmuar. I ndodhi një "kidnapim", sikur i vunë një thes në kokë, dhe ai u konvertua në *star*. Por asnjëherë nuk u ndriçua, nëse "kidnapimi" ishte një ngjarje e rastësishme apo një skenar për ta afirmuar atë *anonimus* të deridjeshëm. Pas disa kohësh, në një takim që kisha me Zotëri Bukoshin, si me të qeshur, i pata thënë se do të

duhej t'i daroviste "kidnappers-it", të cilët e afirmuan brenda natës, pa i dhënë asnjë flakaresh, e lëre më ta torturonin. Po ashtu, as atëherë e as tani, nuk dihet kush i zgjodhi anëtarët e "qeverisë", kush e bëri përcaktimin e posteve, si ndodhi që shumë prej anëtarëve të "kabinetit" ishin nga nomenklatura e vjetër politike, në cilin territor do të ushtronin pushtetin e tyre, pse u zgjodh pikërisht shteti gjerman si vendqëndrim i kësaj qeverie? Shumë pyetje janë shtruar prej kohësh, por deri tani asnjëra prej tyre nuk ka gjetur përgjigje shteruese.

Për të mos e zgjatur, me atë farë qeverie u takua delegacioni i Lëvizjes, sepse ne ishim përcaktuar të bashkëpunonim sa më ngushtësisht me strukturat e Republikës se Kosovës dhe me subjektet partiake që ta jetësonim sa më shpejt, së toku, Republikën e Kosovës. Tani nuk më kujtohet se për çfarë janë marrë vesh konkretisht, por e di se ka rezultuar një asgjë.

(B.I.:) *- A kishit shpresa se kjo qeveri do të ishte seriozisht e angazhuar për pavarësinë e Kosovës, qoftë edhe me mjete radikale, por të domosdoshme?*

(I.K.:) – Për atë farë qeverie kishim iluzione, por mbizotëronin vlerësimet reale. Kjo ngaqë në Lëvizje mendimet nuk ishin uniforme dhe unitariste, sepse ne nuk kemi pasur *njësh* diktator, që të dëgjohej e të zbatohej vetëm mendimi dhe qëndrimi i tij, siç ndodhte me njëshat diktatorë individualistë të subjekteve partiake në Kosovë, sigurisht, të vetëdeklaruar si "demokratë". Me naivitet e gabimisht ata quheshin liderë, por që nuk u vinte fare era lider. Era lideruc, mbase po. Megjithatë, në mbledhjet, pothuajse të përmuajshme të Këshillit të Përgjithshëm, të cilat rëndom zgjatnin dy ditë, debatohej gjatë e rreptë, derisa gjendej kompromisi, i cili shndërrohej në vendim. Pra, iluzionet dhe

vlerësimet reale për atë qeveri janë debatuar dhe, në fund, është marrë vendimi se Lëvizja duhet të ofrojë gatishmërinë për bashkëpunim, prandaj ka ndodhur ai takim. Ky nuk ka qenë një vendim sa për sy e faqe, pra një vendim i pasinqertë, por i arsyetuar me nevojën për të qenë të gjithë bashkë në një mundësi të ardhshme, në rast konflikti të armatosur.

Unë, për vete time, e kisha ndarë mendjen, se gjithë skema e organizimit shtetëror dhe partiak në Republikën e Kosovës ishte pjesë e një makroskenari të përpiluar me mjeshtri të përkryer në Beograd, për ta mbajtur Kosovën të pushtuar me sa më pak forca dhe shpenzime. Ndërsa populli shqiptar po kënaqej me shtetin e tij të improvizuar dhe virtual. Përndryshe, nëse ata do të ishin parti e institucione të vërteta, me ushtrim autoriteti, brenda dhe jashtë Kosovës, me ligje e rregulla, me vendime e porosi, me buxhet e me financa, me ministri të mbrojtjes dhe të punëve të brendshme dhe t'i toleronte në atë farë mase Beogradi, vërtet nuk do të kishim të drejtë ta akuzonim Sllobodan Milosheviqin për diktator e nacionalist serbomadh. Ishte një paradoks i jashtëzakonshëm. Pushteti serb të kishte hequr me dhunë, me polici, me ushtri e me gjak, edhe ato pak të drejta kushtetuese që kishe pasur, të kishte mbyllur si në një geto, të përndiqte, të burgoste, të gjobiste dhe të shkatërronte po të donte dhe ti, përsëri thoshe se kishe qeveri, president, parlament, se po bëje jetë paralele, institucione paralele. Kjo, nëse nuk është marrëzi ose djallosje, është patjetër punë e dyshuar, e fshehtë, me synimin e qartë të shuarjes së vlimit që kishte në popull. Shumë veta, qoftë edhe nga zemra e mirë apo të lodhur nga vuajtjet, ranë viktimë e kësaj loje të fëlliqtë politike, por Lëvizja nuk u bë pjesë, as e mashtrimit dhe as e viktimizimit.

E pse të mos toleronte Milosheviqi vetëkënaqësinë folk-

lorike të shqiptarëve me shtetin e tyre fiktiv e virtual, kur po ndodhte hemorragjia kombëtare, duke "ikur" jashtë, në masë, pjesa më aktive, rinia mashkullore dhe ç'punësimi masiv i shqiptarëve dhe punësimi në vend të tyre i serbëve, kryesisht refugjatë serbë nga Kroacia; kur për arsimin, nga ai fillor deri tek ai akademik, nuk ishte i detyruar të ndante buxhet nga buxheti i Kosovës, për të cilin megjithatë grumbulloheshin taksa e tatime kryesisht nga bizneset e shqiptarëve; kur vetëm me 50 policë serbë regjimi i Milosheviqit mund të ruante rendin dhe qetësinë në tërë Kosovën, etj.

(B.I.:) *- Cilat kanë qenë, në fillim, lidhjet tuaja me këtë qeveri dhe me Zotëri Bukoshin?*

(I.K.:) - Për ndonjë lidhje konstruktive e funksionale, në kuptim të mirëfilltë të fjalës, nuk mund të bisedohet. Megjithatë, kam pasur takime me Zotëri Bukoshin, me Zotëri Mustafën, "ministër i Financave" dhe me Zotëri Nikë Gjeloshin, "ministër i Mbrojtjes". Ata e dinin se unë nuk isha anëtar i Kryesisë, por besoj se ndikonte propaganda dashakeqe që përhapnin kasnecët e LDK-së kundër Lëvizjes, duke e stigmatizuar atë si "Lëvizja e Ibrahim Kelmendit". Më duhet të pohoj se, në atë kohë, unë, pa dashjen time, isha njeriu më i sulmuar nga radhët e Lëvizjes. Kjo lloj fushate bënte xheloz edhe ndonjë bashkëveprimtar të Lëvizjes, anëtar Kryesie, të cilët, si me shaka, thoshin se ata bënin punën, kurse nami më vishej mua. Pra, sa herë që kërkoja takim e, ndonjëherë, edhe ata e kërkonin, ndodhnin ato, sa për taktizim reciprok.

Zotëri Bukoshi shtirej sikur i bëhej qejfi kur unë i shkruaja letër dhe i drejtohesha me: "I nderuar Zotëri Kryeministër..." Por, që të përgjigjej me shkrim, ai nuk përgjigjej, sepse atë kulturë nuk e kishin (ose nuk dinin të shkruanin letra, ose nuk

donin t'u ngeleshin dëshmi), por vetëm më thërriste në telefon për të më falënderuar dhe për t'u përgjigjur në temat që i trajtoja në letër, ose me thërriste në takim fizik.

Për këtë lloj angazhimi informoja Kryesinë dhe ndonjërit nuk i durohej pa më thënë se po anashkaloja hierarkinë e Lëvizjes. Në të vërtetë, në raste të tilla apo të ngjashme me këto, nuk kam qenë edhe aq i disiplinuar. Por, mendoj se jo gjithmonë kam qenë i gabuar.

(B.I.:) - A keni pasur lidhje me përfaqësues të tjerë të kësaj qeverie, si Nikë Gjeloshi apo dhe të tjerë?

(I.K.:) - E thashë që kam pasur takime edhe me Nikë Gjeloshin dhe, me thënë të vërtetën, kisha respekt ndaj tij, sepse më dukej më i përgatituri, më realisti, më konstruktivi. Por, me Zotëri Gjeloshin më shpesh takohej bashkëveprimtari Fehmi Lladrovci, sepse njihej me të qysh nga Kroacia dhe ishte më kompetent për çështje ushtarake. Nikë Gjeloshi, për një kohë, ishte "ministër i mbrojtjes" në atë "qeveri", më duket pas tërheqjes së Ramush Tahirit. Të dy ata, në Kroaci, kishin qenë miq të Fehmi Lladrovcit. E njihnin mirë dhe i njihte mirë dhe, më shumë se te cilido, kishin besim tek ai dhe te sinqeriteti e përkushtimi i tij. Ndoshta ndokënd tjetër edhe mund të mos e merrnin seriozisht po me Fehmiun ishte puna ndryshe dhe duheshin matur mirë. Unë, për vete, nuk e kam ndier kurrë veten xheloz kur shokët e miqtë e mi kishin prioritetin. E kam pasur të zakonshëm këtë qëndrim, ashtu siç nuk kam mundur ta përtyp tërheqjen.

(B.I.:) - A është e vërtetë se gjithë fondin e saj që kishte mbledhur në vite, dhe që nuk ishte një fond i paktë për momentin, Lëvizja ia dorëzoi apo ia vuri në dispozicion Bukoshit dhe qeverisë së tij?

(I.K.:) - Nuk e di. Mendoj se nuk duhet të jetë e vërtetë kryesisht për faktin se ne nuk kishim mjete të grumbulluara që t'ia dorëzonim Bukoshit. Ne nuk kishim mjete për të plotësuar kërkesat minimale të Lëvizjes në Kosovë, për të ndihmuar familjet e të burgosurve politikë etj., e lëre më t'ia dorëzonim Bukoshit. Ndoshta Kryesia duhet të ketë dorëzuar ndonjë shumë simbolike, sa për të dëshmuar vullnetin e mirë për bashkim të fondeve, por shumën konkrete duhet ta dinë anëtarët e Kryesisë, përkatësisht arkëtari i Lëvizjes në ato vite, Gafurr Elshani.

(B.I.:) *- A kishte ndonjë platformë të përbashkët mes Lëvizjes dhe qeverisë për rezistencën në Kosovë?*

(I.K.:) - Me sa mbaj mend, delegacioni i Lëvizjes në takim është marrë vesh për mënyrën e bashkëveprimit për ta bërë rezistencën më aktive, por, kur u dëshmua se Zotëri Bukoshi nuk jepte mjete nga fondi i përbashkët për rezistencë aktive, marrëveshja u zhbë (dhe Bukoshi, si demagog i thekur, arsyetohej se nuk e lejonte Prishtina).

(B.I.:) *- A e përkrahu Lëvizja fondin e qeverisë, i cili fillimisht quhej "Fondi i Ahenit" (Aachen), sipas emrit të qytetit ku nisi fillimisht ky fond, dhe pastaj u themelua fondi i 3-përqindëshit?*

(I.K.:) - Fillimisht po. Ishte bërë marrëveshja taktike që, për atë fond, çdo emigrant patriot të jepte nga një mijë marka, sa iu caktua çmimi një arme çlirimtare. Mund të merret me mend, se vetëm veprimtarët dhe simpatizantët e Lëvizjes jepnin ndihma për armatim, sepse aktivistët e LDK-së kishin platformë konsekuente "pacifiste", të cilën e respektonin me fanatizëm dhe nuk donin të dëgjonin për armë çlirimtare.

Tani shtrohet pyetja: Ku përfunduan ndihmat që u grumbulluan në "Fondin e Ahenit"? Ai fond ishte regjistruar në emër

të një shoqate humanitare, kryetar i së cilës ishte Zotëri Marian Tuna dhe në bankë vetëm ai dhe Hafiz Gagica kishin deponuar autorizimet për të tërhequr mjetet. Meqë këta të dy nuk po i jepnin të holla e llogari Zotërinjve Bukoshi dhe Mustafa, u themelua "Fondi i 3-përqindëshit", si fond zyrtar i "qeverisë" së Republikës së Kosovës. E se ku përfunduan vërtet ato mjete të "Fondit të Ahenit", këtë e dinë vetëm Marian Tuna, Hafiz Gagica, Anton Kola dhe ndonjë bashkëpunëtor i inkriminuar i tyre. Ajo që u deklarua pas luftës, në një mbledhje qesharake të të ashtuquajturit Kuvend i Kosovës, që e kishte këtë mbledhjen e parë e të fundit për përdorimin e fondit dhe shpenzimet e kryera, ishte vetëm një maskaradë e rastit. Kjo maskaradë jo vetëm nuk shfajësoi njeri, por hodhi edhe më shumë dyshime. Më shumë se gjithçka, ai ka qenë një fond i privatizuar që më së paku i ka shërbyer Kosovës.

Si edhe për "Fondin e Ahenit", ndihma financiare janë mbledhur edhe për të blerë shtëpinë në Velani për "seli të presidencës". Ato mjete u deponuan në xhirollogari të Zotëri Musa Dakajt dhe as fati i tyre nuk dihet. Musa Dakaj, ndërkaq, vazhdon të vuajë dënimin për një krim fatkeq në burgjet gjermane. Po, se me cilat mjete u ble ajo vilë, që pas lufte u shndërrua ilegalisht në pallat, nuk janë dhënë asnjëherë sqarime konkrete dhe nuk janë dhënë shpjegime. Si u bë e mundur që "Selia e presidencës" të privatizohet e përvetësohet nga pasardhësit familjar të "presidentit" Ibrahim Rugova. Madje, për atë "seli", nga buxheti i Kosovës u pagua edhe pas lufte qira (ndoshta edhe tani paguhet!?), sepse aty po banonte presidenti Rugova.

(B.I.:) *- Të kësaj kohe do të jenë edhe "zgjedhjet" e para në Kosovë, më 24 maj 1992, të cilat do të zhvillohen edhe në Perëndim. A e mbështeti Lëvizja këtë farsë elek-*

torale dhe cili ishte qëllimi i saj?

(I.K.:) - Po, Lëvizja i përkrahu këto zgjedhje me tërë kapacitetet e saja. Madje do të thosha se ishte organizimi logjistik i Lëvizjes që realizoi zgjedhjet, sepse aktivistët e LDK-së ende nuk kishin përvojën përkatëse. Në të vërtetë, në kuadër të asaj zallamahie të madhe popullore, për të jetësuar Republikën e Kosovës me të tillë cirkusiadë, ai votim ishte një lloj farse. Në Perëndim nuk votohej për parlamentarë, por vetëm për "president" dhe kandidat i vetëm ishte Ibrahim Rugova, tashmë diktator shpirtëror i shqiptarëve të Kosovës.

Unë gjatë asaj kohe isha në Tiranë. Atje, më vjen udhëzimi nga kryesia e Lëvizjes se do të duhej të organizohej votimi. Mora në shfrytëzim sallën e Lidhjes së Shkrimtarëve, krijuam komisionin votues, shtypëm pllakatin njoftues e apelues, shumëzuam (u thënçin) fletëvotimet. Të gjitha këto shpenzime po i përballoja nga mjetet financiare të shtëpisë botuese "Iliria", e para shtëpi botuese private në Shqipëri, e regjistruar në fillim të vitit 1991, të cilën e menaxhoja unë. Që të merrnin formë më zyrtare, takova "ambasadorin" e atëhershëm të Republikës së Kosovës, Prof. Ali Aliun. Ia prezantova përgatitjet teknike dhe organizative, por ai kundërshtoi mbajtjen e votimit me arsyetim se të gjithë aty ishin shqiptarë dhe nuk kishim si t'i dallonim. Unë provova ta bind që t'i mbanim, të paktën për të evidentuar sa shqiptarë ishin shpërngulur në Shqipëri, qysh kur mbreti Zog kishte bërë marrëveshje me Mbretërinë e Beogradit për të pranuar të shpërngulurit me dhunë nga Kosova. Megjithatë profesori nuk pranoi. Në dalje e sipër, gjegjësisht në hyrje nga oborri në Muzeun Kombëtar, ku kishte dy dhoma "ambasada" e Kosovës, afishuam një pllakat. Më vonë u rikthyem, për të mësuar nëse "ambasadori" kishte marrë ud-

hëzime të tjera nga Prishtina, siç u morëm vesh në takimin e parë. Shohim se pllakati ishte grisur. Pyetëm rojën dhe ai na tha se e kishte grisur "ambasadori". Unë dhe Muhamet Elshani, një patriot i përkushtuar dhe trim i rreptë, nga fshati Osdrim i Pejës, bashkëveprimtar i Lëvizjes në Hamburg, u ngjitëm tek "ambasadori" Ali Aliu. Pos tij, aty gjetëm Fatos Arapin dhe një të tretë, polic i shtetit, kujdestar për siguri. Kërkova nga "ambasadori" arsyetime përse e kishte grisur pllakatin. Në debat e sipër, goxha të nxehtë, Muhameti iu vërsul dhe e mbërtheu për fyti me sa fuqi e mllef afektiv që kishte. Për hir të Fatosit e urdhërova Muhametin të mos e ngulfatte.

Edhe ky ekses ndikoi që votimet për "president" të Kosovës të mos mbaheshin në Shqipëri.

Më vonë "ambasadori" nuk u përmbajt nga hakmarrja. Në fillim të qershorit 1992, nuk e di se mbi çfarë kërkese e me cilin arsyetim, i dorëzon një "listë të zezë" Shërbimit Informativ të Shqipërisë, me 17 emra të "enveristëve të rrezikshëm". Midis emrave, mbaj mend, të ishin edhe Fatos Aliu e Xhafer Jashari. Për atë listë qe informuar edhe anëtari i kryesisë se LDK-së, Prof. Dr. Zenel Kelmendi, i cili qe fjalosur me "ambasadorin" në hotel "Tirana", meqë në listë ishte emri i nipit të tij, Fatos Aliut.

Pasi i shpëtova një arrestimi të mundshëm, siç e kam përmendur më parë, shkova te presidenti Berisha, në Presidencë. Ai i kishte dhënë urdhrin rojës së kabinetit që të mos më pengonte ta takoja, sa herë kisha nevojë. Këtë nder ai po ma bënte për hir të përrahjes që i kisha dhënë dhe miqësisë që kishim qysh në fillim të vitit 1991. E informova presidentin Berisha për "listën e zezë" dhe tentativën e SHISH-it për të më arrestuar. Ai më tha se nuk mund të ndërhynte, sepse shkresa

ishte sjellë në rrugë zyrtare nga "ambasadori" i Kosovës, por mua më garantoi se nuk do të më ndodhte ndonjë e keqe. Meqë nuk më mjaftoi garancia e tij, në fillim të korrikut 1992 u arratisa nga Shqipëria, duke lënë prapa pajisjet dhe materialet e shtëpisë botuese, gjegjësisht duke dëmtuar investitorët Muhamer Shabani, Bexhet Mehmeti, Ibrahim e Kadri Ipeku, Imer Duka, Refik Hamiti, Mustafë Kelmendi, që kishin investuar rreth 150 mijë dollarë për atë shtëpi botuese.

(B.I.:) *- A do të kishte takime të mëtejshme mes jush dhe qeverisë, gjithnjë para periudhës e cila në bisedën tonë do të njihet, ashtu siç edhe ka qenë, periudha e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?*

(I.K.:) - Nuk e di nëse ka pasur kryesia ose ndonjë anëtar i saj. Unë kam pasur disa herë takime me Zotëri Bukoshin. Sidoqoftë, për këto takime, edhe nëse kanë ndodhur, nuk është raportuar asnjëherë në mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm. Mos qofsha i gabuar, por edhe ndonjë që kishte pasur iluzione se, edhe përmes "qeverisë" mund të bëjmë punë të vyera, tani ishte i zhgënjyer dhe, më pas, do të zhgënjehej edhe më keq.

(B.I.:) *- Pra, të gjitha këto pyetje kishin lidhje me një periudhë të caktuar e cila, nga njëra anë ka rritjen marramendëse të një strukture politike, LDK-së, dhe, nga ana tjetër, paraqet për Lëvizjen periudhën më të vështirë të saj.*

Siç bëhet qartësisht e njohur nga përgjigjet pararendëse, Lëvizja, me ndjenjën e mirë e të sinqeritetit, përkrahu zhvillimin e partive politike në Perëndim, të njohur, herë pas here, si diasporë. Po qëndrimi i LDK-së ndaj Lëvizjes si ishte?

(I.K.:) - Fillimisht më lejoni të reagoj ndaj emërtimit përcaktues "diasporë", siç kam reaguar tërthoras edhe ndaj emërtimit përcaktues "ilegal". Më duket se njerëzit po i përdorin me

një lehtësi të pavetëdijshme shprehjet "diasporë" dhe "ilegal" dhe që të dyja po i përdorin gabimisht. Për asnjërën nga këto shprehje nuk ndiej mirëkuptim. Diasporë shqiptare janë ngulitjet e hershme të arbërve në Itali, Greqi, Turqi e gjetiu, kurse emigrantët shqiptarë në Perëndim s'janë veçse emigracion.

Në intimitet më duhet të pranoj se opinionet mbizotëruese në Lëvizje nuk ishin pro "alternativës kosovare", përkatësisht pro pluralizmit të improvizuar partiak "legal". Ndoshta, disa i kishte përfshirë një zallamahi mjerane, por shumë shpejt edhe ata u ndërgjegjësuan.

Ndërsa, sa i përket qëndrimit të LDK-së ndaj Lëvizjes, për të mos i rënë shumë rrotull, dua të them se udhëheqësit e saj ishin një servis i modifikuar i UDB-së, i cili na luftonte me tërë energjinë dhe potencialin. Tani Lëvizja nuk kishte përballë vetëm frontin serb, por edhe frontin e kësaj turme mjerane shqipfolëse.

(B.I.:) *- Po sjell në vëmendje dy ngjarje nga jeta ime, pikërisht në këtë periudhë. Në majin e vitit 1992, si gazetar, isha në Gjermani dhe më takoi të ndiqja zgjedhjet parlamentare. Ajo që më bëri përshtypje ishte se gjithçka zhvillohej nën emrin e LDK-së dhe nuk kishte asnjë strukturë tjetër. Kjo mund të jetë e natyrshme. Pikërisht në këtë kohë bëra një takim me Hafiz Gagicën, të parin dhe, siç duket, edhe i fundit. E pyeta se si mund ta takoj Ibrahim Kelmendin. Në atë kohë ju njihja më shumë si dhëndër të një familjeje ku ishim të lidhur edhe ne me krushqi, kurse ecjen tuaj në politikë nuk e njihja. Përgjigjja e tij ishte: "Hiq dorë nga takimi me të, ai është i rrezikshëm!". Ai nuk u ndal vetëm te ju, por edhe te Lëvizja në përgjithësi. Pse kishte këtë mendim? Ku qëndronte "rrezikshmëria" juaj?*

(I.K.:) - Mbase përgjigjja konkrete në këto pyetje rezulton

nga përgjigjet e deritanishme. Por, sidoqoftë, e di që ju kërkoni diçka më të detajuar, sesa një fjali të vetme. Po të mos përgjigjem, e di se do të më pyesni përsëri. Nganjëherë po më pyesni edhe për gjëra që ju i dini fare mirë. Mbase e vlen të thuhet edhe diçka për opinion publik. Dakord.

Hafiz Gagica duhet të ketë ardhur në Gjermani në fund të vitit 1978. Ai u vendos fillimisht tek i ati, në Ludvigsburg, i cili punonte si emigrant ekonomik. Meqë Bardhosh Gërvalla, në cilësinë e punëtori social, përkujdesej për babanë e sëmurë të Hafizit, pati rastin të njihet edhe me Hafiz Gagicën, më shumë si përgjigje ndaj lutjes së të atit që të përkujdesej për djalin e tij rrugaç. Kështu e cilësonte vetë ai të birin që në vendlindje ishte ekspozuar si fëmijë i llastuar. I ati, me vetëdije prej njeriu të urtë, i dërgonte para, por ai nuk mësonte (mezi kishte mbaruar shkollën e mesme, në të shumtën e rasteve duke blerë notat me markat që ia dërgonte ai).

Edhe ne të tjerët, për hir të të atit dhe të Bardhoshit përkujdeseshim që ai të përmirësohej. Ngaqë nuk ia dolëm, e izoluam dhe e përzumë nga radhët e veprimtarëve. Kur erdhi Jusufi në Gjermani, sikur e riktheu, meqë ishte i durueshëm, zemërmirë e zemërgjerë dhe besonte se do ta edukonte. Sërish në vitin 1984, ky gjysmanalfabet, me një karakter të lëkundur, mashtrues, na u hoq qafe duke u shkuar prapa dështakëve Sabri Novosella e Xhafer Durmishi. Nuk na erdhi keq e nuk u mërzitëm.

Meqë kam pasur të tilla konsiderata e raporte për të e me të, rrjedhimisht rezulton përgjigjja e tij. Por, ai dhe të tjerë, duke menduar se po me diskreditonin me cilësimin "i rrezikshëm", nuk ishin të vetëdijshëm se po më bënin shërbim. Kategoria e tij vetëm frikën njihte dhe mua më ndihmonte në suksesin e veprimtarisë dhe të synimeve që kisha. Thënë më shkoqur,

ndoshta ishte e nevojshme që tipa të tillë të ma kishin drojën, të dinin se deri ku mund të shkonin e të bënin kujdes që, kur t'ua tregoja vijën e kuqe, të mos guxonin ta shkelnin.

Hafiz Gagica, i dyshuar për informator i kryeudbashit Selim Brosha, sigurisht se e njihte përcaktimin idealist dhe guximtar të veprimtarëve të Lëvizjes, nga rrjedh "rrezikshmëria" edhe e Lëvizjes dhe ndihem krenar që Lëvizja ishte e rrezikshme për pushtuesin dhe shërbëtorët e tij mjeranë shqipfolës.

(B.I.:) - Rasti i dytë më ndodhi disa muaj më vonë, në janarin e vitit 1993, kur do të shkoja në varrezat e Shtutgartit, në nderim të vëllezërve Gërvalla dhe të Kadri Zekës. Njeriu që mendoja se do të më shoqëronte, një funksionar lokal i LDK-së, në të vërtetë njeri i mirë dhe mikpritës, kur mësoi se nderimin për të rënët e kishte organizuar Lëvizja, më tha: "Po u mbledhkan të kuqtë".

Pra, në të dyja rastet, me shefin e LDK-së në Gjermani dhe një njeri lokal, mendimi ishte se "ju jeni njerëz të rrezikshëm dhe të kuq". Pse përhapej një ide e tillë, cili ishte qëllimi?

(I.K.:) - Për rrezikshmërinë mendoj se fola, kurse fushata e LDK-së për të na diskredituar e për të na luftuar si "të kuq" ishte një gjetje e ekspertëve të UDB-së për luftën speciale. Në atë kohë ishte në trend të simuloje antikomunistin. Kasnecët e LDK-së donin të kamuflonin të kaluarën e tyre, meqë kishin qenë komunistët më dogmatikë të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë. Vetë diktatori i tyre (i "mëndafshtë"), shoku Ibrahim Rugova, kishte qenë për vite me radhë sekretar i Lidhjes Komuniste, madje i pavotuar nga baza partiake, rrjedhimisht i imponuar nga Komiteti Krahinor, siç e kishin imponuar për kryetar të Lidhjes se Shkrimtarëve, të komisionit për luftim të nacionalizmit, etj.

Më duhet të shtoj diçka, e cila, edhe pse është e ditur, shpeshherë fshihet, anashkalohet, mjegullohet, derisa synohet të zhduket. Në të gjithë botën komuniste, mendoj se nuk jam i gabuar, nuk do të kishte më mjeranë, fatkeq dhe dogmatikë sesa komunistët shqiptarë të Kosovës. Ata, për të keqen e njerëzve tanë, ishin dy herë apo tri herë të rrezikshëm. Së pari, nga ideja e tyre komuniste, së dyti, sepse ishin anëtarë të një partie e cila ishte armike e deklaruar e popullit të tyre, meqë ishte pjesë e lidhjes komuniste serbe dhe, së treti, sepse, përmes dogmës ideologjike po shtypnin popullin e tyre, po e vrisnin dhe po e burgosnin atë për hir të pushtuesit të huaj. Nuk e di sa të informuar janë njerëzit, sepse për krimet komuniste në Kosovë po heshtet me tepri. Ndoshta nga fakti se ata u shndërruan në "demokratë" brenda natës, mirëpo numri i të vrarëve në Kosovë, në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore është më shumë se 48 mijë veta ose dhjetë herë më shumë se në Shqipëri; numri i të burgosurve politikë dhe të "përpunuarve" policorë është mbi 500 mijë. Dhe këtë nuk e ka bërë vetëm Rankoviçi dhe klika e tij udbashe, por edhe titistët në Kosovë. Madje, për të qenë të saktë, ata kanë qenë masha djegëse në duart e pushtetit serb. Prandaj ne, që ishim kundër regjimit, kundër vrasjeve të bashkatdhetarëve, që ishim për bashkimin e popullit, që dënoheshim si nacionalistë, që vriteshim si irredentistë, ishim të rrezikshëm për ta. Unë e kuptoj mllefin e tyre, por më mirë sesa unë e kuptojnë shokët e mi, që kanë vuajtur tmerrësisht nëpër burgjet serbe.

Për të mos e zgjatur, do të thosha: mjerë ai popull që di për krimet dhe kriminelët, por që harron ato dhe keqbërësit e shkaktarët!

Tani më lejoni të sqaroj aspektin përmbajtjesor, nëse **e kuqe** ishte Lëvizja apo më e "kuqe" ishte LDK-ja? Kasta

udhëheqëse e LDK-së, pothuajse pa përjashtim, vinte nga kasta më dogmatike e Lidhjes Komuniste. Në Lëvizje nuk kishte pothuajse asnjë veprimtar që kishte bërë karrierë në Lidhjen Komuniste, qoftë edhe të ketë qenë anëtar i thjeshtë i saj. LDK-ja sundohej nga një diktator (më i rrezikshëm është diktatori shpirtëror sesa ai fizik, do të thosha) ku nuk kishte zgjedhje të lira, nuk i përmbahej Statutit, nuk debatoheshin vendimet, etj. Lëvizja mbisundohej nga sistemi demokratik, me udhëheqje kolegjiale, zgjedhje të lira (e të fshehta) në një konkurrencë me më shumë se dy kandidatë, ku ishte i lirë debati i shtruar para vendimmarrjes, etj. Nga LDK-ja përjashtoheshin "të kuqtë", kurse në Lëvizje mirëpriteshin e angazhoheshin "të kuqtë", "blutë", "të gjelbrit"...

Këto janë argumentet se LDK-ja vërtet ishte më e "kuqe" se Lëvizja.

Rikthimi në Kosovë

(B.I.:) *- Mbledhja e Tretë e Përgjithshme e Lëvizjes, për herë të parë, në kushtet e reja, kur dukej se do të kishte më shumë frymëmarrje politike, u zhvillua në Kosovë. Në të morën pjesë edhe disa nga figurat e njohura të ish-të burgosurve politikë të Kosovës, të cilët nuk kishin shumë që ishin liruar nga burgjet, si: Hydajet Hyseni, Gani Syla, Ramë Buja, Ali Lajçi, Berat Luzha, Mehmet Hajrizi etj. Pas tri ditëve u zgjodh drejtues i Lëvizjes, Gani Syla. Për herë të parë u hodh arsyetimi se Lëvizja duhet të jetë legale, të ikë nga formatizimet e mëparshme etj. Kishte edhe mendime se ajo duhej të shkrihej, sepse e realizoi misionin e saj. Nga distanca e viteve unë do të doja mendimin tuaj për dy çështje themelore:*

Çfarë do të ndodhte nëse Lëvizja do të mbetej edhe më pas, sipas vendimit të kësaj Mbledhjeje, një organizatë legale, si gjithë të tjerat, garniturë e pluralizmit politik dhe, e dyta, çfarë do të kishte ndodhur nëse do të merrej parasysh ideja dhe Lëvizja nuk do të kishte më aktivitet politik e ushtarak?

(I.K.:) - Pyetjeve "çfarë do të ndodhte, nëse..." nuk u përgjigjem me dëshirë, sepse rezultojnë hipotetike e me pandehma. Sidoqoftë, nga distanca e viteve, unë mund të shqiptoj arsyetime, të cilat, edhe nëse nuk janë të qëlluara, uroj të mirëkuptohen!

Lëvizja, edhe po të donte, nuk i kishte mundësitë të "legalizohej". Cilët do të ishin ata që do të dërgonin kërkesën në Beograd për ta "legalizuar", kurse Republika virtuale e Kosovës nuk kishte ngritur as formalisht institucionin përkatës të regjistrimit të partive dhe të organizatave politike. Kështu, legalizimi i saj, së bashku me partitë politike që lindën njëra pas tjetrës dhe prej tyre nuk ka mbetur thuajse asnjë, veç LDK-së, s'do të ishte veçse utopi, por edhe një sipërmarrje e parealizueshme.

Njerëz të lodhur nga ngjarjet e mëparshme ose të prirur të besonin iluzionet që po lindin shpejt e do të këputeshin shpejt, mund të kishin edhe një synim të tillë, që edhe Lëvizja të kthehej në një nga të shumtat, ndoshta me emër tjetër, me program e statut tjetër, por ajo, me siguri do të mbetej vetëm një relikt në kujtesë.

Ata që kanë menduar se Lëvizja duhej të shpërndahej, përkatësisht të pushonte veprimtarinë e saj çlirimtare, me arsyetimin se e kishte realizuar misionin e saj, kanë qenë të gabuar. Fatmirësisht, nuk kanë dalë fitues, por as nuk janë anatemuar si armiq të Lëvizjes, meqë shprehën lirshëm mendimin e tyre. Disa prej tyre, ashtu siç e menduan vetë, shkuan për disa kohë edhe në LDK, u bënë edhe figura të asaj partie. Kishte momen-

te kur nuk ishim të një mendjeje me qëndrimet e veprimet e tyre, por kurrë, në asnjë moment, nuk i anatemuam sepse kjo jo vetëm nuk ishte në natyrën e Lëvizjes, por nuk ishte as e denjë.

(B.I.:) *- Disa ditë pas Mbledhjes së Tretë të Përgjithshme, drejtuesi i saj Gani Syla dha dorëheqjen dhe u largua nga Lëvizja. Nuk po futemi tani te shkaqet pse ndodhi kjo, pasi kjo kërkon një analizë të dyanshme, por edhe shumë figura të tjera largohen dhe drejtohen nga LDK-ja. Pse ndodhi kjo?*

(I.K.:) - Ndoshta sepse ishin lodhur dhe ishin harxhuar nga vuajtjet e rënda në burgje. Kjo mund të kuptohet e, deri në një farë shkalle, edhe mund të ishte legjitime. E dinin se Beogradi pushtues dhe serbomadh përndiqte vetëm veprimtarët e Lëvizjes dhe ata nuk donin të përballeshin me rrezikshmërinë për t'u burgosur e për t'u torturuar sërish. Edhe kjo ka qenë legjitime. Kishte nga ata që menduan se mund të shfrytëzonin LDK-në për të realizuar përcaktimet e tyre nacionale, por rezultoi që u zhgënjyen. Ibrahim Rugova nuk ishte aq liberal, sa dukej, për t'i toleruar të tillët, siç nuk ishte edhe aq naiv dhe i brishtë, siç improvizonte, që të mos i njihte dhe të mos ua tregonte vijën e kuqe. E vërteta është se Rugova, në momente të caktuara, e shfrytëzoi mjeshtërisht emrin e tyre, kapacitetin që kishin krijuar, ndjenjën e besimit që kishin njerëzit ndaj tyre si ish-të burgosur politikë, por, kur e kuptoi se ata nuk do të ishin deri në fund aq të urtë dhe kur ata vetë e kuptuan se nuk mund ta birrnin edhe më tej emrin e tyre, ndodhi ndarja. Kështu shumë prej tyre, natyrshëm u drejtuan te streha e dikurshme dhe u pritën jo si një kthim i djemve plëngprishës, por si një rikthim normal te vlerat që ata dikur kishin ndikuar të krijoheshin.

VI. Lëvizja vendos formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Viti 1993 është pa asnjë dyshim njëri ndër më të rëndësishmit në zhvillimin e Lëvizjes. Janë disa arsye pse e bëjnë këtë një vit të veçantë dhe zanafillës të shumë ngjarjeve të tjera, po ashtu tepër të rëndësishme.

Më parë se të vazhdonim komunikimin tonë, dua të përmend disa prej tyre. Në prillin e këtij viti do të zhvillohet ajo, që në historikun e Lëvizjes quhet Mbledhja e Kërçovës (e mbajtur në fshatin Kollare, buzë Zajazit, krahina e Rekës së Epërme), në të cilën, për herë të parë, do të shtrohet me seriozitetin më të madh çështja e fillesës së luftës së armatosur në Kosovë. Mbledhja e Kërçovës do të hedhë poshtë si të dëmshme vendimet e Mbledhjes së Tretë të Përgjithshme dhe do të formojë Grupin e Organizimit dhe të Riorganizimit, i cili, si detyrë parësore do të ketë Përgatitjen e Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme. Grupi i Organizimit dhe i Riorganizimit (GOR) përbëhej prej pesë vetave - Ramadan Avdiu, Adnan Asllani, Hashim Thaçi, Bilall Sherifi dhe Hulusi Beqiri. Për një periudhë shumë të shkurtër dhe në kushtet e fshehtësisë së thellë, grupi duhej të bënte riorganizimin e strukturave të Organizatës, disa prej të cilave ishin dëmtuar nga euforia e legalizimit, duhej të ringrinte struktura të reja, të punonte për materialet që do t'i paraqiteshin Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme dhe të përcaktonte ligjshmërinë organizative të delegatëve të zgjedhur në Mbledhje. Pra, ishte një punë tejet e rëndësishme dhe në një moment delikat.

Është një kohë kur strukturat lokale të Lëvizjes Popullore të Kosovës nuk dëshirojnë më të bëhen pjesë e një revolte të zakonshme, si për shembull shpërndarje traktesh, shkrim parullash, etj, por kërkojnë kalimin në aksionet e armatosura. Kërkojnë njëkohësisht që të ketë një strukturë politike, organizative, që të marrë përsipër realizimin e aksioneve dhe mbështetjen e tyre. Për një gjë të tillë ata bëjnë presion në strukturat drejtuese të organizatës.

Momentet para Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme dhe Organizimi i saj, janë diskutuar edhe më pas, sepse, në të vërtetë, duke qenë një përpjekje e frytshme, ajo periudhë do të jetë në fakt edhe pararendëse e Vendimit të Organizatës për ndërtimin e strukturave të armatosura. Por, për të shkuar deri në marrjen e këtij vendimi, gjërat nuk kanë rrjedhur nga lart, por mendimi fillimisht është përgatitur në strukturat lokale, ku njerëzit e dinin se tashmë duhej vepruar krejtësisht ndryshe.

Le të kthehem edhe një herë në diskutimin e Ramadan Avdiut, në Mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm, në maj 1998.

Ramadan Avdiu: "Ne kemi ardhur në përfundimin dhe kemi ndërtuar strategjinë që të organizohet një strukturë që të jetë e qëndrueshme dhe jo të organizohet një strukturë, e cila kryen një mbledhje dhe nuk i kryen punët që duheshin.

Kështu që, më herët kanë filluar aksionet e armatosura. Ato janë organizuar nga Lëvizja. Unë kam qenë një prej atyre që i kam furnizuar njësitet e para të Ushtrisë, që do të njihet më vonë si UÇK-ja. Dhe kur kam shkuar në Skenderaj, fjala vjen, Mehmeti (Bislimi) ka qenë prezent, edhe Hashimi (Thaçi) ka qenë prezent, nga anëtarësia e Lëvizjes e Këshillit të rrethit, nga Sami Lushtaku, Ilmi Zeka, por edhe nga Adem Jashari, është kërkuar që përgjegjësia për aksionet të merret nga Lë-

vizja. Unë kam kundërshtuar dhe u kam thënë se ne mund ta marrim përgjegjësinë, mirëpo nuk do të shkojë gjatë dhe do të na arrestojnë. Duhet pasur shumë kujdes që të mos dështojmë në start sepse, për ta sjellë gjendjen në këtë shkallë që e kemi sot pas ndonjë goditje eventuale nga ana e armikut, do të na duhet kohë e gjatë. Vazhdimisht kemi punuar që të ndërtojmë strukturën ushtarake të veçantë dhe të ndarë nga struktura politike….” (Arkivi i LPK-së, 1998, kaseta 7-a)

Në këto kushtet e rrethana, kur tashmë do të kishte një filozofi të re në zhvillimin e Organizatës, do të mbahet Mbledhja e Katërt e Përgjithshme, sipas mendimit tim, më e rëndësishmja dhe e njëjtë në përtëritjen historike, si edhe themelimi i saj.

Mbledhja do të ketë edhe një veçori, ajo për herë të parë, jo vetëm që do të zhvillohet në Kosovë, por brenda në Prishtinë, në shtëpinë e Fatmir Brajshorit, dhe, mes të tjerave, do të përcaktohet saktësisht për fillimin e luftës së armatosur.

Në mbledhjen e katërt të LPK është vendosur që të ndryshohet emri nga LPRK në LPK, pastaj vendimi më i rëndësishëm është afrimi i bërthamave të armatosura që i kishim krijuar dhe strukturimi i tyre, duke iu dhënë dritën jeshile për veprim. Pra, vendimi historik për kalimin në fazën e organizimit të luftës së armatosur. Pastaj në këtë mbledhje është zgjedhur Këshilli Drejtues dhe Kryesia e LPK-së.

Zgjedhja e Këshillit të ri të Përgjithshëm do të ketë një veçanti, e cila ka ndodhur vetëm një herë, vetëm në këtë Mbledhje dhe nuk është përsëritur më. Drejtimi i Mbledhjes së Përgjithshme iu caktua Adnan Asllanit (“Bashkimi“), i cili, së bashku me Hashim Thaçin, Halil Selimin, Bilall Sherifin dhe Ramadan Avdiun, do të ishin ndër njerëzit që e kishin përgatitur këtë. Adnanit atëherë i jam drejtuar atij për të

bërë të qartë këtë precedent, që ndodhi vetëm një herë e nuk kishte nevojë të përsëritej më.

Adnan Asllani: "Organizimi i mbledhjeve të mëhershme, sidomos ajo e treta, organizatës sonë i kishte dhënë mësime të mjaftueshme për dekonspirimin e radhëve, sidomos të organeve drejtuese. Prandaj, Grupi i Organizimit dhe i Riorganizimit, në konsultim me kryesinë e para Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme, vendosi që të formojë një Komision, i cili do të shqyrtonte listën e kandidatëve të mundshëm për anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm, dhe, të cilët, do t'ia propozonte Mbledhjes së Përgjithshme. Në propozim do të hidhej që të mos publikohej Këshilli i Përgjithshëm, por t'i besohej komisionit të përbërë nga Halil Selimi, Adnan Asllani dhe Hashim Thaçi. Mbledhja, siç pritej, miratoi propozimin e komisionit dhe ia fali besimin për emërimin e KP.

(Informacion dërguar Kryetarit të Lëvizjes Popullore të Kosovës, BI, maj 1998)

(Sipas parashikimit të Komisionit në KP do të zgjidheshin dhe u zgjodhën: Bajrush Xhemajli, Halil Selimi, Emin Krasniqi, Adnan Asllani, Shaban Shala, Xhavit Haziri, Ali Ahmeti - shënim i intervistuesit).

Ky rast, emërimi i KP, jo vetëm pa hyrë në zgjedhje, por edhe duke u ditur vetëm nga një rreth i ngushtë, do të jetë i vetmi precedent i tillë, dhe kjo ka lidhje me vendimin e veçantë për fillimin e veprimeve të armatosura.

Prej kohësh është diskutuar rreth datës së formimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ka pasur mendime të ndryshme, varësisht nga konceptimet dhe rrjedhat në të cilat njerëzit kanë qenë. Herë-here, themelimi i saj dhe emërtimi i saj janë ngatërruar me njëri-tjetrin, duke krijuar një dyzim, që ka qenë

i tepërt dhe i panevojshëm. Dihet tashmë se emërtimi, Ushtria Çlirimtare të Kosovës, është bërë në Kryesinë e Organizatës, sipas propozimit të Xhavit Halitit, dhe, krahas këtij propozimi ka pasur edhe të tjera, ndërsa ndërtimi i Emblemës së UÇK-së, pas propozimit të Gafur Elshanit, i ngarkuar nga kryesia për këtë gjë, është ndërtuar mjeshtërisht nga Adnan Asllani. Edhe për këtë, ka pasur disa variante të ndryshme, derisa, po nga kryesia e Organizatës, u vendos për emblemën e njohur tashmë nga të gjithë. Po nga Adnan Asllani do të krijohet edhe emblema e Fondit "Vendlindja thërret", që do të miratohet, po ashtu, nga kryesia e Organizatës.

Të gjitha këto kanë ndodhur pas fundit të korrikut dhe fillim gushtit të vitit 1993 dhe për mua, personalisht, kjo është edhe ditëlindja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse, pikërisht në Mbledhjen e katërt të Përgjithshme të Lëvizjes Popullore të Kosovës, u mor vendimi për krijimin, mbështetjen dhe fuqizimin e luftës së armatosur.

Nëse është i pranuar fakti se, dita e 17 Janarit 1982 është dita e themelimit të Lëvizjes Popullore të Kosovës, dhe pas saj, përmes vështirësive u ngritën strukturat e përbashkëta të Organizatës, po ashtu, duhet pranuar se edhe dita e themelimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është po ajo ditë, në të cilën është marrë Vendimi Politik për krijimin e saj.

Në drejtimin e organizatës do të spikatë Xhavit Haziri, i cili do të jetë edhe i ngarkuari kryesor për drejtimin e strukturave klandestine të njësiteve luftarake e më pas të përbërësve më të mëdhenj. Ai, së bashku me Adem Jasharin, në Drenicë do të marrin përsipër fillesën, e cila do të ishte e vështirë dhe për shumëkënd e pamundur. Në të njëjtin rol do të caktohen nga Organizata edhe Xhavit Haliti e Hashim Thaçi, e më pas edhe shokë të tjerë.

Ditën kur po mbahej Mbledhja e katërt e Përgjithshme janë arrestuar 5 veprimtarë të LKÇK-së. Me të kuptuar lajmin e atij arrestimi, është menduar me të drejtë se do të ketë fushatë arrestimesh nga ana e UDB-së dhe janë marrë masat që fillimisht t'i nxjerrin jashtë Kosovës delegatët e Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme që kishin ardhur nga Dega Jashtë Vendit. Ata, të gjithë, në Kosovë ishin futur ilegalisht. Kanë qenë pesë: Emrush Xhemaili, Fazli Veliu, Beqir Beqa, Sabri Kiçmari dhe Bilall Sherifi.

Më 2 gusht 1993 ka filluar një fushatë e egër e arrestimeve të veprimtarëve të LPK-së. Në të njëjtën kohë janë rrethuar dhe është kërkuar që të arrestohen pjesa më reprezentative e veprimtarëve të LPK-së: janë arrestuar Xhavit Haziri, Ahmet Haxhiu, Nehat Selimi, Rexhep Avdiu e Shemsi Veseli në Prishtinë; Ismet Mahmuti, Hajredin Hyseni, Faik Ajeti në Besianë; Bejadin Hallaqi e Binak Berisha në Prizren; Shefki Muqaj e Ilaz Kadolli në Therandë: Ramadan Pllana e Islam Mulaku në Vushtrri: Bajrush Xhemaili në Ferizaj, etj., kurse janë kërkuar që të arrestohen dhe iu kanë shmangur arrestimit, përveç meje, edhe Azem Syla, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Ramiz Lladrovci, Ekrem Jashari, Halil Selimi, Ibish Neziri, Hidajete Krasniqi, Adrian Krasniqi, etj. Nga të gjithë të arrestuarit vetëm Xhavit Haziri ka qenë pjesëmarrës i Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme.

Ramadan Avdiu e Adnan Asllani, po ashtu anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm, do të kalojnë në klandestinitet, më pas do të arratisen në Shqipëri, pastaj në Zvicër. Ndërsa Halil Selimi do të qëndrojë në Shqipëri, ku do të përcaktohet për ngritjen e degës së Lëvizjes në shtetin amë.

Pas kësaj hyrje të gjatë, e cila më është dukur e domosdosh-

me, sepse në Kosovë ndërkohë po ndodhnin ngjarje të rëndësishme, ndoshta më të rëndësishmet në historinë e Organizatës, nuk më është dukur e arsyeshme të flasim për një pjesë, duke lënë mënjanë pjesën themelore.

Le të kthehemi në biseden tonë:

***(B.I.:)** - Do të doja të të pyesja për disa zhvillime, për të cilat, si edhe herë të tjera, mund të më thuash se nuk ke qenë në dijeni, sepse të tjerë ishin të përcaktuar në lidhjet me shokët që vepronin në Kosovë.*

Kur dhe si keni mësuar për Mbledhjen e zhvilluar në Kërçovë, në strukturat tuaja, qoftë atëherë e ndoshta edhe më vonë, a është diskutuar ndonjëherë për këtë ngjarje të organizatës?

(I.K.:) - Sigurisht që detyrohem ta përsëris sa herë të më pyesni për zhvillimet konkrete të Organizatës në Kosovë, se nuk kam qenë i informuar, se të tjerët, sidomos anëtarët e Kryesisë së Lëvizjes, Dega jashtë vendit, kanë qenë të ngarkuar të merren me ato zhvillime.

Po, vetëkuptohet, ne nuk po bëjmë studim dhe as monografi për Lëvizjen, por një bashkëbisedim, në prag të 30-Vjetorit të themelimit të Lëvizjes. E, në bashkëbisedim, rëndom thuhen fragmente që aty për aty u kujtohen bashkëbiseduesve, - në rastin konkret neve, - që i rithërrasim nga mbamendja, që i interpretojmë e vlerësojmë edhe sipas përjetimit personal.

Patjetër që jemi informuar për Mbledhjen e mbajtur në Kollare të Zajazit (Kërçovë) dhe për të gjitha mbledhjet brenda, për aq sa Kryesia i raportonte Këshillit të Përgjithshëm. Me të drejtë, Këshillit të Përgjithshëm (KP) i rezervoheshin një pjesë e informatave, nga se KP ishte forum i gjerë dhe nuk duhej të rrezikoheshin veprimtarët dhe vendimet e Lëvizjes brenda vendit. Raportimet e

Kryesisë duhet të jenë në arkivin e Lëvizjes, ashtu si edhe diskutimet, vlerësimet dhe vendimet në KP-së.

Më vonë jam informuar për vendimin, do të thosha historik, të asaj Mbledhjeje, që të organizohet krahu ushtarak për luftë çlirimtare, duke i seleksionuar anëtarët që ishin për luftë çlirimtare dhe që donin të angazhoheshin. Që atëherë ka filluar seleksionimi i anëtarëve të Lëvizjes brenda Vendit, nga të cilat janë formuar njësitet e para guerile.

(B.I.:) *- A ka qenë e njohur për ty, jo vetëm si individ, por edhe për drejtues të tjerë të Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes, fakti i zhvillimit të Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme?*

(I.K.:) - Po. Na ka informuar Kryesia. Janë bërë vlerësime, por siç sqarova, nuk i kam në memorie, sepse tashmë Organizata ishte zgjeruar, kishte rritur veprimtarinë dhe patjetër që kërkohej sistematizim e ndarje e përgjegjësive.

(B.I.:) *- Si u përjetuan arrestimet që ndodhën në Kosovë?*

(I.K.:) - Përgjigja mbase është e vetëkuptueshme, se arrestimet i përjetonim si goditje të rënda, në planin organizativ, si dëmtim të Organizatës, por edhe në sensin njerëzor. Disa nga të arrestuarit i njihja, disa të tjerë ishin të panjohur për mua. Kishte edhe nga të afërmit e shokëve të mi të organizatës, siç ishte rasti i Bajrush Xhemajlit. Me shumicën prej tyre jam njohur më vonë, ose kur ndonjëri prej tyre erdhi në Perëndim, ose pas përfundimit të luftës në Kosovë. Ka pasur gjithnjë një veçori në Organizatë, e cila ishte mësuar me burgosjet e anëtarëve të saj, burgosje, të cilat ishin të shumta dhe në kohë të ndryshme. E veçanta qëndronte në faktin se, megjithëse kishte dhimbje, nuk kishte mpirje. Sa herë që Organizata është dëmtuar, dhe kjo ka ndodhur kryesisht me drejtuesit kryesorë, ata kanë lënë pas vetes rrjete të tjera, të organizuara, të cilat kanë vazhduar

punën, aty ku është lënë, dhe prej tyre kanë dalë edhe drejtuesit e rinj. Pra, duhet pranuar se, ashtu siç nuk ka pasur periudha pa burgosje e dëmtime, ashtu nuk ka pasur as periudha pa dalë udhëheqës të rinj, të cilët kanë pasur gjithnjë besimin tonë.

Me emrat dhe listat e të burgosurve politikë jam marrë qysh në vitin 1978 e këtej, meqë përgatisja e aktualizoja një si *databas* për ta, sepse qysh atëherë kam qenë në lidhje me *Amnesty International* në Londër, konkretisht me të ngarkuarën për të burgosurit politik në Jugosllavi, Zonjën Melani Anderson. Pos dhimbjes për gjithë ata dhjetëra mijëra të burgosur, shpesh ndjeja edhe lodhje duke radhitur emrat e tyre dhe duke përgatitur broshura në shumë gjuhë për të informuar opinionin, mediat dhe strukturat ndërkombëtare.

(B.I.:) - Cilët nga familja juaj e ngushtë, që ishte në Kosovë ishte pjesë e Lëvizjes?

(I.K.:) - Në atë kohë nuk kam qenë i informuar. Më vonë kam mësuar se kanë qenë nipi, Salihu, vallezërit Qerimi, Ademi, Osmani, qysh kur Lëvizja ka pas radhë të organizuara në Kosovë, përkatësisht qysh kur kanë qenë persona madhor. Pastaj Qerimi dhe Salihu qysh në vitin 1991 kanë filluar të merren me sjellje fshehurazi të armëve dhe municionit nga Shqipëria, kanë mbajtur pranë për ndihmë shumë anëtarë të familjes. I kanë përdorur si strukturë logjistike, sidomos vëllezërit: Zenelin e Dautin; motrat: Ryvën dhe Lushën. Përndjekjet, torturat, burgosjet Nënës, vëllezërve, motrave por edhe disa kushërinjëve të mi nuk iu kanë ndarë ndonjëherë, sidomos nga viti 1979, deri në vitin 1998, pavarësisht faktit se ndonjëri ishte i mitur.

Që ta konkretizoj edhe pak, mbase nuk tingëllon si lavdërim i tepruar familjar, por Qerimi dhe Salihu, bashkë me bash-

këveprimtarët e tyre, vërtet qysh në fillim të vitit 1991 vinin fshehurazi në Tiranë, duke kaluar në këmbë zonën kufitare me male të larta. Ata nuk më shqiteshin derisa më detyronin të "shpërdoroja" financat e Shtëpisë Botuese "Iliria", t'u jepja të holla për të blerë armë dhe i fusnin brenda fshehurazi. Mbase pjesëtarët e parë guerilë do të dëshmojnë ndonjëherë se armët që kishin përdorur në aksionet e para, ishin nga ajo linjë furnizimi!

Kurse Qerimi është shquar për aksionet e para guerile, bashkë me Adrian Krasniqin, Ilir Konushevcin, në bashkëveprim me Zahir Pajazitin, Adem Jasharin dhe shumë bashkëluftëtarë të tjerë.

Fillesë e re

(B.I.:) - Në dhjetorin e vitit 1993 dhe në prillin e vitit 1994, në Tiranë, do të zhvillohen disa takime e mbledhje të rëndësishme mes përfaqësuesve të Organizatës nga brenda dhe shokëve nga jashtë. Aty janë analizuar edhe shkaqet që çuan në arrestimet e vitit 1993, të cilat e goditën rëndë Organizatën. Materiali është punuar nga Adnan Asllani dhe Halil Selimi. Mes të tjerave në material thuhet se është kërkuar të diskutohet e të merret mendimi edhe i shokëve që janë jashtë. Më intereson të di, nëse ndonjëherë, për këto çështje që janë shtruar në këto mbledhje, është marrë mendimi apo sugjerimet e strukturave jashtë vendit, dhe, konkretisht, mendimi juaj?

(I.K.:) - Fragmente nga analizat në fjalë Kryesia ua ka shpërndarë anëtarëve të KP-së. Janë diskutuar dhe janë mbajtur qëndrime, por ja që nuk po më kujtohen tani, konkretisht, diskutimet dhe qëndrimet. Shih për këtë, ka kohë që mendoj. Ma-

terialet arkivore të Lëvizjes do të duhej të fillonin të botoheshin tashmë, meqë distanca kohore duhet të jetë e mjaftueshme.

(B.I.: / Shënim:) *Çfarë ndodh në dhjetor 1993 dhe në fillimin e vitit 1994, në Tiranë? Mendoj se është e rëndësishme, qoftë edhe shkurtimisht, të përcaktojmë disa detaje, ku mund të ndalemi, të bëjmë publike disa vendime që janë marrë, njerëzit që i kanë përçuar ato dhe rrjedhën e mëtejshme. Ndoshta kjo i ngjan një hapje fillestare të një pjese arkivore, ngjarje e cila, edhe sot, nuk është mjaft e njohur dhe si e tillë, duke mos qenë e njohur as në ditët e shkuara, ka lënë vend për pasaktësi, hezitime e mendime të ndryshme.*

Nga data 23 deri me 25 dhjetor 1993, pas arrestimeve që kishin ndodhur disa muaj më parë dhe përpjekjeve për të ringritur strukturat e dëmtuara, në Tiranë do të zhvillohet Mbledhja e Përbashkët e përfaqësuesve të Lëvizjes nga brenda dhe të Kryesisë së KP-së të Degës së LPK-së jashtë vendit. Mbledhja është thirrur nga përfaqësuesit e Lëvizjes brenda vendit. Do të analizohen katër pika: Gjendja aktuale e LPK-së në Kosovë, gjendja e Degës së LPK-së në Perëndim, shkaqet e ardhjes së kësaj gjendje dhe mundësitë e tejkalimit të saj, pozita e të arratisurve në Shqipëri, ruajtja dhe organizimi i tyre.

Në Mbledhje marrin pjesë Besimi (Azem Syla), Daja (Fazli Veliu), Bashkimi (Adnan Asllani), Qamili (Halil Selimi), Selimi (Hashim Thaçi), Abazi (Ali Ahmeti), Muhameti (Emrush Xhemajli), Zeka (Xhavit Haliti).

(Nga procesverbali:)

Në Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme u zgjodh Këshilli i Përgjithshëm prej 7 anëtarësh; u caktua një Komision nga Grupi i Organizimit dhe Riorganizimit, që iu dha besimi nga Mbledhja e

Përgjithshme (u bënë sqarime të plota rreth anëtarëve të KP-së).

Menjëherë pas Mbledhjes, ende pa u konstituuar KP, u bënë arrestimet dhe u burgosën 2 anëtarë të KP, 2 kaluan në Shqipëri, 2 mbetën jashtë rrjedhës - nga shkaku i pozicionit të tyre dhe një në diasporë.

Pas arrestimeve pati shumë kalime në ilegalitet. Bashkimi, Selimi dhe Besimi kanë punuar për konsolidimin e radhëve të LPK-së. Qëndrimi i pjesës më të madhe të rretheve nuk kanë pranuar të vazhdojnë pa u bërë sqarimet rreth arrestimeve dhe në format e deritashme (Mitrovica, Peja, Rugova, Skenderaj, Gllogovci, Klina, Kumanova). Pati edhe rrethe që treguan gatishmëri për veprimtari (Presheva, Obiliqi, Tetova, etj).

Materialet e MKP nuk kanë rënë në dorë të UDB-së. Mbledhja dhe dokumentacioni nuk dihet nga UDB-ja se ku është mbajtur. Kemi kontaktuar me familjet e të burgosurve. Përmes anëtarëve të familjes së tij, Xhavit Haziri na ka çuar fjalë se, "Shtëpinë që kemi filluar ta ndërtojmë, ta lënë krejt, se tullat i ka të dobëta e u rrënohet menjëherë, prandaj djemtë le të kthehen të studiojnë aty ku kanë qenë".

Mbledhja e Përbashkët mori disa vendime të rëndësishme, ndër të cilët, më i domosdoshmi do të ishte (sipas procesverbalit):

Të formohet një Trupë Udhëheqëse e përbërë prej 5 vetëve, tre vetë që janë në Shqipëri dhe dy nga Dega jashtë vendit. Kjo Trupë luan rolin e Këshillit të Përgjithshëm deri në normalizimin e gjendjes (krijimin e një Grupi brenda vendit).

Trupi udhëheqës përbëhet nga Qamili (Halil Selimi), Bashkimi (Adnan Asllani) që do të jetë edhe drejtues i Trupës, Selimi (Hashim Thaçi), Muhameti (Emrush Xhemajli), Abazi (Ali Ahmeti).

Trupa jep llogari para atyre që e kanë ngarkuar, Dajës F.(Fazli Veliu), Besimit (Azem Syla) dhe Zekës (Xhavit Haliti) si dhe organeve statutare.

Kjo do të jetë përpjekja e parë serioze e Organizatës për ndërtimin e strukturave dhe tejkalimin e gjendjes. Është zgjedhur një Trupë drejtuese, e cila për kohën, do të ishte më e mira e mundshme.

Për herë të parë, në këtë procesverbal mësohet se i deleguar nga Këshilli i rrethit të Rahovecit dhe Prizrenit në Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme do të ishte Ukshin Hoti.

Kjo Trupë drejtuese do të vazhdojë deri në 14 prill 1994.

Nga procesverbali i datës 13 mars 1994 kam shkëputur disa pjesë të posaçme, si dëshmi se, edhe në këto kushte, synimi ka qenë rivendosja e lidhjes me strukturat organizative dhe, njëkohësisht, me ato ushtarake.

Selimi (Hashim Thaçi): Organizata jonë në Kosovë nuk është më, tash për tash, një faktor i rëndësishëm politik. Ndoshta nga goditjet, por edhe nga dobësia jonë. Duhet të shohim se ku kemi gabuar. Organizim ilegal në Kosovë, jashtë organizim legal, nuk shkojnë. Nuk është e drejtë që nga të gjithë shokët jashtë vendit, vetëm Abazi rrezikon e futet në Kosovë. Nëse duam të bëjmë brenda një organizim sa për ta pasur, unë nuk jam për të. Unë, kur të jetë nevoja do të futem në Kosovë, por nuk e marr përsipër t'i them këtij apo atij, vetëm për ta futur në një organizim politik. Duhet të ndryshojmë krejt formën e organizimit. Ka qenë e gabuar që nga nëntëdhjeta. Pos një organizimi të mirëfilltë brenda, kjo duhet të bëhet edhe jashtë.

Qamili (Halil Selimi): Të gjitha dobësitë relativisht i dimë. Qëndrimet e mbledhjes së kaluar dihen. Pyes Dajën (Azem Syla), a ka mundësi të shpresohet në njerëz në organizim, meqë mbësh-

tetja kryesore në mbledhjen e kaluar, ishte në deklarimin e Dajës dhe të Selimit (Hashim Thaçit), se kemi forca. Domethënë, nëse po, po e vazhdojmë, por si? Nëse nuk ka mundësi të zbatohen vendimet e Mbledhjes së kaluar, atëherë duhet të zgjidhet një variant tjetër. Kurse ne nuk guxojmë të tërhiqemi, për shkak se mendojmë se nuk shohim mundësi apo për diçka tjetër.

Selimi (Hashim Thaçi): Mendoj se duhet që Këshilli i Përgjithshëm, i zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme, të konstituohet, sepse kjo më duket më e arsyeshme. Mendoj se është i arsyeshëm ky propozim dhe se kemi gabuar që të gjithë, që nuk e kemi bërë që në fillim. Nga rrethet, ata që e kanë ndërmend të punojnë, punojnë dhe nuk na presin, as ne e as askënd, domethënë, kush e ka ndërmend, nuk pret askënd. Unë mendoj se kjo Trupë udhëheqëse duhet të pushojë që sot, sepse duhet të punohet që të konstituohet Këshilli i Përgjithshëm.

Abazi (Ali Ahmeti): "Edhe unë mendoj se kjo është rruga më e mirë. Ne duhet të pozicionohemi dhe të intensifikojmë lëvizjen çlirimtare."

Pas shkrirjes së Trupës Udhëheqëse, merret vendimi i datës 14 prill që kompetencat e drejtimit, për shkak të situatës së jashtëzakonshme të kalojnë në Degën jashtë vendit.

Kjo është periudha, kur jo befasisht, në Perëndim shfaqen disa nga figurat e njohura të Lëvizjes, qëndrimi i të cilëve në Kosovë, tashmë ishte bërë i pamundur. Si priten ata. Për këtë kam një dëshmues.

* * *

***(B.I.:)** - Pse ndodhte që shokët që vinin nga Kosova, për t'u ikur arrestimeve, e të cilët atje kishin qenë drejtues të Organizatës, liheshin mënjanë, nuk vlerësoheshin që në fillim, trajto-*

heshin sikur të ishin anëtarë të posapranuar në Organizatë? Kjo ndodhte kryesisht në Zvicër. Mund të sjell dy shembuj, në fundin e vitit 1993 dhe fillimin e vitit 1994, në Zvicër, mes të tjerëve, do të kërkojnë strehim të përkohshëm dy nga drejtuesit kryesorë të Organizatës, të zgjedhur në Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme: Adnan Asllani dhe Ramadan Avdiu. Do të kalojnë disa vite deri sa ata të kenë rishtas një rol drejtues, megjithëse jo në drejtimin kryesor të Organizatës. Në Gjermani do të ndodhë ndryshe, dy nga shokët e ardhur në këtë periudhë: Hasan Ukhaxhaj dhe Fehmi Lladrovci do të zgjidhen që në fillim në drejtimin e Nëndegës së LPK-së në këtë shtet.

Pse kemi dy qëndrime?

(I.K.:) - Tani ma ke gjetur një pikë nevralgjike. Për këtë çështje kemi bërë goxha shumë debate në mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm, sepse unë nuk pajtohesha me qëndrimin, për gjykimin tim të atëhershëm *non sens,* pothuajse dominues, edhe të Kryesisë, edhe të shumicës se anëtarëve të KP-së, se kuadrot që arratiseshin nga Kosova, që ishin edhe kuadro drejtues të Lëvizjes në Kosovë, me t'u vendosur në ekzil, të ktheheshin në anëtarë të thjeshtë, siç thoshim atëherë, të Lëvizjes, Dega j.v. Jo vetëm dy bashkëveprimtarët që përmende, por atëherë qenë arratisur në Zvicër edhe Azem Syla, Hashim Thaçi, Kadri Veseli e disa të tjerë, që për momentin nuk po më kujtohen. Secili kishte të drejtë të asistonte në mbledhjet e KP, siç kishte të drejtë çdo anëtar i Degës, nëse nuk kishte ndonjë pikë të rendit të punës, për të cilën gjykohej se nuk lejohen mysafirë. Por jo vetëm kaq, unë kërkoja që ata menjëherë të kooptoheshin në organet e larta drejtuese, sepse *de fakto* e *de jure*, kishin qenë drejtuesit e Organizatës. Pra, këta kuadro të Lëvizjes detyroheshin të bënin kërkesa në këshillat lokal, që të fillonin nga e para angazhimin dhe karrierën në Lëvizje,

Dega j.v. Dhe ndodhte që ndonjëri nga ata, me të drejtë, sipas parashikimeve që kisha atëherë, të hidhëroheshin, të dëshpëroheshin, rrjedhimisht të pushonin veprimtarinë, siç ishte rasti i Hashim Thaçit. Unë kërkoja që ata, të paktën të kooptoheshin menjëherë në Këshill të Përgjithshëm. Po e konkretizoj me shembuj. Ta zëmë, Ramadan Avdiu në një periudhë kishte qenë udhëheqësi kryesor i Lëvizjes në Kosovë. Kur po e formulonim listën e kandidatëve, për t'ia propozuar Kuvendit (Mbledhjes) së Përgjithshme të radhës për votim, qe debatuar nëse ai duhej të ishte kandidat, edhe pas një kohe të gjatë të qëndrimit e të angazhimit të tij në Zvicër, sigurisht të angazhimit të tij në bazë. Për të mos e zgjatur, le të tregoj vetëm një rast, të cilin edhe ju e dini, sepse keni qenë pjesë e Mbledhjes së Gjashtë të Përgjithshme, dhe, në mos gaboj e keni drejtuar atë. Ndodhi që të kishim përplasje të rënda, nëse duhej ose jo t'i lejonim të merrnin pjesë Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin në Kuvendin e përgjithshëm, të jashtëzakonshëm, të majit 1998. Komisioni i verifikimit të mandateve, mes të tjerëve ishin edhe Sejdi Gega dhe Agush Buja, ua kishte dhënë atyre të drejtën e pjesëmarrjes, mirëpo kishte kontestime, nëse ishin apo jo delegatë të Këshillit të Përgjithshëm brenda vendit, nëse ishin të zgjedhur si përfaqësues dhe kush i kishte zgjedhur, meqë më parë nuk kishin qenë. Kërkohej nëse kishin dëshmi që i kishte deleguar Lëvizja në Kosovë, etj., siç thoshin... Kjo për faktin se ata kishin qëndruar në Zvicër dhe nuk ishin angazhuar në Organizatë. Tani mund të duket e thjeshtë, por kjo ndikoi në zhvillimin e Mbledhjes, sepse pas saj, si gjithnjë kur ka përplasje, bëhen dy palë.

E kam thënë edhe më herët, ai qëndrim *non sens* duhet të ketë luajtur rol në përplasjet që ndodhen në prag e gjatë Luftës, në mes të grupimit të Hashim Thaçit (Xhavit Haliti, Azem Syla, Kadri Veseli) dhe anëtarëve të Kryesisë së deriatëhersh-

me (Fazli Veliu, Muhamet Kelmendi, Emmrush Xhemajli, Ali Ahmeti, Gafurr Elshani).

Kësaj radhe po përmbahem të shfaq mendime se cili fraksion kishte më shumë të drejtë, meqë nuk i kam shënimet dhe analizat e bëra në atë kohë për t'i konsultuar. Ç'është me rëndësi, nuk i kam në dispozicion as materialet e arkivit të Lëvizjes. Megjithatë po shfaq ndjesitë e atëhershme. Ndaj Kryesisë po mbaja inat qysh nga takimi i marsit 1997. Mendoja se nuk ishin kolegjial dhe nuk kishin koordinim mes tyre. I kishte përfshirë një dëlir madhështie dhe ishin bërë goxha individualistë. Nuk më dukeshin operativ, siç e kërkonte zhvillimi i ngjarjeve. Ndërsa ata të krahut tjetër, po më befasonin, sidomos më brente mendimi përse Hashimi ishte bërë bashkëpunëtor i Xhavitit dhe Azemit!? Për këta dy të fundit po dyshoja se po ndërtonin diçka jashtë organizatës, kurse për Hashimin, por edhe për Kadri Veselin, kisha një simpati tejet shoqërore dhe po me vinte keq, përse ata ishin pasivizuar gjatë viteve pararendëse në Zvicër.

Edhe pse nuk kam njohuri të freskëta, pothuajse njësoj ndodhte edhe me Lëvizjen, Nëndega në Zvicër. As ajo nuk i qaste njerëzisht e shoqërisht këta kuadro, sepse udhëheqësit me stazh e njohje më të gjatë në strukturat udhëheqëse të Nëndegës në Zvicër nuk u linin hapësirë kuadrove që vinin nga Kosova, nuk e dëshironin konkurrencën e tyre.

Ndryshe ndodhte në Nëndegën në Gjermani.

(B.I.:) *- Dua të të tregoj një rast tjetër të kësaj sjelljeje, mund të them të çuditshme. Në arkivin e Organizatës është edhe Materiali i dërguar nga një shok yni, dikur drejtues, ndër më kryesorët në Kosovë, që, pas një qëndrimi të shkurtër në Shqipëri, detyrohet të kërkojë strehim në Zvicër. Siç e thashë,*

ishte një ndër njerëzit kryesorë e për më tepër, si të tillë e kishin njohur e pranuar edhe drejtuesit e Organizatës jashtë vendit.

Ai shkruan "Pas daljes sime jashtë vendit (ai ka dalë në vitin 1994), përveç një rasti, kur jam thirrur për të sqaruar IN për ca probleme që kishte ngritur ai, nuk jam thirrur në asnjë takim, madje nuk isha ftuar ndonjëherë për të ndihmuar në organizimin e radhëve brenda, në ndonjë mbledhje të Kryesisë. Kjo gjë zgjati deri para një viti (letra është e datës 3 korrik 1998, shënimi im) kur njëri ndër shokët e kryesisë më kishte ftuar që të kontaktoj për të biseduar diçka për organizimin brenda.

Megjithëse i mllefosur, gjeta forcë e shkova në qytetin ku banonte ai, u takuam në shoqatë, por kot. Ai nuk po më tregonte pse më kishte kërkuar takim. Vazhdimisht arsyetohej "ja, prit edhe pak". Nuk biseduam atë natë dhe unë u largova i revoltuar jashtë mase."

Si e thashë, ai detyrohet të kalojë në mërgim, si kishin shkuar edhe të tjerët para tij, në vitin 1994, por për tri vite rresht nuk e fton askush, të paktën të tregojë për lodhjet dhe gjendjen e Organizatës brenda vendit, ku ai kishte qenë ndër më kryesorët. Paradoks apo jo?

Po në Nëndegën, në Gjermani, mendoj, ishte ndryshe...

(I.K.:) - Të falënderoj për këto informime që i ke nga Arkivi i Lëvizjes. Sigurisht, ndryshe ndodhte në Nëndegë në Gjermani. Mbizotëronte frymë e bashkëveprimit më liberal. Ta zëmë, ç'kuptim kishte të garoja për kryetar Nëndege unë kundër Fehmi Lladrovcit, Hasan Ukhaxhës, Xhemail Fetahut, e ndonjë tjetri të këtij niveli? Them se, me votim të fshehtë, në Kuvend do t'i mundja, nëse më lejohet të shprehem kaq pa modesti, sepse shumica e delegatëve më njihnin që nga

fillimi i veprimtarisë së organizuar, kurse më pak i njihnin veprimtarët, kuadro të sprovuar, të sapoardhur nga Kosova. Në raste të tilla tërhiqesha nga gara, sepse gjykoja se kuadro të sprovuar në Kosovë, si Fehmi Lladrovci, i sprovuar edhe në Luftën e Kroacisë, Hasan Ukhaxha, Xhemail Fetahaj, etj., duhej të gjendeshin në krye të Nëndegës sonë.

Ishte e natyrshme dhe me vlerë të garonim, sepse Lëvizja tashmë kishte gjallëri e dinamikë të avancuar, kishte debat e fushatë zgjedhore, kishte potencial të veprimtarëve të devotshëm e me përvojë. Pra, nuk i ngjante një kënete, siç ndodhte me partitë moniste "legale" të kohës, ku njëshat, liderucët, imponoheshin si diktatorë autoritativë dhe vetë vendosnin cilët duhet të ishin në udhëheqje.

Në këtë dinamikë demokratike e pluraliste, nëndegët e Lëvizjes, sidomos ajo në Zvicër e Gjermani edhe garonin mes tyre për primatë në Degë. Dhe kjo ishte legjitime, ishte dëshmi e demokracisë së brendshme. Ndonjë dogmat e sektar këtë garë e vlerësonte si përçarje, duke pasur frikë nga seleksionimi që imponon gara.

Përse mos ta them me mburrje se veprimtarët e Nëndegës sonë (në Gjermani) kanë të drejtë të krenohen edhe tani, se ajo Nëndegë i dha heronj të shquar Kosovës: Fehmi Lladrovcin, Xhevë Krasniqi-Lladrovcin, Iljaz Kodrën, Xhemail Fetahun, Abedin Rexhën, Gani Paçarizin, Ahmet Kçikun.

(B.I.:) *- Në dhjetorin e vitit 1993, nga Këshilli i Përgjithshëm i LPK-së, Dega j.v., i cili tashmë kishte marrë kompetencat e drejtimit të Organizatës, do të themelohet fondi "Vendlindja thërret". Ti ke qenë pjesë e kësaj mbledhje, e cila, në mos gaboj, është mbajtur me 3 dhjetor. Për më tepër, në një rast, ti më ke korrigjuar, kur unë kam shkruar se drejtuesi i*

parë i Fondit ka qenë Jashar Salihu, duke saktësuar se këtë funksion në fillim e ka pasur Musa Xhaferi.

Si ndodhi themelimi i fondit, si u ngrit ai, kush ishin ndër të parët, si u bë i mundur zhvillimi i tij i mëtejshëm?

(I.K.:) - Po, në atë mbledhje të KP-së, me propozim të Kryesisë, është themeluar Fondi. Edhe emërtimin e Fondit duhet ta ketë propozuar Kryesia. Kurse koordinator i Fondit qe zgjedhur Musa Xhaferi.

(B.I.:) *- Unë e dija se propozimi është bërë nga Xhavit Hoxha, anëtar i Këshillit të Përgjithshëm, i cili edhe ka bërë pagesën e parë, prej 1.000,- frangash zvicerane.*

(I.K.:) - Ndoshta është siç thoni ju, por, besoj ka pak rëndësi se cili ka propozuar emërtimin, edhe pse ndonjëherë imponohet si me rëndësi, kur është fjala për reklamime egoiste.

Ai Fond u themelua enkas për të ndihmuar financiarisht krahun ushtarak të Lëvizjes. KP edhe më vonë nuk e dinte, se Kryesia me 17 Nëntor 1994, në mbledhjen e saj në qendrën "Teli" të Aarau-t të Zvicrës është përcaktuar për emrin: **Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)** dhe po në atë mbledhje të Kryesisë është vendosur të dilet me Komunikatën nr 11, në emër të Ushtrisë të sapoemërtuar. Dhe jo vetëm kaq, por KP pat vendosur që edhe 60 për qind e anëtarësisë financiare (kuotizacionit) në Lëvizje të dërgoheshin në Kosovë, për të ndihmuar financiarisht LPK-në dhe radhët e armatosura në Kosovë.

Për të qenë krejtësisht i hapur, në vitet e para nuk tuboheshin edhe aq shumë financa, sepse një pjesë e anëtarëve të LPK-së, Dega j.v., tashmë të porsaardhur në Perëndim, ishin të rënduar nga hallet, e ndërkohë mungesat ishin edhe më të pakta, ngaqë ndërkohë po krijonin familje. Të tjerë, që ishin afër

nesh ose shiheshin më pranë nrsh se të tjerët, parapëlqenin të kursenin që të blinin banesa e të kishin rezerva individuale, dhe ndihma nga to nuk ishte gjithnjë si ishte menduar. Edhe emigrantët patriotë nuk ndihmonin sa kishin mundësi, sepse tashmë LDK-ja i kishte bindur se Republika e Kosovës do të realizohej në rrugë "pacifiste", "gandiste", pa pasur nevojë të jepnim financa për armatim. Kurse veprimtarëve të përkushtuar, pothuajse nuk u tepronin para as për bukë, meqë ndihmonin mbi mundësitë e tyre reale. Ne duhet të pranojmë faktin se në vitet e para të ekzistencës së saj, që ishin edhe më të vështirat, UÇK-ja, kishte vetëm ndihmesën e Lëvizjes, jo vetëm politike e logjistike, por edhe financiare, megjithëse ato ishin jo të mjaftueshme, e nganjëherë tejet modeste.

(B.I.:) *- Fondi, në vitet e mëpastajme, e deri vonë, është sulmuar, sidomos nga struktura jashtë Kosovës, por edhe nga lëdëkëistët, se ka qenë një fond i cili është ushqyer me para të ardhura nga droga, nga pistat e kriminalitetit, nga punë të pandershme, nga shitblerja e armëve, etj., etj.*

Si qëndron e vërteta, pasi, në strukturat e këtij fondi ju keni qenë një ndër drejtuesit e tij, i zgjedhur me votim të fshehtë edhe në Mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm, në qershor 1998?

(I.K.:) - Edhe të tilla sulme, me të tilla shpifje diskreditu-ese, ishin mjete të arsenalit të luftës speciale që na e bënte UDB-ja, duke shfrytëzuar argatët e saj shqipfolës të angazhuar kryesisht në LDK. Nuk do mend se disa ishin aktivë, në shërbim të UDB-së, kurse shumë të tjerë të mashtruar e të manipuluar. Këto sulme i koordinonte në terren një ekip që e manipulonte dhe manovronte krejt LDK-në, rrjedhimisht edhe shumicën e qytetarëve shqiptarë.

Me mendimin se nuk i cenojë më sekretet ushtarake, deri në mars të vitit 1998, mjetet financiare të grumbulluara në këtë Fond kanë qenë tejet modeste. E dekonspirova këtë të vërtetë për të ofruar si dëshmi se ndihmat nuk kanë pasur prejardhje të inkriminuar, por kanë qenë ndihma të patriotëve të devotshëm. Po sjell një informim konkret, që dëshmon pohimin tim:

Xhavit Haliti kujton një rast kur për herë të parë do të dërgojë një shumë prej disa mijëra markash në Kosovë, dhe se i ishte dukur sikur kishte dërguar gjithë pasurinë e botës. Nuk ka asnjë rast kur veprimtarë të Fondit apo të Lëvizjes, në këtë periudhë apo më pas, të jenë dënuar, burgosur ose dëbuar për aktivitet të këtij lloji. Fjalët rreth përlyerjes së Fondit dolën më vonë, pas përfundimit të Luftës, që u ngjasonin atyre "dëshmive" të Milosheviqit në Hagë, se UÇK-ja është financuar me para të drogës, në kohën kur ndonjë kontrabandistë droge dukej se ishte i angazhuar në LDK dhe "presidenti" Rugova me dëshirë pushonte në vilat e ndonjërit prej tyre në Zvicër.

Si mendojnë njerëzit se do të na lejonin, sidomos Gjermania e Zvicra, që shquhen për struktura të forta sigurie, që të ushtronim një veprimtari të tillë? Në Gjermani, ta zëmë, kishim themeluar Bashkësinë Demokratike të Shqiptarëve në Gjermani (si OJQ), e kishim legalizuar në gjykatën përkatëse (në Siegburg), dhe Fondin "Vendlindja Thërret" e kishim legalizuar si fond të Bashkësisë, madje patëm fituar edhe statusin e bamirësisë, për të pasur më tej lehtësime tatimore. Meqë kisha të deponuar nënshkrimin në bankën ku kishim hapur xhirollogarinë, kisha kërkuar ndihmën e Bundes- dhe Landes- Verfassungsschutz (shërbim i sigurimit të brendshëm shtetëror gjerman), për të kontrolluar prejardhjen e ndihmave që hynin në atë xhirollogari. Vetëm në katër raste kanë intervenuar dhe

pas sqarimit, na i kanë liruar edhe ato ndihma, të cilat kishin qenë krejt të pastra.

Meqë përmende shkarazi votimin tim në ekipin udhëheqës të Fondit, ndoshta nuk keqkuptohem nëse ofroj një sqarim. Në seancën e parë të asaj mbledhje të Këshillit të Përgjithshëm isha i pranishëm. Pasdite udhëtova për Hamburg. Atje, Lidhja e Studentëve të atij Universiteti kishte planifikuar mbajtjen e tubimit informues për Kosovën, në amfiteatrin qendror të Universitetit. Më kishin paralajmëruar si folës. Në mesin e folësve gjermanë ishte edhe një profesor i Akademisë Ushtarake të Gjermanisë. E luta Bardhylin (Mahmuti) të vinte me mua, si përforcim. Meqë, mendoja se ai ishte bërë pjesë e komplotit kundër Fondit, nuk pranoi të vinte, sepse ishte zotuar që do të angazhohej, të mos më votonin mua. Megjithatë, unë udhëtova dhe në mungesë me ka votuar KP-ja.

(B.I.:) *- Mendoj, je i gabuar. Kur do të bëhej zgjedhja e Fondit "Vendlindja thërret", është ngritur një Komision prej tre anëtarësh për përgatitjen e votimit. Drejtues i këtij Komisioni kam qenë unë dhe mendova kështu se, duke qenë kryetari i Organizatës në këtë rol, do të jetë gjithçka më e besueshme, por edhe për një fakt tjetër. Unë doja, me çdo kusht, që të rizgjidhej Jashar Salihu në drejtimin e Fondit. Anëtarë të Komisionit kanë qenë Xhavit Hoxha dhe Violeta Demiri dhe u kam thënë se, patjetër duhej të zgjidhej Jashari, kjo jo vetëm për vazhdimësi, jo vetëm se ai ishte Nënkryetar i Organizatës, ku edhe ti ishe anëtar i Kryesisë, por edhe për shkak të problemeve që ishin në atë kohë. Duke llogaritur mundësitë, i thashë Bardhylit se nuk duhej të lëvizte askund, se duhej të rrinte, të votonte dhe e dija se domosdo do të votonte për Jashar Salihun. Bardhyli në fillim u hamend, por*

pastaj, qëndroi. Ndoshta ka qëndruar edhe për ty, kjo është një mundësi, por unë dëshmoj për atë që kam biseduar me të dhe për këmbënguljen time që të mos largohej. Për fat Jashari mori votat më të shumta, por kishte vetëm një ose dy vota diferencë me Xhemail Fetahun. Por, më duhet të të them tani, pas kaq viteve, se edhe kur kam pasur ndërhyrje që të bëja rizgjedhjen e Kryesisë së Fondit, me qëllim që mos të ishte aty Ibrahim Kelmendi, nuk kam pranuar, sepse e kam quajtur të drejtë besimin e shokëve ndaj teje dhe e kam çmuar si të vyer punën tënde edhe në Fondin "Vendlindja thërret".

Por, le të vazhdojmë:

Me përcaktimin e fondit në Gjermani lidhet edhe emri i një njeriu të njohur, të cilin ju e keni pasur mik më shumë se të tjerët, Xhmail Fetahu. Në Mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm, që përmenda më sipër, ai u zgjodh Nënkryetar i fondit, ndërsa drejtues i tij u zgjodh Jashar Salihu, që ishte njëkohësisht edhe Nënkryetar i Organizatës. Si i mbani mend këta dy shokë që tashmë nuk janë mes nesh, njëri u vra në luftë - Xhemali, dhe tjetri - Jashari, vdiq pak pas lufte.

(I.K.:) - Me këta dy, personalitete të shquara, jo vetëm që ishim bashkëveprimtarë të të njëjtës Organizatë, por ishim më shumë, ishim shokë të idealit, shokë skajshmërisht të ngushtë. Do të thosha më vëllezër se sa vëllezërit akoma të pamartuar. Këta i qenë përkushtuar çlirimit të Kosovës me tërë qenien e tyre fizike dhe shpirtërore. Asnjëherë nuk kemi pasur ndonjë hidhërim e përplasje mes nesh, edhe pse natyra dhe dinamika e veprimtarisë ndonjëherë mund të shkaktonte hidhërime e përplasje të çastit.

Që të dyve u kemi borxh monografi përkatëse, por ja që mundësitë fizike dhe financiare më kanë penguar për t'u an-

gazhuar në përgatitjen e tyre.

(B.I.:) *- Në vitin 1993, por edhe më herët, në Gjermani do të krijohet në strukturë më e ndjeshme e Lëvizjes. Bëhen të njohur emra të rinj, të cilët kishin qenë të njohur më parë në Lëvizjen brenda vendit, si Sabri Kiçmari, Sami Lushtaku, Iliaz Kodra, Gani Paçarizi, Selim Krasniqi, Begzat Gashi, Islam Rafuna, por edhe të tjerë. Dukej sikur qendra e Lëvizjes, deri atëherë në Zvicër, po shpërngulej drejt Gjermanisë. Në fakt, ajo që ndodhi më pas, ku shumë nga anëtarët e Lëvizjes në Gjermani, normalisht, u bënë të njohur si drejtues të Luftës, tregonte se kishte lëvizur boshti i disa gjërave.*

Si ndodhi e gjithë kjo, si u bë e mundur shtrirja e një rrjeti kaq të gjerë dhe cilësor i Lëvizjes në Gjermani?

(I.K.:) - Ata nuk ishin gjermanë, që të thoshim se kanë si meritë dhuntitë e populli gjerman. Në Gjermani ishte emigracioni më i madh shqiptar. Ishin vlerat dhe meritat individuale të secilit, që duhet të ketë luajtur rol. Po ashtu mirëkuptimi gjatë veprimtarisë, sepse njeriu është qenie interesante, nganjëherë edhe gjërat, në dukje të vogla, kanë ndikim të madh tek ai. Ta zëmë, që të kesh energji për t'u angazhuar maksimalisht, janë të domosdoshme vullneti dhe shtytja e brendshme. Ato varën shumë edhe nga marrëdhëniet e përditshme ndërnjerëzore. Si të ta them, anëtarët e Nëndegës në Gjermani kishin marrëdhënie tepër të mira, tepër shoqërore, pa imponime, pa mburrje. Rol të madh duhet të ketë luajtur edhe kalitja dhe përvoja e emigracionit të vjetër, e kultivuar përmes veprimtarisë patriotike qysh nga viti 1977. Ai emigracion i mirëpriti, i përqafoi vëllazërisht veprimtarët që detyroheshin të vinin nga Kosova. E them këtë, sepse kishte mjedise ku emigracioni i vjetër nuk i mirëpriste refugjatët e rinj, i xhelozonte deri në armiqësim.

(B.I.:) - Në vitin 1994 drejtues i Lëvizjes në Gjermani do të jetë Fehmi Lladrovci. Është një figurë tepër e njohur, i cili, duhet thënë, të ka besuar deri në fund, e ndoshta, pas Ali Ahmetit, të ka besuar edhe ty po aq shumë sa edhe atij.

Si ndodhi lidhja juaj, pasi ju nuk ishit njohur më parë?

(I.K.:) - Nuk di ta them se përse ishim aq shokë të ngushtë. Mbase, qysh në takimet e para fizike na komunikuan ndjenja, idealet, gjaku dhe shpirtrat, të cilat më bëhej se i kishim krejtësisht të përputhshëm.

Unë e kam dashur pafundësisht Fehmi Lladrovcin. Ishte njeri me vlera të shumta, i vyer e fjalëpak, serioz për gjithçka që kishte lidhje me luftën dhe me Kosovën. Edhe ai më ka besuar e dashur, besoj deri në fund dhe kështu, shumë gjëra të tij i kemi ditur vetëm një grup shokësh.

Nganjëherë më dukej sikur i vëllai, Ramizi, po bëhej xheloz, sepse më krijohej përshtypja se Fehmiu ishte më i dashur dhe më i afërt me mua, se me të.

Uroj të mos me hidhërohet tani Ramizi për këtë përshtypje e cila padashur me qe krijuar atëherë.

(B.I.:) - Së bashku me Fehmiun e di se jeni takuar në Zvicër me një grup ushtarakësh. Kjo ndodh në të vërtetë më vonë, në vitin 1997, por, duke e lidhur me njohjen tuaj me Fehmiun, desha të cilësoj se ajo ishte më shumë se një lidhje mes dy njerëzve, kishte një synim të qartë. Në këtë takim merrte pjesë, bashku me ju, edhe Agim Çeku, ndërsa nga "pala" tjetër, nëse mund ta quaj palë, ishte Agim Mehmeti, etj. E di se në këtë takim, pala tjetër nuk pranoi të merrte pjesë njëri nga ushtarakët, që më vonë u vra në luftë.

Kush ishte ky ushtarak, si ndodhi i gjithë takimi?

(I.K.:) - Po. Bashkë me Fehmiun organizuam atë takim me ushtarakët e profesionit, që tashmë ishin në ekzil në shtetet e Evropës Perëndimore. Takimin e organizuam në lokalet e Klubit "Përparimi", në Cyrih, për çka na pat ndihmuar bashkëveprimtari i devotshëm Rexhep Halimi dhe ca shokë të tij që frekuentonin atë Klub.

Disa ditë më herët e kishim vizituar ushtarakun Fadil Demiri në Pragë. Pastaj takuam Xhafer Jasharin në afërsi të Këlnit. Në Gjermani ishte për vizitë i shquari dhe tashmë i famshmi në Kroaci për aftësi të luftës guerile, heroi Bekim Berisha. Ky i fundit qëndroi te Fehmiu disa javë. Kishim takuar edhe Agim Hazirin dhe të tjerë ushtarakë. Donim ta takonim edhe Agim Çekun, atëherë Komandant i Korpusit të 5-të dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë kroate. Me Agimin ishte marrë vesh Fehmiu për t'u takuar në Slloveni. Udhëtuam, por na ktheu mbrapa policia kufitare sllovene. Pastaj Fehmiu u mor vesh me Agimin (Çekun), që të takoheshim ne Zvicër. Vonesa e tij po zgjatej, sepse Shtabi kroat nuk po i jepte leje të dilte jashtë shtetit. Më në fund Agimi siguroi lejen, por po e shoqëronin dy kroatë, për shkaqe të sigurisë trupore dhe të sekreteve ushtarake.

Për ta pritur Agimin organizuam atë takim. Ushtarakët që kontrollonte "qeveria" e Bukoshit, nuk donin të vinin. Megjithatë, erdhën ca, meqë "shefi" i tyre, Agim Mehmeti, nuk po i kundërshtonte dot më "lutjet" tona.

Aty patëm debat, pothuajse politik, i cili, sikur nuk u shkonte ushtarakëve. Ca shtireshin si "institucionalistë" dhe nuk donin të angazhoheshin që të bënin luftën bashkë me "kaçakët" e UÇK-së, siç i quanin. Thoshin se do të angazhoheshin vetëm kur të jepte urdhër "komandanti suprem", e për komandant su-

prem disa injorantë e plangprishës e dinin "pacifistin" Rugova.

Në përmbyllje të tubimit Agim Çeku mbajti një fjalim profesional, konstruktiv, motivues, patriotik. Ai sqaroi shumë prej tyre dhe më dha leksion motivues edhe mua, që të vazhdoj me atë angazhim, në përkrahje të Fehmiut.

Kurse sa për ushtarakun që pyet, ka qenë Agim Ramadani. Ai erdhi për të marrë pjesë, së bashku me një ushtarak tjetër, Ramadan Gashin, që kishte qenë dikur në të njëjtin grup klandestin me Fehmiun. Agimi erdhi deri tek dera, donte të ishte pjesë e takimit, por Agim Mehmeti kundërshtoi dhe prandaj nuk ishte në takim.

(B.I.:) *- Në këtë periudhë, fillim i vitit 1994,së bashku me profesor Hasan Ukhaxhaj, me sa di unë, sipas propozimit tënd dhe miratimit të Fehmiut, unë do të pranohem si anëtar i kryesisë së LPK-së në Gjermani. Quheshim anëtarë të jashtëm, por merrnim pjesë rregullisht në mbledhjet e Kryesisë. Mbaj mend se, ndërkohë, kishin filluar takimet e para me bashkatdhetarët për të bërë më të qartë vijën dhe synimin e Lëvizjes. Si i kujton takimet e para, si zhvilloheshin ato? Kishit pengesa, provokim, moskuptime?*

(I.K.:) - Kemi bërë edhe shkelje statusore, siç thuhej, për hir të vlerave dhe rritjes së veprimtarisë.

Treshja juaj: Fehmiu, Hasani, Ti, "edhe frigoferëve po t'u flisnit, në furra pice do t'i shndërronit" - siç e kam dëgjuar të thoshte "Daja Cufë" (Jusuf Iberdemaj). Sqarimet dhe fjalët tuaja motivuese në ato tubime me masat, siç thoshim atëherë, kishte ndikim të madh. Paraprakisht njerëzit e UDB-së, të kamufluar si LDK-istë, provonin të na pengonin, por nuk ia dilnin, sepse tashmë emigracioni ishte ndërgjegjësuar dhe nga dita në ditë po pozicionohej pro luftës çlirimtare.

Sa i përket angazhimit të personaliteteve në Kryesi të Nëndegës, edhe tani mendoj, kemi vepruar mirë që ndonjëherë nuk kemi qenë aq statutarë strikt e të disiplinuar deri në sektarizëm për të respektuar vetëm hierarkinë organizative.

VII. Në nderim të "Zërit të Kosovës"

Lëvizja klandestine, e cila përreth dy dekada veproi në Kosovë dhe në Perëndim, e kishte të domosdoshme, jetike do të thosha, krijimin e një shtypi të saj që do t'ua bënte të njohur njerëzve qëllimet, rrugët dhe perspektivën e mendimit politik dhe të veprimit praktik. Është filluar me gazeta të ndryshme, të thjeshtëzuara, për vetë kushtet e mundësitë, si me "Bashkimin", "Lajmëtari i Lirisë", "Liria", etj., për të shkuar më tej me „Zërin e Kosovës", gazetë që u bë më kryesorja në jetën e Organizatës. Në vite të ndryshme aty kanë drejtuar Jusuf Gërvalla, Xhafer Durmishi, Xhafer Shatri, Mustafë Xhemajli, Avni Dehari në mos gaboj, Beqir Beqa, Bislim Elshani, Adnan Asllani, Lulëzim Etemaj, pa folur për një numër të madh bashkëpunëtorësh, të cilët ishin e domosdoshmja e gazetës. Nga të gjallët, përjashto xhaferët, të tjerët janë ende nga miqtë e mi më të mirë. Ua di përkushtimin dhe sakrificën, ashtu siç e di se rreth tyre, në vite të ndryshme, u mblodhën redaktorët e palodhur, të cilët, kur shkoja në redaksinë e gazetës, i shihja përherë të kërrusur mbi faqet e gazetës, të skuqur nga sytë prej lodhjes dhe pagjumësisë, njerëz gazmorë, mirëdashës, secili me veçantitë e tij.

***(B.I.:)** - Cili ka qenë mendimi juaj në vite për gazetën, ku herë pas here kemi qenë bashkëpunëtorë të saj, për drejtuesit e saj? Çfarë i dallonte ata nga njëri-tjetri, si bëhej mbështetja financiare e botimit të saj?*

(I.K.:) - Historiku i shtypit të Lëvizjes dhe organizatave pararendëse të Lëvizja ka dritëhijet e veta. Ka filluar me gazetën "Bashkimi" (si organ i Frontit të Kuq Popullor) në vitin 1977 dhe ka përfunduar me "Zërin e Kosovës", kur Kosova u çlirua nga pushtimi serb, në qershor 1999, që do të thotë një kohëzgjatje prej gati 22 viteve. Numrat e parë të "Bashkimit" kishin nivel amatorësh. Me angazhimin e Jusuf Gërvallës cilësia e tij pat rritje të madhe. Por, siç e kam thënë edhe herëve të tjera, gatishmëria e FKP-së për t'ia besuar Jusufit redaktimin dhe përgatitjen teknike të "Bashkimit", në njërën anë, si dhe gatishmëria e Jusufit për ta pranuar atë, në anën tjetër, duhet të ketë qenë një shembull ekzemplar në fushën e gazetarisë klandestine. Ndërkohë, nga mesi i vitit 1980 Jusuf Gërvalla nxjerr revistën "Lajmëtari i lirisë". Gjatë vitit 1981 botohet organi i OMLK-së "Liria", të cilin e redaktojnë Kadri Zeka dhe Jusuf Gërvalla. Në fund të vitit 1981 po Jusuf Gërvalla fillon të nxjerrë gazetën "Zëri i Kosovës" (si organ i LNÇKVSHJ-së). Pas themelimit të Lëvizjes për Republikën e Kosovës, "Zëri i Kosovës" vazhdon të botohet si organ i kësaj Organizate, sado që emri i saj që tjetërsuar, kur ndodhi akti komplotist pas vrasjes së dy themeluesve të saj - Jusuf Gërvallës dhe Kadri Zekës.

Deri në vitin 1984, kur për herë të parë na krijohen mundësitë që të formojmë redaksi, gazeta është varur nga përcaktimi individual i atyre që e përgatisnin. Ta zëmë "Bashkimi", tre numrat e parë, nëntor 1977, shtator dhe nëntor 1978, i kam redaktuar e përgatitur unë. "Zëri i Kosovës", dy numrat, tetor-dhjetor 1981, janë redaktuar e përgatitur nga Jusufi, kurse dy numrat pasues, mars dhe maj 1982, janë rezultat i angazhimit të Xhafer Durmishit. Në vazhdim përgatitja e gazetës i besohet Xhafer Shatrit, më saktësisht, ai e uzurpon gazetën. Në fund të vitit 1983 Xhafer Shatri boton një

“numër të jashtëzakonshëm”, të cilin e gjykoi si të tillë, pra të jashtëzakonshëm, edhe udhëheqja e Lëvizjes, gjegjësisht Komisioni që ajo pat formuar, enkas për të hetuar e vlerësuar atë veprim devijant të Xhafer Shatrit.

Kryeredaktorët e tjerë që keni përmendur, të cilët unë e di se i ke miq të afërt, asnjë nuk është shkarkuar për gabime ose dobësi, por secili, në kohë të ndryshme, ka dhënë dorëheqje nga se, do të thosha, lodheshin nga puna e vëllimshme dhe përgjegjësia. Që të sqarohemi, asnjëherë në Lëvizje askush nuk është paguar, qoftë me rrogë, qoftë me honorar, për angazhimet, ashtu siç nuk jeni paguar kurrë as ju, përjashto rastin e bashkëpunëtorit Shaban Sinanit, të cilit i është paguar ndonjë honorar modest, i herëpashershëm, nga 10 deri në 100 franga zvicerane.

Daljen e “Zërit të Kosovës” vazhdimisht e kanë shoqëruar vështirësitë financiare, sepse ZiK për shumë vite është shpërndarë falas. Shpenzimet mbuloheshin nga anëtarësia ose ndihmat e individëve vullnetmirë. Për ta botuar me kosto sa më të ulët, disa vite ZiK është shtypur në shtypshkronjën gjermane “Druckladen” në Bohum. Ajo shtypshkronjë ishte pronësi e disa miqve të mi gjermanë, prandaj në fundjavë ata na e linin në dispozicion, që një pjesë të punëve ta kryenim vetë. Ta zëmë, në dispozicion ata na linin kompjuterët, me të cilët bënim faqosjen, nga se ne nuk i kishim. Për ata që nuk mbajnë mend atë kohë, bëhet fjalë për kompjuterët fillestarë, të cilët kushtonin tepër shtrenjtë. Pastaj vetë bënim edhe palosjen, lidhjen, prerjen e gazetës (e cila në atë kohë botohej në format përfundimtar A4, ngjashëm me revista). Që të përballohej gjithë ajo punë në fundjavë angazhoheshin të rinjtë e Bohumit, si fëmijët e Selim Demirit (nga Morina e Gjakovës), Lani, Demiri, Bucja dhe Behari; fëmijët e Mark dhe Dedë Bardhit

(nga Peja), Noli, Zefi, Tina, Luana, Luigji; fëmijët e Mustafë Kelmendit (Llabjan i Pejës), Atdheu, Margarita, Adriani, Sadri Gashi me bashkëshorten, etj. Përmenda këta, nga se kjo mënyrë e punës ka vazhduar shumë vite dhe prandaj ata është dashur që fundjavat t'i sakrifikonin për përgatitje të ZiK-ut, por që e kompensonin me kënaqësinë se ishin bashkë dhe kështu po socializoheshin me një përkushtim patriotik.

Ndonjëherë më ka takuar të jem edhe anëtar i redaksisë, kam shkruar për gazetat tona, jam përkujdesur për përgatitjen, shtypjen e shpërndarjen, etj. Secili redaktor i saj, pas shkarkimit të Xhafer Shatrit, ka sjellë mënyrën e tij të redaktimit, por paraprakisht kryeartikujt diskutoheshin kolegjialisht në redaksi. Këtë fillesë, në fund të vitit 1984, e pat bërë Mustafë Xhemajli (Komogllavë / Biel, Zvicer), i cili qe kryeredaktori i parë që u zgjodh nga udhëheqja e Lëvizjes dhe ai e pat kompletuar redaksinë.

(B.I.:) *- Si organizohej shpërndarja e gazetës, kishte një rrjet të caktuar apo i lihej më shumë hapësirë rastësisë?*

(I.K.:) - Në vitet e para shpërndarjen e kanë bërë vetë veprimtarët, kurse një pjesë shpërndahej përmes postës. Në vitet e fundit qe nxjerrë në shitje në rrjetin tregtar, të specializuar për shitjen e gazetave dhe të revistave.

Që të mund ta fusnim fshehurazi nga Gjermania në Zvicër, Austri, Danimarkë dhe të kursenim udhëtimet me makina, ndihmonin të punësuarit në DSG (sipërmarrja e hekurudhave gjermane që mirëmbante vagonët restorante dhe të fjetjes) si Zymer Prekaj, Muhamet Elshani, Emin Bajraktari, Lan Kelmendi, Shemsi Groshi, Hajrullah, Avdullah e Agim Vuthi e shumë bashkëveprimtarë të tjerë.

Secilit këshill vendor në rrethe i jepej numër i caktuar dhe

ata e shpërndanin në rrethe të tyre. Një sasi shpërndahej edhe përmes postës, anekënd botës. Ndërsa Kryesia përkujdesej që të fuste disa ekzemplarë fshehurazi në Kosovë, sepse edhe në vitet e "pluralizmit", pas vitit 1991, ishte vetmja gazetë që përndiqej barbarisht nga policia serbe.

(B.I.:) *- A mund të përmenden disa nga bashkëpunëtorët e gazetës, të cilët ishin më të pranishëm në faqet e saj, në kohëra e vite të ndryshme, jo vetëm tek Zëri i Kosovës, por edhe tek organet e tjera paraardhëse të tij?*

(I.K.:) - Ata që kanë shkruar për shtypin tonë gjatë 21 viteve janë shumë. Deri në vitin 1991 shkrimet janë publikuar pa emra konkret të autorëve, ndonjëherë me pseudonime, sepse nuk duhej të dinin policitë e shteteve që na përndiqnin se cilët janë ata. Pas vitit 1991 shkrimet kishin emrat e autorëve. Po të përmendja emrat e disave që po më kujtohen, do hatëroheshin ata që nuk do të më kujtoheshin.

Karakteristik ishte fakti se shumë janë nga ata gazetarinë dhe publicistikën nuk e kishin profesion, por kishin guxim dhe vullnet për të shkruar për gazetën tonë. Shpesh redaktorëve dhe lektorëve u ka rastisur t'u dalë më shumë punë për t'i redaktuar e lekturuar shkrimet e korrespondentëve dhe të tjerëve, se sa t'i shkruanin vetë. Ta zëmë, rastin tim. Kur fillova të shkruaj më mundonte mosZotërimi i drejtshkrimit. Pastaj shkrimet m'i redaktoi Jusuf Gërvalla dhe redaktorët që e pasuan atë.

Edhe sot e kësaj dite njoh shumë gazetarë, publicistë e analistë në Kosovë, që nuk e zotërojnë drejtshkrimin, po nuk e thonë këtë. Kjo, do të thosha, është mangësi tipike në Kosovë.

(B.I.:) *- Në vitet 1997 dhe më pas, deri në përfundimin e luftës, gazeta do të ketë një lidhje të dyanshme me gazetën "Bota e re" që botohej në Prishtinë, si organ i Lëvizjes studen-*

tore. Kjo ishte meritë kryesisht e tre njerëzve: Muhamet Mavrajt, Adnan Asllanit dhe Lulëzim Etemajt, por edhe e Organizatës që e mbështeti këtë projekt dhe ndihmoi në realizimin e tij. Kjo bëri që mendimi politik i organizatës të jetë edhe më i pranishëm në Kosovë, por edhe mendimi i lëvizjes studentore të jetë i pranishëm te shqiptarët në Perëndim. Si ndikoi lëvizja studentore tek njerëzit? Ju a kishit lidhje me të në vite të ndryshme dhe me drejtues të ndryshëm?

(I.K.:) - Ai bashkëpunim pati ndikim në demaskimin më intensiv të rezistencës "pacifiste" në Kosovë dhe gjallërimin e përshpejtuar të rezistencës aktive. Sigurisht, atë projekt dhe mënyrë bashkëpunimi, në ato rrethana, e kam çmuar si gjetje të mirë. Uroj që edhe nga studiuesit përkatës të vlerësohet si një veprimtari me ndikim tejet cilësor.

Edhe unë e kam pasur nderin të bashkëpunoj me liderët e atëhershëm të Lëvizjes së studentëve, si Fisnik Cukajn, Dritan Lajçin, Ernest Lumën. Por, ato kanë qenë bashkëpunime për të afirmuar çështjen te ndërkombëtarët, kurse bashkëpunimet e sferave të tjera ndërmjet Lëvizjes së studentëve dhe LPK-së i kanë menaxhuar të tjerë bashkëveprimtarë të Lëvizjes, të koordinuar nga Kryesia dhe Redaksia e ZiK-ut. Ndër ta edhe personalitetet që ju përmendët. Ai bashkëpunim ka qenë i fshehtë, meqë shumë studentë njëkohësisht ishin edhe anëtarë të LPK-së.

(B.I..:) *- Desha të të tregoj diçka interesante. Kur më lajmëruan Adnan Asllani dhe Lulëzim Etemaj se pas pak kohësh "Zëri i Kosovës" do të fillonte të dilte edhe në Kosovë, përmes gazetës së studentëve, kam qenë jashtëzakonisht i gëzuar, sepse ishte diçka që mungonte atje. Ishte në të vërtetë një hap i guximshëm nga Muhamet Mavraj, njëri ndër*

liderët e Lëvizjes Studentore. Isha aq i gëzuar sa nuk mund ta përmbaja në vete dhe ia thashë Shaban Sinanit. Edhe ai u gëzua dhe në atë turr gëzimi i dërgon një telegram përshëndetjeje redaksisë sonë në Zvicër. Adnan Asllani më thirri menjëherë dhe më tregoi për telegramin. Kisha harruar t'i thosha Shabanit se ky ishte një sekret mes nesh dhe duhet mbajtur ashtu, deri sa të vinte një kohë tjetër.

*Por, si u bë e mundur të botohet **Zëri** në Kosovë dhe **Bota e re** në perëndim? - iu drejtova për t'u informuar kryeredaktorit të atëhershëm, Adnan Asllanit.*

* * *

***(Adnan Asllani:)** - Bashkëpunimi i atëhershëm me „Botën e Re" ka filluar krejt natyrshëm, duke qenë se kishim një respekt e simpati për organizatën studentore si dhe gazetën e tyre. Kemi filluar në krye të herës me këmbimin e materialeve, duke zgjedhur pjesë të ndryshme dhe natyrisht duke pasur një kujdes të veçantë se çka mund të botonin ata atje në Prishtinë, pasi rrethanat ishin të atilla që mund të rrezikonim redaksinë e „Botës së Re". Kur lufta e UÇK-së ishte zgjeruar edhe më shumë dhe kur rezistencës së ashtuquajtur paqësore po i delte boja, ishte më se e domosdoshme që të bënim hapin e duhur në momentin e duhur.*

Ne nuk kishim ndonjë mundësi të përcillnim gazetën tonë tek ushtarët e lexuesit tanë në Kosovë. E vetmja mundësi për të arritur gazeta jonë te lexuesi ishte të mbështilleshim me një emër tjetër. "Zëri i Kosovës" nuk do të mund të kishte jetëgjatësinë si "Zëri i Kosovës" sikur të dilte me emrin e tij të vërtetë në Kosovë, për shkak të rrethanave dhe kohës e cila tashmë nuk

premtonte për të pasur një qasje të re të kësaj natyre d.m.th. të botimit të plotë të "Zërit të Kosovës" me emër të tij.

Në anën tjetër ne kishim filluar tashmë të këmbenim materialet si fotografi nga fronti i luftës, raporte e shkrime të tjetra si dhe "Bota e Re" të merrte herë pas here disa nga shkrimet tona që mund të konsideroheshin se nuk e rrezikonin si gazetë.

Kështu u krijua krejt natyrshëm mundësia e një lidhje të re. Propozimit tonë për botimin e materialeve të njëjta pa asnjë hezitim ju përgjigj Muhamet Mavraj, kryeredaktor i atëhershëm i "Botës së Re."

Kështu ne nga dy gazeta të përafërta krijuam një gazetë me dy emra, do të thosha, njëra quhej "Bota e Re", e që botohej në Kosovë dhe tjera, "Zëri i Kosovës", që botohej në Perëndim. Për këtë gjë është njoftuar paraprakisht edhe kryesia e LPK-së e cila ofroi mbështetje edhe financiare për "Botën e Re", në mënyrë që nga e përmuajshme të shndërrohej në gazetë javore.

Sigurisht se zhvillimi i teknologjisë informative dhe internetit e bëri të mundur që ne të bënim një punë të tillë e cila dikur as që mund të mendohej. Ne kishim rastin të shihnim edhe mënyrën e faqosjes së gazetës dhe edhe ata të bënin të njëjtën gjë, të shihnin të faqosur gazetën tonë dhe të tyren para se ajo të botohej.

Për ne kjo kishte një rëndësi të veçantë, pasi përmes "Botës së Re" tashmë e kishim kthyer "Zërin e Kosovës" në Kosovë, një gazetë e cila dikur po t'i gjendej dikujt në dorë do të përfundonte patjetër në polici e burg.

Ajo çka ishte më e rëndësishmja se ne përmes kësaj forme po shpërndanim gazetën brenda UÇK-së, pa bërë ndonjë bujë të madhe e pa rrahur gjoks për këtë.

Shumë pak njerëz në Perëndim mund ta dinin se materialet që lexoheshin në "Zërin e Kosovës" ishin njëkohësisht të botuara edhe në Kosovë, në gazetën me emrin "Bota e Re" dhe anasjelltas.

Kur botimi i "Botës së Re" dhe i të gjitha gazetave në Prishtinë ishte i pamundur (pas bombardimeve të NATO-s) Redaksia e "Botës së Re". me kryeredaktorin Mavraj, Ernest Lumën, etj., u vendosën në Tiranë dhe nga atje ishin njëri nga burimet tona të informacioneve, analizave, etj.

Në një rrethanë tjetër "Zëri i Kosovës" ishte faqosur e redaktuar komplet në Tirane, pa pasur ndonjë mungesë në botimin e tij tashmë të përditshëm.

* * *

(B.I.:) *- Është fakt se nga Shqipëria, me dëshirën e tyre dhe kryesisht pa asnjë lloj pagese, janë angazhuar në gazetë edhe disa nga emrat e njohur të publicistikës shqiptare si: Xhevahir Spahiu, Dritëro Agolli, Moikom Zeqo, Sabri Godo, Koço Danaj, por ku spikat, në mënyrë të veçantë profesor Shaban Sinani. Lidhjet e tij me Organizatën janë shumë të hershme, dhe këto rrjedhin fillimisht nga funksioni i tij shtetëror që ka pasur si këshilltari kryesor politik i presidentit të Shqipërisë, Ramiz Alia.*

Si u vendosën lidhjet me Shaban Sinanin, cila ishte rruga që u ndoq, cila ka qenë përfshirja e autoriteteve të politikës shqiptare, por edhe të mendimit politik të Shqipërisë në gazetë e në jetën e organizatës, pas vitit 1991?

(I.K.:) - Sipas njohurive që kisha, mbaj mend, fillet e bash-

këpunimit me shumë intelektualë të Tiranës janë qysh nga viti 1991. Më konkretisht, qysh kur një delegacion i Lëvizjes është pritur nga Presidenti i asaj kohe, Ramiz Alia. Gjatë vitit 1991 dhe deri në korrik të vitit 1992, kam qëndruar edhe unë në Tiranë, si korrespondent i gazetës gjermane TAZ, njëherësh edhe si menaxher i Shtëpisë Botuese "Iliria". Në Tiranë, pothuajse gjatë gjithë kësaj kohe ka qëndruar edhe Xhavit Haliti. Duke qenë atje, angazhoheshim për të shpërndarë ZiK-un dhe për të përvetësuar personalitete intelektuale që të shkruanin për gazetën tonë. Bashkëveprimtari ynë shumëvjeçar Shaban Sinani ka kontribuar pothuajse mbi mundësitë e tij teknike dhe fizike, sepse lidhjet e atëhershme për komunikim dhe kushtet jetësore në Tiranë kanë qenë tmerrësisht të rënda. Dhe jo vetëm Shabani si individ, por edhe Bashkëshortja e tij, Alma, dhe dy vajzat e tyre, kanë sakrifikuar shumë gjatë përkrahjes së Lëvizjes dhe Luftës çlirimtare.

Uroj që në Kosovë të ketë nga ata që dinë të çmojnë kontributin e Shaban Sinanit, për t'i propozuar Presidencës së Kosovës që t'i japë titullin e qytetarit të nderit për kontributin që ka dhënë!

(B.I.:) *- Profesori im i dikurshëm i frëngjishtes, Kujtim Hyseni, i cili më pas do të jetë ambasadori i shtetit shqiptar në ish-Jugosllavi, kur u takuam pas shumë vitesh në Rambuje, së bashku me Pëllumb Xhufin, në atë kohë zëvendësministër i Punëve të jashtme, po kishim qenë bashkëstudentë, më tregonte se kur e kishin ngarkuar të mësonte më shumë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, kishte gjetur një vend në Tiranë ku shitej gazeta "Zëri i Kosovës". Ajo ishte informuesja kryesore dhe ajo e çoi tek Shaban Sinani, e më pas, edhe tek të tjerët. Kishte në atë kohë ndonjë gazetë tjetër, e cila kishte të njëjtin qëndrim përkrahës ndaj lëvizjes klandestine përgjithësisht dhe Ushtrisë Çlirimtare në veçanti?*

(I.K.:) - Ndonjë gazetë "legale" që botohej në Prishtinë dhe jashtë, por që kontrollohej nga udhëheqja e LDK-së, për të cilën kisha mendimin se ishte dorë e zgjatur e regjimit të Milosheviqit për të mbajtur me pak mjete e forca të pushtuar Kosovën, nuk më kujtohet të ketë pasur. Madje, jam i bindur se nuk ka pasur. Kur i kthehem sot arkivit të shkrimeve të kohës dhe shoh mendimet që kanë shprehur "analistët" e atyre viteve në Kosovë, ndihem i mjeruar, jo për vete, po për ata. Edhe njerëz që janë takuar atëherë me shefat e lartë të sigurimit shtetëror serb, dalin tani sikur kanë qenë përkrahës të flakët dhe sikur gazetën e tyre e kishin në dobi të luftës, kur ishte krejt e kundërta. Përkundrazi, ato qenë angazhuar, si kor i qyqeve, që të propagandonin kundër Lëvizjes dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Flamurtare e atij lloj shtypi ka qenë gazeta "Bota sot", pronar i së cilës ishte një ish-polic nga Peja. Unë dyshoja se ai nuk kishte idenë ç'është gazeta, por se, ishte gjetje e përshtatshme e UDB-së. E për kamuflazh, thuhej se mjetet financiare për të filluar botimin, ia kishte dhënë "mister" Hajdin Sejdia, gjithashtu i dyshuar prej meje si argat i UDB-së.

Ajo që të ka treguar Zotëri Kujtim Hyseni është një dëshmi fatkeqe, e cila vërteton se edhe kuadri i lartë diplomatik i Shtetit shqiptar ka qenë i painformuar për zhvillimet në Kosovë. Merre me mend, kur ish-ambasadori dhe klasa e intelektualëve akademikë në Shqipërinë londineze nuk ishte e informuar për zhvillimet në Kosovë, atëherë sa duhet të kenë qenë të (pa)informuar, qytetarët?!

(B.I.: / Shënim:) *Dua të të tregoj për një rast, i cili është krejt i afërt me fillimin e luftës. Është fundi i shkurtit 1998, kur së bashku me Fehmi Lladrovcin dhe Rexhë Ibërdemajn, u takuam me një nga përfaqësuesit më të lartë të shtetit shqiptar, njëri ndër ministrat më zëplotë të saj. U takuam në Mynih.*

Biseduam rreth 6 orë dhe vetëm në fund u morëm vesh për diçka e jo për çka donim. Cila ishte befasia ime më e madhe? Si të thashë, ishte fund shkurti dhe më 22 mars do të bëheshin "zgjedhjet parlamentare" në Kosovë. Krejt befas, ministri na tha se duhej të merrnim pjesë në zgjedhje dhe nëse fitonim, atëherë shteti shqiptar do të kishte lidhje me ne e jo vetëm me Rugovën. Kur i thashë se vetëm fakti se je anëtar i Lëvizjes shkon disa vite në burg, e kuptova se nuk ia kishte idenë e kësaj gjendjeje. Kur i thashë se nuk mund të bëheshin zgjedhje nën pushtim, nuk ishte i një mendjeje. Pra, ke të drejtë, por nuk ka qenë gjithnjë e për të gjithë ashtu. Apo do më japësh ndonjë shembull tjetër?

(I.K.:) - Mbase nuk mërziteni nëse ju rrëfej telegrafisht përvojën dhe përjetimet e mia në Tiranë, në janar të vitit 1991 e në muajt vijues. Sapo konstatova se as gazetarët nuk ishin të informuar për Kosovën, vendosa të organizoj një konferencë shtypi, siç kishim organizuar me dhjetëra në Perëndim. Pyeta Sekretarin e Lidhjes së gazetarëve (me vjen keq që emri i tij nuk po me kujtohet), sa e kishte qiranë salla e tyre për një konferencë shtypi? U përgjigj se nuk kishin praktikuar ndonjëherë të mbaheshin konferenca shtypi. E luta të ma rezervonte. Kundërshtoi duke u arsyetuar se frikësohej. Por tha, "prit t'i telefonoj filanit (ma tha emrin) në Komitet Qendror për ta pyetur." E kundërshtova. Erdhi Kryetari i Lidhjes, Marash Hajati. Pranoi. Shpërndamë njoftimin. Luta poeteshën Naime Beqiraj (nga Peja) dhe Milaim Zekën (nga Gllogovci) të vinin, që të mos isha vetëm. Erdhën shumë gazetarë. Plasi sherri mes tyre. Disa thoshin kemi informuar shumë për Kosovën, të tjerë thoshin jo. Për të mos e zgjatur, mjafton të them se njëri gazetar pyeti kolegun e tij: "I thuaj emrat e katër qyteteve në Kosovë dhe po të besojmë se kemi informuar shumë!" Plasi sherri. E mbylla

konferencën që mos të eskalonte në sherrnajë më të madhe.

Në fillim të shkurtit organizova dy tubime informative: njërin në Amfiteatrin e Institutit të Lartë të Arteve, tjetrin në Qytetin e Studentëve. Ishte një zhgënjim i tmerrshëm kur dëgjoja se çfarë pyetjesh bëheshin. Deri edhe në shkallën nëse Kosova ishte një qytet, një fshat, një mal, etj. Kisha dilema në ishte fjala për mosinteresim individual, meqë literaturë për Kosovën ishte botuar nëpër vite; ishte gjendja që i kishte bërë të harronin; apo vërtet Shteti kishte informim me pikatore!? Dilemat shtoheshin kur shihje librat e shkollave fillore dhe të mesme, që nuk përmbanin tematika nga e për Kosovën, kurse, ta zëmë, edhe për malet e Kinës kishte paraqitje të zgjeruara.

(B.I.:) *- Nganjëherë ti, Ibrahim kalon në ekstrem, duke sjellë përgjithësime nga ajo që ke përjetuar në momente të veçanta. Nuk është e vërtetë se njerëzit nuk kanë ditur për Kosovën. E vërtetë është se nuk është ditur sa duhet. Edhe sot nuk dihet sa duhet. Për shembull, edhe sot nuk dihet në Shqipëri për gjenocidin që është bërë ndaj shqiptarëve të Kosovës pas vitit 1945. Ka njerëz që mendojnë se Kosova ka qenë parajsë, se atje nuk ka pasur burgje, nuk ka pasur të vrarë; se atje policia serbe ka qenë e interesuar vetëm për të ndjekur marksistët, ndërsa për lëvizjen nacionaliste në Kosovë, nuk dihet thuajse asgjë. Në Kosovë, edhe një fëmijë i gjimnazit, e di se cilët qenë ministra të punëve të brendshme në Tiranë dhe krimet e tyre, dhe bëjnë mirë që e dinë, por, të njëjtët në Kosovë nuk dinë asgjë për Rankoviçin dhe klikën e tij shqipfolëse, e moshatarët e tyre në Shqipëri as që kanë dëgjuar. Kjo ndodh kur politika vendoset para kombëtares, siç ka ndodhur dikur në Shqipëri e si ndodh edhe sot. Unë di mjaft familje të mëdha, të cilat ishin të hasmëruara me pushtetin në Shqipëri, por ishin të gatshëm, që edhe nën komandën e këtij pushteti që nuk e donin, të vdisnin*

për Kosovën. Në Shqipëri, në vite, janë botuar autorët më të njohur shqiptarë të Kosovës, kanë ardhur artistë të njohur, që nga Pagarusha, ansamble artistikë, i fundit nga të cilit dha shfaqje në qytetin tim, në Shkodër, pikërisht në prillin e vitit 1981, ngjarjet e Kosovës ishin në vemendjen e të gjithëve, për të mos shkuar më tej, kur me një ligj të pashkruar, në median shqiptare tonë nuk flitej asnjë fjalë negative për Kosovën dhe njerëzit e saj. Sidoqoftë, unë të jap të drejtën për atë që ke përjetuar, sidomos në vitin 1991, kur në kohën e ndryshimeve të mëdha do të ishin të pranishme edhe traumat e mëdha. Desha të të pyes diçka tjetër:

Në vite të ndryshme, herë e organizuar e herë jo, ju jeni takuar me shtetarë të ndryshëm të shtetit shqiptar, të cilët ose ishin në qeverisje ose në opozitë. Më intereson të di qëndrimin e tyre, të dyanshëm, por edhe në dy kohë të ndryshme. Jam i sigurt se jeni takuar me profesor Servet Pëllumbin, Ilir Metën, Fatos Nanon, por edhe me njerëz të afërt me zotin Berisha. Desha të di mendimin Tënd lidhur me qëndrimin e tyre ndaj lëvizjes klandestine dhe Kosovës? Nuk më intereson të di se si kanë qeverisur ata apo se si kanë bërë opozitë, por vetëm në lidhje me këtë që po dialogojmë.

(I.K.:) - Për këtë tematikë shumë vite kam terrorizuar veten që të hesht, sepse asnjëherë nuk ndieja kënaqësi ta shfaqja gjithë zhgënjimin e hidhërimin tim lidhur me qëndrimin e klasës politike shqiptare të Tiranës ndaj Kosovës. Herë pas here nuk jam përmbajtur, sidomos ndaj "vëllezërve siamezë" Nano dhe Berisha, pa shfaqur zhgënjimin, hidhërimin dhe dyshimet ndaj tyre. Përgjithësisht, më kanë zhgënjyer pothuajse të gjithë.

E di, ju dhe shumë bashkëveprimtarë të tjerë, keni menduar se fillesa e një përkrahje ishte gjë e mirë, duke das-

hur të keni në të ardhmen porta më të hapura, të cilat edhe janë hapur herë pas here, ama unë, që idealizoja se kur një pjesë e kombit hyn në luftë, mobilizohet i gjithë kombi, vërtetë me ka dëshpëruar. Dëshpërim që vjen e ngulit deri në thellësi të shpirtit nga indiferenca, neutraliteti dhe, sidomos, kundërshtimi i klasës politike të Tiranës. Dëshpërimin ma zbuste paksa përkrahja më e angazhuar e Ilir Metës, Pandeli Majkos, Fatos Klosit, Servet Pëllumbit, Sabit Brokajt, Luan Ramës, etj., dhe shumë të tjerëve që nuk po i përmend tani, por edhe përkrahja e tyre më dukej e vakët. Solla me këtë rast disa emra vetëm të politikanëve "të majtë" dhe asnjë "të djathtë", sepse, fatkeqësisht, ashtu qe e vërteta. Po të dija për ndonjë "të djathtë", se e ka ndihmuar dhe përkrahur konkretisht luftën tonë, nuk do të përmbahesha pa ia përmendur emrin, madje me respekt e mburrje.

Mbase një ditë do të bëhet bilanci konkret se cili nga ata të klasës politike ka qoftë edhe një dëshmi, se ka dhënë ndihma nga xhepi i tij, siç praktikohet të thuhet, siç duhet të bëhet bilanci, nëse Shteti shqiptar ka dhuruar ndonjë armë (për ndihmë financiare as të mos flasim) që nga viti 1981 e derisa u çlirua Kosova. Ta zëmë, edhe Presidenti i Italisë Pertini ka një dëshmi individuale, për ndihmën që u ka dhënë shqiptarëve kur qenë ballafaquar me fatkeqësinë e rëndë të eksodit me çdo kusht e mënyrë nga Shqipëria. Ai pat strehuar në shtëpi të tij një familje shqiptare, për t'u dhënë shembull qytetarëve italian, që t'i strehonin dhjetëra mijë fatmjerë shqiptarë, meqë shteti italian nuk po ia dilte t'i strehonte njëherazi. Dini ju të ketë strehuar në shtëpinë e tij ndonjë familje nga Kosova, kur po ndodhte eksodi i madh, Presidenti i Shqipërisë, Kryeministri, ministrat, liderët e partive, e të tjerë me radhë?

Tjetër është bujaria e popullit që hapi shtëpitë e tyre, për të strehuar mbi një milionë refugjatë fatmjerë, edhe pse vetë jetonte në varfëri të skajshme. Ai ishte një akt madhështor që farkoi në praktikë vetëdijen e përkatësisë dhe përbashkësisë kombëtare.

Them, më mirë të mos bëhet kurrë ky bilanc konkret për politikanë e qeveritarë, sepse do të rezultojë një zero me turp, siç do të kishte thënë Nolit madhështor. As me këtë rast nuk mohoj ndonjë tolerancë konkrete (shpesh të paguara me deviza) dhe ca përkrahje që na kanë bërë disa personalitete politike, por unë nuk i kam çmuar të mjaftueshme atëherë dhe nuk i çmoj as tani...

(B.I: / Ndërhyrje:) *- Them përsëri se të pëlqen të jesh njeri i ekstremit. Nuk është e saktë se, unë vetë, qoftë si gazetar apo edhe si drejtues i LPK-së gjatë kohës së luftës, të jem kënaqur me atë që është bërë nga shteti shqiptar. Por, jo çdo gjë ka qenë e mjegullt. Takimet e para të UÇK-së me përfaqësues të lartë diplomatikë perëndimorë, si me ata amerikanë, mes tyre me zotin Hoollbruck, janë organizuar nga shteti shqiptar, nga Zotëri Nano. Mund të të them se angazhimi i Fatos Klosit ka qenë i jashtëzakonshëm. Ka pasur një marrëveshje me zotin Majko për logjistikën dhe stërvitjen e trupave të UÇK-së në Shqipëri. Unë e di se shumë gjëra janë bërë pas hapjes së portave nga diplomacia perëndimore, e di gjithashtu se ajo që është bërë është krejt e vakët, por, gjithçka shpërtheu marramendshëm shpejt. Nëse ke pritur vërtet se shteti shqiptar do të rrokte armët për të luftuar për bashkatdhetarët e tij në Kosovë, ke qenë i gabuar dhe këtë ta kam thënë që në vitin 1994, në shtëpinë tënde. Ndryshe ndodhi me shqiptarët e Kosovës, të cilët luftuan për sivëllezërit e tyre në Maqedoni. Nuk e di nëse*

kjo e fundit është vetëm rrjedhojë e shpirtit të tyre, apo edhe e Ali Ahmetit, që kishte shkrirë vite të tëra jete për Kosovën.

(I.K.: / Vazhdim i përgjigjes:) Të falënderoj për kundërshtimet dhe sqarimet e plotësimet.

Sa për rolin e Nanos që përmendet, jam më se i bindur se nuk kanë qenë nisma dhe merita të tija, por të diplomacisë amerikane. Tjetër gjë është fakti se ai, si kryeministër, ka orientuar amerikanët me informata se kush ishin njerëzit që e "përfaqësonin" UÇK-në.

Tjetër ishte angazhimi Fatos Klosit. E, meqë po i rikujtojmë meritat e tij, më duhet të bëjë një sqarim të natyrës teknike. Ndoshta rreth 20 marsit rastësisht shkova për ta vizituar kushërirën time të largët, Vera Sadik Bekteshin. Ajo iu gëzua vizitës sime befasuese, sepse nuk ishim takuar një kohë të gjatë. Pas bisedës prej rreth një ore me të, për gjendjen në Kosovë, për vështirësitë dhe për ndonjë angazhim të mundshëm të saj, ajo doli jashtë dhomës së ndejës dhe bëri një telefonatë. Kur u kthye më tha: "Nuk të prish punë, thirra të vij një shok të studimeve, sepse është tepër i merakosur për zhvillimet në Kosovë dhe mendova se ti do ta informosh më saktësisht." Nuk ma prezantoi cili ishte ai. Pas rreth gjysmë ore vjen Fatos Klosi. Nuk e njihja personalisht. Sapo ma zgjati dorën, m'u prezantua me emër, mbiemër e funksionin që ushtronte. Madje më tha se po më kërkonte nëpër qiell dhe më gjeti në tokë. Pastaj m'u ankua se Shërbimit po i mungonin informatat për UÇK-në dhe prandaj po ndihej i mëngët kur po takohej me kolegë të shërbimeve amerikane, angleze, etj. Unë u befasova për thjeshtësinë, sinqeritetin dhe brengosjen e tij. E njoftova se për të informuar Shtetin shqiptar, respektivisht Shërbimin e tij, Lëvizja kishte autorizuar njerëz të saj. Ai sqaroi se kishte provuar ta kontak-

tonte, meqë për atë autorizim dinte, por Xhaviti nuk kishte pranuar. Bile, në një rast Klosi ishte ndierë i ofenduar, kur e ka refuzuar duke i thënë se kishte lidhje me kryesorin (duke aluduar në Nanon). Tregoi se ishte takuar pastaj me Shaip Mujën, por nuk kishte marrë informata të vyeshme. Biseduam rreth dy orë. Ndërkohë i propozova të shkëputeshim ca që ta sillja Xhavitin aty. E mirëpriti propozimin premtues. Pa vonesë gjeta Xhavitin bashkë me anëtarë të tjerë të Kryesisë së Lëvizjes. I propozova të vinte me mua që të takohej me Klosin. Me fodullëk refuzoi, duke u krekosur se kishte lidhje më të fuqishme se sa me Fatos Klosin. Madje nxori edhe një të sharë goxha vulgare. Nuk hezitova t'i përgjigjem merituesshëm. U ktheva, i tregova Klosit çfarë më ndodhi. E udhëzova të takohej me Ilir Konushevcin dhe bashkëluftëtarët e tij, duke e bërë me dije se ata kanë informata më konkrete nga terreni dhe lidhje më të ngushta me UÇK-në në Kosovë, ndërsa Xhaviti i ka informatat nga ato që i mblidhte kryesisht në kafehanet e Tiranës.

Tani po vazhdoj ku e lashë më herët.

Ta zëmë, sa kohë kanë gënjyer ca kasnecë, meqë nuk kishin çfarë të gënjenin tjetër, se gjoja Sali Berisha paskësh ofruar kullën e tij në Viçidol të Tropojës për bazë logjistike të UÇK-së. E vërteta është se ajo kullë kishte qenë e prindërve të tij, por ata para shumë vitesh ia kishte shitur kushëririt dhe ai kushëriri, Sylejmani, patriot i devotshëm, ka bërë nderin, duke na e lënë tashmë kullën e tij. Nuk di nëse ndokujt në Tiranë e Prishtinë i ka ra ndërmend të nderojë Sylejman Berishën për kontributin e tij të devotshëm, duke rrezikuar edhe jetën, ose të vendosë qoftë edhe vetëm një pllakë përkujtuese në derën e asaj kulle!?

Për të mos e zgjatur me këtë tematikë fatkeqe, më beso, po

të mos kishte ndodhur rebelimi i vitit 1997, që do të thotë, po të kishte pushtet të fortë Berisha ose Nano, ne nuk do të mund ta shfrytëzonim fare shtetin shqiptar, qoftë për t'u furnizuar me armatim, qoftë për territor logjistik, qoftë edhe për t'u strehuar si të përndjekur. A nuk e dëshmon këtë përndjekja dhe arrestimi i Zahir Pajazitit, Luan Haradinajt, Hashim Thaçit, Adrian Krasniqi, etj., nga pushteti i Sali Berishës?!

Po nuk u pajtuat me këto vlerësime dëshpëruese, mund t'ju ofroj shembuj konkret sa të doni.

Tjetër është nëse ndalemi dhe bëjmë krahasime se cili krah ka ndihmuar më shumë, i "majti" apo i "djathti"!? Sigurisht që i "majti" ka kontribuar më shumë, meqë i "djathti" nuk ka ndihmuar fare. Pra, kur krahasojmë ndihmën modeste me hiçin, atëherë rezulton të jetë shumë e madhe. Ma thoni ju ose ndokush tjetër një politikan të "djathtë" që ka dhuruar armë a municion (e kishin sa të duash edhe në shtëpitë e tyre), ndërsa të "majtë" di unë, por nuk po ua përmend emrin, për të mos i "kompromentuar" tani.

Mos m'u hidhëroni, nëse sjell si shembull tipik një koleg tuajin, Hamit Alinë, poetin e afirmuar nga Tropoja, i cili ka bërë edhe shumë tekste për këngë patriotike. Pandehja se e kisha mik, nga se isha interesuar ta ndihmoja sadopak gjatë vitit 1991. Në fund të marsit 1998 e pyeta nëse njihte pronarët e ndonjë kulle të pabanuar në Tropojë, për ta shfrytëzuar si depo armësh, derisa të barteshin në Kosovë. Më tha se kishte kullën e tij. Më kërkoi që t'ia blija një banesë në Tiranë si kompensim, pastaj 500 euro qira në muaj. Nga zhgënjimi e injorova fare. U ngut të ma ofronte një kallash, për të cilin m'i kërkoi 300 dollarë. I thashë të mos guxonte të më kërkonte ndihmë ndonjëherë tjetër, madje as të më përshëndeste. E përmenda

konkretisht, jo për ta poshtëruar atë fatkeq, por për të treguar se ai nuk ishte rast, përjashtim, por njëri nga të shumtit që i kishin "prodhuar" zhvillimet në Shqipëri.

(B.I.: / Reagim:) *- Ndërsa unë desha të të tregoj për një rast krejt të ndryshëm, të cilin ti sapo e përmende në fillimin e këtij kapitulli. Unë dua të kthehem edhe një herë tek profesor Shaban Sinani, por dua të kujtoj edhe përkushtimin e Moikom Zeqos, qoftë me shkrimet e dërguara në gazetë, qoftë me botimin e Përmbledhjes së Veprave të Ukshin Hotit, ashtu siç do të mund të të thosha për Xhevahir Spahiun, Fatos Arapin, apo edhe për Ali Podrimen e Gjelosh Gjokën, të cilët kanë qenë të pranishëm fuqishëm në shtypin, si mund të quhet ilegal apo në përkushtimet e tjera. Mendoj se jo gjithnjë kemi ditur ku të trokasim, sepse nuk dua të besoj se, në atë vend të bekuar, nuk mund të ishin gjendur me dhjetëra e me dhjetëra intelektualë që e donin Kosovën si loçkën e zemrës. Nëse Shaban Sinani është më i përkushtuari i tyre, kjo nuk ka të bëjë me vendlindjen e tij, si dibran që është, por edhe me lidhjet që u krijuan, me atë ndjenjë të veçantë që ai ka ditur ta shprehë aq mrekullisht në shkrimet dhe librat e tij për Kosovën, në mirësinë e tij si njeri dhe si atdhetar. Ndoshta ti nuk e di, por unë kam qenë në dijeni se ka pasur raste kur atij i janë ofruar vende pune të privilegjuara, me kusht që të mos afishohej më si zëdhënësi i UÇK-së në Tiranë, e në fakt ai ishte ashtu, i pashpallur, por i vërtetë, dhe nuk ka pranuar. Pra, mik i dashur, i kemi të dyja rastet, të mirën dhe të hidhurën, ashtu si kudo në trevat tona.*

Por unë, më mirë se të gjitha ato që mund të them vetë, ia lë fjalën vetë profesorit, Shaban Sinanit, i cili, pa e ditur se do të botohej, më ka dërguar materialin e mëposhtëm, duke iu përgjigjur pyetjes sime për angazhimin e tij. I kërkoj ndjesë që po

e botoj të gjithin, ashtu siç më ka ardhur, duke besuar se edhe kësaj here, jam i mirëkuptuar nga ai.

Rrëfimi i Shaban Sinanit:

Fillesat e njohjes dhe të angazhimit tim kanë ndodhur kështu. Në fillim të vitit 1991 u kërkua takim me R. Alinë si kryetar i shtetit shqiptar nga një përfaqësuesi e lëvizjes klandestine shqiptare në mërgim. Dihej se ishin në kryesimin e LPRK-së, siç quhej atëherë. Paralelisht kishte kërkuar takim me të dhe një person tjetër, edhe ai i paraqitur si përfaqësues i organizatave të fshehta shqiptare (Mentor Kaçi), por për të qenë raportuar të dhëna jo të këndshme. R. Alia dha pëlqimin për pritjen e përfaqësisë së LPRK-së dhe u bë një takim pa të tjerë. Kanë qenë 3-4 veta, prej të cilëve mbaj mend të ndjerin Ahmet Haxhia dhe Xhavit Halitin. Ishin të veshur bukur, me pamje protokollare, sa nuk të shkonte në mendje se mund të ishin veprimtarë të fshehtë. Detyra ime ishte t'i prisja tek porta e jashtme dhe t'i shoqëroja në zyrën e Presidentit. Njohja ime e deriatëhershme për lëvizjen klandestine, përveç sa ishte shkruar për Jusuf Gërvallën, Kadriun e Bardhoshin, ishte shumë e kufizuar. "Zëri i Kosovës" vinte rregullisht në adresë të R. Alisë dhe sigurisht e lexoja, por dilte shumë rrallë, ndoshta një herë në muaj. Biseda zgjati shumë dhe në atë bisedë nuk është mbajtur verbal dhe as ka pasur regjistrime. Në mbarim të bisedës, pasi kreva dhe detyrën e përcjelljes, R. Alia më thirri brenda dhe më tha: "Këta qenkan shumë të zjarrtë! Janë të vendosur dhe s'të dëgjojnë po t'u thuash të jenë më të matur e më të menduar kur veprojnë. Më kanë kërkuar të kenë një njeri që t'u shkruajë për shtypin e tyre. Dhe u dhashë fjalën. E bën ti këtë punë?" E bëj sigurisht, por për çfarë t'u shkruaj! Po ja, kur dalin

njoftime për shtypin nga kjo zyrë, dërgojua dhe atyre. Jo të gjitha, por ato që kanë të bëjnë me çështjen kombëtare. Pastaj shih vetë çfarë mund të jetë e vlefshme për ta. Dhe kështu nisi bashkëpunimi im me "Zërin e Kosovës". R. Alia më dha një numër telefoni dhe një numër teleksi që mund t'i përdorja për lidhje. Në atë kohë telefaksi nuk kishte hyrë në funksionim (madje disa muaj më vonë gati-gati u quajt një mjet spiunazhi). Në katin e tretë të ndërtesës ku ushtronte detyrën Presidenti gjendej një zyrë e teleksit dhe aty nisa të dërgoj shkrimet e para, pa emër. Dhe ashtu dilnin, pa emër. Nuk e dija kush i priste ato shkrime, nuk dija as kush ishte kryeredaktor. Më vonë mësova se në atë kohë "Zërin e Kosovës" e drejtonte poeti Avni Dehari, të cilin e njoha kur do të botonte "Sagën fluturuese", por në atë kohë nuk ishte më në këtë detyrë. Deri kur e mbylli me dorëheqje detyrën e tij si kryetar shteti R. Alia më ka pyetur dy-tri herë: "More, u shkruan atyre të luftës apo jo?"

(Ndërkaq, për hir të së vërtetës, një "thyerje" e vogël kishte ndodhur ndërkaq, sepse Ibrahim Kelmendi kishte nxitur themelimin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, dhe kjo në atë kohë quhej njësoj si të krijoje një parti politike opozitare me atë që kryesonte Alia, ndërsa ndonjë prej familjes Gërvalla ishte rreshtuar në krahun e djathtë, por, megjithatë, "ata të luftës" ishin të rëndësishëm për të).

Në pranverë të vitit 1992 njoha për herë të parë një ilegal të LPK-së, që më kërkoi një takim me telefon. U takuam më këmbë dhe bëmë disa minuta bisedë në ecje në rrugën prej Bankës deri tek Gjykata. M'u paraqit me emrin Haxhi Baba dhe, megjithëse më ngjante si emër lufte, nuk e pyeta më tej. Më vonë i mësova emrin e vërtetë: Musa Demiri. Para se të ndaheshim, Haxhi Baba më tha se kishte një porosi nga qendra dhe nxori me lëvizje të

kujdesshme dhjetë franga e m'i dha. Po këto çfarë janë? e pyeta. Këto janë për shkrimet që i ke dërguar gazetës sonë. Po unë nuk njoh asnjë atje dhe nuk kam folur për honorar. Mos më ngatërro, tha Haxhi Baba, këto nuk janë honorar, janë franga. Do të të sjell dhe ndonjëherë tjetër. Kur të ketë. I mora dhjetë frangat dhe nuk dija ç'të bëja me to, nuk e dija a ishte një gjë e mirë a e keqe.

Kështu vazhdoi bashkëpunimi im me "Zërin e Kosovës", duke u bërë më i shpeshtë, siç shpeshtohej dhe dalja e gazetës. Kryeredaktori i parë me të cilin kam pasur një bisedë telefonike të drejtpërdrejtë nga Zvicra ka qenë Beqir Beqa. Beqiri nga vetë natyra ishte me një vetëpërmbajtje të rrallë, por në telefon ishte dhe më i kujdesshëm. Në fakt, kishte të drejtë. Në atë kohë qeveria ua hoqi telefonat e shtëpisë rreth 250 funksionarëve të mëparshëm dhe një ndër ta, në listë, isha dhe unë. Por, megjithëse nuk ia them shumë për dredhi, në këtë rast bëra një dredhi që më eci. Në zyrën e pajtimtarëve në postën e Tiranës ishte një punonjëse nga Lura dhe iu luta të ma ndërronte numrin e telefonit me ndonjë numër tjetër, mundësisht të ndonjë ndërmarrjeje që po mbyllej, si, bie fjala, ndërmarrja e grumbullimit, dhe kështu numri im i mëparshëm u zhduk nga lista. Në fakt, arsyeja më e rëndësishme e mbajtjes së telefonit ishte sepse tashmë një herë në javë duhej të komunikoja me redaksinë. Si rregull, për të mos shpenzuar unë, në mbrëmje më thërrisnin nga redaksia dhe unë përcillja shkrimet duke i lexuar dhe dikush i radhiste aty për aty. Gjithsesi, telefonin isha i detyruar ta mbaja hapur me jashtë, gjë që atëherë ishte shumë e rrezikshme, sepse ishte bërë një lloj "vjedhjeje popullore" përdorimi i telefonit të tjetrit, mjaft të mos ishte me kod për bisedime me jashtë: "njerëz të shkathët" bënin lidhje paralele dhe të tjerët flisnin lirisht me të afërmit e tyre në botë. Kjo ishte shumë e lehtë, sepse lidhjet telefonike ishin në sipërfaqe, le po të kishe ndonjë mik në shërbimin postar, që mund ta ktheje në

postë të vërtetë. Në fakt, dy muaj radhazi e pësova rëndë nga kjo, me dy fatura që i tejkalonin "frangat" (honorar) e katër vjetëve së bashku, por për këtë nuk i thashë njeriu dhe as sot nuk e di kush.

Në fillim kam shkruar me pseudonim, në fakt me disa pseudonime që i kisha përdorur dhe në shtypin e Tiranës dhe thuajse m'i njihnin të gjithë: Martin Nika, Gëzim Reçi. Redaksia më zgjodhi dhe një pseudonim të tretë: Ganimet Hasani. Nga viti 1993 kam nënshkruar vetëm me iniciale: Sh. S., kurse një vit më vonë kam nënshkruar me emër të plotë.

Njohja ime me njerëzit e "Zërit të Kosovës" dhe të LPK-së u bë më e afërt kur në vitin 1993 (në verë të atij viti) në banesën time u bë një mbledhje e një pjese të rëndësishme të veprimtarëve të saj. Kam përshtypjen se përsëri njeriu që më njoftoi se çfarë duhej të bëja ishte përsëri Musa Demiri. M'u tha se duhej të ftoja R. Alinë, D. Agollin, K. Islamin, L. Ramën, ndoshta dhe ndonjë tjetër. Po ashtu, njerëzit e familjes duhej të çoheshin tek të afërmit. Unë i njoftova të gjithë këta, por më parë erdhën veprimtarët e LPK-së: prof. Fazli Veliu, Abazi (Ali Ahmeti), Emrush Xhemajli, Zefi (Sabri Kiçmari), Atdhetar Labënishti, Ramadani (por jo Avdiu, një Ramadan tjetër, ndoshta Pllana) dhe disa të tjerë. Po shënjoj vetëm emrat e atyre që i mbaj mend me siguri. Nga vendësit R. Alia nuk mundi të vinte (ai ishte në mbikëqyrje të vijueshme dhe në shtator të atij viti do të arrestohej), por erdhi z. Sokol Haxhimusaj, dhëndër i tij; si dhe Guro Zeneli, edhe ai njësoj si unë një prej këshilltarëve të tij. Kastriot Islami erdhi, megjithëse ishte në zjarrin e luftës politike (në atë kohë ai ishte bërë shenjim i ashpërsisë, me shprehjen "do të thyejmë kafka"). D. Agolli telefonoi në mbrëmje vonë dhe nuk e di se çfarë biseduan. Luan Rama erdhi dhe iku shpejt.

Ishte shumë e vështirë të rregulloheshin aq shumë njerëz

në banesën time me dy divane e disa karrige. Në tavolinën që u shtrua kishte djathë, bukë, disa sallatëra, pak mish, raki dhe ndonjë gjë tjetër. Prof. Fazli Veliu kishte sjellë me vete një gjysmë qengji të therur atë ditë, por kush ta gatuante?! Gjithsesi, mbrëmja qe shumë e ngjeshur, megjithëse dritat ndërpriteshin herë pas here.

Për herë të parë pashë me sy ilegalët e luftës, njoha emra të vërtetë dhe u fol hapur për organizim luftarak, për krah të armatosur të LPK-së. Ishte e rëndësishme dhe e frikshme. Ishte gjithashtu jo dhe aq e besueshme. Gjithë biseda u përqendrua në pyetjen se "sa mund të llogaritim në mbështetjen e Shqipërisë" në rast se ne do ta nisim. Gjatë gjithë kohës që bëheshin bisedime Ali Ahmeti këndonte nën zë këngën "Po pyet bota për Shqipërinë / Sa të madhe e ka ushtrinë". Në fillim e mora si një punë qejfi, por pastaj nisa të mendoj se kjo mund të ishte një pyetje e shprehur me këngë. Dhe, duke menduar kështu, mendova të formuloj një përgjigje pa kontekst, si të thuash për kulturë. Shqipëria është njohur si një prej vendeve më të militarizuara, thashë. Kjo kënga thotë të vërtetën, sepse Shqipëria ka pasur një ushtri shumë të madhe për fuqinë dhe madhësinë e saj. Kjo do të thotë se ka pasur dhe armatim dhe rezerva armatimi të mjaftueshme për të bërë një luftë ballkanike. Në çdo paradë ushtarake që zhvillohej në Shqipëri shtypi i Perëndimit ishte i vëmendshëm të shënjonte se ç'armë të re kishte manifestuar ushtria. Ky shpjegim më duket se e kënaqi "Abaz Gjukën" (të paktën në atë kohë këtë pseudonim kishte Ali Ahmeti), dhe e bëmë "gëzuar" me raki.

Kjo vizitë ka qenë vendimtare për të shpeshtuar punën me "Zërin e Kosovës". Tanimë njihja shumicën e bashkëpunëtorëve të saj, që kishin ardhur në banesën time, që nga Xhavit Haliti, Avni Dehari, Bilall Sherifi, Bislim Elshani, Ramadan Avdiu, Faik Raca dhe shumë të tjerë, që i takonin të njëjtit rreshtim (si Agush

Buja, për shembull). Gjithashtu në shtëpinë time kishin hyrë e dalë shumë prej gjeneralëve të sotëm, po dhe dëshmorë të luftës. Një pjesë e tyre qëndronin në shtëpinë e Haxhi Babës në Golem, që u kthye në një farë spitali për të plagosurit, sidomos nga viti 1995 e më këndej. Vajzat e mia shkonin shpesh tek shtëpia e Haxhi Babës dhe kanë foto me ta.

Besoj në të njëjtin vit, më 1993, redaksia më dërgoi një kompjuter, i cili nuk kishte kujtesë të pavarur. Kishte vetëm një fole diskete, ku fillimisht futej disketa e programit, e cila mund të hapte një faqe për të shkruar. Pas mbarimit të punës, duhej hequr disketa e programit dhe duhej futur një disketë tjetër, sepse nuk kishte hapësirë tjetër regjistrimi. Më vonë redaksia më dërgoi një kompjuter tjetër, **Apple**, shumë të mirë, që ma bëri punën shumë të këndshme.

"Zëri i Kosovës" nisi të dalë me 16 faqe, pastaj dhe me më shumë, u bë e përjavshme, doli dy herë në javë, derisa u bë e përditshme intensive. Meqë thuajse në çdo numër më takonte të kisha tre-katër shkrime dhe shumë njoftime, redaksia provoi të instalonte një faks-modem, por pa sukses. Pastaj provuam të komunikonim me një adresë elektronike që redaksia më hapi në bluewin.ch (shsinani@bluewin.ch), por edhe kjo nuk funksionoi. Rishtypja e materialeve në redaksi ishte tejet e mundimshme. Për një kohë shkoja dhe i nisja shkrimet aty ku sot është Banka Islamike e Shqipërisë, ku gjendeshin zyrat e albaniaonline.com, kundrejt pagesës, që nuk ishte e vogël. Pajtimi në shtëpi ishte shumë i kushtueshëm dhe veç kësaj, shpejtësia nuk kalonte mbi 16 bit, gjë që e bënte të pamundur punën. Ndonjëherë shkrimet mund t'i nisja nga zyra e Luan Ramës, që punonte në "Zërin e popullit". Kjo punë u vështirësua sidomos kur hyri në detyrën time edhe marrja e shkrimeve të bashkëpunëtorëve: Naim Zoto, Dritëro Agolli, Xhevahir Spahiu, Sabri Godo, Pajtim Ribaj dhe shumë të tjerë.

Kam qenë tri herë i ftuar në Zvicër, ku jam njohur me shumicën e gazetarëve të "Zërit të Kosovës". Herën e parë kam qenë i ftuar në 15-vjetorin e ngjarjeve të vitit 1981, që u përkujtua me një konferencë shkencore dhe jubilare në Lozanë. Ishte një ngjarje shumë e bukur, me atë rast kam hyrë në shtëpitë e njerëzve të luftës, kemi folur pa pseudonime, kam njohur gjendjen e jetesës së tyre. Një tjetër herë kam qenë i ftuar nga klubi "Përparimi" bashkë me Dritëro Agollin, dhe me atë rast njoha dhe shumë veprimtarë të tjerë në pjesën Suisse-Allemagne. Një herë isha i ftuar bashkë me mikun tim dhe gazetarin e njohur Naim Zoto dhe në ato ditë që qëndruam në redaksi e punuam bashkë me miqtë tanë vendës, "Rilindja" e Zvicrës dhe ajo e Tiranës shkruan se kishim udhëtuar për të mbledhur fonde për fushatën e socialistëve. Ishte për të qeshur e për të vajtuar. Flitej për mbledhje fondesh, ndërsa gjendja e njerëzve që na prisnin ishte aq e kufizuar në të ardhura, plus shpenzimet që bënin për lëvizjen, saqë mëngjes e drekë i kalonim me byrekë e coca-cola në redaksi.

Kryeredaktorët e "Zërit të Kosovës" janë ndërruar shpesh. Punova me Lulzim Etemajn, prej të cilit dua të përmend një detaj. Nuk më kujtohet viti, ndoshta kjo ndodhi më 1998, kur një pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u gjend e sulmuar nga shumë anë, mundet dhe e tradhtuar, dhe dhjetëra djem të rinj erdhën e u vendosën në spitalin ushtarak të Tiranës, ku merrnin mjekimin e domosdoshëm. Redaksia më porositi që të shkoj të njihem me këta njerëz. Vajta disa herë dhe shkrova edhe një reportazh, që është botuar. Në mbrëmje L. Etemaj më telefonoi dhe më pyeti: "A thanë ndonjë gjë tjetër ata që takove?". M'u kujtua se për të krijuar mirëbesim me të lënduarit ndonjëherë duhej përmendur një emër i njohur si garanci, dhe e kisha bërë këtë me emrin e L. Etemajt, duke thënë se jemi miq. Një prej ushtarëve, kur përmenda emrin e tij, u bë shumë i vëmendshëm dhe më pyeti: "Vërtet

e ke shok?". Po, i thashë. Nëse ke ndonjë porosi për të, të siguroj se ia çoj menjëherë. Jo, s'kam ndonjë gjë, tha, "vetëm kisha dashtë me e pa me sy". Ia kujtova këtë bisedë Lulzimit dhe ai nuk e zgjati shumë, por të nesërmen në mbrëmje ishte tek unë dhe mbeta pa mend kur e pashë se ishte zbardhur tërësisht (ai kishte qenë në Tiranë vetëm disa muaj më parë dhe ndryshimi binte në sy menjëherë). I kishte takuar ushtarët, vetëm kaq folëm për këtë gjë, nuk pyeta dhe as më tha gjë se çfarë kishin folur.

Në fund njoha dhe Adnan Asllanin, që ishte një prej kryeredaktorëve më të qetë që kam njohur. Adnani pati ardhur disa herë tek unë dhe një natë ka fjetur në karrigen ku unë punoja, sepse nuk kishte asnjë vend, as në dysheme, ku mund të shtrihej. Ishin intensifikuar lidhjet e degës së LPK-së jashtë vendit me atë brenda vendit dhe ka ndodhur që kanë fjetur edhe në korridor. Fillimisht gjendej vend për më të moshuarit, pastaj vinte një çast kur thuhej lirisht: Ju të tjerët rregullohuni vetë ku të mundeni.

Një moment i jashtëzakonshëm ka qenë marsi i vitit 1998, kur ndodhi rrethimi i Jasharajve në Drenicë. Në atë kohë thuajse gjithë kryesia e LPK-së ishte vendosur në Tiranë. Paradite punonin në zyrat e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, që e kryesonte Xhevahir Spahiu, dhe ua kishte lënë me çelësa në dorë, dhe në mbrëmje mblidheshin tek unë, ku vazhdonin të diskutonin. Një mbrëmje I. Kelmendi më tha se do të vinin shumë njerëz dhe duhej të largohej krejt familja nga shtëpia, ndryshe nuk bëhej puna. Por ata erdhën shpejt, pa u larguar ende Alma, gruaja ime, me dy vajzat. Unë vetë nuk e dija a duhej të qëndroja në kuzhinë, ku ishin mbledhur njerëzit, apo jo. Thuajse nuk mbaj mend asgjë nga ajo mbrëmje, sepse edhe kur hyja brenda për të shërbyer ndonjë gjë modeste (pije freskuese, ujë, ndonjë gotë raki) përpiqesha të mos dëgjoja asgjë. Ka qenë një ditë kritike, një javë kritike, me

lajme e kundërlajme, sepse një herë pohohej vrasja e Jasharajve, një herë tjetër mohohej, ishte çështje morali luftarak.

Po atë vit, me udhëzim të Bedri Islamit, me të cilin kisha komunikuar shumë herë në telefon, duke pasur ndihmën e ministrit të mbrojtjes S. Brokaj, organizuam në Vlorë një miting solidariteti dhe mbështetjeje për UÇK-në. Përfaqësia e familjeve të të rënëve, duke përfshirë bacën Rifat Jashari me djem e nipër, Ramiz Lladrovcin, si dhe babanë e Luljeta Shalës (më duket quhej Jahir), qëndruan atë natë në banesën time dhe pikërisht atë natë për disa orë i mbeti bacës Rifat të flinte në karrigen time të punës, derisa guxova dhe e lëviza një prej më të rinjve për t'i ndërruar vendin.

Pas kthimit nga Vlora në Tiranë përfaqësinë e priti z. Ilir Meta, besoj zëvendëskryeministër. Dreka u shtrua në një restorant afër vilës 31, ku kishte jetuar E. Hoxha. Gjatë drekës u bë dhe një bisedë shumë e vështirë për t'u bërë në prani të 20 vetëve (i pranishmi më i patrazuar ishte vajza e vogël e I. Metës, të cilën e shoqja, Monika, e kish marrë në një si karrocë dhe tundte herë pas here për ta mbajtur në gjumë). Në atë drekë, në mënyrë krejt të papritur, R. Lladrovci tha me seriozitet: "Ne, zoti Meta, presim më shumë nga ju". Çfarë prisni?! i tha Meta. Armë presim, u përgjigj shkurt Lladrovci. Armë, tanke, armatime të rënda, lufta po rreptësohet. Dhe oficerë. Për habinë time, Ilir Meta, megjithëse me një prani kaq të madhe njerëzish, tha: Po, do t'i keni, vetëm të gjenden rrugët, të ruhet fshehtësia. Pastaj dreka vazhdoi e qetë. Unë kisha rastisur në bisedime për armë qysh në vitin 1991, kur përfaqësuesi i parë i qeverisë së Kosovës Prof. Ali Aliu i pati bërë disa propozime të ngjashme R. Alisë, por duke qenë vetëm dy a tre vetë bashkë, jo më shumë.

Vazhdova të punoj me "Zërin e Kosovës" edhe kur në Ti-

ranë erdhën M. Mavraj, D. Lajçi e disa të tjerë, deri në muajin shtator, kur pothuajse gjithë pjesa e kryesisë së LPK-së - dega jashtë vendit - u kthye për t'u bashkuar në Prizren në një mbledhje të përgjithshme, prej së cilës LPK-ja u kthye në organizatë politike që kërkonte pushtetin. Dy herë më pati ftuar kryetari i LPK-së, Bedri Islami për t'u bërë pjesë e mbledhjeve a ngjarjeve të brendshme: në kohën kur u mbajt konferenca e Rambujesë (dhe për këtë jam penduar që nuk ia dëgjova fjalën) dhe pikërisht në këtë udhëtim të fundmë në grup për në Prizren. Herën e dytë nuk kam pasur ndonjë dilemë, sepse mendoja që detyra ime tani mbaroi, si do të ndorohet Kosova është një çështje me perspektivë të qartë dhe një përgjegjësi e brendshme e banorëve të saj. Kjo ka qenë gjithashtu hera e fundme që veprimtarët e LPK-së nuk kanë pasur mundësi tjetër përveçse të zinin karriget e të flinin në to, sepse mundësitë e tjera pak më të mira ose të mira u ruheshin më të moshuarve. Them se nuk gaboj, në këtë rast ka qenë dhe Bedri Islami,i cili po punonte për Fjalën që do të mbante në Mbledhjen e Përgjithshme,e pastaj fjeti në karrige, Rifat Jashari,i cili erdhi me Bedriun dhe, së bashku me time shoqe punuam për të përgatitur Filmimin e ardhjes së djemve të Familjes Jashari nga TV Shqiptar,një ditë më pas, e po ashtu dhe Beqir Beqa.

Pas shtatorit të vitit 1999 bashkëpunimi me "Zërin e Kosovës" filloi të shuhet ngadalë, megjithëse herë pas here u kam dërguar shkrime Emrushit dhe Gafurr Elshanit. Ose më shpesh më kanë botuar shkrime që i kanë gjetur në formë të numërizuar. U jam mirënjohës që botojnë vazhdimisht gjithçka që gjejnë për librat e mi. Ruaj si kujtim nga redaksia e "Zërit të Kosovës" një kompjuter, si dhe një numër shkrimesh të fundme që kisha menduar t'i botoj nën titullin "Kosova në ksenokraci", dhe ky do të ishte vijim i "Kosova në gjeopolitikë" dhe "Kosova në syrin e ciklonit", ku gjenden shkrimet e mia më të mira botuar në atë gazetë.

Dua të pohoj se me redaksinë e "Zërit të Kosovës" asnjëherë nuk kam kërkuar dhe as biseduar për shpërblim. Por, megjithatë, kur gazeta nisi të dalë një herë në javë, jo rregullisht, por sipas mundësive, jam shpërblyer deri dhe me 100 franga ose marka në muaj. Kur gazeta u bë e përditshme herë pas here kam marrë honorar më të mirë. Por ka pasur vite kur gati gjysma e gazetës bëhej në Tiranë, prej meje dhe bashkëpunëtorëve të mi, punimet e të cilëve i redaktoja, i pajisja me tituj e nëntituj, shpesh dhe me foto (atëherë nuk ishte si tani, që prof. Google të përgjigjet menjëherë për gjithçka që kërkon).

VIII. Përgatitja e luftës dhe fillimet e saj

(B.I.:) ***-*** *Kryesia e Lëvizjes Popullore të Kosovës, me miratimin e Këshillit të Përgjithshëm, ndërtoi Sektorin e rëndësisë së veçantë të saj, i cili në të vërtetë ishte zanafilla e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Në këtë sektor do të bëjnë pjesë Xhavit Haliti, i cili ishte drejtues i tij, Ali Ahmeti, Jashar Salihu, më pas edhe Azem Syla. Përmes këtij sektori do të lëviznin gjërat për ndërtimin dhe funksionimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të ringriheshin lidhjet e vjetra dhe do të formoheshin lidhje të reja. Pak kohë më vonë, jo menjëherë, do të ngrihen edhe strukturat e Shtabit të Përgjithshëm në Kosovë. Si është e ditur tashmë, Sektori vepronte si njësi e pavarur edhe brenda kryesisë. Ai ruante lidhjet e tij, nuk jepte llogari për veprimtari konkrete, duke mbetur çdo gjë brenda një rrethi të ngushtë, sigurisht të besuar. Kjo bëhej që të mos zgjerohej rrethi i njerëzve që dinte më shumë se sa duhej dhe të mos kishte goditje të tjera në dëm të veprimtarisë çlirimtare. Kur mësuat ju për krijimin e këtij sektori?*

Si ishin lidhjet tuaja me këtë Sektor dhe me cilin nga anëtarët e Sektorit kishit ndërtuar lidhje më të qëndrueshme?

(I.K.::) - Për Sektorin e rëndësisë së veçantë nuk jam informuar, por në mbledhje të Këshillit të Përgjithshëm kam votuar që të formohet, diku në fund të vitit 1993, kur kemi formuar edhe Fondin "Vendlindja thërret". Me atë rast qe vetëkuptuar se po i formonim për të jetësuar vendimin që Lëvizja kishte marrë në Kosovë - formimin e forcave të armatosura çlirimta-

re. Këto dy institucione duhet vlerësuar si fillesat konkrete të ngritjes se formacionit të armatosur, të cilin Kryesia e Lëvizjes, Dega jashtë vendit, e emërtoi me 17 dhjetor 1994: **Ushtria Çlirimtare e Kosovës**. Po në atë mbledhje, për shkak të rëndësisë se tij, KP ia ka bartur përgjegjësitë Kryesisë që të emërojë anëtarët dhe përgjegjësin e atij Sektori. Sektori nuk ka qenë i pavarur. Ai, sipas një vendimi të posaçëm, jepte llogari para Kryesisë, por pa u ndalur në hollësitë, të cilat ishin ekskluzivitet i sektorit.Gjysmën e tij, do të thosha, e "pavarësuan" në ndërkohë Xhavit Haliti dhe Azem Syla.

Meqë tani nuk është kohë për propagandë, me dhëmbje shpirti shpreh bindjen se Shtab të Përgjithshëm, të mirëfilltë, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk ia kemi dalë të formojmë e të konsolidojmë që në fillim. Edhe më vonë ka qenë e vështirë, fjalën e kam për kuptimin klasik të një shtabi të përgjithshëm. Ndoshta mungesa e përvojës, koha që ishte shumë e vrullshme, por edhe nga dëshirat subjektive të ndryshme. Shtabi, më të shumtën, ka ekzistuar si emër dhe është shfrytëzuar e nganjëherë shpërdoruar, kryesisht nga 3-4 individë. Ndoshta tek nga muaji qershor 1998 ka marrë formë të përafërt me shtab që duhej të ishte në gjendje për të koordinuar e komanduar gjithë ushtrinë tonë, e për këtë merita fillestare u takon ushtarakëve të sprovuar që u futen në Kosovë, siç ishte Bislim Zyrapi, e jo vetëm ai.

E di se ju keni mendim tjetër, por po deshët, debatojmë. Që të dy jemi të informuar, nga se nuk kemi qenë vështrues periferikë, por pjesë aktive, nëse mund të shprehem kështu. E për të debatuar duhet të kapësh premisën bazë, se LPK-ja e ka themeluar UÇK-në. Ajo e ka organizuar politikisht, ajo e ka mbështetur, ajo e ka financuar, etj. Megjithatë, UÇK-ja,

pavarësisht të metave organizative, që kanë qenë pasojë e pamundësive, paaftësive, por edhe e komploteve, Ajo ia ka dalë ta bëjë luftën çlirimtare dhe në përmbyllje të luftës, të dalë fitimtare. Vullneti i madh i trimave patriotë, fakti se idetë e Lëvizjes u bënë të njënjëshme me aspiratën e popullit, shtabet e zonave, e kanë kompensuar mungesën e shtabit të mirëfilltë të pëtgjithshëm.

Sektori i rëndësisë së veçantë i ka raportuar dhe ka qenë i detyruar t'i raportojë Kryesisë, sepse edhe në këtë rast ka vlejtur rregulli i përgjithshëm, secila krijesë i raporton, për të mos thënë i jep llogari, "krijuesit" të saj. Kam pas dyshime se koordinatori i Sektorit, bashkëveprimtari shumëvjeçar Xhavit Halitaj, qysh nga viti 1996 ka anashkaluar bashkëpjesëtarët e Sektorit, Ali Ahmetin dhe Jashar Salihun, ka anashkaluar dhe Kryesinë, duke sajuar grup të tij të veçantë. Këto nuk po i them tani, për herë të parë, këto i kam ngritur në mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm, në Kryesi të tij, qysh gjatë vitit 1996 e deri në mbarim të luftës. Dhe jo vetëm që i kam ngritur, por edhe jemi përballur me to, për t'i menaxhuar. Besoj, prova për këto që po them, ekzistojnë në arkivin e LPK-së.

(B.I.:) *- Është e vërtetë se i ke ngritur edhe më parë këto probleme, bile më ashpër se sot. Në arkivin e Organizatës janë dy materiale nga ti, me shkrim, por edhe të incizuara, pikërisht për probleme të tilla. Mirëpo, po ashtu, është e vërtetë se jo të gjithë anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm apo të Kryesisë, të kanë mbështetur dhe kanë qenë në një mendje me ty. Ndoshta është me vend të përcaktoj se përgjithësisht vlerësimet kanë qenë pozitive për grupin që punonte në Sektorin e rëndësisë së veçantë, por edhe për Xhavit Halitin, kryesisht, e jo rrallë edhe për Azem Sylën. Nga ana tjetër, edhe ata, në*

diskutimet e tyre, kanë qenë krejtësisht kundër idesë tënde se është formuar "një katërshe", si e ke cilësuar, por edhe kundër punës që ti, herë pas here, bëje sipas mendimit tënd, duke kaluar strukturat përkatëse. Çdo ngjarje dhe çdo njeri duhet shikuar në kompleksin e tij, në kohën që ka jetuar, dhe në momentet që kanë qenë përcaktuese.

Si ishin lidhjet tua me shokët e Sektorit të rëndësisë së veçantë, pasi, megjithatë problemet që mund të ishin, në fund të fundit, ishit në të njëjtën strukturë.

(I.K.:) - Keni të drejtë kur thoni se shumica ishin kundër vlerësimeve të mia kritike. Sikur të mos ishte shumica, mendoj unë, mangësitë ndoshta do të riparoheshin me kohë. Dhe përse ndodhte kështu? Sepse Lëvizjen, Degën j.v., e kishte përfshirë sëmundja e konformizmit. Ishim shoqëruar aq shumë me vete, sa na vinte keq ta kritikonim njëri-tjetrin. Ta zëmë: Kryesia nuk miratonte kritikat e mia ndaj Sektorit të rëndësisë së veçantë, sepse në Kryesi ishin shokë tepër të ngushtë të Xhavitit. Pastaj duke i pranuar kritikat për Sektorin, vetë Kryesia do të bëhej bashkëfajtore, përse nuk e ka mbajtur me kohë nën kontroll. Por, ama, fakt ishte se koordinuesi i Sektorit, Xhavit Haliti, në bashkëveprim me Azem Sylën, qysh nga viti 1996 kishin anashkaluar Ali Ahmetin dhe Jashar Salihun. Ky Sektor nuk kishte lidhje me tri zonat e Ushtrisë dhe nuk u dërgonte ndihma financiare. Për kohën që po flasim, Ushtria (është fjala gjithnjë për UÇK-në) ishte e organizuar, e shtrirë dhe aktive në të tri këto zona. Ku ishin strukturat e tjera të Ushtrisë? Ushtri nuk mund të quhen dy persona, që sorollateshin nëpër Prishtinë dhe bënin sikur ishin komandantët kryesorë - Nait Hasani, i kooptuar nga Xhavit Haliti dhe Xheladin Gashi, i kooptuar nga Azem Syla. Pra, fillet e Ushtrisë ishin njësitet

në Zonë të Llapit, të komanduara nga Zahir Pajaziti, pastaj nga Ilir Konushevci dhe Rrustem Mustafa; njësitet në Drenicë, që komandoheshin nga Adem Jashari, Rexhep Selimi dhe të tjerë; njësitet në Dukagjin, që komandoheshin nga Adrian e Mujë Krasniqi, Luan Haredinaj. Të gjithë këto kanë qenë antarë të Lëvizjes, kjo është e vërteta. Thuajse asnjërin nga këta komandantë dhe këto njësi nuk i donin Xhaviti dhe Azemi, sepse ata nuk pranonin që të komandoheshin nga Zvicra. Mu për këtë qëllim, Xhaviti dhe Azemi nuk u dërgonin armë e financa atyre dhe e quanin të dënueshme po që se u dërgonin të tjerët.

Tjetra, pastaj. Kur shpërtheu kryengritja e armatosur, ku ishte Shtabi i Përgjithshëm, Azem Syla që bartte çizme e "hekura" në Tiranë; Xhaviti që vegjetonteve nëpër kafehane të Tiranës? Përse atëherë konflikti në mes të Xhavit Halitit e Azem Sylës kundër Kryesisë në mars-prill 1998? Për të mos e zgjatur, Shtabi zuri të formohej tek në qershor 1998, kur Drejtor i Drejtorisë operative u caktua Bislim Zyrapi. Vetëm atëherë u vendos që në Shtab të Përgjithshëm të merrnin pjesë të gjithë komandantët e zonave, bashkë me Xhavitin dhe Azemin, që sorollateshin vetëm në Tiranë, me Hashim Thaqin dhe Kadri Veselin, si "ndërlidhës", përkatësisht si drejtorë në drejtoritë politike dhe të shërbimit informativ dhe Jakup Krasniqit si Zëdhënës.

Unë e kuptoj se për të gjithë diletantët, që nuk kishin idenë se ç'është ushtria dhe çfarë është shtabi i përgjithshëm, sigurisht që ekzistonte shtabi i përgjithshëm, ama atij vetëm era shtab i mirëfilltë nuk i vinte. Me këtë nuk dua të them se të gjithë ata që i quanin improvizimet *shtab i përgjithshëm*, nuk donin të kishim Shtab të Përgjithshëm, por ama duhet të pranojmë se nuk kishim mundur ta formonim e konsolidonim para se të shpërthente kryengritja dhe kur ajo na gjeti pa të,

vetëkuptohet se ishte e vështirë që të formohej. Po i akuzoja si komplotistë sidomos Xhavitin e Azemin, jo për tjetër, por se kishin një koncept të tyre për ushtrinë, që ta mbanin të vogël në numër. Ajo të bënte aksione gjithashtu të vockla, e kështu me radhë, por, gjithsesi, të ishte e komanduar vetëm prej tyre. Me kaq ndiheshin të vetëmjaftueshëm, të kënaqur.

Jo vetëm gjatë viteve 1996 -1998 "gjysma" e Sektorit të rëndësisë së veçantë (Xhaviti dhe Azemi), nuk i kishin ndihmuar zonat, por edhe pastaj, derisa mbaroi lufta, ata përpiqeshin të bllokonin armatimin e të gjitha zonave. "Gjysma" tjetër, ndërkaq (Aliu dhe Jashari) ishin dhe angazhoheshin për të armatosur e ndihmuar me financa të gjitha zonat. Këto janë fakte që kanë ndodhur në terren dhe ushtrisë sonë nuk ia ulim vlerat nëse i themi të vërtetat. Përkundrazi, vlerat do t'ia ulnim po të pranonim të dezinformonim, se UÇK-në e ka komanduar Azem Syla dhe Xhavit Haliti.

Për të përforcuar vlerësimet tuaja, pos faktit se shumica në Këshill të Përgjithshëm ishin kundër kritikave të mia, sjell edhe Ilir Konushevcin si dëshmitar për mos ekzistim të shtabit të përgjithshëm. Vërtet atë e kishte "deleguar" Zona e Llapit për në Shtab të Përgjithshëm. Por, Iliri, për të gjallë të tij, nuk ka marrë pjesë në ndonjë mbledhje të shtabit, pos që i bënin lajka herë Xhaviti e herë Azemi se ai ekzistonte dhe se Iliri ishte anëtar i tij. Ai ishte udhëheqës i Sektorit logjistik, sepse bashkë me bashkëluftëtarë e kishte ngritur atë dhe prandaj e kishte merituar të ishte. Tjetër strukturë logjistike Ushtria nuk kishte. Por, a kishte Sektori logjistik buxhet të vetin? Nuk kishte. Iliri herë pas here u përshpirtej Xhavitit dhe Azemit për financa dhe ata i jepnin ca mjete modeste, sa për t'i treguar se nuk ishin të barabartë, sa për t'i treguar se ata që kishin kuletën, prandaj edhe komandonin.

Duke parë gjendjen në terren, nga mesi i prillit 1998 vendosa të kthehem në Gjermani, të konsolidoj logjistikën e Fondit dhe të përkujdesem që të gjitha mjetet financiare t'u shkojnë vetëm zonave, qoftë si armë, qoftë si të holla, dhe, mundësisht, asnjë të mos u bjerë në dorë Xhavitit e Azemit. Fatmirësisht kështu ka ndodhur. Prandaj janë përpjekur që të më komplotojnë, që edhe këto mjete t'i shtinin në kthetrat e tyre, por nuk ia dolën dhe për këtë isha krenar dhe u bëra krenar edhe më shumë pas lufte, kur mësova shumë të vërteta të hidhura të asaj kohe.

(B.I.: / Ndërhyrje:) *- Ti, Ibrahim, flet sikur fondi në Gjermani ka qenë pronë e ytja dhe se vetëm ti kishe të drejtën e komandimit të tij.Në të vërtetë nuk ka qenë kështu, pasi fondi, edhe në Gjermani,ka patur grupin e tij drejtues e kontrollues, ishte i lidhur me pjestarë të shtabit dhe, po ashtu, edhe me kryesinë e fondit, që ndodhej në Zvicër.Nga ana tjetër, unë e di fare mirë se, në kohë të ndryshme, pikërisht nga fondi që flet Ti, u janë dërguar shuma të ndjeshme financiare pjesëve të lidhura me këtë anë të shtabit, i cili, vazhdoj të mbroj mendimin tim, ka ekzistuar, dhe për kohën, ashtu si rrodhën ngjarjet, ka bërë pjesë të rëndësishme të punës së tij. Nganjëherë, përplasjet që keni pasur në vite,kanë qenë të ashpra, por edhe afrimet e bashkëpunimet kanë qenë të vyera.Këtë nuk e them për të zbutur qëndrimet mes jush, sepse nuk u kam trajtuar kurrë si dy palë të kundërta, por të ndryshme, por për të saktësuar ngjarjet që kanë ndodhur atëherë. Ne, të dy, kemi qenë të pranishëm në Mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm, dhe kundërvëniet ndaj disa pikëpamjeve apo qëndrimeve Tuaja, nuk kanë ardhur nga sektarizmi, sepse nuk ishin të gjithë sektarë, dhe si ke thënë disa herë, në organizatë ka qenë tejet i pranishëm mendimi ndryshe, por edhe nga parimet që herë pas here janë shkelur. Ti e ke parë të keqen, në se mund të them kështu, tek*

dy apo tek katër njerëz, të cilët, duke qenë në pozita drejtuese, kanë bërë aq sa kanë mundur,ndërsa unë e shoh tek devijimi që ka ndodhur, tek shprishja që mund të mos ishte. Ashtu edhe mbështetja që ka ndodhur me pikëpamje të tjera Tuaja, nuk ka ardhur nga familjariteti apo se ishit të njohur të vjetër, por sepse janë gjetur të drejta e të sakta.

(I.K.:) Më lejo të përfundoj mendimin tim.Tani po i rikthehem pyetjes suaj.

Lidhjet e mia me Sektorin e rëndësisë së veçantë ishin aktive. Sa herë që pjesëtarët e Sektorit më ngarkonin me angazhime, i kryeja. Më konkrete kanë qenë lidhjet me Ali Ahmetin dhe Jashar Salihun. Qysh në vitin 1996 Aliu na kishte angazhuar Fehmi Lladrovcin dhe mua të merreshim me ushtarakët profesionistë shqiptarë, të cilët kishin mbaruar akademi ushtarake dhe kishin bërë karrierë në Ushtrinë e Jugosllavisë (APJ). Për të qenë më të sigurt, ata na kishin udhëzuar që të orientoheshim për të afruar ushtarakët e sprovuar në luftërat e Sllovenisë, Kroacisë dhe të Bosnjës. Bazuar në këtë udhëzim, Fehmiu dhe unë jemi angazhuar që të përafrojmë ushtarakë që nga viti 1996 e këtej dhe për këtë kemi folur më herët. Ai angazhim që shpaguar, sepse angazhimi i tyre në UÇK i dha asaj formën dhe përmbajtjen e Ushtrisë.

Me Jashar Salihun, Drejtues kryesor i Fondit "Vendlindja thërret" nga viti 1996 e tutje, kemi pasur bashkëpunim të ngushtë, fal edhe shoqërimit tepër të afërt dhe respektit të ndërsjellë mes nesh, me bazë që në kohën e angazhimit të Jusuf Gërvallës. Bashkëpunimi me Jasharin ka funksionuar ndonjëherë duke anashkaluar edhe përcaktimet e koordinatorit të Sektorit, Xhavitit, por edhe të Kryesisë. Po të sjell shembuj. Ndonjëherë Nëndega e LPK-së në Gjermani, qysh

nga viti 1996, dërgonte ndihma financiare në Drenicë, Llap e Dukagjin, duke anashkaluar organizimin dhe kompetencat e centralizuara organizative. Këto i miratonte Jashari, edhe pse pastaj me kritikonte koordinatori i Sektorit dhe Kryesia. Natyrisht, për t'u mbrojtur nga kritikat e tyre, nuk dekonspiroja se kisha miratimin e Jasharit, të Aliut e të ndonjërit që ishte në pozita udhëheqëse, sepse nuk doja t'u shkaktoja atyre vështirësi më të mëdha.

Gjatë këtij angazhimi kemi pasur përplasje, por i kemi tejkaluar ato, duke gjetur zgjidhjet më të mira, vetëkuptohet, të mundshme në kohë e hapësirë, të cilat kanë rezultuar me sukses.

Ta zëmë, qysh më 1996 kanë filluar t'i vinin kërkesa për ndihma financiare Nëndegës së LPK-së në Gjermani nga bërthamat e Ushtrisë në Drenicë, Llap e Dukagjin. Nga Drenica, kërkesat na vinin përmes Fehmi e Ramiz Lladrovcit; nga Llapi, përmes Sabri Kiçmarit e Ali Ramës; nga Dukagjini, përmes Xhemajl Fetahut e Sali Kelmendit. Dhe ne u kishim premtuar atyre se do t'i ndihmonim, siç edhe vepruam. Kisha besimin se Kryesia dhe Sektori i rëndësisë së veçantë po anashkalonte ndihmesën e atyre zonave, për shkak të shkëputjes së lidhjeve që ndodhnin nga goditjet e herëpashershme nga forcat e specializuara pushtuese serbe. Më vonë më rezultoi se ishin bërë anashkalime nga Sektori i rëndësisë së veçantë, nga se kishin zënë të ndihmonin vetëm të dëgjueshmit e tyre në Kosovë dhe ata, të dëgjueshëm, nuk ua përcillnin ndihmat financiare zonave. Pata formuar bindjen, se përmes mjeteve, Xhavit Haliti dhe Azem Syla donin të shtinin nën kontrollin e komandimit individual të tyre çdo gjë që kishte lidhje me luftën, pa pasur koncept, dije e përvojë, se si ndërtohet dhe komandohet një ushtri.

(B.I.:) - *Sidoqoftë nuk duhet harruar se Lëvizja, si krijuese*

dhe drejtuese e UÇK-së, njeriun e saj kryesor në strukturat e luftës kishte deleguar pikërisht Xhavit Halitin, meqenëse pikërisht ai ishte emëruar si drejtues i Sektorit të Rëndësisë së veçantë, apo më shkoqur, si drejtuesin e sektorit ushtarak, që ishte edhe pjesë e Shtabit të Përgjithshëm. Parë në parim, edhe kërkesa e tij, që gjërat të kalonin përmes sektorit, është e arsyeshme, pasi mund të mendohet se, duke qenë ata të zotët e punës, e dinë më mirë se ku i pikon çatia dhe se çfarë duhet bërë. Pastaj ne flasim për fillimet e luftës, fillimet e lëvizjes së armatosur klandestine.

Që ndërtimi i UÇK-së po bëhej në klandestinitet të plotë tregon edhe një diskutim yti në Këshillin e Përgjithshëm, më 23 maj 1998. Aty ti ke thënë se e kishit kuptuar se vëllai yt, Qerimi, i njohur si Dema ose Shpirtmadhi, ishte ushtar i Ushtrisë, vetëm pasi ishte plagosur dhe në shtëpinë tuaj në Kosovë kishin filluar arrestimet dhe keqtrajtimet e njerëzve tuaj të afërt. Por, ju e dinit se Qerimi dhe Sali Kelmendi kishin kohë që blinin armë. Si mësuat për pjesëmarrjen e tij në ushtri? Më intereson përgjigja e saktë, për të dalë më pas në një pyetje tjetër?

(I.K.:) - Të lutëm, me mirëkupto, edhe unë kam votuar që Kryesia të formoi Sektor të rëndësisë së veçantë, por ama votën nuk ia kisha dhënë *blanko* dhe të përjetshme. Nga viti 1996 e kam kuptuar se Xhaviti, i caktuar si koordinues, nuk po e ushtron atë përgjegjësi si duhet, prandaj kam filluar ta kritikoj dhe t'i kundërvihem. Sidomos nga mbledhja e Kryesisë, në mars të vitit 1997, kur u thirra të jap llogari pse po u dërgonim ndihma zonave në Kosovë. Kurse Kryesia e kuptoi tek në prill të vitit 1998, por atëherë ishte bërë vonë.

Për fillesat e angazhimit të Qerimit dhe të Salihut, me bash-

këveprimtarë të tyre, qysh në vitin 1991, kam shpjeguar më herët. Këtë e dija, sepse ata më detyronin t'u jepja ndihma financiare, nga ato që ishin të Shtëpisë Botuese "Iliria", menaxher i së cilës isha zgjedhur nga investitorët.

Kurse më konkretisht, gjatë vitit 1996, për bërthamat e ushtrisë në Drenicë jam informuar nga Fehmi e Ramiz Lladrovci, Ilaz Kodra e Sami Lushtaku; për Llap, nga Ali Rama (i caktuar si korrier nga Zona e Llapit) e Sabri Kiçmari; për Dukagjin, nga Xhemajl Fetahu e Sali Kelmendi. Ndërsa nga mesi i dhjetorit 1996 kam shkuar vetë në Tiranë, bashkë me vëllanë, Dautin, që punonte në Zvicër, për të vizituar Qerimin e plagosur dhe për të ndihmuar shërimin e tij. Atje kam takuar Adrian Krasniqin, madje në banesë të tij, afër Urës në Rrugën e Elbasanit, ku edhe kemi pritur Vitin e Ri 1997. Po gjatë asaj vizite kam takuar Zahir Pajazitin dhe të tjerë bashkëluftëtarë të tyre. Me atë rast jam bindur se Ushtria po rritej e konsolidohej, sepse pata fatin të njihesha me personalitete të devotshme të saj.

(I.K.:) *- Emrat e Ilir Konushevcit dhe Ardian Krasniqit janë ndër më të njohurit sot. Jo thjeshtë sepse u vranë në aksione të ndryshme apo se ishin miq të afërt. Mendoj se ata janë dy nga njerëzit që, së bashku me të tjerë, i vunë themelet ushtrisë. Kur jeni njohur për herë të parë me Ilirin dhe Ardianin?*

(I.K.:) - Për njohjen me Adrianin rrëfeva, kurse takimi i parë me Ilirin mund të ketë ndodhur në janar 1997, por qysh në shkurt 1998, kur me Rifat Hamitin (Mitrovicë / Kiel të Gjermanisë) shkuam në Tiranë për qëllime biznesi, kisha takime më të shpeshta.

(B.I.:) *- Iliri ka dërguar edhe një letër në adresën e organizatës, letër, e cila ndodhet në arkiv, por pjesë të saj janë bërë të njohura. Aty ai shfaq mendimin dhe idetë e tij*

për ristrukturimin e luftës dhe hovëzimin e saj. Ti di për këtë letër, besoj. Por edhe jeni takuar disa herë me Ilirin. Fakt është se ai, në rrugë normale dhe të drejtpërdrejtë, ka propozuar që ti të jesh anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Kjo edhe nga besimi tek ti, por, dihet se ai ishte njëri ndër njerëzit më të afërt të vëllait tënd, Qerimit. Më intereson të di, nëse keni qenë në dijeni të veprimtarisë së Ilirit në fushën e logjistikës, si keni krijuar lidhjet me të dhe përgjithësisht me Grupin e njohur si Linja e Llapit, ku drejtonte Zahir Pajaziti?

(I.K.:) - Siç thashë, me Ilirin e me shokun e tij të ngushtë, Dilaverin, jam njohur në shkurt të vitit 1998, përmes Qerim Kelmendit. Iliri dhe bashkëveprimtarët e Tij në atë kohë po ndihmoheshin shumë edhe nga Perlat Gojçi dhe Isni Neza (nga Qeremi, gjegjësisht Leniqi i Malësisë së Gjakovës / Tropoja). Këta dy malësorë patriotë kanë ndihmuar shumë Ushtrinë tonë.

Që nga njohja e deri sa u ktheva në Gjermani, në prill të vitit 1998, për të marrë pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme dhe për t'u mobilizuar në mbledhje të ndihmave financiare, pothuajse përditë, kisha kontakte pune me Ilirin dhe Dilaverin, sepse bashkërisht merreshim edhe me strehimin dhe sistemimin e ushtarakëve që na kishin ardhur në Tiranë nga Bosnja, Kroacia e Sllovenia.

Përkushtimi, angazhimi dhe përvoja e Ilirit dhe Dilaverit me patën fascinuar, me patën dhënë energji të reja për angazhim.

Se Iliri paskësh kërkuar që unë të bëhem pjesë e shtabit të përgjithshëm, me beso, e dëgjoj për herë të parë. Por, ai duhet ta ketë bërë këtë kërkesë, meqë qe angazhuar me përkushtim që shtabi vërtet të formohej e të konsolidohej, sepse e dinte se kishim shtab jo sa duhej efektiv, në emër të të cilit thirreshin e

shpërdoronin sidomos Xhavit Haliti dhe Azem Syla. Këta përpiqeshin ta mashtronin Ilirin se ekzistonte shtabi, se Iliri ishte anëtar i tij, sikundër e thashë më herët, por ai nuk kishte marrë pjesë në ndonjë mbledhje të shtabit dhe nuk kishte si të merrte pjesë, përderisa ai ishte fiktiv.

(B.I.:) *- Të kuptohemi drejtë. Në Letrën e tij, siç shkruan ai vetë, shokëve të tij të idealit, letër e cila gjendet në arkivin e Organizatës, Iliri, ose Mërgimi, si e kemi njohur, në asnjë rast dhe në asnjë vend, nuk bën fjalë për Shtab fiktiv. Problemet që ai ngre, për momentin kur janë ngritur, janë të rëndësishme, sidomos për fuqizimin e luftës. Por ai, edhe pse herë-here e ka ndjerë veten të mënjanuar, nuk ka ngritur probleme të fiktivitetit ose të mosfunksionimit të Shtabit Qendror, siç është quajtur deri në mars të vitit 1998. Në të kundërtën, ai bën fjalë për Zahir Pajazitin, si udhëheqësin e tij dhe drejtuesin e Shtabit Operativ Qendror, shtab i cili, në kohë të ndryshme, ka ekzistuar dhe vepruar krahas Shtabit Qendror. Zahiri ishte njëri nga anëtarët e dyfishtë të strukturave drejtuese dhe njëkohësisht, ishte edhe drejtuesi më i drejtpërdrejtë i Ilir Konushevcit, Demës, Adrianit e shumë të tjerëve. Kjo do të thotë se Shtabi nuk ka qenë krejtësisht fiktiv, por, për vetë kohën kur janë zhvilluar ngjarjet, dinamizmin dhe përvojën, shumë gjëra mund të bëheshin ndryshe, çka do të thotë, mund të bëheshin më mirë.*

Por, më mirë, le të vazhdojmë me përgjigjen tënde.

(I.K.:) - Sërish e njëjta paqartësi. Unë i kam kaluar pothuaj dy muaj me Ilirin dhe gati ditë për ditë jemi takuar. Për këtë mund të dëshmojë Dilaveri, Qerimi, Bislim Zyrapi dhe shumë të tjerë. Por, kjo ka pak rëndësi. Rëndësi ka se Ilirit i ka ardhur vështirë të përdorë terminologjinë time, ama unë i dija shqetësimet e tij. Pastaj ai nuk i ka pasur informatat e as njohjet që

kisha unë. Unë, natyrisht, atyre nuk u tregoja gjë, sepse nuk doja t'i demoralizoja. Për mua në atë situatë emergjente kishte rëndësi, që ata, me atë vullnet, përkushtim e guxim, të futnin në Kosovë sa më shumë armë e municion, meqë vetëm ata kishin rrjet përmes të cilit fusnin armë në Kosovë.

Për ta bërë sektorin logjistik të UÇK-së në Shqipëri, Iliri bashkë me Bislim Zyrapin e ushtarakë të tjerë, patën bërë një projekt të detajuar. Në praninë time Iliri ia ofroi atë Xhavitit për prezantim (nga mesi i prillit 1998), me kërkesë që të mblidhej shtabi për ta shqyrtuar. Xhaviti ia grisi duke murmuritur ca të shara nëpër dhëmbë kundër oficerëve "titistë". Isha i pranishëm. Nuk na erdhi mirë, por e ruajtëm qetësinë.

Megjithatë, Iliri po e menaxhonte logjistikën e Ushtrisë mbi mundësitë reale, sepse Azemi dhe Xhaviti, sipas bindjes sime, nuk po e mbështesin si duhet, për të mos thënë se po e sabotonin.

(B.I.:) *- Nuk e kuptoj, cili ishte qëllimi i Xhavitit ose i Azemit që të sabotonin një linjë që i shërbente luftës. Në planin organizativ, ata, të dy, ishin të caktuar nga Kryesia e Organizatës; në linjë ushtarake, që të dy ishin anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, pasi ishin anëtarë të Sektorit të Veçantë, asnjëri dhe as tjetri, nuk besoj se mendonin se Iliri mund t'i spostonte dhe jam i bindur se as Ilirit nuk i ka shkuar në mendje kjo gjë. Nganjëherë kemi të dhëna jo të mjaftueshme dhe formohet një mendim jo i plotë. Jam i bindur se Iliri, po të kishte mundësi më të mëdha, do të kishte bërë mrekulli. Edhe grupi që vazhdoi punën pas vrasjes së Ilirit, po ashtu, mori barrën kryesore të logjistikës. Mirëpo duhet një logjikë tjetër që të mendosh se dy njerëz, të caktuar nga Organizata, duan të prishin punët e një tjetri, i të njëjtës linjë me ta. Ndoshta të kujtohet, kur ishim në Tiranë, mësuam për konfliktin mes Zekës dhe Raifit. Infor-*

macioni i parë ishte po ashtu, se Zeka po e pengon Raifin dhe nuk ka më kontakt me të. E shtruam në mbledhje. Nuk ishte e saktë. Zeka i kishte dhënë Raifit mjete të ndjeshme për logjistikën dhe ai ende nuk kishte bërë raportimin për justifikimin e mjeteve. Në këtë rast është e drejtë të thuhet, "justifiko mjetet që more e pastaj flasim për të tjera". Nuk dua të justifikoj Zekën e aq më pak Azemin, mirëpo nuk dua as të hyj në hakun e askujt. Edhe mundësitë, deri në prillin e vitit 1998, kanë qenë shumë të pakta. Ato ishin vetëm një rrëkezë, mund të them, në krahasim me atë që duhej.

(I.K.:) - Nuk e sqarojmë dot këtë tematikë Ti dhe unë. Informata dhamë për aq sa mund të jepen në një bashkëbisedim, të tjerët le t'i vlerësojnë këto të dhëna. Argumenti juaj se Lëvizja i kishte caktuar ata në ato pozicione është i saktë, por ama nuk do të thotë se individët që ka zgjedhur e ngarkuar Lëvizja kanë qenë çdo herë më të qëlluarit dhe më të merituarit. Për këta të dy kisha dhe kam bindjen se kam gabuar që i kam votuar, sepse nuk paskëshin qenë njerëzit e duhur, për vendin e duhur. Mbase do të bindeshit po të kishit qenë më herët në rrjedhë të ngjarjeve.

Sa për atë takimin me Raifin e Xhavitin, mundet ta keni fjalën për një takim që mbajtëm në fund të qershorit, ose në fillim të korrikut në ambientet e Hotel "Dajtit". Aty u kërkuam llogari për dy rrjete furnizuese, sepse për shkak të përplasjeve, i kishim ndarë në dysh. Për atë që e kishte bazën në Hoxhaj të Tropojës, i cili udhëhiqej nga Gani Nuhaj pas vrasjes se Ilirit, na erdhi për të dhënë llogari Raif Gashi, kurse për tjetrin Azem Syla. Raifi paraqiti shënime të detajuara që ishin mbajt në Hoxhaj, kurse Azemi nuk paraqiti asnjë shënim, por belbëzoi, se për shkaqe sigurie nuk po mbante shënime rrjeti që udhëhiqte ai diku në Has.

E përse ata të dy, Xhaviti e Azemi pra, përse sabotonin e komplotonin, duhet ta dinë vetë ata më së miri. Unë u mundova të shpjegoj më herët, se ata kishin tjetër koncept për luftën (vetëm si llafe, asgjë nuk kishin të projektuar në letër), sepse përmes mjeteve financiare donin ta kishin nën komandim të tyre gjithë Ushtrinë. Fatmirësisht shumë shpejt ata u nxorën si "tepricë teknologjike", nëse mund ta përdor gjuhën teknike, nga Hashim Thaqi e Kadri Veseli.

Pra, shkaqet mund të jenë gjithfarësoj, pse mund të pengohet një njeri, një grup e të mbështetet një grup tjetër. Disa prej atyre shkaqeve edhe Ti i din. Askush nuk e ka dëgjuar Ilirin të ankohet për çështje personale e subjektive, nëse ka pasur ndonjë ankim, e kishte vetëm për hir të luftës. E ai ka pas goxha shumë ankime kundër atyre të dyve.

Për të mos e zgjatur me rrëfimin për angazhimet e heroit markant, më 9 maj 1998 Iliri u vra në pritë nga kriminelët mercenarë të Tropojës. Hetimet për vrasjen e tij u sabotuan. Ndoshta me urdhër personal të kryeministrit Nano! Përse? Ndoshta do të sqarohemi ndonjëherë. Hetimet fillestare i pat sabotuar edhe Raif Gashi, i cili nuk depononte ato që dinte, ta zëmë emrat e njerëzve që e shoqëronin në atë rrugëtim Ilirin me Dr. Malën, ndihmësin e Ilirit,i cili gjithashtu u vra nga kriminelët në atë pritë.

Vrasja e Ilirit në pritë, në Qafëmal të Tropojës, jo vetëm që ishte goditje dhe humbje e madhe për Ushtrinë, por e kam përjetuar edhe si goditje të rëndë shpirtërore. Dyshimi im i kohës ishte se vrasësit e Ilirit duhet t'i kishin informuar ata që i dinin lëvizjet e tij, sidomos në ditët e fundit. Dhe këta njerëz nuk kanë qenë të shumtë. Por rëndësia e zbulimit qëndron, kush i angazhoi dhe pagoi vrasësist, sepse kriminelët nuk duhet të

kenë bërë vrasjen për qëllime plaçkitëse (meqë as të hollat që kishte në xhep Iliri, nuk i ishin plaçkitur.).

Uroj që organet përkatëse në Shqipëri të rinisin hetimet, sepse prova e dëshmitarë ka dhe, po të duan, mund ta ndriçojnë rastin, duke zbuluar se kush i kishte paguar vrasësit mercenarë (ndërkohë edhe ata të vrarë). Por këtë temë, edhe Ti e ke filluar në librin "Enigma e një vrasje të trefishtë", pra nuk je i panjohur me ngjarjet, për të mos thënë se mund të dish edhe gjëra të tjera, qoftë edhe nga fakti se ke drejtuar Komisionin e veçantë që u ngrit për hetimin e këtyre ngjarjeve.

(B.I.:) *- Më përpara se të bëj pyetjen tjetër, dua të të tregoj për natën e fundit të Ilir Konushevcit, ashtu si më është thënë nga Halil Selimi. Është e natyrshme që të kemi folur për Ilirin, sidomos pas botimit të librit tim "Enigma e një vrasje të trefishtë". Halili më tregonte se, natën kur është nisur për në Tropojë, në bazat e logjistikës, ai ka qenë në Durrës, në shtëpinë e Haxhi Babës, ku ishte, si të thuash, njëra nga qendrat e njohura. Si duket kishte parandier diçka, pak para se të nisej, e ndan Halilin mënjanë dhe i jep 30 mijë dollarë ose diçka më shumë. I thotë t'i mbajë ai, sepse po niset për rrugë, rreziku është në çdo kthesë dhe nuk do që, së bashku me të, t'i ngjajë diçka edhe mjeteve që kanë dhënë njerëzit për luftën. Më kupton drejt besoj, vetëm një njeri i përmasave tepër njerëzore, por edhe jashtëzakonisht atdhetare, në një moment të tillë, mendon për vazhdimin, për sakrificat e të tjerëve, mundimet dhe përkushtimin. Në shtëpi ai kishte një vajzë të porsalindur, sepse, në mos gaboj, e bija e Ilirit, Nertila, ka lindur më 5 mars 1997, dhe mendimi i tij nuk është aty, ku në fakt ka qenë zemra e tij, por tek ëndrra për Kosovën.*

(I.K.:) - Akoma më shumë e më konkretisht do të mund të

thoshin Raif Gashi, dy oficerët shoqërues dhe shoferi i kamionit, por ja që hetimet, si unë mendoj, i ka ndaluar vetë kryeministri Nano dhe mjerisht nuk po i vazhdojnë as të tjerët.

(B.I.:) *- Në dhjetor të vitit 1997 Zahir Pajaziti dhe Qerim Kelmendi, i plagosur, do të vijnë në Shqipëri. Ky do të jetë udhëtimi i fundit i Zahirit drejt Shqipërisë. Të dhëna të sakta nuk kam, por nga intervistat e bëra me drejtues dhe anëtarë të Lëvizjes, në kuadrin e Komisionin të veçantë për verifikimin e ngjarjeve të Luftës, të cilin e kam drejtuar, ka të dhëna se ti je takuar në këtë periudhë më Zahirin. Nëse kjo është e vërtetë, çfarë është biseduar, si qëndron në mendimin tënd figura e tij?*

(I.K.:) - Me Zahirin jam takuar, por nuk kemi pas asnjë bisedë e njohje konkrete. Ka qenë takim i rastit, siç uleshin bashkëveprimtarët në lokale të Tiranës. Ka qenë tepër i heshtur dhe prandaj nuk ma ka tërhequr vëmendjen. As Qerimi, i cili, pas plagosjes kishte ardhur në Tiranë për t'u mjekuar, nuk më pat treguar me kë isha takuar dhe cili ishte ai. Ishin edhe disa veta në tavolinë, pos ne të tre vëllezërve. Dhe kjo ndodhte për shkak të konspiracionit strikt.

Më vonë, kur kam dëgjuar për bëmat e heroit Zahir, nuk do mend të thuhet se kam pasur admirim të madh dhe vrasja e tij ka qenë goditje e rëndë për Ushtrinë dhe për Kosovën.

(B.I.:) ***-*** *Besoj, dhe deri diku jam i bindur, se lidhja jote me Grupin e Drenicës dhe me Adem Jasharin ka ardhur përmes Fehmi Lladrovcit. Pastaj do të jetë zhvilluar përmes Iliaz Kodrës, i cili, pas Grevës së urisë në Bonn, do të kthehet në Kosovë. Kjo është e përgjithshmja. Më intereson të di më shumë hollësi për këtë lidhje, e cila, megjithëse ishte nga larg dhe jo drejtpërsëdrejti, shpesh herë ka qenë e vyer.*

(I.K.:) - Njohje dhe komunikim personal me heroin e shquar, Adem Jasharin, nuk kam pasur.

Më lejo, të shfrytëzoj rastin për sqarim, përse nuk po e quaj "legjendar", si të tjerët, meqë e pata sqaruar në fjalën që pata mbajt në Muzeun Kombëtar në Tiranë, në tubimin që u organizua disa ditë pas vrasjes. Në fjalorët e gjuhës shqipe cilësimi *legjendar* bëhet për heronj që nuk u dihen bëmat, por që kanë ngelur në legjendat e bartura nga brezi në brez. Kam bindjen se shpesh shqiptarët, për Lekën e Madh, për Gjergj Kastriotin, për shumë të tjerë, i cilësojnë si heronj legjendarë. Për Ademin nuk ishte nevoja, pos nëse nuk i dihej ose nëse synohej falsifikimi i biografisë së tij. Legjenda është gojëdhënë me mistere e fantazi, me hiperbola e trille. Tek Ademi çdo gjë ishte e madhërishme, pikërisht sepse ishte tokësore e njerëzore. Është punë tjetër ajo kur akti sublim pastaj përthith atributet e mitit.

Unë e di që Komunikatën për shpalljen e Adem Jasharit si Komandant i përgjithshëm legjendar, fillimisht e ke shkruar Ti, sipas vendimit që mori Kryesia e Organizatës, dhe u habita, kur një ditë më pas, thuajse e njëjta erdhi nga Kosova, por ishte hequr passhtesa "i përgjithshëm", si për të dashur të lënë vetëm legjendën e jo të vërtetën.

Le të kthehem të njohjet dhe lidhjet.

Unë jam informuar konkretisht për Adem Jasharin në një mbledhje të Kryesisë së Nëndegës në Gjermani, në vitin 1996, kur Fehmi Lladrovcit pat bërë kërkesë për t'i dërguar ndihma atij dhe bashkëluftëtarëve të tij, për të cilët gabimisht përdorej identifikimi "Grupi i Drenicës". Me atë rast Fehmiu pat shpjeguar përse dhe kujt i dedikohen ndihmat që kërkoheshin. Kryesia e Nëndegës, ku ishe edhe Ti, pat miratuar qëndrimin që të ndihmojë sa herë që veprimtarët dhe çlirimtarët në Kosovë të

kërkojnë ndihma. Vetëkuptohet, nëse do të kishim në Nëndegë. Menjëherë u dërgua një shumë simbolike, meqë për momentin nuk kishim më shumë. Koordinatori i Sektorit të rëndësisë së veçantë qe hidhëruar, duke më fajësuar mua se po prishja "disiplinën" dhe kompetencat, meqë mjetet duheshin dërguar vetëm përmes atij Sektori. Tek në mars të vitit 1997 Kryesia e KP me thirri në mbledhje që të jap llogari. Besoj, nuk është koha t'i rrëfej përplasjet që patëm (ato duhet të jenë të arkivuara), por unë u largova nga ajo mbledhje me shpjegimin se sa herë që do të na kërkojnë mjete nga Kosova, do t'i dërgojmë, sepse është dëshmi që ose janë shkëputur lidhjet, ose Sektori i rëndësisë së veçantë i nuk i dërgon ku duhet mjetet qendrore. Me atë rast pata raportuar për ndihmat që kishim dërguar, jo vetëm në Drenicë, por edhe në zonat e Llapit e të Dukagjinit.

Historia e një greve urie dhe vazhdimi i mëtejshëm

(B.I.:) ***-*** *Pak më parë, jo rastësisht, përmenda Grevën e urisë në Bon, zhvilluar nga Lëvizja Popullore e Kosovës në Gjermani. Është një periudhë që njerëzit e mbajnë mend mirë. Tashti është koha t'i rikthehemi për të tjerët, që ose nuk e dinë mirë se si ndodhi, ose ishin ende të rinj për të rrokur një përmasë të tillë të zhvillimit të ngjarjeve.*

Lidhur me këtë unë do të doja të kisha përgjigjet e disa nënpyetjeve:

Fillimisht ju e nisët këtë Grevë në oborrin e "qeverisë Bukoshi", por pastaj dolët në sheshin kryesor të kryeqytetit të dikurshëm gjerman. Si ndodhi kjo, pse u larguat?

(I.K.:) - Jo, fillimisht dëshiroj të rrëfej, përse dhe si vendosëm për grevën.

Shtytje konkrete për të diskutuar në Kryesi të Nëndegës, nëse duhet ose jo të bëjmë grevë, ishte vizita e presidentit të Shqipërisë, Sali Berisha në Bon, në fillim të majit 1996. Ai në konferencën për shtyp pat deklaruar se Shqipëria angazhohet që çështja e Kosovës të zgjidhet me një statut autonomie në kuadër të Jugosllavisë.

Arsye e dytë qe nënshkrimi i një marrëveshjeje mes Ministrit të jashtëm gjerman, Klaus Kinkel, me presidentin Sllobodan Milosheviq, për t'i kthyer azil-kërkuesit e Kosovës, që nuk ishin të përndjekur politikisht përmes aeroportit të Beogradit.

Arsye e tretë ishte parashikimi, se përmes grevës do të ndikojmë në gjallërimin dhe intensifikimin e rezistencës në Kosovë.

Në Kryesi patëm debatuar gjatë, se mos po na cenohej trimëria burrërore me grevën e urisë. Por në fund të debatit morëm vendimin pro grevës së urisë. Kërkesën tonë ia përcollëm Kryesisë së KP-së të Degës. Nuk donin të na e miratonin. Megjithatë, e nisëm pa pritur miratimin.

Paraprakisht patëm një takim, do ta quaja të fshehtë, me "kryeministrin" Bukoshi. I biseduam kërkesat dhe pas ndonjë ndryshimi kozmetik, i miratuam. Ndërsa për të mbajtur grevën në oborrin e selisë së "qeverisë" u vendos për shkak të lehtësirave praktike, fiziologjike dhe higjienike. Për këtë qëllim Bukoshi na dha çelësin e hyrjes kryesore, për të shfrytëzuar kompjuterët, fotokopjuesit, faksin dhe banjat e "qeverisë".

Kërkesa e parë, ishte dorëheqja e Sali Berishës për prononcimin e tij para gazetarëve; E dyta, ishte shfuqizimi i marrëveshjes Kinkel-Milosheviq; E treta, dorëheqja e presidentit Rugova, meqë ai po e shtyp rezistencën aktive në Kosovë.

Ditën e parë të grevës në oborr të selisë së "qeverisë" ishim në rregull, shërbeheshim me infrastrukturën e asaj shtëpie. Ditën e dytë të grevës i qe ndërruar çelësi derës dhe nuk e morëm vesh si ishte e mundur. Në mëngjes policia kërkoi të shpërngulemi nga ai oborr, ngaqë kishte kërkuar pronari gjerman i shtëpisë, meqë i ishin ankuar qiraxhinjtë ("qeveria" e Bukoshit). Pas një debati vendosem të shpërngulemi në qendrën kryesore të Bonit, me arsyetim se atje do të kishim më shumë publicitet. Kishte propozime që të thyenim dyert e ndërtesës, të merrnim gjithë gjerat dhe ta digjnim. Dhe do ta bënim, sepse ishin mbledhur goxha trima, që nuk e përballonin kollaj mashtrimin e Bukoshit, megjithatë u shpërngulem. Bëmë grevë 16 ditë. Shumë veta: Tima, Violeta, Sabrija dhe femra të tjera u sëmurën. Por, u sëmurën edhe meshkuj.

Besoj, ndikimi i asaj greve që i shumanshëm, sidomos ndërgjegjësimi i bashkatdhetarëve për rezistencë aktive. Me grevën e urisë u solidarizuan emigrantët tanë në shumë kryeqendra evropiane dhe mijëra veta ishin aktivizuar. Edhe në Kosovë, prej nga na vinin telegrame mbështetëse, pati shkundje nga telalgjia "pacifiste".

(B.I.:) ***-*** *Është thënë se fillimisht me ju ishte i një mendje edhe Zotëri Bukoshi, bile ai pat ndërhyrë edhe në tekstin e deklaratës. Më pas çdo gjë ndryshoi. Ai doli haptas, jo kundër grevës, por kundër afishimit të emrit dhe të qeverisë që thuhej se e mbulonte.*

(I.K.:) - Detajet vërtetë nuk po më kujtohen, por, siç rrëfeva, Bukoshi nuk iu përmbajt marrëveshjes. Të interesuarit për detaje mund të informohen edhe nga shtypi i kohës, por edhe ju mund të shfrytëzoni arkivin, po gjykuat se duhet konkretizuar detajet. Në mos gaboj, tekstin e deklaratës, në fund e kemi

dërguar edhe tek ju, për t'i bërë redaktimin e nevojshëm.

(B.I.:) - Cili ishte qëndrimi i shtetit gjerman?

(I.K.:) - Mediet gjermane i patën dhënë jehonë goxha të bujshme. Edhe qytetarët e shumtë gjermanë rrinin pranë nesh, për të shprehur përkrahjen dhe dhimbjen e tyre, sepse skenat ishin goxha tronditëse. Ishim me dhjetëra veta, të shtrirë në mes të sheshit, të rrethuar nga qindra shqiptarë. Qeveritarët gjermanë në fillim u përmbajtën, për të parë nëse e kishim seriozisht me grevën. Ata po informoheshin nga Kryqi i Kuq, nëse ndonjëri po ushqehej fshehurazi. Kryqi i Kuq ishte autorizuar që secilën ditë të kontrollonte gjakun e grevistëve dhe të raportonte. Pas 5-6 ditëve filluan të vinin qeveritarë, por të skalionit të tretë. Bisedonin me ne, mundoheshin të na bindnin. Tek në ditën e 15-të e 16-të po na vizitonin ata të eshalonit të dytë, nga disa ministri dhe nga zyra e Kancelarit. Më në fund morëm premtimin bindës, se azilkërkuesit e refuzuar nuk do të ktheheshin përmes Beogradit, por përmes Tiranës, duke na bindur se nuk mund ta shfuqizonin marrëveshjen publikisht, por në heshtje nuk do ta zbatonin. Nuk dyshuam në premtimin e tyre, sepse tashmë njihnim karakterin gjerman, fjalën nuk e shkelin. Dhe ashtu rezultoi.

Për dorëheqjet e Berishës dhe Rugovës nuk deshëm të vazhdonim, sepse i vlerësuam të papërgjegjshëm.

(B.I.:) - Si ishte përkrahja nga kryesia e Organizatës dhe së fundi për këtë temë, si ishte mbështetja nga njerëzit e zakonshëm?

(I.K.:) - Pothuajse të gjithë anëtarët e Kryesisë ndjenin keqardhje, por aprovim të plotë nuk na dhanë. Shpesh vinte Nënkryetari Muhamet Kelmendi për të na vizituar, meqë po shqetësohej për grevistët që po sëmureshin. Vinte më rrallë edhe ndonjë tjetër, kurse, nëse nuk gaboj, vetëm Ali Ahmeti kishte

organizuar grevë urie në Lucern ku ishte futur edhe ai. Ai i njihte karakteret e Fehmi Lladrovcit, Ilaz Kodrës, Xhemajl Fetahut, Sabri Kiçmarit, Sami Lushtakut, Rexhë Ibërdemajt dhe të tjerëve, se mund të vazhdonin deri në vdekje, po vendosen. Për mua më behej sikur s'merakoseshin gjithaq, sepse po më akuzonin si fajtor për frymëzim dhe mbase dyshonin se po haja fshehurazi, meqë unë isha vazhdimisht në konferenca shtypi, në takime me qeveritarë, në intervista, bashkë me Sabri Kiçmarin, Time Dukajn, Violeta Demirin. Në fakt, gjithë grevistët patën kërkuar që unë të mos bëja grevë, për të pasur energji për aktivitetet që duheshin bërë, por nuk pranova.

Solidariteti i bashkatdhetarëve u rritë shumë. Sidomos në fundjavë bllokohej sheshi. Sikur po më shfaqet edhe tani i gjallë Fehmiu rezistent, gjithë kohën i ulur këmbëkryq, duke u dhënë zemër grevistëve dhe bashkatdhetarëve. Ai shquhej për oratori dhe rrjedhshmëri, për përmbajtje të thellë, të shprehur në gjuhë popullore. Vërtet, më bëhet sikur edhe tani po më shfaqet si personazh epik.

(B.I.:) *- Nga greva juaj e urisë unë ruaj një kujtim të veçantë, i cili ka mbetur tek unë. Erdha të bëj një reportazh për gazetën "Zëri i Kosovës". Megjithëse isha i zgjedhur në kryesinë e Nëndegës, nuk hyra në grevë. Njerëzit ishin mbledhur rreth Fehmiut. Më duket se asaj dite rigonte shi dhe ishte ftohtë. Qëndrova mënjanë me Iliaz Kodrën. Sapo ishte martuar. Dhëndër i ri, luftëtar i vjetër. E ngacmova diçka dhe ai qeshi. Me Iliazin më kishte njohur Ramiz Lladrovci, që ishte miku më i afërt i tij, bashkë me Lulëzim Jasharin. E pyeta nëse mund t'ia përmendja emrin në reportazh, më shumë e pyeta për të qeshur, sepse e merrja me mend përgjigjen."Nuk ka asnjë problem"- më tha qetësisht. Pastaj si për të më thënë një sekret u zgjat pak nga unë dhe më tha, "Mezi po pres të mba-*

roj greva". "Kërkon të shkosh tek nusja"- i thashë. "Jo, më tha, do të shkoj tek nana, do të kthehem në Kosovë". Ka qenë takimi i fundit me të. Edhe kur më pas flisnim në telefon, për herë të fundit kam folur nga shtëpia e bacës Rifat Jashari, më kujtohej pamja e tij e qeshur, imtësia e fytyrës, butësia e zërit dhe serioziteti me të cilin i merrte punët e luftës. Ajo ditë, kur u dëgjuam për herë të fundit, më ka ngelur dhimbje në shpirt dhe ende më tingëllon zëri i tij kur thoshte se "kemi mbetur pa një kokërr kallamoq, o baca Bedri", dhe unë e dija se çfarë fshihej pas kokrrave të misrit. U vra edhe ai në maj, si Iliri, u vra si komandant i brigës 114 "Fehmi Lladrovci", si miku i tij.

Pas luftës, menjëherë pasi isha ndarë nga familja e Jasharëve, kemi qenë së bashku, në se të kujtohet, vizitën tjetër të parë, e bëra tek shtëpia e Iliazit. Gjithçka ishte shkatërruar e djegur, trarët digjeshin ende në oborrin e shtëpisë, ndjehej menjëherë se aty kishte qenë lufta në të gjitha përmasat e saj, por, si një mrekulli, kishte filluar të çelë jeta. Vajza e Iliazit ishte aty, në oborrin e shtëpisë e pas pak do të vinte në jetë edhe vajza tjetër. Me të dy shokët tanë, me Iliazin dhe me Xhemail Fetahun ndodhi njëlloj: pas vrasjes së tyre, erdhën në jetë bijat e dyta. Një ditë do ta mësojnë se çfarë baballarësh të mrekullueshëm kanë pasur.

IX. Dy mendime të ndryshme

Kur po shikoja fragmentet e diskutimeve që Ibrahim Kelmendi kishte mbajtur, në kohë të ndryshme, në mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes, mendimi i parë që më erdhi ishte se, për disa nga qëndrimet e tij dhe për vendimet që janë marrë, apo për njerëzit që është diskutuar, ne kemi pasur pozicione të ndryshme, pavarësisht se, që të dy, kemi qenë anëtarë të së njëjtës strukturë drejtuese, apo se kemi qenë (dhe jemi) miq.

Fragmentet e diskutimeve të Kelmendit unë i krahasova me origjinalin që gjendet në arkivin e Organizatës, fletët e të cilave, që të gjitha, nuk e di se për cilën arsye, ai i ka nënshkruar njërën pas tjetrës. Në mos qofsha i gabuar, diskutimi, i cili sillet i dyti në radhë në këtë libër, ai i datës 12 dhjetor 1998, duhet të jetë edhe në arkivin e Shtabit të Përgjithshëm, pasi vetë Kelmendi, kur ia kërkuan, më lejoi dërgimin e tij. Ndoshta jam i gabuar, por besoj se kështu ka ndodhur.

Diskutimi i Ibrahim Kelmendit në mbledhjen e KP, 23 maj 1998:

»(...) Mbledhja e 6-të e Përgjithshme e LPK-së, Dega jashtë vendit, miratoi të drejtën e pjesëmarrjes së dy përfaqësuesve, - Hashimit e Kadriut, - të "Këshillit të Përgjithshëm " të LPK-së, pa pasur mundësi verifikimi të tyre dhe të KP, pasi Sektorit përkatës, të lidhje-mbajtjeve, i mungonin të dhënat, përjashto njërin anëtar të sektorit, Ademin, i

cili befasisht informoi ose dizinformoi Mbledhjen e Përgjithshme, se, sipas tij, "Këshilli i Përgjithshëm është formuar në Kosovë dhe se dy shokët ishin përfaqësuesit e tij".

Edhe Komisioni i Verifikimit të Mandateve, ndoshta duke qenë i mashtruar nga Ademi e ndonjë tjetër, ua miratoi atyre mandatin, pa ofruar asnjë dëshmi.

E gjitha kjo ndodhi, mendoj unë, edhe si rrjedhojë e parapërgatitjeve që duhet të jenë bërë para Mbledhjes, për të "disiplinuar" Degën sipas dëshirës dhe synimit të disa individëve. Pjesëmarrës të tjerë të Mbledhjes vendosën të heshtnin. Dhe vendosen të heshtin sepse e kishin hetuar se do të bëheshin prapaskena, por nga dëshira e mirë që, çështjet që zienin prej disa kohe të kapërceheshin pa u hapur para delegatëve dhe Mbledhja të përfundonte në harmoni.

Gjatë Mbledhjes, përfaqësuesit e supozuar të KP, Hashimi e Kadriu, e humbën durimin për të dëshmuar qëllimin e tyre të vërtetë të pjesëmarrjes në Mbledhje, dhe, mendoj se me nervozizëm, tentuan të ngrinin "çështje me rëndësi", po në Mbledhje. Shumica e delegatëve, të hutuar nga kjo, se çfarë "bombe" mund të hidhej aty, e panë të udhës që çështjet t'i kalonin Këshillit të Përgjithshëm. "Përfaqësuesit" dhe bashkë-aktorët e tyre ranë dakord, gjithnjë duke shpresuar se, në zgjedhjet e reja, nuk do të fitonin të padëshiruarit e tyre, për çka ishte bërë edhe fushata paraelektorale.

"Bomba" plasi në Mbledhjen e parë të Këshillit të ri të Përgjithshëm, që në fillim, pasi, disave u interesonte jashtëzakonisht shumë, që në Kryesinë e re, të zgjidheshin tashmë vetëm të "merituarit", vetëm ata që i takonin atij grupimi, por nuk u prishte punë edhe ndonjë tjetër, që ende nuk ishte i informuar...

Ca nga ciflat e asaj "bombe" më gjetën edhe mua. Kështu, "daja i vogël", Azemi, me sinqeritet tepër naiv, me dëshpërim të papërmbajtur, shprehu keqardhjen pse isha zgjedhur edhe unë në Këshillin e Përgjithshëm, pasi, sipas tij, isha një fajtor i madh për shumëçka që kishte ndodhur.

Kurse Hashimi e Kadriu po më fajësonin vetëm për "anarshinë" e krijuar në Shqipëri gjatë muajve të fundit. Mendoj se ata duhet të më kenë kursyer pa më fajësuar më rëndë, kryesisht pse kemi pasur marrëdhënie të mira shoqërore dhe respekt reciprok. Por kjo nuk do të thotë se nuk do të ndodhë në ndonjë Mbledhje tjetër...

E kam thënë disa herë para shumë viteve, ndoshta edhe e kam shkruar, se LPK vazhdon të ballafaqohet me vështirësi, pasi asaj i është zënë peta keq, që kur është themeluar. (...)

Ca nga shëmtitë, që "përfaqësuesit" Sabri Novosella, Abdulla Prapashtica dhe Xhafer Shatri ia kanë imponuar Lëvizjes qysh në fillim, kanë qenë imponimi i frymës së grindjeve, grupimeve, individualizimeve, imponimeve, duke u thirrur "në emër" të strukturave fiktive. Këto shëmti, herë pas here, u shndërruan në një vijë të dytë të Lëvizjes. Ajo kurrë nuk ka mundur të lirohet e të shërohet plotësisht nga ato. (...)

Qysh në vitin 1996 pata filluar të dërgoj të holla në Kosovë, në dukje "kokë në vete", pa i pyetur paraprakisht shefat, duke iu përgjigjur kërkesave që bënin bashkëluftëtarët atje. Ato ndihma ishin simbolike dhe i dërgoja pasi konsultohesha me disa anëtarë të tjerë të kryesisë së Nëndegës së Lëvizjes në Gjermani. Natyrisht edhe "shefat" e Kryesisë së KP të Degës i informoja. Edhe ca "kaçakëve" të Prekazit, siç kam dëgjuar t'u thuhet atyre trimave nga disa "të disiplinuar", u kemi dërguar ndihma simbolike, pasi qysh atëherë, në vitin 1996, ishim informuar se nga jashtë, këta "kaçakë" nuk ishin përkrahur e as nuk ishin ndihmuar. (...)

Qysh në shkurt të vitit 1997 filluan të na kërkojnë ndihma edhe shokët e Linjës së Llapit. Kjo kërkesë arsyetohej me vrasjen e Zahirit dhe me shkëputjen e lidhjeve me Shtabin, sepse deri atëherë lidhjet ishin mbajtur përmes Tij. Me konsultimin e shokëve, kryesisht Sabri Kiçmarit dhe Fehmi Lladrovcit, por edhe duke informuar "shefat" përkatës të Kryesisë, u kemi dërguar, përmes lidhjes që kishin caktuar ata vetë, ndihmat financiare, po ashtu modeste. Edhe ata të Linjës se Dukagjinit

kërkonin ndihma për nevojat e tyre. Aq sa arrinim, u dërgonim, gjithnjë përmes lidhjeve që kishin caktuar ata vetë.

Disa shokë drenicas, me të cilët kishim qenë në Grevën e urisë në Bon, në maj të vitit 1996, me vendim të Kryesisë lënë Gjermaninë për t'iu bashkëngjitur radhëve të UÇK-së në Kosovë. Kur arrijnë atje, mes tyre edhe Ilaz Kodra, bashkëluftëtarët e tyre u ankohen se nuk iu ishin dhënë mjete të Fondit në mënyrë të organizuar. Edhe atyre u dërguam ndihma modeste. Vazhdoi shfaqja e pakënaqësisë tek disa rrethe të caktuara të UÇK-së, dhe pëshpëritjet, se nuk po merrnin ndihma nga "kompetentët". Prandaj më thirrën në një mbledhje të Kryesisë, sa më kujtohet në mars ose maj të vitit 1997, për të dhënë llogari dhe për të më disiplinuar, që të mos jap më ndihma. Aty Zeka e pranoi se ishin shkëputur ca lidhjet pas vrasjeve të Janarit dhe burgosjeve, dhe se kishin ngelur pa u ndihmuar në mënyrë të rregullt disa rrethe. Për këtë dukuri më kishte rastisur të bisedoj edhe me Jashar Salihun, Udhëheqësin e Sektorit të Fondit, në të cilin edhe unë isha anëtar. Edhe ai nuk ishte i kënaqur për pëshpëritjet që kishin filluar dhe atëherë u vetëkuptua pse rrethet e shkëputura kishin gjetur vetë rrugën e lidhjes me Degën jashtë vendit, më konkretisht Nëndegën në Gjermani. Dhe pse e gjetën tek ne në Gjermani, kjo duhet të analizohet. Zeka na tha se ndërkohë lidhjet ishin vendosur dhe se ne, që administronim Fondin V.Th. në Gjermani, nuk duhej të dërgonim më mjete drejt për drejtë në rrethe, pasi kështu krijohen shkëputjet dhe shpërqendrimet. Ai këmbënguli se më mirë është që mjetet të shkonin në mënyrë të rregullt, të centralizuar dhe të disiplinuar. Natyrisht se isha dakord, por u shpjegova se, nëse rrethet do të vazhdonin të kërkonin mjete, edhe ne do të vazhdonim t'u dërgonim. Por edhe pastaj, luftëtarët e Zonës së Drenicës janë ankuar se nuk po u shkonin ndihma dhe sërish jemi detyruar t'u dërgojmë nga kontoja e Fondit në Gjermani. Për këtë mund të konsultohet edhe Letra e shokëve të Drenicës në fillim të dhjetorit 1997. (...)

Duke qenë në Shqipëri, ndërkohë ndodhi ndeshja e madhe mes forcave të pushtuesit dhe forcave të UÇK-së. Në shënjestër ishte Prekazi. Dëm-

timi i radhëve tona, sidomos i luftëtarëve dhe i popullsisë civile të Prekazit heroik, ishte i madh. Por shpresoj, po aq, ose edhe më i madh, është dëmtimi forcave pushtuese. Ndoshta do të ketë ndonjë ushtarak që do të thotë nesër se forcat e UÇK-së nuk manovruan si njësi ushtarake, por më shumë si trima stoikë, të cilët me qëndresë dhe sakrificë të Tyre, vetëdijesuan e politizuan popullin në kulm. Dhe kjo ishte gjithsesi fitorja më e madhe e Tyre. Ademi e Hamzë Jashari u shndërruan në heronj epikë. Familja e tyre e sakrifikuar u shndërrua në dhimbje e krenari gjithëkombëtare.

Edhe në këtë luftë të pabarabartë u pa se trimat e Prekazit nuk kishin armë të mjaftueshme, sidomos ato të sofistikuara. Duhet të bëhen hulumtime dhe hetime, perse ka qenë kjo gjendje në Prekaz dhe përgjithësisht në Drenicë, pse u detyruan ata t'i shkruajnë letër Organizatës se janë të diskriminuar në armatim. (...)

Sa i përket logjistikës, ajo ka funksionuar spontanisht, sipas kutit të aftësisë dhe të disponimit të "kompetentëve", me zhurmë e përplasje, me stihi e me anarki, në dukje edhe me sabotime, por kryesisht si rrjedhojë e paaftësisë dhe individualizimit të problemeve. Më shumë bëhej çka kujt i tekej. Aty vepronin, të them kushtimisht, dy grupime kryesore, për të cilat i thashë disa fjalë më sipër, por po shtoj edhe disa të tjera. Këto dy grupime sikur bënin garë se kush do të bënte më shumë, por pa u koordinuar në mes tyre, e për më tepër, edhe duke qenë një garë e pabarabartë. (...)

Kushdo që kishte nevojë për mjete, duhej të priste në hotel "Tirana", ku e ka Zeka vendtakimin e përhershëm, të shihte një herë disponimin e tij, pastaj t'i drejtohej në mënyrë lutëse, sikur kishte shkuar për hallin e tij personal. Dhe vërtetë kjo formë nuk ishte funksionale. (...)

Me ushtarakët, që kishin marrë pjesë në luftimet në anën e popujve që bënin luftë për t'u çliruar nga pushtuesit serbë, të cilët ndërkohë kishin ardhur në Tiranë, mbaja kontakt të përhershëm. Për të mos thënë se më duhej të interesohesha edhe për ushqimin e strehimin e tyre. Ata u bashkuan në një grupim të fortë e funksional, duke treguar gatishmërinë për

t'u inkuadruar në UÇK, sapo Shtabi i Përgjithshëm të miratonte kërkesën e tyre dhe t'i caktonte aty ku e shihte të përshtatshme ai. Kishte ndër ata ushtarakë me gradën e kolonelit, por edhe të gjeneralit të brigadës. Të gjithë ishin emra të njohur në luftimet përkatëse, ishin shquar në luftëra. Nuk kisha ngurruar t'ua shpjegoja UÇK-në, si e njihja unë, të gjithë ndjeheshin krenarë me atë që kishte bërë dhe ishte duke bërë UÇK-ja. Shpjegonin në mënyrë bindëse se, në një fazë të tillë, kroatët dhe boshnjakët kishin qenë më keq, se shumë lehtë mund të strukturohej një ushtri e mirëfilltë, që të fillonte luftën. Më vinte keq t'ju thoja se gatishmëria e tyre varej nga ata, të cilët shumë pak merrnin vesh nga lufta. (...)

Në fillim të prillit 1998 ka ardhur Smajli (Ramush Haredinaj) në Tiranë. Ai çmohej si më trimi dhe më luftaraku në fshatrat e Dukagjinit, ku veç ka shpërthyer ndeshja luftarake me sulmin frontal serb në Glloxhan, me synim që të shpartallojnë një zonë me rëndësi të UÇK-së. Për Smajlin, veç asaj që flitej, për trimërinë dhe bëmat e tij, nuk e di se çfarë pozicioni ka ai në të vërtetë në UÇK. Anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, them, nuk është, por nuk e di nëse është ose jo drejtues i Shtabit të Zonës operative të Dukagjinit. Ai qëndroi, më duket, dy ditë në Tiranë. Duke qenë i dezinformuar, lidhur me qëndrimin e ushtarakëve aty dhe lidhjet e tyre me mua, ai ka kontaktuar si vetëtimë me disa nga ushtarakët, të cilëve u ka thënë në mënyrë të prerë, se nuk kishin pse të vazhdonin të qëndronin në Tiranë dhe aty të shpenzonin të hollat e vëllaznisë. Pra, sipas tij, ata dhe të gjithë ne duhet të futeshim menjëherë në Kosovë dhe të rreshtoheshim krah forcave të armatosura. Ai, si më thanë ushtarakët dhe siç e dëgjova vetë në telefon, nuk kishte pasur kohë të bisedonte dhe të informohej nga ushtarakët, se ata, po prisnin përgjigjen e Shtabit të Përgjithshëm. Ai, gjithashtu, nuk duhet ta ketë ditur se çfarë qëndrimi mospërfillës dhe mohues po mbanin "shefat" karshi tyre. Si duket, ai ishte keqinformuar, se ushtarakët vetëm po silleshin e po shpenzonin, prandaj, nëse e shikojmë kështu, ai me të drejtë u ishte drejtuar atyre brutalisht. Se ishte i irrituar e nervozuar Smajli nga dezinformatat e shpifjet e dikujt, e mësova po atë natë, vonë,

nga biseda telefonike me të, me të cilin ndërrova ca fjalë të rrepta.

Disa konkluzione:

- Pas vrasjeve të janarit 1997 dhe burgosjeve të ushtarëve dhe kuadrove të UÇK-së, analizat për to duhej t'i bënte menjëherë Shtabi Qendror dhe ai të merrte qëndrimin e qartë për ngjarjet, shkaqet dhe fajtorët, duke mbajtur qëndrimin ndëshkues, gjithsecilit sipas fajit, dhe jo këto probleme të ngrihen tani. Kjo është një provë që Shtabi, sidomos pas vrasjeve e burgosjeve, nuk ka pasur funksionalitetin e mirëfilltë.

- Sidomos pas arrestimeve Shtabi Qendror dhe gjithë UÇK-ja do të duhej të riorganizoheshin, pasi ka ekzistuar rreziku që ndonjëri nga të burgosurit, duke mos qenë në gjendje të përballoj torturat, të dekonspirojë shumë vetë e shumëçka. Përkundrazi, kam përshtypjen se Shtabi Qendror nuk i ka përfillur kërkesat e shtabeve lokale për riorganizimin e Shtabit Qendror, prandaj janë shkëputur lidhjet dhe është bërë e vështirë gjetja e lidhjeve të reja, për të siguruar ndihmat dhe bashkëpunimin.

- Shtabi Qendror, sidomos pas vrasjeve e arrestimeve, është monopolizuar nga pak veta, në një rreth të caktuar shoqëror e lokal, një pjesë e madhe e të cilëve nuk kanë qenë që gjatë kohë në Kosovë, por këtu, në emigracion, dhe prej këndej, janë munduar të drejtojnë ose të ç'drejtojnë UÇK-në.

- Kryesisht me fajin e Sektorit të rëndësisë se veçantë është shkaktuar gjendja e ngrirë, nëse jo diç më shumë, në mes të Shtabit dhe Kryesisë së Degës. Në këtë drejtim duhet të ketë ndikuar përbërja e Shtabit. Kjo ka bërë që ai të mos ketë takime me Kryesinë, pas kërkesës së saj muaj më parë, pasi shumë nga anëtarët e shtabit ishin të mërguar në Zvicër dhe kjo është dashur të mbahet e fshehtë. Kaq e fshehtë ishte sa që, në takimin me Kryesinë, në prill të këtij viti, në një rast Zeka e pyet Hashimin: "Ti çfarë roli ke në UÇK?" Ose ndoshta me këtë pyetje ka dashur edhe më tej të ruaj të fshehtat e përbërjes se shtabit.

- Shtabi nuk ka koncept aktual për gjendjen ku ndodhemi, gjegjësisht për luftën, se a duhet të vazhdohet me aksione të bëra nga grupe të vogla

guerile, apo duhet të përforcohen radhët për një luftë frontale, të cilën, siç po duket, pushtuesi veç na e ka imponuar në disa zona qysh tashti.

- Shtabi ka zvarritur legalizimin e UÇK-së, si një ushtri çlirimtare popullore, në përmasa të pa dëmtueshme për të, edhe pse ka pasur propozime, të cilat nganjëherë kanë qenë edhe publike. Duhet të emërohet zëdhënësi, të futet në përdorim vula, të firmosen komunikatat, qoftë edhe me pseudonimin e Komandantit të Përgjithshëm, të ngarkohen persona të caktuar me detyra të caktuara, ato të jetësohen me vendime me shkrim. Ndoshta, edhe për shkak të kësaj zvarritje, UÇK-ja vazhdon të vlerësohet nga struktura të ndryshme, brenda e jashtë, nga masmediat, herë si grup "ilegal", e herë, çka është më keq si grup "terrorist". (...)

Propozoj:

• Këshilli i Përgjithshëm i Degës, përkatësisht Kryesia e re që do të zgjidhet nga ajo, duhet të shkarkojë të gjithë sektorët përkatës, atë të rëndësisë se veçantë dhe të lidhje-mbajtjeve, dhe kjo është e drejtë e saj, pasi anëtarët dhe drejtuesit e këtyre sektorëve janë emëruar po nga Kryesia.

• Shtabet lokale, në bashkëpunim me shtabin qendror, duhet të zgjedhin një shtab të ri, i cili duhet të përbëhet nga anëtarë që gjenden në Kosovë dhe në të përfshihen ushtarakë të sprovuar.

• Rrjeti i logjistikës në Shqipëri duhet të organizohet në mënyrë strukturore, kryesisht me shqiptarë vendas, ushtarakë, pasi ka mjaft nga ata, më të përgatitur se shokët tanë që po merren aktualisht me këtë detyrë, nga ana tjetër kjo do të na kushtojë më lirë dhe nuk do të biem gjithaq në sy.

• Duhet të ndërpritet zvarritja dhe nënvlerësimi i ushtarakëve shqiptarë të Kosovës e të Shqipërisë, të sprovuar e të dëshmuar, të cilët kanë shprehur gatishmërinë e tyre të sinqertë për të qenë pjesë e UÇK-së.

• Duhet të përcaktohen qartë dhe pa asnjë ekuivok raportet mes UÇK-së dhe LPK-së, nga të dyja palët, pasi jemi e njëjta gjë dhe kemi të njëjtin synim. (...)«

Diskutimi i Ibrahim Kelmendit në mbledhjen e KP, 12 dhjetor 1998:

»Unë do të diskutoj më gjatë, i përgatitur me shkrim, për shkak të një momenti kritik dhe për shkak të rendit të ditës, pra të një vendimi i ndërvarur me ca dukuri të tjera, vendimit për tjetërsim të Fondit "Vendlindja thërret".

Është kohë e përgjegjësive dhe e vendimeve të mëdha. Dhe mirë që ka ardhur kjo kohë. Për këtë kohë është punuar shumë, është sakrifikuar shumë. Deri tek kjo kohë nuk kemi ardhur në mënyrë drejtvizore. Siç është e rëndomtë, nuk kemi kontribuar të gjithë njësoj, por gati të gjithë kemi kontribuar si kemi ditur dhe sa kemi mundur. Jo të gjithë kemi vepruar në mënyrë konstruktive, kush pse nuk ka ditur e kush pse e ka pasur me hile. (...)

Gjithsesi, nuk kemi pse të heshtim, aq më keq, edhe ta fshehim, të paktën jo këtu, qoftë edhe për shkak të modestisë, apo për ndonjë arsye a pseudo arsye tjetër, se kontributin më të madh për të ardhur deri këtu e ka dhënë Lëvizja Popullore e Kosovës. Prandaj, pikërisht për këtë, kërkohet përgjegjësi edhe më e madhe, njëherësh edhe angazhime konstruktive, po nga anëtarët e Lëvizjes.

Në këtë moment unë Lëvizjen nuk e mendoj të ngushtuar, vetëm të anëtarëve të tanishëm statutor. Lëvizje janë edhe organizatat e grupimet pararendëse, të viteve 50-ta, 60-ta e të viteve 70-ta. Pse mendoj kështu? Sepse, sukseset, por edhe dështimet e Organizatave dhe grupimeve pararendëse, kanë nxjerrë organizatat e grupimet pasuese, për të ardhur deri tek Lëvizja jonë. (...)

I thashë këto për të rikujtuar se Lëvizja jonë është shumë më e gjerë e shumë më e shtrirë, në kuptimin pozitiv, por herë here, edhe në kuptimin

negativ, se sa ka ajo tani anëtarë të rregullt, në kuptimin statutor; por edhe të parregullt, shumë herë jo për fajin e tyre, sidomos kur është fjala për anëtarët në Kosovë. Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e pamundësive, e paaftësive dhe e defekteve të ndryshme organizative, në përgjithësi, por edhe të strukturave të saj udhëheqëse, në veçanti, pa harruar këtu edhe luftimet nga pushtuesit, që është dashur t'i përballojmë.

Të gjitha këto Lëvizjes i kanë ndodhur për shumë arsye, por më së paku për arsye përmbajtjesore ideologjike e politike, pasi, pavarësisht mënyrës së bashkimit të organizatave e grupimeve, Lëvizja ka qenë gjithnjë dhe gjithherë e hapur, shumë e hapur, me një fjalë vetëm lëvizje kombëtare, gjithsesi demokratike, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Ka pasur defekte e keqkuptime, por ato nuk kanë mundur të ndryshojnë karakterin përmbajtjesor. (...)

Dikujt edhe mund t'i duken të parëndësishme dhe të pavend këto që thashë, por unë mendoj se janë me vend, sidomos në momentet kur ka individë dhe struktura, edhe brenda Lëvizjes, që po mendojnë e po sillen, sikur Lëvizja e ka përfunduar rolin e vet, se ajo duhet t'i takojë historisë. Edhe më të ashpra janë mendimet e vlerësimet e individëve apo të strukturave pranë Lëvizjes, të cilët dhe të cilat, në një mënyrë ose në një tjetër, kanë qenë në Lëvizje, ose kanë qenë të lidhura me Lëvizjen. Të tillëve, grupit të parë e të dytë, Lëvizja dhe anëtarët e saj, tani mund t'u duken dhe t'u duhen njëanshmërisht, e shumta, vetëm si servis financiar e kadrovik.

Tani do të mundohem të konkretizohem për çështjen që është thirrur mbledhja.

Shkresën që po shqyrtojmë sot, e shqyrtuam paraprakisht në mbledhjen e Kryesisë. Vetëm se shkëmbyen mendime, përplot shqetësime nervoze, do të thosha, së paku nga ana ime. Vendim nuk morëm, pasi letra, që i ngjan më shumë një urdhri, i ishte drejtuar njëherësh Kryesisë dhe Këshillit të Përgjithshëm.

E kam thënë atëherë, po e them edhe tani, një vendim të tillë, kështu si

është marrë, në formë e në përmbajtje, nuk e miratoj.

Fillimisht arsyetimi sa i përket anës formale. Me cilën të drejtë, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, i një subjekti ushtarak, të them në këtë rast, krejt sovran, merr vendim të kësaj përmbajtje ndaj një Fondacioni që e ka themeluar një subjekt tjetër, gjithashtu krejt i mëvetësishëm – Lëvizja Popullore e Kosovës? Ta zëmë se këto relacione janë kështu. Atëherë kjo do të ndodhte vetëm po qe se Shtabi i Përgjithshëm do të kishte shpallur pushtetin ushtarak.

Thënë të drejtën, aktualisht edhe unë, do të kisha dëshiruar që UÇK-ja të ishte në gjendje ta bënte këtë, po të mos e bënte pa i provuar të gjitha mundësitë politike e civile.

Protagonistët e letrës dhe të vendimit ende të pakomunikuar, argumentojnë se Fondi "Vendlindja thërret" është fond i UÇK-së, prandaj vetëm Shtabi i Përgjithshëm, pas të cilët fshihen këta protagonistë, ka të drejtën sovrane të vendosë për të. Atyre nuk u intereson se kush, kur e për çka e ka themeluar dhe se vetë ata, në ato përgjegjësi, janë dërguar nga Lëvizja ose janë vetemëruar si të Lëvizjes.

Në mbledhjen e Kryesisë, nga Bardhyli u informuam se drejtor i Drejtorisë Financiare të UÇK-së është "emëruar" Azem Syla, anëtar i këtij organi. Për ata që mund të kenë harruar, këtij Organi i thonë Këshilli i Përgjithshëm i Lëvizjes Popullore të Kosovës. Edhe protagonistët që e kanë iniciuar këtë vendim, për të mos thënë se e kanë marrë në mënyrë vetjake, janë gjithashtu anëtarë të Lëvizjes Popullore të Kosovës, e ndonjëri edhe anëtar i këtij organi.

Ky emër, i Azem Sylës, më ka provokuar emocionet e shqetësimet në mbledhjen e Kryesisë, por jo në ato përmasa që m'i provokoi vetë vendimi apo letra. E them këtë, për të mos kujtuar e menduar ndokush se janë në pyetje vetëm inatet personale, dhe jo përmbajtja e letrës, gjegjësisht vendimi. Sa për dëshmi, po sjell një sqarim të përmbledhur. Tre apo katër ditë para se të merrnim me shkrim këtë letër apo vendim, gojarisht e pata mar-

rë vesh nga Bardhyli, në Tiranë, në praninë edhe të Ramiz Lladrovcit, Bilall Sherifit dhe Halil Selimit, se një vendim i tillë do të merrej. Ishte një takim i shkurtër, ku mendohej të jepej incizimi i pjesës përkatëse të mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm, pasi përmbajtja e vendimit me shkrim, hartuar nga Kryetari, Bedri Islami, ishte polemizuar, jo se nuk ishte i saktë, por sepse ishte halli diku tjetër. Ai polemizim ishte rrjedhojë e njerëzve të zgjedhur, të padëshirueshëm për Azem Sylën. Sikur Këshilli i Përgjithshëm të kishte pyetur përpara Azem Sylën se, cilin e preferon ai në atë detyrë dhe të zgjidhej sipas preferencës së tij, atëherë nuk do të na kishin ndodhur, as mosaprovimi i të zgjedhurve, as spekulimet rreth atij vendimi me shkrim, dhe as marrja e një vendimi tjetër, që mendohet të na imponohet. (...)

As që më shkonte ndër mend se Azem Syla mund të ishte ose do të mund të bëhej drejtor i Drejtorisë Financiare, pasi e dija se ai ishte drejtor i Drejtorisë së Logjistikës.

Nuk është e tepërt të shtrohet pyetja: Përse na janë krijuar këto raporte ndërnjerëzore? Paksa e ngatërruar për t'u përgjigjur. Gjithsesi nuk janë fërkime të natyrës personale.

Tashmë është bërë e qartë se unë kundërshtoj dhe kontestoj kryesisht veprimtarinë dhe sjelljet e katër personave. Këta janë Xhavit Haliti "Zeka", Azem Syla, "Daja i vogël", Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, që të gjithë anëtarë të Lëvizjes. Dy të parët, Xhaviti dhe Azemi, janë anëtarë të këtij Këshilli të Përgjithshëm, kurse dy të tjerët, Hashimi e Kadriu, thonë se janë anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së, në Kosovë, por që ende nuk e kanë dëshmuar me ndonjë provë konkrete. Kjo katërshe, fatkeqësisht, i është imponuar ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si "drejtuese" e " komanduese" autokratike, si "Shtab i Përgjithshëm" i saj. Tani, kjo katërshe, po ndjehet e penguar në formën e drejtimit e të komandimit nga ana e Lëvizjes, gjegjësisht organeve të saj drejtuese, Këshillit të Përgjithshëm dhe Kryesisë së saj. Meqenëse iu dështuan spekulimet për të

zgjedhur në organet drejtuese të preferuarit e tyre, ata duan që Lëvizjen ta shndërrojnë në një servis financiar e kadrovik, ose ta mënjanojnë fare. (...)

Mirë do të ishte sikur këto vlerësime e parashikime të miat të mos ishin të vërteta. Fatmirësisht, kam të drejtë të mendoj, bile edhe të them atë që mendoj.

Ky është shqetësimi im kryesor, prandaj nuk dua ta pranoj, as formën dhe as përmbajtjen e këtij vendimi.

E di se Lëvizja Popullore e Kosovës e ka themeluar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, pavarësisht se po bëhen përpjekje për ta mjegulluar mënyrën, datën e vendin e themelimit. Mendoj se kjo po ndodh më shumë si rrjedhojë, se kujt, cilit individ, duhet t'i takojë të zërë vendin në histori si themelues i UÇK-së. Mua, nuk do të më prishte fare punë që të ishin dhe të thuhej se kjo katërshe e ka themeluar, pasi edhe kjo katërshe ishin dhe janë anëtarë të Lëvizjes. Me rëndësi është se dihet se kush e ka themeluar.

Gjithashtu e di se, të paktën Xhaviti, Azemi, Abazi, tashmë i mënjanuar dhe Jashari, tashmë i anashkaluar, janë emëruar anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm nga Lëvizja, gjegjësisht nga ky Organ i saj, duke e fshehur emrin për shkaqe sigurie si Sektor i Rëndësisë së veçantë. (...)

Shqetësimi duhet të ketë qenë, ta zëmë, kërkesa e heroit Fehmi Lladrovci (Lavdi pastë!), për t'i dërguar ndihmë financiare disa "djemve të Drenicës", qysh në vitin 1994. Ai, në kryesinë e KP të Nëndegës së Gjermanisë, kërkoi një ndihmë modeste prej 1.000./DM për ta. Jo më shumë. E arsyetoi kërkesën e tij se, "djemtë në Drenicë", nuk po ndihmoheshin nga asnjë fond i yni dhe se e kishin gjendjen shumë të rëndë. Më vonë mësova se ata, "djemtë e Drenicës", ishin Heroi Adem Jashari me shokë. Për këtë mund të konsultohet procesverbali i atëhershëm. Kërkesa u miratua. Nuk e di se cilit nga anëtarët "e katërshes" nuk i ka pëlqyer ai vendim. Fehmiu, herë pas here, është ankuar edhe në mbledhjet e KP, dhe tek anëtarët e Kryesisë. Nuk ka gjetur mirëkuptim. (...)

E kam thënë edhe në një rast tjetër, por kur gjërat për arsye të ndry-

shme nuk kuptohen, duhet të përsëriten: Në mars ose në prillin e vitit të kaluar, Kryesia e atëhershme e KP, më thirri të jepja llogari për dërgimin e të hollave disa njësiteve të UÇK-së, në disa rrethe të saj. U akuzova për decentralizim. Kjo akuzë u fshi, meqë në pyetjen time, a janë fajtorë ata që po i kërkojnë, a janë fajtorë ata të Shtabit të Përgjithshëm që nuk po u dërgojnë, apo ne (unë dhe shokët e tjerë) që po ua plotësojmë kërkesat. Xhaviti (Zeka) pranoi se ishin shkëputur lidhjet, por ndërkohë ishin vendosur përsëri. Prandaj, unë duhej të ndërprisja dërgimin. Pranova, por me një kusht, që nga brenda të mos na kërkonin më. Nëse nuk do të na kërkonin, kjo do të thoshte se ishin rregulluar vërtet lidhjet dhe një provë se kishte filluar financimi i centralizuar në mënyrë të rregullt. Zotimi i Xhavitit nuk doli i vërtetë. Ndërkohë shtabi i Llapit dërgoi vendimin me shkrim, se duhej t'i dërgoheshin 4 mijë DM në muaj. Pra, shtrohej pyetja për ndihmesën e UÇK-së në Llap, në Prishtinë, në Dukagjin dhe në një hapësirë të caktuar të Drenicës, dhe këto, ishin thuajse të gjitha radhët e atëhershme të UÇK-së. Kjo mënyrë vazhdoi deri në mars të këtij viti, kur ndodhi Epopeja e Prekazit.

Nuk do të ishte pavend pyetja: cilit shtab rajonal, ose më thjeshtë, cilave njësi të UÇK-së në rrethe, iu kanë dërguar furnizim në logjistikë ose në të holla, kjo katërshe, që në fakt ishte vetë Shtabi i Përgjithshëm? Të këtij planeti jemi edhe ne, prandaj nuk duhet spekuluar me ndonjë dezinformatë, ta zëmë se, janë furnizuar e ndihmuar radhë të tjera të UÇK-së, jashtë zonave që përmenda, atje ku nuk kishte, pasi as aksione nuk ndodhnin.

Ndodhi Epopeja e Prekazit! Shpërtheu populli i Drenicës dhe i Dukagjinit, u shkund nga shpërfytyrimi rugovian. Gufoi vetorganizimi i hovshëm i UÇK-së, me karakteristikat e theksuara të kryengritjes popullore, por, fillimisht, e përkufizuar në ato rrethina ku kishte pasur më parë struktura e aksione të UÇK-së.

Ato ngjarje më gjetën në Tiranë. Andej pari i shihja anëtarët e katërs-

hes, sidomos Xhavitin dhe Azemin, ndonjëherë edhe Hashimin e Kadriun. Nuk kishe se si të bindeshe për funksionalitetin e Shtabit të Përgjithshëm, sidomos në terren. Edhe në Shqipëri, hutim e kaos tek ushtarët e UÇK-së. Erdhi në Tiranë Kryesia e atëhershme e KP, për të marrë në dorë drejtimin e situatës. Improvizuan një si shtab. Por shumë shpejt degradoi, pasi Xhaviti dhe Azemi as që donin t'ia dinin se ishin edhe anëtarë të asaj Kryesie, e cila kishte kohë që e kishte humbur funksionalitetin, e cila, në fakt, i kishte emëruar të dy ata, në këtë detyrë, si anëtarë të Sektorit të rëndësisë se veçantë, rrjedhimisht të Shtabit, bile Xhavitin si Kryesues të Sektorit.

Kaos organizativ në Kosovë, kaos në Shqipëri, kaos në emigracion. Katërshja, d.m.th. bërthama e Shtabit të Përgjithshëm, as nuk ishte në gjendje të komandonte, ose, të paktën të drejtonte, apo të kërkonte ndihmë. Ajo ishte zënë e befasuar dhe, njësoj si Kryesia, po improvizonin shtab të përgjithshëm. (...)

Të dëgjosh se Heroit Fehmi Lladrovci, që kur ka hyrë në Kosovë, në mars, e deri kur ka rënë heroikisht, në shtator, nga mekanizmat e shtabit i janë dhënë vetëm një mijë DM, e përsëris, një mijë DM, për shpenzimet e të gjithë njësisë që komandonte, siç u mor vesh, Brigada 114, është më tepër se skandaloze, për të mos thënë siç e ndjej, se është armiqësore. Të dëgjosh të ankohet njëri ndër komandantët e Shalës, Mensur Kasumi, se që kur është zgjedhur komandant, nuk i ka shkuar asnjë urdhër, asnjë udhëzim, asnjë ndihmë financiare, kjo nuk ka se si të mos shqetësojë. Gjithandej ankohen, kërkojnë armë, municion, kërkojnë të holla për nevoja elementare, teknikë komunikacioni, rroba. Përse ndodh kjo? Sepse ata nuk kanë lidhje me Shtabin e Përgjithshëm, me katërshen, dhe, as Shtabi i Përgjithshëm dhe as katërshja, nuk mban lidhje me ata.

Me ndihmën që dha Kryesia e tanishme, u bë bashkimi i "pikave" furnizuese. Ata u vunë nën komandën e Drejtorisë së Logjistikës, drejtor i së cilës u "emërua" Azemi. Vërtet duhej emëruar ai njeri, i cili kishte

kontribuar më së shumti në përçarje e ndasi?

Unë vazhdoj të dyshoj në funksionimin e mirëfilltë dhe me përbërjen e kompletuar të Shtabit të Përgjithshëm. Bile, as bërthama e këtij shtabi, katërshja, nuk e ka funksionalitetin, siç mund të mendohet. Kjo shihet nga vendqëndrimi i tyre, nga përmbajtja e komunikatave dhe e deklaratave politike. Ta zëmë, Xhaviti nuk shkon asnjëherë në Kosovë, Azemi bëhet sikur shkon, ose shkon shumë rrallë, Hashimi e Kadriu shkojnë më shpesh, por edhe atje lëvizin ndaras, për të kryer detyrat e terrenit. Të gjithë merren me gjëra që nuk i takojnë të merren anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm. Përmasat që ka marrë UÇK-ja kërkojnë një Shtab të Përgjithshëm që komandon UÇK-në në mënyrë kabinetike, ashtu siç vetëkuptohet Shtabi i Përgjithshëm. Dhe ai Shtab duhej të ishte sa më pranë fronteve, por në vend të sigurt. Pra, kur dimë se pjesëtarë të katërshes gjenden në Kosovë, në Shqipëri dhe herë here edhe në Evropë, nuk ke ku e gjen kohën, qoftë edhe për mbledhje të rralla të Shtabit. (...)

Unë vazhdoj të dyshoj tek përdorimi i mirë i mjeteve që u janë dorëzuar atyre. Me të hollat që i kemi dorëzuar "shtabit" të "pikës" logjistike furnizuese në Hoxhaj të Tropojës, janë blerë në Shqipëri, thuajse tri herë më shumë armë se sa ka blerë ky grup, bashkë me "pikat" që ka ngritur e komandon Azemi. Me mjetet financiare që kemi dërguar në Bosnje e Kroaci janë blerë thuajse të gjitha armët e sofistikuara që në Kosovë kanë hyrë nga jashtë. Me mjetet që kemi dhënë për uniforma, mjetet elektronike, emblema, etj., kapin tre të katërtat e volumit të përgjithshëm të logjistikës që ka mundur të blejë ky grup i katërshes, së bashku me shokët e Këshillit Qendror të Fondit në Zvicër.

Më kuptoni, me këtë katërshe kam pasur raporte të mira shoqërore, i respektoja dhe i admiroja paksa më theksueshëm se të tjerët, edhe më donin e më respektonin. Nuk kam pasur asnjë arsye private të krijoj këtë mendim kritikues kundrejt tyre. (...)

Është e kuptueshme, më shumë i dua Kosovën, UÇK-në dhe LPK-në,

se sa të katërtit bashkë e cilindo qoftë tjetër. Unë mendoj se veprimtaria e tyre, sjelljet e tyre, e kanë dëmtuar dhe po e dëmtojnë UÇK-në, gjithsesi edhe LPK-në. Prandaj do t'i lusja si vëllezër, që të reflektojnë. (...)

Edhe dy arsye, pse nuk do ta pranoja një vendim të tillë, të njëanshëm: E para, sepse nuk besoj se Azem Syla do të shpërndante financat drejtësisht, sipas nevojave ushtarake. Për këtë, besoj se solla argumente të mjaftueshëm, për ata që duan të marrin vesh. Në këtë gjendje, atij nuk do duhej t'i besohej as kuleta familjare. E dyta; një komunikim publik i Vendimit, si është paralajmëruar, do të sjellë ndalimin e fondit "Vendlindja thërret". Ndokujt mbase mund t'i jetë mbushur mendja se shtetet ku grumbullohen ndihmat në Fond, nuk mund ta ndalojnë aq rreptësisht veprimtarinë e tij. Mashtrohen. (...)

Mund që keqkuptohem si sektar, si fanatik i Lëvizjes, se jam kundër përfshirjes së subjekteve të tjera në Këshillin Qendror të Fondit, se jam që UÇK-ja të jetë monopol i Lëvizjes, nëse mund të shprehem kështu. Përkundrazi, jo pak herë e kam theksuar se, do të duhet të gjejmë personalitete të subjekteve të tjera, t'i bëjmë anëtarë të Fondit, t'i vendosim në drejtim ku e meritojnë. Për bazë ne kemi një kriter të vetëm, përcaktimin patriotik, pranimin e UÇK-së si Ushtri e vetme e Kosovës. (...)«

Shtesë e intervistuesit (Bedri Islami):

Nga diskutimet e gjata të Kelmendit, secila mbi 25 faqe, ai solli vetëm këto pjesë, ndoshta duke menduar se më pas, në botimet e tjera të tij, mund të zënë vend më të plota. Megjithëse me disa nga qëndrimet e tij mund të mos jem i një mendjeje, përsëri, kjo ka qenë fjala e tij në Mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm, dhe më duhet të pranoj se, pjesët e zgjedhura në këtë bashkëbisedim, janë ndër më të "butat", nëse mund të them kështu.Sidoqoftë, Këshilli i Përgjithshëm, jo gjithëherë dhe jo për të gjitha problemet e ngritura, ka qenë i një mendje

me Kelmendin, për të mos thënë se për disa prej tyre, ka patur mendim dhe qëndrim të ndryshëm apo të kundërt.Mbështetja e Shtabit të Përgjithshëm përgjithsisht ka qenë e plotë dhe pa probleme nga Lëvizja, ngjarjet kanë patur sqarimet e duhura dhe kanë gjetur rrjedhime poizitve.

Si e thashë në fillimin e këtij kapitulli, edhe unë përsonalisht, si drejtues i Lëvizjes,për mjaft nga qëndrimet e Kelmendit, nuk kam qenë i një mendjeje. Edhe për Vendimin, për të cilin bëhet fjalë në diskutimin e tij, po ashtu, nuk kemi qenë të një mendjeje. Këshilli i Përgjithshëm i Lëvizjes, me propozimin tim, e miratoi këtë vendim, dhe e bëri të njohur vetëm brenda organizatës. Për hir të së vërtetës, kur ai nuk po zbatohej, në atë formë që ishte ndërmarrë dhe ishte përcaktuar, si hallkë kyçe për centralizimin e tij, e po ashtu, ngaqë këshillat popullore të Lëvizjes nuk e mirëpritën, vendimi u tërhoq, por bashkëpunimi, jo. Ai vazhdoi edhe më tej, dhe jo rrallë herë, edhe vetë Kelmendi, pavarësisht protestës, ka qenë nismës i këtij bashkëpunimi. Shembujt janë të shumtë, ata gjenden në arkivin e organizatës, por herë pas here do t'i gjeni edhe në shënimet e kësaj interviste.

(Sqarim i Kelmendit:)

Diskutimin tim, të parapërgatitur me shkrim, të datës 23 maj, ia shpërndava disa shokëve, anëtarë të KP, por ia dërgova edhe shokëve që ishin në Tiranë, sidomos Xhavitit, i cili, për hir të së vërtetës, i ka ditur mendimet e qëndrimet e mia kritikuese ndaj tij.

Më habiti një ngjarje: disa ditë pas mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm, isha përsëri në Tiranë. Rastësisht ose jo, më takoi oficeri NN, i Shërbimit Informativ Ushtarak. Më tha se e kishin një kopje të fjalës sime të 23 majit. Ishin të shqetësuar

dhe më kërkoi që, me këtë rast, të takoja edhe Shefin e Shërbimit. Pranova, por edhe u habita, sepse nuk e dija se si e kishin siguruar kaq shpejt kopjen. E pyeta, por nuk pranoi të më tregonte rrugën se nga e kishin siguruar. Takova shefin, që ishte i shoqëruar nga NN. Më tha se më njihte, qysh kur kishte qenë me shërbim në Ambasadën Shqiptare në Stokholm, në fillim të viteve 80'ta. Ai shfaqi shqetësimin e tij të trazuar për gjendjen dhe shprehu gatishmërinë e Shërbimit që e komandonte, për të marrë përsipër bartjen e armatimit dhe municionit që i duheshin UÇK-së. E falënderova, por i thashë se me gjithë dëshirën e tij të mirë, këtë gjë nuk do ta pranonin pikërisht ata të cilët i kisha fajësuar për gjendjen si dhe kryeministri Fatos Nano.

Fjalën time të 23 majit e kam përgatitur në një gjendje të rëndë shpirtërore, do të thosha të papërballueshme. Pak ditë më parë, më 9 maj, na e kishin vrarë Ilir Konushevcin, Shefin e logjistikës, dhe ndihmësin e tij, Hazir Malën e Tropojës, në një pritë në Qafën e Malit, kur po udhëtonin drejt qytetit Bajram Curri. Lajmin e morëm kur ishim në mbledhjen pararendëse të Këshillit të Përgjithshëm, në një situatë të ngarkuar, e cila u acarua edhe më tej, deri në shpërthimin e reagimeve të pazakonta, sidomos për një mbledhje të tillë, kur edhe problemet që ishin shtruar, ishin aq të rëndësishme. Megjithëse kishin shkuar disa ditë nga vrasja enigmë e tyre, që edhe tash nuk është zbardhur, gjendja ime, kur po përgatisja fjalën tim, vazhdonte të ishte e rëndë, dhe në botën e asaj gjendje që isha, kërkoja që problemet të zgjidheshin sa më shpejt, sa më drejtë, në të mirë të Kosovës. Nuk kam pasur atëherë asnjë qëllim e bindje tjetër, ashtu siç nuk kam as sot.

Dëshirova të publikohen këto fragmente, si dëshmi dokumentuese, se për zhvillimet e atëhershme, besoj, kam folur në kohën e duhur dhe në organin e duhur.

X. Njerëzit e mirë të luftës

(B.I.:) - Si duket shkuam larg në bisedën tonë. Duke ngarendur, kemi lënë pas vetes disa gjëra, të cilat, edhe mund të duken të vogla në pamjen e parë, përbëjnë në vete gjëra njerëzore. Pra, le të flasim për njerëzit, organizimet e tyre, për ata që hapën portat, që u vunë në shërbim të Luftës dhe të përpjekjeve, me gjithçka kishin, me mendjen, zemrën, por edhe me sakrificën. Besoj se ky është edhe një nderim, sado i pakët ndaj tyre. Nderim për njerëzit e mirë të luftës dhe për vetëdijen e tyre.

Po kthehem edhe një herë te një dukuri që fillon e ndodh në perëndim, te shqiptarët e Kosovës, fill pas shfaqjes së lëvizjes çlirimtare: Afishimi i klubeve dhe shoqatave të ndryshme. Deri tani i je referuar disa herë Klubit shqiptar të Dyzeldorfit, ndërkohë që, siç e dimë, ka pasur edhe klube të tjera shqiptare, si në Bruksel - "Idriz Seferi", në Berlin - "Bajram Curri", etj.

Cilat kanë qenë lidhjet mes Lëvizjes dhe klubeve shqiptare dhe ndërmjet vetë atyre? Cilat kanë qenë lidhjet tua vetjake me klubet dhe drejtuesit e tyre? Dhe, për ta mbyllur me këtë temë, për të mos u kthyer më, cili ishte roli i klubeve gjatë Luftës në Kosovë.

(I.K.:) - Kam rrëfyer se më 26 mars të vitit 1978 formohet Klubi i parë shqiptar në Dyzeldorf, Gjermani Perëndimore, të cilin e pagëzuam me emër të heroit, Emin Duraku. Nisma qe nga nëpunësi i Konsullatës jugosllave në Dyzeldorf, Zenel Syka (nga Gjakova). Ai propozoi për kryetar Enver Maliqin

(nga Shkupi), por disa pjesëmarrës në tubimin themelues nuk e donin atë. Enveri dha dorëheqje pas një jave dhe, në vend të tij nismëtarët zgjodhën Rrahman Begën (Jezerc / Ferizaj). Po atë natë ai u sulmua fizikisht në banesë të tij nga individë që dyshohej se udhëhiqeshin nga Zenel Syka. Pësoi një plagosje dhe rrjedhimisht dha dorëheqje. Pra, Zenel Syka i Konsullatës kishte marrë iniciativën, por po me ndikim të tij, po ndodhnin grindjet. Motivi i Konsullatës për formimin e klubit ishte pengimi i veprimtarisë patriotike të Frontit, siç u informuam më vonë. Konsullata planifikonte t'i grumbullonte emigrantët shqiptarë, që t'i kishte nën kontroll dhe përmes tyre të informohej për veprimtarinë "armiqësore" të Frontit.

Për këto përplasje dëgjova dhe u shkova në ndihmë bashkëveprimtarëve. Ramë dakord që për kryetar të zgjidhnim Nebih Rekën (Norodime / Ferizaj). Dhe ashtu ndodhi, meqë Konsullata nuk dinte për skenarin që kishim përgatitur, se si gjatë tubimit për zgjedhjen e kryetarit të radhës, do të duhej të mbulonin hapësirën me diskutime e propozime vetëm bashkëveprimtarët, duke i bllokuar kasnecët e Konsullatës, siç shquheshin vëllezërit Hamdi e Muharrem Tuba (nga Rrethi i Gjakovës), Hamdi Gashi (nga Llapi) dhe disa të tjerë.

Përplasja e dytë serioze, që zgjati disa muaj, ishte emërtimi. Konsullata dhe kasnecët e saj propozonin që klubi të quhej "klubi jugosllav Emin Duraku", kurse bashkëveprimtarët këmbëngulnin të emërtohej "klubi shqiptar Emin Duraku". Konsullata filloi me kërcënime, që të frikësonte anëtarët që këmbëngulnin të quhej **klub shqiptar**. Kryetari Nebi Reka me Sekretarin Qazim Shala (Mushitisht / Suharekë), kërkuan përkrahje nga Shefqet Hashi, sekretar i parë i ambasadës jugosllave në Bon. Ai ofroi ndihmën e tij dhe në prani të konsullit serb foli se shqiptarëve në Jugosllavi ua garanton Kushtetuta

të drejtat e barabarta nacionale, prandaj shqiptarët nga Jugosllavia, edhe në Dyzeldorf, kanë të drejtë të paraqiten dhe organizohen në klubin e tyre si shqiptarë. U votua kompromisi për emrin "Klubi i punëtorëve shqiptarë nga Jugosllavia Emin Duraku".

Meqë është individ kontestues, vlen të informoj se edhe Jusuf Buxhovi, i pranishëm në mbledhje si korrespondent i gazetës "Rilindja", nuk u përmbajt pa u prononcuar pro mikut të tij Zenel Syka, që të mos përmendej në emërtim cilësimi shqiptar, me arsyetim se gjermanët na njohin vetëm si jugosllavë. Por, meqë Shefqeti aty ishte më i pushtetshmi, e urdhëroi që të bëjë detyrën e tij si korrespondent dhe të mos kundërshtonte vullnetin e punëtorëve shqiptarë.

Aty e tutje bashkëveprimtarët e FKP morën udhëheqjen e Klubit. Në kuadër të Klubit formuam Shoqërinë Kulturore "Aleksandër Moisiu" (me kryetar Isak Gutën nga Shkupi), sektorin letrar (me drejtues Samedin Iljazin nga Tetova), etj. Oda tradicionale që u improvizua në ambientet e Klubit ishte një ambient informimi dhe kultivimi, sepse aty në secilën fundjavë lexoheshin para punëtorëve shkrimet e përzgjedhura të shtypit të Tiranës e Prishtinës, fragmente nga librat që përzgjidheshin nga Isak Guta, Hizri Reka, Samedin Iljazi. Pastaj bëhej diskutim i shtruar, nën përkujdesjen e më të moshuarve: Ali Bega (nga Jezerci), Zyber Kryeziu (nga Opoja), Avdi Begisholli (nga Ferizaj), Jakup Kurtishi (nga Rrethi i Suharekës, vrarë gjatë luftës në Kosovë), Xhemail Nuha (i zhdukur gjatë luftës në Kosovë). Në Klub hapëm edhe shkollën shqipe me mësues të dërguar nga Universiteti i Punëtorëve në Prishtinë, ku mund të mbaronin shkollë 8-vjeçare ata që donin, hapëm kurse të gjuhës gjermane, etj.

Nga Prishtina organizoheshin edhe vizita të krijuesve le-

trarë, një lloj veprimtarie tipike "socialiste", për të frymëzuar punëtorët me poezi. Rastisi të vinte me një grup Sabri Hamiti dhe me tangërllëkun e tij irritoi qindra pjesëmarrës.

Kjo përvojë na bindi për përparësitë e klubeve në edukimin e kultivimin patriotik e kulturor të punëtorëve emigrantë, prandaj veprimtarët e këtij Klubi u angazhuan për themelimin e klubeve të tjera në Bruksel, Berlin, Hamburg, Bielefeld, Kopenhagen, Malmë dhe qytete të tjera, duke u shtrirë pastaj me themelimin e tyre edhe në Zvicër. Kështu kishim nisur një garë goxha inatçore mes nesh dhe përfaqësive diplomatike e Qendrës kulturore jugosllave në Këln (udhëheqës i kësaj të fundit ishte Mitalip Qoqa).

Për të mos e zgjatur, përmes klubeve ne mund të kontaktonim më shumë bashkatdhetarë, t'i informonim e ndërgjegjësonim ata, t'i kultivonim përmes angazhimeve kulturore duke e shtrirë veprimtarinë patriotike në rrethe sa më të gjëra. Kur punëtorët tashmë bëheshin pjesëtarë të masave të angazhuara, nuk frikësoheshin se do të keqtrajtoheshin kur do të shkonin për pushime në vendlindje. Megjithatë, nga themelimi deri në vitin 1982, me sa mbaj mend, qenë burgosur gjatë pushimeve në Kosovë 37 anëtarë të Klubit Emin Duraku dhe do të burgoseshin edhe më shumë veta, po të mos vendosnin që të mos shkonin më në vendlindje.

Në këtë klub vizita të shpeshta kanë bërë Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla, Fehmi Lladrovci dhe shumë patriotë të shquar, të cilët dhanë jetën e tyre për liri të Kosovës. Xhemail Fetahu ishte anëtar aktiv i këtij Klubi.

Po sjell edhe disa angazhime domethënëse të klubit tonë. Kur "qeveria" e Bukoshit bashkë me të gjitha subjektet patëm vendosur të shpallin "Muajin e ndihmave për arsimin shqip në

Kosovë“, Klubi ynë në Dyzeldorf pat mbledhur ndihma financiare më shumë se sa i gjithë emigracioni në Amerikë (paçka se zhurma e tyre vetëlavdëruese ishte në frymën e Rambos). Kështu ndodh edhe gjatë luftës kur ky klub dhe anëtarët e tij, mbledhin përsëri ndihma financiare për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës më shumë se i gjithë emigracioni në Amerikë. Për t'u bindur se cili ishte kontributi i tij, meqenëse po e krahasoj me emigracionin shqiptar në Amerikë dhe organizimet e tyre atje, mjafton të kujtojmë vetëm faktin se nga ky Klub dhe rrethinat e tij, në radhët e UÇK-së janë shumë më tepër se Batalioni "Atllantiku". Me këtë rast nuk e kam ndër mend fare të kontestoj këtë Batalion, i cili, po ashtu, i dha një vlerë tepër të lartë UÇK-së dhe me bëmat e tij ka mbetur përgjithmonë në memorien tonë. Gjithësesisi dëshirova të potencoj nivelin e kontributeve, përmes krahasimi, dhe modestinë tonë, të bëhen punë të mëdha me sa më pak propagandim afirmativ, sepse edhe demonstratat e Pranverës 1981 Klubi në Dyzeldorf nxjerrte më shumë bashkatdhetarë, se sa gjithë emigracioni në Amerikë.

Të njëjtën gjë mund të them për klubin shqiptar "Idriz Seferi" në Bruksel, "Liria" në Malmë, "Ibe Palikuqi" në Hamburg, "Bajram Curri" në Berlin, "Kosova" në Bielefeld, "Besa" në Kopenhagë, etj. Bile, në Kopenhagen e kishim të vështirë të bënim kthesën patriotike, sepse atje ishte ambasador i RSFJ-së, me nder më thënë Sinan Hasani, - më vonë kryetar i Kryesisë se Jugosllavisë, - i cili kishte formuar strofulloxhe aktive të UDB-së. Këto klube ishin qendra të devotshme për kontributin ndaj Kosovës ku, gjatë gjithë kohës do të ndihmohej Lëvizja jonë patriotike me të gjitha mundësitë që kishin.

Më vjen keq, që herë pas here, qeveritarët tanë, por edhe shokët tanë, shkojnë tani në Bruksel, në takime e mbledhje

të ndryshme, e "harrojnë" të shkojnë aty ku kanë qenë dikur në shtëpinë e tyre, tek këta njerëz, të cilët bujarisht na kanë pritur, përkrahur e ndihmuar. Gjatë gjithë këtyre viteve. Nuk mbaj mend asnjëherë të kemi fjetur në hotel, sado të lirë apo të shtrenjtë të ketë qenë, por te bashkëveprimtarët tanë në Bruksel dhe prandaj edhe tani nuk duhet t'i harrojmë, qoftë edhe për faktin se qeveritarët tani i kanë mundë të flejëë në hotele me parat e buxhetit të Shtetit të Kosovës.

Pra, klubet që udhëhiqeshin nga bashkëveprimtarët tanë, qenë shndërruar në vatra patriotizmi. Kurse ca klube që i kishin nën kontroll dhe i komandonin përfaqësitë diplomatike, qenë shndërruar në vatra antishqiptare, siç ishte klubi "Rilindja" në Mynhen, klubi "Përparimi" në Bruksel, klubi "Kosova" në Hamburg, klubi "Isa Boletini" në Shtutgart, etj.

(B.I.:) *- Pas vitit 1981 dhe pas vitit 1993, përkatësisht pas arrestimeve dhe dënimeve të atyre viteve, mjaft ish - të burgosur politikë dolën në Perëndim. Disa prej tyre u përfshinë menjëherë në Lëvizjen çlirimtare, disa të tjerë qëndruan në heshtje. Pra, nga njerëz të sakrificës dhe të angazhuar, kaluan në njerëz të heshtur. Përse ndodhi kjo?*

(I.K.:) - Ku ta di unë. Mbase ata i kishin lodhur e frikësuar torturat barbare, vuajtja e dënimeve të gjata e të rënda në burgje. Nëse këto kanë qenë arsyet e tyre, i quaj njerëzore dhe kam mirëkuptim. Por, ndonjëri duhet të jetë pasivizuar edhe për shkak të zhgënjimit nga zhvillimet politike me të cilat janë ballafaquar kur kanë vuajtur dënimet. Ata duhet të jenë zhgënjyer nga thartimi i turmave, i psikologjisë së tyre që u shkonin prapa liderucëve. Për këtë më vjen keq.

Kishte nga ata që donin të inkuadroheshin në Lëvizjen tonë, Dega jashtë vendit, por edhe ne nuk ditëm t'i mirëpresim, sep-

se në përmasa goxha serioze, Lëvizjen, Degën jashtë vendi, thuajse e përfshiu sindroma e sektarizmit dhe i vetëmjaftueshmërisë. Për mosmirëpritjen e tyre vërtet më vjen keq dhe u kërkoj falje edhe tani për atëherë, sado që edhe atëherë kam "zhurmuar" për atë lloj shkarjeje që po na ndodhte.

Mbase ndonjë bashkëveprimtar, pjesëtar i udhëheqjes së Lëvizjes (jashtë vendi) nuk do të pajtohej me këtë vlerësim timin të fundit dhe mund që do të kërkojë argumente. Le të paraqiten dhe mund të debatojmë, edhe tani si atëherë, për të provuar se nuk ishim gjithaq imunë ndaj sektarizmit, etj.

(B.I.:) *- Edhe para luftës në Kosovë, besoj për të gjithë veprimtarët ka qenë i njohur shembulli i Familjes së Ibush Bytyçit në Paris, së bashku me gruan e tij, Sadijen. Ishte një familje që u dha me përkushtim ndaj idesë së lirisë së Kosovës. Por, si kjo familje, të cilën ju e keni njohur, ka pasur edhe shumë të tjera, si familja Selim Demirit, Dedë Bardhit, (i ati i Fanolit), për të mos përmendur shumë nga këto. Unë, edhe si shenjë nderimi, desha të di për disa nga këto familje, më shumë se sa është thënë deri tani, nga që lidhjet tuaja me to, janë të hershme dhe të qëndrueshme.*

(I.K.:) - Dhuntia e familjeve patriotike, bujare, është tematikë me vete dhe unë, edhe sikur të mund të bëja një libër enkas për to, prapë nuk do ta çmoja të mjaftueshme. Ato kanë qenë streha, çlodhja, çmallimi ynë. Madje, do të thosha, ato ishin faktori kryesor që më kanë regjeneruar energji dhe me kanë ofruar kushte fizike për angazhim të përhershëm. Edhe pse dihet, meqë më pyete, nuk po përmbahem pa rrëfyer se pothuajse 90 për qind të kohës e kam kaluar në rrugëtime dhe prandaj kam pasur nevojë për strehim te këto familje. Janë raste tepër, tepër, të rralla, siç thashë, kur më është dashur ta ka-

loj natën në stacione të trenave, për hotele të mos flasim. Të këto familje mund të shkoja në çdo kohë, pa paralajmërim. Të rrija sa kisha nevojë, të pastrohesha e të ndërroja rrobat. Falënderimin për to e kam të pafund.

Le të më lejohet të përmend vetëm disa prej tyre, sepse lista vërtet do të ishte shumë e gjatë. Po filloj nga Veriu, Norvegjia, për të shkuar drejt Jugut.

Në Norvegji:

Isa Thaqi (Oslo / Dubovik), Nufri Leka (Oslo / Pejë), Jashar Etemi, etj.

Në Suedi:

Shehide e Xhemajl Duraku (Malmë / Prishtinë), Shpëtime e Musli Fida (Malmë / Strugë), Shefkate e Nexhmi Sherolli (Norkoping / Lund /Mitrovicë / Pogradec), Ramadan Shala (Male / Pejë, Lena e Sherif Gjonbalaj (Engelholm / Vuthaj), etj.

Në Danimarkë:

Familja e Avdulhalim Kasamit (Kopenhagen/Tetovë),

Ismail Sulejmani (Kopenhagen / Tetovë), Xhemil Zeqiri (Kopenhagen / Tetovë), Emine dhe Ibrahim Xhemaili (Kopenhagen / Ferizaj), Remzi Loku (Kopenhagen / Tetovë), etj.

Në Gjermani:

Zymer Prekaj (Hamburg / Pejë), Muhamet Elshani (Hamburg / Pejë), Muhamet Ibrahimi (Hamburg / Tetovë), Mari e Jochaim Streicher (Bremen. Pothuajse katër vite kam jetuar tek ata pa paguar qira dhe me ushqimin e tyre), Have e Zylbehar Beshiri (Bremen / Gostivar), Halime e Zymer Shabi (Osnabryk / Pejë), Marie e Mark Bardhi (Bochum / Pejë), Hajrie e Dedë Bardhi (Bochum / Pejë), Hateme e Selim Demiri (Bochum / Gjakovë), Idriz Bajraj (Bochum / Istog), Lazar

Dodiq (Bochum / Janevë), Nurije e Mustafë Mekaj (Mylheim Ruhr / Pejë), Musë Daka (Duisburg / Suharekë), Have e Ramiz Iberdemaj (Paderborn / Pejë), Samedin Iljazi (Dyzeldorf / Tetovë), Vezire e Sylë Nuha, Haxhi Bega, Nazmi Nuha, Mursel Nuha, Nebih e Hisri Reka, Qamil Rexhepi (Dyzeldorf / Ferizaj), Imerja Qamili (Tetovë / Dyzeldorf), Imer Duka (Bonn / Deçan), Isa Elshani (Siegburg / Gllogovc), Veton Shasivari (Këln / Mitrovicë), Suzana, Jusuf e Bardhosh Gërvalla (Untergruppenbach / Deçan), Nami Ramadani (Esslingen / Tetovë), Sabrije e Vadat Jusufi (Shtutgart / Strugë), Zade e Fahredin Tafallari (Nagold / Prizren), Hajrie e Ukë Dreshaj (Shtutgart / Pejë), Qemal Bajrami (Nyrnberg / Dibër), Bajram e Rifat Mulaj (Berlin / Istog), Ahmet Meta (Berlin / Istog), Michael e Dashamire Stenger (Mynhen / Gostivar), Wolfgang e Leta Stoppel (Mynhen / Greqi), Xhemajl, Ibrahim e Kadri Ipek (Erlangen / Turqi / Istog), Ramë Mehmeti (Erlangen / Pejë), Isuf Gysel (Erlangen / Pejë / Turqi), Shkurte e Mustafë Ibërdemaj (Nyrnberg / Pejë), Zade e Hysen Iberdemaj (Nyrnberg / Pejë), Vebi Bajrami (Frankfurt / Gjilan), Safet Azizi (Vupertal / Shtimje), Sylejman Haxhai (Vupertal / Pejë), Malush Ademaj (Vupertal / Pejë), etj.

Në Belgjikë:

Sheribane e Muharrem Berisha (Bruksel / Kumanovë / Turqi / Deçan), Fatime e Ernest Vatansever (Bruksel / Tetovë / Mitrovicë / Turqi), Sefer Haxhijaj (Bruksel / Istog), Aferdita e Sadik Tolaj (Bruksel / Prizren / Deçan), Hysen, Smajl e Avdullah Haxhijaj (Bruksel / Istog), Sabit Ukshini (Bruksel / Gjilan), Mustafë Mustafa (Namyr / Preshevë), Hashim Shala (Namyr / Klinë), Xhemë Ismaili (Bruksel / Istog), Sheribane e Basri Reka (Bruksel / Ferizaj), etj.

Në Zvicër:

Rexhep Halimi (Cyrih / Shtërpcë), Familjet Dakaj (Cyrih / Lipjan), Hasan Kadrija (Friburg / Preshevë), Shyqri Ukshini (Gjenevë / Gjilan), Mirëvete e Mustafë Xhemajli (Biel / Komogllavë), Vera e Gafurr Elshani (Aarau / Suharekë), Bardhy Mahmuti (Lusan / Tetovë), Muhamer Shabani (Biel / Gjilan), Fazli Veliu (Lucern / Zajaz), Ali Ahmeti (Lucern / Zjaz), Musa Xhaferi (Lucern / Zjaz), Avni Dehari (Bern / Kumanovë), etj.

Në Francë:

Sadije e Ibush Bytyçi, Besim Elshani (Paris / Suharekë), Avni Ndreca (Paris / Suharekë), etj.

Në Holandë:

Piktori akademik Qenan Sheji (Amsterdam / Veleshtë).

Në Amerikë:

Ahmet Zherka (NY / Tropojë), Ndue Camaj (NY / Tuz), Gjergj Kalaj (NY / Tuz), Kolë Gojçi (Detroid / Tuz), Tomor Lleshi (Çikago / Dibër), Familjet Bruçaj (NY / Plavë) e të tjera, e të tjera pa fund.

Gjithsesi, kërkoj mirëkuptim nga shumë familje që me këtë rast nuk po ua përmend emrin.

Secila nga këto familje ka qenë e vetëdijshme se po strehonte "armikun" e Jugosllavisë dhe prandaj do të kishin pasoja kur do të shkonin për pushime në vendlindje, nëse UDB-ja do të merrte vesh se po më strehonin, qoftë mua, qoftë shokët e mi. Megjithatë, secila na ka strehuar, kurdo që kemi pasur nevojë. Burrat më kanë mirëpritur si vëllanë e tyre, po asgjë më pak edhe bashkëshortët e tyre.

Sa për ilustrim, po sjell një shembull fatkeq dhe të vrazhdë. Në vitin 1980, UDB-ja në Prizren burgos një bashkëveprimtar

nga të lartpërmendurit. Ai pranon se po më strehonte në banesë, me arsyetim se mysafiri kur të troket në derë, mirëpritet. Por, udbashi pis, provon ta godasë në sedër duke i thënë: "Si ia ke besën ta lësh brenda edhe kur ti shkon në punë? Ai është student, i zhvilluar fizikisht, ti ke grua të re...". Bashkëveprimtari, nga inati, i përgjigjet: "Vetëm le të angazhohet për çlirimin e Kosovës, punët e tjera janë të familjes sime". Për të këtillë "kundërvajtje" e dënojnë me 6 muaj burg.

Besoj, pos që me kanë bërë nder dhe ndihmë, edhe këto familje duhet të kenë përfituar nga prania ime, sepse burrave dhe grave u flisja për emancipimin, për nevojën që edhe gratë të angazhohen për çlirimin tonë, etj. Pikërisht nga këto bashkëbisedime ka rezultuar të kemi shoqe të devotshme, kontributi i të cilave ka pasur vlerë e rëndësi vërtet tepër të çmuar. Me dëshirë do t'i veçoja disa emra, por e kam të vështirë të bëjë përzgjedhje, pasi edhe tani vazhdojmë të ruajmë afërsinë e dikurshme, sikur vërtet të kishim qenë një familje dhe të kem qenë vëllai i gjithë atyre motrave. Pastaj kam këshilluar fëmijët, jam interesuar për hallet dhe shkollimin e tyre. Ndonjëherë nuk harrojnë edhe tani të më shprehin mirënjohjen edhe për këto angazhime, kurse vetë ata, fëmijë të dikurshëm, tani i kam miq, shoqe dhe shokë.

Shpesh kur më duhej të shkoja ndokund dhe nuk kisha adresë familjeje që do të më strehonte, për të mos e kaluar natën në stacione trenash, gjeja emra shqiptarësh në librin e telefonit të qytetit përkatës, u telefonoja dhe u shkoja mysafir. Nëse do të më thoshin në telefon, se nuk më njihnin, përgjigjesha se po u shkoja edhe për t'u njohur.

Parathënia e përfaqësimit politik të UÇK-së

(B.I.:) *- Menjëherë pas afishimit të UÇK-së, në perëndim, Lëvizja si themeluese e mbështetëse e saj, bën të mundur ngritjen e disa grupeve, të cilat angazhimin themelor kishin vendosjen e kontakteve me diplomacinë perëndimore. Kjo do të jetë, në një farë mënyre, parathënia e grupit politik të marrëdhënieve me jashtë të UÇK-së. Si u ndërtuan këto grupe, cilët bënin pjesë dhe çfarë veprimtarie zhvilluan?*

(I.K.:) - Përfaqësuesit politik të UÇK-së në Perëndim janë caktuar nga Kryesia e Lëvizjes, në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm. Më aktivët kanë qenë Bardhyl Mahmuti, Sabri Kiçmari, Pleurat Sejdiu, Xhevat Bislimi dhe Dino Asanaj, do të thosha. Le të më falin të tjerët, angazhimet e të cilëve për momentin nuk më kujtohen.

Edhe Sektori i Lëvizjes për marrëdhëniet me të huaj është marrë pothuajse me po këtë veprimtari.

(B.I.:) *- Besoj se nuk ka qenë kurrë e mjaftueshme fjala e mirë dhe përgëzuese për Grupin e Përfaqësuesve Politikë të UÇK-së në Perëndim, të cilin e drejtonte Bardhyl Mahmuti. Vazhdoj të mendoj se askush më mirë se ata nuk mund ta kryente këtë punë, e cila, sa ishte e vështirë, aq edhe kërkonte impenjim të lartë, devotshmëri dhe aftësi politike. Njerëzit e afruar pranë Bardhylit ishin të denjë për të marrë përsipër një gjë të tillë, ku do të shquheshin Bilall Sherifi, Ramadan Avdiu,Sabri Kiçmari, Jashar Salihu, Pleurat Sejdiu, Xhevat Bislimi, ndërsa vetë roli i Bardhylit ishte i jashtëzakonshëm. Grupi ka pasur edhe një zanafillë të mirë, do të thosha të jashtëzakonshme, në takimin e parë afirmativ me përfaqësuesit e Departamentit*

të Shtetit amerikan, e pastaj me Zotëri Hollbruck-un dhe të tjerë. Në këtë takim, i cili u organizua me kërkesën e shtetit amerikan dhe me ndërmjetësinë e shtetit shqiptar, do të jenë tre shokë të njohur për vizionin e tyre dhe për përkushtimin ndaj çështjes: Bardhyli, Bilall Sherifi dhe Ramadan Avdiu. Mirëpo, e gjitha kjo ndodh jo në kohën kur do të ishte edhe më e dëshiruar, por sidoqoftë ishte në kohën e duhur. Duke u kthyer vetëm pak në kohë, desha të të pyes: A kishte ndonjë shenjë mirëkuptimi për UÇK-në dhe krijuesen e saj, LPK-në, pas fillimit të aksioneve guerile, nga mendimi politik evropian apo nga kancelaritë e tyre, qofshin këto sinjale edhe të heshtura apo të thëna në mirëbesim?

(I.K.:) - Thënë të drejtën, mirëkuptimi i tyre ka qenë tepër i vonuar. Kështu ndodh rëndom. Presin derisa të binden se e ke seriozisht dhe pastaj të njohin e të përkrahin, por ndonjëherë përkrahja e qeverive vonon shumë. Më mirë do të ishte të informojnë ata që janë marrë konkretisht me këtë veprimtari. Ndërkombëtarët na kanë dëgjuar me vëmendje dhe ne kishim për detyrë t'i bindnim se e kishim me gjithë mend. Por ata parapëlqenin *status quon*, siç ndodh rëndom, prandaj e lavdëronin "pacifizmin" e Ibrahim Rugovës, ndërsa mjeranët "pacifistë" këtë e quanin përkrahje dhe vlerë. Më duhet të nënvizoj se takimet e para do të ishin në nivele të shkallës së katërt, thjeshtë për t'u njohur, pa marrë përsipër asnjë impenjim, pa dhënë asnjë mendim ose ndonjë shenjë se ishin duke na kuptuar. Herë-herë mendoja se ata njerëz ishin të akullt, por duke e ditur natyrën e diplomacisë evropiane, sidomos atë gjermane, përpiqesha të kuptoja edhe pas heshtjes së tyre. Kishte një nënvizim të përhershëm për ruajtje nga aktet ekstreme. Sikur u interesonte më shumë që të mos bënim "zhurmë" në vendet ku jetonim, u dukej sikur Kosova ishte larg dhe se qetësia do të ru-

hej edhe për një dekadë e më shumë. Kishte edhe raste kur nuk e besonin se seriozisht mund të kishte lëvizje të tjera, veç asaj pacifiste. Pastaj gjërat erdhën duke u rritur, takimet u bënë më të shpeshta dhe filluan të organizohen seminare, konsulta dhe ata nuk po i bënin më me zyra të zakonshme, por me struktura që lidheshin me çështjet e sigurisë, siç ndodhi në Bon.

Për raste konkrete, takime dhe bisedime, nuk parapëlqej të ndalem, pasi shumë syresh nuk ishin për t'u bërë publike dhe unë nuk dua të jem i pari që prek këtë sferë. Është jashtë terrenit tim.

(B.I.:) *- Lëvizja natyrisht që herë pas here ka qenë objekt i studimeve, vëzhgimeve dhe, pse jo, edhe i përndjekjes nga qarqe të ndryshme politike ose jo politike, por të lidhura me politikën. Këto u shpeshtuan me shfaqjen e UÇK-së. Edhe unë e kam në kujtesë Takimin në Bon, ku ishim të dy të ftuar, ku fjalën kryesore e kishin ushtarakë të lartë të këtij shteti. Mund të them edhe fjalën e fundit. Si e keni ndierë këtë, qoftë si Lëvizje, qoftë si person, sidomos deri në vitin 1997, meqë pas kësaj, këtë e kam përjetuar edhe vetë?*

(I.K.:) - Them se shumë shpejt, qysh në vitet e para në ekzil, kam pasur pritshmëri realiste. Për këtë duhet të më ketë ndihmuar më së shumti angazhimi në lëvizjen studentore, e cila në ato vite ishte skajshmërisht e politizuar. Qysh atëherë kuptova se çfarë realisht janë pushtetet "demokratike", "socialiste", sido që ta quajnë ato veten e tyre; çfarë interesash egoiste kanë shtetet, të cilat prej kohësh janë kapur dhe shndërruar në shërbim të kapitalit, të oligarkive financiare, etj., etj.

Në anën tjetër, kam pasur tepër herët shumë kontakte me njerëz në ekzil, të angazhuar edhe ata në lëvizjet e tyre çlirimtare.

Qysh kur jam angazhuar dhe deri në mbarim të vitit 1999, edhe kam përjetuar survejimet dhe përndjekjet që na kanë bërë

strukturat përkatëse të shërbimeve e institucioneve të sigurisë, sepse ato janë në shërbim të shteteve të tyre, ndërkohë që ato shtete interesoheshin ta kishin mirë me Jugosllavinë, për hir të konjukturave politike e ekonomike të tyre.

Thjesht, këto shtete, më në fund, i ka detyruar kthesa amerikane, më konkretisht, fitorja e demokratëve në Amerikë, që të intervenojnë kundër agresionit fashist të Serbisë. Është me interes, prandaj, të studiohen arsyet e kthesës amerikane. Për ata që nuk e dinë, Amerika ka qenë sponsorizuesja kryesore financiare, ushtarake e politike e Jugosllavisë, që nga viti 1948 deri në vitin 1992.

Sa me fat isha që kalova dy ditë me një personalitet të shquar amerikan gjatë lufte (ndoshta tetor 1998), pa ditur se cili ishte me të vërtetë dhe për këtë e falënderoj mikun Xhakli, që ishte shoqërues i tij dhe e kishte bindur të më takonte. Dhe ai ishte hiç më pak se shefi i CIA-s për Ballkan. Ndërsa ajka e mrekullisë ishte vetë Klintoni, që erdhi në pushtet me konceptin e tij humanitar.

Populli ynë që me fat. Personalitetet që kanë shumë influencë në politikën operative amerikane, shefi i CIA, Teneti, ishte me origjinë shqiptar, me nënën nga Tepelena dhe babanë nga Himara; shefi i CIA për Ballkanin, në vitet 1985-99, ishte shqiptar me origjinë nga Zymi; Sekretare e Shtetit ishte Lokemadhja, Ollbrajt. Po të kishin qenë proserbët, si Igalbergeri, Bejkeri, Rajersoni, Skofvorfi, etj., jam më se i bindur se qeveria amerikane nuk do të kishte intervenuar, rrjedhimisht nuk do të ishte angazhuar NATO. E kundërta do të kishte ndodhur.

Duke qenë realist në pritshmëri, parashikoja se vetëm sakrifica jonë duke të provokuar Serbinë që të bëhet skajshmërisht agresive, do ta detyronte Perëndimin për të intervenuar, sepse

pushtetarët në Perëndim duhet të ruajnë imazhin e tyre, sado minimal, para qytetarëve të tyre votues.

Merita kryesore e Ushtrisë sonë, edhe kur ajo nuk ishte ushtri në kuptimin mirëfilli të fjalës, sidomos në fillim të luftës, është se ka provokuar Serbinë, që të bëhet superagresive. Ndërkaq merita kryesore dhe kulmore e Jasharëve, sakrifica e tyre është se ka prekur ndjesitë e çdo qytetari të ndërgjegjshëm dhe i ka dhënë shkëndijë shpirtit kryengritës.

Po konkretizoj me një shembull tepër shpjegues. Kancelari i sapozgjedhur gjerman nuk mundi t'i thoshte jo Presidentit Klinton, sa i përket ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë. Ngaqë i tha PO, partia e tij deshi ta rrëzonte nga posti. Ajo thirri kongres të jashtëzakonshëm. "Pacifistët" (proserbët) kishin shumicën në kongres. Po prisnin që përqindjen ta rrisnin sapo të mbante fjalim edhe moralisti Erhard Eppler, tashmë veterani më i moshuar dhe më me ndikim në SPD dhe në socialdemokracinë evropiane. Secilin minutë po e përjetoja me ankth, si i pranishëm në atë kongres. Shpresat i kisha mbështetur vetëm tek Erhardi, i cili kishte biseduar sa herë me mua dhe Sabri Kiçmarin për ta përgatitur atë fjalim. Më pak prisja nga Hans Koshnik, i cili, gjithashtu kishte biseduar me ne. Edhe "pacifistët" po prisnin me padurim Eppler-in, por ata për interesa të tyre – që ta rrëzonin Kancelarin Schröder. Dhe doli Erhardi. Mbajti fjalim historik. I bëri me vaj shumicën e delegatëve. Ata që nuk besojnë, mund të gjejnë në arkiva incizimet televizive. Shpëtoi Shrëderi. Secili analist komentonte: *fal Erhardit*. Përtej modestisë, them se ishim me fat që kishim gjetur lidhjet për ta informuar Erhardin (dhe gjatë informimi nuk po i mbaja dot lotët, po sytë i qenë njomur edhe atij), apo ndoshta ditëm t'i gjenim lidhjet. Dikush do të thoshte, punë

e madhe, edhe po të kishte rënë kacelari gjerman, amerikanët do të intervenonin vetëm! Nuk e besoj.

Pra, përjetimet kanë qenë ndonjëherë tepër terrorizuese, sepse duhej përqendrim i sforcuar dhe mirë i menduar, për të bindur e përvetësuar ndërkombëtarët.

Kaq për këtë tematikë kësaj radhe. Shpresoj të kem kohë e vullnet për ta trajtuar ketë tematikë më me nge e më me përkushtim.

Takimi i Brukselit, një ngjarje e panjohur

(B.I.:) - Shumë gjëra që kanë ndodhur në Kosovë janë mbajtur në distancë nga Kryesia e Organizatës, mendoj se kjo ka qenë e drejtë,ata kanë gjalluar vetëm, brenda saj dhe ndonjë strukture të saj. Kjo, ashtu si ka bërë të mundur të ruhen brenda një grupi të vogël njerëzish sekretet e ndryshme, e domosdoshme kjo për kohën e luftës, ashtu ka bërë që problemet të grumbullohen e herë pas here edhe të mahisen. Pastaj ka ndodhur që, kur kanë shpërthyer, ata kanë qenë ose me zgjidhje të vonuara ose zgjidhja ka qenë e pafrytshme. Mendoj se një mbledhje e tillë ka ndodhur edhe në Bruksel, para shpërthimit të luftës. Për këtë takim, disa ditor, është folur fare pak, krejt përciptas, për të mos thënë se është lënë në heshtje, ndërsa ai, për mendimin tim, ka qenë tejet i rëndësishëm. Me sa mbaj mend është zhvilluar në fundin e vitit 1997, në klubin "Idriz Seferi". Mendoj se ka ardhur koha të flitet më gjatë për këtë takim? Konkretisht, si lindi ideja për të, kush e organizoi, si u bë organizimi i tij, kush mori pjesë, cilat probleme u shtruan, me çfarë u ballafaquat, çfarë konkluzionesh u arritën?

Pra, brenda një pyetje, janë disa të tilla. Do të doja një përgjigje të zgjeruar për të gjitha, dhe jo, siç është në stilin tënd, nganjëherë telegrafik.

(I.K.:) - Po me vjen pak si zor ta torturoj memorien për ndodhi kaq konkrete dhe mbase nuk rezulton gjë, sepse trurit, me kalim të kohës, i reduktohen kapacitetet mbamendëse që ka.

Fillimisht rrethanat para mbledhje janë me rëndësi.

Zhvillimet në Kosovë po precipitonin me shpejtësi, sepse Serbia kishte ndarë mendjen për të na dhënë goditjen asgjësuese. Organizata në përgjithësi, e sidomos në Kosovë, strukturat e saj të përfshira në UÇK, brenda e jashtë vendit, e ndienin se një gjendje e re po vinte, e prisnin atë dhe kishin marrë ato masa që ishte e mundur në atë kohë, me atë përvojë, forcë e logjistikë që kishin. Por edhe aq sa ishte bërë e po bëhej, sidomos në fundin e vitit 1997 dhe fillimin e vitit vijues, ishin të rëndësishme. Shfaqja e përfaqësuesve të UÇK-së në varrimin e mësuesit H. Geci, si paraqitje e parë publike e tyre, dëshmoi një fakt të rëndësishëm: Qëllimi i parë i Lëvizjes, për ta futur në mendimin e popullit mbështetjen për njerëzit e luftës, ishte arritur. Populli dëshmoi se, me gjithë qëndrimin qyqar të "pacifistëve" ishte i gatshëm të përballonte luftën. Më pas u dha shenja e dytë, rrethimi në muajin janar 1998 i Familjes Jashari dhe përballimi i këtij rrethimi. Ndërkohë kishin ndodhur edhe disa luftime të tjera, të cilat dhanë jo vetëm shpresë, por ishin edhe sinjal lufte. Pra, Lëvizja në tërësi, si organizëm politik dhe UÇK-ja në veçanti, si organizim luftarak, ishin në pritje, gjithnjë me mendimin se " kur të thahet toka në Drenicë, do të fillojë sulmi serb". Kjo ishte pranvera. Pra, dy mundësi që vareshin nga Lëvizja ishin arritur në një shkallë të ndjeshme: përgatitja e strukturave dhe mendësia e popul-

lit. Ajo që mungonte ishte logjistika, por në atë kohë dikush tjetër grabiste mjetet financiare dhe Lëvizja kishte mbetur e vetme në mundësinë e saj.

Unë vazhdoj të mendoj se në atë kohë po krijohej një kontradiktë, të cilën unë mund të vëreja. Ndryshe nga sa ndodhte në Organizatë dhe sidomos në strukturat e saj në Kosovë, kryesia tashmë po u shkonte ngjarjeve pas dhe, kisha përshtypjen, se herë pas here nuk po mundej t'i përcillte as si agjenci lajmesh. Thjesht po vonohej.

Siç e kam përmendur, pa qenë fare anëtar Kryesie kisha filluar të shqetësohesha qysh në vitin 1996, sepse detyrimi i tri zonave ushtarake, për të kërkuar mjete financiare nga Nëndega e LPK-së në Gjermani ishte për mua shqetësuese. Kryesia nuk po merakosej, pse ato zona po i kërkonin, por pse ne po ua dërgonim. Anëtarët e Kryesisë, më vjen keq ta them, sikur tashmë ishin shoqëruar e familjarizuar në ato përmasa, sa asnjëri nuk po interesohej të vëzhgonte punët e tjetrit. Në rastin konkret, nuk po interesoheshin të kërkonin llogari prej Sektorit të rëndësisë se veçantë (bërthamës, të menduar si shtab i përgjithshëm, i cili duhej të formohej e konsolidohej). Kurse Kryetari i Kryesisë, bashkëveprimtari i kamotshëm, vetëm tani po më bindte se nuk e kish as shtatin dhe as konstruktin për të qenë në këtë funksion, në këtë situatë kulmore. Muhamet Kelmendin, nënkryetar, e kishte kapluar dëliri i madhështisë prej shkencëtari të drejtësisë, akoma me shumë, edhe teoricien i luftërave çlirimtare. Ai as donte t'ia dinte pse ne të tjerët nuk po e kuptonim. Megjithatë donte të imponohej se kishte gjetur thembrën e Akilit – njëfarë fronti..., në kohën kur as 5-6 veta në Kryesi sikur nuk ishin bashkë dhe nuk po e dinin për çfarë ishin bashkë. Emrush Xhemaili, Gafurr Elshani dhe Ali Ah-

meti, me gjithë përkushtimin e tyre, sikur nuk po pajtoheshin me realitetin e hidhur, se prej kohësh shoku i tyre i ngushtë, Xhavit Haliti, dukej sikur ua kishte kthyer shpinën. Nga zhgënjimi befasues dhe dëshpërues, ata as nuk ishin në gjendje t'i kërkonin llogari, nga se dinin se ai nuk do t'u jepte më. Nuk kishin kurajë as të kërkonin ndihmën e Këshillit të Përgjithshëm, meqë dëshironin të shijonin kënaqësinë, sikur po ia dilnin ta fshihnin gjendjen e rëndë, që do të thotë, sikur po vazhdonin të na mashtronin se ishin të suksesshëm.

(B.I.: / Nderhyrje:) *- Në pohimin tënd mendoj se ka dy mangësi; së pari, nëse e pranojmë se disa nga drejtuesit e kryesisë nuk ishin, si i thonë, të aftë të merrnin përsipër atë që shtronte koha dhe, të tjerët, të qëndronin në heshtje, atëherë përse sektori i veçantë, më i rëndësishmi që ka pasur ndonjëherë organizata, duhet të mbështetej tek ata. Së dyti, si e ke cilësuar, ushtarakët, kur erdhën në Tiranë, ishin të bindur se gjendja e UÇK-së dhe e vetë Kosovës në pragun e luftës, ishte shumë më e mirë se sa në vendet e tjera të ish-Jugosllavisë,në të njëjtën periudhë, se ishin ngritur strukturat. Atëherë kush kishte influencuar në këtë ngritje?Mendoj se kryesia e organizatës ka rolin e saj, e sektori i veçantë, po ashtu. Nuk mund të ketë një ndarje të thikëzuar mes gjërave që kanë ndodhur, ato kanë ndikim tek njëra-tjetra.*

(I.K.:) - Më lini ta shtjelloj deri në fund mendimin tim. Unë këtë gjendje e kam konstatuar asaj kohe dhe këtë e kam thënë. Jo sot, por kur ishte vendi e koha e duhur. Megjithatë, kishte nga ata që mendonin se kishin zgjidhje konkrete – shkuarjen e tyre në Kosovë, për t'i dhënë infuzion UÇK-së së goditur rëndë. Ky ishte Fehmi Lladrovci. Pasi ishte konsultuar me shumë ushtarakë, pasi ishte konsultuar me "Grupin e Drenicës", siç

po e quanin disa individë Adem Jasharin dhe bashkëluftëtarët e tij, Fehmiu kishte motivuar trima të përzgjedhur që të shkonin në Kosovë. Por realizimin e shkuarjes e mendoi gabueshëm, nga se kërkonte leje nga Kryesia jokompetente. Dhe Kryesia nuk po ia miratonte kërkesën, sepse Xhavit Haliti dhe Azem Syla, tashmë përvetësues *de fakto* të Sektorit të rëndësisë se veçantë, ishin kundër. Po përse ishin kundër? Bënin këtë pyetje Kryetari, Nënkryetari, Sekretari dhe anëtarët e tjerë të Kryesisë? Sikur nuk pyesnin, as veten e tyre, as njëritjetrin. Ata u mjaftuan fillimisht t'i thoshin jo Fehmiut, me arsyetim se shtabi i përgjithshëm, kishte refuzuar. Pakkush po pyeste, vërtet kishte shtab në atë kohë e në ato rrethana? Ndërsa mua po më shqetësonte vazhdimisht kjo pyetje dhe me ato pak të dhëna, (meqë më shumë të dhëna nuk kisha nga t'i siguroja, sepse edhe Kryesia, edhe Sektori, në emër të konspiracionit, kishin kyçur gojët) kisha formuar bindjen se shtabi tashmë ishte vetëm emër fiktiv sado që kishte pasur përpjekje për ta formuar e konsoliduar.

Fehmiu dhe grupi rreth tij ishte mbështetur më shumë tek Aliu, nga se po prisnin më shumë prej tij. Por as ai, as ne, ende nuk dinim se Xhaviti dhe Azemi e kishin mënjanuar atë. Në atë gjendje, atij po i vinte keq prej Fehmiut dhe bashkëveprimtarëve të tij, që kishin vendosur të shkonin në Kosovë, meqë po detyrohej të arsyetonte refuzimin e Xhaviti dhe Azemit. Edhe Fehmiu po me hidhëronte, sepse i kisha thënë disa herë, mos prit lejen e tyre, sepse nuk janë kompetentë për të thënë po as jo. Megjithatë ai shquhej për disiplinë, donte të respektonte e zbatonte hierarkinë e Organizatës dhe të Ushtrisë.

(B.I.:) *- Më duket se përsëri je i gabuar në kohë, sidomos për sa i takon pozicionit të Aliut në këtë periudhë. Kërkesa e grupit, i cili mund të quhet, Grupi i Fehmi Lladrovcit, kërkesën*

e parë për të qenë pjesë e radhëve të UÇK-së, e ka bërë para ngjarjeve të janarit 1997,kur ndodhën arrestimet dhe vrasjet e shokëve. Kërkesa e tyre është trajtuar më urgjentisht pas këtyre ngjarjeve, ku u bë edhe më e domosdoshme vajtja e këtij grupi në Kosovë. Sipas bisedës me Xhavit Halitin, ai nuk ka qenë kurrë i interesuar të pengojë kënd të futet në Kosovë dhe as që ka mundur ta bëjë këtë. Ndërsa Ali Ahmeti, në këtë periudhë, ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe njëri ndër njerëzit kryesorë në ndërlidhjen e strukturave të luftës në Kosovë. Edhe pas arrestimeve, ai nuk i kishte humbur lidhjet, ashtu si kishin lidhje të tjera edhe anëtarët e kryesisë të caktuar për këtë qëllim. Nëse Aliu mund të quhet i mënjanuar nga funksioni i tij,kjo ka ndodhur pas majit të vitit 1997, por ka qenë një mënjanim i padeklaruar dhe jo i saktë, pasi ai e ka vazhduar gjithnjë detyrën e tij. Nga ana tjetër, nuk duhet harruar se pikërisht kjo kryesi, më pas, e miratoi kërkesën e Grupit për të hyrë në Kosovë dhe për realizimin e këtij misioni caktoi dy shokë nga sektori i rëndësisë së veçantë, Ali Ahmetin dhe Xhavit Halitin.

Dhe diçka tjetër. Fehmiu kishte zgjedhur rrugën e drejtë. Ai, bashkë me shokët që e shoqëronin, mes tyre edhe Xheva, donin të shkonin në mënyrë të organizuar për disa arsye kryesore. Së pari, Fehmiu kishte qenë gjithnjë një njeri i strukturave, i ndërtuar në atë mënyrë që, me gjithë karakterin e tij të jashtëzakonshëm, përsëri ishte një njeri që i bindej jetës organizative. Pra nuk ishte rebel ose një njeri i rebeluar, siç ishe shpesh herë ti. Pastaj, ai kërkonte që shokëve në Kosovë t'u jepte mesazhin e qartë se atje nuk ka shkuar si një njeri fillikat, në kokën e tij dhe pse ashtu iu mbush mendja, por mbi bazën e një vendimi dhe kjo do të thoshte se shtabi ekziston, se organizata është e pranishme. Së fundi, ai e mendonte dhe e dinte se lufta do të ishte e ashpër, dhe nëse do të shkëputeshin hallkat, kjo do ta

bënte luftën të pamundur. Ai i kishte menduar gjatë të gjitha këto dhe zgjodhi këtë rrugë, e cila, vërtet ishte e drejtë, por më pas ishte edhe tragjike. Si e kam shkruar edhe në librin "Përjetësia e dyfishtë", gjithnjë më ka munduar pyetja se cili nga "shokët brenda", të thënë "shokë të shtabit", nuk ishte dakord që Fehmiu të futej në Kosovë. Rexhep Selimi më ka thënë se ne ishim të dëshiruar të kishim një njeri si Fehmiu. Adem Jashari do të thoshte haptas se "vetëm vdekja më ndan nga Fehmi Lladrovci". Atëherë kush?

Unë mendoj, edhe pas kaq kohe, se pas figurës së tij, ka pasur një dyzim mendimi. Dikush ka menduar se amullinë e vet mund ta shlyejë përmes figurës së Fehmiut, sepse jo të gjithë kanë qenë sinqerisht të interesuar si ishte Ali Ahmeti; por kishte edhe të tjerë që kishin drojën se me futjen e Fehmiut në Kosovë, gjërat nuk do të mund të ishin si më parë, si mendohej, në dorën e askujt.

(I.K.: / Vazhdim i përgjigjes:) - Me ishte mbushur mendja se, në bazë të atyre pak të dhënave, e nuk ishte e dhënë pa rëndësi që të gjitha zonat e atëhershme nuk ishin të lidhura mes tyre dhe as nuk kishin një qendër (shtab), ku të paktën mund të kërkonin mjete financiare. Duke e dhunuar edhe intuitën për të skanuar gjendjen, se Xhaviti dhe Azemi, ose i kishin humbur lidhjet me njerëzit e tyre, ose po donin të ndërtonin një guerilje sa të ishte në gjendje për ndonjë aksion simbolik, që do të prodhonte hiç më shumë se sa zhurmë e spekulime mediumesh. Por, kur u informova se Xhaviti kishte kooptuar Nait Hasanin, kurse Azemi kishte kooptuar Xheladin Gashin, atëherë m'u imponua një vlerësim i ri, tepër fatkeq – mendoja se ata nuk ishin të zotët për të formuar e konsoliduar shtab ushtrie. E, meqë i dija për të tillë, - tashmë Naiti ishte në burg,

- kurse për Xheladinin, po, për Xheladinin, nga nuk më ndërlikeshin dyshimet, të kishte dezertuar, të ishte trembur dhe prandaj të ishte "zhdukur", apo të kishte ndodhur diçka tjetër!? Për këtë të fundit, po më habiste fakti: Naiti arrestohet jo fort larg banesës se tij, kurse policia nuk kishte shkuar për t'ia bastisur banesën, siç ndodh edhe në rastet më ordinere, ku do ta gjenin komandant "Plakun" (Xheladin Gashin).

Gjithë këto dilema, dyshime, turbulenca, në njërën anë, dhe vrasja e Zahir Pajazitit me dy bashkëluftëtarë, në anën tjetër, më kishin nxjerrë fare nga binarët. Nuk doja më t'ia dija për disiplinën (skllavëruese) që kërkonte Kryesia, nuk respektoja më centralizmin demokratik, që kuptohej, në rastin konkret, të mblidhnim ndihma dhe ato të përfundonin në Sektorin e rëndësisë se veçantë, për të cilin mendoja se i kishte humbur lidhjet. Të kuptohemi drejt, edhe rebelimin më duhej ta bëja me takt, të tërhiqja perin, por të mos e këputja. Prandaj, i kisha thënë Kryesisë, qysh në mars, kur më thirren për të dhënë llogari, se do të disiplinohesha posa ta sanonin gjendjen në Kosovë. Atëherë zonat nuk do të kishin më nevojë të kërkonin ndihmë nga Nëndega në Gjermani.

Isha bërë tepër aktiv, duke u munduar të sqaroj e të bind me takt se Kryesia nuk ka më kontroll mbi Sektorin e rëndësisë së veçantë, mjetet financiare janë të përqendruara vetëm te Xhaviti dhe Azemi dhe nuk e dimë se si është ecuria e tyre në Kosovë. Për rrjedhojë, duhej të mbahet mbledhje e Këshillit të Përgjithshëm dhe duhej kërkuar llogari nga Kryesia, nëse e ka nën kontroll Sektorin, i cili, siç më dukej mua, nga një sektor i rëndësisë së veçantë, po kthehej në sektorin e Xhavitit dhe të Azemit. Më bëhet, sikur ua mbusha mendjen anëtarëve aktiv të Kryesisë: Aliut e Emrushit, pasi Fazliun, Gafurrin e Muha-

metin nuk kisha përse t'i torturoja (meqë mendoja se ishin shndërruar pothuajse vetëm në figurantë) dhe shumë anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm, që të mbahej mbledhje e KP-së, ku ose do të informoheshim e do të gjenim zgjidhje, ose do të zhbëheshim. Prandaj u thirr mbledhja e KP-së në fjalë, dhe jo si herëve të tjera në Zvicër, por në terren "neutral", në Bruksel.

Ndoshta mund t'ju kujtohen këto zhvillime bashkëveprimtarëve, nëse kanë kurajë e sinqeritet për t'i kujtuar.

Për të mos e zgjatur, në atë mbledhje po vërtetoheshin shqetësimet e mia, edhe pse informatat jepeshin me pikatore. Dhe aty Kryesia raportoi se në ç'gjendje të padëshirueshme ishte katandisur Sektori, se shtabi nuk po i përgjigjej më, se ajo që kishte qenë në fillim, e strukturuar dhe e kontrolluar, tani kishte filluar të ndryshonte, se marrëdhëniet sikur kishin ngrirë, etj., etj.

Më në fund, them se do të bënit shërbim të mirë, sikur t'i nxirrje detajet nga dokumentet e asaj mbledhjeje, po patët qasje në arkivin e Lëvizjes.

(B.I.: / Shënim:) *Dokumentet e asaj Mbledhjeje janë në arkivin e Organizatës,megjithëse unë nuk kam qasje në këtë pjesë. Më duhet të sqaroj, më shumë ata që e lexojnë bisedën tonë, se Mbledhja është bërë në dhjetorin e vitit 1997 dhe në Kosovë, këtë vit, kishin ndodhur ngjarje të rëndësishme, disa nga të cilat, tragjike dhe të dhimbshme deri në palcë. Ishte vrarë Zahir Pajaziti, drejtuesi kryesor i Shtabit Operativ, dhe bashkë me të, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu. Ishte arrestuar Nait Hasani dhe bashkë me të kishte pasur arrestime masive në të gjithë Kosovën. Më 2 qershor 1997 do të fillojë gjykimi ndaj anëtarëve të UÇK-së në Zonën Operative të Drenicës, mes të cilëve do të jenë edhe Adem Jashari, i dënuar*

me pas me 20 vite burg, por edhe Hashim Thaçi, i dënuar me dhjetë vjet. Në maj, duke synuar të kalojë kufirin, bashkë me grupin e drejtuar nga Fehmi Lladrovci, vritet Luan Haradinaj, njëri ndër drejtuesit e sektorit të logjistikës, apo si është quajtur "buka e UÇK-së". Do të ketë aksione të shumta.

Mirëpo nuk jem i të njëjtit mendim se nuk kishte pasur lidhje mes grupeve dhe zonave operative. Me aq shtrirje sa kishte UÇK-ja deri në atë kohë, ishin bërë përpjekje dhe ishin realizuar disa takime. Nait Hasani, si koordinator kryesor, ishte takuar me Zahir Pajazitin, në varrezat e Prishtinës dhe kishin krijuar lidhjet, e po në të njëjtën kohë ishin krijuar lidhjet edhe me Adem Jasharin, me Rexhep Selimin, Sulejman Selimin, Sokol Bashotën, me Ardian Krasniqin, i cili do të vritet në sulmin gueril më 16 tetor 1997, me Qerim Kelmendin. Si do të dëshmohet më pas, të gjithë ata që ishin figurat kryesore të luftës, kanë qenë të lidhur me njëri-tjetrin dhe në një strukturë të përbashkët. Dikush kishte luajtur rolin në krijimin e një mjedisi të ri të luftës, pas goditjeve të rënda. Pra, kishte filluar ndryshimi i gjendjes dhe lidhjet ishin bërë me koordinimin e Sektorit e rëndësisë së veçantë. Fakt është se, në takimin e parë mes tyre, Naiti i është paraqitur Zahirit me emrin "Abazi", në shenjë të Ali Ahmetit. Pra, kishte lidhje, sado të vakëta, të cilat vijnë e rriten gjithnjë e më shumë. Krijohet Drejtoria Operative e UÇK-së. Vendosen kontaktet me diplomacinë Perëndimore. Nait Hasani vendos lidhjet me shokët në Drenicë. Arrestimet më parë e vrasjet më pas, bënë që shumë lidhje të prishen, të rrinë në pritje, disa kaluan në Shqipëri përkohësisht pasi kërkoheshin për t'u arrestuar, si të Linjës së Llapit, por, gradualisht, edhe të vendosen lidhje të reja, të ketë rikthim dhe ndërtim të ri, aty ku ishte prishur apo edhe kishte munguar. Por, edhe gjendja ishte e rëndë. Nga ata që njiheshin si anëtarë të Shtabit të Përgjit-

hshëm, pavarësisht nëse ti mendon se e kanë merituar apo jo, dy ishin në burg, Nait Hasani dhe B.Zogaj, njëri do të vinte në Zvicër, Xheladin Gashi, Zahiri ishte vrarë. Kush kishte mbetur: Rexhep Selimi dhe Sokol Bashota. Në Drenicë ishte Adem Jashari, por edhe Abedin Rexha, Iliaz Kodra e Sulejman Selimi, megjithëse këta tre të fundit nuk ishin anëtarë të Shtabit. Sidoqoftë, pas kësaj gjendjeje, mund të them, më e rënda deri asaj kohe, gjërat filluan të lëvizin. Të sjell një shembull: më datën 3 dhe 4 gusht 1997 do të kryhen njëkohësisht katër aksione, në katër vende të ndryshme të Kosovës. Në Podujevë, në Skenderaj, në Komoran dhe në Gllogovc. Kjo nuk është rastësi. Një shembull tjetër: më 11 shtator 1997, në orën 23, do të ketë njëkohësisht aksione të grupeve guerile në Irzniq të Deçanit, në Ponashec të Gjakovës, në Ratkoc të Rahovecit, në Runik të Skenderajt, në Gllogoc, në Ozdrim, në Kliçinë, Çallapek, në Klinë. Njëmbëdhjetë sulme të armatosura në njëmbëdhjetë stacione policore serbe, në të gjitha anët e Kosovës. Përsëri nuk besoj se është rastësi. Për më tepër, duke u bazuar në një bisedë me Rexhep Selimin, pyetjes sime, përse zgjodhët 11 objektiva, i është përgjigjur se, po të kishim më shumë mjete, do të kishim sulmuar më shumë. Dhe, më 28 nëntor 1997 Lëvizja Popullore e Kosovës i bën thirrje të hapur gjithë popullit për kryengritje të armatosur dhe luftë deri në çlirim.

Pra ka pasur disa zhvillime, të cilat, edhe sepse në Lëvizjen jashtë vendit ka pasur shqetësime e probleme, ata kanë bërë më tej.

(I.K.:) - Ju falënderoj për këtë qartësim. Po, që të mos keqkuptohemi, unë nga një ushtri po prisja më shumë. Rexhep Selimi ju ka thënë se po të kishin mjete do të sulmonin më shumë. Kjo do të thotë se ne nuk i kemi furnizuar sa duhet dhe si duhet, e rrethanat e favorshme për të bërë furnizim me ar-

matim e municion i kishim tepër të volitshme, qysh kur ndodhi rebelimi në mars të vitit 1997 në Shqipëri.

(B.I.: / Ndërhyrje:) *– Rexhep Selimi e kishte fjalën për armë të një cilësie të re, të fuqishme, si "Zolat" etj.*

(I.K.:) - Meqë isha atje, në Jug të Shqipërisë, në mars të vitit 1997, bëja thirrje që të mobilizoheshim për të siguruar armë. Atëherë njerëzit do të ishin të gëzuar, nëse do të gjenin blerës të armëve të tyre të grabitura nga depot e shtetit me çmim simbolik. Ta zëmë 10 dollarë një kallash. Por nuk po ndodhte asnjë angazhim konkret. E unë pata blerë vetëm një sasi simbolike, meqë nuk kisha më shumë të holla.

Veprimtarët e logjistikës së ushtrisë sonë nuk kishin para as për ushqim të bollshëm. Kurrë nuk mund ta harroj, në çfarë kushtesh e patëm kaluar ndërrimin e moteve nga viti 1996 në vitin 1997, në banesë të Ardian Krasniqit në Tiranë. Nuk ishte vetëm mungesa e ushqimit dhe kushteve minimale jetësore, por edhe përndjekja nga shërbimet inteligjente të shtetit shqiptar, në bashkëpunim me shërbimet serbe. Dhe do ti, ka edhe nga ata që i dinë këto gjëra, megjithatë madhërojnë kryepushtetarët e atëhershëm të Shqipërisë, ndërsa ka të tjerë që mallkojnë popullin, përse u rebelua kundër plaçkitjes nga firmat piramidale, pas të cilave qëndronin edhe ustallarë serbë, *a la* krimineli Arkan, i cili bashkëpunonte me pushtetarët e Tiranës.

Që të sqarohemi, nuk i bëjmë nder Lëvizjes dhe as Ushtrisë sonë nëse vazhdojmë vetëm të propagandojmë e glorifikojmë, por duhet të evidentohen edhe pengesat, paaftësitë dhe defektet tona.

(B.I.: / Ndërhyrje:) *- Ti, mik i dashur, harron kohën se për cilën flasim. Është dhjetori i vitit 1996, kur je takuar me Zahirin dhe shokët e tjerë, megjithëse nuk i ke njohur se cilët janë,*

me përjashtimin e Adrianit. Çfarë fondesh kishte Lëvizja asaj kohe? Të papërfillshme.

(I.K.: / Ndërhyrje:) – Më falni për ndërhyrjen, por mua atëherë m'i pat dhënë Kryesia 15 mijë marka, me sa mbaj mend, për t'ia dorëzuar Xhavitit në Tiranë.

***(B.I.:)** – Më fal, nuk janë me rëndësi detajet, prandaj po vazhdoj ku e lashë.*

Ta zëmë, Nëndega e Lëvizjes në Gjermani, sa mund të dërgonte në muaj, në Linjën e Llapit? Ata kishin kërkuar 4 mijë marka gjermane në një muaj dhe kjo, herë plotësohej e herë jo. A mund të bliheshin armë të një cilësie të lartë me këto mjete, kur mungonte edhe buka. Përse fondi në Gjermani nuk i pajisi me logjistikë moderne tri zonat që ndihmonte? Për një fakt të thjeshtë, nuk kishte. Unë nuk dua të glorifikoj askënd, por nuk dua as të mohoj askënd. Fakti që, edhe në këto kushte, do të thosha të një rrethimi të trefishtë, Lëvizja mori përsipër t'i ngriste strukturat e luftës, i bën nder asaj. Dhe këto struktura kanë pasur drejtues, Organizata, po ashtu, ka pasur drejtues, të cilët, edhe pse mund të kishe vërejtje, e bënë punën e tyre.

(I.K.: / Vazhdim i përgjigjes:) - Prej kohësh nuk kemi të njëjtin mendim, i kemi parë dhe i shohim gjërat ndryshe, por, mëqë kësaj radhe ju më pyetni e unë duhet të përgjigjem, më lejo ta shtjelloj mendimin tim. Të sjell një shembull: Mbaj mend se si e vuaja në heshtje mandatën kur u informova nga Behxhet Mehmeti ("Bajrami") në fillim të vitit 1984, sapo qe arratisur bashkë me Emrush Xhemailin ("Muhametin") dhe Behxhet Luzhën ("Hazirin"). Ai me dhembje po më thoshte: "na janë vrarë bashkëveprimtarët Rexhep Malaj e Nuhi Berisha dhe na janë burgosur rreth 300 veta, prandaj për to duhet të mbajmë përgjegjësi, meqë duhet të jenë infiltruar spiunë të

UDB-së në radhët tona, përndryshe - si u informua policia të na zërë prita e të na burgosin kaq shumë veta?" Me qindra e me mija ishin arrestuar gjatë vitit 1981. Edhe në vitet e pastajme na janë vrarë dhjetëra dhe burgosur me mijëra veprimtarë. Vërtet, nuk kishim ne faje që nuk zotëronim teknikën e konspiracionit dhe organizimit klandestin, apo duhet fajësuar vetëm super-aftësinë e shërbimeve jugosllave, përkatësisht serbe të Kosovës?! Cilin rol luanin kuislingët shqipfolës *a la* Azem Vllasi e Ibrahim Rugova në gjithë këto goditje?! Nëse gjithandej vazhdojmë të lavdërojmë, si mund t'i arsyetojmë pësimet e goditjet e shumta e të rënda, si mund të arsyetojmë mungesën e mjeteve financiare edhe për ushqim për Zahir Pajazitin, Adrian Krasniqin, Ilir Konushevcin, Qerim Kelmendin (që i kisha parë me sytë e mi)?! Si duhet sqaruar që Adem Jashari me bashkëveprimtarë ankoheshin për mungesën e armatimit të avancuar në vitin 1996/97?! Deri kur duhet të heshtet se familjarët e Jasharëve në Gjermani grumbulluan vetë ndihma financiare për t'ia dërguar Adem Jasharit me bashkëveprimtarë dhe ia besojnë dërgesën e tyre Azem Sylës. Ato ndihma kurrë nuk arritën në destinacion?!

Si rrohej në Prishtinë kur Drenica po përgjakej?! Si duhet vlerësuar shpallja e "zgjedhjeve të lira" nga kuislingët shqipfolës, kur Drenica e Dukagjini po përgjakeshin?!

Do të më fani: ose më duhet të "zbrazëm", ose të pëlcas!

XI. Sprovat konkrete në fillim të Kryengritjes

(B.I.:) - Pas takimit të Brukselit kam biseduar gjatë, në fillimin e janarit të vitit 1998, me Fehmi Lladrovcin. Ishte i mllefosur, thoshte vazhdimisht se shokët "nuk po janë në tokë të bukës, nuk po e kuptojnë se këtë vit do të ketë luftë". Si një njeri që ishte mësuar me shenjat e luftës, ashtu si kishte ndodhur në Kroaci, kur ai u vendos krah forcave kroate kundër fashizmit serb dhe krijoi të parën njësi ushtarake, e njohur si Brigada e Gospiqit, ai e ndjente se lufta po vinte. Po vetë organizata, ju që ishit pjesë e rëndësishme e saj, e ndjenit se lufta po vinte dhe çfarë masash morët përsipër të realizonit?

(I.K.:) - Me Fehmiun më ra hise të bëja disa udhëtime gjatë vitit 1987, pikërisht sepse ai kishte parashikimin se lufta do të fillonte shpejt. Prandaj edhe vinte ai angazhimi i tij me ngulm, përkushtim, i atypëratyshëm, që t'i freskonte e konkretizonte lidhjet e mëhershme, fillimisht me ushtarakët që i kishte njohur personalisht. Pas thirrjes së Fehmiut pat ardhur nga Kroacia në Gjermani, Bekim Berisha. Ata ishin gjatë kohë bashkë, hulumtonin literaturë të armatimit, katalogë të armëve, diskutonin plane, etj. Disa herë kam qenë edhe unë i pranishëm, por nuk përzihesha në diskutimet e tyre konkrete profesionale. Ndonjëherë edhe më mërzisnin me të tilla bisedime. Që në atë kohë Fehmiu takoi ndër të parët ushtarakët Fadil Demirin dhe Xhafer Jashari, ngase me ata ishte shoqëruar qysh kur kishte shkuar për të studiuar në Zagreb dhe, po bashkë me ata dhe të tjerë, i kishin burgosur, duke i akuzuar për veprimtari armiqësore. Kur e vizituam Fadil Demirin në Pragë, mbaj mend

të kemi biseduar gjatë, ndonjëherë rreptë, meqë Fehmiu donte ta bindte se shpejt do të fillonte lufta në Kosovë. Fadili i kundërvihej, me shpjegim se luftë mund të ketë vetëm ndërmjet dy ushtrive. Kosova nuk kishte ushtri, kurse Serbia e kishte shumë të fuqishme. Dhe sërish Fehmiu takonte dhe konsultohej me Ali Ahmetin, meqë e dinte se është anëtar në Sektorin e rëndësisë së veçantë, që do të thotë ishte bërthama e shtabit të përgjithshëm që duhej ta konsolidonin.

I thashë këto tani, edhe pse për angazhimet konkrete të Fehmiut në vitin 1997 rrëfeva më herët, por vetëm desha ta konfirmoj informacionin tuaj, lidhur me bisedën që keni pasur me Fehmiun në fillim të janarit 1998. Konkretisht për parashikimin që ka shfaqur ai.

Para se t'i përgjigjem pyetjes, përmendet Brigadën e Gospiçit, të cilën e kishte formuar e komanduar Fehmiu. Ai më ka rrëfyer gjerë e gjatë për atë Brigadë dhe për angazhimet e tij në Kroaci, sidomos në rrugëtimet e gjata me makinë, ngase në makinë rëndom flitet e flitet. Shoferëve sikur u duhen bisedat për të përballuar lodhjen fizike dhe monotoninë e rrugës.

Këtu po rrëfej një fragment që kishte të bënte me kazermën ushtarake të Ushtrisë jugosllave në Gospiq. Ajo komandohej nga koloneli Ahmet Krasniqi. Ishte kazerma e fundit që po rezistonte kundër Ushtrisë çlirimtare kroate. Pasi merret ajo kazermë Ushtria kroate e kap Ahmet Krasniqin, si macja miun. Por, pastaj e shkëmbejnë si rob lufte me një ushtarak kroat, të zënë nga Ushtria Jugosllave, tashmë e shndërruar në ushtri serbe. Për meritat e rezistencës në kazermë, ushtria serbe e bën Ahmetin anëtar të Shtabit të përgjithshëm të saj dhe komandant për bombardimin e Vukovarit.

Fehmiu më pat rrëfyer edhe për një paraqitje të gjatë të

Ahmet Krasniqit në Televizionin e Novi Sadit, ku kishte bërë thirrje patriotike serbe për ta mbrojtur "Jugosllavinë".

Fehmiu, gjatë atyre bisedimeve, ankohej kundër mospërkrahjes nga udhëheqësit e Kosovës, por ndihej i zhgënjyer edhe për përkrahjen simbolike nga Lëvizja, anëtar i së cilës kishte qenë dhe ishte. Më saktë, kishte qenë dhe vazhdonte të ishte njëri nga kuadrot drejtues të saj. Ai mendonte: Kur kjo ndodh me mua, që jam këtu, i brendshëm, i gatshëm dhe në të njëjtën lidhje, po të tjerëve që janë tutje, krejt të papërfillshëm?

Më gjatë nuk po ndalem në ato biseda, sepse ju keni bërë një monografi të plotë dhe të denjë për Fehmi Lladrovcin dhe Xhevë Krasniqin-Lladrovcin.

Tani, sa i përket pyetjes, nëse Organizata kishte të njëjtat parashikime dhe a ndërmerrte angazhime përkatëse, sikur jam i dyzuar në vlerësime. Pjesa e parë e dyzimit tim lidhet me strukturat organizative në Kosovë. Ata, mund të them me bindje se, në atë masë sa e kishin të mundur, e kishin parashikuar se lufta po vinte dhe, të paktën moralisht, ishin përgatitur për ta përballuar atë. Mungesa e logjistikës ka qenë përherë problemi ynë më i madh, por kjo nuk ka qenë e lidhur gjithnjë me mundësitë tona. Fakti se kërkesat për logjistikë, gjatë vitit 1997, ishin shtuar jashtëzakonisht shumë, pavarësisht humbjeve dhe arrestimeve, ishte një dëshmi se lufta po vinte dhe se strukturat e UÇK-së donin ta përballonin atë.

Dyzimi i dytë.Përgjithësisht, me keqardhje më duhet të pranoj se Kryesia sikur kishte halle të tjera shqetësuese të saj, sepse Sektori i rëndësisë së veçantë e kishte anashkaluar. Më saktësisht, udhëheqësi Xhavit Haliti dhe përkrahësi i tij, Azem Syla, me Kryesinë bashkëpunonin vetëm sa për mjetet financiare. Kurse Aliu, që vazhdonte të ruante rendin dhe rregullin,

ishte anashkaluar dhe po merrej pothuajse individualisht me përgjegjësitë që i takonin si anëtar i atij Sektori. Prandaj Aliu po angazhohej me përkushtim, do të thosha, dhe me shqetësim për të bërë maksimumin e mundshëm, duke bashkëvepruar me ata që kishin preokupime e shqetësime të njëjta, siç ishte rasti me Fehmi Lladrovcin. Ama, fakt ishte se Aliu kishte lidhje aktive me të tri zonat e atëhershme të Ushtrisë: të Drenicës, Llapit dhe Dukagjinit, kurse Xhaviti dhe Azemi duhet të kenë pasur lidhje vetëm me Nait Hasanin, Xheladin Gashin, Rexhep Selimin, Sokol Bashotën! Për cilësinë e atyre lidhjeve koordinuese midis tyre nuk me duket e arsyeshme të flas, sepse ato janë produkt i informimit të mëvonshëm dhe jo të kohës, për të cilën po flasim. Ndërsa Jashari (Salihu) merrej me mbikëqyrje të menaxhimit të Fondit, drejtues i të cilit ishte.

Që të përmbledh përgjigjen: Organizata, edhe për shkak të inercisë nga përcaktimet e mëhershme dhe tradita, ishte në gjendje mobilizuese, siç dëshmojnë angazhimet e Fehmiut me bashkëveprimtarë, që organizoheshin për të shkuar në Kosovë ose, siç ishin ndihmat financiare të strukturave, si ato të Nëndegës dhe Fondit në Gjermani, e jo vetëm në Gjermani, si edhe e veprimtarëve të Lëvizjes që kishin lidhje të drejtpërdrejta me luftëtarët në zona. Fakt është se kjo është periudha kur strukturat e luftës gjejnë shtrirje më të gjërë se më parë, por, ndoshta edhe për shkak të problemeve të rritjes apo të lidhjeve të përkohshme, edhe e fshehta e klandestinetit luan rol këtu, problemet e krijuara, në dukje të vogla, mund të hapnin telashe më të mëdha, nëse nuk u dilej përpara. Pikërisht për të sanuar atë situatë, qe mbajtur mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm në Bruksel, për të cilën folëm më herët. Në fakt, ajo mbledhje pak gjë sanoi dhe për kohë të shkurtër. Në këtë kohë të shkurtër Xhavit Haliti i rrumbullakosi përsëri punët, unë e quaj kom-

plot, dhe gjërat vazhduan si më parë.

(B.I.:) - Do të ishte mirë të të ndërpritja, për të thënë edhe unë mendimin tim, pasi po bashkëbisedojmë, dhe, për më tepër, lidhur me rolin e Halitit, ne, jo rrallë, kemi pasur mendime e qëndrime të ndryshme. Jam i bindur se në përgjigjet e mëpasme do ta thellosh idenë tënde, ndaj, më duket me vend, që të kesh edhe mendimin tim. Pastaj, secili nga ne, dhe kushdo tjetër, është i lirë të ketë mendimin e tij. Nuk e kam kuptuar as atëherë, kur e ke ngritur për herë të parë, e nuk e kuptoj dot as tani, se ku qëndron komploti i Xhavit Halitit. Ai ishte emëruar si drejtues i Sektorit të Veçantë. Kjo ishte detyra e tij, të cilën, për kushtet që kanë qenë, nuk mund ta kryente askush më mirë dhe nuk besoj se do të mund të kryhej edhe nga ndonjë tjetër. Si drejtues i sektorit, ai e kishte për detyrë të mbante të fshehta lidhjet, qëndrimet, linjat e veprimit. Të krijonte, me aq sa mundte, një mjedis të përshtatshëm në Shqipëri, në kontaktet me diplomacinë perëndimore, por gjithnjë me aq sa i kishte mundësitë dhe me hapësirat që i linin. Jo vetëm që nuk ka qenë detyra e tij, por, për më tepër, ka qenë e drejta e tij, që gjërat të mbaheshin sa më mbyllur dhe nuk kishte përse ai të informonte sa herë që të donte Këshilli i Përgjithshëm, se si ishin punët dhe sa e si ishin vendosur lidhjet. Në këtë kuadër, ai nuk kishte përse të ju informonte edhe Ju, kur për më tepër, shpesh herë, në Mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm, ai ka thënë mendimin e tij, me forcë do të thoja, se një ndër shkaqet që mund të fragmentizohet lufta, është edhe veprimtaria yte.Sipas bindjes sime, Xhavit Haliti është një njeri i heshtur, i mban enigmat në vete dhe, besoj, do t'i mbajë ato gjatë në vete, por në të gjitha takimet që kemi pasur gjatë kohës së luftës, qoftë në Tiranë, qoftë në banesën time, në Shtutgart, jam bindur se rruga që kishte ndjekur, kishte qenë e arsyeshme, nganjëherë përtej

mundësive që kishte pasur. E pse jo, kishte pasur edhe gjëra që mund të bëheshin më mirë. Unë e kam thënë edhe në shkrimet e tjera apo në qëndrimin që kam mbajtur në Organizatë, se ai ishte një njeri i besuar, të cilin që herët e kishin ngarkuar me detyrën e organizimit të lëvizjes së armatosur në Kosovë. Kjo daton që nga emërimi i tij në Byronë Organizative, që ishte i pari organ në ilegalitet, që kishin krijuar lëvizjet klandestine pas bashkim/shkrirjes. Pra, nuk ishte një i panjohur. Keni punuar shumë vite së bashku, herë mirë e herë jo mirë, sepse keq nuk keni punuar; edhe brenda sektorit kishte njerëz më praktikë, siç ishte Xhaviti; më romantikë, me më shumë lidhje e më realizues, siç ishte Ali Ahmeti; më të tërhequr, siç ishte Jashar Salihu dhe, në fund, edhe më të pagjetur e më të pakënaqur, siç ishte Azem Syla. Këta njerëz kanë qenë të caktuar nga Organizata dhe këta kanë krijuar edhe lidhjet brenda vendit, e si duket, nuk kanë qenë vetëm këto.

Sidoqoftë, në të gjitha rrethanat, ti ke të drejtën të kesh mendimin tënd, e këtë mendim, e di krejt mirë, nuk e ke prej sodit apo prej hidhërimit, por sepse kjo bindje të është krijuar. Le të vazhdojmë më tej me bisedën tonë!

(I.K.:) - Para se të shtrosh pyetjen, do të më falësh të shpreh mendimin për këto që the.

Sa për informim, me Xhavitin kemi qenë shpesh bashkë në angazhime në terren, sepse as ai nuk ishte i zënë me punë dhe nuk përtonte të udhëtonte anekënd Evropës, për të takuar bashkatdhetarët. Kur u arratis dhe u vendos në Zvicër, (ndoshta në vitin 1986, them në të njëjtën kohë me Gafurr Elshanin), meqë në Kosovë kishte ndodhur edhe një valë e goditjeve të organizimeve klandestine, ai u përfshi menjëherë në strukturat drejtuese të Degës, sepse bashkëveprimtarët që

kishin ardhur para tij kishin besim e respekt ndaj tij. Rastisi që bashkëveprimtari Muhamet Elshani, nga Osdrimi i Pejës, me banim në Hamburg, reagoi brutalisht kundër angazhimit të tij në Organizatë. Ai e arsyetonte kundërshtimin e tij me njohjet e tyre të mëhershme, që në vitet e 70-ta. Thoshte se qysh atëherë ai është futur nën tutelën e UDB-së.

Ngjashëm me Muhametin e përfliste edhe ndonjë imigrant i anëve tona. Megjithatë, unë e mbroja Xhavitin, sepse bashkëveprimtarët e sapoardhur nga Kosova flisnin mirë për të, e lavdëronin për guximin dhe shkathtësinë. Mund ta kontaktoni Muhametin po deshët dhe do të bindeni për atë që më ka thënë, sikundër edhe për kështillat e mia që ai të heshtte dhe për përmbajtjen e tij pas këshillimeve të mia, sepse kishte respekt të madh ndaj meje.

Tjetra: unë nuk po e kontestoj përgjegjësinë dhe angazhimin e tij në Sektorin e rëndësisë së veçantë, por po sqaroj se ai nuk kishte lidhje me zonat operative të Ushtrisë sonë në Kosovë. Prandaj ato nuk përkraheshin me financa, pavarësisht faktit se Aliu kishte lidhje, por nuk kishte influencë në Sektor në ndarjen e ndihmave financiare. Për mua mjaftonin këto njohuri, për të konstatuar se Sektori ishte ndarë dhe se Xhaviti e Azemi po bënin komplot.

Një pyetje e herëshme: Si ishte qëndrimi ndaj Adem Jasharit dhe zonës së Drenicës?

(B.I.) - Them se nuk ke nevojë të vazhdosh më tej me këto sqarime.Në këtë rast ne jemi në dy pole të ndryshme, dhe kemi shikuar gjithnjë anë të tjera.Unë e kam çmuar, qoftë si gazetar, si analist apo si pjesë e drejtimit të organizatës, gjithë punën e

jashtëzakonshme që kanë bërë drejtuesit e mëhershëm të saj, sepse, jo vetëm që ka qenë një periudhë e vështirë, por ka kërkuar sakrifica, dhe këto njerëz, miqtë e tu dhe miqtë e mi, i kanë përballuar.Nuk ka ardhur askush nga hëna të trajtojë e të zgjidhë këto çështje.Ata kanë gjetur rrugën e duhur nga këto njerëz, të cilët, jam i bindur, Ti, edhe sot, i respekton edhe më shumë se unë, pasi ke një jetë me to.Dhe mendoj se ka qenë një jetë jashtë së zakonshmes.Por le të vazhdojmë me diçka tjetër.

Tashmë dihet ngjarja epike e Familjes Jashari. Ka pasur gjithnjë debate në lidhje me këtë strukturë themelore të Ushtrisë sonë,zonën operative të Drenicës, që drejtohej pikërisht nga Adem Jashari. Me dhjetëra herë është thënë, po ndihmohet apo nuk po ndihmohet, ka përparësi apo nuk ka. Ka pasur edhe zëra se ai është një njeri i pabindur, disi rebel, etj. Kjo nuk ka ndodhur vetëm në kohët e fundit, por që kur ai ka filluar rezistencën e tij. Ademi ishte anëtar i rëndësishëm i Lëvizjes, do të jetë njëri nga ata që bënë presion në Organizatë për të filluar aksionet. Pas rrethimit të parë të tij dhe të bashkëluftëtarëve, mes të cilëve edhe dy vëllezërit, Rifati dhe Hamza, ka përpjekje në Organizatë për t'i ndihmuar më konkretisht. Dy drenicakë, Ramiz Lladrovci dhe Hashim Thaçi, do të shkojnë në qendrën e Organizatës dhe do të bisedojnë me Ramadan Avdiun. Kërkesa e tyre ishte: Të ndihmohet Adem Jashari! Nga katër mitraloza që kishte atëherë Organizata, njërin prej tyre do ta dërgojnë tek ai. Më pas, tre të tjerët, pra tre mitralozat e tjerë, do të kapen nga policia serbe në kontrollet e bastisjet e tyre. Edhe atëherë, kur më është besuar detyra e drejtuesit të organizatës, por edhe tash, kam pyetur: Përse nuk u dërguan të gjitha armët tek ai, qoftë edhe si strehë e sigurt. Por, për ty unë kam tani dy pyetje brenda së njëjtës: E para, a është ndihmuar Adem Jashari nga Organizata, kur

dhe nga kush, cila pjesë, ka qenë ndihmë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, e rregullt apo me raste dhe, e dyta, cili ka qenë qëndrimi i Organizatës ndaj tij, korrekt, apo i lëkundshëm, qoftë edhe në individë të veçantë?

(I.K.) - E kam të vështirë të jap përgjigje tepër konkrete, sepse është tematikë e ndjeshme. Së pari, më duhet të të them se pas vitit 1996 e sidomos pas ngjarjes tragjike të 31 janarit 1997, ku u vrane Zahiri, Hakifi dhe Edmondi, Adem Jashari ishte figura kryesore e luftës në Kosovë. Ka shumë faktorë pse e bënë të tillë, por, mbi të gjitha, vetë figura e tij të imponontе respekt e besim. Organizata ka gjetur tek ai përsonifikimin e njeriut me virtyte të jashtëzakonshme dhe e ka mbështetur pa mëdyshje. Por ai ka qenë një njeri që i ka bërë vend vetes, si thonë shprehimisht. Jo vetëm se ishte njeri trim, por edhe i fjalës, njeri i besës, i zoti për luftë, i lindur për këtë gjë. Mbështetja e Adem Jasharit dhe e luftëtarëve rreth tij ka fillesë që në vitin 1992, ai e ka pasur këtë mbështetje fillimisht nga ata që e kanë njohur nga afër, pastaj nga strukturat e duhura. A ka qenë e plotë kjo mbështetje, kjo duhet parë në raport me kohën, me njerëzit dhe me mundësitë.

Duke qenë bashkë me Fehmiun, qoftë në Kryesi të Nëndegës së Lëvizjes në Gjermani, qoftë shokë tepër të ngushtë, kam qenë pranë burimit të informimit të dorës së parë për Zonën e Drenicës. Qysh në vitin 1996 Kryesia e Nëndegës u ishte përgjigjur pozitivisht kërkesave të tri zonave të Ushtrisë sonë, kishim caktuar konkretisht njerëzit ndërlidhës, siç informova më herët: Sabri Kiçmarin e Ali Ramën me Zonën e Lllapit; Fehmi e Ramiz Lladrovcin me Zonën e Drenicës dhe, Xhemail Fetahun e Sali Kelmendin me Zonën e Dukagjinit. Këto kishin ndodhur në bashkëpunim e me aprovim të Ali Ahmetit, për të cilin po besonim, se duke qenë anëtar i Sektorit të rëndësisë së

veçantë, rrjedhimisht ishte edhe kompetent. Qysh atëherë zuri të përvijohej një dukuri fraksionizmi në Sektor, rrjedhimisht në bërthamë të shtabit të përgjithshëm, që duhej të konsolidohej e mandatohej në Shtab të Përgjithshëm, meqë Ushtria nuk ishte organizatë e pavarur politike demokratike, që të votonte anëtarët e Shtabit, e as individët të vetemëroheshin për komandant. Ishte Lëvizja ajo që e kishte formuar, po e udhëhiqte politikisht, po e financonte dhe, prandaj, duhej të formonte Shtabin dhe ta mandatonte atë për komandim. Në kuadër të këtyre përcaktimeve, Lëvizja kishte formuar Sektorin e rëndësisë së veçantë, si bërthamë fillestare të Shtabit. Fatkeqësisht rrjedha nuk u zhvillua gjithnjë siç ishin planifikimet e përcaktimet, meqë Xhaviti kishte përvetësuar Azemin, ose anasjelltas, për të vepruar kokë më vete. Ndërkaq ata, siç do të dëshmohet më vonë, ose nuk ishin në gjendje t'i ushtronin përgjegjësitë (nuk kishin lidhje me zona të UÇK-së), ose nuk donin! Unë qysh atëherë, që do të thotë qysh në maj të vitit 1998, i kam akuzuar si komplotistë me fjalën e paraqitur në mbledhje të KP, fjalë që e kisha parapërgatitur me shkrim.

Me që jemi tek kjo tematikë, që nga viti 1996 e deri kur ndodhi Epopeja e Jasharëve në Prekaz, Xhaviti e më shumë Azemi, ngulnin këmbë se Adem Jashari me bashkëluftëtarë nuk duhej të përkraheshin, sepse nuk ishin në UÇK. I cilësonin si "grup kaçakësh", si "grup i Drenicës". Këtë e pat shprehur me mllef vetë Xhaviti në mbledhjen e Kryesisë së Lëvizjes, në mars të vitit 1997, kur u thirra për të dhënë llogari pse po i dërgonim në zona mjetet financiare të Nëndegës dhe të Fondit në Gjermani dhe, po me mllef e në mënyrë ultimative, ju thashë se do t'ua dërgojmë, sa kohë që ata do të na kërkojnë, meqë Kryesia dhe Sektori kanë humbur lidhjet me ta, ose nuk po duan t'i përkrahin. Arsyetova se kërkesat

e zonave i kishim me shkrim, me zë, përmes ndërlidhësve. Edhe aty pata thënë se për të gjitha veprimet tona është informuar Ali Ahmeti, si kompetent që ishte. Kishim ndihmën dhe angazhimin aktiv e miratimin e tij, pa ditur ende se cilat raporte i kishin ata brenda për brenda.

Me të dalë nga mbledhja me rastisi të takoj Jashar Salihun dhe Xhavit Hoxhën dhe gjithë mllef i informova, sepse doja ta kisha miratimin e Jasharit për ato veprime, meqë ishte Kryetar i Fondit "Vendlindja Thërret". Tani mund të quhet shpërdorim, meqë ata nuk janë më gjallë, por e vërteta është se Jashari më dha të drejtë. Këtë e dëshmon bashkëveprimtaria e mëtejme, tepër e ngushtë dhe asnjëherë nuk m'u ka hidhëruar kur bëja veprime "krye në vete", si më akuzonin Xhaviti e Azemi, e disa nga anëtarët e Kryesisë. Këta të fundit, në parim, duke i dalë në mbrojtje centralizimit demokratik, siç ishin normat statutore të Organizatës.

B.I.:) - *Pas marsit të vitit 1998 do të kemi masivizim të jashtëzakonshëm të luftës në Kosovë. Si e pret Organizata këtë zhvillim të ri, ishte ajo e përgatitur apo jo? E keni mendimin se drejtues të veçantë të saj, të Lëvizjes, para marsit të vitit 1998, dhe që ishin jashtë Kosovës, mendonin se mund të drejtonin luftën nga perëndimi?*

(I.K.:) - Pas Epopesë se Jasharëve ndodhi shpërthimi i kryengritjes së armatosur që përfshiu kryesisht Zonën e Drenicës dhe Zonën e Dukagjinit. Edhe Sektori, edhe Kryesia u zunë në befasi. Megjithatë, shpërthimi i kryengritjes së armatosur nuk na zuri fare të papërgatitur. Koha tregoi se strukturat e organizuara në Kosovë i qëndruan valës së parë të goditjes dhe u bënë gati për të pritur ofesivat e tjera. Pikërisht kjo parapërgatitje do të jetë edhe shkaku kryesor që ri-

filloi me shpejtësi të jashtëzakonshme ringritja e strukturave të luftës, tashmë në të gjitha zonat, ndodhi kthimi në Kosovë i dhjetra aktivistëve të shquar të organizatës, të cilët morën përsipër drejtimin e luftës, thuajse në të gjithë zonat. Lëvizja, si forcë politike dhe ushtarake, bëri shndërrimin e saj, ajo kaloi e gjitha në luftë, duke dhënë shembullin se, në kohë lufte, nuk ka vend dhe kohë për partizim politik. Pra, është fakt do të thoja, se kjo periudhë, aq sa ishte edhe kthesa e madhe dhe piku i provës, aq edhe dëshmoi se puna që ishte bërë në vite, nuk po shkonte dëm. Në të gjitha këshillat popullore të Lëvizjes, kudo në Perëndim, momenti i parë i hutimit ishte shumë i shkurtër, si duket, me shpejtësi, zuri vend idea se tashmë ishte koha kur gjithçka duhej të ishte përfundimisht në shërbim të luftës. Mirëpo ndodhte edhe një paradoks.

Fatkeqësisht pjesëtarët e Sektorit vazhdonin të mendonin se Ushtrinë tonë, që duhej të kishte vetëm disa dhjetëra ushtarë deri në atë kohë, do ta koordinonin e komandonin nga jashtë. Mendoj se ka pasur efekt të dobishëm, futja në Kosovë, që në mars të vitit 1998 e një grupi shokësh të Organizatës, të cilët i dhanë hov luftës. Kur me to u bashkuan edhe ushtarakët profesionistë, atëherë mendoj se filloi me të vërtetë strukturimi i UÇK-së. ***(B.I.: / Ndërhyrje):*** *Të jemi të sinqertë, meqë po synojmë të flasim hapur. Ideja për të drejtuar luftën nga jashtë, nga perëndimi, nuk ka qenë thjeshtë e atyre që po i quan pjesëtarë të Sektorit të rëndësisë së veçantë, që në fund të fundit ishin anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm. Nga të gjithë anëtarët e Kryesisë, ata kishin ndoshta më shumë përgjegjësi se kushdo që të kishin të drejtën e ndërhyrjes, mendimit, e herë-herë edhe të komandimit të veprimeve të luftës. Por synimi për të qenë në komandë, qoftë nga Gjermania, qoftë nga Zvicra, si anëtarë të Kryesisë, është ndeshur edhe tek të tjerët. Në arkivin e Organizatës, në*

materialet e vitit 1994, mars dhe prill, vërehet kjo tendencë e jo rrallë është shprehur edhe haptas. Unë mendoj se që këtu kanë filluar divergjencat para, sepse ka pasur koncepte të ndryshme për luftën, e jo vetëm për komandimin, por edhe për organizimin e saj. Ka pasur dy koncepte për zhvillimin e luftës, brenda organizatës. Njëri ishte për një luftë guerile, të zgjatur, derisa çështja e Kosovës të shtrohej për zgjidhje. Koncepti tjetër ishte për një fillesë me luftë guerile dhe shkuarje drejt luftës së përgjithshme, po vetëkuptohet, të armatosur. Është diskutuar kjo llojshmëri konceptesh në Organizatë?

(I.K.:) - Nuk besoj të ketë pasur, pra, nuk besoj të jetë diskutuar as në Sektor, as në Kryesi për këto dy koncepte. Dokumentat, për të cilët e ke fjalën, nuk i kam të njohur. Por, nga mënyra e sjelljes dhe nga bisedat e rastit, sepse atëherë kisha biseda intensive me të gjithë, edhe me Xhavitin e Azemin, rezultonte se këta të dy parapëlqenin që zhvillimet të zgjateshin me aksione të herëpashershme, deri sa të ngrihej e aftësohej ushtria e mirëfilltë. Ama, zhvillimet morën përmasën e kryengritjes së armatosur, pa pyetur për dëshirat dhe përcaktimet e asnjërit dhe askujt.

***(B.I.:)** - Në Mbledhjen e Gjashtë të Përgjithshme u shtrua teza dhe u miratua ajo për ndërtimin e Frontit të Përbashkët për Çlirimin e Kosovës. Në lidhje me të unë kam dy pyetje: E pra, pse u shtrua ajo me aq forcë vetëm në Mbledhjen e Gjashtë të Përgjithshme dhe nuk u fillua të ndërtohej më parë, që në hapat vendimtarë për organizimin e luftës dhe, e dyta, dihet tashmë se Fronti i Përbashkët, në atë mënyrë klasike që jemi mësuar të shohim një Front, nuk u ndërtua. Kush ishte shkaktari i mosndërtimit, qëndronte ky shkak brenda organizatës apo ishte më shumë jashtë saj?*

(I.K.:) - Vendimet decidive të asaj Mbledhjeje nuk më kujtohen, por di se vendime të ngjashme janë marrë. Nuk besoj të ketë qenë mbledhja e 6-të.

(B.I.: / Ndërhyrje:) - *Po, ka qenë Mbledhja e Gjashtë e Përgjithshme, siç shihet edhe nga Rezoluta përkatëse e saj dhe, për të ndërtuar këtë Front, nga Mbledhja e Përgjithshme, si drejtues i grupit u caktua Muhamet Kelmendi, deri atëherë Nënkryetar i Organizatës.*

(I.K.: / Vazhdim i përgjigjes:)... të falënderoj për sqarimin.

Rëndom kishte edhe nga ata që kishin ide "të mëdha", të mbështetura në dëshira të idealizuara. Dhe, meqë ishin tërheqëse, edhe miratoheshin. Por, me kë, realisht, duhej formuar një front gjithëpërfshirës, kur të gjitha subjektet "legale", që vegjetonin nën sqetullën e LDK-së, si dhe vetë LDK-ja, nuk donin as të dëgjonin për front të përbashkët çlirimtar, e lëre më të binin dakord që ta formonim. Nuk besoj se ndokush nga Lëvizja nuk ka dashur, ose ka penguar për të jetësuar të tillë vendim, por nuk kemi mundur, sepse nuk kishim subjekte "legale" dhe "ilegale" që kanë qenë të interesuara, pos vetë Lëvizjes.

(B.I.:) - *Në një bisedë që kam bërë në atë kohë, por edhe më vonë, me Ali Ahmetin, duke e pyetur pse nuk u ndërtuan më parë strukturat e larta drejtuese të luftës, kam pasur përgjigjen se puna për ndërtimin e tyre filloi në pranverë të vitit 1998. Kjo ishte tepër vonë, prandaj, edhe në momentin e parë, ka pasur probleme. Çfarë pengonte për të ndërtuar këto struktura drejtuese?*

(I.K:) - Rrethanat në Kosovë kanë qenë tepër të rënda për të ngritur struktura qendrore komanduese, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Tashmë nuk ishte vetëm pushteti pushtues i Beogradit që përndiqte brutalisht të tilla veprimtari, por edhe

udhëheqja e LDK-së i spiunonte. E që të mos ua shkarkojmë gjithë fajin atyre, doemos edhe paaftësia e Lëvizjes ka hisen e fajit. Them kështu ngaqë gabimisht zgjodhi Xhavit Halitin koordinues të Sektorit të rëndësisë së veçantë. Ai Sektor, si duket, nuk arriti që të formoheshin e të konsolidoheshin ato struktura. Mendoja kështu, sepse në Kosovë dhe jashtë Kosovës dhunti organizuese Xhaviti kishte, njerëz për të angazhuar kishte, vullnet dhe guxim kishin shumica e anëtarëve të Lëvizjes. Së këndejmi marsi i vitit na zuri pa shtab të përgjithshëm funksional, bile edhe koordinimi midis zonave, që ishte më parë, nuk po funksiononte. Nuk them se nuk janë bërë fare përpjekje, por me goditjet e fundit, kur u arrestua Nait Hasani, u vra Zahir Pajazit me dy bashkëluftëtarët, ajo përpjekje u godit rëndë. Logjika me thoshte se Xhaviti e kishte mandatuar Nait Hasanin si njeri të parë të Ushtrisë në Kosovë, kurse Azemi e kishte mandatar Xheladin Gashin ("Plakun"), si njeri të dytë dhe, kur i pari dhe i dyti në një ushtri dështojnë, dihet çfarë gjendje krijohet. As atëherë dhe as sot nuk e kisha dhe nuk e kam të qartë, nëse Xheladini dhe Naiti ishin të zotët për atë përgjegjësi, dhe nëse e kishin mundësinë e aftësinë të ishin të tillë. Sidoqoftë, Naiti u arrestua dhe unë e çmoj jashtëzakonisht fort qëndrimin e tij në burg, sipas informimeve të tij. Tepër stoik dhe burrëror, por përtej saj, nuk e di se çfarë vlere tjetër konkrete kishte ai në drejtimin e luftës. Ndërkaq për Xheladinin policët serbë bënë sikur nuk e dinin kush ishte, edhe pse duhej t'i kishin përcjellë që nga restoranti "Fjala", në mes të Prishtinës, ku kishin drekuar se bashku me Naitin. Tani unë pyes gjithkënd: A ishte e drejtë që drejtuesi kryesor i luftës dhe zëvendësi i tij, sipas mendimit tim, të shkojnë në mes të ditës, në një restorant në Prishtinë (që njihej si çerdhe e inspektorëve të sigurimit), të drekojnë pa të keq kur në të gjithë Kosovën kishte filluar vala

e madhe e arrestimeve? Si mund të drejtohet një ushtri klandestine duke qenë legalë dhe të hapur komandarët e saj? Nuk e kuptoj, nuk e kuptoj fare.

Uroj që këto dyshime të jenë vetëm rrjedhojë e mënyrës së rezonimit tim.

Mbase ndonjëherë do të sqarohet, si ndodhi që Adem Jashari dhe Zahir Pajaziti të mos ishin që nga fillimi kuadro ushtarake në pozicion të parë dhe të dytë në shtab të përgjithshëm, por të ishin të tjerë, Naiti dhe Xheladini. Shtoja kësaj edhe fatkeqësinë se Azemi kishte caktuar veten e tij për komandant të përgjithshëm, (ende nuk e di askush datën se kur u caktua ai në këtë post, e për më tepër se kush e caktoi), atëherë mund të merret me mend përse kishte vështërsi në formimin e, më pas, në konsolidimin e strukturave komanduese të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kur këtë ma pat thënë Azemi, gjoja në besim prej shoku, kurse unë e kuptova se po donte të më imponohej si autoritet (meqë vendime të tilla nuk i tregohen as shokut), i pata thënë mos ta dëgjon më njeri "sepse ty nuk ta beson as gruaja kuletën e familjes që ta menaxhosh, e lëre më të na bëhesh komandant i përgjithshëm!" Sigurisht m'u pat hidhëruar, por nuk shfaqi armiqësi të hapur, as në atë moment, as pastaj. Vazhdonim të bashkëvepronim duke taktizuar ndaj njëri-tjetrit.

(B.I.:) *- Në kuadër të Organizatës ka pasur edhe një sektor të rëndësishëm, i quajtur Sektori i Lidhje-mbajtjeve, i drejtuar nga Emrush Xhemajli dhe Gafurr Elshani. Ky sektor, sa dihet, nuk ishte si Sektori i rëndësisë së veçantë, që nuk i raporte Këshillit të Përgjithshëm, por vetëm Kryesisë. Duke qenë i tillë, si ishin raportet e tij me Këshillin e Përgjithshëm?*

(I.K.:) - Që të dy sektorët duhej t'i raportonin vetëm Krye-

sisë, kurse Kryesia i raportonte Këshillit të Përgjithshëm vetëm gjëra për të cilat Kryesia mendonte se nuk rrezikoheshin organizimet në Kosovë. Përgjithësisht, duke qenë të merakosur e të shqetësuar për zhvillimet në Kosovë, në vitet 1996-97, shumë anëtarë të KP-së nuk ishim të kënaqur me Kryesinë, përkatësisht me pazotësinë e saj për të menaxhuar kompetencat e tyre. Fatkeqësisht unë isha më i "zhurmshmi". U shpreha kështu, sepse, mendoja, nuk isha "i zhurmshëm" e i "padisiplinuar", siç më quanin shpesh, qoftë për të më neutralizuar, qoftë për të më disiplinuar, por mendoja se kisha arsye për të qenë kritikues e kërkues. Sidoqoftë unë e kam menduar gjithnjë se puna e tyre ka qenë e vyer, me sakrifica, ka qenë edhe e vështirë, sepse lidhjet me Kosovën nuk ishin të lehta, sepse mund të kishte dekonspirime dhe pas tyre, arrestime e dëmtime. Qoftë Emrush Xhemajli, qoftë Gafur Elshani ishin shokë që punonin gjithmonë me ndershmëri të madhe, nganjëherë edhe mbi forcat e tyre, ata, si thojnë, nuk ndaleshin, ishin gjithnjë në lëvizje dhe në ruajtjen e lidhjeve. Por, po ashtu mendoj se vetë fakti i klandestinetit e bën të mundur që të ketë edhe mangsi, të ketë shkëputje të lidhjeve, dhe e meta e tyre themelore do të thoja, ishte se për disa vite, nuk bënë të mundur që Këshilli iPërgjithshëm të konstituohej brenda në Kosovë, si organi më i lartë udhëheqës i Organizatës. Kur ata menduan se ishte koha për ta bërë, ishte tepër vonë, tashmë ishin të tjerë që i bënin rregulat e "lojës". Sidoqoftë, seriozitetin e tyre dhe përkushtimin ata e dëshmuan edhe me shkuarjen e tyre në luftë, që nga fillimi, aty ku ishin më të dobishëm.

Por ajo e metë që citova më sipër, dashje pa dashje, la hapësirë për të krijuar gjendje jo të kënaqshme në organizatë, nga e cila erdhën edhe sherre të dëmshme.

(B.I.:) - Ti, Ibrahim, shpesh herë ke zotësinë të shohësh anën, si të thuash, të padashur të gjërave, dhe më pak atë që vërtet nuk duket edhe aq shumë, por që bën dobi. Për disa vite, më saktësisht, që nga dhjetori i vitit 1993, por edhe më parë në forma të tjera, grupi i caktuar për lidhje-mbajtje, ku ishte edhe Bilall Sherifi, në mos gaboj, ka ngritur mjaft struktura, të cilat, pas arrestimeve të fillimgushtit 1993, ishin të dëmtuara, të paralizuara ose në pritshmëri. Kjo nuk ka qenë një punë e lehtë, që mund të bëhej vetvetiu, sepse tek njerëzit në Kosovë po ndodhnin shndërrime të rëndësishme, dhe më kryesorja do të jetë në qëndrimin e tyre ndaj fillimit të luftës së armatosur. Sanimi i gjendjes, siç quhej asaj kohe, ka qenë një përpjekje e mundimshme. Fillimisht, sipas vendimit përkatës, atë e marrin përsipër Adnan Asllani, Hashim Thaçi, Shaban Shala dhe Kadri Veseli, tre nga të cilët ishin jashtë Kosovës, ndërsa Shabani, si gjithnjë, ishte në Kosovë. Në harkun e pak muajve, deri në dhjetor, ata arritën të kenë disa ringritje, riorganizime, riformatime të këshillave popullorë, dhe fakt është se, sipas konstatimit të Hashim Thaçit, në Kosovë tashmë ekzistojnë mundësitë për vazhdimin e luftës, është marrë edhe vendimi për ta vazhduar atë. Sektori i Lidhje-mbajtjeve, për mendimin tim modest, bëri një gabim: ai i përqendroi punët vetëm në një adresë, jashtë Kosovës dhe mbështetja tek një drejtues i grupit në Kosovë, ishte e vakët për të mos thënë, se nuk ekzistonte. Ndaj them me bindje se në ngjarjet e marsit të vitit 1998, njerëzit në Kosovë, u dëshmuan më operativë se drejtuesit e Organizatës jashtë vendit. Por, le të kthehemi tek ngjarjet që lamë pas, në marsin e vitit 1998.

Tiranë, mars 1998

Në marsin e vitit 1998, menjëherë pas fillesës së luftës, e gjithë Kryesia e Organizatës, nuk e di me vendim apo jo, shkoi në Tiranë. Së bashku me të, si anëtar i Këshillit të Përgjithshëm, shkove edhe ti. Ka dy gjëra: u bë mirë që Kryesia shkoi në Tiranë, pse ishte afër ngjarjeve dhe njerëzve, por nuk u bë mirë që shkoi e gjitha dhe Lëvizja në perëndim ngeli për disa kohë, jashtë angazhimit të ri, në kushtet e reja.

(I.K.:) - Sa për informim të natyrës teknike, nëse mund të thuhet kështu, në Tiranë unë kisha shkuar qysh në fillim të shkurtit 1998, sepse Refik Hamiti, një bashkëveprimtar që kishte para, donte të investonte atje dhe me luti ta shoqëroja, si njohës i rrethanave në Tiranë.

Me të njëjtin aeroplan fluturoi edhe Azem Syla. Paksa iu hidhërova. Dy-tre ditë me parë e pyeta nëse kishte për të dërguar gjë në Tiranë. Me pat thënë se kishte për të dërguar ca këpucë ushtarake "për djemtë", siç u thoshte ai pjesëtarëve të Ushtrisë. E lamë që të na i jepte këpucët që t'i dërgonim në destinacion. Nuk na i solli dhe as nuk na informoi. Kur u takuam në aeroport të Cyrihut, i fola me hidhërim: "As bartjen e këpucëve nuk ma besove, por erdhe vetë të harxhosh kot e kot financat e Fondit edhe për të tillë angazhim!".

Kryesia e Lëvizjes u zhvendos nga Perëndimi në Tiranë pas Epopesë së Jasharëve dhe shpërthimit të Kryengritjes së armatosur. Më gjetën në Tiranë. Më pyetën, ku mund të vendoseshin? Do fati dhe po më kërkonte Kryetari i Lidhjes se Shkrimtarëve, Xhevahir Spahiu. Me të isha miqësuar prej kohësh dhe pothuajse përditë më takonte që të informohej për zhvilli-

met në Kosovë. Kësaj radhe ia shfaqa lutjen, të na ndihmonte të gjenim një shtëpi të përshtatshme, që ta kishim si pikë takimi dhe qendër koordinuese. Ai, pa një pa dy, nxori nga xhepi tufën me shumë çelësa të Selisë së Lidhjes së Shkrimtarëve, ma lëshoi në dorë, duke më thënë, në stilin e tij, "mos me thënçin Xhevo, nëse nuk jua vë në dispozicion gjithë Selinë, derisa unë të jem kryetar i Lidhjes dhe po ndjehem i lumturuar që kam mundësi të kontribuoj më diç". Informova Kryesinë. Filluan me mbledhjet e tyre maratonike në zyrat lartë, kurse salla e madhe poshtë u akomodua në qendër informimi për gazetarë e qytetarë. Pothuajse err e terr i kishim në sallë Xhevon, Fatos Arapin e shkrimtarë të tjerë patriotë, të cilët po na jepnin kurajë me fjalët e tyre patriotike, kurse Xhevoja dhe Fatosi, kur shpërndaheshim në mbrëmje, na jepnin ca skeda me adresa dhe numra, sa veta mund t'i çonim për të kaluar natën te njerëzit e tyre. Në të kundërtën, shkrimtarët Agim Gjakova dhe Adem Istrefi, ditën e kalonin aty, me llafe të mëdha, kurse në mbrëmje iknin, pa u merakos ku do të strehoheshin veprimtarët.

Mendoja se nuk kishte gabuar Kryesia që qe zhvendosur në Tiranë, sepse Lëvizja në Perëndim nuk pat mbetur pa udhëheqje. Kishim kryesitë e nëndegëve në secilin shtet dhe ato ishin mobilizuar për të bërë më të madhën që ishte në mundësitë e tyre. Më shumë po më brengoste fakti se ajo, aty për aty, po improvizonte Shtabin e Përgjithshëm.

(B.I.: / Ndëhyrje:) - Pse shkuat në Tiranë dhe pse u bë mirë, do të ma thuash mendimin tënd. Që anëtarët në Perëndim mbetën disa kohë në mjegull do ta them mendimin tim. Mjafton të kujtoj se pikërisht në këtë kohë, duke shfrytëzuar dhimbjen e njerëzve, qeveria e quajtur Bukoshi, fillon aksionin financiar "Gjithçka për Drenicën" dhe grumbullon dhjetëra e qindra milionë marka gjermane, ndërkohë që Shtabi i Përg-

jithshëm dhe strukturat drejtuese të luftës nuk kishin mundësi të ndihmonin njerëzit që vinin në Shqipëri. Po të tregoj vetëm një rast, kur dy anëtarë të Kryesisë së Nëndegës në Gjermani, në një mbledhje në qytetin e Ulmit, ku kishte dhjetëra e qindra bashkatdhetarë, nuk kishin asnjë të dhënë për Takimin që ishte bërë me Bukoshin, dhe ku gjoja kishte qenë edhe Fehmi Lladrovci, i cili kishte nënshkruar, sipas këtij spekulimi inicimin e të gjithëve nën "yllin" e Bukoshit. Ndërkohë ne e dinim se Fehmiu ishte rrugës për në Kosovë ose edhe kishte arritur atje. Dhe çfarë ndodh!? Me këtë letër në dorë, spekulantët shkojnë edhe tek familja e Adem Jaharit në perëndim, ia mbushin mendjen, duke e mashtruar edhe Rifat Jasharin, se u bë bashkimi dhe e bëjnë fakt të njohur. Për disa ditë me radhë qeveria "Bukoshi" spekuloi me këtë bashkim. Fakti, ndërkaq, është se të gjitha ndihmat, të domosdoshme, jetike në atë kohë, shkuan në llogaritë e atyre që nuk e dhanë kurrë një ndihmë për Luftën në Kosovë. Kryesia mund të ndahej në dy pjesë, ajo ushtarake dhe e lidhje-mbajtjeve në Tiranë, ndërsa pjesa e politikës, në Perëndim.

Por t'i marrim me radhë: pse shkuat në Tiranë?

(I.K.:) - Besoj, dhashë një shpjegim. Po shtoj edhe diçka sa u përket sqarimeve që ofruat, për të më orientuar se çfarë më shumë ju intereson të rrëfej.

Them se nuk ngelën në mjegull vetëm bashkëveprimtarët që kishim në Perëndim, por të gjithë shqiptarët: në Kosovë, në Shqipëri, në emigracion, në diasporë e gjetiu. Ishim në mjegull nga shoku që përjetuam kur u informuam për përmasat e krimit nga ana e fashistëve serbë dhe përmasat e sakrificës stoike të Familjes Jashari në Prekaz. Kushtimisht, përjashtim nga gjithë shqiptarët bënin vetëm "presidenti" Rugova dhe argatët e tij

më të afërt dhe kozmopolitët në Prishtinë.

Bujar Bukoshi, si usta që ishte për të plaçkitur para nga emigrantët, që pastaj t'i shpërdoronte e përvetësonte, gjykoi se ishin rrethanat më emocionale për të mbledhur të gjitha të hollat që kishin emigrantët. Fillimisht, për të mbledhur maksimumin, ai vendosi t'i mashtrojë edhe aktivistët e Lëvizjes që të kyçeshin në aksion, për të mos i pasur konkurrues. Propozimin e tij e mirëpret Lëvizja dhe në takime dërgon përfaqësuesit e saj. Po mendonim se situata e re duhet ta ketë ndërgjegjësuar, që luftën ta bënim se bashku. Por, sapo u testua me kërkesat e para për të dhënë mjete financiare dhe ai nuk i dha, u tërhoqëm nga marrëveshje. Sigurisht, ai doli fitues, sepse ai ka qenë usta i bixhozit qysh kur kishte ushtruar profesionin si mjek në Drenas. Dhe vërtetë grumbulloi qindra milionë marka përmes atij aksioni, kurse ne na mbeti të mblidhnim kryesisht nga anëtarët dhe simpatizantët tanë, të cilët financiarisht i kishim lodhur edhe më herët.

Meqë jemi të kjo temë, pas ca ditësh, vonë në mbrëmje, krye më vete në Zyrat e "qeverisë" Bukoshi në Bon, shkojnë Isuf Iberdemaj dhe Genc Kelmendi. Prej aty me telefonojnë se janë në zyrë të Bukoshit, por se ai s'po jep mjete financiare. U thashë: "Ose kidnapojeni, ose vrisne, nëse nuk ua jep të gjitha parat që i ka ai kriminel aty!". Muhamet Kelmendi qëlloi pranë, ma mori telefonin nga dora, duke më bërtitur: "Mos u bëj hajvan, je në gjendje shoku". Muhameti bisedoi me Gencin (nipin e tij), e këshilloi të mos bënin ndonjë marrëzi, ta bindnin Bukoshin që të jepte ndihma, sepse nuk kishim mjete për t'u dhënë as bukë njerëzve që kishin ardhur nga Kosova në Tropojë, vetëm për t'u armatosur dhe për t'u kthyer mbrapa që të mbronin familjet e tyre dhe popullin kundër agresionit fashist serb.

Kurse sa për zhvendosjen e Kryesisë nga Perëndimi në Tiranë, ka qenë më tepër se e nevojshme. Tjetër se ajo u sabotua, u pengua dhe së fundi u përzu që andej. Asnjë shtetar i shtetit shqiptar, megjithë kërkesën e parashtruar, nuk gjeti "kohë" të takohej me Kryesinë. Përndryshe, edhe po të kishte qenë Kryesia në Perëndim, kriminelët Bukoshi dhe Mustafa po njësoj do të na mashtronin, thuajse njësoj do t'i mblidhnin, shpërdoronin e përvetësonin ndihmat e atij aksioni.

Sa për informim, na ka dhënë disa mjete financiare, fillimisht, nëse nuk gabohem, diçka më shumë se dy milionë marka ia ka dhënë Xhavit Halitit. Më vonë u ka dhënë disa komandantëve të rangut të dytë në disa zona të Ushtrisë sonë, por ato për qëllime përçarëse e diversioni. Ndoshta rreth 40 milionë duhet t'ia ketë dhënë Ahmet Krasniqit për të formuar e armatosur FARK-un.

Prandaj edhe i influencuar nga gjithë ato rrjedha, emocione e tensionime, me një rast pata sugjeruar ta kidnapojnë ose t'i japin fund Bukoshit, nëse nuk do të jepte ndihma financiare.

(B.I.: / Ndërhyrje:) *- Vërtet, ashtu pate dhënë porosinë!?*

(I.K.:) - Po. Më lejoni të sqaroj. Unë jam i interesuar të rrëfej sa më me vërtetësi për rrjedhat dhe zhvillimet e kohës; të paraqes dyshimet, mendimet e vlerësimet e mia të atëhershme dhe jo të jem konjuktural, siç po ndodh me disa.

Më vonë reflektova dhe u binda se ajo porosi ishte rrjedhojë e gjendjes tmerrësisht të rëndë, sepse të ballafaqohesh me njerëz që kishin udhëtuar këmbë me orë të tëra nëpër bjeshkë, kishin përfunduar në kullë të Sylejman Berishës në Viçidol të Tropojës dhe në livadhin përreth kulle ishin rreth 1.400 veta që erdhën brenda natës, dhe të mos kesh para t'u japësh as bukë e djathë; të mos kesh financa për t'u dërguar armë e municion

kryengritësve në Kosovë, kur Serbia ishte tërbuar fare, ndërkohë që kriminelët Bukoshi dhe Isa Mustafa bllokonin me qindra milionë marka para të emigrantëve që i kishin dhënë edhe për këtë gjendje të rëndë, a nuk e meritonin? Ata, sipas çdo ligji të luftës në botë, do të dënoheshin merituesheëm. Cili popull nuk do t'i kishte vrarë ata gjatë luftës për krime të tilla?! Dhe, atyre kriminelëve nuk po u mjaftonin qindra milionë marka që kishin grumbulluar gjatë viteve paraprake, por ata farë "pacifistësh" po mashtronin emigrantët edhe në gjendje lufte. Edhe disa hidhërime të mëhershme, gjatë disa muajve pararendës patën bërë që kupa egërsimit tim të tejmbushej. Në dhjetor të vitit 1997 i pata kërkuar takim Bukoshit. Ai, për t'u bërë më interesant, gjoja për t'u ikë syve të LDK-së, caktoi vendtakimin në Aeroport të Cyrihut. Shkova me Jashar Salihun. E informuam për zhvillimet në Kosovë dhe i kërkuam mjete financiare për UÇK-në. Ai gënjeu se nuk e lejon "presidenti" dhe Kryesia e LDK-së. Se mos i pyeste ai ata. Faktikisht, as Rugova, as LDK-ja nuk dinin sa para kishin grumbulluar, si i kishin shpërdoruar dhe tjetërsuar. Kurse, pak ditë përpara porosisë që pata dhënë për ta kidnapuar ose për ta vrarë (nëse nuk i jep të gjitha paratë që kishte në zyrë), Bukoshi në zyrën e "ambasadës" së Kosovës në Tiranë, ma cenoi rëndë integritetin dhe dinjitetin personal, duke më urdhëruar ta lëshoj takimin me oficerët, të cilin unë e kisha bashkorganizuar. Për të mos e zgjatur, kjo ishte gjendja ime shpirtërore në momentin kur po u kërkoja Jusufit dhe Gencit aktin e sipërpërmendur. Më vonë qeshë fjalosur edhe me Muhametin, duke i thënë se nuk ishte i përgatitur për të qenë udhëheqës lufte.

Kufiri shqiptaro/shqiptar, pranverë 1998

(B.I.:) - Para se të futemi në debatet për ngjarjet e zhvilluara në Tiranë, le të ngjitemi më lart, në Veri: Çfarë po ndodhte ndërkohë atje, në zonat buzë kufirit shtetëror?

(I.K.:) - Në Veri, gjegjësisht në Tropojë, Ilir Konushevci, Adrian Krasniqi dhe Qerim Kelmendi kishin ngrit bazë logjistike për furnizimin e UÇK-së dhe për koordinim të vullnetarëve të ri. Por, kur shpërtheu kryengritja struktura logjistike që udhëhiqej nga Ilir Konjushevci, nuk kishte mjete financiare as për nevojat më elementare. Kryesia e Lëvizjes nuk kishte mjete financiare. Ky ishte shqetësim serioz. Sikur nuk mjaftonte kjo, më vjen lajmi se policia e Tropojës kishte burgosur vëllanë tim, Qerimin, bashkë me një grup komandosësh, kur ishin nisur për të kaluar në Kosovë. Ata komandos sapo i kishte përgatitur ushtaraku Kadri Kastrati në Qerret të Durrësit. Në mesin e komandove ishte edhe Bekim Shyti (i Oshlanit të Vushtrrisë), i cili më pas do të shquhet për luftime të guximshme dhe komandime të zhdërvjellëta.

Pasi ra fjala për Bekimin, po rikthehem që të rrëfej për njohjen e parë me të, meqë e quaj me rëndësi.

Me 14 mars, vetëm ca ditë pas Epopesë se Jasharëve, po kaloja pas Hotel Tiranës, për të shkuar në vendstrehimin tim. Aty shoh një djalosh trupgjatë, me flokë të lidhur prapa koke. Nuk di pse ma tërhoqi vëmendjen, ndoshta pse nuk mund të priste i qetë dhe as nuk ecte. Iu afrova dhe e pyeta përse po priste aty. Ai, i befasuar, ma ktheu, përse po më interesonte. E sqarova se po më dukej i shqetësuar ndaj dëshiroja ta ndihmoja, nëse kisha mundësi. Tha, po priste taksi për të shkuar në aeroport,

pastaj në Gjenevë, por ishte në dilemë. E luta të ulshim të pinim nga një kafe. Refuzoi me arsyetim se do t'i ikte aeroplani. Sërish e luta, duke i premtuar se po i iku aeroplani për shkak të kafes, do t'ia paguaja biletën e re. Më pyeti kush isha dhe sapo dëgjoi emrin tim, pranoi. U ulem në hajat të kafes "Çaplin", pas Muzeut Kombëtar. E luta të prezantohej. U prezantua. E luta të tregonte pse ishte aq i shqetësuar. Rrëfeu se kishte ardhur para dy ditësh për të takuar njerëz të UÇK-së, që të armatosej dhe të kthehej sërish për të luftuar në Kosovë. Donte të hakmerrej për tmerrin që kishte parë e përjetuar. Dhe nxori dy filma negativë fotografish nga xhepi, duke thënë se aty i kishte të fiksuar trupat e masakruar të Jasharëve dhe varrimet e tyre. Sakaq i besova. E luta të shkonim që t'i zhvillonim, duke e siguruar se do t'i kompensohej bileta për aeroplanin që do t'i ikte. "Nuk do të kthehem më në Gjenevë" - foli shkurt duke u ngritur nga Tavolina. Shkuam te fotografi më i afërt. E lutëm të na i zhvillonte sa më shpejt. I duhej të paktën një orë. Bekimi nuk pranoi të shkonim sërish në kafe dhe të ktheheshim pas një ore. Gjatë shtypjes së fotografive ustai zuri të qante dhe nxori një ofshamë: "Çfarë masakrash të llahtarshme paskeni fiksuar...!" Po lotonim edhe ne. Fotografi nuk na mori hakun që i takonte. Prej aty shkuam në televizion. Gjatë rrugës po e bindja që t'i prezantonte fotografitë duke informuar për secilën. Po ngurronte, meqë nuk kishte dalë ndonjëherë në televizor. Atje takuam Besa Çekun dhe Asllan Bajramin. I binda se duhej t'i prezantonin. Ramë dakord të përgatitnin prezantimin dhe intervistën menjëherë dhe jo drejtpërdrejtë, sepse Bekimi nuk ishte i sprovuar.

Emetimi i atyre fotove në darkë shkrehu Shqipërinë në vajë. Ajo gdhiu ndryshe, ua zbuti shpirtrat edhe ca pushtetarëve për t'u bërë më tolerantë ndaj angazhimeve tona logjistike.

Bekimi më pat rrëfyer eksesin që kishte pasur gjatë varrimit me Dr. Zekeria Canën. Ai kishte provuar t'ia ndalonte fotografimin, por ky e kishte kërcënuar se do ta rrihte po e pengoi. Pastaj, po ai Zekëria Cana, po gënjente duke përvetësuar autorësinë e atyre fotografive, pasi i pa të emetoheshin nga televizionet e botës.

Të nesërmen Bekimi insistoi ta dërgonim në Kosovë. E dërgova në ushtrime për komandos, të cilat para 4-5 ditësh i kishte filluar ushtaraku Kadri Kastrati. Kur shkuam në Qerret, pashë se të tjerët pjesëmarrës në ushtrime kishin kokat e rruara. Kadriun e luta ta toleronte Bekimin, sepse nga Kosova ishte arratisur si fëmijë 14-vjeçar, pa shoqërim familjar, dhe ishte rritur në një familje suedeze meqë, si fëmijë, shteti suedez nuk e kishte strehuar në kampe. Në moshë 18-vjeçare kishte kaluar në Zvicër. Atje ishte marrë edhe me ushtrime të sporteve luftarake. Kadriu më mirëkuptoi dhe më premtoi se do ta bënte atë përjashtim. Të nesërmen kur shkova t'i vizitoj, pashë Bekimin me kokë të rruar. Kadriu sqaroi se ai vetë pat vënë kusht: o do të më qethni si bashkëluftëtarët, o do të largohem nga ushtrimet!

Ja, këta komando të përgatitur shpejt e shpejt, të cilët Qerimi donte t'i fuste në Kosovë, i kishte burgosur policia shqiptare.

E luta Xhavitin të angazhohej për t'i liruar. Nuk u shqetësua fare. Shkova vetë në Ministri të Brendshme. Në portën hyrëse hezituan të më lenin brenda, meqë nuk kisha caktuar takim. U thashë se po shkoja te Ndre Legisi, meqë tjetër emër nuk më kujtohej. Nga porta i telefonuan Legisit, ia thanë emrin, më pranoi. Ia paraqita rastin e burgimit. U befasua, por tha se duhej të shkoja të Sokol Bare, Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shqipërisë. Nuk e gjeta në zyrë.

Po prisja para derës. Më pa zëvendësi i Sokolit, miku gjirokastrit Ilir Çano. Më mori për krahu dhe më futi në zyrë. Më pyeti çfarë shqetësimi kisha. I tregova. "Je me fat që të takova unë, se Sokoli mund që do të nxirrte probleme edhe ty këtu". Menjëherë telefonoi në Degën e policisë në Bajram Curr. Urdhëroi që t'i lironin nga burgu, t'i këshillonin të ishin më të kujdesshëm dhe t'i ndihmonin, ku mund të ndihmohen. Pjesëtarët komando u liruan dhe hynë në Kosovë.

Pas disa ditësh, në mbrëmje, më telefonoi Ilir Konushevci nga Tropoja. Më tha se në Tropojë kishin ardhur mbi një mijë veta dhe policia nuk po i lejonte t'i ushqenin. Ata tashmë po sëmureshin nga uria dhe të ftohtit.

E luta Perlat Gojçin, vuthjan nga Qeremi i Tropojës, të na çonte mua dhe Gafurr Elshanin. Pranoi, edhe pse shpjegoi se rruga ishte e vështirë dhe me rreziqe. Kishte xhip të fortë. Shkuam. U informuam për gjendjen nga pjesëtarët e pikës logjistike në Bajram Curr. Po kështu nga Fanol Bardhi u informuam se policia ua kishte konfiskuar xhipin, të ngarkuar me bukë, gjatë rrugës për në Viçidol. Atje ishin rrethuar nga policia rreth 1.400 veta që kishin ardhur nga Kosova, pse nuk po pranonin të regjistroheshin si refugjatë, që pastaj të sistemoheshin në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Gjatë ditës provova ta bindja Drejtorin e policisë që të lironte furnizimin me bukë. Ai nuk pranonte duke u arsyetuar se ashtu e kishte urdhëruar Sokol Bare. Oficeri i Shërbimit Informativ thoshte se një urdhër të tillë nuk e kishte nga shefi i tij, Fatos Klosi. Gjatë peripecive vizituam hallexhinjtë e sfilitur nga uria e të ftohtit, ngase po plotësohej dita e tretë që po e vuanin dënimin me uri nga Drejtori Sokol Bare. Njëri nga hallexhinjtë u prezantua se ishte kryetar i LDK-së në Junik, mësues i anglishtes. Luti që ta

vinim në kontakt me ambasadorin e Kosovës, Iljaz Ramajlin, që të vinte e t'u binte mbrapa. Ia mundësuam të lidhej me të përmes telefonit satelitor nga Viçidoli. Ramajli iu përgjigj me arrogancë, "nuk ju kemi thirrur prandaj nuk kemi obligim ndaj jush". U thashë t'i zgjidhnin pesë veta si përfaqësues, të vinin me ne që të mundohemi ta bindim policinë të lironin bukën. U lajmëruan pesë vullnetarë. Nuk i la policia të vinin me ne. Kur u ktheva sërish në polici, zëvendësi i drejtorit më sugjeroi me zë të ulët: "Mashtro Drejtorin Hyka e shkoni në Tiranë, unë ndoshta do mund të çoj bukën gjatë natës, sepse i shkoi fytyra Malësisë së Gjakovës!" I telefonova Fatos Klosit. Pyeta a mund të takoheshim me të dhe Sokol Baren, nëse do të shkonim me Drejtorin Hyka që të zgjidhnim gjendjen tmerruese e turpëruese. Fatosi miratoi. Hyka thirri një mik të tij, me arsyetim se ka xhip të mirë. Ai kërkoi 300 dollarë për të na dërguar natën në Tiranë. U nisem, duke marrë arsenal armësh me vete, meqë gjatë rrugëtimi ndodhnin prita plaçkitësish. E pyeta shoferin se mos po bëhej përfitues lufte duke kërkuar 300 dollarë për atë rrugëtim. Ai u arsyetua, meqë po përfitonte Besnik Tafa (Krasniqi), në shtëpi të të cilit ishin vendosur pjesëtarët e logjistikës për "pikën" në Tropojë, pse të mos përfitonte edhe ai. Kur e binda se Besnikut nuk po i jepnim asgjë, se ia kishte lëshuar shtëpinë kushëririt të tij, dëshmorit (tani heroit) Adrian Krasniqi pa kompensim financiar, ai foli: "E pifsha gjakun e djalit tim, po t'i mora 300 dollarët!"

Në Tiranë duhet të kemi arritur pak pas mesnate. Në kabinetin e tij të punës po na priste Shefi i SHIK-ut, Fatos Klosi. I telefonoi Sokol Barës. Na informoi se nuk po e kontaktonte dot qysh nga ora 19.00 kryeministrin Fatos Nano dhe kjo po e shqetësonte. Erdhi Sokol Bare. Edhe ai njoftoi se nuk po e kontaktonte dot Nanon. Kryeministër e jo mahi! - më doli një

ofshamë. Sokolit nuk i erdhi mirë. Zumë të bisedonim se si të hiqet bllokada e urisë. Sokol Bare nuk pranonte, me arsyetim se ashtu e kishte urdhëruar kryeministri Nano. Fatos Klosi thoshte se ai nuk ishte informuar për një vendim të tillë. Filluan polemikat. Sokoli me kërcënoi me arrestim të atypëratyshëm. Fatosi tha "nuk ka njeri që e arreston në zyrën time, sepse nuk jam besëprerë.". U acarua gjendja, u prish ndeja pas rreth dy orë polemikash e fjalosjesh. U kthyem për Bajram Curr. Arritëm rreth orës tetë të mëngjesit. Drejtori Hyka urdhëroi të mblidheshin të gjithë policët para hyrjes së drejtorisë. I urdhëroi të forconin rrethimin. Unë mora fjalën, fola shkurt, me emocione, se si po e turpëronin Malësinë historike të Gjakovës policët malësorë.... Policët deklaruan dezertimin. Hyka m'i hodhi çelësat para këmbëve, duke thënë, "tani ti je drejtor". Mora çelësat. Iu drejtova policëve të rrinin aty në gatishmëri dhe të përgatiten 5 policë për të dërguar bukën në Viçidol. Njërin e urdhërova të shkonte te shtëpia e Besnikut dhe të njoftonte furnizuesit e UÇK-së, të vinin me bukë për ta çuar në Viçidol. Hyra bashkë me Hykën në drejtori, e luta të vinte të më tregonte si ta bëjë punën. U ulëm në zyrë të drejtorit. Gjatë bisedës, pas rreth 15 minutash, në drejtori hyn pjesëtarët e njësisë speciale "Brisku". Komandanti i tyre pyeti, ku ndodhej Ibrahim Kelmendi. Iu prezantova. Foli: "Je i arrestuar!" E pyeta, nëse ishte shqiptar ose minoritar. Ai u hidhërua paksa. Kur ia paraqita zhvillimet, tha: "Jam patriot lab, m'i jepni çelësat e xhipit t'ua çoj bukën vëllezërve. Nuk ka njeri që guxon të më dalë në rrugë dhe nuk lejoj që të turpërohet Shqipëria duke dënuar bashkëluftëtarët e Adem Jasharit me uri." E falënderova duke u përqafuar dhe lotët po më rrokulliseshin për faqe nga emocionet. Labi më këshilloi që të mos e koritja Kosovën, se burri nuk loton. Kështu dezertoi edhe Njësia "Brisku", u thye rret-

himi, mbrapa mbeti turpi për Sokol Barën dhe Fatos Nanon.

Rrethimi u thye, por nuk kishim para për të blerë bukë. Vonë pasdite erdhën Muhamet Kelmendi dhe Adem Grabovci. Më thanë se duhej të shkoja në Tiranë dhe nesër duhej ta lëshoja Shqipërinë. Kështu kishte vendos Qeveria shqiptare, më thanë ata. Pyeta nëse vetëm unë duhej të largohesha nga Shqipëria. Më thanë, edhe anëtarët e Kryesisë. Nuk desha të kthehem. Me bindjen e lutjet e tyre u ktheva me taksinë që kishin ardhur ata. Ditën e nesërme do të ktheheshin ata, paradite, dhe do të largoheshin nga Shqipëria. Në mëngjes shkova në Hotel "Tirana" për të takuar ndokënd. Gjeta Ilir Çanon. Ia shfaqa zhgënjimin dhe hidhërimin për atë urdhër. Ai u habit. "Mos flisni këso marrëzirash, nuk ka të tillë urdhër, por po i sajoni vetë." Më siguroi. U përmbajta pa ia thënë se atëherë ishte komplot i Xhavit Halitit, meqë edhe atë e kishte mik të ngushtë.

Që atë ditë policia në Tropojë u angazhua për t'u përkujdes e ndihmuar logjistikën e UÇK-së, në anën tjetër u aktivizuan mercenarët shqipfolës të Serbisë, të cilët plaçkisnin e vrisnin veprimtarët e logjistikës.

(B.I.:) *- Si ishte gatishmëria e shtetit shqiptar? Në atë kohë ju keni informuar në Këshillin e Përgjithshëm për përplasjet tuaja dhe funksionarë të lartë të Ministrisë së brendshme si Sokol Bare, etj. Si janë zhvilluar ngjarjet?*

(I.K.:) - Shteti shqiptar është gjithëpërfshirës. Një fragment të qëndrimit armiqësor të kryeministrit Nano dhe të Drejtori Sokol Bare e rrëfeva, siç rrëfeva përkrahjen e Shefit të SHIK-ut, mikut patriot Fatos Klosi. Edhe në nivele të tjera dallonte individi nga individi. Ta zëmë, Ilir Meta ishte shndërruar në bashkëveprimtarë, ashtu si edhe Sabit Brokaj. Përgjithësisht, në fillim transportin e armëve drejt Veriut duhej ta paguanim.

Më kishte thënë Xhaviti se kishte bërë marrëveshje, njëmijë dollarë për xhiro duhet dhënë shoqëruesve të transportit. Besoj, mjafton kaq për të kuptuar qeverisjen e Nanos deri më 15 shtator 1998, kur vetë ai, kryeministri Nano u arratis në Maqedoni, që të strehohej.

Përsëri në Tiranë, ardhja e ushtarakëve

(B.I.:) - Ndërkohë filloi ardhja në Tiranë e ushtarakëve shqiptarë, shumë prej tyre vinin në emrin e Fehmiut dhe të Organizatës. Do të vijnë Bekim Berisha, AB-ja, Naim Maloku, Fadil Demiri, Halil Bicaj, Xhafer Jashari, Bislim Zyrapi, Mensur Kasumi, Agim Çela, Agim Ramadani, Ramadan e Binak Gashi e shumë të tjerë. Si ishte pritja e tyre?

(I.K.:) - Oficerët erdhën sapo ndodhi Epopeja në Prekaz. Kryesia e Lëvizjes kishte mbajtur mbledhje, duke marrë rolin e shtabit të përgjithshëm. Në mbledhje kishin marrë pjesë edhe Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë dhe koordinues i Sektorit të rëndësisë së veçantë si dhe Azem Syla, që ishte vetëm anëtar i Sektorit. Në atë mbledhje ishte vendosur që Ali Ahmeti të merret me sistemim të ushtarakëve, për ndihmës të tij me kishte caktuar mua. Me oficerët po merresha kryesisht unë, meqë Aliu kishte shumë obligime të tjera.

Oficerët kërkuan që të takoheshim me "kryeministrin" Bukoshi. Ata donin të kundërshtonin emërimin e Ahmet Krasniqit për "ministër të mbrojtjes" dhe për komandant të përgjithshëm. Tjetër, donin të kërkonin nga Bukoshi që të njihte UÇK-në. Ai nuk pranonte. Luta Shemsi Reçicën që t'ia ndërronte mendjen. Me Shemsiun ishim miq prej vitesh dhe ai qe angazhuar para pak ditësh këshilltar te Bukoshi, duke marrë edhe pëlqimin

tim. Më në fund ai ia doli ta bindte Bukoshin. Shkuam në "ambasadën" e Kosovës. Bashkë me oficerët edhe Aliu dhe unë. Kur hyri Bukoshi në dhomën e takimit, sapo u ul, kur pa Aliun dhe mua, tha se mund të mbahej takimi vetëm nëse ne do të dilnim. Unë u ndjeva i denigruar dhe mezi përmbajta veten pa e sharë me ç'kishte. Oficerët kundërshtuan, sqaruan se kishin ardhur për t'u angazhuar në UÇK dhe prandaj ne na çmonin për koordinatorë. Bile Halil Bicaj u revoltua, kërkoi leje që të fliste boshnjakisht, që të mund të shprehte më fuqishëm mllefin. I foli goxha brutalisht Bukoshit. Oficerët i thanë Bukoshin se nuk e njihnin për komandant Ahmet Krasniqin. I shpjeguan disa arsyetime se gjatë gjithë luftës në Kroaci kishte luftuar në anën e Serbisë, etj. Tubimi përfundoi pa asnjë marrëveshje.

Sapo u formua FARKU dhe komanda e tij, me disa oficerë u mora vesh kush duhej të shkonte në komandë të FARK-ut. U vendos që në FARK të angazhoheshin Xhafer Jashari, Fadil Demiri, Ramadan e Binak Gashi, Agim Haziri, Agim Ramadani. E quajtëm të mjaftueshëm të shkonin vetëm këta, të paktën të informonin se çfarë do të bënte FARK-u dhe nëse do të provonte të merrte vendime për të hyrë në luftim kundër UÇK-së, ta pengonin, në pamundësi së paku të na informonin.

Po kalonin ditët dhe oficerët tjerë po prisnin ku do t'i angazhonte shtabi i përgjithshëm i UÇK-së. Ata nuk dinin se ende nuk kishim shtab dhe unë nuk po u tregoja, për të mos i dekurajuar. Oficerët po i angazhonte në logjistikë Ilir Konusheci, që të prisnin në mënyrë aktive derisa të sistemoheshin në Kosovë.

(B.I.:) *- Mes ushtarakëve dhe drejtuesit të Zonës Operative të Dukagjinit ndodh këto ditë një përplasje e ashpër, si rrjedhojë e keqkuptimeve. Cila ishte kjo përplasje?*

(I.K.:) - Në fund të marsit ose në fillim të prillit Ramush

Haradinaj, Komandant i Zonës së Dukagjinit, vjen në Tiranë. Prej Xhavit Halitit kërkon të dërgoheshin ushtarakë në atë Zonë, por Xhaviti e dezinformon, se ushtarakët nuk po shkonin, nga se e kishin gjetur mirë në Tiranë, duke shpenzuar kot paratë e popullit. Me atë turr Ramushi shkon në strehimoren e ushtarakëve, gjen aty Naim Malokun, Beslim Zyrapin, Mensur Kasamin, Agim Çelën e ndonjë tjetër. U flet rëndë dhe shkon pa pritur sqarime. Kur u ktheva në atë strehimore, gjeta Mensurin të përlotur. Pyeta çfarë kishte ndodhur. Më rrëfyen se Ramush Haradinaj i kishte akuzuar e fyer. I telefonova Ramushit për t'u takuar. Zuri të më bërtiste. Ia ktheva me të njëjtin ose me tonë edhe më të lartë. Pastaj u qetësua ca për të më dëgjuar. E sqarova se oficerët po mërziteshin duke pritur. Përditë lusin individë të shtabit që t'ua caktojnë vendin. E mbyllëm bisedën pa u sqaruar dhe pa pranuar që të takoheshim. Pra, nuk kishte ndodhur përplasje, pasi për përplasje duhen dy veta ose dy palë. Në rastin konkret Ramushi ishte dezinformuar nga Xhaviti dhe Nesim Haradinaj dhe ishte zbrazur gabimisht ndaj ushtarakëve.

Naimi, i revoltuar nga sharjet e Ramushit, shkon menjëherë në Hotel "Tirana". Aty gjen Muhamet Kelmendin dhe Xhavit Halitin. U ankohet. Edhe Xhaviti sillet keq ndaj tij, ndoshta më keq se Ramushi.

Të nesërmen Naimi niset për Tropojë. E pata shoqëruar. Atë natë u fut në Kosovë i shoqëruar nga furnizuesit e UÇK-së, djemtë e familjes Demiri nga Morina e Gjakovës. U angazhua në Zonë të Dukagjinit.

(B.I.): *- Ndërkohë, si me urdhër të peshkut, krijohet FARK-u. Një strukturë paraushtarake, që në fakt nuk u bë kurrë ushtarake, por e rrezikshme, sepse mund të fuste vendin në një luftë brenda vetes. Mendimi im i bindur është se krijimi i kësaj qend-*

re nuk ishte asgjë tjetër, veçse ndarja e strukturave të luftës, mbajtja peng e ushtarakëve dhe krijimi i një alibie për to, që të mos futeshin në luftë, ashtu siç edhe ndodhi. Krijues të FARK-ut, sipas shërbimit sekret të Zvicrës, do të jenë Bujar Bukoshi dhe Xhafer Shatri. Drejtues u bë Ahmet Krasniqi, figurë e njohur në Luftën e zhvilluar në Kroaci,ku kishte qenë në anën serbe, i zënë rob dhe i ndërruar me një ushtarak të lartë kroat. Atëherë, pse ndodhi ndërtimi i FARK-ut? A ishte në dijeni Organizata se mund të krijohej një strukturë e tillë? Kush ishte Ahmet Krasniqi? A vendosi lidhje Organizata me FARK-un? Si u vendos të dërgohet brenda në FARK, Halil Bicaj, njeriu që më pas do të vendoste një urë mirëkuptimi mes FARK-ut dhe UÇK-së?

(I.K.:) - Formimi i FARK-ut më kishte ngjarë me formimin e LDK-së. Marrëzia nuk kishte fund. Strukturat "pacifiste" po formonin forca të armatosura. Jo, kështu i kishte urdhëruar Beogradi, mendoja atëherë. Dhe njësoi siç e kishte vënë Beogradi në krye të LDK-së Ibrahim Rugovën, edhe në krye të FARK-ut e kishte vënë Ahmet Krasniqin. Pra, thënë shkurt e shqip, kisha bindjen se formimin e kësaj strukture e kishte urdhëruar Beogradi, për t'ia kundërvënë UÇK-së. Nuk vonoi e për këtë u dha prova. Formuan një brigandë, caktuan të inkriminuarin Tahir Zemajn për komandant të saj. Brigada hyri në Zonë të Dukagjinit, sepse ishte Zona me më se shumti armatim e ushtarë dhe ishte Zona buzë kufirit, që shërbente për bartjen e armatimit edhe për zonat e tjera. Tahir Zemaj ia doli të shpartallonte UÇK-në e asaj Zone dhe u kthye në Tiranë.

Për Ahmet Krasniqit kam shpreh dyshimet, mendimet e vlerësimet disa herë publikisht, edhe me shkrim, qysh kur ai ishte gjallë. Bindja ime e atëhershme ishte se ai ishte pro-

serbi më i thekur dhe më i angazhuar. Këtë bindje e pata krijuar nga shumë burime.

Takimi i Adem Demaçit dhe Xhavit Halitit me Ahmet Krasniqin në Osllo, në zyrën e Fatmir Zymberit, qe një befasi dëshpëruese për mua dhe ende nuk jam informuar, kush i autorizoi Ademin e Xhavitin të takoheshin me atë farë Ahmetin. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe, u morën vesh për të mos u marrë vesh.

Interesante ishte përpjekja e Sabri Novosellës për të mbrojtur Ahmet Krasniqin. Ai thoshte se me sugjerimin e tij Ahmeti ka shkuar në akademi ushtarake, se ishte nip i Aziz Zhilivodës, prandaj ishte patriot, etj. Nuk kam nevojë t'i kontestoj të tilla belbëzime të Sabriut, por askush nuk qe në gjendje të shpjegojë, përse e lejoi ushtria jugosllave Ahmetin të bënte gjithë atë karrierë ushtarake, kur ishte nip i Aziz Zhilivodës? Pseudo argumenti, se ua kishte hedhur duke ndërruar mbiemrin, sa ishte qesharak, po aq ishte i mjerë. Pavarësisht prejardhjes, vetë biografia e tij, sidomos angazhimi në luftën serbe, janë argumente që dëshmojnë se cili ishte ai.

Do fati që bëmat e tij proserbe t'ia thyejnë Ahmetit qafën. Një ushtar i Brigadës së Tahir Zemës ia jep dënimin e merituar - atentat patriotik!

Pas vrasjes së Ahmet Krasniqit u ktheva në Shqipëri, meqë disa ditë kisha qenë në udhëtime tepër të largëta. Disa shpifarakë ma veshin mua meritën e organizimit të atentatit. Shefi i Kundërzbulimit të FARK-ut, bashkëfshatar i Bujar Bukoshit, më takoi për të marrë mendimin tim. Që të mos e mundoj atë menjëherë i thashë: merita për atentat nuk më takon mua, por kur të zbulohet atentatori, nëse nuk kam pasuri tjetër, do t'ia dhuroj tokën që ma ka lënë babai, për shërbimin patriotik që

ka bërë. Më vonë, kësaj shpifje, sikur unë kam pasur dorë në këtë atentat, bile duke shtuar, në bashkëpunim edhe me Hashim Thaçin, udbashët i janë kthyer disa herë. Nuk më ka bërë përshtypje. Mendimin tim e thashë: nuk e kam pasur atë fat dhe prandaj nuk më takon ajo meritë.

Do fati tjetër e Bujar Bukoshi, pas vrasjes së Ahmetit, cakton ushtarakun pejan, Ismet Shaqirin, për komandant të FARK-ut dhe ministër të mbrojtjes, por ai nuk mund ta merrte menjëherë detyrën. Ismeti lut kolegun dhe bashkëluftëtarin Halil Bicajn, që ta marrë atë përgjegjësi derisa t'i jepte leje Qeveria e Bosnjës, meqë ishte atashe ushtarak në Turqi. Halili vjen menjëherë në Gjermani për t'u konsultuar. E lus që të pranojë. Ai po ngurronte, meqë po e vlerësonte si tradhti ndaj UÇK-së shkuarjen në FARK. E binda se ishte në interes të UÇK-së dhe të Kosovës ta shtinim nën kontroll të plotë FARK-un dhe ta shfrytëzonim për ta rritur forcën luftuese të UÇK-së. Pranoi pasi mori garanci se po e merrja unë përgjegjësinë.

Akoma pa e marrë detyrën Halil Bicaj u konsultova me Ali Ahmetin, nëse po ma miratonte vendimin. Ajo ndodhi. Vendosem ta informonim vetëm Bislim Zyrapin, tashmë Drejtor i Drejtorisë operative të Shtabit të Përgjithshëm dhe asnjeri tjetër. Të dy i këshilluam të bashkëpunonin vetëm mes tyre, pa informuar njeri tjetër. Ashtu edhe ndodhi.

(B.I.: / Ndërhyrje:) - Për këtë vendim tëndin, nëse mund të them kështu, Aliu më ka informuar edhe mua, si drejtues i Lëvizjes. Ai më kërkoi që nëse mes Halil Bicajt dhe shokëve të Shtabit ndodhin përplasje ose ka konflikt, më duhej të ndërhyja. Me Halilin, gjatë kohës që ishte komandant i FARK-ut, kam biseduar disa herë në telefon, e po ashtu, nga ai kemi pasur edhe materiale të rëndësishme, të cilat janë ende në arkivin e

Organizatës. Më ka bërë përshtypje një Raport financiar i "qeverisë" Bukoshi, për financimin e luftës, përmes FARK-ut dhe lëvizja e mjeteve financiare, ndryshimi i të dhënave, fakti nëse me ato mjete, të cilat thuheshin se ishin kthyer në logjistikë luftarake, mund të kishte shumë më tepër se aq sa raportohej, më formuan mendimin se kishte filluar rëndshëm fshehja e abuzimeve pas shifrave të luftës.

(I.K.:) - Po e dëgjoj për herë të parë dhe të falënderoj. Kisha bindjen se e dinim vetëm unë, Ali Ahmeti, Halil Bicaj dhe Bislim Zyrapi.

Pranverë 1998, Kosovë

***(B.I.:)** - Jemi ende në fundin e marsit dhe fillimin e prillit 1998.*

Çfarë po ndodh ndërkohë në Kosovë?

Në të vërtetë sinjali për atë që po ndodhte në Kosovë ishte dhënë një herë, në fundin e dhjetorit të vitit 1991, kur kishte ndodhur edhe rrethimi i parë i Familjes së Adem Jasharit, e ku, brenda natës, ishin grumbulluar qindra vetë për të filluar luftën.

Tashmë ishte një situatë tjetër. Mendoj se ka qenë një fat i madh që kjo gjendje shpërthyese nuk e gjeti Kosovën fare të papërgatitur. Nëse do të kishte ndodhur ndryshe, kjo do të kishte qenë një katastrofë kombëtare. Fakt është se ishin dhënë disa prova të njëpasnjëshme se strukturat konspirative në Kosovë, të drejtuara nga Lëvizja Popullore e Kosovës, tashmë ishin një realitet dhe duhej pranuar si i tillë. Lëvizja Studentore kishte dhënë shembullin e madh të protestave,

ku mes Muhamet Mavrajt, Driton Laçit, Albin Kurtit e Bujar Dugollit, si drejtues të Lëvizjes Studentore, kishte shkëlqyer edhe shembulli i profesor Ejup Statovcit, rektorit famëmadh të Universitetit të Prishtinës.

Në dhjetëditëshin e parë të muajit mars, në Kosovë do të kthehen disa nga figurat e njohura të Lëvizjes si Fehmi e Xhevë Lladrovci, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Fatmir Limaj, Sami Lushtaku, Selim Krasniqi, Gani Paçarizi e të tjerë, të gjithë, në kohë të ndryshme, figura drejtuese në strukturat e Lëvizjes Popullore të Kosovës, të cilët do të marrin përsipër edhe drejtimin e luftës. Më i njohuri prej tyre do të jetë Fehmi Lladrovci, një figurë mitike në historinë e Kosovës, ashtu siç do të jetë edhe Xhevë Krasniqi-Lladrovci, figura më e shquar e gruas shqiptare në luftën për liri. Ndërkohë drejtuesit më të njohur do të jenë Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, ose "djemtë", siç quheshin në përgjithësi, duke i nënkuptuar ata.

Në krejt pak kohë, sikur të kishin pritur këtë shpërthim, u ngritën zonat operative edhe jashtë atyre që kishin qenë deri asaj kohe. Thuajse kudo, për të mos thënë kudo, drejtuesit e këtyre zonave do të jenë anëtarë të Lëvizjes ose njerëz të lidhur ngushtë me Lëvizjen, dhe kjo do të ishte e natyrshme. Shtabet e zonave u përforcuan me ushtarakë, të cilët herë-herë do të kishin dy lloj vështirësish: edhe me njerëz që nuk ishin mësuar me artin ushtarak e kjo ishte më e lehta, por edhe me përhedhje pas shpine e kjo do të ishte më e vështira.

Për pak kohë në Kosovë do të ndodhte ajo që, më vonë, nga Komandanti i Përgjithshëm i NATOs, Gjenerali Klark, do të quhej "Lëvizja guerile me rritjen më të shpejtë në botë".

Njerëzit që kishin pritur kaq gjatë nën robërinë serbe dhe kishte qenë një dimër i madh pushtimi, si duket kishin pritur

këtë pranverë të vitit 1998 për të shpërthyer dhe për të gjetur njerëzit që do t'i prinin dhe tek të cilët do të kishin besimin më të madh në një të ardhme, e cila, megjithëse do të kishte tragjiken e saj, përsëri do të ishte e jashtëzakonshme.

Kjo shpresë dhe kthimi i këtij besimi do të ndjehej edhe jashtë Kosovës, do të shkonte edhe në mendimin e Ismail Kadaresë, i cili, krejt natyrshëm, luftëtarët e UÇK-së, do t'i quante "Dalëzotësit e Kosovës", duke përdorur kështu, jo rastësisht, një shprehje të kthyer nga kohërat e lashta, më saktë nga periudhat skënderbejane - dalëzotës.

Do të fillojë kështu një ndër periudhat më të jashtëzakonshme të historisë së Kosovës.

Lëvizja e Kosovës nuk do të jetë thjeshtë pjesëmarrëse aty, nuk do të jetë as vetëm pjesë: ajo do të jetë themeluesja, shpirti dhe fryma e kësaj lufte, ndërgjegjja e saj, përfaqësimi i saj dhe muajt që do të vinin do të dëshmonin se ajo do të ishte edhe flijimi më i madh i saj.

Asgjë më shumë se sa kjo periudhë nuk i bën nder Lëvizjes Popullore të Kosovës.

Historia e një kënge

***(B.I.:)** - Jemi ende në marsin dhe në prillin e vitit 1998. Le të merremi me një ngjarje tjetër, e cila, në dukje, ishte e parëndësishme, por në fakt u bë një gjë jetike, sidomos për të ardhmen. Si çdo ngjarje epike, edhe lufta e zhvilluar në Drenicë, do të kishte jehonën e saj, në mes të tjerave, edhe në këngë, të cilat, kur vijnë në kohën e duhur dhe me frymën e duhur janë, siç e thashë, jetike. Një herë, më duket se ka qenë fillimi i vitit 1999,*

po rrinim në familjen Jashari, tek baca Rifat, në Mynih dhe djemtë e shtëpisë e pyetën Arif Vladin, këngëtarin e njohur, për këngën e parë që doli menjëherë pas rënies së Ademit, Hamzës dhe të tjerëve. Kënga është kënduar nga Arif Vladi, me tekst të Gjokë Becit dhe muzikën e Edmond Zhulalit, në mos gaboj. Arifi, ndërsa fliste për këngën, përmendi edhe emrin tënd, si nismëtar i saj. Çfarë lidhje kishe ti me këtë këngë? Nuk të kam pyetur asnjëherë, tani, erdhi koha.

(I.K.:) - Merita për këngën himn të UÇK-së u takon kryesisht Arif Vladit, Gjokë Becit dhe Edmond Zhulalit. Roli im qe rastësor dhe me vjen turp të tregoj si ka ndodhur. Dy-tre ditë para se të bëhej kënga kisha bërë një ujdi me vëllanë e Arif Vladit (më vjen keq që s'ia kujtoj emrin). Më parë ai kishte qenë polic. Meqë pagat ishin të vogla, kishte lënë atë punë dhe punonte taksist në Tiranë. Unë e angazhova atë për 50 dollarë në ditë, që të na shërbente, qoftë për të na bartur ne, qoftë për të transportuar ndonjë sasi urgjente të armëve, qoftë për të na gjetur njerëz dhe baza në krahinën (Peshkopi-Kukës), prej nga vinte ai. Në fund të ditës së parë dëgjova nga ai një slogan domethënës për kapitalizmin. Honorarin prej 50 dollarësh po ia paguaja, siç ishim marrë vesh. Ai m'i kërkoi 57 dollarë. E kundërshtova për 7 dollarë më shumë. U arsyetua se duke na pritur gjatë ditës, në lokale kishte pirë kafe dhe kishte ngrënë sandviç që i kishte kushtuar 7 dollarë. I thashë - paguaj nga 50 dollarët. Më tha: Zotëri, po të mos isha në shërbimin tuaj, kafe dhe bukë do të pija e do të haja në shtëpi, te gruaja ime dhe nuk do t'i paguaja 7 dollarë. Në kapitalizëm, vetëm mirëmëngjesi është pa lekë, të tjerat i ke me lekë. Më provokoi arsyetimi ndaj ia dhashë 7 dollarët.

Arifi duhet të jetë informuar nga i vëllai se ku mund të më

gjente. Ai më njihte qysh në fillim të viteve të 90-ta. Erdhi dhe më tha se ishte koha për të bërë një këngë për UÇK-në. Kishte disa herë që më thoshte dhe prandaj po më bezdiste. Dikur reagova: "Shko, përse nuk e bën këngën!?" Më tha se duhen lekë për tekstin dhe kompozimin. E pyeta sa duheshin. Më tha 700-800 dollarë. Thënë të drejtën, nuk parashikoja fare rëndësinë e këngës, por që ta heq qafe, nxora dhe ia dhashë njëmijë dollarë. Menjëherë iku nga tavolina. Të nesërmen erdhe e më tha: "Kënga është gati. Do ta dëgjosh?" "Aman, iu përgjërova, më lërë rehat tani! Nuk dua ta dëgjoj pa le që edhe nuk marrë vesh nga muzika!

Kaq ishte kontributi im rastësor për atë këngë. Por, isha i sigurt se Arifi, me përkushtimin që kishte, do ta kishte bërë megjithatë, duke gjetur zgjidhje tjetër. Ai e dëshmoi veten edhe më vonë, jo vetëm me këtë këngë, por edhe me të tjerat, ashtu siç u angazhuan edhe shumë artistë të tjerë. Sa për rëndësinë e këngës tejet motivuese, "Marshi i UÇK-së", duhet ta vlerësojnë profesionistët.

E falënderoj me këtë rast mikun tim, Arif Vladin, që paska përmendur veprimin tim, ndërsa mjetet ishin të Fondit dhe duhen falënderuar donatorët.

Perëndim, pranverë / verë 1998

(B.I.:) - Po rikthehem në një temë që më duket se mbeti e varur. Në përgjigjet e mësipërme më the se nuk ishe i një mendjeje me mua se, pas shkuarjes së gjithë kryesisë në Tiranë, nëndegët nuk mbetën të shkëputura, pasi kishin udhëheqjet e tyre. Në të vërtetë, për mua, ata kanë mbetur të shkëputura, edhe nga fakti se dy drejtuesit e nëndegëve më të mëdha, Fehmi Lla-

drovci në Gjermani, dhe Adem Grabovci në Zvicër, nuk ishin më aty ku jetonin, vepronin dhe drejtonin. Fehmiu ishte rrugës për në Kosovë, ndërsa Ademi, si Kryetar i Kryesisë së Nëndegës në Zvicër, ishte tek ju, në Tiranë...

(I.K.: / Ndërhyrje:) - Prit pak, të lutëm, se mund të më bësh shumë pyetje njëherësh, siç po ndodh herë pas here. Më herët argumentova se Lëvizja në Perëndim nuk ngeli pa udhëheqje në kuptimin e masivizimit a të hutimit sa të mos dijë se si të veprojë. Kur arsyetova kështu, kisha parasysh faktin se Lëvizja kishte përvojë. Ajo pothuajse varej shumë pak nga udhëheqësit. Secili anëtar i saj kishte bërë aq shumë përvojë, sa të dinte vetë se çfarë duhej të bënte, pa e udhëhequr drejtuesit e zgjedhur. Pra, nuk kishim Organizatë që komandohej dhe vetëm ato që komandoheshin, bëheshin, por Organizatë vullnetarësh që angazhoheshin përditë, bënin edhe aktivitete që bazoheshin në kreativitetin individual. Shumica e anëtarëve, që nuk ishin zgjedhur në struktura udhëheqëse, ishin po aq të aftë dhe po aq të përkushtuar, sa edhe ata që ishin zgjedhur. Dhe ata, që të gjithë, ishin mobilizuar. E kishin kuptuar se nevojat kryesore në ato rrethana ishin: të mblidhnin ndihma financiare, të motivonin të rinjtë për të shkuar në luftë. Shumë prej tyre zunë vendin e të parëve dhe po i bënin punët si duhej.

Besoj, kaq mjafton dhe nuk kam pse të zgjatëm, hëpërhë, me shpjegime të tjera.

(B.I.:) *- Të mirëkuptova. Të falënderoj edhe për durimin e mirëkuptimin tënd. Tani po vazhdoj me pyetje tjera.*

Përpara se të ktheheshit në Gjermani, ndërkohë ishte marrë vendimi për thirrjen e Mbledhjes së Gjashtë të Përgjithshme, sa më parë që të ishte e mundur. Lëvizja, përgjithësisht, është shquar për trajtimin serioz të jetës organizative, për mendimin

ndryshe në radhët e saj, për qëndrime të pavarura, por edhe për kolegjialitet. Për këtë unë jam vetë dëshmitar.

Lidhur me Mbledhjen e Gjashtë të Përgjithshme dua të të pyes: U bë ajo në kohën e duhur?

(I.K.:) - Më fal, ta perceptoj një çik pyetjen pa nënpyetje!

Jo, ajo Mbledhje nuk është bërë në kohë të duhur. Ka qenë e vonuar. Mbledhja e Përgjithshme, e jashtëzakonshme, do të ishte dashur të mbahej 2-3 muajt e fundit të vitit 1996. Këtë mendim e kam shprehur atëherë. Për mua mjaftonin kërkesat për ndihma financiare, që i vinin Nëndegës së Lëvizjes në Gjermani nga zonat e Ushtrisë sonë në Kosovë. E çuditshme, tri zonat ekzistuese në atë kohë, kur ende nuk kishte shtrirje më të zgjeruar, nuk i kishin drejtuar kërkesat as te Sektori i rëndësisë së veçantë, as të Kryesia e Lëvizjes, Dega j.v., as të Nëndega në Zvicër dhe as te ndonjë nëndegë tjetër. Po t'i kisha ditur qysh në atë kohë edhe relacionet mes të Kryesisë dhe Sektorit të rëndësisë së veçantë, do të thotë përgjysmimin dhe mënjanimin që ai Sektor i kishte bërë Kryesisë, respektivisht Lëvizjes, sigurisht që do të kisha kërkuar më me ngulm mbajtjen e mbledhjes së përgjithshëm në vitin 1996. Kur them më me ngulm, nuk mendoj se do të kisha "zhurmuar" më fuqishëm në mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm, por do të kisha përvetësuar të tjerë anëtarë, duke krijuar shumicën e domosdoshme, që të përshpejtonin mbledhjen e përgjithshme. Nëse nuk do t'ia dilnim ta mbanim aq shpejt, do të duhej të mbahej më së voni në pranverën e vitit 1997, menjëherë pasi unë u thirra në Kryesi, në mars të vitit 1997, për të dhënë llogari. Nga këndvështrimi i mëvonshëm, gjykoj se mbajtja e mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm, dedikuar vetëm asaj tematike, dhe prandaj, për shkak të seriozitetit, mbajtja e saj në Bruksel, për

të cilën kemi biseduar, nuk qe e mjaftueshëm. Nuk sanuam gjë, vetëm i prolonguam problemet. Kur e mbajtëm Mbledhjen, në fillim të majit të vitit 1998, ishte tepër e vonuar, sepse zhvillimet në Kosovë kishin shpërthyer në ato përmasa sa që na kishin zënë të papërgatitur sa duhet për t'u bërë ballë.

(B.I.:) - Si ishte gjendja në Organizatë para thirrjes së saj, pasi, sipas një dëshmie të Ali Ahmetit, gjithçka po precipitonte shpejt dhe kishte zëra se ishte e mundshme të kishte një ndarje?

(I.K.:) - Për gjendjen në Organizatë biseduam. Sa për sqarim plotësues, gjendjen në Organizatë e kishim mobilizuese, qysh kur kishin ndodhur aksionet dhe konfrontimet gjatë vitit 1996. Gjendjen, siç u informova pak më vonë, nuk e kishim të mirë vetëm në Sektorin e rëndësisë së veçantë dhe në Kryesi.

Jam krejtësisht i mendimit se ndarje të Lëvizjes nuk mund të ndodhnin. Meqë kam këtë bindje them se Aliu nuk ia paskësh qëlluar. Kush do të ndahej? Më saktësisht, kush do t'u shkonte mbrapa atyre që mund të ndaheshin? E shumta rreth 10 individë. Mijëra anëtarë e simpatizantë do të përcaktoheshin për ruajtjen e unitetit dhe funksionalitetit të Organizatës si të tërë. Madje, do të thosha se ikja e ndonjërit qysh në fund të vitit 1996, do ta kishte ndihmuar përforcimin e përshpejtuar të UÇK-së dhe Lëvizjes. As UÇK-në ikja e tyre nuk do ta dëmtonte. Po them ikja e tyre, e jo ndarja, sepse kur nga disa mijëra pjesëtarë do të shkëputeshin pak veta, kjo nuk do të mund të quhet ndarje. Vetëm tani po e kuptoj Aliun përse nuk ka alarmuar menjëherë për gjendjen në Sektor të rëndësisë së veçantë. Ai ka patur drojën se mund të ndodhë përçarja e Lëvizjes, prandaj ka duruar me shpresë se do të sanohej gjendja më vonë, apo jo?

(B.I.:) - Unë jam duke të intervistuar ty, jo ti mua, prandaj

kërkoj mendimin tënd. Por, nëse do të dish edhe mendimin tim, ai në disa raste ndryshon nga yti. Ti, gjithë fajin, sipas idesë sate, e hedh tek dy njerëz, të cilët, sipas mendimit që ke edhe sot, e ndoshta sot edhe më shumë se dje, paskan prishur të gjitha punët. Për ty, fajtorë janë vetëm dy vetë, Xhaviti e Azemi. Por edhe për ta, siç e kanë thënë shpesh në mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm, ti je fajtor sepse asnjëherë nuk ishe i disiplinuar. Për shkakun tënd nuk u bë njësimi si duhet i Fondit dhe vetëm fondi, ku de fakto drejtoje ti, nuk ishte i dëgjueshëm. Nëse të gjitha fondet kudo që ishin, dhe për këtë Xhavit Haliti, në njërën nga Mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm në Wyrzburg të ka kritikuar haptas, të kishin vepruar si fondi në Gjermani, atëherë çfarë do të ndodhte? Nuk do të kishim asgjë veçse rrëmujë. Unë e kuptoj hallin e atyre që ishin në luftë dhe nuk ndihmoheshin, mirëpo ndryshe do të ishte puna sikur çështjet të shtroheshin si duhet, qartë, thjeshtë e me seriozitet. Sepse më lind e drejta të pyes, çfarë bënte kryesia deri në marsin e vitit 1998, ku ishte ajo, përse vetëm atëherë asaj iu mbush mendja të bënte edhe rolin e Shtabit të Përgjithshëm, të koordinatorit të Fondit, të logjistikës, të merrte përsipër gjëra, për të cilat deri asaj kohe vetëm kishte heshtur ose nuk kishin qenë detyrë e saj? Për katër vite me radhë drejtues të kësaj kryesie nuk ishin interesuar të dinin së çfarë po bëhej e tani donin të bënin vetë gjithçka. Nuk më duket e arsyeshme, pasi po ata, vetë, i kishin zgjedhur e emëruar njerëzit që do të përgatitnin luftën e armatosur.

Por, siç të thashë, është koha ime të të pyes ty, e nuk është koha për më të pyetur ti mua. Nganjëherë ne bashkëbisedojmë, por synimi i këtij libri është tek përgjigjet e tua, se si ka rrjedhur jeta jote përmes Lëvizjes dhe se si Lëvizja është pjesë e jetës tënde. Ky binom, jeta e një njeriu dhe jeta e

Lëvizjes, është synimi i kësaj bisede, dhe nëse të kam gjetur ty, kjo edhe për faktin se ishe pjesë e 17 Janarit të vitit 1982, kur edhe filloi historia e Lëvizjes.

E meqë është kështu, po vazhdoj me pyetje.

U bënë shkak këto zëra për ndarjen dhe kjo gjendje, që më pas, kur ishim në Shqipëri, si Kryesi e Organizatës, gjë për të cilën do të flasim më vonë konkretisht, të gjithë drejtuesit e lartë të shtetit, presidenti, shefi i qeverisë, shefi i SHIK-ut, ministrat, na thanë se u vinte mirë që po na shihnin bashkë, sepse kishin informacione se ishim ndarë?

(I.K.:) - Edhe herë të tjera kemi pasur debat për këtë çështje. Nuk e kuptoj pse i mbron? Nuk i bëhet nder Organizatës vetëm nëse propagandojmë, por edhe kur dëshmojmë, siç i dimë, të vështirat dhe të metat. Kjo i bën nder asaj sepse i ka kaluar pengesat e vështirësitë me sukses. Nuk e di pse juve ju vjen keq për disa bashkëveprimtarë, të cilët, mendoj unë, nuk e meritojnë respektin, sepse janë shpërfytyruar e tjetërsuar. Unë nuk bëhem bashkëfajtor i të tillëve dhe, sot o nesër, herët a vonë, do t'i them të gjitha, siç i di unë, ndoshta edhe gabimisht, por nuk do të ndodhë asnjë tërmet. Organizatës i rritet vlera nëse dëshmojmë për rrugëtimin e vështirë që ka pasur. Aftësia e menaxhimit të këtyre përplasjeve, deri edhe e armiqësive, ishte kryevepra juaj si drejtues i Organizatës. Tani unë nuk pres ndonjë nderim prej tyre, meqë nuk ishin të ndershëm deri tani. Por, po kthehem tek ndodhitë në Tiranë. Babai sa herë ma ka përseritur një porosi të Ali Pashë Gucisë: "Bëni nder, kush është për nder."

Fatkeqësisht ashtu na qe thënë. Por, duhet t'ju kujtohet, si edhe të tjerëve, kur ishim në takim me Presidentin Mejdani në korrik të vitit 1998, si reagova unë kur ai na pat thënë se po i

vinte mirë që na shihte të gjithëve bashkë, pasi kishte pasur informacion se Lëvizja në Zvicër e Gjermani ishte përçarë. Unë ia ktheva: "Ju paskan dezinformuar, nuk është përçarë fare Lëvizja". Dhe për mendim timin, kishte dizinformuar Xhaviti e nuk e di pse kishte dezinformuar.

(B.I.:) *- Më duhet të ndalem edhe një herë, dhe nga një njeri që pyet, të kthehem në bashkëbisedues. Shkuarja jonë në Shqipëri, si Kryesi e Lëvizjes e ka një zanafillë. Ti e di fare mirë se, në muajin mars dhe në prill të atij viti, me gjithë kërkesat e vazhdueshme të Kryesisë, asnjë institucion i shtetit shqiptar nuk i kishte pritur dhe nuk kishin pasur asnjë lloj takimi. Edhe qëndrimi i shtypit kishte qenë mohues dhe, herë pas here edhe ironizues, ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ndaj vetë Lëvizjes. Në qershorin e vitit 1998, më thirri në telefon, aty ku banoja, profesor Fatos Klosi. Numrin tim të telefonit në Tiranë e kishin fare pak vetë. Nuk ia kisha dhënë asnjë shtetari, pasi nuk kisha vendosur lidhjet me ta, por si duket, ai e kishte, ose nga Raif Gashi ose nga Xhaviti. Pasi thamë fjalët e para të përshëndetjes, ai më kërkoi të takoheshim në Shqipëri dhe sa më shpejt të ishte e mundur. E pyeta se kur dhe përgjigjja e tij ishte befasuese, "edhe pas një ore, po t'i keni mundësitë". E kuptova se kishte diçka serioze dhe e pyeta më tej, por më tha se do të bisedonim. Mendova se vajtja ime vetjake atje nuk ishte e dobishme dhe lajmërova të gjithë Kryesinë. Në portin e Durrësit më priti Dashamir Kadëna dhe prej atje u takova me profesor Klosin. Më pas u takuam të gjithë, anëtarët e Kryesisë dhe Xhavit Haliti, i cili ishte njëkohësisht anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe i dërguar i Lëvizjes në Tiranë, por edhe koordinator i takimeve. Profesor Klosi, i cili edhe kishte informuar Presidentin dhe Kryeministrin, ishte i trazuar. Gjendja ishte e ngatërruar. Një palë njerëz shkonin tek ai dhe i thoshin*

se ishin të UÇK-së dhe se të tjerët janë të shitur tek serbi; të tjerë shkonin dhe i thoshin se ne jemi të UÇK-së dhe se të tjerët janë të shitur tek italiani e bëjnë punën e tyre; dikush kishte shfrytëzuar autorizimet që kishim dhënë për të qenë në shërbim të zonës operative të Dukagjinit, sipas kërkesës së Ramush Haradinajt, e po shkonin gjithandej, të tjerë i thoshin se ishin të Lëvizjes në Gjermani... Në lëvizjen e logjistikës kishte probleme, njerëz të FARK-ut lëviznin nën flamurin e UÇK-së, matrapazët kishin filluar të lëviznin po ashtu. Ishte fillimi dhe ishte gjendje e rëndë. Edhe në takimin me të, por edhe në takimin e përbashkët, ai na i tha të gjitha këto dhe shumë prej tyre ishin të vërteta. Pra, ai kishte pasur disa burime të informimit, shto këtu edhe njerëzit e tij në konsullata, të cilët përgjithësisht nuk bënin asnjë hair tjetër. Nuk mendoj se një apo dy njerëz mund të kthenin mendimin e shtetit shqiptar, por ishin bërë shumë gjëra njëkohësisht. Edhe vetë atyre, sikur i pëlqente kjo tymnajë, për të përligjur qëndrimin e tyre të heshtur, të paktën deri asaj kohe.

Por le të kthehemi tek Mbledhja e Përgjithshme. Në parapërgatitjen e saj, veç Kryesisë, u angazhuan edhe disa shokë, që u quajtën të kooptuar përkohësisht, si Adnan Asllani dhe Hasan Ukhaxhaj. Ti, si anëtar i Këshillit të Përgjithshëm, kishe dijeni për gjendjen dhe se në Mbledhje të Përgjithshme mund të kishte përplasje?

(I.K.:) - Sa për sqarim, me sa mbaj mend, mbledhjet e përgjithshme nuk i përgatiste Kryesia, por Këshilli i Përgjithshëm. Në mbledhjen e fundit të mandatit të radhës, zgjidhte grupet e punës për përgatitjen e mbledhjeve të përgjithshme.

Sigurisht që dija shumëçka, por jo të gjitha. Për të kapur seriozitetin e gjendjes më pat ndihmuar të qenit në Tiranë

gjatë kohës kur atje ishte Kryesia, e cila po ushtronte rolin e njëfarë shtabi të improvizuar të UÇK-së. Në mbledhjen e caktuar të saj, të fundit në Tiranë, e që nuk u mbajt, me patën thirrur për të informuar për angazhimet me oficerët. Aty e përjetova ***live***, se si Xhaviti u tha anëtarëve të Kryesisë, që bënin mirë të iknin menjëherë nga Shqipëria. Dhe kjo ndodhte sepse Kryesia, në njërën nga mbledhjet paraprake, kishte vendosur që të gjitha ndihmat financiare për UÇK-në, që vinin nga Perëndimi, nga Kosova, nga Maqedonia, e gjetiu, të dorëzoheshin në Kryesi dhe ajo t'i menaxhonte.

Po ata të dy, Xhaviti dhe Azemi, duke urdhëruar "në emër" të shtabit, e kishin bindur Kryetarin e Fondit "Vendlindja thërret", Jashar Salihun, që mjetet t'i dorëzonte vetëm tek ata të dy dhe jo në Kryesi. Kurse kasnecët e tyre i kishin angazhuar në aeroport dhe port në Tiranë e Durrës, që t'ua zinin pritat ndihmave që vinin.

(B.I.:) *- Pse u kujtua Kryesia të merrte përsipër aranzhimin e ndihmave financiare dhe të logjistikës në marsin e vitit 1998? A nuk është fakt se që kur është krijuar Fondi, në dhjetorin e vitit 1993 e deri në qershor 1998, kryesia nuk e kishte marrë asnjëherë në analizë veprimtarinë e tij dhe nuk e kishte shtruar as në Këshillin e Përgjithshëm, gjithnjë me idenë e ruajtjes së sekretit. E pse tani, menjëherë po ndryshonte gjithçka? Përgjegjës kryesor për menaxhimin e tyre u caktua Muhamet Kelmendi, nënkryetar i Organizatës në atë kohë. Cili do të ishte roli i saj, i Kryesisë, në këtë gjendje, këtë edhe sot nuk e kam të qartë. Në Mbledhjen e Gjashtë të Përgjithshme, njëra ndër akuzat që u bë, e për këtë do të kthehemi pas pak, ishte se mjetet e siguruara nga Lëvizja, në prill-maj 1998, ishin ndarë pa kriter, ku të mundnin e si të mundnin dhe njësitë e organizuara nuk kishin përfituar sa e si duhej prej tyre.*

(I.K.:) - Jam i bindur se për disa gjëra ke mendim tjetër, e ndonjëherë, ndoshta nga dëshira për t'i mbajtur gjërat brenda, po i mbyll. Nuk jam për t'i mbyllur. Herët a vonë, në mos këtu do t'i them diku tjetër.

Çfarë nuk kisha mundur të parashikoja para Mbledhjes, ishte dalja në skenë e Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit si të lidhur me Xhavitin dhe Azemn. Ata i kisha çmuar e dashur si vëllezër, që kur i kisha njohur. Më kishte ardhur keq përse ishin pasivizuar gjatë qëndrimit të tyre në ekzil në Zvicër dhe për këtë fajësoja Kryesinë, Këshillin e Përgjithshëm, i cili, ata që po detyroheshin të arratiseshin jashtë Kosovës dhe po vendoseshin në Perëndim, po i denigronte në anëtarë "të thjeshtë", edhe pse në Kosovë kishin qenë kuadro drejtues të Lëvizjes. Mbaj mend të kem thënë në debate përkatëse: Lëvizja, Dega j.v., nuk është shoqëri aksionare që më shumë aksione të kenë anëtarët e Kryesisë, më pak se ata anëtarët e KP; të tjerat t'i kenë anëtarët e kryesive dhe këshillave të përgjithshëm të nëndegëve dhe çfarë të tepronte, t'u takonte anëtarëve "të thjeshtë" (pa funksione); ndërsa kuadrot e Lëvizjes që vinin nga Kosovë, të përpiqeshin për hise në aksione, pasi të startonin si anëtarë "të thjeshtë".

Për të mos e zgjatur, ardhjen e Hashimit dhe Kadriut në Mbledhje të Përgjithshme, mënyrën e tyre se si u imponuan si të deleguar nga Lëvizja në Kosovë, e sidomos akuzat që ngriti Hashimi, vërtet nuk i kisha paraparë.

XII. Mbledhja e Gjashtë e Përgjithshme, maj 1998

(B.I.:) - Të dy e dimë fare mirë se si u zhvillua Mbledhja e Gjashtë e Përgjithshme, situatën, atmosferën në Mbledhje, trajtimin e problemeve, akuzat që u bënë, reduktimi i tyre i mëpasmë, etj. Mirëpo, aty u morën edhe vendime të tjera, që kishin rëndësinë e tyre kapitale.

Si ka mbetur në vizionin dhe në memorien tënde kjo Mbledhje, e cila do të jetë e fundit në Perëndim?

(I.K.:) - Fatkeqësisht si një ngjarje e eksesive, e vështirë, por e domosdoshme dhe me favore, nëse u shpreha qartë. Fatkeqësi sepse përplasja kishte marrë ato përmasa, por nuk ishte rrumbullakuar, prandaj duhej penguar e sanuar. E domosdoshme, sepse metastaza e përplasjes duhej të identifikohej, për të përzgjedhur terapinë kuruese. Ajo Mbledhje gjeti zgjidhjet më të mira, të mundshme, për të menaxhuar situatën e mëtejme deri në përfundim të Luftës. Nuk kam përse ta fsheh krenarinë se e kemi bërë maksimumin e mundshëm dhe fundi ka qenë fatlum.

(B.I.:) - A mendon se problemet mund të ishin tejkaluar me kohë, nëse nga Kryesia e asaj kohe do të kishte pasur një qëndrim më serioz ndaj problemeve më të kohës dhe të mos lihesin punët deri në mbledhje apo pas saj?

(I.K.:) - Kam sqaruar edhe më herët, se pyetjeve me alternativën "nëse" nuk u përgjigjem më dëshirë, sepse lënë hapësirë për spekulime. Megjithatë, mendoj se problemet, ju thoni do të ishin tejkaluar, unë do të thosha, do të ishin zgjidhur, meqë vështirë tejkalohen, nga se ishin probleme të rënda.

Nëse Kryesia nuk paskësh pasur qëndrim më serioz, atëherë ai paskësh qenë vetë problemi. Në Kryesi nuk kishim ndonjë anëtar që do të donte të mos ishte serioz. Ashtu i kam vlerësuar atëherë dhe as tani nuk kam ndryshuar mendimin. Vazhdoj t'i vlerësoj se ishin seriozë dhe të përkushtuar.

Mbase me duhet një shpjegim pak më i zgjeruar, meqë në bashkëbisedime të këtilla ngjan gati si me rastin kur një personalitet (ndoshta Çehovi) i kishte shkruar mikut të tij në fund të letrës: "Me fal, ngaqë nuk kisha kohë të shkrova kaq gjatë". Në këtë rast po mundohem ta përshtat: Me fal, se nuk po kam dhunti e hapësirë për të bërë sqarime të kuptueshme, por të thukta!

Lëvizjen e kanë themeluar individë, e kanë rritur individë, e kanë fuqizuar individë, gjithherë mbi baza të angazhimit vullnetar, mbi baza të besimit reciprok. Në krye të herës qemë të papërgatitur teorikisht dhe praktikisht, pa mundësi baze financiare, etj. Kishim përballë shumë armiq, shumëfish më të fortë. Ta zëmë, unë jam angazhuar si revolucionar e politikan pothuajse adoleshent, i papërgatitur teorikisht, pa përvojë. Kisha dëshirën entuziaste dhe bindjen se na takonte liria, por meqë nuk na jepej, duhej ta fitonim. Për mundësi financiare të mos flas. Nuk i dihet, po të isha i kamur, ndoshta nuk do të angazhohesha, sepse të kamurit rëndom ideal e pasion kanë pasurinë. Zhvillimet më kanë nxjerr aty, në bashkëbisedimin mes Jusufit e Kadriut, prej nga lindi Lëvizja dhe them pa modesti se ndihem krenar. Ai moment ma përcaktoi dhe ma përthithi jetën e pastajmë. Me Lëvizjen jam rritur e kalitur; jam ngritur, pak a shumë, në aspektin teorik e praktik.

Ngjashëm ka ndodhur pothuajse me të gjithë që janë përcaktuar e angazhuar për veprimtari çlirimtare.

Tani vjen momenti konkret, kur në Kryesi shokët e idealit, siç u thoshim atëherë, ishin bashkëveprimtarë, ishin bashkëveprimtarë sepse i kishte bashkuar e lidhur ideali dhe besimi ndaj njëri-tjetrit. Ky përcaktim duhet të ketë qenë i idealizuar, romantik, prandaj edhe i gabueshëm herë-herë, meqë assesi nuk është menduar e dyshuar se mund të mashtrojë, komplotojë, tradhtojë shoku-shokun. Për rrjedhojë, ka munguar vëmendja, kontrolli, verifikimi.

Duke pasur parasysh këto që thashë, pa ndier nevojën të sjell të tjerë faktorë, (që ka sa të duash), them se bashkëveprimtarët tanë, atëherë anëtarë të Kryesisë, nuk janë mbizotëruar me vetëdije dhe qëllimisht nga mungesa e seriozitetit dhe neglizhencës. Madje as ata që i quaj fajtorë për disa situata si Xhavit Halitin dhe AzemSylën. Parapelqej të shpresoj, se nuk kanë komplotuar për qëllime armiqësore, por me mendimin se mënyra e veprimit të tyre sjell më shpejt e më shumë suksese. Secilit prej nesh mund t'i kishte ndodhur njësoj, sigurisht për herë të parë, por jo t'i përsëdytë të njëjtat gabime. "Po të mund të nusëroja për herë të dytë, do të nusëroja më mirë" - kishte thënë njëherë një nuse e pakënaqur nga nusërimi i parë. Sigurisht, në rrethana të tjera, me kushte e mundësi të tjera, nuk do të kishin ndodhur gabime të ngjashme. Gabime ndodhin sepse gabimet janë njerëzore, siç thuhet. Vetëm ata që punojnë, bëjnë gabime, kurse ata që nuk punojnë, janë gabimi vetë. Por, synimi është: të ndodhin gabime sa më të pakta dhe sa më të vogla, më me pak pasoja.

Për të mos u zgjatur, bashkëveprimtarëve në Kryesi, nga besimi i idealizuar ndaj njëri-tjetrit, u është përvjedhur vigjilenca për të hetuar devijimet e përplasjet fillestare. Nuk kanë vepruar qëllimisht ashtu, por ashtu kanë ditur e vepruar. Unë i bëj me faj, përse nuk kanë reaguar menjëherë ndaj atyre shenjave që

dukeshin, ndaj atyre veprimeve që ndodhnin? Përse nuk kanë reaguar menjëherë, sapo koordinatori i Sektorit të rëndësisë së veçantë, bashkëveprimtari Xhavit Haliti, ka filluar dhe më vonë nuk ka dhënë fare llogari. I fajësoj për paaftësi për të mbajtur qëndrim të drejtë në mbledhjen e marsit 1997, kur unë thosha, kemi ndihmuar tri zonat e ushtrisë, sepse na janë drejtuar me kërkesa, kurse ata gjykonin se kishim prishur disiplinën, nuk kishim respektuar hierarkinë dhe kompetencat. Habitesha se si nuk mund të kuptonin në atë rast shkëputjen e lidhjeve, shansin përmes nesh për t'i ringritur ato, por insistonin në disiplinimin e Kryesisë së Nëndegës në Gjermani, që t'i dorëzonte të gjitha mjetet financiare sipas vendimeve. Habitesha, përse nuk po mbanin qëndrim, kur koordinatori i Sektorit, njëherësh anëtar i Kryesisë së KP-së, Xhavit Haliti, po ofendonte "grupin e Drenicës" si "kaçakë ", të cilët nuk duheshin ndihmuar. Pra, nuk kishin besim as në sinqeritetin e Fehmi e Ramiz Lladrovcit që i kërkonin ndihmat për bashkëluftëtarët e tyre dhe Zonën e Drenicës. E logjika të shpie drejt konstatimit se Xhaviti kishte atë mendim e qëndrim, ngaqë ashtu e kishte dezinformuar e bindur Azem Sylem që vinte nga ajo anë.

(B.I.:) *- Cili ishte qëndrimi yt ndaj shqetësimeve që u ngritën në atë Mbledhje dhe në mbledhjet pasuese të Këshillit të Përgjithshëm, të cilat, pasi zgjodhën Kryesinë e re, miratuan edhe ngritjen e Komisionit të veçantë për shqyrtimin e ngjarjeve të luftës?*

(I.K.:) - Akuzat që ngriti Hashimi fillimisht më shkaktuan befasi tronditëse. Por, as i pata pranuar për të vërteta dhe as i refuzova. I përmbahesha premisës: "Gabimet janë njerëzore". Ato akuza nuk ma patën lëkundur besimin që kisha ndaj atyre që akuzoheshin. Gabimi ndodhi kur pjesëmarrësit e Mbledhjes u alarmuan. Nuk u alarmuan vetëm ata që kishin përgatitur

goditjen dhe ata që ishin të informuar dhe po e përkrahnin për ta çuar deri në fund, ashtu siç e quaja unë, komplotin.

Megjithatë Mbledhja u menaxhua falë përvojës dhe urtisë se të gjithë pjesëmarrësve. Mos qofsha i gabuar Ti ke qenë drejtues i Mbledhjes së Përgjithshme, bashkë me disa shokë të tjerë, Bardhyli, Mehmet Bislimi, Musa Xhaferi e Adnan Asllani. Edhe ata që synuan ta bëjnë këtë goditje, u përmbajtën, sepse duhet të kenë parashikuar se po t'i shkonin përplasjes dhe akuzave deri në fund, aty për aty, nuk do të dilnin fitues. Zgjidhjet e pastajme qenë operative, të shpejta, pragmatike, pothuajse krejtësisht të drejta, me të vetmen mungesë: masat ndëshkuese ndaj komplotistëve. Dëshiroj të besoj se Komisioni hetimor nuk pat propozuar masa adekuate ndëshkuese, jo pse nuk kanë ditur të ndajnë drejtësi, por sepse kanë qenë të bindur se tashmë nuk do të mund të jetësoheshin dhe të sillnin pasoja më të rënda. Edhe atëherë, edhe tani gjykoj se atë gjendje Lëvizja e kapërceu me të mjekuara me sukses, që bëri të mundur të vazhdojë rrugëtimin deri në fitore. Mbase vetëm ashtu, siç e kemi menaxhuar, ka qenë e mundur, në kohë dhe hapësirë.

(B.I.:) *- Pas shumë kohe kishte ndodhur edhe rikthimi yt në udhëheqjen e lartë të Organizatës, si anëtar i Kryesisë së saj. Them pas shumë kohe, që nga ngritja e Qendrës Ekzekutive, pasi duke qenë anëtar i Këshillit të Përgjithshëm, nuk ishe anëtar i Kryesisë. Tani, besimi i njerëzve solli rikthimin tënd? Si e ke vlerësuar asaj kohe, në momentin e parë dhe si e vlerëson tani, pas kaq shumë viteve?*

(B.I.:) - Të kuptoj, nuk qenke informuar për një segment të zhvillimeve në Lëvizje, meqë atëherë ishe në Shqipëri.

Do fati e Lëvizja konsolidohet deri në atë nivel sa për herë të parë të praktikojë zgjedhje të lira, thellësisht demokrati-

ke, do të thosha edhe pluraliste, meqë Organizata jonë kishte anëtarë me bindje nga më të llojllojshmet ideopolitike. Mjaftonte kriteri përcaktues për Kosovën Republikë, të mos shfaqje racizëm, shovinizëm e fashizëm. Dhe ky emancipim, zgjedhjet e lira, po ndodhnin pasi kishim përzënë ose ishin larguar xhaferët (Durmishi e Shatri), Sabri Novosella e ca kasnecë të tyre.

Në mbledhjen paraprake, para se të ndodhnin zgjedhje të lira, pata kërkuar të sanksionohej një kriter i përhershëm: në kryesi të mos zgjidheshin dy e më shumë veta nga e njëjta familje. Bëra këtë propozim sepse kishim raste kur dy e më shumë veta ishim të angazhuar në Organizatë, më konkretisht, doja të evitoja që në kryesi të mos ishim dy Kelmendë (unë dhe djali i axhës, Muhameti), si dhe dy vëllezërit Xhemajli (Mustafa dhe Emrushi). Se do të votoheshim, isha i sigurt, sepse në Lëvizjen e atëhershme, Dega j.v., ishim ndër më të arsimuarit dhe gjithashtu, ndër më të afirmuarit. I njëjtë ishte rasti edhe me Vëllezërit Xhemajli. Që debatuar shumë dhe pati polemika. Ndonjëri thoshte është diskriminim, tjetri ose tjetra thoshte cenim i lirisë elementare për të pasur të drejtë të zgjidhen, etj. Ama, unë ngula këmbë si mushka, në interes të reputacionit të jashtëm të Lëvizjes, kundër familjarizmit në organet udhëheqëse. Po mendoja, një kryesi prej shtatë anëtarësh, me dy kushërinj Kelmendë dhe dy vëllezër Xhemajli, sikur nuk shkonte. Me në fund, ndoshta pse isha veteran i Lëvizjes, ma plotësuan kërkesën. Pasoi vështirësia tjetër, cilin nga Kelmendët dhe Xhemajlët duhej privuar nga e drejta e kandidimit. Që të kurseja diskutimin, unë deklarova se po tërhiqesha nga kandidimi, me arsyetim se Muhameti ishte 6 muaj para meje, më i shkolluar dhe për respekt që kisha ndaj tij. Pastaj Mustafë Xhemaili deklaroi se po tërhiqej edhe ai nga kandidimi, me arsyetimin se Emrushi, edhe pse më i ri, kishte më shumë për-

vojë dhe përgatitje përkatëse në organizimin klandestin.

Kjo ka qenë arsyeja konkrete, përse nuk kam qenë anëtarë, që kur ishte formuar Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm e deri në vitin 1998. Do ti, shtypi i verdhë (armiqësor), propaganda e strukturave të UDB-ës, të LDK-së, vetë UDB-ja, të orkestruara në luftën e tyre speciale, shpifnin: "Lëvizja e Ibrahim Kelmendit". Dhe kjo shpifje e tyre pat marrë përmasa të atilla, sa ndonjëri nga bashkëveprimtarët bëhej xheloz dhe me ironi thoshte, po ndodh si dikur në Drenicë, që thuhej: "Shokët luftojnë, Azemit (Galicës) po i mbesin"), domethënë: Azemi në fakt nuk po luftonte, por meqë shokët po luftonin, atij po i rritej fama.

Pra, jo për mungesë apo rikthim të besimit, nuk isha, përkatësisht isha anëtar i Kryesisë. Edhe në Mbledhjen e Gjashtë do të ishte zbatuar ai përcaktim i kamotshëm, por goditja kundër disa anëtarëve të Kryesisë, sidomos kundër Ali Ahmetit, Emrush Xhemailit dhe Muhamet Kelmendit, vetvetiu bëri që Muhameti të mos kishte shanse për t'u votuar, kurse unë, i bindur se do të isha produktiv, doja të votohesha, prandaj heshta kur që të dy ishim në listën e kandidatëve.

(B.I.:) - Për të saktësuar gjërat: më i anatemuari nga të gjithë ishte Ali Ahmeti, por ai u zgjodh në Kryesinë e Organizatës. Edhe Muhamet Kelmendi e Emrush Xhemajli u rizgjodhën në Këshillin e Përgjithshëm. Kjo ishte faza e parë. Sipas një marrëveshje të heshtur, u vendos që shokët që ishin tashmë në luftë, të mos ishin anëtarë të kryesisë, ndaj edhe Emmrushi e Xhaviti nuk do të ishin e po ashtu as Adem Grabovci. Ndrëkohë edhe Xhavit Hasliti e Azem Syla kishin marrë detyra të rëndësishme në kuadrin e UÇK-së.Se si ndodhi me Muhamet Kelmendin, do të bashkëbisedojmë më pas.

Në Kryesinë e re të Organizatës mjaft nga anëtarët e dikurshëm të Kryesisë pararendëse, nuk u rizgjodhën. Shumë prej tyre tashmë ishin në luftë ose në strukturat e veçanta të saj, kështu që nuk mund të ishin edhe në drejtimin e Organizatës, megjithëse ishin anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm. Ndonjëri edhe u tërhoq nga rikandidimi, siç ishte rasti i Rexhë Iberdemajt; ndonjë tjetër, fillimisht u tërhoq, pastaj nga këmbëngulja, rikandidoi, siç ishte rasti i Fazli Veliut. Flas vetëm për anëtarët e Kryesisë. Por, u rizgjodh Ali Ahmeti. Ç'dëshmi e parë ishte rizgjedhja e tij?

(I.K.:) - Sa për sqarim, në Kryesinë, të cilën e patëm kategorizuar si "teknike", meqë kishim vendosur, pasi të hetoheshin akuzat, të mbahej Kuvendi tjetër dhe të zgjidhej kryesia e rregullt, sa mbaj mend, u zgjodh vetëm Ali Ahmeti, nga gjithë anëtarët e Kryesisë së vjetër. Kjo ishte dëshmi se shumica e Organizatës nuk u besonte akuzave të Hashimit, se vazhdonin të kishin besim dhe respekt ndaj Aliut. Vetëm ky fakt do të ishte i mjaftueshëm ta bënte të panevojshëm Komisionin hetues, por mirë që u ngrit, për të sqaruar edhe shumë zhvillime, devijime dhe dyshime të tjera.

(B.I.:) Je i gabuar, në kryesinë teknike nuk është zgjedhur Ali Ahmeti, si antar i saj.Unë jam zgjedhur drejtues i saj, e bashkë me mua janë emëruar edhe Bardhyli, Agush Buja, Mehmet Bislimi, Sabri Kiçmari, R. Rama, Xhevat Bislimi.

(I.K.:) - "Viktimë" e akuzave të Hashim Thaçit, pra, ishin edhe Xhavit Haliti, koordinues i Sektorit të rëndësisë së veçantë. Nuk u zgjodhën as Fazli Veliu, kryetari disavjeçar i Kryesisë, as Emrush Xhemajli, sekretar disavjeçar. Por, çudi e radhës për mua ishte, përse nuk u zgjodh as "komandanti suprem" i UÇK-së, Azem Syla, siç e kishte afishuar vetën me

pështpëritje të inskenuara të pjesëmarrësit në atë Mbledhje.

Se mos po keqkuptohem si skandaloz, po nuk prish punë, me informimin vijues: Sapo u njoftuan rezultatet, Azemi, si rastësisht kaloi para meje dhe më tha me zë nëpër dhëmbë: "Zgjedhja jote në Kryesi i dha fund Lëvizjes!" Ia ktheva me të qeshur: "Ruaje nivelin, zoti komandant suprem!"

(B.I.: / Sqarim i intervistuesit:)

Në kohën kur do të bëheshin propozimet për anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm, tre pjesëmarrës në Mbledhje dhe një jashtë Mbledhjes, kërkuan të mos kandidoheshin për t'u zgjedhur. Në Mbledhje kërkuan Rexhë Ibërdemaj, deri atëherë anëtar i Kryesisë; Fazli Veliu, deri atëherë Kryetar i Kryesisë dhe Hasan Ukhaxhaj. Nga jashtë, përmes Ramizit, Fehmi Lladrovci kërkoi të mos zgjidhej, me arsyetimin se ishte në luftë dhe në luftë nuk duhet të ketë më angazhime partiake, por mbetet gjithnjë anëtar i Lëvizjes. Pas këmbënguljes së delegatëve, Fazli Veliu pranoi të rikandidonte, ndërsa profesor Hasani dhe Rexhë Ibërdemaj, nuk pranuan. Profesor Hasani pranoi të ishte në dy Komisione, për hartimin e Rezolutës, ku isha edhe unë dhe Fazli Veliu dhe në Komisionin e Votimit, ku ishte kryetar. Të gjitha fletët e votimit, që janë ende në arkiv, kanë firmën e profesor Hasanit. Kemi qenë 116 delegatë. Nga përfundimi i votimeve unë kam pasur 115 vota pro, që do të thotë se ka munguar vetëm vota ime. Pas meje, ka qenë Bardhyl Mahmuti me 89 vota pro. Kjo erdhi si pasojë e gjendjes së krijuar në organizatë, por edhe e një vendimi që u mor vetëm në atë Mbledhje, përcaktimi i anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm sipas nëndegëve. Kjo do të thoshte se për çdo nëndegë u caktua një numër i atyre që do të ishin në Këshillin e Përgjithshëm. Në atë

kohë, por edhe më pas, isha njëri ndër njerëzit që nuk i takoja asnjë ndarjeje, nëse mund të them kështu. Kisha një emër si gazetar dhe mund të isha si pikë referimi. Nuk kam pasur asnjë meritë tjetër. Më pas, njëzëri, me propozim direkt, ose si i thua ti, me aklamacion, jam zgjedhur kryetar i kryesisë teknike, e cila në të vërtetë është quajtur "e përkohshme", pa e marrë askush parasysh mendimin tim. Propozimi është bërë nga Ali Ahmeti dhe është mbështetur nga Hashim Thaçi, ti, Ramiz Lladrovci, Emrush Xhemajli, i cili kur dolëm në pushim, më tha se kishte besim tek unë, dhe, pastaj, po ashtu, pa marrë askush mendimin tim, po me miratim ***njëzëri****, jam zgjedhur Kryetar i Komisionit të veçantë për shqyrtimin e akuzave dhe të ngjarjeve të Luftës. Ndërsa, po ashtu, me aklamacion, pas propozimit të Hashim Thaçit, në Mbledhjen e fundit të Përgjithshme, jam zgjedhur si kryetar i grupit për shndërrimin e Lëvizjes në parti politike legale.*

Si duket, ti, nga ngarkesa e atyre ditëve dhe pa pasur si referim arkivin, gjë që e kam aktualisht, ke ngatërruar dy ngjarjet: zgjedhjen e Këshillit të Përgjithshëm dhe të Kryesisë Teknike.

Më pas, në qershor të atij viti, pasi u dhanë konkluzionet e Komisionit që drejtoja unë, ku ishin edhe Sejdi Gega e Naser Idrizi, u bë zgjedhja e Kryesisë së rregullt, përsëri me votim të lirë, të drejtpërdrejtë, nga i cili dolën 7 anëtarët e Kryesisë: Bedri Islami, Bardhyl Mahmuti, Jashar Salihu, Ibrahim Kelmendi, Ali Ahmeti, Sejdi Gega dhe Agush Buja. Në mbledhjen e parë të saj, Kryesia zgjodhi: kryetar - Bedri Islamin, pas propozimit të Bardhylit dhe mbështetjes sate; nënkryetarë - Bardhylin dhe Jasharin; përgjegjës për financat - Sejdi Gegën; Ali Ahmetin - për lidhjen me zonat operative dhe përgatitjen e ngjarjeve në Maqedoni dhe ty, si koordinator mes Kryesisë dhe Fondit.

(I.K.: / Vazhdim i përgjigjes:) - Mbase jam i gabuar, në ato ditë kanë ndodhur aq shumë ngjarje njëra pas tjetrës, saqë edhe ngatërrohen, pasi në një hark prej pak ditësh, u bënë disa mbledhje, takime, ballafaqime. U ngritën e ranë akuza, u formuan e shprishën grupe, saqë është e kuptueshme, të ketë ngatërrime të këtij lloji. Por, ama, isha i bindur se jeni zgjedhur një herë kryetar me aklamacion dhe kjo paska ndodhur në zgjedhjen e kryesisë së përkohshme!

Megjithatë, sa herë e kam përsëritur, me gojë e me shkrim, se zgjedhja Jote për Kryetar qe një fat i dhuruar nga Zoti, do të thoshin besimtarët, kurse unë do të thosha se ju ishit fati i Lëvizjes dhe UÇK-së. Ti dhe gjithë ata që me njohin e dinë se unë nuk lavdëroj njeri për hatër dhe as shaj njeri për xhelozi.

(B.I.:) *- Paralelisht, në këtë kohë, ndodhi edhe vetëlargimi i Muhamet Kelmendit nga Organizata, rrjedhimisht përjashtimi i tij dhe ky ishte një vendim i Këshillit të Përgjithshëm.*

Por, edhe shumë të tjerë nuk u rizgjodhën. Pra, disa u larguan, të tjerë erdhën. Dikush u mërzit, dikush e mori seriozisht detyrën e re. Fehmi Lladrovci, nga Drenica na solli mesazhin se nuk mund të rizgjidhet në strukturat drejtuese të Organizatës, pasi ishte në luftë. Ndodhën ndryshime në drejtim. Si mendon, ishte kjo për së mbari, apo u krijuan diferenca të reja?

(I.K.:) - Pyetje paksa e bezdisshme. Po të mos e bënit, do të ndihesha më rehat. Por, megjithatë, po përpiqem të përgjigjëm.

Arsyet e vërteta se përse dha dorëheqje Muhameti, nuk i kam mësuar. Intimisht pata menduar se ai nuk i përballoi dot pabesitë nga ana e Xhavitit dhe Azemit, akuzat nga Hashimi (edhe pse nuk i kishte aq të ashpra, sa kundër Aliut e Emrushit), mosvotimi në Kryesi, etj. Por, përse kishte nevojë ta përjashtonte Këshilli i Përgjithshëm, meqë ai veç kishte dhënë

dorëheqje, këtë nuk e kuptova atëherë, nuk e kam arsyetuar asnjëherë. Isha në pozitë të vështirë që të kundërshtoja propozimin për atë përjashtim dhe mezi e gëlltita atë gabim.

(B.I.:) *- Largimi i Muhametit u bë pasi ishin dhënë Konkluzionet e Komisionit të Posaçëm. Në mënyrë demonstrative ai u largua nga Mbledhja dhe na dërgoi një Letër, në të cilën thuhej se nuk i njihte më vendimet e këtij Këshilli dhe pastaj në një letër tjetër, se do të formonte një Lëvizje të re. Këto dy letra janë ende në arkiv dhe kjo e dyta ishte edhe shkaku i përjashtimit të tij, pasi nuk ishte e kuptueshme që dikush të punojë për një Lëvizje të re dhe të jetë anëtar i një forumi drejtues. Nëse ai nuk do të largohej, me siguri do të rizgjidhej në Kryesi, ose së paku unë besoj kështu.*

(I.K.: / Vazhdim i përgjigjes:) - Ai ndryshim ishte kompromis dhe, Kryesia në të cilën ishim anëtarë, nuk ishte më "teknike", pasi tashmë ishin sqaruar e hedhur poshtë akuzat tepër të rënda dhe do të merreshin vendime përkatëse. Do të thosha, nuk patëm shumë alternativa dhe besoj se ishte zgjidhje më pragmatike, sepse u "kombinua" një Kryesi funksionale, e cila menaxhoi gjendje të rëndë e zhvillime të mëdha.

Të zgjatëm me arsyetime konkrete, nuk më ka hije, sepse keqkuptohet si vetëlavdërim. Megjithatë, nuk do të përmbahem pa thënë: merita kryesore të takon Ty, sepse edhe Kryesia jonë kishte dy-tre tifozë të Hashimit, nga se ishin të bindur se Hashimi duhej të ishte udhëheqësi kryesor i UÇK-së, pa qenë të informuar se ai ishte vetëm Drejtor i Drejtorisë politike pranë Shtabit të Përgjithshëm, por jo komandant. Por, ama, nuk ishin tifozë vulgarë, radikalë. Ishin brenda të tolerueshmes, brenda të drejtës për anime fraksioniste. Meqë tashmë nuk është "sekret publik", siç thuhet me shpoti, bëhet fjalë për Bardhyl

Mahmutin, Jashar Salihun dhe Agush Bujën. "Kundër" Hashimit klasifikoheshim Sejdi Gega, Ali Ahmeti dhe unë, paçka se nuk ishte e vërtetë, në kuptimin e ngushtë të fjalës. Kurse Ti, Miku Bedri, të dinin për neutral, paçka se qarkullonin spekulime se anonit më shumë nga Aliu dhe unë. Ka ndodhur sa herë, që për të njëjtin vendim do të kishte tre vota pro e tre vota kundër e atëherë pritej qëndrimi Yt.

Megjithatë, nga Organizata nuk shkuan të tjerë bashkëveprimtarë. Sa i përket Fehmiut, ai e kishte ndarë mendjen, nuk do të largohej më nga Kosova dhe përcaktimi i tij për të mos kandiduar ishte rrjedhë e logjikshme e përcaktimit dhe angazhimit të tij.

Qershor 1998, rizgjedhja e Kryesisë së Fondit "Vendlindje thërret"

(B.I.:) - Po në këto ditë, pas Mbledhjes së Gjashtë të Përgjithshme, u bë edhe analiza e Fondit „Vendlindja thërret" dhe u zgjodhën drejtuesit e rinj të saj. Jashar Salihu, i cili ishte edhe Nënkryetar i Organizatës, u rizgjodh drejtues i Fondit, ndërsa Zëvendës i tij u zgjodh Xhemail Fetahu. Ti, u zgjodhe në Stafin Drejtues, por edhe njeriu kryesor i Fondit në Gjermani. Deri asaj kohe fondi ishte i shtrirë kryesisht në anëtarësinë e Organizatës, dhe ne e kishim të detyrueshëm kontributin në Fond sipas sasisë që caktohej. Por nuk mund të mbahej lufta vetëm me kontributin e anëtarëve e të simpatizantëve të Organizatës. Pas ngjarjeve në Kosovë frymoi një mentaliteti të ri në Organizatë, se Fondi nuk është vetëm i më të besuarve, pra kur në drejtimin e tij në bazë hynë me shumësi njerëz të palidhur me organizatën, ai u rrit dhe filloi të përballojë nevojat e luftës

dhe të mbijetesës. Çfarë ndryshoi konkretisht, cilat ishin shkaqet e këtij hovi që mori edhe Fondi VTH?

(I.K.:) - Paraqitja e ecurisë zhvillimore e Fondit V.Th. është goxha e ngatërruar. Megjithatë po jap ca informata telegrafike dhe vlerësime të shkurta.

Së pari, vet emërtimi qe një fatkeqësi, sidomos për hapësirën gjermanofolëse. Përkthimi tekstual në gjermanisht i "Vendlindja Thërret" ishte: "Heimat ruft". Ky paskësh qenë slogan i përhapur i nazizmit gjerman! Mediet gjermane, por edhe ato perëndimore, e shpërdoronin këtë koincidencë.

Deri në mars të vitit 1998 hyrjet në Fond ishin simbolike, vetëm nga kontributet e anëtarëve të Lëvizjes, Dega j.v., dhe sigurisht që nuk mjaftonin për të ngritur ushtri të fortë.

Për mjetet që kanë hyrë në Fond, nga themelimi deri në mars të vitit 1998, nuk isha i informuar se ku kanë shkuar dhe si janë shpenzuar. Di se ato i ka menaxhuar Sektori i rëndësisë së veçantë. Nganjëherë kam dyshuar se gjatë asaj kohe është abuzuar me sekretin ushtarak dhe konspiracionin edhe sa u përket mjeteve të Fondit. Nuk jam informuar ndonjëherë se Sektori duhet t'i ketë dhënë llogari Kryesisë për përdorimin e mjeteve.

Nga marsi 1998 e këndej, sikur kemi bërë garë kush po grumbullon më shpejt e më shumë mjete financiare nga Fondi. Duke parë zhvillimet në Tiranë, më saktësisht duke krijuar bindjen në atë kohë, se mjetet e Fondit po i përvetësonin Xhaviti dhe Azemi dhe nuk po i investonin si duhet për të armatosur Ushtrinë tonë, nga mesi i prillit 1998 i dhashë vetes urdhër të kthehesha në Gjermani, të organizoja rrjetin logjistik të Fondit për të mbledhur sa më shumë ndihma financiare dhe pastaj të përkujdesesha që ato të mos bien në dorën e tyre, por t'ua përcillja drejtpërsëdrejti komandave të zonave në Kosovë,

përmes lidhjeve e strukturave të tyre logjistike.

Shumë shpejt e mbuluam Gjermaninë me të autorizuar të Fondit për të bërë propagandë dhe për të mbledhur ndihma. Me ndihmën profesionale të Agim Reshanit, bashkëpronarit të Reisebüro "Dituria" në Dyzeldorf, bëmë *databas* të sofistikuar për të regjistruar të gjitha hyrjet. Njëkohësisht shtypem blloqet e faturimit, të cilët u shpërndan në gjithë Perëndimin; blemë pajisje moderne për të shtypur *ID-Card* me fotografi për të autorizuarit, shfrytëzuam në maksimum shërbimet teknike të bankës, ku e kishim xhirollogarinë e Fondit. E regjistruam si Fond bamirës, për të pasur favore nga tatimet. Në bankë, të drejtën e tërheqjes e kisha vetëm unë, më pas edhe Sabri Kiçmari.

Te gjitha këto angazhime rriten të hyrat marramendshëm në krahasim me kohën e deriathershme. Rritet azhuriteti për t'i regjistruar, fal edhe shumë aktivistëve që punonin err e terr në zyrën qendrore të Fondit në Bon. Nuk do mend se për rritje kaq të hovshme të ndihmave ndikuan zhvillimet në Kosovë dhe sidomos autoriteti dhe jehona e UÇK-së.

Paralelisht u angazhuam që të ngrihen e të shtrihen strukturat e Fondit në Belgjikë, Danimarkë, Suedi e Norvegji. Meqë në këto shtete unë kisha njohje më shumë se cilido bashkëveprimtar në organet udhëheqëse, përkujdesesha që ndihmat e mbledhura atje të vinin në zyrën e Fondit në Gjermani.

Këtë përcaktim dhe angazhim timin e cilësuan si devijim dhe për problemet e lindura bëmë një takim të veçantë, mes kryesisë së organizatës dher kryesisë së fondit në Gjermani, ku ishte dhe Xhemal Fetahu. Me Jashar Salihun i shtruam problemet hapur. E ndjeja se ai kishte urdhër të bënte "përqëndrimin". Dhe nguli këmbë për këtë.

Do sqaruar se Jashari, megjithatë, nuk kishte dëgjueshmëri naive, sepse e kisha informuar, por edhe vetë qe bindur ndërkohë, se mjetet duhej të shkonin në rrugë të ndryshme tek UÇK-ja.

(B.I.: / Ndërhyrje:) *- Mirëpo, ndërkohë kishte një Vendim të Këshillit të Përgjithshëm për përqendrimin e Fondit dhe ti ke qenë dakord me këtë vendim. Dhe bile, e ke mbështetur atë.*

(I.K.:) - Nuk po më kujtohet. Megjithatë unë vazhdoja sipas përcaktimit tim, që ma miratonin gjithë ata që dinin çfarë po ndodhte.

Për të mos e zgjatur, mjetet që dorëzoheshin në zyrë të Fondit në Gjermani dhe në xhirollogari bankare, u shkonin vetëm zonave ushtarake në Kosovë, me përjashtim të Zonës së Drenicës. Vetëm tepricat, për shkak se zonat nuk kërkonin më shumë se sa mund t'i vinin në punë, u dorëzoheshin, me miratim të Jashar Salihut, atyre që kishin lidhje me Xhavitin dhe të tjerët. Këtu po përmend dy-tre raste, për të cilat pastaj jam penduar. Na u tha të dërgonim katër milionë DM në Lubjanë. I ngarkova Mark Bardhajn dhe Vesel Bacajn për bartjen e tyre. Kur u kthyen, ma dorëzuan protokollin e dorëzimit, të cilin e kishte firmosur Gani Thaçi, Vëllau i Hashimit. Nuk e dija rolin e tij, por meqë lufta përfundoi shpejt, dyshoja se duhet t'i ketë përvetësuar. Rasti tjetër qe kërkesë e Shaban Mujës, për të dërguar po ashtu katër milionë DM në Austri. Me miratim të Jasharit, i përcolla. Me erdhi protokolli i firmosur si pranues nga Fatmir Zymberi. Sidomos për rastin e dytë qeshë hidhëruar, sepse te Fatmiri dyshoja për shpërdorues dhe u zhgënjeva kur mësova se Xhavit Haliti e kishte angazhuar atë.

Një rast flagrant i tjetërsimit të të hyrave të Fondit ishte nga

Remzi Ejupit, pronar i "Euro Koha", dhe bëhet fjalë për rreth gjashtë milionë marka. Ai i përvetësoi të hollat e biletave të turneut gati dy mujorë të estradës së kombinuar nga Kastriot Tusha, Manjolla Nallbani, Arif Vladi, Ilir Shaqiri, Çun Lajçi, e të tjerë, të cilët u angazhuan për të ngritur moralin patriotik të emigrantëve, rrjedhimisht për të ndihmuar financiarisht UÇK-në. Remziu shpërdoroi besimin dhe na i grabiti fitimet nga ajo turne. Qe vlerësuar se ai duhet grabitur rreth gjashtë milionë DM.

Tani po sqaroi, përse nuk i dërgonim mjete financiare Zonës së Drenicës. Unë po mendoja se Azem Syla, Hashim Thaçi, që të dy nga kjo Zonë, po favorizonin Drenicën dhe prandaj nuk dërgonin armë, municion e financa në asnjë zonë tjetër.

Ata që njiheshin si "shtab i përgjithshëm" kishin në dorë rreth 70 për qind e mjeteve të gjithëmbarshme të Fondit. Nga mjetet që i mbikëqyrte Fondi në Gjermani, rreth 30 për qind, i orientoja të shkonin në zona të Llapit, Dukagjinit, Shalës, Pashtrikut dhe Jezercit.

Pas Çlirimit, në një takim rasti në Hotel "Victory" në Prishtinë, me të gjithë komandantët e zonave, kur po ndodhte tjetërsimi i UÇK-së në TMK, Komandanti Sami Lushtaku në prani të të gjithëve m'u ankua, se nga shtatori i vitit 1998 nuk kishin marrë nga Fondi dhe nga Shtabi "as një lekë e fishekë". Ia vërtetoi ankesën Komandanti Sylejman Selimi. Thanë se me armë e municion ishin furnizuar kryesisht nga zonat e tjera. Të tjerë komandantë rrëfyen se ishin furnizuar nga rrjetet logjistike të tyre dhe nga ndërlidhjet, që burimet financiare i kishin nga Fondi në Gjermani. Sa më erdhi keq për Drenicën. I tregova Samiut, përse nuk ishim përkujdesur për Zonën e Drenicës dhe e fajësova atë, përse nuk na kishte informuar me kohë, meqë kishim njohje

e shoqëri të ngushtë gjatë veprimtarisë sonë në Gjermani.

(B.I.: / Ndërhyrje:) *- Duhet saktësuar koha se kur zona e Drenicës nuk kishte marrë ndihma. Sepse, në pragun e përfundimit të luftës, dhe ky është një rast që unë e di mirë, pikërisht tek komandanti i zonës, Sami Lushtaku, do të dërgohet një shumë e ndjeshme e të hollave, pas kërkesës së Ramiz Lladrovcit, e këtë shumë se sa ishte e di mirë; e po ashtu, edhe tek Garda e Kosovës, do të ketë një ndihmë të rëndësishme. Por është e vërtetë se, në telefonatën e fundit që kam pasur me Iliaz Kodrën, pak para se të vritej, e atëherë ai ishte komandant i Brigadës "Fehmi Lladrovci", më pat thënë shprehimisht se nuk kishin asnjë kokërr kallamoq (shprehje për municion) për të luftuar.*

(I.K.:) - Sapo Kosova u çlirua, policia gjermane ndërmori një aksion të rrufeshëm, të njëkohshëm, në gjithë Gjermaninë, rreth orës 04.30 të mëngjesit, duke bastisur rreth 400 banesa të të autorizuarve të Fondit. Njëkohësisht bastisen zyrën qendrore në Bon dhe banesën time në Këln. Konfiskuan të gjitha materialet dhe mjetet që gjeten.

Të gjithë materialet e konfiskuar policia i ktheu pas një viti dhe ia dorëzoi aktivistit Shaban Thaçi (nga Llapushniku i Drenasit), me banim në Bon. Mjetet financiare, rreth 1,4 milionë marka, që policia i kishte gjetur në zyrën qendrore dhe në banesat e veprimtarëve të autorizuar dhe në xhirollogari bankare, na u konfiskuan dhe iu dorëzuan Ministrisë së financave, në emër të borxhit tatimues, që ajo ia kishte caktuar Fondit si dënim.

Në pyetjen që më bëri Shaban Thaçi, se ku t'i çonte materialet evidentuese dhe dokumentacionin e Fondit, meqë ia kishin zënë bodrumin, i thashë le t'ia dorëzonte "qeverisë së përkohshme".

Por, pas Çlirimit të Kosovës disa herë e kam lutur Jashar Salihun dhe bashkëveprimtarë të tjerë kompetentë në kohë lufte, që t'i publikojmë, qoftë edhe vetëm të hyrat, me emra dhe shumat përkatëse të të gjithë donatorëve, por nuk kanë pranuar. Sekush duke u arsyetuar se nuk i kishin mundësitë, se nuk kishin kohë, sekush me arsyetimin se duhet ruajtur edhe më tej sekreti i luftës. Sa për të hyrat, që i ka evidentuar zyra në Bon, ka qenë fare e lehtë, fal dokumentacionit dhe *databas*, të cilat policia ia pat kthyer Shaban Thaçit.

Them se ky informim telegrafik është i mjaftueshme, në kuadër të një bashkëbisedimi, nëse ndokush nuk do ta mallkojë si të tepërt.

(B.I.:) *- Sa e di, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm, u ngrit Komisioni i Veçantë për shqyrtimin e ngjarjeve të luftës. Ai mori edhe vendimet përkatëse, të cilat i miratoi edhe Këshilli i Përgjithshëm. Vendimi kryesor ishte se akuzat e hedhura dhe dyshimet e ngritura ishin të pabaza. Rreth këtij raporti, asaj kohe, nuk kishte as vërejtje dhe as kundërshtime. Si drejtues i këtij Komisioni, shfrytëzoj rastin që të falënderoj edhe një herë Sejdi Gegën dhe Naser Idrizin, si anëtarë të Komisionit, për përkushtimin e tyre, seriozitetin dhe trajtimin real të ngjarjeve. Sidoqoftë, më vonë, disa probleme u ringritën. Si i kemi trajtuar asaj kohe këto ngjarje dhe si mendon tani, kur shumë gjëra janë bërë më të qarta?*

(I.K.:) - Siç informove, hetimet qenë objektive. Rezultatin e tyre përfundimtar e pat miratuar Këshilli i Përgjithshëm, pa ndonjë votë kundra. Tashmë i keni publikuar disa rezultate të atyre hetimeve në librin *"Enigma e një vrasjeje të trefishtë"* dhe në librin "*I vërteti (Ali Ahmeti)"*.

Hetimet patën konstatuar se akuzat që pat ngritur Hashim

Thaçi në Mbledhjen e Gjashtë të Përgjithshme qenë të pasakta dhe pa prova. Por, kundër akuzuesve, nuk u morën masa ndëshkuese. Dinamika e zhvillimit të luftës pamundësoi mbajtjen e Mbledhjes tjetër të Përgjithshëm, që aty të merreshin vendimet përkatëse, të rehabilitoheshin të akuzuarit dhe të ndëshkoheshin akuzuesit.

Ndërsa Mbledhja e Shtatë, e fundit e Përgjithshme, u mbajt në qershor të vitit 1999, në Prizrenin e sapoçliruar, e cila, duke qenë një Mbledhje kompetente, mori vendimin që Lëvizja ta mbyllë veprimtarinë e saj dhe të shndërrohet në një parti politike legale.

XIII. Edhe një herë në Tiranë, korrik 1998

(B.I.:) - Pas zhvillimit të Mbledhjes së Gjashtë të Përgjithshme, Kryesia e Organizatës, me ftesën e Shtetit shqiptar, do të jetë në Tiranë. Do të takohet me presidentin e Shqipërisë, Rexhep Mejdanin, me kryeministrin, Fatos Nano, me shefin e Shërbimit Kombëtar Fatos Klosin. Pastaj u zhvilluan disa takime të rëndësishme brenda organizatës dhe përfaqësuesve të UÇK-së. Nga tri takimet e zhvilluara çfarë ju ka bërë më shumë përshtypje?

(I.K.:) - Sa për sqarim, vetëm në takimin që kishim me Presidentin Mejdani, unë isha pjesëmarrës. Në mos gabohem kam qenë edhe në takimin paraprak me Zotëri Klosin, por ky ishte thjesht një takim mirëseardhjeje. Në takimet e tjera nuk pata mundësi, sepse e kisha të rezervuar biletën për një udhëtim të rëndësishëm jashtë Shqipërisë, i cili ishte planifikuar prej disa kohe. Për takimet e tjera pasuese jam informuar nga Ju, si Kryetar i Kryesisë së KP të Lëvizjes. Prandaj nuk më takon mua të rrëfej për rrjedhën, as për përshtypjet.

Në takim me Presidentin, veç Kryesisë, ishte edhe Xhavit Haliti në cilësinë e përfaqësuesit të Lëvizjes në Tiranë, shefi i SHIK-ut, Fatos Klosi, Artan Meçe, Drejtor i Drejtorisë së SHIK-ut për Kosovën dhe Preç Zogaj, në cilësinë e këshilltarit të Presidentit, ose diç e ngjashme. Mua më rastisi të ulëm pranë Zotëri Zogajt. E kisha në krah të djathtë, ai ishte i fundit në tavolinë.

Fillimisht Presidenti na përshëndeti, na uroi mirëseardhjen

dhe shprehu mendimin se do të ishte një takim i frytshëm. Pastaj e morët fjalën Ju. Treguat se e kishim mirëpritur ftesën për bisedime me strukturat më të larta të shtetit shqiptar dhe se do të ishte dashur që këto takime të bëheshin edhe më herët, për të mos pritur një ditë të tillë. E falënderuat atë dhe Shtetin Shqiptar, duke bërë kujdes t'i zgjedhnit fjalët e duhura, si duket për të mos krijuar probleme. Në fund të fundit, ju ishit drejtuesi i Kryesisë sonë dhe prandaj duhej të hapnit shteg për bisedime edhe të mëvonshme. Pastaj e mori fjalën Jashar Salihu. Edhe ai, si duket për të qetësuar debatin nga një dialog mes Mejdanit dhe Bardhylit, filloi me lavdërime. Unë e humba durimin, duke iu drejtuar Jasharit, por edhe bashkëveprimtarëve të Kryesisë: "Me fal, o Jashë, pse po i lavdëron? Nuk kemi ardhur këtu vetëm për të falënderuar Shtetin shqiptar, gjegjësisht Presidentin dhe qeverinë, por të pyesim pse nuk po na ndihmojnë. Pastaj iu drejtova Presidentit: "Profesor, po na toleroni në Shqipëri sepse secilin hap që po lëvizim po e paguajmë me deviza. Armë nuk po na jepni, por po i blejmë kryesisht të vjetruarat, që i janë grabitur shtetit kur ndodhi rebelimi në mars të vitit 1997. Bartjen e tyre deri në kufi me Kosovën po e paguajmë me deviza dhe, jo vetëm transportin, por edhe lejen për t'i transportuar, bukën që po hamë dhe fjetjen po i paguajmë me deviza. Atëherë për çfarë t'ju falënderojmë?"

Ju, Dushi (siç ju thërrasin me ledhatim në Shkodër), u munduat të ma ndërpritnit shpërthimin emocional, në dukje të pakontrollueshëm, sepse me të drejtë vlerësuat se nuk i shkonte takimit. Por, presidenti Mejdani tha: "Lere të flasë Ibrahimin, se studentët e fizikës ashtu i kemi edukuar kur ligjëronim në Prishtinë!". Pastaj ai iu drejtua Fatos Klosit: "Janë të vërteta këto që tha Ibrahimi, nuk u jepni armë dhe nuk ua transportoni, siç kam urdhëruar!?" Fatmirësisht, Klosi e konfirmoi vërtetësinë:

“E kam përcjellë urdhrin Tuaj. Kryeministri Nano e ka refuzuar, kurse ministri i mbrojtjes, Hajdaraga, thotë se e do urdhrin me shkrim. E sqarova se urdhri me shkrim rrezikon të zbulohet nga vëzhguesit ndërkombëtar.” Atëherë Presidenti Mejdani u hidhërua: “Domethënë këtu paska ndodhur puçi kundër Komandantit Suprem dhe Presidentit, dhe unë nuk ditkam gjë”.

Gjendja u bë e rëndë dhe pjesa tjetër e bisedave as që më ka interesuar ta mbaj mend. Sigurisht që keni folur sërish ju, pastaj Aliu. Por, për ato që ka fol Aliu, ju pjesërisht i keni zbardhur në librin “I vërteti (Ali Ahmeti)”, ndërsa për ato që keni thënë ju nuk kam nevojë t’jua kujtoj.

Ndoshta është me interes të rrëfej një incident që ishte paksa ngacmues. Duke i folur me atë vrull presidentit, Preç Zogaj më preku me këmbën disa herë, për të ma tërhequr vërejtjen. Iu ktheva me gjysmë zëri: “Mos më pengo se i tregoj Presidentit, çfarë lidhjesh ke ti me UDB-në“! - dhe pata vazhduar.

Pastaj, presidenti shprehu keqardhjen për përçarje të Lëvizjes në Gjermani me atë në Zvicër. Nuk durova ta çonte deri në fund: “Profesor, ju kanë gënjyer, nuk jemi fare të përçarë në dy Lëvizje, në të Gjermanisë dhe në Lëvizje të Zvicrës”.

Kur mbaroi takimi, sapo dolëm jashtë më mbuluan me lëvdata, por edhe ca kritika pa pasoja, ngaqë unë kisha krijuar imunitet gjatë viteve. Rëndësi kishte që ia thashë presidentit, Prof. Rexhep Mejdanit, prandaj u ndjeva i lehtësuar. Së paku kështu gjykoja atëherë.

Vërtet kam ndier keqardhje që nuk munda ta dërgoja ndonjë aktivist tjetër në vendin tim në atë angazhim ose ta riorganizoja fluturimin, që të isha në mbrëmje në pritjen e kryeministrit Nano, që t’ia shprehja akoma më rreptë hidhërimin tim, sidomos ndaj tij.

(B.I.: / Ndërhyrje:) *- Ne kemi vajtur në orën 11 paradite, tek Presidenti Mejdani, së bashku me Klosin dhe Artan Meçen, një punonjës i shërbimit informativ, i ngarkuar nga Klosi për të punuar në linjën tonë.*

Në hyrjen e Presidencës, nga punonjësit e shërbimit, jemi pyetur nëse kemi armë me vete dhe Zeka, që e kishte, e dorëzoi. Ne jemi ulur në sallën kryesore të bisedimeve dhe pas pak hyri edhe zoti Mejdani.

Ai na përshëndeti të gjithëve dhe pyeti për Artan Meçen se çfarë kërkon ai aty. Klosi iu përgjigj se e kishte marrë ai me vete. Ti ishe ulur në të njëjtin krah si unë, i parafundit. Në mes nesh ishin Jashari dhe Sejdi Gega.

Pastaj, ai na uroi mirëseardhjen dhe shprehu gëzimin se ishim të gjithë bashkë, pasi kishte dëgjuar se ishim ndarë dhe se gëzohej që nuk kishte qenë e saktë ose ishte tejkaluar. E pyeta se nga e kishte këtë informacion dhe ai tregoi Klosin. Pastaj e pyeta Klosin se nga e kishte informacionin dhe ai tha nga burimet e mia, pa i treguar burimet.

Ai më pyeti për njohjen tonë dhe i thashë se kemi pasur një mik të përbashkët, fizikantin e shquar Besnik Sykja, i afërt i nënës sime, i cili vdiq pas një sëmundjeje të rëndë dhe sot, një shkollë e mesme në Tiranë mban emrin e tij.

Më pas, unë bëra një ekspoze të shkurtër pse jemi këtu, duke i falënderuar për ftesën dhe shpreha dëshirën që shteti shqiptar, në të ardhmen, të vepronte më denjësisht në ndihmë të luftës.I thashë se tani zonat operative të luftës po ngrihen në të gjithë Kosovën, por ata duhen mbështetur

Pastaj, ai filloi të tregojë se e kishte ndjekur me vëmendje angazhimin tonë dhe shtoi se duhet bërë kujdes në Maqedoni. Ai tha mendimin se atje kërkesat do të zgjidhen nga rritja e

popullsisë, se shqiptarët po shtohen më shpejt se maqedonët, dhe një ditë, mund të kenë edhe presidentin e shtetit. Si duket, krahas të tjerave, qëllimi i takimit ishte pikërisht ky: hiqni duart nga Maqedonia dhe këtu ndërhyri Bardhyli, ashpër, dhe i tha se kjo do të thotë se ju, zoti President, na mësoni që t'u themi shokëve "lërini armët dhe shkoni e flini me gratë se ashtu do t'i fitojmë të drejtat". Vetëm pak ditë më parë Bardhyli kishte pasur takimin e njohur tashmë me zotin Hollbruck, ku, nga të gjitha përjetimet që kishte pasur, e vetmja që nuk i kishte shkuar për shtat, kishte qenë e njëjta porosi që po jepte tashmë edhe Presidenti i Shqipërisë, por tashmë me terma të tjera.

Për të qetësuar situatën, e mori fjalën Jashari dhe fillimisht tha se e falënderojmë shtetin shqiptar për përkrahjen dhe këtu, pa e mbaruar ai fjalën, ke ndërhyrë ti dhe konkretisht, me ngulm e nerv the: "Pse, o Jashë, po i falënderon këta. Asgja deri tash nuk kanë ba për Kosovën. Tana po i blejmë me devizë dhe me paret tona, edhe armët e vjetra, edhe ushqimin edhe transportin. Nëse shkon edhe më tej kështu, dikush po pengon qëllimisht".

Unë ndërhyra, duke të thënë se mund të flasësh me zë më të ulët dhe më qetësisht, por Mejdani tha: "Lëre Ibrahimin, e njoh se ka qenë student i fizikës dhe ne, të fizikës, i biem punëve më drejtë".

Atëherë e pyetëm pse shteti shqiptar nuk po ndihmon dhe ai na tha se e ka dhënë urdhrin tek Hajdaraga, që ishte ministër i mbrojtjes, por ai e kërkonte me shkrim. Klosi e miratoi. U interesuam pse nuk e jepte urdhrin me shkrim dhe ai tha se, po e dhashë sot, nesër shkon tek "Nju Jork Taims" dhe shtoi, se tash nuk është si dikur, kur fliste vetëm njëri dhe të tjerët heshtnin.

Klosi e miratoi se nuk kishte ndihma dhe shtoi se ai i kishte bërë propozimin Luanit (Hajdaragës)që mjetet t'i kalonte tek SHIK-u dhe, pastaj ai i kalonte aty ku duhej. Por, Luani nuk ishte dakord. (Këtë ide, të bartjes së logjistikës nga njëri institucion në tjetrin dhe pastaj aty ku duhej, Klosi e shtroi edhe në takimin e mbrëmjes vonë, të asaj dite, tek kryeministri Nano). Në të vetmen herë që ndërhyri Xhavit Haliti ishte kur sqaroi se pengesa nuk ishte tek zoti Nano, pasi ishte biseduar me të dhe do të bisedohej edhe në takimin e posaçëm.

Pastaj foli Abazi dhe kërkoi që shteti shqiptar të mos pengonte rrugët e logjistikës, si kishte ndodhur ato ditë, me arsyetimin se nuk dihet se kush janë dhe se cilët po lëvizin. Mejdani tha se vërtet po kërkojnë të vijnë shumë tek unë dhe ne nuk e dimë se kush punon në linjën tuaj dhe se kush nuk punon, por tani ju keni një strukturë të vetme dhe përmes saj mund të koordinohen punët. Ai, si institucioni i kryetarit të shtetit, megjithëse ishte shumë i përkushtuar, nuk mori asgjë përsipër, nuk u përcaktua asnjë detaj konkret dhe asnjë angazhim, qoftë edhe afatshkurtër. Sidoqoftë, ne e morëm mesazhin që, megjithëse ndihma mund të ishte e vogël, edhe pengesat, po ashtu, do të zvogëloheshin.

Kur po dilnim, ishim ende në oborr, tek ti erdhi një nga këshilltarët e zotit Mejdani dhe na sugjeroi se ndoshta do të kishim mundësinë që, me fondet që mendonin se kishim, të blinim një makinë të re për zyrën e Presidentit. Ti më thirre, më tregove për sugjerimin dhe e refuzuam, duke thënë edhe ndonjë fjalë që nuk shkonte në atë vend.

Në të vërtetë unë isha pak entuziast, duke menduar se punët po ktheheshin për së mbari dhe ia thashë mendimin tim Zekës, por ai, me që e njihte më saktë rrymën e nëndheshme të shte-

tit shqiptar, përplasjet, dasitë, fjalët, premtimet e pambajtura, vështirësitë, më tha qetësisht se nuk duhet besuar shumë nga fjalët, se fjalët i kanë pasur të mira edhe më parë, punët nuk kanë qenë gjithnjë si fjalët. Ai kishte pasur të drejtë.

Pyetje: Në mesin e shtatorit 1998 do të ndodhë largimi i Fatos Nanos, dhe drejtimin e qeverisë, do ta zërë Zotëri Pandeli Majko. Sipas mendimit tënd, ishte ky ndërrim në të mirë të UÇK-së, apo nuk luajti asnjë lloj roli? Cili ishte kontributi i qeveritarëve të rinj të shtetit shqiptar?

(I.K.:) - Pak më ndryshe ka ndodhur. Vendin e Nanos nuk e zuri Zotëri Majko, por e zgjodhi partia e tij për Kryeministër në Kongres të jashtëzakonshëm. Ndodhi kjo sepse me 14 shtator qe vrarë Azem Hajdari, lideri i parë i Partisë Demokratike. Ndodhi revolta e PD-së, e cila provoi të bënte grushtshtet. Nano dezertoi me 15 shtator nga posti i kryeministri dhe u arratis e u strehua në Maqedoni.

Sigurisht që ndryshimi i qeverisë ishte favorizues për UÇK-në, sepse kishim mirëkuptim e përkrahje më të madhe dhe më konkrete. Tashmë edhe Ilir Meta u bë zëvendës-kryeministër dhe ai ishte shqetësuar, merakosur e angazhuar prej fillimit të luftës. Nga qeveria e re kishim gatishmëri të avancuar, por ja që këtë ndryshim disa nuk e mirëpriten dhe prandaj sabotuan që të shfrytëzojmë maksimalisht gatishmëritë dhe ofertat e Kryeministrit Majko.

***(B.I.:)** - Në Shqipëri, në periudhën për të cilën po flasim, ndeshemi me një dukuri të re, është rasti kur populli i zakonshëm është më përpara se qeveritarët e tij. Ai, populli, e përkrah UÇK-në, e ka për zemër atë, bën akte jo të bujshme, por domethënëse. Nga këto raste, cili ju ka bërë më shumë përshtypje dhe ju ka mbetur në mendje?*

(I.K.:) - Nuk dëshiroj të veçoj individ, mbase i kam dhënë shpjegimet më herët për këtë tematikë. Sa për popullin, qysh kur ndodhi Epopeja e Jasharëve u bë një kthesë e madhe ndërgjegjësimi e solidarizimi, sidomos nga mbrëmja e 14 marsit 1998, kur RTSH fillimisht e pastaj edhe TV të vendeve të tjera, emetuan fotografitë e para të masakrës në Prekaz, fotografi që i kishte bërë në rrethana tejet të vështira dhe të rrezikshme Bekim Shyti. Por atë ndërgjegjësim nuk pati kush ta materializonte për të mobilizuar luftëtarë që do t'i bashkëngjiteshin UÇK-së. Një përpjekje bëri politikania patriote Monika Kryemadhi, e cila ishte atëherë Kryetare e Rinisë Eurosocialiste. Ajo thirri të rinjtë të regjistroheshin vullnetarë, që të shkonin në luftë. Ajo zuri të përpilonte lista me emra konkret, por munguan strukturat e UÇK-së që t'i angazhonin vullnetarët e gatshëm. Ai angazhim i Zonjës Kryemadh pat shqetësuar ndërkombëtarët.

(B.I.:) *- E di se në Tiranë, në kohë të ndryshme, jeni takuar me ushtarakë të shtetit shqiptar. Disa herë, edhe tek unë, e keni shfaqur mendimin se do të ishte mirë sikur me çështjet e logjistikës të merren ushtarakët e mësuar, të shtetit shqiptar, të cilët mund të realizojnë në mënyrë më të organizuar të gjitha punët që duhen. Me cilët jeni takuar, nëse mund të jepen emrat dhe si qëndronte ideja që kishit asaj kohe?*

(I.K.:) - Kam takuar shumë ushtarakë, por fatkeqësisht nuk i kanë lejuar pushtetarët e Tiranës dhe as ne të merrnin përsipër logjistikën e UÇK-së në territorin e Shqipërisë dhe as të angazhoheshin në UÇK. Vërtet do të kishte qenë ndihmesë e madhe. U angazhua vetëm ndonjëri që nuk iu përmbajt ndalesës së pushtetarëve të Tiranës, ose që ishin dërguar si informatorë të shërbimeve shqiptare SHIK dhe SHIU. Thënë të vërtetën, ta-

koja përplot ushtarakë të gatshëm, të cilët pushteti i Berishës i kishte nxjerr në pension para kohe, edhe të tjerë që mbeten në udhëkryq kur u shpërbë Ushtria shqiptare gjatë rebelimit të vitit 1997, por nuk do t'i angazhonim, pasi "komandanti i përgjithshëm" dhe ndonjë shef i tij, kishin mosdurim ndaj ushtarakëve profesionistë, të Shqipërisë dhe të Kosovës, përjashto ndonjë rast kur ata vetë duhet të kenë angazhuar ndonjërin, dyshoj si mercenarë (ta zëmë, si rasti i Kudesi Lamës).

(B.I.:) *- Këshilli i Përgjithshëm, në qershor 1998, analizoi Konkluzionet e Komisionit të veçantë për ngjarjet e luftës. Ju keni qenë pjesë e diskutimeve që janë zhvilluar. A mendoni tani, pas kaq viteve, se ka qenë në dobi të Organizatës, krijimi i një fryme më të qetë dhe pse ndodhi e gjithë kjo përplasje?*

(I.K.:) - Sikur mos t'i vlerësoja të dobishme Konkluzionet, nuk do t'i kisha votuar. Konkluzionet qenë një gjetje e mirë për situatën dhe kohën, ama nuk qenë plotësisht të drejta. Për ato merita ju takon kryesisht juve. Po të mos ishte roli juaj vështirë se do të gjenim zgjidhje ne të tjerët, sepse ishim palë në konflikt, siç thuhet.

Në bazë të akuzave që pat ngritur Hashim Thaçi në Mbledhjen e 6-të të Përgjithshme, të cilat Komisioni i pat skualifikuar si të pasakta, u mënjanuan disa bashkëveprimtarë të përkushtuar (prandaj Emrush Xhemaili dhe Gafurr Elshani, kokë me vete ose nga hidhërimi, duhet të kenë hyrë në Kosov, ku dhanë kontribut të çmuar në radhët e Ushtrisë sonë.). Dëmi që pësuan ata nuk riparohej dot, por ama edhe ngritësit e akuzave nuk u dënuan. Nuk u dënuan, sepse Lëvizja nuk kishte më pushtet mbi disa nga anëtarët e saj. Pra, siç e thashë, ishte një zgjidhje pragmatike për të shpëtuar atë që mund të shpëtohej dhe për të menaxhuar Lëvizjen si tërësi. Tashmë disa

njerëz, brenda Organizatës, mendonin se e kishin përvetësuar UÇK-në. Por, sidoqoftë, fundi rezultoi i mbarë, dolëm fitues. Pa dashur ta teproj me lavdërime, por për hir korrektese duhet them – fal edhe angazhimit tuaj.

(B.I.: / Ndërhyrje:) *- Është me vend të të sqaroj një gjë, e cila më duket e rëndësishme. Komisioni i Posaçëm nuk u ngrit për të dhënë dënime dhe kjo nuk ishte në kompetencën e në të drejtën e tij. Ai u ngrit për të verifikuar disa ngjarje dhe për të analizuar disa akuza që u bënë në Mbledhjen e Përgjithshme. Bashkëveprimtarët e përkushtuar, të mënjanuar pa të drejtë, nuk ishin vetëm të njërës "palë", nëse i quajmë kështu. Më shumë se nga akuzat, ata u mënjanuan nga sistemi që zgjodhëm. Nëse nga njëra anë, ta zëmë, nuk u rizgjodhën Gafur Elshani apo Bislim Elshani, që e meritonin plotësisht, nga ana tjetër, nëse vazhdojmë t'i quajmë kështu, nuk u zgjodhën Bilall Sherifi apo Shaban Muja, që po ashtu e meritonin plotësisht. Por në Mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm askush nuk e ngriti çështjen e pasakuzave.*

Fakt është se, pas prillit të vitit 1998, Organizata në Kosovë u shndërrua e gjitha në strukturat e UÇK-së. Unë mendoj se kjo i bën nder asaj, sidomos për konceptimin e drejtë se lufta ishte në vendin e parë. Ndryshe nga Lëvizja, LKÇK ndërmori aktivitet politik partiak dhe kjo solli edhe një farë ndarje. Edhe më parë, LKÇK kishte pasur qëndrime të ngurta ndaj luftës. Por nga ana tjetër, Lëvizja jashtë vendit mori një hov të jashtëzakonshëm, kjo për meritë të shembullit të anëtarëve të saj që ishin në luftë. Cilat kanë qenë lidhjet tuaja, pas qershorit të vitit 1998 me njerëzit që ishin në luftë dhe me strukturat e atjeshme?

(I.K.:) - Kisha lidhje të shumëfishta dhe të shumëllojshme

me disa kuadro kryesorë të UÇK-së në Kosovë, sidomos përmes bashkëveprimtarëve të Lëvizjes. Lidhje të drejtpërdrejta, sipas nevoje, me mundësoheshin përmes telefonave satelitorë, sepse Bashkësia Demokratike e Shqiptarëve në Gjermani, e regjistruar si shoqatë, ishte bartëse e tyre, më konkretisht Telekomi gjerman na i kishte dhënë me *lising*. Sa mbaj mend, duhet të kenë qenë rreth 140 telefona satelitor që i kishim futur në Kosovë dhe në muaj shpenzoheshin qindra mijëra marka. Listën e numrave të tyre i kishim vetëm disa veta dhe prandaj mund t'u telefononim, por edhe përdoruesit e tyre në Kosovë mund të telefonin në gjithë botën. Për shembull, pothuajse të gjithë përdoruesve në terren është dashur t'ua shpërndajmë numrat e një baze të NATO-s, e ngritur enkas në Maqedoni, për të informuar për lëvizjen e trupave ushtarake serbe. Por, lidhjen operative në mes të UÇK-së dhe zyrës së Fondit në Gjermani i kanë mbajtur strukturat që i kishin caktuar vetë zonat e Ushtrisë në Kosovë, të cilat ishin udhëzuar të kërkonin financa aq sa u duheshin.

Meqë ra fjala për telefona satelitorë, se si me shkrepi të gjej zgjidhje për të mos paguar aq shumë për bisedat telefonike. Rreth tre-katër javë para se të përfundonte lufta, i telefonova Shtabit të Ushtrisë gjermane, i ngritur enkas për Kosovën. Zërit në linjë ia paraqita problemin, se në pamundësi që të paguajmë shpenzimet, jemi të detyruar të ndërpresim kontratën me Telekomin. Folësi u habit nga paraqitja ime dhe me tha se kisha telefonuar gabimisht, meqë ai Shtab nuk kishte të bënte gjë me telefonat tonë. E luta të konsultohet me një epror më të lartë, duke e sqaruar se ishin telefonat e vetëm që kishte UÇK-ja në Kosovë dhe përmes tyre po informohej NATO-ja. Folësi sërish sqaroi se nuk ishin kompetentë për të bërë gjë për telefonat tonë. Kështu përfundoi biseda. Por, ndodhi surpriza. Pas

rreth 15 minutave pranova një telefonatë. M'u tha të dalë pas gjysmë ore në restorantin përballë zyrës së Fondit ku do të më takonin dy persona. Ata dy persona që takova ishin ushtarakë të Shtabit gjerman, por të veshur civil. Biseduam për telefonat satelitorë dhe për Luftën. Në fund me sugjeruan që të shkoja në Telekom, të bëjmë ndërprerjen e kontratës. Më tej premtuan se telefonat do të vazhdonin të punonin dhe Shoqata jonë nuk do të detyrohej të paguante më. I gëzuar shkova në Telekom. Me priti personi që e kishte paralajmëruar Shtabi i Ushtrisë gjermane. Më tha se kontratën nuk kisha nevojë ta ndërprisja, por edhe për të paguar nuk ishim më të obliguar. Rreth shtatë muaj pas luftës nga Telekomi gjerman më kishte ardhur në banesë një faturë me shumë të përgjithshme prej rreth 1 milionë e 200 mijë markave. U shqetësova, me mendim se gjermanët me paskëshin mashtruar, sepse fatura ishte lëshuar në emrin tim. Unë isha në Prishtinë. I shqetësuar bisedova me Adem Grabocin, i cili ishte përgjegjësi i shndërrimit të Fondit "Vendlindja Thërret" pas mbarimit të luftës në "Fond të qeverisë se përkohshme". Më tha me sarkazëm, më mirë të shkoja në burg disa vjet, se sa të paguanim atë shumë. Kur shkova pas dy vjetëve në Gjermani u paraqita me atë faturë në Telekom për t'u sqaruar. Personi i autorizuar më tha se faturën mund ta mbaja kujtim, por nuk kisha përse të shqetësohesha, sepse më nuk do t'm'i kërkonin. Ndjeva një si lehtësim dhe pata menduar me vete: megjithatë gjermanët e mbajtkan fjalën, edhe pse nuk kishim firmosur asnjë marrëveshje.

Për ndonjë kërkesë konkrete rëndom na telefononin ushtarakët e zonave në Kosovë dhe për to ju konsultoja juve. Ju falënderoj që çdo herë keni miratuar kërkesat e tyre. Edhe Jashari nuk ishte kundër. Diçka që më kujtohet posaçërisht është fakti se nga Telekomi merrja listë raportuese për të gjitha thirrjet

e bëra dhe kisha mundësi të shihja kush dhe me kë telefononte.

(B.I.:) *- Në këtë periudhë, në qershor-korrik 1998, ndodh edhe dezertimi i ushtarëve të FARK-ut, si një sprovë fatkeqe që, ende sot, nuk e di se kush provoi ta bënte. Siç dihet, me këmbënguljen e strukturave të LDK-së dhe të FARK-ut, shumë vetë në zonën operative të Dukagjinit, dorëzuan armët, me shpresën se shpejt do të kenë armë të tjera moderne. Si qëndron për ty krijimi i FARK-ut dhe ngjarja në fjalë?*

(I.K.:) - Sipas dyshimit tim FARK-u qe formuar me urdhër të Beogradit, si dikur LDK-ja. Për Ahmet Krasniqin dhe Tahir Zemajn dyshoja se ishte tandemi më proserb, që komandoheshin nga eprorët e tyre në Beograd. Për ta luftuar UÇK-në nga brenda, ai tandem formoi një brigadë me mercenarë e vullnetarë të mashtruar dhe u fut në Zonën e Dukagjinit. Fillimisht qe ndaluar nga UÇK-ja, sapo hyri në Dukagjin, por dikush duhet të ketë mashtruar Shtabin e Zonës se Dukagjinit, se gjoja kishin marrëveshje me FARK-un për të hyrë ajo brigadë, e komanduar nga Tahir Zemaj, që të luftonin bashkërisht kundër pushtuesve. Shpejt u vërtetua e kundërta, se ajo brigadë kishte hyrë për të bërë diversion në Dukagjin, në Zonën më të armatosur në Kosovë, për të prerë edhe rrugët e furnizimit me armë.

Sapo e kreu misionin, Tahir Zemaj, i shoqëruar nga Ramiz Muriqi dhe kryeshefi i UDB-së së Malit të Zi, nëpër territor të Malit të Zi kthehet në Shqipëri. Për meritat në shërbim të pushtuesve serbë Ahmet Krasniqi e dekoron në Tiranë Tahir Zemajn. Pason dënimi. Sipas investigimeve të mia, një ishushtar i Tahir Zemajt, vret Ahmet Krasniqin. Ky atentat ishte një fat i madh për Kosovën. Vendin e tij, me miratimin e Ali Ahmetit dhe timin, e zuri Halil Bicaj. Edhe ky ishte fat i madh për Kosovën. Prej atij momenti, komandimi i Halil Bicajt bëri

që edhe FARK-u të angazhohet për çlirim të Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me UÇK-në.

Një qëndrim i kundërt me njëri tjetrin

(I.K.:) - Le të kthehemi tek një problem, ndaj të cilit keni reaguar që herët. Në janar 1999, Këshilli i Përgjithshëm mori vendimin që administrimi i Fondit t'i kalojë Shtabit të Përgjithshëm. Të dy e dimë se si lindi ky variant. Unë dhe gjithë Këshilli i Përgjithshëm, e kemi mbështetur këtë vendim, ndërsa Ti, Ali Ahmeti dhe Naser Idrizi, ishit kundër. Sidoqoftë, vendimi u mor, për mendimin tim edhe të sotëm, parimisht ishte një vendim i drejtë, ndërsa për shkak të moszbatimit si duhet të tij, sidomos nga ti dhe Jashari, ai vendim u tërhoq. Arsyet mund t'i kishit pasur të ndryshme, por fakt është se, edhe në këshillat popullorë, si quheshin asaj kohe, vendimi u prit ftohtë, për të mos thënë se nuk ishin në një mendje me Këshillin e Përgjithshëm. Është vendi që edhe një herë të kujtoni të gjithë atë që ka ndodhur dhe meqenëse kemi qenë në dy pozicione të ndryshme, le të shfaqim mendimet tona edhe sot. Së pari, pse ishit kundër atij Vendimi?

(I.K.:) - Të dy e dinim se ishte një si komplot ndaj Fondit. Ashtu kam menduar atëherë, ashtu mendoj edhe tani. Ju mendonit se mund ta kthenit në të mbarë, sipas parimit që mbronit. Unë mendoja se nuk mund të kthehej për mbarë, duke pasur parasysh problemet që kishim pasur dikur. Sidomos më vriste ideja se ky vendim erdhi menjëherë pas vendimit tonë për përqendrimin e Fondit në zyrën që kishim ngritur, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm, në Tiranë dhe ku, sipas propozimit tuaj, autorizuam Ramiz Lladrovcin dhe Halil Se-

limin. Kam qenë në zyrë, në fond, kur erdhi Letra që e kishit shkruar ju, së bashku me Vendimin e Këshillit të Përgjithshëm dhe e pashë se si u ngrysën disa.

Lëvizja e kishte themeluar UÇK-në dhe Fondin "Vendlindja Thërret". Përse "fëmija" duhet t'u imponontе tani prindërve parimet?! – nëse mund të përdor figuracion kaq të pahijshëm. Në çdo shtet qeveria dhe parlamenti caktojnë buxhetin për ushtrinë, ndërsa ministria e mbrojtjes e menaxhon atë buxhet dhe jo ushtria. Meqë nuk kishim shtet, Lëvizja për UÇK-në ishte parlamenti, qeveria dhe ministria e mbrojtjes. Vetëm militaristët që mendojnë se ushtria duhet të jetë mbi të gjitha institucionet, mundohet ta "pavarësojnë" ushtrinë, që do të thotë ta vënë mbi institucionet që e kanë formuar dhe financuar…

(B.I.: / Ndërhyrje:) *- Mos e trajto kështu, le ta trajtojmë më realisht, si e kemi shtruar atëherë: kush më mirë se Shtabi i Përgjithshëm do t'i dinte hallet e nevojat e luftës. Pastaj, paraprakisht është vendosur që Organizata të kishte përfaqësinë e saj në Tiranë dhe përmes saj të bëhej lëvizja e logjistikës. Deri atëherë, Lëvizja dhe Shtabi kishin qenë buka e një mielli, përse duhet bërë ndarja, ne jemi "prindërit", e ju jeni "fëmija". Pra, në asnjë rast nuk do të kishte mënjanim të Lëvizjes. Fakti që dy personalitete të Lëvizjes, Ramizi dhe Halili ishin në qendër, ishte një shkas më shumë për besimin që duhej të kishim ndaj Vendimit tonë. Herë pas here, ka ngritur shtat mendimi se kush do të kishte mjetet e logjistikës, ishte më i rëndësishëm. E di, jam i bindur, se nuk ke vuajtur nga kjo "hedhje shtati". Por, për hir të së vërtetës, më parë, këtë Vendim, e kisha diskutuar në Tiranë me Xhavit Halitin dhe ai kishte qenë dakord, e pastaj, në Lërach (Lörach) edhe me Hashim Thaçin. Pra nuk kishte qenë një Vendim që do të kishte shkak të kundërshtohej.*

(I.K.:) - Nëse të kujtohet, ne kemi qenë në shtëpinë e Shaban

Vishës, kur ka ardhur Letra e Shtabit për vendimin e tyre, që duhej ta miratonte edhe Lëvizja. Që në atë moment në mbledhjen e Kryesisë i thashë Bardhylit që e solli Letrën, se këtu ka një hile të madhe dhe se nuk është vendim i lindur rastësisht.

Ne kishim gjendje jo gjithnjë të mirë në terren, kur e dinim se mjetet financiare të Fondit jo kudo po përdoreshin drejtë, pasi kishte edhe dyshime se mund të shpërdoroheshin. Për këtë Lëvizja, Këshilli i Përgjithshëm, bëri disa analiza të veçanta për Fondin. Dyshimi im ishte se mos shtetarët shqiptarë, përmes presionit, bllokimit, angazhimit fals, mund të përfitonin dhe do të shpërdoronin Fondin. Flitej se Nano po përfitonte shumë nga fondi ynë…

(B.I.: / Ndërhyrje:) *- Mos harro që Nano ka ikur nga qeverisja në shtator 1998 dhe deri asaj kohe, fondi i luftës ishte tepër i pakët për të pasur dikush që të përfitonte shuma të ndjeshme nga fondi. Në maj të këtij viti fondi nuk mbulonte as nevojat për ushqim dhe pak logjistikë të njerëzve që kërkonin të luftonin, e jo të bënte "dhurata".*

(I.K.: / Vazhdim i përgjigjes:) -... pastaj, ata që donin të "centralizonin" Fondin, nuk e kishin të gjithë për të mirë të UÇK-së, por për të bërë presion kundër zonave operative ushtarake të Ushtrisë sonë, sepse ato ende nuk e pranonin komandimin e atyre që rrinin në Tiranë. Por, edhe kur u konsolidua Shtabi i Përgjithshëm, financimi i UÇK-së, ashtu siç kishit shpresuar ju, nuk u përmirësua krejtësisht. Për dëshmi po sjell prononcimin e Komandantin të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Agim Çekut. E pata pyetur pas lufte, në prani të Rexhep Qosjes, Ton Markut dhe të tjerëve, në kabinetin e tij, se a dinte kush i menaxhonte financat e UÇK-së gjatë kohës kur ai ishte Komandant i Shtabit të Përgjithshëm dhe a ishte

informuar ndonjëherë për mënyrën e shpenzimit të tyre? Ai qe përgjigj me një JO të prerë. Po të tjerë pjesëtarë të Shtabit janë informuar ndonjëherë, a është diskutuar e planifikuar në Shtab, sa mjete kanë dhe përse e si duhet t'i shpenzonin!? Përgjigja e tij qe gjithashtu jo.

Që të mos e zgjas, ju patët votuar pro sepse, siç e thatë, e çmuat parimore. Disa nuk kishin informata se po mund të shpërdoroheshin mjetet. Ne që votuam kundër kishim informata edhe para se ju të zgjidheshit Kryetar, dhe vazhdonim të ishim të lidhur me shtabet e zonave, prej ku informoheshim. Këto informata i kishit edhe ju, kur u bëtë Kryetar, qoftë nga lidhjet tuaja, qoftë përmes nesh, që herë pas here konsultoheshim me njëri-tjetrin, si edhe nga raportimet që bëheshin. Kishte të tjerë, sidomos ata që porsa ishin zgjedhur në Këshillin e Përgjithshëm, që nuk kishin njohuritë e duhura se çfarë po ndodhte në kushtet e luftës.

Po sjell si shembull, se si silleshin disa, sidomos "komandanti i përgjithshëm", Azem Syla. Ta zëmë Naser Idrizi kishte vëllanë, Qemalin, në Krumë dhe bashkë me Ruzhdi Saramatin kishin krijuar një linjë furnizimi për të futur armë në Kosovë. Nga mesi i marsit 1998, ata kërkuan një varkë, sepse kalimi i Drinit me ngarkesë të logjistikës së luftës ishte i vështirë, ujët ishte i ftohtë dhe meqë ishte i thellë, lageshin armët dhe municioni. Me kërkesën e tyre porositëm Refik Hamitin në Gjermani për ta blerë e sjellë një varkë gome. Në Portin e Durrësit prisnin njerëzit e Azem Sylës, për t'i marrë të gjitha furnizimet materiale dhe prurjet financiare. Ata e kishin marrë atë varkë dhe e kishin dërguar në depon që e menaxhonte Shaip Muja. Por, nga depoja nuk dilte gjë pa leje të Azem Sylës. Iliri dhe Dilaveri e kishin kërkuar disa herë atë varkë për ta dërguar në

Krumë. Nuk e merrnin dot. Kërkuan intervenimin tim. Që të tre e takuam Azemin. Ai refuzonte, me arsyetim se ishte blerë pa lejen e tij. U desh ta kërcënoja që të jepte miratimin.

Qemali kishte parë një aksion spektakular, të cilin e kishte përgatitur Azem Syla. I kishte paguar hasjanët që të fusnin në Kosovë 24 kuaj të ngarkuar me armë. Kishte bërë incizimin me videokamerë kur ishte nisur karvani. Ndërkohë bënë mot i keq dhe hasjanët zbarkojnë armët në një vend tjetër, jo atje ku ishin porositur. Disa ditë kishte rënë shi. Qemali dhe Ruzhdi Saramati i kishin parë rastësisht armët, kur po hynin në Kosovë. Erdhi Qemali në Tiranë për të kërkuar leje nga Azemi që t'i merrte ato armë që kishin filluar të ndryshkeshin nga shiu dhe t'i dërgonte deri në pikën ku do t'i merrnin furnizuesit e UÇK-së. Azemi, në vend që të mirëpriste atë lutje, u tërbua fare, duke thënë se Qemali po shpifte, meqë ato armë kishin shkuar në destinacion. Qemali u hidhërua dhe fati deshi që isha unë i pranishëm, përndryshe kisha drojën se do ta kishte demoluar fizikisht Azemin për atë denigrim që i bëri. Pas dy ditësh Ushtria serbe i gjeti ato armë. Bëri incizime dhe i emetoi në televizion, si sukses operativ kundër UÇK-së.

Për ca zhvillime para se ju të zgjidheshit Kryetar rrëfeva më herët dhe nuk po i përsërisë. Ama, ju falënderoj edhe tani për atëherë, se ju mbajtët qëndrim të drejtë, jo si disa anëtarë të Kryesisë që më patën bërë fajtor në mbledhjen e marsit 1997, pse Nëndega në Gjermani u kishte dërguar ndihma financiare tri zonave ushtarake në Kosovë. Dhe jo vetëm mbajtët qëndrim të drejtë, por drejtuat Kryesinë që të gjenim kompromise dhe nuk di të na ketë ndodhur ndonjë përplasje e hidhërim gjatë mandatit tonë.

Këto ndodhi Qemali duhet t'ia ketë treguar vëllait të tij,

Naserit. Pastaj Naseri ishte i autorizuar nga Shtabi i Zonës së Shalës për ndërlidhës dhe e dinte çfarë do të ndodhte, nëse do të kishte një pëqndrim fiktiv dhe jo të efekkshëm..

Neve që kishim aq shumë informata nuk do të na falej asnjëherë të votonim pro tjetërsimit të të gjithë Fondit, edhe nëse në dukje, duhej të ishte parimore që Fondin ta menaxhonte në mënyrë të centralizuar Shtabi i Përgjithshëm.

Edhe sot nuk e di përse Ramiz Lladrovci paskësh votuar pro. Ka mundësi se ai nuk ka qenë në atë Mbledhje të Këshillit të Përgjithshëm, ose e ka bërë nga respekti ndaj jush. Ai e dinte se me çfarë zori e kishte siguruar një snajper 12.7 mm për Fehmiun. Të tillë snajperë vazhdimisht i kemi pasur problem. Ata i binin bashkatdhetarët nga Amerika. Totali i shpenzimeve për një snajper ishte rreth 8 mijë dollarë. Nga ata snajperë vetëm një mundi ta merrte Ramizi për t'ia dërguar Fehmiut, pasi u rebelua. Ai përgjithësisht e dinte se si po e pengonin Fehmiun, Bekim Berishën dhe të tjerë si ata. Bekimi i pat lënë ankesat e tij me shkrim dhe në audiokasetë, para se të nisej drejt vdekjes heroike në Junik.

Fatmirësisht vendimin e tërhoqët shpejt dhe për këtë merita kryesore ju takon juve, sepse ishit Kryetar që respektonte kundërshtitë e këshillave popullorë dhe kishit ndikim te Hashimi, që ta bindnit për pasojat.

(B.I.:) *- Me Vendim të Këshillit të Përgjithshëm, si përfaqësues të Lëvizjes dhe të Fondit u dërguan në Tiranë Ramiz Lladrovci dhe Halil Selimi. Ramizi jetonte në Gjermani ndërsa Halili që nga viti 1993 jetonte në Shqipëri. Mendoni tani se ky ishte një vendim i drejtë, dhe nëse po, ku konsiston arsyetimi yt, dhe e kundërta: nëse sot nuk keni të njëjtin mendim si asaj kohe, si e arsyeton?*

(I.K.:) - Vendimi ishte i drejtë, por rezultoi vetëm pjesërisht i suksesshëm. Këshilli i Përgjithshëm vendosi për të menaxhuar ndershmërisht dhe efektivisht mjetet e Fondit. Por, nuk mundem ta shkarkonim Xhavitin nga autorizimi, për ta zëvendësuar me Ramizin dhe Halilin që i kishim votuar. Kjo po dëshmonte se Kryesia jonë nuk e kishte të gjithë autoritetin e duhur për të zbatuar atë vendim.

(B.I.: / Ndërhyrje:) *- Pasi lexova këtë pjesë të përgjigjes tënde, iu drejtova edhe një herë Arkivit të Organizatës dhe gjeta Vendimin përkatës, i cili, kur u dërgua në Tiranë, është nënshkruar nga unë. Më përpara, kisha një bisedë telefonike me Azem Sylën, nga të paktat, pasi vetë përcaktimi që kishim dhe njohja jonë kishte qenë e vonshme. Ndryshe ishte me Xhavit Halitin, me të cilin, edhe pse nuk e kishim njëri-tjetrin, në rrethin e miqve të afërt, kishim gjithnjë ndjenjën e mirë të bashkëpunimit. Azemi më kërkoi informacion për Vendimin e Këshillit të Përgjithshëm dhe më tha se do të ishte mirë nëse do të shkoja vetë në Tiranë dhe të qartësonim gjërat, e ndërkohë, t'i dërgoja një kopje të vendimit përkatës. Unë mora pjesë nga procesverbali, pra nga diskutimet e zhvilluara, dhe për korrektesë, po i risjell në dialogun e përbashkët:*

"Bedriu: - Ky është një Sektor i ri që po krijojmë në Tiranë dhe që del nga Vendimi që porsa morëm për mbarëvajtjen e mëtejme të Fondit 'Vendlindja thërret'., po edhe nga Vendimi që kemi marrë për centralizimin e fondit në Shqipëri. Ky Sektor nuk i bie ndesh Sektorit të rëndësisë se veçantë, por bashkëpunojnë me njëri tjetrin. Për krijimin e këtij sektori është biseduar paraprakisht edhe me Zekën (Xhavit Haliti), është biseduar edhe me të tjerë, të gjithë janë dakord që të bëhet centralizimi i fondit".

XIV. Rambujeja / Një nisje e re

(B.I.:) - Viti 1999 u hap me një ngjarje të rëndësishme për shqiptarët në Kosovë dhe përgjithësisht për shqiptarët dhe çështjen e tyre: Konferenca e Rambujesë. Personalisht nuk e kam besuar se kjo konferencë do të jetë e fundit për Kosovën. Si e ke përjetuar atë, kur për më tepër, në ditët e zhvillimit të saj, ti ke qenë në Rambuje, në atë që mund të quhet seksion i përkrahjes dhe i ndërtimit të lidhjeve mes delegatëve dhe zonave dhe njerëzve në Perëndim? Desha të di për punën që është bërë në ato ditë dhe përjetimet personale që keni pasur, ti dhe shokët tanë.

(I.K.:) - Vendimi i Bashkësisë ndërkombëtare për të mbajtur Konferencën ndërkombëtare për Kosovën ishte një surprizë tejet avancuese. Për herë të parë në historinë e saj Kosova po faktorizohej si subjekt politik ndërkombëtar. Nuk po e fsheh dot, as për hir të modestisë, kënaqësinë që kam ndier, sepse kjo fitore më bindte se gjaku i bashkëveprimtarëve në themelet e Lëvizjes, më 17 Janar 1982, gjaku i bashkëveprimtarëve në vitet pasuese dhe luftëtarëve të shquar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i derdhur deri në ditën kur do të fillonte Konferenca ndërkombëtare në Rambuje (më 6 Shkurt 1999), po shpaguhej me këtë fitore. Kisha bindjen se aty e tutje Kosova do të përparonte drejt fitoreve të tjera. Kurse në planin subjektiv, kjo fitore ishte edhe një shpërblim shpagues për angazhimin dhe sakrificat e mia të deriatëhershme, shumëvjeçare.

Kjo fitore nuk e ekzaltoi dhe dalldisi Organizatën tonë, që të hutohej për të mos u dalë zot angazhimeve ditore. Prandaj,

pos shumë planifikimeve e vendimeve, vendosëm që në Rambuje paraprakisht të vendosej një ekip pune për t'i qëndruar sa më pranë Delegacionit tonë në Konferencë, për ndihmë "teknike" dhe morale dhe për të informuar mediet botërore që do të vendoseshin aty. Në këtë ekip, fillimisht nga kryesia e Organizatës në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm, qenë caktuar Bardhyl Mahmuti, Sabri Kiçmari, unë dhe, pastaj, edhe Pleurat Sejdiu, Xhevat Bislimi. Ndoshta edhe ndonjë tjetër, që tani nuk po më kujtohet. Menjëherë morëm masat teknike dhe bëmë rezervimin e hotelit sa më afër Kështjellës.

Ditën kur Shtabi i Përgjithshëm po caktonte anëtarët e Delegacionit që do ta përfaqësonte UÇK-në ishim së bashku Bardhyl Mahmutin, unë dhe një i tretë që po voziste makinën (tani nuk më kujtohet se cili ishte) në rrugëtim e sipër nga jugu i Gjermanisë në drejtim të Bonit. Gjatë rrugës Bardhyli më tregoi se në ato momente po mbahej mbledhja e Shtabit. Më kërkoi që të flisja me Zëdhënësin e Shtabit, Zotëri Jakup Krasniqin dhe t'i sugjeroja Bardhylin si pjesëtar të Delegacionit. Pa ndonjë hezitim e miratova propozimin e tij, edhe pse nuk më pëlqeu propozimi që e bëri për vete. Thënë të drejtën, e mendova edhe si një shans, që shqiptarët e Maqedonisë të kishin një njeri nga anët e tyre në delegacion, sepse në Organizatën dhe Ushtrinë tonë kishte shumë veta nga Maqedonia dhe kontributi i tyre ishte tejet i rëndësishëm dhe dinjitoz. Pastaj, nga burime diplomatike ishim informuar se pritej që Bardhyli të ishte njëri nga anëtarët e Delegacionit dhe unë kisha konsideratë për përgatitjen e tij profesionale dhe për përvojën diplomatike.

Ndaluam anash magjistrales. Bardhyli telefonoi me celular dhe, sapo mori lidhjen, ma kaloi mua. Jakupi më njoftoi se sapo kishin caktuar pesë veta: Hashim Thaçin, Jakup Krasni-

qin, Ramë Bujën, Azem Sylën dhe Xhavit Halitit. Kurse unë e luta që të korrigjohej përbërja e Delegacionit, duke propozuar që të jetë anëtar edhe Bardhyl Mahmuti. Ai më sqaroi se tashmë ishte vendosur dhe nuk mund të bënin ndryshime. Me atë rast shpreha pakënaqësinë, me ton goxha të ngritur, se nuk kishte kuptim të ishin tre drenicas nga pesë veta sa ishte Delegacioni, se shqiptarët e Maqedonisë meritonin të kishin një anëtar në Delegacion, se Azem Syla nuk kishte pse të ishte pjesë e Delegacionit, meqë nuk do të merrte vesh gjë se çfarë do të ndodhte në Konferencë, etj. Biseda përfundoi me shprehje të hidhërimit tim. Nga ai moment Bardhyli u trazua tepër emocionalisht, shfryu me disa sharje që ishin në temperamentin e tij në çastet e zemërimit dhe tha se nuk do vinte fare në Rambuje. Më vonë e shndërroi hidhërimin e tij në një kundërshtim të heshtur fillimisht ndaj Hashim Thaçit dhe bashkëpunëtorëve të tij dhe e zgjati deri disa muaj pas Çlirimit të Kosovës. Më saktësisht, deri kur Hashimi dhe vetë rrjedha e ngjarjeve e mundi atë. Së këndejmi rezultoi që partia Bashkimi Demokratik, që e drejtonte deri atëherë Bardhyli, të riorganizohej në Partinë Demokratike, sipas përcaktimit të Hashim Thaçit.

Një javë para se të fillonte punimet Konferenca, Lëvizja kishte organizuar një miting dhe kishte paraqitur Peticionin e saj politik me kërkesën për Pavarësinë e Kosovës. Mitingu do të ishte si një parathënie e Mitingut të madh që do të zhvillohej më pas, po nga Lëvizja, në përkrahje të Delegacionit shqiptar në Rambuje.

Ishin ditë të ankthshme se çfarë do të ndodhte, ditë të ftohta, me temperaturat e ulëta dhe me dëborën që kishte rënë gjithandej.

Kur shkova të shtunën pasdite në Rambuje, disa orë para se të niste Konferenca, u befasova nga serioziteti i gjendjes para

hyrjes në Kështjellë ku do të mbahej ajo. Aty ishin stacionuar me qindra antena mobile satelitore, gumëzhinin qindra gazetarë nga e gjithë bota. Aktivistët që kishin shkuar më herët na treguan hotelin që kishin rezervuar.

Në fillesat e Konferncës u bë publik emri i Komandantit të Shtabit të Përgjithshëm - Sylejman Selimi, të cilin e thërrisnin Komandant Sulltani. Ky njoftim më pat gëzuar, sepse do t'i shtonte favoret Ushtrisë sonë për të mos qenë anonime, e dyshimtë, pa komandant të njohur me emër e mbiemër të vërtetë. Por, siç do të informohem shumë shpejt, ai njoftim nuk ishte mirëpritur nga Delegacioni i UÇK-së në Rambuje, sidomos nga "komandanti i përgjithshëm", Azem Syla. Njoftimin se Sylejmani u caktua Komandant i Shtabit të Përgjithshëm ai e përjetoi si puç kundër tij, sepse ai pretendonte të ishte i tillë, pavarësisht faktit se nuk e kishte emëruar asnjë strukturë.

Me komandantët e zonave operative ishte në lidhje të rregullt Sabri Kiçmari dhe informimet nga terreni ia përcillte Delegacionit përmes bisedave telefonike, por edhe përmes Dukagjin Goranit, i cili ishte në stafin teknik të Konferencës. Edhe Bukurije Gjonbalaj, gjithashtu pjesëtare e stafit teknik, na ndihmonte në komunikim me përfaqësuesit e UÇK-së në Delegacion.

(B.I.: / Ndërhyrje:) *Zgjedhja e Sulejman Selimit është bërë në ditën e dytë ose të tretë të zhvillimeve të punimeve të Konferencës. Pasi kisha qenë në Rambuje në Mitingun e parë dhe kisha dorëzuar Peticionin në emrin e Lëvizjes, unë erdha atje, në mbrëmjen e po asaj dite të 6 Shkurtit. Ndërkohë, Thaçi kishte mbërritur në aeroportin* e *Parisit, ai po vinte nga Kosova,përmes Zvicrës; ishte me vonesë, dhe një mik i yni i përbashkët, më tregoi se ai do të vinte dhe se*

ishte nën mbështetjen e shërbimit francez të sigurimit, pra ishte i shoqëruar, megjithëse i pavërejtur. Dy ditë më pas ose në të tretën ditë, unë u lidha me të, dhe krahas të tjerave, ai më pyeti se si e kishte pritur Lëvizja zgjedhjen e Sulejman Selimit si Komandant i Përgjithshëm i UÇK-së, gjë që kishte ndodhur një ditë më parë. Sidoqoftë nuk është e rëndësishme data. Tjetër kund e kam fjalën.

Në të vërtetë nuk e kam konceptuar kurrë që drejtuesi kryesor i Luftës të mos ishte në Kosovë. Ai, patjetër, duhej të ishte në drejtimin e Shtabit të Përgjithshëm, siç kishte ndodhur në të gjitha luftërat në botë dhe fakti që Drejtori Politik ishte atje më të shumtën e kohës, nuk e zhbënte rolin që do të duhej të kishte drejtuesi operativ i luftës. Kam menduar gjithnjë se Komandanti i Përgjithshëm duhej të ishte një personalitet me autoritet, me ndikim, fjala e të cilit të kishte peshën e vet të jashtëzakonshme. Një njeri që të ishte i padiskutueshëm dhe i pranuar nga të gjithë, sidomos në kushtet tona. Nuk njihja njeri tjetër më të saktë për këtë se sa Fehmi Lladrovcin, por ai tashmë kishte ndërruar jetë, dhe emërimi i Sulejman Selimit ishte një lajm i mirë. Në fund të fundit, që të jem i saktë, nuk e kisha perceptuar kurrë Azem Sylën, me gjithë respektin ndaj punës së tij, si Komandant të Përgjithshëm. Më shumë e dija se ai ishte përgjegjësi financiar i luftës. Ndaj, kur më pyeti Hashim Thaçi për zgjedhjen e Sylejmanit, i thashë mendimin tim se ishte bërë mirë. Ai më sugjeroi se do të ishte mirë nëse Lëvizja i bënte një telegram urimi dhe mbështetjeje për zgjedhjen e tij, që të mos kishte ekuivoke në zgjedhjen dhe në mbështetjen ndaj tij. Rashë i një mendje, sepse edhe unë doja ta bëja këtë. Pra, në fillim, nuk ishte fjala për asnjë lloj puçi. Vetë Hashim Thaçi e çmoi si një zgjidhje pozitive për kohën, megjithëse nuk kishte qenë një zgjidhje afatgjate, pasi vendin e Selimit shumë shpejt

e mori përsipër Agim Çeku, por kjo është një histori tjetër.

(I.K.: / Vazhdim i përgjigjes:) - Të falënderoj për shpjegimet dhe mendimet. Megjithatë, unë fola për një perceptim dhe përjetim **puçi** vetëm nga pozicioni i Azemit. Por "puçi" kundër Azemit u "riparua" pas pak ditëve...

Po vazhdoj me përgjigjën time.

Ditët në vijim, 17 ditë rresht, sa zgjati Konferenca në atë Kështjellë, ekipi ynë pati aktivitete të ngjeshura informative. Në ndihmë na kishin ardhur edhe korrespondentë shqiptarë nga Brukseli, si Afrim Gjonbalaj, Augustin Paloka, Ekrem Krasniqi dhe të tjerë. Për të qenë më efektiv, në restorantin buzë hyrjes në Kështjellë dhe sheshit qendror, ku ishin stacionuar antenat mobile të transmetuesve satelitor, kishim bërë rezervim të përhershëm të shumicës së tavolinave dhe me pronarin ishim marrë vesh, t'u thotë gazetarëve se pijet e tyre i paguante Kosova. Kjo bujari i tërhoqi shumicën e gazetarëve aty dhe gjatë gjithë kohës informoheshin nga veprimtarët tanë.

Si befasi e përjetova ardhjen e Donika Ekrem Bardhës. Biznesmeni Ekrem Bardha ishte me origjinë nga Jugu i Shqipërisë. Atë e mbaja mend qysh nga viti 1982, kur isha në Amerikë. Ai ishte shquar për përkrahjen e Kosovës. Donika shprehu gatishmëri për t'u angazhuar në ekipin tonë. Në pyetjen, nga e përse kishte ardhur, u përgjigj: "Vij nga Amerika, dëshirova t'i gëzohem fitores së Kosovës duke qenë sa më pranë Konferencës dhe të kontribuoj me atë që do të kërkohet nga unë." Me sharmin dhe gjuhën e saj angleze (si e lindur, rritur dhe arsimuar në Amerikë), pat ndikim të mrekullueshëm te gazetarët e shumtë, për të zbutur paragjykimet e tyre, se populli shqiptar është i prapambetur. Po këtë Donikë, disa ditë pas Çlirimit të Kosovës, me rastisi ta takoj në recepcionin

e Hotelit Grand, në Prishtinë duke rezervuar dhomën. Sapo kishte ardhur nga Tiranë. U gëzua kur u takuam. Më foli: "Gëzuar Kosovën e çliruar. Të lutem për një shërbim. Më gjej një restorant dhe fto miq, sepse kam ardhur nga Tirana për ta festuar Ditëlindjen time në Kosovën e çliruar!"

Nuk po kursej të sjellë edhe një shembull i cili paraqet dhuntitë domethënëse të popullit tonë. Nga unë kërkoi intervistë një televizion arab. Meqë nuk e flisja anglishten, shikova rreth e rrotull, kush mund të ishte më kompetent për të dhënë intervistë. Për momentin aty ishte Krist Paloka. I propozova dhe ai pa ndonjë hezitim pranoi. Por, në atë çast ia pashë kryqin të varur në qafë. U mendova, mund të kishte ndikim negativ kur do ta shihnin besimtarët myslimanë arabë. Krista hetoi se sytë ia kisha drejtuar kryqit dhe po doja t'i flisja, prandaj vetë më foli i pari: "Mos u merakos, po e përthekoj këmishën që të mos duket".

Në Rambuje ishin edhe gazetarët Jusuf Buxhovi dhe Mero Baze. Nuk i kuptova përse nuk po hynin asnjëherë në atë restorant, por shikonin vëngër duke qëndruar para vitrinave të tij kur në shesh bëheshin konferenca shtypi nga personalitetet botërore. Në një rast i takova në një restorant tjetër. Iu bashkëngjita tavolinës së tyre pa pyetur për leje. U habitën. Secili duhej të më njihte në mënyrën e tij. Po paragjykoja se Meroja më njihte si enverist, si ekstremist, ndoshta edhe si vrasës i shokëve, sepse ashtu ishte përfolur në rrethin e njerëzve me të cilët ai shoqërohej dhe komunikonte. Po mendoja, paragjykimet duhej t'ia kishte rritur akoma më shumë Jusufi gjatë këtyre ditëve. Po Jusufi? Njiheshim qysh nga viti 1978. Ai më njihte si armik të shtetit jugosllav, unë e njihja si argat të UDB-së, të kamufluar si korrespondent i gazetës "Rilindja". Ai më njihte si

veprimtar me influencë në Lëvizje, unë e njihja si Nismëtarin e parë themelues të Lidhjes Demokratike. Çfarë pasonte, mund të merrej me mend. Njëri-tjetrin e dinim për kundërshtar politik, ndoshta akoma më shumë. Megjithatë unë bëra gjestin, iu afrova atyre, me synim që t'iu tregoja se Konferenca e Rambujesë ishte një kthesë dhe nuk kishim nevojë t'u përmbahemi paragjykimeve dhe armiqësive të kaluara, por të afrohemi për të ardhmen. U thashë se nuk kishin përse të rrinin të vetmuar, mund të vinin në hotelin ku ishim vendosur, të bashkëpunonim. Pas gjysmë ore bashkëbisedim kërkova leje të largohesha, me shpresë se u mirëkuptuam. Nuk e pranuan ofertën time, vazhduan me të tyren. Më vonë kam lexuar librin e Meros. Me kishte paraqitur si një personazh mafioz në Rambuje. E falënderoj tani për atëherë, sepse, megjithatë, nuk më kishte harruar. Ashtu siç nuk e harrova edhe unë.

Nga fundi i javës së dytë, Prokuroria në Gjermani kishte bllokuar xhirollogarinë e Fondit "Vendlindja Thërret". Ditën e dytë të bllokimit, një gjerman i stafeve të padukshme operative gjermane, i angazhuar rreth Konferencës në Rambuje, më takoi dhe më pyeti: "Pati efekt ndikues te përfaqësuesit e UÇK-së në Delegacion bllokimi i Fondit 'Vendlindja Thërret?" Unë as që isha informuar dhe as edhe ndonjë tjetër nuk e dinte. Por, gjermanit iu përgjigja sikur e dija se e kishin bllokuar: "As që i kemi informuar, sepse nuk duam ti influencojmë me këtë veprim tuajin të padrejtë" – i thashë. Në fillimin e javës se 3-të të Konferencës, pas një bllokimi vetëm gjatë dy ditëve të punës, Fondi sërish na u zhbllokua.

Ndryshe ndodhte me Fondin në Zvicër, të cilin, zonja Del Ponte, atëherë Prokurore e Përgjithshme e Zvicrës, e kishte bllokuar. Rastësisht një belg, konsull nderi i Kinës në Zvicër,

ndërmjetësoi te Zonja Del Ponte për ta zhbllokuar Fondin në Zvicër. Për këtë shërbim ai kërkoi 50 mijë dollarë, me shpjegim se duhej t'ia jepte Zonjës Del Ponto si bakshish. Të hollat iu dhanë belgut në fillim të korrikut 1998 dhe Fondi na qe zhbllokuar. Jo vetëm kaq, por mbi aktivistët e drejtuesit e Fondit bëheshin presione të gjithfarshme, deri tek thirrjet në hetime, arrestimet e përkohshme, cilësimin si një fond që shërben për terrorizmin, e nuk jam çuditur më pas, kur ish-kryeprokurorja e Zvicrës, e dëshmuar kundër zhvillimeve në Kosovë dhe kundër luftës çlirimtare, do të bëhej figura numër një e akuzës në Gjyqin e Hagës; do të nxirrte nga sirtari i vjetër i hidhërimit e urrejtjen, gjithë mllefin kundër luftës, duke bërë akuza monstruoze. Sidoqoftë, megjithëse ajo e bllokoi Fondin në Zvicër, nuk e ndaloi dot dhe, për këtë, i jam gjithnjë mirënjohës shokëve tanë atje, sidomos disa drejtuesve të njohur si Jashar Salihu, Agush Buja, Mehmet Bislimi, Shaban Muja, e të tjerë.

Ditën e parafundit të Konferencës, kur ndërkohë kishte lindur dilema e nënshkrimit ose jo të Marrëveshjes, më takon një bashkëpunëtor i Stafit të Volfgang Petriçit (Wolfgang Petritsch), përfaqësuesit të Bashkësisë Evropiane në Grupin e Kontaktit, i cili ishte mandatuar që ta bashkorganizonte Konferencën. Me tha se vinte i porositur nga Zotëri Petriçi. Midis të tjerash tha: "Zotëri Thaçi po arsyetohet për mosnënshkrimin e marrëveshjes, me rrezikun që e pret nga komandantët e zonave operative të UÇK-së, sepse janë disa ekstremistë që do ta akuzojnë për tradhti kombëtare. Në pyetjen e Zotëri Petriçit, se kush ka ndikim tek ata komandantë ekstremistë, ai është përgjigjur: Ibrahim Kelmendi. Prandaj Zotëri Petriç më dërgoi që t'ju lus, të ndikoni tek ata komandantë, që Zotëri Thaçi të mos ketë presion e ngurrim! Sapo të ketë kohë,

dëshiron t'ju takojë vetë Zotëri Petriçi".

Më vonë ndodhi takimi edhe me Petriçin. E njëjta bisedë, i njëjti sqarim. Kjo më pat irrituar e hidhëruar jashtë mase. E sqarova: "Lidhjet telefonike me komandantët e zonave operative po i mban kryesisht Zotëri Sabri Kiçmari, që të informohemi se çfarë po ndodh atje dhe pastaj t'i informojmë përfaqësuesit e UÇK-së në Delegacion. Të gjithë komandantët janë të përgjegjshëm dhe të disiplinuar, pranojnë e respektojnë vendimin që do të firmosin përfaqësuesit tanë."

Po atë ditë më takon një bashkëpunëtor i stafit të Ministrit të jashtëm gjerman, Joshka Fisher. M'u lut të shkoja në konferencën e shtypit që do ta mbante ai, "meqë do të bisedojë me ju." Shkova. Sapo mbaroi konferencën e shtypit, iu afrova Fisherit: "Je ti Ibrahim Kelmendi"? - më pyeti. M'u drejtua kështu për të dëshmuar se më njihte si kolegë të të njëjtës parti, meqë unë isha i angazhuar në Partinë e tij, Die Grünen (Të Gjelbërtit). "Të njoh, meqë më ka folur për ty, miku ynë i përbashkët, Johanes Vollmer, për të cilin ti e di se është Sekretar i shtetit. Prandaj dërgova bashkëpunëtorin të të lus për këtë takim. Situata është serioze. Kështilltarët më thonë se ti je pengesa kryesore që Zotëri Thaçi nuk pranon të nënshkruajë marrëveshjen. Ma bëjë këtë nder, dhe i thuaj Zotëri Thaçit të nënshkruajë, meqë vetëm ai nuk po pranon. Nuk jeni vetëm ju shqiptarët njerëz të besës, edhe ne gjermanët e mbajmë fjalën. Po nënshkruat marrëveshjen, jua jap fjalën e nderit se ka për të intervenuar ushtarakisht NATO-ja...".

I zënë ngushtë, i thashë: "Nuk jam unë penguesi, për më tepër nuk kam as si të jem, megjithatë po jua them dyshimin tim se kush në të vërtetë po pengon. Jo unë, as komandantët e zonave të Ushtrisë sonë, por po e pengon Shërbimi informativ

ushtarak francez. Këtu në Konferencë ndodhet edhe një oficer i atij Shërbimi, të cilin Zotëri Thaçi e paraqet si 'shok personal'. Kam drojën se Zotëri Thaçi ndikohet nga ai, ose ai ka gjetur mënyrën për të bërë presion ndaj tij. Duhet të intervenoni përmes Qeverisë franceze, që 'shoku personal' të mos bëjë presion ndaj Thaçit dhe më pas, besoj unë, edhe Thaçi do të pranojë".

Joshka ra paksa në mendime: "Qenka situatë tepër e koklavitur dhe për ta zgjidhur na u dashka më tepër kohë..." U ndamë, duke përqafuar njëri-tjetrin si miq që po i rëndonin shqetësime të njëjta.

(B.I.: / Ndërhyrje:) *Nënshkrimi ose mosnënshkrimi nga Hashim Thaçi, gjithnjë sipas mendimit dhe bindjes sime, por edhe nga lidhjet e asaj kohe e të mëvonshme me Thaçin, nuk ka pasur të bëjë me ndikimin ose jo të një pjesëtari të shërbimit francez. Sepse, nëse nga njëra anë do të mund të ishte një shtet si Franca, nëse e përkufizojmë kështu, nga ana tjetër, si rrallë herë, ai kishte mbështetjen dhe ndikimin e shteteve të tjera të fuqishme, mes tyre edhe të Shteteve të Bashkuara, të Gjermanisë etj. Pra nuk mendoj se kjo ishte kështu, kaq e thjeshtëzuar. Më shumë se gjithçka tjetër ajo duhej parë në draftet që paraqiteshin, dhe që nuk ishin, thuajse asnjëherë, në përputhje me dëshirën e shqiptarëve dhe me sakrificat e tyre. Nga ana tjetër, i gjendur në një situatë të tillë, krejtësisht të jashtëzakonshme, edhe për një diplomat që do të mund të kishte karrierë më shumë vite nga sa kishte vite jete Thaçi, ishte një gjë e vështirë. Duhej të zgjidhte në pak ditë, përmes një presioni të jashtëzakonshëm, një rrugë për të ardhmen e vendit të vet, kur deri atëherë nuk na ishte dhënë asnjë rrugë tjetër, veç nënshtrimit. Në atë periudhë ai ka pasur edhe presion nga drejtues të zonave, si nga drejtuesi i zonës operative të Llapit,*

komandant Remi apo nga familjet e njohura të dëshmorëve të luftës. Por, nuk besoj se është trandur nga kërcënimet e Remit. Disa herë, gjatë kohës kur ishte në Konferencë, ndërsa bisedonim për të ditur shkakun e ndryshimit mes mendimit të tij dhe të tjerëve, ai ishte i bindur se, për momentin ndërkombëtarët po kërkojnë qetësimin e gjendjes, ndërsa ai donte zgjidhjen e çështjes. Besoj se ky ka qenë ndryshimi dhe këtu qëndronte shkaku i dyshimit dhe hezitimit të tij.

Por njeriun misterioz, ose si i thua ti, "mikun personal" e kam takuar edhe unë, por për këtë le të flasim ndoshta më pas. Ndërkohë, vazhdo me rrëfimin tënd dhe më ndjej për ndërhyrjen. Mendova se ishte më e arsyeshme në se jepej edhe mendimi im.

(B.I.: / Vazhdim i përgjigjes:) - Gjithsesi e çmoj ndërhyrjen, aq më tepër kur sjell informata dhe opinione. Unë tregova çfarë kishte ndodhur dhe çfarë dyshoja, tjetër është nëse kisha ose nuk kisha të drejtë. Të vazhdoj ku e lashë.

Me të njëjtin 'shok personal' të Thaçit bisedova në Hotelin "Maritim", në Këln, kur po mbahej Samiti Botëror për Kosovën. Para se të vinte Hashimi në Këln telefonova në atë Hotel për t'i rezervuar një dhomë. Më thanë se është i rezervuar nga Qeveria gjermane për delegacionet shtetërore që do të marrin pjesë në Samit. M'u tek t'i them: "Prandaj ju telefonova, për të rezervuar dhomën për kryeministrin shqiptar." Pas pak sekondash folësi në anën tjetër të telefonit më tregoi numrin e dhomës së rezervuar. Hashimi erdhi në Aeroport të Këln/Bonit. Dolëm ta prisnim. Pas ca vështirësive të vogla në aeroport, udhëtuam drejt Hotelit. Me Hashimin ishte Bilall Sherifi. Depërtuam rrethimin policor të Hotelit, me sqarimin se ishte kryeministri shqiptar dhe se e ka të rezervuar dhomën në atë Hotel.

Hashimi dhe Bilalli u ngjitën në dhomë për të lënë valixhet, unë po prisja te holli. Duke qenë aty m'u afrua një Zotëri dhe më përshëndeti me një gjermanishte, në të cilën dallohej aksenti francez: "Mirëdita, Zotëri Kelmendi. Jam shok i Hashim Thaçit...". U ulëm dhe derisa prisnim po bisedonim. E pyeta, që kur ishte shok me Hashimin dhe ku ishin takuar për herë të parë. Më tha se e kishte takuar në kursin e gjermanishtes në Cyrih, ku e kishte dërguar Shtabi i ushtrisë së tij për të mësuar gjermanishten. Me atë rast ma zgjati kartëvizitën. E pyeta paksa me nëntekst: "Nuk kishte Shtabi Juaj një kurs të gjuhës gjermane në Paris, ose në Gjermani, diku më afër se sa në Cyrih? Përse pikërisht në Cyrih, ku qytetarët nuk e flasin gjermanishten standarde?" Pyetja ia thartoi ca paraqitjen e fytyrës dhe zuri të arsyetohej se në Cyrih ai kishte pasur dëshirë të mësonte gjermanishten, se ishte koincidencë që aty e njohu dhe u shoqërua me Hashimin. Sikur e kuptoi se mua nuk më bindi, sepse e kisha të vështirë të besoja se duhej të ishte koincidencë njohja e shoqërimi i tyre, sepse oficerët e asaj kategorie nuk mund të shoqërohen rastësisht. Hashimi dhe Bilalli zbritën. Na gjetën te holli duke biseduar. Unë ende po e mbaja në dorë kartëvizitën e 'shokut personal'. M'u duk sikur Hashimit nuk i erdhi mirë që kishim pas rast të njiheshim dhe e kisha tashmë kartëvizitën e tij. Edhe Hashimi zuri të rrëfente për koincidencën e njohjes në kursin e gjuhës gjermane në Cyrih. I thashë, nuk ka nevojë të rrëfente, sepse shumë më parë më kishte informuar Rexha (Rexhep Halimi).

Disa muaj pas Çlirimit të Kosovës, në Hotelin Grand në Prishtinë, më rastisi të asistoja në një fjalosje të rreptë midis Bardhylit dhe 'shokut personal' të Hashimit. Ndërhyra që Bardhyli të përmbahej, me arsyetim se miku nuk sulmohet në shtëpi. "Mos më ndërhyj, ky nuk është mik, por një spiun i

fëlliqur proserb...” - më foli Bardhyli.

(B.I.: / Ndërhyrje:) *Këtë “Mik” e kam njohur edhe unë, e kam takuar në dy rrethana të ndryshme nga njëra-tjetra. Herën e parë, sapo kishte përfunduar Mbledhja e Jashtëzakonshme e Lëvizjes në Prizren dhe ishte marrë vendimi për shndërrimin e saj në parti politike. Së bashku me Hashimin dolëm në rrugët e Prizrenit dhe ishte një natë e jashtëzakonshme, që nuk më shqitet kurrë nga mendja. Prizreni e priti Hashimin si njeriun më të dashur, gati sa nuk e mbanin në krahë, pasi ishte personifikimi i njeriut që kishte drejtuar luftën dhe kryeministri i qeverisë së përkohshme. Tjetri, rivali i tij, Rugova, i kishte braktisur dhe ndodhej larg Kosovës, në një vend të fshehtë, i rehatuar në një vilë italiane. Në mes të parit, që vinte nga lufta, dhe tjetrit, që kishte qenë në një takim me Milosheviqin, njerëzit natyrshëm kishin zgjedhur të parin.*

Pasi u larguam nga njerëzit, dolëm në anën tjetër të lumit dhe shkuam në një lokal për të pirë një kafe dhe për të biseduar për ndodhitë që ishin kaluar ose që do të vinin. Tamam në këtë kohë, në lokal ishim vetëm ne të dy, hyri edhe “miku personal”, si i thua ti. Hashimi na njoftoi. Ai më tha shkurt se kishte dëgjuar për mua, pastaj mori lejen të largohej. Më shumë se sa drejtuesi i Hashimit, ai dukej si truproja e tij, pasi kishte gjithnjë drojën përse kishte ardhur aty.

Herën tjetër e takuam pas disa kohësh, në një drekë, ku shkuam së bashku me Thaçin dhe Arben Xhaferin. Me këtë të fundit po rrija për herë të parë. Më bëri përshtypje humori i tij, tepër i zgjuar, me ndjenjën se tashmë ndaj Rugovës duhej luftuar jo me pamjen tradicionale, por me bjerrjen e personalitetit të tij përmes humorit. Në lokalin ku shkuam, diku në kodrat rreth Prishtinës, gjetëm edhe “mikun”. U afrua shpejt, i tha Thaçit se nuk e kishte ditur se do të shkonim edhe ne aty,

u largua, e përsëri më krijoi mendimin se ai e kishte gjithnjë drojën nëse ishte në vendin e duhur ose jo.

(I.K.: / Vazhdim i përgjigjes:) - Meqë po flisja për Samitin e Këlnit, i cili u mbajt në qershorit e vitit 1999, nuk po kursej të tregoi edhe për një ndodhi. Ditën e dytë të Samitit, Zotëri Hashim Thaqi, tashmë kryeministër i qeverisë se përkohshme, kishte takim me kryeministrin anglez, Toni Bler. Mundësia e vetme të shkonim në takim, nga hoteli "Maritim" deri në restorantin ku do të takoheshin me Blerin, ishte vetëm në këmbë, sepse policia, për shkaqe sigurie, kishte bllokuar të gjitha rrugët dhe hotelet. Meqë po merakosesha për sigurinë e kryeministrit Thaçi, shkova për të pyetur në qendrën për koordinimin e sigurisë së Samitit, që ndodhej në hotelin përballë stacionit të trenit. Sapo hyra aty dhe u prezantova, akoma pa bërë pyetjen për sigurimin e kryeministrit Thaçi, më komunikuan arrestimin derisa të mbaronte Samiti. Arsyetimi: e kisha futur ilegalisht Zotëri Thaçin në hotelin "Maritim", ku ishin të vendosur kancelari Shröder dhe shumë kryeministra të tjerë. U thirra në miqësinë dhe konsultimin që kisha pasur me ministrin e jashtëm, Joshka Fisher. Pas rreth një orë më liruan.

Tani po rikthehem të Konferenca e Ramubujesë.

Dy ditët e fundit të saj, dita e 16-të dhe 17-të, ishin përballje me një presion që nuk mund të përshkruhet. Shumë personalitete qeveritare amerikane, angleze, gjermane, etj., po bënin presion vetëm mbi Hashim Thaçin që të nënshkruante marrëveshjen. Tashmë, edhe ne të Lëvizjes, ishim pro nënshkrimit, meqë në marrëveshje u miratuan faza kalimtare 3-vjeçare dhe referendumi i popullit të Kosovës për pavarësi, i cili do ta përmbyllte pushtimin serb. Pos kësaj, të gjitha personalitetet po na bindnin se delegacioni serb nuk do të firmoste, prandaj

fajtor i vetëm do të mbetej Serbia.

Ishin pothuajse vetëm tre personalitete shqiptare që po kundërshtonin nënshkrimin: Adem Demaçi, i cili kishte qenë prej fillimit kundër mbajtjes së asaj Konference; kryetari i PD-së Sali Berisha, dhe, siç po vetëkuptohet, kundërshtuesi vendimtar, Hashim Thaçi. Kishim informata se të gjithë anëtarët e Delegacionit tonë ishin pro nënshkrimit.

Brenda në Kështjellë Sabri Kiçmari kishte përcjellë garancitë tona, se asnjë shtab i zonave operative nuk do t'i kërkonte Hashimit llogari personale nëse do të nënshkruante, meqë ato kishin besimin se përfaqësuesit ishin edhe përfaqësuesit e tyre politikë dhe do të respektonin vendimet e tyre. Vërtet, nuk po kuptoja, përse këmbëngulte Hashimi dhe përse po pyetej tashmë një njeri i vetëm, qoftë ai edhe kryesues i Delegacionit. Po mendoja, ai tashmë, me atë qëndrim nuk kishte të drejtë morale, por as juridike. Dyshimi po më thellohej: Gjithnjë e më tepër kisha drojën se mos qëndrimi i tij ishte i diktuar nga Shërbimi Inteligjent i Ushtrisë franceze, mikes më të angazhuar pro Serbisë, dhe Hashimi po detyrohej ta zbatonte, nga se aty e kishte 'mikun personal', që mund ta kishte kërcënuar: "po firmose, nuk del i gjallë nga Kështjella".

(B.I.: / Ndërhyrje:) *Ti, Ibrahim, nganjëherë më dukesh se shkon deri në ekstremin e mendimit dyshues. Së pari, nuk ishte e lehtë të shantazhoje një njeri brenda Kështjellës, e aq më tepër një figurë politike që ishte vënë në qendër të gjithçkaje. Të dyshosh, nuk do të thotë se bën gabim, por kur dyshimi kthehet në vijën e mendimit, atëherë mund të dalësh edhe në konkluzione të gabuara. Vërtet Hashimi ishte në Konferencë një njeri i vetëm, qoftë edhe si kryesues i Delegacionit, por këtë e dinin edhe të tjerët, përfaqësuesit më zëmëdhenj të di-*

plomacisë perëndimore. Edhe ata mund t'i thoshin: "shkoni në djall, ne kemi miratimin e gjithë të tjerëve, ju po të doni, firmosni, po të doni, mos firmosni". Edhe ata e kishin një shkak që e bënin këtë, e dinin se pas këtij njeriu ishte një forcë autoriteti, që, duam apo nuk duam, ai e kishte vendosur. Më pas, kam krijuar bindjen se, edhe ata, që kërkonin, qoftë përmes lutjeve, qoftë përmes presionit, që ai të nënshkruante, nuk ishin të bindur se do e mbanin fjalën e dhënë, ashtu si edhe nuk e mbajtën, as për periudhën kalimtare tre vjeçare, sepse u bënë 13 vite e jemi ende gjysmë shtet i pavarur e gjysmë i kontrolluar, dhe as për referendumin. Pra, për askënd nuk ka qenë një gjë e lehtë, e kalueshme vetëm me një nënshkrim dhe "hajt, na qoftë dita e mbarë"!

(I.K.: / Vazhdim i përgjigjes:) - Më lejoni ta përmbyll mendimin tim, edhe nëse nuk jeni dakord me të. Unë mendoj se jam në të drejtën time, të sjell faktet si i kam parë, kuptuar, përjetuar dhe si i kam menduar atëherë. Edhe mund t'i zbukuroj sot, por kjo nuk është në natyrën time dhe mos pritni që t'i ndryshoj ato që kam menduar atëherë e disa prej të cilave i kam përjetuar me dhimbje, me shpresë dhe me padurim. Ja një shembull prej tyre: Në përmbyllje të Konferencës, me arsyetimin se do të mbahej pjesa e dytë, meqë Hashimi kishte kërkuar të konsultohej me strukturat komanduese të UÇK-së, zëdhënësi amerikan Rubin u paraqit para qindra gazetarëve, për të arsyetuar ndërprerjen e Konferencës. Isha ulur në tokë rreth dy metra para tij, për të mos penguar gjithë ato kamera që iu kishin drejtuar. Atë njeri, të qetë e stoik, si ishim mësuar ta shohim, gjithnjë në mbrojtje të Kosovës, gati sa nuk e mbërtheu vaji, sepse dështimi i Konferencës, po vetëkuptohej, ishte dështim i Qeverisë amerikane. Nga keqardhja për të dhe për

Kosovën, pashë se padashur po më rridhnin lotët.

I skllavëruar nga dyshimet e përhershme, për të mos thënë ankthi, që nga fillimi i jetës sime politike, se shërbimet serbe ishin në gjendje për të bërë çfarë të donin dhe kur e ku të donin, - pra: për të pozicionuar spiunin e saj, Xhevat Ramabajen, siç dyshoja, qysh në tubimin themelues të Frontit të Kuq Popullor; për t'i vrarë bashkëveprimtarët e shokët Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka e Bardhosh Gërvalla; për të infiltruar oficerin dhe spiunët e saj si komplotist kundër Lëvizjes, Abdullah Prapashticën, Sabri Novosellën apo edhe Xhafer Shatrin, etj., etj.; për të më fajësuar e terrorizuar mua përmes luftës speciale si vrasës i bashkëveprimtarëve e shokëve të ngushtë; për të goditur Organizatën brenda vendit sa herë që ajo merrte ringritjen e saj, - tashmë, rrjedhimisht dyshoja se mos Hashimi, me mosnënshkrimin e tij kryeneç, kishte rënë viktimë e ndonjë loje të ndërtuar mirë në prapaskenat politike. Çuditesha, përse të tjerët nuk vepronin, përse heshtnin, kur për më tepër i kisha dhënë një sinjal, pra, pistën për lejimin apo moslejimin nga 'shoku personal', që Hashimi të nënshkruante, ia kisha treguar Joshka Fisherit, edhe pse e dija se për ndërhyrje të atij niveli duhej më shumë kohë.

Nuk besoj se do të mund të kisha duruar një goditje të tillë, nëse ajo do të rezultonte e vërtetë.

Mbase lexuesit do të më mirëkuptojnë: Çlirimi i Kosovës nuk më kishte gëzuar vetëm siç kishte gëzuar shumicën e qytetarëve, por me kishte çliruar edhe mua si qenie nga dyshimet terrorizuese që i kisha vuajtur më shumë se dy dekada, se shërbimet serbe ishin të gjithëpranishme kurdo e kudo. Megjithëse ishin munduar ta mbanin Kosovën pronë të tyren, e për këtë s'kishin kursyer vrasjet, burgimet, mashtrimet, luftën e

fshehtë, njerëzit e saj, përsëri kishin dështuar.

Çlirimi tjetër tejet relaksues nga dyshimi për 'shokun personal', i cili, edhe po të ishte vërtet vetëm shok, nuk kishte përse t'i rrinte vazhdimisht pranë Hashimit, qe ardhja në krye të Francës e Presidentit Sarkozi (kushëri jo fortë të largët i Gjeraldinës, bashkëshortes së Ahmet Zogut dhe kushëri i Artistes së Popullit, Tinka Kurti), i cili, politikën e Francës e ktheu për 180 shkallë, sa i përket miqësisë tradicionale të Francës me Serbinë, sikundër e ndryshoi edhe armiqësinë e Francës ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Tashmë nuk po frikësohesha nga 'shokut personal', të cilin, aty e tutje, më nuk ma zuri syri në Kosovë. U zhduk edhe ai, në hijen e një dyshimi, që ende nuk më është shqitur krejtësisht, për një sprovë të dështuar që bënë miqtë tradicionalë serbë, e që, po të kishte suksesin e saj, do të ishte e përgjakshme dhe tragjike për fatet e populli tonë.

Pas Rambujeja dhe fillimi i fundit të luftës

(B.I.:) *- Pas Rambujesë do të jetë një ngjarje tjetër e rëndësishme: Vendimi për sulmet ajrore të forcave serbe në territorin e Kosovës, por edhe të objekteve të rëndësisë së veçantë në Serbi. Ky është edhe momenti kur intensifikohen takimet dhe kontaktet mes përfaqësuesve të Lëvizjes dhe të UÇK-së me diplomacinë botërore. Cili ishte vendi dhe roli yt, si e përjetuat momentin e parë të fillimit të bombardimeve?*

(I.K.:) - Isha anëtar Kryesie i LPK-së, Dega jashtë vendi, Ju ishit Kryetar, Jashar Salihu dhe Bardhyl Mahmuti (Berisha) nënkryetarë. Anëtarë ishin Ali Ahmeti, Agush Buja dhe Sejdi Gega. Urdhri për sulmim e NATO-s, më 24 Mars, nuk më be-

fasoi, sepse u besoja premtimeve që kishin dhënë shumë personalitete qeveritare botërore. Por, më befasoi ai që e publikoi urdhrin, Sekretari gjeneral i NATO-s, Zotëri Havier Solana. Atij po ia lexoja torturën në fytyrë derisa po e shpallte fillimin e bombardimeve, si proserb i thekur që ishte. Ai, si spanjoll, vazhdonte të ishte i skllavëruar nga ambicia për të mbajtur të pushtuar Baskinë e Kataloninë, njësoj siç ishin nacionalistët serbë të skllavëruar me bindjen dhe përcaktimin se Kosova u takonte atyre dhe vetëm atyre. E mbaja mend atë fytyrë të shpifur nga një demonstratë maskaradë para Selisë së BE-së në Bruksel, ku ai vetë ishte i angazhuar si "Ministër i jashtëm" i BE-së. Kishte dalë me rreth 30 nëpunës të lartë spanjollë që ishin të angazhuar në BE për të protestuar kundër akteve terroriste të ETA-s. Vërtet me që dukur i shpifur atëherë, kur po mbante një pllakat në dorë, njësoj sikur kur demonstronin pushtuesit serbë kundër padrejtësive që, sipas tyre, u bënin shqiptarët që ata vetë i kishin pushtuar, përzënë e nëpërkëmbur. Prirje e çoroditur për pozë viktimizimi, e denjë për psikanaliza frojdiane. Dhe atë maskaradë të shpifur e pashë në një ditë të pazakontë, kur ne sapo kishim mbaruar demonstratën tonë, në të cilën morëm pjesë mijëra veta.

Sa u përket personaliteteve të huaja, nuk më dukej gjithaq e nevojshme t'i takoja, nuk ishte më as koha ngaqë kishte nisur fillimi i zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Aleanca më e fuqishme ushtarake e botës ishte në veprim. Më me rëndësi e quaja, të plasonim sa më shumë informata për gjenocidin fashistoid serb dhe për eksodin biblik të popullsisë sonë. Edhe ministrat e mbrojtjes të shteteve kryesore të NATO-s, që po bombardonin pikat ushtarake të Serbisë, kishin rënë në hall për më shumë informata për ndodhitë në Kosovë, sepse një pjesë e madhe e medieve Perëndimore po i kundërshtonin bombardimet si të

padrejta. Dhe ato media arsyetonin me të Drejtën ndërkombëtare, që garantonte sovranitetin e shteteve. Pastaj, me pjesën tjetër të kohës dhe energjisë duhej të angazhoheshim që të mblidhnim sa më shumë ndihma financiare, për të armatosur sa më shumë zonat operative, sepse tashmë serbët do të mobilizoheshin më të gjitha forcat për t'u hakmarrë kundra UÇK-së dhe sidomos kundër popullatës duarthatë, si shkakun kryesor që kishte sjellë një gjendje të tillë deri te vendimi historik i NATO-s, i pari i këtij lloji në historinë e saj. Sigurisht që na duhej të ndihmonim edhe refugjatët e mjerë. E gjithë Kryesia dhe Organizata ishim në gjendje mobilizuese, sepse kishim aq shumë gjera për të menaxhuar e koordinuar.

Fatkeqësisht ndodhi takimi i "presidentit" Ibrahim Rugova me kriminelin Sllobodan Milosheviq. Takimin e emetuan si top-temë të gjitha televizionet e botës. Milosheviqi dhe Rugova tashmë po merreshin vesh mes tyre për të gjetur zgjidhje "paqësore", thoshin komentatorët antiamerikanë, proserbë, pacifistë. Akoma më antishqiptar ishte apeli i Ibrahim Rugovës nga ai takim, që NATO-ja t'i ndërpriste bombardimet. Takimi i tyre çoi në mbledhjen urgjente të Këshillit të NATO-s. Ambasadori francez kërkoi në mënyrë ultimative që NATO-ja t'i ndërpriste bombardimet, me arsyetimin se Milosheviqi dhe Rugova po gjenin zgjidhje paqësore. Atyre u shkuan pas diplomatët italianë, të cilët kishin qenë që nga fillimi kundër një zgjidhje të drejtë e përfundimtare. Sipas Rregullores së NATO-s, mjaftonte vetëm një anëtar që të ndryshohej vendimi paraprak, që do të thoshte, të ndërpriteshin bombardimi. Gjenerali Klark, po Gjenerali Klark, Gjergj Kastrioti i atyre ditëve, ia preu ambasadorit francez: "Bombardimet do të vazhdojnë, sepse presidenti Rugova është detyruar të takohet me presidentin Milosheviq dhe të bëjë atë apel. Vetëm kur do

të flasë në liri, do t'i besojmë".

Rreziku i parë serioz kapërceu, fal vendosmërisë së Gjeneralit Klark, por se cilin rrezik tjetër të radhës do ta inskenonte Beogradi fashist, nuk e parashikoje dot.

Prof. Fehmi Agani e pagoi me jetë refuzimin e komplotit Milosheviq-Rugova, meqë refuzoi të krijonte "qeverinë kalimtare", më saktësisht kuislingë, të Kosovës.

Milosheviqi i telefonon mikut të tij, ministrit të jashtëm të Italisë, të dërgonte enkas aeroplan, që ta transportonte Rugovën nga Beogradi në Romë, sepse ai ishte i sigurt se Rugova edhe në Romë do ta përsëriste apelin – NATO-ja t'i ndërpriste bombardimet. Proserbin, Monsinjor Pale të Shën Egjidios Milosheviqi e urdhëron ta presë Rugovën në Aeroportin e Romës, ta strehojë dhe të kujdesej për të. Ministri italian dërgoi aeroplanin.

Shumë nga shqiptarët e mjerë e fatkeq të Kosovës, të tjetërsuar e të shpërfytyruar gjatë sundimit të Rugovës, po vazhdonin t'i besonin ende atij dhe po e mallkonin UÇK-në.

Aeroplani ateron në Romë. Zbret mumia politike Rugova, kryekuislingu shqipfolës i Milosheviqit. U drejtohet të pranishmëve me apelin për ndërprerjen e bombardimeve. Shpifaraku, po mendonte se po u fliste gazetarëve. Por ishin njerëz të shërbimeve. Ata ishin një hap para Palës së Shën e Exhidios proserbe. E fusin Rugovën në makinë, e transportojnë, e izolojnë, fare e izolojnë, në një vilë qeveritare gjermane në Bon. Aty ai fillon të ulërin ta linin të lirë, të shkonte në Romë, të Shën Exhidio. Kot po ulërinte. Sikur ulërima e tij po përmbante gjithë dhimbjen e tij të madhe për Serbinë. Sorollatej nëpër vilë si i çmendur, kërkonte gazetarë. Kot sorollatej, vendimi ishte marrë, të mbahej i izoluar derisa të dorëzohej Serbia. Fatmirësisht edhe ai rrezik kapërceu në interes të shqiptarëve fal

përkushtimit dhe shkathtësisë gjermane.

Për këto rrjedha po informohesha, sepse dikush nga shqiptarët duhej të dinte, çfarë dobiçi u kishte rënë hise dhe ata, megjithatë, po e çmonin si profet të tyre, siç me thoshte miku gjerman kur përshkruante Rugovën e atyre ditëve. Edhe në atë situatë më fluturonte kujtesa të informatat e Zotëri Idriz Zeqirajt (nga Studenica e Istogut), i arratisur në Shqipëri. Ai po më thoshte, në fillim të vitit 1991 në Tiranë, se e kishte spiunuar Ibrahim Rugova, prandaj ishte detyruar të arratisej në Shqipëri, për të vuajtur pastaj atje. Thoshte se e kishte pasur shokë shkolle, në gjimnazin e Istogut dhe që atëherë Ibrahimin e kishte rekrutuar UDB-ja, si shumicën e anëtarëve të familjes së tij. Pastaj e kishte pasur koleg pune e megjithatë, thoshte Idrizi, Ibrahimi e kishte spiunuar. Provonte të më bindte ta urreja edhe unë, sa e si e urrente ai. Dhe do ti, pas dy-tre vjetëve, Idrizi emigron në Gjermani, te vëllai i tij në Ludwigshafen. Papritmas transformohet, tjetërsohet, shpërfytyrohet në përkrahës e ithtar të Rugovës. Ai e arsyetonte transformimin e tij me adhurimin e popullit për të, dëgjueshmërinë e popullit ndaj tij. Besoj, nuk do koment fakti, kur intelektuali tjetërsohet për t'u bërë pjesë e turmës tru-shpërlarë, ose turmës pa tru – siç thoshte dikur Noli ynë i madh.

(B.I.:) *– Idriz Zeqiraj është një mik i imi i vjetër, megjithëse prej viteve nuk shihemi me njëri tjetrin.Gjithnjë ka gëzuar respektin e mirëbesimin tim, ashtu, si besoj, edhe unë besimin e tij. Ndryshimi i tij mund të ketë ndodhur për shumë faktorë,. Por nuk kanë të bëjnë me karakterin e tij.Ai është njeri i fortë nga karakteri, por, si e di fare mirë, ai beson lehtësisht.Por le ta lëmë atë në rrugën e tij, mendimi im për të si njeri i fjalës së dhënë, nuk ka ndryshuar.*

Fillon ofensive e fundit serbe në Kosovë dhe dëbimi masiv i njerëzve. Ndërkohë nga Perëndimi po shkojnë me mijëra vullnetarë shqiptarë për të qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Rekrutimin dhe bartjen e bën Lëvizja dhe kjo ka qenë një sipërmarrje e madhe.

Pra janë dy momente: njerëzit në Kosovë po dëbohen nga vendi i tyre, të rinjtë në perëndim po e lënë atë për të shkuar në luftë. Disa prej tyre do të vriten në luftime.

Cili ishte konkretisht roli i Lëvizjes, së pari, në zbutjen e dhimbjeve të njerëzve që po dëbohen dhe ndihmesën e tyre, dhe së dyti, në mobilizimin e të rinjve për në luftë?

(I.K.:) - Po si, vërtet po ndodhnin dy lëvizje të mëdha të shqiptarëve, por me kahe të kundërta. Fatkeqësisht qindra mijë qytetarë iknin nga lufta, mijëra shkonin vullnetarisht në luftë. Lëvizja nuk kishte potencial për t'i rekrutuar e transportuar mijëra të rinj nga Evropa Perëndimore që paraqiteshin vullnetarë. Përditë angazhonim autobusë, furgonë, makina. Nuk mjaftonin. Na hidhëroheshin ata që u duhej të prisnin radhën.

Lëvizja nuk kishte potencial financiar, njerëzor dhe kohë, për të ndihmuar turmat në eksod. Po më vinte keq që as financat e 3-përqindëshit, të përvetësuara nga kriminelët Bujar Bukoshi dhe Isa Mustafa, nuk po u shkonin as për ndihmë emergjente atyre fatkëqijve të mjerë. Me vjen keq, për kriminelë i dija në atë kohë dhe në ato rrethana tragjike.

Sapo kisha dëgjuar nga një funksionar i lartë i ministrisë së jashtme gjermane një informatë të kobshme, ndoshta edhe të turpshme. Kishin ardhur nga Kosova në Bon gazetari Migjen Kelmendi dhe disa të tjerë. Në restorantin afër Zyrës së Fondit u shtrova darkë. Thirra dhe funksionarin e lartë qeveritar gjerman që t'i takonte dhe të informohej prej tyre për

gjendjen në Kosovë. Ndenjëm gjatë. Gjermani piu goxha. Në një moment m'u drejtua: "Përse po na shkaktoni vështirësi politike me grumbullimin e ndihmave financiare për UÇK-në, harxhoni një herë ato që keni." "Nuk kemi" - ia ktheva. "I keni qindra milionë marka të Fondit të 3-përqindëshit". "Ato i kanë bllokuar Bukoshi e Mustafa, nuk po i japin as për ndihma emergjente humanitare," - e informova. Sikur u rrëqeth kur më dëgjoi dhe foli në gjendje prej të hidhëruari: "Uroj të mos dalin të vërteta ca informata që kemi siguruar këto ditë. Bukoshi duhet t'i ketë dërguar para ca ditëve 500 milionë marka në Beograd. Jemi duke i verifikuar këto informata. Të lutëm, mos ua përkthe tani për tani kolegëve gazetarë këto informata, derisa t'i kemi verifikuar." Pastaj ai iu drejtua Migjenit në anglisht, për të ndërruar temën.

(B.I.:) *- Si ndodhi kthimi yt në Kosovën e pasluftës. Ti po ktheheshe pas më shumë se dy dekadave? Ishe larguar nga vendi yt, por jo i huaj për të; kishe kontribuar me atë që kishe mundur për shumë vite, tani po ktheheshe, në një vend të djegur, por të lirë.*

(I.K:) - Fillimi i kthimit ishte një aventurë fatkeqe. Sapo u çlirua Kosova, bashkë me Naser Idrizin (e Vushtrrisë) rezervuam biletat e fluturimit nga aeroporti i Hamburgut për në Tiranë, me kompaninë hungareze *Malev*. U nisa me makinë nga banesa në Këln rreth orës 03.30 të mëngjesit me bashkëveprimtarin Veton Jashari (nga Mitrovica), sepse fluturimi ishte në ora 08.00. Bashkëshortja më porositi t'i telefonoja në orën 06.00, për ta zgjuar që të shkonte në punë në "Dojçe Vele" (Deutsche Welle). Kur i telefonova më doli një zë burri gjerman. I kërkova falje, me mendimin se i kisha rënë gabim numrit të telefonit. Ai menjëherë më pyeti nëse isha unë. Iu përgjigja se isha Ibrahim Kelmendi, duke shprehur habinë se kush ishte ai

zë burri gjerman, në atë kohë, në banesën time. Më sqaroi dhe tha të kthehesha, sepse policia po ma bastiste banesën. I thashë, nuk do të kthehem, sepse që 23 vite kisha pritur këtë ditë, të kthimit në Kosovën e çliruar. Ai më tha të kthehesha, meqë kishin dhënë urdhër të mos mund të dilja jashtë Gjermanisë. Do ta provoj, i thashë dhe ia mbylla telefonin. Në aeroport takova Naserin. I tregova çfarë më kishte ndodhur. E luta të shkonte te sporteli i *Malevit* dhe unë do ta vështroja nga distanca e mjaftueshme, për të mos u rënë në sy ndjekësve. Sapo ai u paraqit në sportel, dy individ, të veshur civil e mbajtën. Pas pak më telefonuan përsëri policët që po bastisnin banesën. Sërish më thanë të kthehesha, nga se tani duhet të isha bindur se nuk mund të fluturoja. I thashë, meqë po ma bëni këtë padrejtësi, po udhëtoj për në Danimarkë. Atje jam në bisedime me një fabrikë të vajit ushqimor, për të blerë vaj që ta shpërndajmë në Kosovë si ndihmë humanitare dhe, prej atje, do të fluturoj drejt Kosovës. Sërish më tha, nuk shkon dot, sepse kemi lëshuar urdhrin për hetime. I thashë, nuk e kontrolloni dot gjithë kufirin tokësor me Danimarkën dhe ia mbylla telefonin. Hoqa baterinë nga telefoni. I thashë Vetonit të më dërgonte në stacionin e trenit të Hamburgut, pasi dua të provoj të largohem me tren. Isha i stërvitur për t'iu shmang kontrolleve kufitare kur hyja ilegalisht me trena në Zvicër. Ia dola. Nga Zvicra, me tren udhëtova deri në Bari dhe prej atje me traget për në Durrës. Nga Zvicra telefonova në Gjermani dhe më informuan se rreth 400 banesa, kryesisht të veprimtarëve të Fondit, i kishte bastisur policia gjermane, njëkohësisht, në gjithë Gjermaninë.

Pas dy vitesh, kërkova ndihmën e mikut Erhard Epller, - ideologut të plejadës së vjetër më me ndikim në SPD, qeveritarit shumëvjeçar, tashmë i pensionuar, por i angazhuar si këshilltar i Kancelarit Schröder, - që të pushojnë hetimet kun-

dër meje. Ai bisedoi me ministren federale për drejtësi. Ajo i kërkon prokurorisë kompetente që të mos i zvarriste më gjatë hetimet, o të ngrinte padinë, ose ta mbyllte lëndën. Fatmirësisht, por me të drejtë, pasoi mbyllja e hetimeve.

Në Tiranë, në zyrat e Fondit, iu bashkova Grupit të punës për organizimin e Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Lëvizjes. Vendosem t'i propozojmë Mbledhjes që Lëvizja të përfundojë veprimtarinë e saj dhe të "mbyllte" Organizatën, pas më shumë se 17 viteve veprimtari.

Me shumë bashkëveprimtarë udhëtuam drejtë Kosovës. Hyrjen në Kosovë e përjetova si gëzim, por të përmbajtur, pasi më kishte përfshirë meraku - çfarë pas çlirimit? Po më binte ndërmend proverbi filozofik i popullit: "Lirinë është më vështirë ta mbash, se sa ta fitosh!"

XV. Mbledhja e fundit e Përgjithshme e LPK-së / Prizren, qytet i lirë, qershor 1999

(B.I.: / Ndërhyrje:) *Vendimi për mbajtjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të Lëvizjes, në Prizren, është marrë në Mbledhjen e fundit të Këshillit të Përgjithshëm, mbajtur në Bazel, në ditët e fundit të luftës. Menjëherë, pas këtij vendimi, si drejtues i Organizatës, u jam drejtuar me një letër gjithë këshillave në Perëndim, për të tërhequr mendimin e tyre, pra për të konkretizuar ose jo idenë e mbështetur nga Këshilli i Përgjithshëm, për shndërrimin e Lëvizjes në një parti politike. Thuajse të gjitha ishin dakord, por kishte edhe përjashtime, edhe mendime ndryshe. Disa mendonin se ishte koha për të qenë Lëvizja një organizatë politike legale, kur për më tepër disa nga shokët tanë ishin pjesë e qeverisë së përkohshme, disa të tjerë mendonin se duke qenë parti ajo do e kishte të vështirë të angazhohej për shqiptarët që ishin jashtë Kosovës administrative, e të tjerë, shkonin edhe më larg, duke arsyetuar se Lëvizja ende nuk e kishte realizuar qëllimin e saj, bashkimin kombëtar. Drejtues të Grupit për Organizimin e Kuvendit, fillimisht u caktuan Ramiz Lladrovci dhe Xhevat Bislimi. Mmë pas, me kërkesën e tij, drejtimin e mori Bardhyl Mahmuti. Në Grupin e Organizimit ishin disa shokë, mes të tjerëve Ali Ahmeti, ti, pastaj Shaban Shala, Halil Selimi, Adnan Asllani e të tjerë.*

(B.I.:) *- Lëvizja do të bëjë, menjëherë pas largimit të trupave ushtarake serbe, aktin e saj të parë politik në Kosovën e çliruar: Mbledhjen e saj të Jashtëzakonshme, që ishte edhe e para e këtij lloji. U mblodhën në Prizren më shumë se 230*

delegatë, u morën vendime të rëndësishme, për shndërrimin e saj në një parti politike legale, e cila, de fakto kishte njerëzit e vet në qeverinë e përkohshme. Cili ishte përjetimi juaj?

(I.K.:) - Po më dhimbsej Lëvizja që po e shpërndanim, sepse isha rritur në gjirin e saj, siç praktikohet të thuhet. Kisha shumë emocione për te. Doemos që edhe ndihesha krenar që kishte dhënë kontribut efektiv për çlirimin e Kosovës, megjithëse, turmat tru shpëlara, të tjetërsuara nga ish-udhëheqësit e Lidhjes Komuniste dhe nga specialistë e UDB-së, nuk po e çmonin. Kjo e fundit po më zhgënjente. Po dëgjoja luftëtarë të shquar, se kishin luftuar në radhët e UÇK-së, duke kamufluar përkatësinë e tyre në Lëvizje, sepse LDK-ja i kishte bindur qytetarët, "Lëvizja ishte organizatë armiqësore".

Atmosfera në Organizatë në prag të mbajtjes së Mbledhjes së Përgjithshme, të Jashtëzakonshme, nuk ishte aspak dashamirëse dhe miqësore. Ndërkohë, në Lëvizje ishin përvijuar dy krahë të ndryshëm: ai i Hashim Thaçit dhe i Bardhyl Mahmutit (Berishës) dhe pjesa më e madhe ishte neutrale, spektatore. Po kultivoheshin kundërshti në mes të dy krahëve.

U trishtova kur mësova se, sapo ju kishit ardhur në Prizren, meqë si drejtues i Lëvizjes do të mbaje raportin kryesor, Bardhyli ju kishte sinjalizuar se nuk duhej të lëvizje i vetëm, jashtë vëmendjes së tij ose të Ramizit, sepse mund të të ndodhte ndonjë ngjarje e rëndë. Për të mos thënë se druhej se do të kishte ndonjë ngjarje të dhimbshme, të cilën nuk po e përmend.

Kishte edhe ca zhvillime të tjera tepër diskredituese për "Krahun e Luftës", sepse disa komandantë nuk po e përballonin dinjitetshëm tundimin e pushtetit dhe të parasë dhe dëlirin e madhështisë. Po sjell tre shembuj karakterizues.

Në Besianë (ish-Podujevë) veprimtarët e Lëvizjes, njëherësh komandantë kryesor të UÇK-së në atë Zonë Operative, kishin thirrur një miting në stadiumin e qytetit. U nisa me ca bash-këveprimtarë. Atje u informova se kishte ndodhur një ekses. Eskortën e kryeministrit të qeverisë së përkohshme, Hashim Thaçit, e kishte ndaluar policia ushtarake e UÇK-së. I kishin thënë kryeministrit Thaçi se mund të vazhdonte udhëtimin vetëm nëse do të kthehej mbrapsht Xhavit Haliti, të cilin ai e kishte me vete, i njohur si anëtar shtabi, meqë atij ia paskëshin shpallur "zonë të ndaluar" Llapin. Kthehet ai, e pastaj vazhdon rrugëtimin eskorta e Hashimit. Stadiumi ishte i mbushur për-plot me qytetarë. E hap mitingun Komandanti i ZO të Llapit, Rrustem Mustafa. Duartrokitje, ovacione, thirrje të fuqishme: UÇK, UÇK, UÇK! Prezantohet dhe flet Komandanti i Shta-bit të Përgjithshëm të UÇK-së, Agim Çeku, sërish të njëjtat duartrokitje, ovacione, thirrje. Merr fjalën kryeministri Thaçi, qytetarët brohorasin: LDK, LDK, LDK! Isha i ulur në rreshtin e parë, mes Agim Çekut e Sabri Kiçmarit. Po shikonim njëri-tjetrin nëse kishim ndonjë shpjegim. Secili ishte më i habitur se tjetri. Ishte një paradoks i jashtëzakonshëm.

Ndodhia e dytë. Po mbahej miting në Skenderaj. Koman-danti i ZO të Drenicës, Sami Lushtaku, urdhëron policinë usht-arake që të ndalonte po Xhavit Halitin. Gjendja tensionohet. Pas shumë ndërhyrjesh, evitohet zbatimi i atij urdhri. Atij i ishte ndaluar të shkonte edhe në Zonën e Drenicës. Ishte deliri i komandantëve të zonave apo problemet që ishin krijuar me vite, kjo nuk ishte e qartë. Po ajo që dukej krejt qartë ishte se mes këtij njeriu dhe zonave të luftës, kishte pasur një shkëputje aq të madhe, saqë ishte krijuar një mëri jashtë së zakonshmes.

Organizohet miting i madh në stadiumin e Prishtinës. Masa

e pranishme gati sa nuk po çirrej me thirrjet UÇK, UÇK, UÇK! Fjalime pas fjalimesh, njësoj ovacionet e brohoritjet. Në tribunë paraqitet njeriu i kudondodhur, skandalozi Milaim Zeka, për të përshëndetur në emër të kryeministrit Hashim Thaçi. Shpërthejnë thirrjet: LDK, LDK, LDK!

Ndoshta do të mund të komentohej se qytetarët e adhuronin UÇK-në, por pa disa nga "shefat" e saj, nëse mund të quheshin kështu dhe që shumë prej tyre, kur bëhej lufta, këta njerëz që kishin luftuar as nuk i kishin dëgjuar e as nuk i njihnin, e tash po mësonin se kishin qenë ata, të panjohurit, që i kishin drejtuar. Nuk kam ditur atëherë, nuk di as sot të komentoj të tilla ndodhi skandaloze.

Kur bëhesh i njohur pranë njerëzve, ata të duan. Ky është fakt. Kur u thua se jo komananti i tyre, por je larg, ata nuk kanë pse të duan.

Një ditë para mbajtjes së Mbledhjes së Përgjithshme, Ali Ahmeti dhe unë, si anëtarë të Grupit organizues të Mbledhjes, shkojmë për t'u konsultuar, tashmë me ushtarakët Emrush Xhemaili dhe Gafurr Elshani, të angazhuar në Shtabin e ZO të Dukagjinit. Ishim informuar se Shtabi i asaj Zone kishte marrë vendim që t'ua ndalonte angazhimin partiak ushtarakëve. Shpresonim të bindnim Komandantin, Ramush Haradinajn, që të bënte një përjashtim për Emrushin dhe Gafurrin. Takojmë Emrushin në Baballoç të Gjakovës, në kompleksin e shtëpive të ndërtuara nga Serbia për ish-refugjatët nga Shqipëria, që deklaroheshin serbë, tani të shndërruar në shtëpi banimi për pjesëtarët e UÇK-së. Ia prezantuam dokumentacionin e përgatitur për Mbledhje. E miratoi. Ai shpresoi se ne do të nxirrnim leje nga Komandanti Haradinaj, për t'i liruar atë dhe Gafurrin që të marrin pjesë në Mbledhje. Sh-

kojmë pastaj në Pejë, në Komandën e ZOD. Gjejmë Ramushin dhe Gafurrin. Bisedojmë me ta. Ramushi nuk jep leje, me arsyetimin se delegatët e Zonës veç ishin caktuar. Edhe pas mbledhjes vizituam ushtarakun Emrush Xhemaili. Ai i përshëndeti vendimet e Mbledhjes.

(B.I.: / Ndërhyrje:) *- Me Emrushin dhe me Gafurr Elshanin, në kohë të ndryshme, jam takuar edhe unë. Ne kemi një grup prej disa vetëve, kjo ndodhi kur ishte marrë vendimi për kalimin e Lëvizjes në parti politike. Me Emrushin folëm më gjatë, i tregova, kur ishim veçmas, se më parë kisha biseduar edhe me Hashimin dhe kishim mendimin se ai, me bagazhin që kishte e duke lënë çfarë kishte ndodhur, duhej të kthehej në politikën aktive dhe të zinte vendin në qeverinë e përkohshme, më dukej se si sekretar shteti.Vend që më pas, në mos qofsha i gabuar, e kishte Ramadan Avdiu. Emrushi ishte dakord, por më pyeti nëse kisha biseduar me "djemtë", çka nënkuptonte Hashimin e Kadri Veselin. I thashë se, po, kishim rënë dakord. Duke ditur lidhjet, afërsitë organizative dhe përkushtimin, ishte menduar që në partinë e re, atij t'i besohej detyra e sekretarit të përgjithshëm. Ndërsa Gafuri na e tha shkurt se jo. Na tha sinqerisht se ai kishte vendosur të ecte në vazhdimin e asaj që kishte ecur deri asaj dite. Ne ishim, më duket katër vetë, së bashku me Sabri Kiçmarin, Halil Selimin dhe Ramiz Lladrovcin. Më fal për ndërhyrjen.*

(I.K.: / Vazhdim i përgjigjes:) - Po afrohej hapja e Mbledhjes në Prizrenin historik, në Pallatin e kulturës. Situata ishte entuziaste, por e tensionuar. Vendimi për të mos lejuar të merrnin pjesë delegatë të armatosur nuk po zbatohej. Dhe nuk ishte e logjikshme të çarmatosje ushtarakë të UÇK-së, të cilët ishin ardhur në uniformë dhe të armatosur. Hapja po vonohej,

sepse po vonohej kryeministrit Thaçi.

Ai erdhi pasi mbledhja kishte disa kohë që kishte filluar, ishte zgjedhur grupi i punës për drejtimin e saj, tamam në kohën kur ju po e lexonit raportin.

Për të mos e zgjatur me përshkrime të detajuara, meqë janë të incizuara nga kamera e Visar Rekës, u propozua "mbyllja" e Lëvizjes dhe nga ajo të formohej parti politike, siç ishte përcaktuar Grupi organizues. Kundërpropozim paraqiti Hashim Thaçi, që Mbledhja të shndërrohej në "mbledhje konsultative". Nuk u pranua. Për propozimin e Grupit organizues votuan 224 veta pro, katër kundra, dy abstenime. U zgjodh Grupi për përgatitjen e formimit të partisë politike, me kryetar Grupi, Bedri Islamin. Ndonjë vendim tjetër Mbledhja nuk duhet të ketë marrë, me sa mbaj mend. Kështu, me vendim legjitim, "mbyllet" Lëvizja. Mua më ngel mbrapa dhimbja krenare për të, krenaria se ishte Organizata patriotike e çlirimtare që pati më së shumti merita për Çlirimin e Kosovës.

Meqë një prononcim imi në atë Mbledhje tingëlloi paksa spektakular, kur refuzova të zgjidhesha në Grupin për përgatitjen e formimin e partisë politike, po e risjell sipas mbamendjes: "...Falënderoj UÇK-në që ma mundësoi të kthehem në Kosovën e çliruar pas 23 viteve në ekzil! Nëse angazhimi dhe kontributi im patriotik e çlirimtar kanë qenë të vyeshme, vlerësoj se kanë qenë të bollshme; nëse kanë qenë të dëmshme, kanë qenë të tepërta. Në parti politike nuk do të angazhohem...". Edhe sot e kësaj dite vërtet nuk jam anëtarësuar në asnjë parti politike në Republikën e Kosovës.

(B.I.:) *- Si e di, në Kuvendin e jashtëzakonshëm, unë kam mbajtur raportin dhe kam qenë drejtues i saj. Ka pasur dy mendime: i pari, që të bëhet një analizë e gjithë problemeve që kis-*

hin ndodhur gjatë viteve; kjo kryesisht nga shokët nga jashtë, dhe, një tjetër, që të ishte Kuvendi i njerëzve që sakrifikuan, por e fituan luftën. Mbaj mend Shaban Shalën e Drenicës të më ketë thënë se, "nëse keni ardhur të hapni sot të gjitha problemet, nuk mendoj se e keni mirë", dhe unë isha i të njëjtit mendim. Në fundin e Mbledhjes, sapo isha propozuar nga Hashim Thaçi për të qenë kryetar i Grupit për shndërrimin e Lëvizjes në parti politike, dhe zgjedhja ime nuk u bë me votim, por me aklamacion. Ti kërkove fjalën. Kisha drojën se do të "rebeloheshe", sepse e kisha këtë përvojë me ty, megjithëse nuk do të rebeloheshe me zgjedhjen time. Të them të drejtën kam menduar se pas fjalës tënde, mund t'ia fillonim edhe një herë nga e para, kur ti fole shkurt e the se për ardhjen tënde në Kosovë, pas më shumë se 23 viteve, falënderon Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, gjakun e bijve të saj. Kaq. Dhe u ule.

Tani, nga distanca e viteve, cili është mendimi yt për ngjarjet përmbyllëse të historisë së Lëvizjes klandestine dhe kthimin e saj në parti politike, mbresat tuaja nga ditët e para në Kosovën e çliruar dhe tashmë të lirë?

(I.K.:) -...sa për saktësim, Lëvizja në Gjermani nuk ka qenë klandestine dhe as ilegale, meqë atje me ligj lejohen organizime edhe të paregjistruara. Mjafton të mbash dokumentacion të rregullt në rast kontrollimi, nëse hetohet ndonjë shpërdorim. Klandestine ishin vetëm angazhimet e saja në Kosovë. Në Zvicër ligjet ishin më të rrepta dhe nuk lejonin organizimin politik të të strehuarve politik. Kurse në shtetet e tjera në Evropën Perëndimore ishin akoma më tolerante.

Përmbyllja e Lëvizjes sonë dhe organizimi i veprimtarëve të saj në parti politike, ishin zgjidhjet më pragmatike për kohën dhe rrethanat, do të thosha.

Mbresat e mia gjatë ditëve të para në Kosovën e sapoçliruar ishin të përziera. Gëzimin dhe krenarinë po ma zvetënonin keqsjelljet e liderëve të vjetër e të rinj politikë dhe, sidomos keqsjelljet e disa komandantëve të UÇK-së dhe paaftësia për të konsoliduar qeverinë e përkohshme dhe për të qeverisur vendin, etj.

Gjithsesi po më habisnin dhe po me brengosnin zelli dhe taktika e kuadrit të vjetër komunist dhe të UDB-së, të inkorporuar në LDK, me fushatën e tyre të orkestruar për të diskreditуar UÇK-në dhe veprimtarët patriotë. Dhe vërtet, çuditërisht, ishin të suksesshëm, meqë kishin përvojë shumëvjeçare. Po shpresoja se të kaluarën e tyre antishqiptare, kriminale, armiqësore, do ta arkivonin, meqë askush nuk po ju kërkonte llogari për krimet e tyre. Megjithatë, fatkeqësisht, nuk shfrytëzuan shansin që të bënin ***katarsis*** (pastrim shpirti) dhe aty e tutje të jetonin shqiptarisht. Mos u pastë hije, as atëherë, as tani! Zoti ua shpagoftë, do të thoshin besimtarët!

(B.I.:) *- Pas Konferencës së jashtëzakonshme ne shkuam së bashku tek familja e Jasharëve dhe pastaj, tek varri i Fehmi Lladrovcit, Xhevës dhe shokëve të tjerë. Si mendon, a e ka mbajtur Lëvizja amanetin e tyre?*

(I.K.:) - Ata nuk i kanë lënë ndonjë amanet konkret Lëvizjes, pavarësisht se në gjuhën e patriotizmit folklorik spekulohet në emër të amaneteve të dëshmorëve e heronjve.

Lëvizja ka bërë maksimumin e mundshëm, në rrethana tepër të vështira, dhe për të ruaj respekt e krenari të përjetshme!

(B.I.:) *- Dhe pyetja e fundit për këtë bashkëbisedim, i cili ka filluar me ndërprerje që disa ditë, si duket ishte koha e përmbylljes së tij:*

Në Kuvendin për shndërrimin e Lëvizjes në partinë e Bashkimit Demokratik, pararendëse e Partisë Demokratike, deklarove se nuk doje të hyje në listën e të zgjedhurve, pasi nuk e dije nëse do të rrije në Kosovë.

Por tani nuk je as në Perëndim, ke një adresë tjetër?

Shkurtimisht, ku është Ibrahim Kelmendi sot?

(I.K.:) - Në atë Kuvend themelues të partisë së re erdha si qytetar vullnetmirë për t'ju ndihmuar, vetëm teknikisht, do të thoja, që të themeloni dhe të organizoni partinë. U angazhova i shtyrë edhe nga shqetësimet që po m'i shkaktonin ndasitë e asaj kohe në mes të krahut të Hashim Thaçit dhe Bardhyl Mahmutit (Berishës). Gjatë gjithë atyre ditëve isha angazhuar në ndërmjetësime, qetësime dhe mirëkuptime, që gjendjet të mos eskalonin më tej.

Në prag të Kuvendit themelues ju po mundoheshit ta bindnit Hashimin që të merrte pjesë. Keni pasur disa takime me të, por si duket nuk ia arritët. Në mos gabohem, ai ju ka pyetur edhe për rolin tim, nëse do të jem në grupin drejtues apo jo, duke thënë dëshirën se do të ishte mirë të isha. Mbaj mend shqetësimin e Jashar Salihut. Në fakt, aty erdhën të gjithë drejtuesit e zonave të luftës, anëtarët e qeverisë së përkohshme, intelektualë të njohur edhe për angazhimin e tyre patriotik dhe ishte një shans i madh që të krijohej një parti e fuqishme, demokratike dhe masive në Kosovën e pasluftës. Si edhe herë të tjera, e keqja, nëse e quaj kështu, na erdhi nga vetja, sepse, problemet që i kishim pasur me vite, nuk i hoqëm bashkë me pushtimin, por i bartëm edhe më tej.

Propozimet, për të qenë në listën e kandidatëve për t'u zgjedhur, i kundërshtova, sepse ashtu isha përcaktuar në Mbledhjen e fundit të Lëvizjes, në Prizren.

Jam gëzuar, kur nga përfundimi i votimit të parë, ju kishit shumë më tepër vota se sa të tjerë konkurentë, por isha dakord me Ju se nuk ishte më koha që një parti në Kosovë të drejtohej nga një qytetar i Shqipërisë, megjithëse nga Shkodra dhe megjithëse kishte qenë drejtues i Organizatës tonë, meqë OSBE-ja nuk do të lejonte legalizim e saj. Pas votimit të dytë, meqenëse Hashim Thaçi, me gjithë përpjekjet tuaja nuk erdhi, drejtues u zgjodh Bardhyl Mahmuti (Berisha). Kjo qe një zgjidhje disa mujore, që i kushtoi shumë partisë të sapoformuar, pasi në kohën kur secili përpiqej të mblidhte njerëz rreth vetes, LDK-ja gjeti momentin të përhidhte fjalët, të bënte shantazhin medial, të organizohej dhe në pak kohë të mblidhte veten.

Ju propozuat që emri i partisë të mbetej ai që ishte, Lëvizja Popullore e Kosovës. Ndoshta e kishit ende nostalgjinë; Shaban Shala i Drenicës propozoi për emërtimin Bashkimi Demokratik dhe ashtu ngeli.

Kurse unë pata propozuar që partia të emërtohej "Partia Demokratike e Kosovës", por meqë shumica e pjesëmarrëseve kishin kundërshti e përçmim ndaj PD-së në Tiranë, nuk u miratua.

Tani Ibrahim Kelmendi është nomad, në rrugëtim në mes të Prishtinës, Tiranës dhe Tetovës. I papunësuar, pa mjete të rregullta financiare për të mbuluar shpenzimet jetësore, i pabanesë, i pashtëpi. E ngushëllon veten me krenari për fitore, por edhe me raste më të rënda se sa situata e tij jetësore. Jetesën e përballon kryesisht me ndihma të herëpashershme humanitare nga ndonjë mik, që ende ka vullnet të mirë e rahmet, nëse përdor shprehjen fetare arabe për ndihmë – mëshirë.

Në Shoqatën e Veteranëve të Luftës ende nuk më kanë anëtarësuar. Sa herë kam bërë lutje, më është thënë, se duhet të paraqes dëshmi nga Azem Syla. Kur Azem Sylës, para pak

kohe, ia kërkova dëshminë, më tha: “Le të ta japin shokët e tu, Xhaviti dhe Hashimi...”. Në bisedë e sipër, në fund më premtoi se do të bënte diçka. Uroj të ketë mëshirë të ma mundësojë të anëtarësohem, sepse besoj ta kem merituar para rreth 20 mijë vetave, nga se në atë Shoqatë, siç mora vesh, qenkan anëtarësuar mbi 40 mijë veta, madje disa edhe me dëshmi të blera nga drejtues të Shoqatës.

Për të kryer obligimet patriotike e qytetare, si dhe për të përballuar zhgënjimet dhe dëshpërimet për shkak të zvarritjes se shtetndërtimit, jam angazhuar me shkrime, për të cilat nuk me ka paguar ndokush honorar. Kam shkruar e publikuar romanin “Atentatet” në prag të 25-vjetorit të përkujtimit të shokëve heronj, gjaku i të cilëve u derdh në themelin e Lëvizjes dhe jetët e të cilëve u bënë kurban i Lëvizjes - për të dalë fitimtarë dhe faqebardhë; kam botuar librin “Sfidat e radhës”; kam përkrah shoqata të ndryshme dhe gjatë viteve të fundit kryesisht në Maqedoni si korrespondent vullnetar dhe k dhe përpjekem tu përpjekem për të p dhe përpjekemrkrah shqiptarët që t’i avancojnë të drejtat e tyre nacionale e qytetare, etj.

Meqë qenka pyetja e fundit, miku Bedri, më lejoni t’ju shpreh falënderimin për angazhimin tuaj me përkushtim tepër njerëzor, që ta zhvillonim këtë bashkëbisedim kaq të gjatë, në prag të 30-Vjetorit të themelimit të Lëvizjes, me uratën që ky Përvjetor të shënohet dinjitetshëm, më **17 Janar 2012**.

Lexuesit dëshiroj t’i sqaroj se pavarësisht vështirësive të tanishme për të përballuar jetesën; pavarësisht emocioneve të hidhura; pavarësisht hatërmbetjeve ndaj disa ish-bashkëveprimtarëve, që tani ndërtojnë vila marramendëse dhe vënë pandershëm pasuri “për shtatë brezat” e tyre pasardhës pa kthyer kokën fare nga unë, ju siguroj se jam përpjekur të

jem i sinqertë, korrekt, objektiv. Ndonjë informatë e pasaktë që mund të më jetë përvjedhur, nuk ka qenë e qëllimshme, hakmarrëse, por thjesht prodhim i lodhjes së mbamendjes.

Ndaj disa hidhërimeve e armiqësive të kohës kundër bashkëveprimtarëve, sigurisht që distancohem tani.

Jam i vetëdijshëm se për shumë bashkëveprimtarë, tashmë heronj e dëshmorë, nuk kam folur sa duhet, por mundësitë e një bashkëbisedimi mbase nuk lejojnë më shumë. Këtë mangësi do t'ua shpërblej me respekt të përjetshëm, por edhe me shkrime në të ardhmen kur të më jepen mundësitë për publikime.

Nëse edhe për shumë bashkëveprimtarë, që kanë mbijetuar luftën, nuk kam folur mjaftueshëm, i lus të më ndjejnë, sepse është bashkëbisedim pa pretendime dhe jo monografi e kompletuar e Lëvizjes dhe e UÇK-së.

Paraprakisht falënderoj të gjithë ato/ata që do ta lexojnë këtë bashkëbisedim, me shpresë, të paktën të mos më keqkuptojnë, po me respekt për vërejtjet e tyre.

(B.I.: / Autori i intervistës:)

Kjo ishte biseda ime e gjatë me Ibrahim Kelmendin. Si e thashë në fillimin e këtij libri, e kisha dëshiruar prej kohe një bisedë të tillë, ashtu siç e dëshiroj edhe me shokët e mi të tjerë, për ta bërë të qartë jetën e tyre, e përmes saj, edhe jetën e Organizatës që i kanë takuar, meqë ajo ka qenë shumëdimensionale e shumë njerëzore njëkohësisht.

Biseda nuk ka qenë gjithnjë e qetë, e shtruar, pasi, megjithëse jemi miq të vjetër, disa pikëpamje mbi ngjarjet dhe për njerëzit, nuk i kemi të njëllojta. Kjo varet nga mënyra se si i kemi ndërtuar marrëdhëniet, si i kemi parë ngjarjet, në cilën

kohë dhe në cilën perspektivë. Edhe gjatë luftës, jo gjithnjë, i kam mbështetur veprimet e Kelmendit, flas për kohën kur isha drejtues i Organizatës, por ato ia kam thënë në kohën e duhur, e në këtë bashkëbisedim, kam ndërhyrë aty ku e kam parë të arsyeshme të sqaroj ngjarje, rrethana e mendimin tim për njerëz të ndryshëm.

Kam qenë një njeri i lumtur që koha e vitet më bënë të njihem me shumë njerëz, të cilët, duam apo nuk duam, bënë historinë e re të Kosovës. Njëri prej tyre, ndoshta më "rebeli" dhe më kontradiktori njëkohësisht, ka qenë Kelmendi, por mendoj dhe kam bindjen se ka qenë gjithnjë një njeri i sinqertë, i gatshëm të mos njohë klishe e karizma mbi kokë.

Për vete, i takoj një drejtuesi që marrëdhëniet me të nuk i ka pasur të acaruara apo konfliktuale, si kishte ndodhur më parë, thuajse me gjithë të tjerët. Ka ndodhur kështu, jo për ndonjë aftësi timen apo se Kelmendi ishte zbutur, por sepse koha ishte e luftës dhe, në këtë kohë, të gjithë e gjejnë vendin e tyre dhe nuk kanë kohë të shohin për vendin e tjetrit, e aq më pak, të bëjnë fjalë për këtë gjë.

Ka qenë një periudhë e jashtëzakonshme, e cila, më shumë se çdo gjë tjetër, mban emrin e Lëvizjes Popullore të Kosovës, njëra nga gjërat më të vyera të këtij populli në fundshekullin e shkuar.

Bashkëbisedimi ynë mbaron këtu.

Unë do të kisha dëshirën të flisja kështu edhe me shokët e mi të tjerë, pasi, siç e kam thënë, jeta e tyre nuk është më vetëm e tyrja, por një sfidë që duhet shfaqur, një e vërtetë që duhet bërë e njohur, një jetë që duhet të qartësohet.

Ditë më parë, një miku im i mirë, Bajrush Xhemajli, më tregonte një ngjarje nga jeta e familjes së tij. E bija kish-

te ditëlindjen dhe ai si prind e kishte pyetur se çfarë kishte dëshirë. E bija, pa u menduar fare, i kishte thënë se dëshironte që ditëlindjen e saj ta kalonte në Shqipëri. Dhe Bajrushi shtoi: "Ta kisha ditur se do të vinte kjo ditë, kur isha në burgjet serbe, gjithçka do të më ishte dukur më e lehtë".

Ne jemi në një ditë të tillë..., nëse herë pas here kthejmë kokën pas dhe shohim se çfarë është bërë, do të jemi në gjendje të kemi një të ardhme më të mirë.

Unë e falënderoj Ibrahim Kelmendin për idenë që kishte, por edhe i kërkoj ndjesë për mundimet që i dhashë, shqetësimet që i kam përcjellë, nganjëherë nervozizmin tim në mospajtimin me të, por nuk e kam harruar se ne ishim të gjithë si ujërat e lumenjve që, ngado që të rendin, përsëri derdhen në det. Edhe jeta jonë është derdhur e tëra në jetën e Kosovës.

Të faleminderit Lëvizje, të falënderoj për atë që bëre për kombin, por edhe për atë që bëre për mua.

(Bashkëbisedim i autorizuar me 10.01.2012.)

CIP Katalog